

ENVER HOXHA

VEPRA

5

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

**ROTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

5

TETOR 1948 - NËNTOR 1948

**SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1970**

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 5

Në vëllimin e 5-të të veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen: Referati në aktivin e Partisë në Tiranë mbi analizën dhe konkluzionet e Plenumit XI të KQ të PKSH, Fjala e mbylljes në aktivin e Partisë në Korçë, Raporti në Kongresin I të PKSH dhe Fjala e mbylljes në Kongresin I të PKSH.

Rreth analizës dhe konkluzioneve të Plenumit XI të KQ të PKSH ka disa materiale të shokut Enver Hoxha. Në këtë vëllim botohen vetëm Referati në aktivin e Partisë në Tiranë dhe Fjala e mbylljes në aktivin e Partisë në Korçë.

Referati në aktivin e Tiranës ka pothuaj të njëjtën përmbajtje me raportin në Plenumin XI, veçse është pasuruar me gjërat e reja që dolën gjatë diskutimeve në plenum dhe pas plenumit, sidomos rreth veprimtarisë tradhëtare të Koçi Xoxës e të grupit të tij antiparti.

Raportet e shokut Enver Hoxha në Plenumin XI dhe në Kongresin I të PKSH janë vënë në themel të vendimeve të këtyre mbledhjeve historike të Partisë, që shënuan një kthesë të madhe në jetën e brendshme të saj e të gjithë vendit. Plenumi XI dhe Kongresi I shënuan një fitore të vërtetë mbi oportunizmin e trockizmin, shkatërruan përfundimisht ndërhyrjen brutale ar-

miqësore të udhëheqjes jugosllave në Partinë e Punës dhe në Republikën Popullore të Shqipërisë si edhe veprimtarinë tradhëtare të grupit të Koçi Xoxes, ndreqën të gjitha gabimet e vërtetuara në vijën politike dhe sidomos në vijën organizative të Partisë për shkak të kësaj ndërhyrjeje e të kësaj veprimtarie tradhëtare, e pajisën Partinë me një vijë të përgjithshme të drejtë marksiste-leniniste, e armatosën atë dhe masat popullore me një program shkencor për ndërtimin e bazave të socializmit dhe me një përvojë të madhe të luftës kundër revizionizmit modern.

Trajtimi i çështjeve dhe i ngjarjeve në materialet e këtij vëllimi karakterizohet nga një analizë e thellë shkencore mbi baza marksiste-leniniste.

Në mënyrë të veçantë analizohet me një logjikë të hekurt marksiste-leniniste lufta e Partisë kundër ndërhyrjes armiqësore të udhëheqjes jugosllave në punët e brendshme të Partisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, kundër tezave dhe teorive antimarksiste të revizionistëve jugosllavë, duke zbuluar karakterin oportunisto-trockist të këtyre tezave e teorive.

Drejtësia e kësaj analize është vërtetuar plotësisht edhe nga zhvillimi i ngjarjeve të mëvonshme. Sado që kanë kaluar shumë vjet nga koha kur janë krijuar këto materiale, ato ruajnë kurdoherë një vlerë aktuale përsa i përket mbrojtjes dhe zbatimit me besnikëri e në mënyrë krijuese të parimeve themelore të marksizëm-leninizmit, të ligjeve të përgjithshme të revolucionit e të ndërtimit socialist.

Në trajtimin marksist-leninist që u bën çështjeve e ngjarjeve shoku Enver Hoxha në Plenumin XI të KQ

dhe në Kongresin I të PKSH, një rol historik kanë luajtur letrat e KQ të PK(b) të BRSS, drejtuar KQ të PKJ dhe Rezolucioni i Byrosë Informativë të disa partive komuniste «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave». Këto materiale, që gjetën praninë të njëzëshëm në gjithë Partinë dhe në masat punonjëse të Shqipërisë, hodhën dritë në shumë anë të errëta të vijës politike e të veprimtarisë antimarksiste të udhëheqjes së PKJ. Kjo dritë e ndihmoi drejtpërdrejt Partinë e Punës të Shqipërisë të realizonte plotësisht ndërhyrjen brutale dhe qëndrimet revizioniste të grupit Tito, Kardel, Gjilas, Rankoviç.

Si çdo dokument e material historik, edhe veprat e shokut Enver Hoxha në këtë vëllim mbajnë vulën e kohës. Prandaj që të kuptohet drejt brendia e tyre, është e domosdoshme të mbahen medoemos parasysh rrethanat në të cilat janë krijuar.

Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik, shteti sovjetik, nën udhëheqjen e J. V. Stalinit, në ato rrethana qëndronin mbi baza të shëndosha revolucionare marksiste-leniniste, duke ndjekur me besnikëri rrugën e mësimet e V. I. Leninit; si partia më e madhe dhe si partia e parë e klasës punëtore e tipit të ri, si shteti i parë dhe më i fuqishëm socialist, luanin një rol vendimtar historik në fatet e socializmit dhe të marksizëm-leninizmit në shkallë botërore.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u orientuar në politikën e saj nga Partia Bolshevike e nga Bashkimi Sovjetik, mbronte marksizëm-leninizmin dhe rrugën revolucionare marksiste-leniniste të revolucionit dhe të ndërtimit të shoqërisë socialiste, mbronte unitetin e

kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në të cilën Partia Bolshevike, me përvojën e saj të madhe dhe me shembullin e saj, luante një rol pararojë.

Por kursi marksist-leninist i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik pësoi një përmbysje rrënjësore pas vdekjes së J. V. Stalinit. Revizionistët hrushovianë, që rrëmbyen pushtetin në parti dhe në shtetin sovjetik, e zëvendësuan politikën revolucionare, të ndjekur nga Partia Bolshevike të udhëhequr nga V. I. Lenini dhe J. V. Stalini, me një kurs të ri kryekëput antimarksist, antileninist. Prej kësaj kohe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe shteti sovjetik e humbën rolin pararojë të mëparshëm në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në lëvizjen revolucionare botërore, duke marrë përsipër një rol në thelb antikomunist, reaksionar, imperialist.

Përsa i përket Partisë Komuniste Jugosllave, e cila më vonë u quajt Lidhja e Komunistëve Jugosllavë, ajo i thelloi edhe më shumë qëndrimet antimarksiste, antileniniste në vijën politike dhe në veprimtarinë e saj, si në shkallë kombëtare, ashtu edhe ndërkombëtare. Ky fakt flet për drejtësinë e vlerësimeve rreth këtyre qëndrimeve që bënë atëhere Partia Bolshevike, Byroja Informativ e disa partive komuniste, Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera komuniste e punëtore. Nuk shkoi një kohë e gjatë që të arrihej përfundimisht në konkluzionin, se kursi i ndjekur nga udhëheqja jugosllave dhe Lidhja e Komunistëve Jugosllavë, përbënte një revizionim të vetëdijshëm rrënjësor të marksizëm-leninizmit.

Këtu duhet vënë në dukje se termi «revizionist» në

kohën e Plenumit XI dhe të Kongresit I të PKSH, nuk përdorej. Në vend të tij është përdorur shpesh termi «trockist» për të përcaktuar qëndrimet revizioniste të udhëheqjes jugosllave. Ky term atëhere përdorej zakonisht për të cilësuar çdo lloj shmangjeje nga marksizëm-leninizmi dhe jo vetëm për ndjekësit ideologjikë të Trockit.

**REFERAT NË AKTIVIN E PARTISE NË TIRANË
MBI ANALIZËN DHE KONKLUZIONET
E PLENUMIT XI TË KQ TË PKSH**

4 Tetor 1948

**RËNDËSIA E LETRAVE TË PARTISE BOLSHEVIKE,
DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË PARTISE
KOMUNISTE JUGOSLLAVE DHE E REZOLUCIONIT
TË BYROSE INFORMATIVE**

E gjithë Partia jonë është në dijeni të letrave të një rëndësie të madhe historike, që Partia Bolshevike e BS i ka drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave¹. Me anën e tyre Partia Bolshevike u tërheq vërejtjen dhe i qorton udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave për një sërë gabimesh të mëdha parimore që kanë bërë, i këshillon ata në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe u tregon mënyrën e shpejtë e radikale, për të korrigjuar këto gabime të rrezikshme.

E gjithë Partia jonë është gjithashtu në dijeni të Rezolucionit të Byrosë Informative «Mbi gjendjen në

¹ Këto letra ju drejtuan KQ të PKJ nga KQ i PK(b) të BS me 27 mars, 4 maj dhe 22 maj 1948.

Partinë Komuniste Jugosllave»¹. Ky rezolucion që u punua nga të deleguarit e Komitetit Qendror në gjithë Partinë dhe tërë organizatat e Frontit Demokratik, u aprovua njëzëri nga gjithë komunistët dhe masat punonjëse të vendit tonë, të cilat u treguan solidare deri në fund me Partinë Bolshevike, me mësuesin tonë të madh Stalinin, me Byronë Informative dhe me Deklaratën e Komitetit Qendror të Partisë sonë.²

Komiteti ynë Qendror u shpjegoi gjerësisht Partisë dhe masave të gjera të popullit tonë në se konsistonte tradhëtia e madhe e udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, në se konsistonte politika e tyre antishqiptare dhe ç'rëndësi kanë letrat e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Partinë tonë dhe për unitetin e kampit socialist. Gjithashtu Komiteti ynë Qendror u vuri mirë në dukje Partisë dhe masave të gjera të popullit rëndësinë historike të Rezolucionit të Byrosë Informative.

Udhëheqësit tradhëtarë të Partisë Komuniste Jugosllave, me klikën nacionaliste të Titos, Kardelit, Rankoviçit, Gjilasit, etj., në krye, janë vënë në pozita antimarksiste, antisovjetike dhe kundër kampit të socializmit. Udhëheqësit jugosllavë janë revizionistë të marksizëm-leninizmit dhe vazhdues të vërtetë të teorive opor-

¹ Rezolucioni u aprovua në mbledhjen e Byrosë Informative që u mbajt në Bukuresht në qershor 1948.

² Është fjala për komunikatën e Komitetit Qendror të PKSH të datës 1 korrik 1948, që aprovoi mbledhja e jashtëzakonshme e Plenumit të KQ të PKSH, e cila mori në shqyrtim Rezolucionin e Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave».

tuniste dhe likuidatore të Bernshtajnit, Folmarit, Buharinit, të menshevikëve dhe trockistëve të tjerë. Teoritë e gjithë këtyre tradhëtarëve të marksizmit ata i kanë bërë të tyret, janë përpjekur me demagogji t'u veshin një rrobë të re dhe t'i paraqesin si zhvillim gjoja specifik të marksizmit, në përshtatje me kushtet e reja të krijuara nga Lufta e dytë botërore. Duke devijuar nga rruga marksiste-leniniste, ata kanë rënë në pozita nacionaliste borgjeze dhe në një shovinizëm të shfrenuar, duke braktisur kështu dhe luftuar traditat internacionaliste të Partisë Komuniste Jugosllave.

Klika nacionaliste e Titos me shokë ka ndjekur një politikë të egër dhe shpifëse kundër Bashkimit Sovjetik, atdheut të parë të socializmit, udhëheqësit të kampit të socializmit në botë. Këta tradhëtarë, duke shpifur kundër Bashkimit Sovjetik, kishin për qëllim të diskreditonin sistemin socialist dhe të shkurorëzonin kësisoj ndërtimin e socializmit. Ata u përpoqën njëkohësisht që pikëpamjet e veta t'i përhapin edhe në vendet e tjera të demokracisë popullore për të mbështetur dhe fuqizuar edhe më tepër veprën e tyre tradhëtare.

Grupi nationalist-trockist i Titos ka ndjekur një politikë dinake dhe të poshtër ndaj Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, duke shpifur pas krahëve kundër saj gjëra monstruoze, duke bërë nga pozita trockiste të djathta po ato akuza dhe shpifje, që bënte Trocki në kohën e tij, kundër të cilave Lenini dhe Stalini bënë një luftë të ashpër e të vendosur.

Klika tradhëtare e Beogradit ka zbatuar një politikë të denjë për imperialistët ndaj Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, që luajti rolin kryesor në shpëtimin e bo-

tës dhe të vetë Jugosllavisë nga robëria më e rëndë e fashizmit gjerman dhe që krijoi kushtet e favorshme në Evropë për formimin e shteteve të demokracisë popullore, për fuqizimin dhe zhvillimin e tyre në rrugën e ndërtimit socialist. Udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave, të verbuar nga nacionalizmi i tyre, janë përpjekur të mohojnë rolin çlirues të Ushtrisë Sovjetike dhe kanë përçmuar artin ushtarak të saj. Ata, me megalomani e me fodullëk, janë përpjekur të ngrenë artin ushtarak të ushtrisë jugosllave në një shkallë shumë më të lartë se ai i ushtrisë së Bashkimit Sovjetik duke thënë se «ata i kanë shtuar diçka të re marksizëm-leninizmit» në këtë drejtim. Një vijë e tillë antisovjetike ka pasë për qëllim të krijojë në popujt e Jugosllavisë, në Partinë Komuniste dhe në ushtrinë jugosllave mosbesim ndaj Bashkimit Sovjetik dhe ndaj ushtrisë së tij të lavdishme. Një punë të tillë bëjnë edhe imperialistët anglo-amerikanë dhe gjithë reaksioni në botë.

Këto pikëpamje antimarksiste i vunë udhëheqësit tradhëtarë të Partisë Komuniste Jugosllave kundër unitetit të kampit të socializmit në botë. Ata janë përpjekur me çdo kusht ta dobësojnë dhe likuidojnë këtë unitet, vetë kampin socialist dhe frontin demokratik antiimperialist në botë.

Udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave, me Titon në krye, kanë lejuar në partinë e tyre forma të tilla organizimi dhe pune, që kanë pasur për qëllim dhe si rrjedhim zhdukjen e demokracisë së brendshme të partisë, mbytjen e kritikës dhe të autokritikës, futjen në parti të metodave ushtarake të drejtimit, ngritjen e kultit të «heronjve» sipas pikëpamjes narodnike, vënjen

e partisë nën kontrollin e Ministrisë së Sigurimit të Shtetit, futjen e ndjenjës së frikës në parti, mbajtjen e partisë në ilegalitet dhe, krahas me këtë, shkrirjen e partisë në front dhe shndërrimin e saj në një parti borgjeze e kulakësh. Duke ndjekur një politikë oportuniste ndaj elementit kapitalist, ata kanë zbutur luftën e klasave në fshat, sipas orientimit buharinian që, në periudhën tranzitore nga kapitalizmi në socializëm, lufta e klasave nuk ashpërsohet, por shuhet. Gjithë kjo veprimtari tradhëtare ka për qëllim degjenerimin e Partisë Komuniste Jugosllave dhe degjenerimin e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë në një republikë të tipit borgjez.

Qëllimi i letrave të Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të PKJ, ka qenë që udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave të shkëputeshin dhe të dënonin një herë e përgjithmonë këtë rrugë që i çonte në tradhëti, të njihnin ndershmërisht gabimet e tyre kaq të rrezikshme, t'i korrigjonin ato për interesin e madh të partisë e të popujve të tyre dhe për interesin e kampit të socializmit. Tradhëtarët trockistë të Beogradit, jo vetëm nuk i njohën këto gabime të pamohueshme, por i cilësuan ato paturpësisht si shpifje nga ana e Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe partive të tjera, duke u hapur atyre një luftë të ndyrë prej tradhëtarësh me damkë të marksizëm-leninizmit dhe prej shërbëtorësh të bindur të imperializmit skllavërues.

Udhëheqja tradhëtare e Partisë Komuniste Jugosllave, me një këmbëngulje armiqësore dhe konsekuente në veprën e saj, qëndron në pozitat e saja antimarksiste, antisovjetike dhe kundër kampit të socializmit. Ajo, me

metodat policore që ka futur në Partinë Komuniste Jugosllave, nën presionin dhe frikën e Ministrisë së Sigurimit të Shtetit, thirri Kongresin e 5-të¹, jashtë rregullave të një partie të tipit marksist-leninist-stalinian dhe me terror të ushtruar haptas për të mposhtur vullnetin e partisë dhe të elementit të saj të shëndoshë, legalizoi tradhëtinë e saj. Klika e Beogradit po mban nën një terror të pashoq Partinë Komuniste Jugosllave, mobilizon rreth vetes elementin nacionalist dhe shovinist, duke goditur nga ana tjetër elementin e shëndoshë të partisë, përpiqet të armiqësojë popujt e Jugosllavisë me popujt e tjerë të vendeve të demokracisë popullore dhe, në radhë të parë, me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe Partinë Bolshevike. Një demagogji të madhe po zhvillon ajo për të gënjyer masat e shëndosha të partisë dhe të popujve jugosllavë që kanë një dashuri të sinqertë e të madhe ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike me shokun Stalin në krye, si edhe ndaj partive të tjera motra. Ajo përpiqet me dinakëri të mbulojë tradhëtinë e saj të madhe. Duke marrë disa masa të gabuara e të shpejtuara përpiqet t'u krijojë popujve të Jugosllavisë përshtypjen sikur po i ndreq gabimet dhe po ecën në rrugën e marksizëm-leninizmit. Masat e këtyre antimarksishtëve të regjur nuk bëjnë gjë tjetër përveçse shtojnë rrezikun dhe thellojnë ca më tepër greminën, ku po i çojnë ata partinë dhe popujt e Jugosllavisë, thellojnë edhe ca më tepër armiqësinë që ushqejnë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe kampit të socializmit. Nga këto pozita nacionaliste, Republika Federative Popullore e Jugoslla-

¹ Kongresi i 5-të i PKJ u mbledh më 21 korrik 1948.

visë do të degjenerojë në një vend të varur nga imperializmi amerikan dhe anglez.

Qëndrimi nacionalist e antimarksist i udhëheqjes jugosllave përbënte një rrezik jo vetëm për Partinë Komuniste Jugosllave, për popujt e Jugosllavisë dhe Republikën e tyre Popullore, por formonte një rrezik të madh edhe për Partinë dhe popullin tonë, sepse në mes dy vendeve tona ishin vendosur lidhje shumë të ngushta, ekonomike e politike. Vepra armiqësore e udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave do të refleктоhej dhe do t'i imponohej, pa asnjë dyshim, edhe Partisë e popullit tonë, në rast se Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror nuk do të ishin vigjilentë për të mbrojtur pastërtinë e vijës së Partisë, dhe në rast se nuk luftonin me ashpërsi të madhe tendencat armiqësore, likuidatore, oportuniste, antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të udhëheqjes trockiste të Partisë Komuniste Jugosllave.

Pas çlirimit të vendit situata në Partinë tonë, dhe veçanërisht në udhëheqjen e saj, ishte me të vërtetë shumë e rëndë dhe e vështirë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, duke krijuar një atmosferë shumë të sëmurë, një atmosferë lufte dhe mosbesimi në radhët e Komitetit tonë Qendror, duke e mbajtur atë nën presionin e shantazheve ekonomike, etj., do të shkaktonte që ky të bënte gabime të rënda. Nga një situatë e tillë Partinë e shpëtoi qëndresa e saj e vendosur kundër ndërhyrjes jugosllave dhe drita që hodhën letrat e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave dhe mbi veprimtarinë e udhëheqjes së saj. Letrat e Partisë Bolshevike erdhën në momentin më kritik që kalonte Partia jonë. Ato i bë-

në plotësisht të qartë Komitetit Qendror të Partisë sonë situatën e rëndë që ekzistonte në Partinë Komuniste Jugosllave e, i ndihmuan atij të zbulonte shkaqet e vërteta të gabimeve të rënda, të shikonte qartë se ku qëndronte sëmundja që e dobësonte udhëheqjen e Partisë sonë dhe vetë Partinë. Këto letra historike do të qëndrojnë si shembull i një qëndrimi parimor e internacionalist të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit për të ndihmuar një parti motër. Ato ndihmuan edhe Partinë tonë për të bërë një kthesë të rëndësishme në historinë e saj, për të shpëtuar nga gremina e tmerrshme, ku kërkonte ta tërhiqte me mënyra antimarksiste udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave. Partia jonë u shkund nga një sëmundje e rrezikshme me të cilën kërkonin ta infektonin udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave, ajo u çlirua nga një ankth dhe mori frymë lirisht. Letrat e Partisë Bolshevike na ndihmuan të bëjmë këtë analizë të shëndoshë të punës sonë, të shohim qartë dhe të njohim ndershmërisht gabimet që janë bërë, t'i korrigjojmë këto dhe të mësojmë prej tyre, të forcojmë udhëheqjen dhe Partinë tonë, të armatosemi me një eksperiencë të madhe që do të na shërbejë për ta çuar Partinë kurdoherë përpara dhe për ta ruajtur nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të saj, që përpiqen kurdoherë ta dëmtojnë.

PLENUMI I BERATIT DHE REZULTATET E TIJ

Partia dhe udhëheqja e saj ka bërë disa herë analizën e punës së vet, sidomos prej çlirimit të Shqipërisë e këtej. Këto analiza kanë pasur në bazë qëllime të mira:

të forconin Partinë dhe ta pastronin atë nga disa gabime, që ishin vërtetuar dhe që mund të bëheshin të rrezikshme. Gjatë gjithë jetës së Partisë sonë disa shokë udhëheqës kanë gabuar rëndë, janë përpjekur ta shtrembërojnë vijën e drejtë të saj, kanë devijuar nga kjo vijë e drejtë, prandaj kanë marrë dënimin e merituar.

Do të jetë absurde dhe aspak e drejtë të themi se gjatë gjithë jetës së Partisë sonë nuk janë vërtetuar gabime në udhëheqje dhe në udhëheqës të veçantë të saj. Por çështja është se këto gabime, që bëheshin nga mungesa e eksperiencës së njerëzve tanë, nga situatat e koklavitura që u krijuan gjatë gjithë periudhës së luftës, nga vështirësitë që u hasën në ndërtimin e Shqipërisë së re, nga niveli i ulët ideologjik i masave të gjera të Partisë dhe të disa udhëheqësve, nuk u shikuan dhe nuk u korrigjuan në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Këto gabime u përdorën për të krijuar situata të vështira për Partinë tonë, u përdorën për qëllime të caktuara antiparti dhe antimarksiste nga të deleguarit e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe nga vetë Komiteti Qendror i PKJ.

Për të analizuar drejt gabimet e vërtetuara në Parti, ato ne nuk mund t'i shkëpusim nga influenca e keqe që ushtronte Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave; nuk do të jetë e drejtë që gabimet e vetë udhëheqjes së Partisë sonë t'i shkëpusim nga ndërhyrja armiqësore e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Mendimi ynë është se, pa influencën e dëmshme që ushtronte Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë për një periudhë të gjatë mbi Partinë tonë, udhëheqja e Partisë sonë nuk do të bënte

gabime të mëdha në punën e saj. Pa ndërhyrjen e tyre gabimet qoftë këto të vogla në praktikë, qoftë të meta individuale, do të korigjoheshin, sikundër që janë korigjuar mjaft prej tyre dhe Partia do të kishte bërë hap edhe më të mëdhenj përpara. Që të bëjmë një analizë me të vërtetë objektive dhe në baza marksiste-leniniste, na duhet të shikojmë të gjitha etapat nëpër të cilat ka kaluar Partia, të rishikojmë të gjitha analizat që janë bërë në Partinë tonë dhe t'i vëmë çështjet drejt në vendin e tyre. Duhet të sqarojmë mirë cilat janë me të vërtetë gabime dhe të hedhim poshtë të gjitha ato që s'kanë qenë të tilla, por që janë quajtur «gabime të rënda» në rrethana të errëta e me qëllime të caktuara. Tani ne kemi mundësi ta bëjmë këtë analizë nga pozita të qarta dhe të shëndosha marksiste-leniniste.

Situatat e krijuara para Plenumit XI kanë lënë gjurmë në radhët e Partisë dhe në kuadrot e saj. Janë krijuar mendime, paragjykime dhe simpati të sëmura, të cilat duhet të sqarohen. Analiza e Plenumit XI të na shërbejë për të shëndoshur si Partinë, ashtu edhe kuadrot e saj. Është koha që anëtarët e kuadrot e Partisë të shkunden nga të gjitha pikëpamjet e gabuara të së kaluarës, është koha që ata të shëndoshen në rrugën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Për t'i analizuar drejt situatat e ndryshme që janë krijuar në Parti dhe gabimet që janë vërtetuar në këto situata, duhet të analizojmë para së gjithash punën që është bërë për përgatitjen e Plenumit II të KQ në Berat në nëntor të vitit 1944 dhe pasojat e tija në fund të vitit 1944 dhe menjëherë pas çlirimit të plotë të Shqipërisë. Andej duhet ta nisim punën, pse atje e kanë origjinën

sëmundjet dhe gabimet më të rënda që janë bërë nga udhëheqja jonë dhe pse pas Plenumit të Beratit fillon ndërhyrja e hapët dhe me qëllime armiqësore e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë kundër Partisë sonë.

A ishte e nevojshme thirrja e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë në prakun e çlirimit të Shqipërisë? Ne mendojmë se ishte jo vetëm e nevojshme, por e domosdoshme, për arësyet e mëposhtme:

a) Ai duhet të bënte bilancin e forcave dhe të fitoreve të Partisë sonë që ndërmori një luftë kaq të madhe dhe çliroi popullin e atdheun nga një robëri e rëndë, duhej të mendonte për detyrat e etapës së re që do të përballonte Partia. Detyra të mëdha i viheshin asaj përpara në prakun e çlirimit, siç ishin rindërtimi i vendit të shkatërruar nga lufta, forcimi i pushtetit popullor dhe i ekonomisë popullore. Partia ishte e vetmja forcë drejtuese e popullit tonë. Ajo duhej të vihej në krye të këtyre detyrave historike. Pra, Komitetit Qendror të Partisë i binte barra të mblidhej dhe të përcaktonte vijën që duhej të ndiqte Partia pas çlirimit.

b) Ai duhej të rishikonte punën e Partisë gjatë gjithë periudhës së luftës, të bënte në mënyrë marksiste analizën e fitoreve dhe të gabimeve që ishin konstatuar gjatë punës, të mësonte nga këto gabime, t'i korrigjonte drejt dhe të merrte masa që ato të mos përsëriteshin më, në mënyrë që të forcohej Partia dhe roli i saj drejtues.

Plenumi i Komitetit Qendror që u mbajt në Berat, në formë u thirr për qëllimet që përmenda më lart, por në realitet qëllimet e drejta të tij u shtrembëruan. Ato u zëvendësuan me qëllime të këqia e prapaskena të dëm-

shme e të rrezikshme. Në Berat, pas një pune konspirative në prapaskenë, në formë grupazhi të organizuar, fshehurazi nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, fshehurazi nga shumica dërmuese e Komitetit Qendror të Partisë, u përgatit goditja kundër vijës së drejtë që kishte zbatuar Partia gjatë gjithë kohës së luftës dhe kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Një veprimtari e tillë, e dënueshme nga të gjitha rregullat e Partisë sonë, kryesohej nga delegati i jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, i mbështetur nga Sejfulla Malëshova, shërbëtor i borgjezisë dhe nga shoku Nako Spiru, Koçi Xoxe, Pandi Kristo, etj.

Cilat ishin qëllimet që dëshironte të arrinte Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave në Plenumin e Beratit?

a) Të luftonte çdo pikëpamje e qëndrim të drejtë marksist-leninist që synonte të ruante pavarësinë e Partisë sonë.

b) Të arrinte që të vinte Partinë tonë në realitet nën drejtimin e plotë të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të bënte që ajo të zbatonte pa diskutim direktivat e Komitetit të saj Qendror.

c) Të formonte bindjen te njerëzit tanë se lufta e Partisë dhe e popullit tonë i detyrohej drejtimit dhe direktivave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe, si rrjedhim, Partia dhe populli ynë, edhe pas çlirimit gjithë luftën e rezultatet t'ja dedikonin Partisë Komuniste Jugosllave dhe udhëheqjes «së ndritur» të saj.

ç) Të diskreditonte udhëheqjen e Partisë sonë, që

kishte drejtuar luftën dhe e kishte çuar popullin në fitore, duke e akuzuar këtë për një sërë gabimesh që gjoja kishte bërë gjatë periudhës së Luftës nacional-çlirimtare, për ta nxjerrë atë të paaftë për të përballuar detyrat e rënda që i viheshin me çlirimin e Shqipërisë.

d) Të krijonte dhe të mbante gjallë një përçarje në Komitetin Qendror të Partisë sonë, duke shfrytëzuar në mënyrë djallëzore të metat dhe lëshimet që ishin vërtetuar gjatë periudhës së luftës, duke inkurajuar njerëzit ambiciozë dhe karrieristë, duke influencuar disa udhëheqës të Partisë sonë që të binin në pozitat e gabuara të udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të bënin lojën e tyre. Në këtë mënyrë udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave, do të mund t'i impononte më me lehtësi vullnetin dhe pikëpamjet e saja të sëmura Komitetit Qendror të Partisë sonë, të dobësuar nga një punë e tillë armiqësore.

Cilat ishin qëllimet e atyre udhëheqësve të Partisë sonë që ranë në pozitat e udhëheqjes jugosllave në Plenumin e Beratit?

Sejfulla Malëshova, që ishte një megaloman i sëmurë dhe ambicioz, kishte prirje të dilte në krye të Partisë dhe t'i imponohej asaj vetëm me blofe. Ai synonte të zinte kryesinë e Partisë, pa dhënë prova se e meritonte. Jo kryesinë e Partisë, por ai nuk meritonte as edhe vendin që ju dha padrejtësisht para Beratit dhe sidomos pas Beratit. Për t'ja arritur qëllimit të tij, Sejfulla Malëshova u bashkua me pikëpamjet antimarksiste të udhëheqësve jugosllavë. Ai e akuzoi Partinë tonë heroike, Partinë tonë, që kurrë s'kishte gabuar në vijën e saj politike, si «një parti jomarksiste, si një parti

që ka pasur një vijë politike të gabuar, si një parti që po degjenerohej në një parti banditësh dhe terroriste». Më në fund ai goditi rëndë udhëheqjen e Partisë sonë, duke e akuzuar atë si të pazonjën dhe të paaftë për të drejtuar. Sejfulla Malëshova me teorinë e tij të «shefit të partisë» u përpoq sa mundi të diskreditonte Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë si të padenjë për vendin që i kishte besuar Partia, duke arritur të thoshte në prapaskenë, për të bindur anëtarët e tjerë të Komitetit Qendror, se «nuk është moment i përshtatshëm, pa Enver Hoxha nuk e meriton të jetë Sekretar i Partisë». Sejfulla Malëshova, një oportunist i regjur, u bashkua me pikëpamjet oportuniste të delegatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, Velimir Stojnićit, edhe përsa i përket vijës që kishte ndjekur Partia jonë gjatë luftës dhe asaj që duhej të ndiqte pas luftës. Komiteti Qendror i Partisë sonë e demaskoi këtë oportunist të fëlliqur, përpara shfaqjes së sëmundjes së madhe që kishte molepsur Partinë Komuniste Jugosllave. Këtu është vendi të thuhet që Sejfulla Malëshova në Berat jo vetëm u shërbeu qëllimeve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, për të goditur Partinë tonë, por pikëpamjet e tija oportuniste përputheshin kryekëput me pikëpamjet antimarksiste e likuidatore të udhëheqjes jugosllave, lidhur me rolin e partisë dhe të klasës punëtore; ai ishte një shërbëtor i kulakëve, i borgjezisë dhe i reaksionit shqiptar.

Cilat ishin qëllimet e Koçi Xoxes dhe të Nako Spirut?

Ne mendojmë se jugosllavët përfituan gjerësisht nga ambicia e sëmurë e Koçi Xoxes dhe nga pakënaqë-

sitë e Nako Spiru dhe i përdorën këta për qëllimet e tyre.

Pa asnjë arsye të shëndoshë, shoku Nako Spiru doli në Berat si njeriu më i pakënaqur, sikur kundër tij ishin bërë padrejtësira të mëdha dhe ishte përbuzur nga ana e drejtuesve të tjerë kryesorë të Partisë. Këto pakënaqësi, që në realitet fshihnin ambicien e tij të sëmurë, ai diti t'i maskojë deri diku dhe të frenojë kritikën kundër vijës së Partisë në mbledhjen e Plenumit të Beratit.

Nga ana tjetër, Koçi Xoxe foli për gabime të paqena në vijën e Partisë. Ai kritikoi Partinë për shfaqje oportunizmi dhe për shtrembërime organizative. Koçi Xoxe u bashkua me qëllimet antimarksiste të udhëheqjes jugosllave për të zgjidhur pakënaqësitë e tija personale dhe sepse kishte pikëpamje të gabuara për sa i përket qëndrimit të ashtuquajtur oportunist të Partisë ndaj «Ballit Kombëtar». Përveç kësaj, ai nuk kishte besim te Sekretari i Përgjithshëm i Partisë dhe u bashkua në rrugën e dëmshme që shtronin delegatët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave për të arritur qëllimet e tyre antimarksiste dhe antishqiptare.

Në Berat këta shokë punën e tyre më të madhe e më të dëmshme e kanë bërë në prapaskenë. Koçi Xoxe e Nako Spiru ishin të parët që muarën kontakt me delegatin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe tok me të, arritën që Plenumi i Beratit, nga një mbledhje e rregullt e Komitetit Qendror, të shndërrohej në një mbledhje jashtë çdo rregulli partie, e kurditur për të goditur vijën e Partisë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të saj. Mendimi ynë është se Nako Spiru

u bashkua me udhëheqësit jugosllavë, pasi dëshirat e tija puqeshin me synimet e këtyre, të cilët mendonin ta zëvendësonin Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë si një «persona non grata» për ta.

Ne mendojmë se në fakt të metat dhe gabimet që ishin vërtetuar në Parti gjatë periudhës së luftës, si për Koçin e Nakon, ashtu edhe për udhëheqësit jugosllavë, kishin një rëndësi të dorës së dytë, por ato u përdorën prej tyre për qëllime të veçanta, që çonin ujë në një kanal, në dobësimin e Partisë dhe në përçarjen e udhëheqjes së saj. Nako Spiru dhe Koçi Xoxe, dy nga udhëheqësit kryesorë të Partisë, del qartë se kanë qenë në opozicion të heshtur me Sekretarin e Përgjithshëm, pikërisht të shtyrë më tepër nga pakënaqësitë personale. Të nisur nga këto pakënaqësi personale, ata bënë që Plenumi II i KQ në Berat të kthehej në interes të antimarksistëve jugosllavë, të bëhej pikënisja e sëmundjes dhe e gabimeve që do të vërtetoheshin më vonë në Partinë tonë. Këta shokë, kanë gabuar rëndë të influencuar nga intriga e madhe e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, kanë bërë lojën e tij.

Në Plenumin e Beratit u kritikua ashpër udhëheqja e Partisë sonë për gjoja gabimet e mëdha që ajo kishte bërë. Cilat ishin këto gabime? A ka pasur gabime politike ose organizative në vijë? Ne themi se gjatë gjithë kohës së Luftës nacional-çlirimtare vija politike e Partisë sonë ka qenë e drejtë. Edhe vija organizative, në përgjithësi, ka qenë e drejtë.

Partia jonë nuk ka gabuar politikisht. Qëndrimet e saj ndaj okupatorit, ndaj «Ballit Kombëtar», ndaj «Legalitetit» dhe kuislingëve, kanë qenë të drejta. Në ato

momente oportunisti e lëkundja në qëndrimet e Partisë ndaj elementit të ashtuquajtur nacionalist ishte rrezik. Por lëkundje të tilla nuk u vërtetuan në vijën e Komitetit Qendror. Shfaqjet oportuniste që janë vërtetuar gjatë periudhës së Luftës nacional-çlirimtare, si kompromisi me gjermanët në Berat, Mukja dhe disa qëndrime oportuniste të përkohëshme dhe sporadike në Gjirokastrë, nuk ishin gabime të Partisë dhe të Komitetit Qendror të saj, por gabime të personave të veçantë. Këto gabime janë goditur ashpër nga Komiteti Qendror.

Kompromisi i Beratit nuk e ka burimin te vija e Partisë sonë. Ky ishte një gabim i palejueshëm dhe i rëndë i një udhëheqësi, por jo i Komitetit Qendror dhe i Partisë. Mukja ishte gjithashtu vepra personale e oportunistit Ymer Dishnica, element me pikëpamje oportuniste të theksuara, njeri megaloman dhe i bindur për «zotësinë e tij», njeri i shtresave të larta të borgjezisë dhe jo gabimi i Komitetit Qendror të Partisë. Sejfulla Malëshova u përpoq në Plenumin e Beratit t'ja vishte gabimin e madh të Ymer Dishnicës, Komitetit Qendror dhe vijës gjoja të gabuar të Partisë sonë. Kjo ishte një shpifje dhe një orvatje e pashpresë. Komiteti Qendror jo vetëm që e kishte këshilluar Ymer Dishnicën të vepronte ndryshe nga ç'veproi, por dhe kur e mori vesh tradhëtinë e Ymer Dishnicës e dënoi menjëherë pamëshirë këtë akt të tij.

Në Plenumin e Beratit Nako Spiru ka thënë se «Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj u gjetën të përgatitur përpara themelimit të «Ballit Kombëtar» dhe nuk e kuptuan që «Balli» doli si reaksion kundër Frontit Nacional-Çlirimtar». Kjo nuk është e vërtetë. Krijimi

i «Ballit Kombëtar» nuk ishte aspak një gjë e papritur për Partinë tonë. Komiteti ynë Qendror në asnjë moment nuk ka dyshuar për ekzistencën e reaksionit në vendin tonë, i cili përbëhej prej kuislingëve, në radhë të parë, prej bejlerëve latifondistë, prej borgjezisë së pasur, tregëtarëve të mëdhenj të lidhur me okupatorin, si dhe prej politikanëve tradhëtarë. Ai e parashikonte që grumbullimi i reaksionit do të ishte i paevitueshëm, prandaj edhe po përgatitej për luftë kundër tyre. Pra, edhe për krijimin e organizatës së «Ballit Kombëtar», Komiteti ynë Qendror ishte në dijeni. Por që influenca e Partisë sonë në ato momente nuk ishte aq e fortë, edhe kjo është e vërtetë. Partia sapo që formuar. Puna e saj në masat e gjera të popullit akoma ishte e dobët. Njerëzit e Partisë nuk kishin akoma një eksperiencë të madhe, elementët që do të viheshin në krye të «Ballit», mbanin akoma një qëndrim ekuivok dhe s'kishin dalë në skenë hapët. Këta e konsideruan Partinë tonë dhe lëvizjen nacional-çlirimtare si diçka sporadike, vepër prej kalamanësh të fantaksur, që shpejt do të zhduke-shin nga forcat e okupatorit. Por faktet provuan të kundërtën. Lëvizja jonë nuk ishte as e rastit dhe as sporadike. Partia jonë ishte një organizatë e shëndoshë që do ta udhëhiqte me vendosmëri këtë lëvizje.

Pas Konferencës së Pezës okupatori dhe reaksioni i brendshëm i mprehën armët kundër Partisë sonë dhe krijuan një farë organizate, siç ishte «Balli Kombëtar». «Balli Kombëtar» ishte një organizatë heterogjene, pa forma organizative të përcaktuara, por me një program demagogjik, që kishte për qëllim të gënjente shumë njerëz të lëkundur, sidomos borgjezinë e mesme e të vo-

gël dhe fshatarësinë, ose t'i neutralizonte këto, në rast se nuk do të mundte t'i hidhte në luftë të hapët kundër nesh. Të ashtuquajturat çeta të «Ballit Kombëtar» ishin në pritje të ngjarjeve, për t'u ndeshur me okupatorin ose për t'u lidhur ngushtësisht me të, kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Taktika jonë për t'i larguar elementët e lëkundshëm nga kjo organizatë e porsakrijuar dhe për t'i futur çetat e «Ballit» në luftë dhe në aksione, ishte plotësisht e drejtë. Çështja e luftës dhe e aksioneve na preokuponte në radhë të parë dhe pikërisht mbi këtë platformë u zhvilluan bisedimet tona të para me organizatën e «Ballit», ose më mirë të themi me krerët e presupozuar të tij. Në asnjë platformë tjetër nuk diskutoi Komiteti ynë Qendror me ta. Çështja ishte të demaskohej «Balli» në pikën më nevralgjike, në qëndrimin ndaj luftës kundër okupatorit. Që në diskutimet e para «Ballit» ju shtrua çështja në se do të luftonte apo jo kundër okupatorit. Pikërisht në këto çështje i duhej hequr atij maska.

Në fillim u arrit marrëveshja për krijimin e komisioneve të koordinimit të veprimeve, komisione që mbetën një letër e vdekur, pse «Balli Kombëtar» dhe çetat e tija as që u bindën kurrë të luftonin okupatorin dhe kuislingët. Qëllimi i Partisë sonë ishte që të tërhiqte çetat e «Ballit» dhe t'i gjakoste ato në luftë me okupatorët. Në ato momente, kur disa nga elementët e «Ballit» kishin nga e kaluara një farë influence të pamërituar në shtresat e fshatarësisë, sidomos të disa krahinave, kjo taktikë e Partisë ishte plotësisht e drejtë. Thirrja e Partisë për luftë dhe aksione, demaskonte demagogjinë e «Ballit» që kishte si pikësynim largimin e popullit nga

lufta çlirimtare. Prandaj «Balli», në fillim pranoi në parim formimin e komisioneve të koordinimit të veprimeve për të sabotuar luftën e popullit. Me anën e tyre, ai do të përpiquej që, në vend të luftës dhe aksioneve, të bëheshin muhabetë dhe diskutime të pambaruara, deri sa t'i vinte në vesh okupatorit qëllimi i aksionit dhe vendi ku do të kryhej ky. Por Komiteti ynë Qendror e kishte kurdoherë parasysht këtë gjë dhe nuk e la aspak fatin e aksioneve në duart e këtyre komisioneve. Njerëzit e Partisë sonë do të propozonin në komision bërjen e aksionit, por në rast se propozimi nuk do të pranohej nga «Balli», aksioni do të bëhej nga ana jonë. Siç thamë, këto komisione mbetën vetëm në letër, çetat e «Ballit» s'hynë kurrë në luftë, komisionet as u mblodhën. Ky ishte karakteri dhe roli i këtyre komisioneve të koordinimit të aksioneve, për të cilat në Berat na akuzuan se paskemi qenë në «pozita oportuniste ndaj «Ballit»». Kjo akuzë nuk është e drejtë. Në qëndrimet tona ndaj «Ballit» s'ka pasur oportunizëm. Taktika e Partisë ka qenë e drejtë. Do të ishte e dëmshme dhe oportuniste në rast se krijimi i komisioneve do ta frenonte lëvizjen nacional-çlirimtare, por kjo s'ngjau dhe s'mund të ngjiste.

Jugosllavi Vukmanoviç Tempo ka thënë në Kongresin e 5-të të Partisë Komuniste Jugosllave, se ne paskemi qenë «në pozita oportuniste me «Ballin» dhe nuk e paskemi demaskuar e luftuar këtë organizatë». Këtë pikëpamje Vukmanoviç Tempua e ka shfaqur edhe gjatë kohës së luftës, në kohën kur erdhi pranë Shtabit tonë. Pikëpamjen e tij e përkrahu Koçi, por e përkrahu me të madhe edhe Sejfulla Malëshova. Qëllimet e Sejfullaut janë tani të njohura për të gjithë. Që kur vuri

këmbët në Shqipëri, ky kërkonte mbështetjen e ndokujt për të shfaqur kundërshtimin që ushqente ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe për ta zëvendësuar atë. Pikëpamjen e Vukmanoviçit ne e kundërshtuam që në atë kohë si një vërejtje të padrejtë. Ne asnjëherë nuk kemi qenë kundër demaskimit të «Ballit». Vukmanoviç Tempua e quante të padrejtë që «Balli» nuk u demaskua në shkallë të gjerë qysh në fillim. Këtë gjykim ai e bënte në mënyrë eks katedra pa njohur situatën dhe rrethanat në Shqipëri. Ne, të mbështetur në kushtet konkrete, ishim të mendimit se demaskimi i «Ballit» nuk mund të bëhej në shkallë të gjerë qysh në fillim, ky do të bëhej gradualisht. Por fakti është që Partia jonë kurrë nuk ka bërë kompromis me «Ballin», ajo kurrë nuk ka mbajtur qëndrime oportuniste ndaj tij. Me «Ballin» ne kemi qenë kurdoherë në luftë. S'mund të ekskludohet më ndonjë rast javashllëku nga ana jonë në këto veprime dhe s'mund të caktohej me saktësi kjo ose ajo ditë kur duhej bërë demaskimi, ashtu si thoshte Tempua. Akuza e Vukmanoviç Tempos dhe e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, siç u duk qartë edhe kohët e fundit në kongresin e tyre, kishte për qëllim të diskreditonte Komitetin tonë Qendror dhe udhëheqësit e Partisë, sikur ne ishim në pozita oportuniste me «Ballin Kombëtar».

Ndërkaq delegati jugosllav në Plenumin e Beratit e konsideroi thirrjen e Konferencës së Labinotit, ku u dënua marrëveshja e Mukjes, si një akt sektar nga ana e Partisë sonë. Po ky delegat pretendonte se, megjithë-që ishte bërë gabim në Mukje (ky gabim s'ishte i yni, por i Ymer Dishnicës dhe Komiteti ynë Qendror e dënoi

atë menjëherë porsa mori vesh tradhëtinë e tij), nuk duhej të refuzonim ftësën e Ali Këlcyrës për të marrë pjesë në mbledhjen e «Komitetit për çlirimin e Shqipërisë» që kishte krijuar Mukja, por të shkonim atje, të vazhdonim bisedimet e të demaskonim krerët e «Ballit» nga kjo platformë. Qëndrimi ynë në këtë çështje ishte i drejtë, kurse pikëpamjet e delegatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë ishin plotësisht oportuniste. Vajtja jonë në atë mbledhje, të krijuar nga Mukja, do të thoshte çorientim për Partinë. Ai do të ishte një lëshim që do t'i bënte Komiteti Qendror i Partisë sonë «Ballit Kombëtar», sepse në këtë mënyrë do të njihte vendimet e padrejta dhe armiqësore që u muarën në Mukje. Vazhdimi i bisedimeve nga platforma e Mukjes do të ishte një gabim i madh për Komitetin Qendror të Partisë sonë, por këtë gabim ai nuk e bëri. Sepse nuk e bëri këtë gabim, Komiteti ynë Qendror u akuzua prej delegatit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe prej Sejfulla Malëshovës se kishte rënë në sektarizëm.

Sejfulla Malëshova, i mbështetur nga delegati i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, ja ngarkoi vijës së Partisë, Komitetit Qendror dhe në radhë të parë Sekretarit të Përgjithshëm disa gabime taktike që ishin bërë nga Liri Gega dhe disa shokë të tjerë në Veri, si dhe represaljet ndaj një numri ballistësh në prakun e çlirimit të Tiranës. Sejfulla Malëshova i quajti këto gabime të rënda e sektare në vijën e Partisë dhe deklaroi se «Partia po shndërrohej në një parti terroriste». Këto ishin akuza të poshtër që i bëheshin Partisë nga një mbrojtës i elementit kundërshtar ballist. Ky

ishte preludi i pikëpamjeve dhe i veprimtarisë oportuniste dhe armiqësore të Sejfulla Malëshovës kundër vijës së Partisë. Edhe delegati i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë na akuzoi për veprime ilegale dhe shumë sektare. Në realitet veprimet që u bënë në Veri dhe gjatë luftës së Tiranës mund t'i quajmë për ndonjë rast të shpejtuara e të papeshuara aq drejt sa duhet, shokët tanë mund të ishin më të moderuar në disa raste, por në ato momente nuk mund të evitoheshin plotësisht ndodhira të tilla. Dënimi e eliminimi i agjentëve të të huajve për Sejfulla Malëshovën ishin veprime sektare e të dënueshme.

Këto ishin në përgjithësi akuzat që ju bënë vijës së Partisë në Plenumin e Beratit nga delegati jugosllav dhe përkrahësit e tij.

Në vijën organizative mund të themi se ishin vërtetuar disa gabime gjatë periudhës së luftës. Gabimi kryesor, sipas mendimit tonë, nuk qëndronte në krijimin e Komitetit Qendror të Përkohshëm të Partisë, siç na kanë akuzuar. Në atë kohë dhe në ato kushte, kur u formua Partia, nuk mund të bëhej më shumë. Provat treguan se zgjidhja ka qenë e mirë. Partia u formua dhe u konsolidua, ajo luftoi kundër fraksionistëve dhe i shtypi këta. Organizatat e Partisë u krijuan në shumë rrethe.

Një gabim organizativ u bë në mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së Komitetit Qendror të Partisë në Konferencën e parë të Vendit të PKSH. Konferenca u bë e rregullt, delegatët u zgjodhën në rrugë të drejtë, me gjithë rrethanat e vështira që paraqiteshin, por Komiteti Qendror u zgjodh në një konspiracion të tepruar,

gjë që influençoi më vonë në mosfunksionimin e tij të rregullt, si dhe në moszbatimin si duhet e me përgjegjësi nga çdo anëtar i Komitetit Qendror të detyrave që u ngarkoi Partia me anë të konferencës. Dihet si u zgjodh Komiteti Qendror e Byroja, si u caktuan sekretarët, si i filloi punimet Komiteti, etj. Ne e kemi bërë këtë analizë dhe unë them se ajo është bërë drejt. Ne kemi pranuar se këto veprime me rëndësi të madhe për Partinë janë bërë me gabime. Për këtë gabim ne mund të akuzojmë veten tonë, mund të akuzojmë Miladin Popoviçin, por mendojmë se faktori kryesor është Blazho Jovanoviçi. Ai erdhi si delegat i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për të na ndihmuar posaçërisht për këtë punë. Ne mund të themi me plot gojën se na mungonte eksperiencia për organizimin e forumeve të tilla si konferenca, kongrese e zgjedhje të organeve të tyre, si Komiteti Qendror, etj. Një eksperiencë e tillë i mungonte edhe shokut Miladin Popoviç, i cili ka qenë gjithashtu një kuadër i ri, që kishte një eksperiencë pak a shumë të madhe për drejtimin e një komiteti qarkor partie, në format e ilegalitetit të partisë. Por faji i Miladin Popoviçit është se ai duhej të kishte formuar deri në konferencë një besim më të madh në kuadrot e Partisë sonë, t'i çmonte drejt dhe të mos lëkundej në vendime dhe në gjykime në lidhje me to. Në fillim kjo ishte e justifikueshme, por më vonë, kur shokët tanë kishin dhënë prova dhe ishin formuar si kuadro, atyre duhet t'u besohej më tepër drejtimi i punëve të Partisë, ndërsa Miladini kishte lëkundje në këtë drejtim. Ai kishte ndjenjën e përgjegjësisë dhe kjo ishte një anë pozitive e tij, anë e shëndoshë e një marksisti internacionalist.

Por ai duhej të mendonte dhe ta kuptonte më thellë se përgjegjësia kryesore ndaj Partisë, ndaj popullit tonë dhe Kominternit, na binte neve. Mbi këtë bazë duhet të bëheshin zgjedhjet e Komitetit Qendror, në mënyrë që çdo shok i zgjedhur të merrte përgjegjësi të plotë për drejtimin e punëve të Partisë. Edhe në çështjet e organizimit, Miladin Popoviçi qëndroi në ato forma të ngushta pune që ishin të përshtatshme për një komitet qarkor, por jo për një forum kryesor, udhëheqës të Partisë.

Kuptimi i ngushtë i çështjeve organizative, mungesa e eksperiencës sonë dhe e shokut Miladin, si dhe rrethanat e vështira të luftës, lejuan që në çështjet e organizimit të Partisë dhe të funksionimit të organeve të saj të kishte edhe gabime. Por do të bënim gabim, po t'i shohim këto akoma nga platforma e shtrembër e akuzave që kurdisën në Berat udhëheqësit jugosllavë, me qëllimet e të cilëve u bashkuan Sejfulla Malëshova e shokë të tjerë, disa prej të cilëve, si Koçi Xoxe me shokë, vazhduan edhe më vonë të qëndrojnë në konkluzionet e gabuara që u arritën në Berat.

Pikësëpari, është krejtësisht e gabuar dhe aspak e drejtë të thuhet që Partinë e ka drejtuar Miladin Popoviçi, sikur Komiteti Qendror dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë të kishin lidhur duart. Në këtë mënyrë janë përpjekur ta paraqesin çështjen jugosllavët, për të diskredituar Komitetin tonë Qendror dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, megjithëse ata ishin në kundërshtim personalisht me Miladin Popoviçin. Një tezë e tillë është armiqësore, është kundër Partisë sonë, por e keqja është se në Berat ajo u pranua, në mos në më-

nyrë të hapët, heshtazi. Partinë tonë dhe Luftën nacional-çlirimtare e ka drejtuar Komiteti ynë Qendror, ndërsa Miladin Popoviçi, i cili duhet të konsiderohet si një shok i Partisë sonë, vetëm ka ndihmuar, aq sa kanë ndihmuar veç e veç edhe shokët e tjerë të Komitetit Qendror.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë sonë e ka luajtur rolin e tij si udhëheqës dhe drejtues i Partisë dhe e ka kryer detyrën e tij. Ai është përpjekur dhe ka mundur të drejtojë Partinë dhe lëvizjen, t'i orientojë ato në rrugë të drejtë, t'i ushqejë me direktiva dhe me udhëzime politike e organizative të vlefshme, duke u bazuar në eksperiencën e Partisë dhe në ndihmën e madhe që i jepnin anëtarët e tjerë të Komitetit Qendror, të cilët drejtonin organizatat e terrenit dhe Luftën nacional-çlirimtare në gjithë Shqipërinë. Këtu është vendi të thuhet që Miladin Popoviçi u rrit krahas me ne. Atë e rriti Partia jonë, ashtu sikundër na rriti të gjithë ne. Ai ishte një shok me të vërtetë internacionalist, që e donte shumë Shqipërinë dhe popullin shqiptar dhe ka mbajtur në çdo rast qëndrim të drejtë komunist, internacionalist, në mbrojtje të interesave e qëndrimeve të drejta të vendit e të Partisë sonë. Miladini ishte një militant komunist me kurajë të madhe. Shpesh, para syve tanë, ai kundërshtonte pikëpamjet e të deleguarve të tjerë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, si Dushan Mugoshës, Vukmanoviç Tempos, Blazho Jovanoviçit, Velimir Stojniçit, etj. Për këtë arësye ai nuk shihej me sy të mirë nga udhëheqja jugosllave dhe në prak të çlirimit, para Plenumit të Beratit u urdhërua të largohej nga Shqipëria. (Siç dihet ai më vonë u vra pas

shpine në një atentat të kurdisur nga OZNA¹ në mars 1945.)

Në Berat, me ndërhyrjen e udhëheqjes jugosllave dhe të deleguarit të saj, u formua opinioni se Komiteti ynë Qendror nuk kishte drejtuar si duhet dhe se Miladin Popoviçi nuk kishte punuar për të krijuar një udhëheqje të vërtetë. Kjo nuk është e drejtë. Të qëndrosh në konkluzionet e Beratit, do të thotë të bësh një gabim të madh. Komiteti ynë Qendror u forcua, u farkëtua dhe drejtoi në luftë. Shokët e Komitetit Qendror organizuan Partinë në gjithë Shqipërinë, ata drejtuan Luftën nacional-çlirimtare, drejtuan repartet partizane. Pa ekzistencën e Komitetit Qendror, pa udhëheqjen e Partisë, nuk mund ta kishim Partinë, ashtu si e kemi sot, nuk do të kishim arritur këto fitore. Dhe fitorja nuk mund t'u kushtohet dy ose tre personave, nuk mund të sigurohej nga një parti, Komiteti Qendror i së cilës paska qenë shumë i dobët, ose nuk paska ekzistuar fare.

Është e drejtë të thuhet se mund të ishin bërë më tepër mbledhje të rregullta të Komitetit Qendror, por të mos kujtojmë se brenda tre vjetëve dhe në kushtet e vështira të luftës, do të bëheshin shumë mbledhje. Megjithatë edhe mbledhje janë bërë, në mos të plota, por një sërë shokësh të ndryshëm, me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë janë mbledhur, kanë diskutuar probleme, kanë marrë vendime, etj. Për çdo situatë politike, për çdo ngjarje me rëndësi, Komiteti Qendror ka mbajtur qëndrim. Për këtë flasin dokumentat e Partisë. Në kohë të ndryshme, pra, Komiteti Qendror është mbledhur

¹ OZNA — Shërbimi i fshehtë jugosllav.

ku i plotë, ku jo i plotë, janë bërë diskutime, është përcaktuar qëndrimi ynë dhe janë marrë vendime që i janë komunikuar Partisë. Të gjitha këto janë bërë në kushtet e vështira të luftës dhe jo në kohë paqeje, prandaj edhe të metat duhet t'i njohim brenda këtyre situatave dhe vështirësive.

Ka pasur dhe raste të nënvleftësimit ose të spostimit nga përgjegjësia të ndonjë anëtari të Komitetit Qendror. Gjatë veprimtarisë së Komitetit Qendror të Partisë sonë të re, disa herë ka pasur edhe forma pune partizane. Përgjegjësia e sekretarit organizativ, për shembull, duhej të përcaktohej më qartë. Ky është një gabim, në radhë të parë, nga Miladin Popoviçi, pastaj edhe nga unë, por faji është njëkohësisht i të gjitha atyre rrethanave që e ndihmuan një situatë të atillë jo të drejtë. Unë jam i bindur që jo vetëm nga ana ime, por edhe nga ana e Miladinit nuk ka pasur qëllime të caktuara, se Koçi nuk duhej të kishte vendin që i kishte caktuar Konferenca e parë e Vendit. Unë e hedh poshtë atë që është thënë në Berat, sikur i paskemi mbajtur fshehur Koçit, zgjedhjen e tij prej konferencës si sekretar organizativ dhe sikur s'i paskemi besuar detyrën në këtë drejtim. Unë kam pasur pikëpamjet e mia mbi punën jo aq të madhe të Koçit. Mendimet e tij për çështjet dhe problemet ishin të lëkundshme e të kufizuara, ai kishte pak besim në mendimet e veta dhe influencuhej shpejt. Por është fakt që Koçi s'e mori si duhet detyrën e tij.

Në këtë drejtim kishte influencuar edhe Liri Gega, e cila, me qëllime të caktuara e intriga, punonte që të mbante në dorë pozita të rëndësishme drejtuese në Ko-

mitetin Qendror dhe ta zëvendësonte Koçi Xoxen. Më kot është akuzuar Miladin Popoviçi se kishte përkrahur Liri Gegën në këto synime, përkundrazi ai fliste me përbuzje për Lirinë, kurse ai që ushqente mëndjemadhësinë e arrogancën e saj ishte Dushan Mugosha. Liri Gega ishte një intrigante dhe aspironte të krijonte një rreth të saj të sëmurë. Puna e saj ishte mjaft sektare e personale. Në Berat ajo u orvat të bëhej «Drejtoare e kuadrit», u përpoq t'i jepej grada më e lartë ushtarake. Disa gabime të Liri Gegës, si puna e saj sektare në Veri, përpjekjet për të imponuar mendimin e saj lidhur me kuadrot, unë i kam kritikuar. Por nuk mund të mohohet se gabimet e saj u kritikuan ashpër vetëm në Berat. Nakua dhe Koçi mund ta kishin parë Liri Gegën me një sy tjetër, mund që i kishin parë asaj mjaft të meta, por fakti është se asaj nuk i qe bërë ndonjë kritikë serioze dhe nuk qe ngritur kjo si një çështje aq e rëndësishme, siç u ngrit në Berat. Liri Gega meritonte një kritikë të shëndoshë. Por udhëheqësit jugosllavë e shfrytëzuan këtë kritikë për qëllimet e tyre.

Çështjet në Berat nuk u shikuan në prizmin e vërtetë të Partisë, Koçi dhe Nakua në kritikën e tyre udhëhiqeshin nga interesa personale. Por më e keqja është se qëllimet e udhëheqjes jugosllave nuk u kuptuan, prandaj edhe u pranuan akuzat e «këshillat» e tyre. Shokët nuk u thelluan gjithashtu as në qëllimet e Sejfulla Malëshovës dhe të pjesëtarëve të tjerë të prapaskenës. Kjo rrodhi, mendoj, vetëm për arsye se gjërat nuk u analizuan në frymën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë, por në forma shumë të ngushta dhe në mënyra partizane. Kjo ka qenë një e metë e madhe që u shfaq

edhe më vonë dhe që ka bërë të mos ruhet masa e kritikës në gjykimin e problemeve që na janë vënë përpara për zgjidhje. Ka munguar objektiviteti, gjakftohtësia dhe gjykimi i thellë e jo i njëanshëm mbi çështjet.

Qëllimi kryesor i ndërhyrjes së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë në Plenumin e Beratit, sipas mendimit tonë, nuk ka qenë as për të ndrequr gabimet që ata pretendonin se kishim bërë ne, as për të forcuar Komitetin tonë Qendror, as për të vënë në vend çështjen e kuadrove që gjoja ishin nënvleftësuar. Qëllimet e tyre ishin të paramenduara. Delegati i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, Velimir Stojniçi, kishte ardhur me vendime në xhep, të pregatitura që më parë. Qëllimi kryesor i udhëheqjes jugosllave ishte: të goditej pavarësia e Partisë sonë. Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror duhej t'i nënshtroheshin vijës dhe direktivave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, vendi ynë duhej të orientohej plotësisht dhe vetëm nga Jugosllavia. Për t'ua arritur këtyre qëllimeve duhej të krijohej një situatë aspak e shëndoshë në Partinë tonë, të krijohej opinioni se pa Jugosllavinë ne nuk mund të kishim as parti, as luftë dhe as çlirim. Jugosllavët kishin mendimin se Partia dhe populli shqiptar e shihnin me simpati Jugosllavinë, por nuk e vlerësonin ashtu si dëshironin ata.

Për Partinë tonë, gjatë Luftës nacional-çlirimtare, Jugosllavia ishte një fqinjë, aleate dhe mike e shtrenjtë. E gjithë Partia jonë kishte dashuri e simpati për Partinë Komuniste dhe për popujt e Jugosllavisë. Por Jugosllavia kishte vendin e saj. Për Partinë tonë në vend

të parë ishin Bashkimj Sovjetik, Partia Bolshevike dhe Stalini. Ata, duke shpëtuar botën nga fashizmi, dhanë një kontribut të madh në fitoren e popullit tonë. Këtë e dëshmojnë traktet tona, që prej atyre të fillimit dhe deri në fund. Fakt është se emri i Titos ishte i panjohur për Partinë tonë, por njerëzit tanë e njihnin dhe e vlerësonin drejt luftën e popujve të Jugosllavisë. Ajo na inkurajonte dhe na lehtësonte barrën e luftës sonë. Por vetëm kaq. As lidhje direkte me Ushtrinë nacional-çlirimtare jugosllave ne nuk kishim, as ndihmë direkte.

Natyrisht, Komiteti ynë Qendror ka përfituar në njëfarë mase nga eksperiencia e luftës dhe e Partisë Komuniste Jugosllave me anën e radios «Jugosllavia e Lirë» dhe tek-tuk me anë të ndonjë broshure që na binte në dorë. Këto kanë qenë të vetmet forma që na kanë lidhur me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, duke përjashtuar ardhjen e atyre delegatëve jugosllavë që përmendëm më lart, të cilët më shumë kanë prishur punë, se sa kanë ndrequr dhe vajtjen e një delegacioni të rinisë sonë në Shtabin e Titos, delegacion që u kthye gati nga fundi i luftës.

Por, nga mënyra se si u zhvillua Plenumi i Beratit, u krijua një situatë sikur çdo gjë ne ja detyronim Jugosllavisë dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave. Në Berat, në vend që të viheshin në dukje sukseset e luftës sonë (këto u vlerësuan aq sa i deshi qejfi delegatit të Partisë Komuniste Jugosllave), u kritikua rëndë vija e Partisë dhe u godit udhëheqja e saj në mënyrë të padrejtë dhe të padenjë. Qëllimi i jugosllavëve ishte goditja dhe eliminimi i Sekretarit të Përgjith-

shëm të Partisë, pse ata mendonin se ai ishte pengesa e vërtetë për realizimin e qëllimeve të tyre.

Shokun Miladin Popoviç në mënyrë të poshtër e tërhoqën me dhunë, nuk e lanë as të bënte autokritikën ose kritikën që kishte për të bërë, sepse kishte edhe ai fjalën e tij për të thënë. Ata e dëbuan nga Shqipëria. Unë s'kam qenë dakord për këtë gjë me delegatin jugosllav. Por puna ishte që Miladin Popoviçi të hiqej nga mezi, sepse ai do të prishte punë. Ndryshe s'kishte arsye përse të organizohej Plenumi i Beratit prapa krahëve të mia, si një veprim misterioz.

Kur u shtruan çështjet, unë disa i gjeta të arësyeshme, si kritikën që i bëhej Liri Gegës dhe atyre të metave që vërtetoheshin në punë. Por në mbledhjen e Beratit nuk u fol përveçse për «gabimet» trashanike të shokëve kryesorë që drejtonin punën dhe aspak për gabimet e të tjerëve, për shembull, për pasivitetin e njohur të Sejfulla Malëshovës, për punën e ngushtë të Koçi Xoxes, etj. Pse u fol aq ashpër dhe padrejtësisht kundër Miladin Popoviçit, derisa delegati jugosllav, duke parë se kritikën kundër tij mund të preknin indirekt vetë Partinë Komuniste Jugosllave dhe të ulnin besimin ndaj saj, e ndaloi në mes të mbledhjes kritikën ndaj shokëve jugosllavë? Kjo bëhej patjetër me qëllime, për të goditur dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë. Për Sekretarin e Përgjithshëm, që kishte luftuar dhe kishte bërë detyrën e tij me sa kishte mundur, në Berat nuk u tha asnjë fjalë e mirë, përkundrazi ai akuzohej për gjëra dhe për gabime, që nuk i kishte bërë dhe u krijua kështu mosbesim ndaj tij. Vetëm po të mendohet pak, kuptohet që pas një situatë të tillë të krijuar për

Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, as në Byro nuk mund të kishte unitet dhe harmoni. Të gjithë anëtarët e Byrosë do të përpiqeshin të tërhiqnin jorganin në këmbët e tyre, nuk do të kishte kush të harmonizonte veprimet. Mendimet e Sekretarit të Përgjithshëm do të shikoheshin me dyshime, ambiciozët, që kishin vepruar për një situatë të tillë, do të përpiqeshin të realizonin qëllimet e tyre në mos de jure, de fakto. Gjithshka do të degjeneronte në punë personale, do të mbretëronin intrigat, zënkat, moskuptimet, paragjykimet, formalizmat dhe shumë të meta të rënda, që do të kërcënonin Komitetin Qendror dhe Byronë Politike. Dhe kjo për një kohë ngjau. Këto të këqia Partisë sonë ja solli Plenumi i Beratit, i cili jo vetëm kënaqi dëshirat e sëmura të disa shokëve dhe hapi rrugën që ato të zhvilloheshin edhe më shumë, jo vetëm kënaqi plotësisht dëshirat e delegatit jugosllav dhe të udhëheqjes jugosllave, por i dha shkas edhe oportunitizmit të infiltrohej në vijën e Partisë sonë. Për kritikën aq pa vend që i bëheshin Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë sonë, Velimir Stojniçi jo vetëm nuk ndërhyri e as nuk u përpoq t'i zbuste, por përkundrazi ai kënaqej kur Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe e Nako Spiru ngrinin teorinë e «shefit të partisë», ekzaltonin Titon dhe e cilësonin Sekretarin e Përgjithshëm sikur ishte sinteza e të gjitha gabimeve që ishin bërë gjatë kohës së Luftës nacional-çlirimtare.

Delegati jugosllav ishte një injorant edhe në çështjet organizative të partisë, një element që nuk mund të orientohet në situatat politike. Ai s'njhihte aspak situatën e vendit tonë, literalisht aspak. Ky e njhihte vendin tonë vetëm nga informatat që i kishte dhënë Komi-

teti i tij Qendror, por dhe këto ishin të gabuara. Ai kishte qenë vetëm një komisar divizioni dhe kishte në kokë një sërë frazash. Ky ishte tërë bagazhi i tij. Na dha edhe disa qarkore për organizimin e Partisë e të pushtetit, të cilat as që mund t'i quanim definitive. Me këto ai na u imponua dhe na huajti shumë gjëra të gabuara për vijën tonë marksiste-leniniste, të cilat shkaktonan që gabimet e filluara në Berat të bëheshin edhe më të mëdha. Tipike është çështja e Frontit. Me kërkesën e këtij njeriu ne futëm në Front Cen Elezin dhe disa banditë të tjerë që, pa sugjerimin e tij, ne do t'i kishim varur ndonja dhjetë herë. Një javë pas kësaj, duke dëgjuar radion e Beogradit, ai na tha se duhet të mbylleshin dyert e Frontit e budallallëqe të tjera. Nga ana tjetër, ai, duke qenë vetë në pozita oportuniste, përpiqej të na influenconte ne për të afruar njerëz, që s'kishin qenë kurrë me ne dhe që u bënë armiq të deklaruar të Partisë, të lëvizjes dhe të pushtetit tonë.

Plenumi i Beratit do të ishte një datë e shquar për Partinë tonë, në rast se do të diskutonte problemet për të cilat ishte thirrur dhe do të zhvillonte punimet me frymë të shëndoshë partie.

Në Berat u kritikuan ashpër udhëheqja, metodat e saja të punës, u kritikua mungesa e unitetit, mungesa e sinqeritetit, puna personale e ngushtë dhe sektare. Të gjitha këto kritika, po të ishin të shëndosha, duhej të jepnin rezultate të mira dhe të pritura, kurse Plenumi i Beratit dha krejtësisht të kundërtën dhe kjo është një provë tjetër që kritika dhe autokritika s'ishte aspak komuniste. Pikësynimi i KQ të PKJ në Berat ishte pra goditja, diskreditimi dhe, po të kishte mundësi, eliminimi

i Komitetit Qendror të Partisë sonë, që të delte kështu më i dukshëm roli i ndihmës së pretenduar që KQ i PKJ gjoja i paskish dhënë Partisë sonë gjatë luftës dhe që paskish çuar në fitore.

Por nuk duhet të mendojmë se kritikrat që u bënë në Berat për të meta e lëshime kanë qenë të gjitha të padrejta. Kritika kundër Liri Gegës, siç e tregoi edhe puna më vonë, ka qenë plotësisht e drejtë, por Plenumi i Beratit i ka sjellë Partisë më shumë dëm se sa të mira. Duhet të jemi të bindur që ndihma e KQ të PKJ dhe e delegatit të saj ka qenë zero, ose më mirë të themi shumë negative.

Pas Beratit është e vërtetë që u organizua pushteti, u organizua aparati i Komitetit Qendror, etj., por këtë organizim e bëmë ne vetë dhe s'ja detyrojmë delegatit të KQ të PKJ. Situata e krijuar pas çlirimit të Shqipërisë, patjetër na ndihmoi që shumë gjëra t'i sistemojmë.

Me një trajtim të rregullt të çështjeve në Berat ne do të ishim shumë më mirë dhe shumë më përpara. Mund ta bënim ne atje një gjë të tillë pa delegatin Stojniç? Unë mendoj se mund ta bënim, natyrisht edhe me të meta, por jo me ato të meta të mëdha parimore që u vërtetuan.

Me gjithë të këqiat që solli Berati, u vërejt një gjë pozitive, në rast se mund ta quajmë kështu, që gjithë punimet e këtij plenumi mbetën në krye të Partisë, ato nuk u shtruan në Parti. Në qoftë se do të kishte ndodhur kjo, atëhere do të qe krijuar një konfuzion edhe më i madh. Sëmundjet e Beratit u zhvilluan në Byro dhe në Komitetin Qendror. Pas plenumit që u mbajt atje, anëtarët e Komitetit Qendror nuk ishin të qartë, nuk kishin

bindje dhe të gjitha evenimentet që erdhën më pas i tërhoqën zvarrë. Toni i Beratit ka influencuar në gjithë punën e Komitetit Qendror, në mënyra të ndryshme.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe delegati i saj në Plenumin e Beratit pati një fitore. Ai arriti të prishë unitetin e Komitetit tonë Qendror, të godasë udhëheqjen e Partisë, të trondisë besimin e kësaj në vetëveten, të krijojë mosbesimin e disa shokëve të Byrosë dhe të Komitetit Qendror ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, të shkatërrojë mënyrën e punës kolegjiale në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror. Kjo ishte një fitore për udhëheqësit jugosllavë, por e pamjaftueshme. Dëshira e tyre ishte që Komiteti ynë Qendror t'u nënshtrohej plotësisht urdhërave të të deleguarit të tyre. Por sharra hasi në gozhdë.

Pas Plenumit të Beratit delegati jugosllav u përpoq të ndërhynte kudo, por nuk pati sukses. Ai i ra derës së Sekretarit të Përgjithshëm, por kjo nuk ju hap, i ra derës së Nakos, por as ajo s'ju hap. Ai dhe shokët e tjerë të tij jugosllavë filluan të mblidhnin disa anëtarë të Komitetit tonë Qendror, të bisedonin me ta, t'u qaheshin se s'po viheshin në korrent; njëkohësisht ata u përpoqën t'i influencojnë këta shokë dhe t'i vënë në kundërshtim me Byronë Politike të Partisë. Delegati jugosllav kërkoi të vinin kuadro të Partisë Komuniste Jugosllave në organizatën tonë të rinisë. Kjo ju refuzua nga ana jonë. Ai kërkoi t'i dorëzoheshin raportet që i vinin Komitetit Qendror nga komitetet e Partisë, por edhe kjo ju refuzua. Ai bëri agjente të tij Liri Gegën dhe, megjithëse kishte qenë dakord me dënimin që ju dha asaj në Berat, propozoi, pa kurrfarë turpi dhe drojtjeje, që ne ta

pranonim atë përsëri në Komitetin Qendror. Por dhe kjo ju refuzua kategorikisht. Velimir Stojniçi, me veprimet e tij antimarksiste për të zbatuar porositë e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, u dogj dhe u bë i pavlefshëm. Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë ju desh të ndërronte taktikë dhe njerëz, prandaj dërgoi në vend të tij Josip Gjergjen. njeriun e OZNA-s për Shqipërinë, që «të ndreqte punët që kishte shkatërruar Velua».

**SITUATA PAS PLENUMIT TË BERATIT DHE TEZAT
E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË PARTISË
PËR REVIZIONIMIN E KËTIJ.**

Është e nevojshme të analizojmë pak situatat që u krijuan pas Plenumit të Beratit dhe pasojat e rënda që rrodhën prej tyre. Në radhë të parë, Komiteti ynë Qendror dhe Byroja Politike e tij nuk ishin aq të armatosur, të organizuar dhe të lidhur si një trup i vetëm për t'u bërë ballë situatave dhe për të zgjidhur problemet e mëdha që u viheshin përpara pas çlirimit. Plenumi i Beratit nuk i dha as Komitetit Qendror dhe as Byrosë Politike unitetin aq të dëshiruar dhe të konceptuarit e drejtë për veprimtarinë e tyre si një shtab i organizuar, për mungesën e të cilave ishin kritikuar në Berat. Anëtarët e Komitetit Qendror nuk u vunë si duhej në krye të punës, nuk u përcaktuan mirë përgjegjësitë që duhej të merrnin, funksionet e tyre caktoheshin rastësisht dhe pa u studjuar thellë. Kjo ndodhte sepse vetë Byroja Politike nuk ishte në gjendje të bënte një ndarje pune si duhej.

Plenumi i Beratit krijoi një situatë të privilegjuar për Sekretarin organizativ të Partisë, i dha shkas Koçi Xoxes të monopolizonte punët në duart e tija, ndërsa, nga ana tjetër, lëkundit e tronditi të gjitha pozitat e tjera e në radhë të parë pozitën dhe funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Autoriteti i Sekretarit të Përgjithshëm u godit dhe u lëkund. Mjaft shokë të Byrosë Politike nuk kishin besimin e duhur te ai. Të pretendohet ndryshe, nuk është e vërtetë, pse realiteti ka qenë ky. Ndryshe nuk mund të shpjegohen qëndrimet dhe gabimet e disa shokëve. Sekretarit të Përgjithshëm i binte të parit barra që të përcaktonte, të drejtonte e të kontrollonte punën e anëtarëve të Byrosë dhe të Komitetit Qendror. Por kjo gjë nuk mund të bëhej me zor, sidomos pas situatës së krijuar nga Plenumi i Beratit. Të thuhet «pse e lejoi Sekretari i Përgjithshëm këtë situatë», nuk do ishte aspak objektive.

Në Plenumin e Beratit dhe pas këtij, personaliteti i Nakos u ngrit mbi të tjerët, po këtë nuk e bëri Sekretari i Përgjithshëm, përkundrazi kjo u bë në disfavorin e tij. Shokëve të tjerë të Byrosë u binte detyra ta ndreqnin këtë situatë, në rast se e kishin kuptuar që Nakua po shkonte më larg se sa duhej. Në radhë të parë, kjo detyrë i binte Koçit, por ai s'e bëri këtë. Pse s'e bëri këtë Koçi? Në fillim ky s'u ndie, sepse qëndrimi dhe veprimtaria e Nakos, të inkurajuara nga delegatët jugosllavë, dobësonin pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, gjë që pajtohej me dëshirat e planet e ardhshme të Koçi Xoxes. Po të ishte ndryshe, logjika ta do që Koçi Xoxe, si sekretar organizativ, pas Plenumit të Beratit, duhej të bashkëpunonte ngushtë me Sekretarin e Përgjithshëm

dhe të shihte se puna e Nako Spirut po prekte unitetin në udhëheqjen e Partisë dhe spostonte rolin e Sekretarit të Përgjithshëm. Por, kur jugosllavët kuptuan se Nakon nuk e manipulonin dot sipas qejfit, filluan të mbështesnin, të nxisnin e të ngrinin më shumë Koçi Xoxen. Atëhere u dukën edhe acarimet e Nakos me jugosllavët e Koçi Xoxen. Si duket, në këtë kohë Nakua realizoi gabimet e tij dhe u afrua me Sekretarin e Përgjithshëm, kurse Koçi Xoxe, i cili në këtë afrim shikonte një rrezik për vete e nuk shikonte interesin e Partisë për forcimin e unitetit të saj, filloi, nën nxitjen edhe të jugosllavëve, luftën kundër Nako Spirut. Plenumi i Beratit kishte krijuar te Koçi Xoxe bindjen që shumë gjëra mund të zgjidheshin pa e pyetur fare e pa marrë mendimin e Sekretarit të Përgjithshëm, kishte krijuar te Koçi Xoxe një siguri të tepruar në veten e tij. Këto influencuan në krijimin e situatave që u thanë më lart.

Ndërsa shoku Nako Spiru bëri një kthesë dhe u afrua më me besim te Sekretari i Përgjithshëm, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo vazhduan në vijën e gabuar, duke mos pasur besimin e duhur te Sekretari i Përgjithshëm, duke mos e kuptuar dhe përdorur drejt armën e kritikës dhe të autokritikës dhe luftën e kontradiktave brenda në Parti, të cilat ata i shikonin në planin personal dhe si të organizuara prej Nako Spirut. Kjo ka bërë që këta të dy të gabojnë rëndë në vijën politike dhe në atë organizative.

Unë e ndjeja nevojën e bashkëpunimit me shokët e Byrosë Politike, prandaj nuk shihja asgjë të keqe nga afrimi i Nakos. Personalisht kisha konsideratë për Nakon dhe e doja atë me gjithë të metat që kishte, me-

gjithëse qëndrimi i tij në Berat nuk më pëlqeu. Për këtë vërejtjen ja bëra hapur që atëhere. Punën e Nakos në prapaskenë unë vazhdova të mos e dija edhe për shumë kohë më vonë pas Beratit. Kjo m'u tregua më pas nga shokë të tjerë. Pra, nuk kishte arsye pse unë të dyshoja për qëllime jo të shëndosha nga ana e tij. Asnjë kritikë s'i ishte bërë Nakos për punën e tij, përkundrazi ai ishte një shok që dëgjohej nga të gjithë. Ai kritikonte me mjaft kurajë. Ç'gjë të keqe mund të shihja unë nga afrimi i Nakos? Përkundrazi, unë vuaja për atë afrim dhe këtë nuk e bëja për preferenca personale. Nakua mund të kishte pasur tendenca të caktuara në punën e tij, ai kishte edhe gabime, por gabime bëheshin dhe nga të tjerë.

Të metat dhe gabimet ne i diskutonim, i rrihnim aq sa mundnim dhe i kritikonim. Por është fakt se, në mes Nakos dhe Koçit, Nakos dhe Sejfullaut, Bedriut dhe Koçit, Sejfullaut dhe Koçit, këto diskutime e kritika shiheshin e bëheshin në prizmin personal. Arbitrazhi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe mendimi i tij nuk arrinte të influenconte sa duhej në këtë atmosferë që ishte krijuar në mes këtyre shokëve në shkallë të ndryshme. Kjo e kishte burimin te mungesa e unitetit dhe e koordinimit të veprimtarisë në Byro. Një pjesë e këtyre shokëve akuzonin Sekretarin e Përgjithshëm për butësi ndaj Koçi Xoxes, ndërsa Koçi dhe Pandi Kristo kishin formuar idenë se ai ishte nën influencën e Nakos, të këtij ose të atij shoku. Në asnjë moment nuk më është bërë mua një kritikë serioze dhe me baza, me të cilën të provohej se isha influencuar në rrugë të shtrembër nga këta shokë. Fajet dhe gabimet e të tjerëve nuk mund t'i marr unë.

Në fakt unë asnjëherë nuk jam influencuar nga pikëpamjet e gabuara të Nakos, unë i kam kritikuar dhe i kam konsideruar si të rrezikshme qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare tendencat e gabuara të Nako Spirut dhe Liri Belishovës për punën me rininë. Gjithashtu unë nuk kam qenë dakord edhe me disa pikëpamje të tjera të gabuara që kishte Nakua, sidomos përsa i përket kuadrit.

Nga një kuptim i tillë i çështjeve do të krijohej patjetër ajo çarje që u vërtetua në Byronë tonë dhe nga e cila përfitoi Sejfulla Malëshova, përfituan jugosllavët për të realizuar qëllimet e tyre armiqësore, përfitoi Koçi Xoxe për të monopolizuar punët, duke nënvleftësuar rolin e Sekretarit të Përgjithshëm në udhëheqje, gjë që i dha shkas Nako Spirut të zhvillonte ambicien e tij të sëmurë. Në të gjithë këtë situatë Sekretari i Përgjithshëm ka pasur pikëpamjet e tija, që, me sa duket, ishin të drejta. Ai nuk e kishte humbur sensin e përgjegjësisë, Berati nuk e kishte mposhtur kurajën dhe vullnetin e tij, ai i shihte jo keq situatat e vështira që zhvilloheshin në Byronë tonë, ai shihte dëmin që kishte sjellë Berati dhe punën armiqësore të Velimir Stojniçit. Nga të gjitha këto, Sekretari i Përgjithshëm kishte arritur në konkluzionin se Plenumi i Beratit ishte sëmundja kryesore, që kishte sjellë mungesën e unitetit në Byronë Politike, që burimi i këtyre ishte ndërhyrja e Velimir Stojniçit, që vija e Partisë gjatë Luftës nacional-çlirimtare ishte kritikuar pa vend, po ashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm, që në çështjet organizative kishte gabime praktike që duheshin ndrequr, që kishte spostim në udhëheqje, që ishte krijuar dualiteti parti-pushtet, e të tjera gabime të rënda.

Për të gjitha këto unë kisha krijuar bindje, prandaj vendosa të shtroja në Byro tezat për revizionimin e Plenumit të Beratit dhe për ndreqjen e gabimeve. Tezat për revizionimin e Plenumit të Beratit ishin një dokument i rëndësishëm, ku problemet ngriheshin me takt dhe gabimet kritikoheshin në masën e rrezikshmërisë që po dukej, pa ekzagjerime dhe aspak me «parti pris». Por tezat e mia dhe qëllimi i mirë i tyre nuk u kuptuan drejt dhe as nuk u pranuan nga të dy palët, as nga Koçi me Pandin, as edhe nga Nakua. Gabimet e Nakos, nuk ishin alarmante në kohën kur unë paraqita tezat në Byro, por nuk ishin alarmante as edhe gabimet organizative të Koçi Xoxes. Oportunizmi i Sejfulla Malëshovës, që ishte më i rrezikshmi, ishte mënjanuar.

Çështja kryesore ishte Plenumi i Beratit, gabimet që rrodhën prej tij, mungesa e unitetit në Byro dhe dëmet që ju shkaktuan punës së Partisë. Mirëpo, këtë çështje të dy palët as që u përpoqën ta ndreqnin. Dhe arësyeja kuptohet. As Koçi Xoxe me Pandi Kriston dhe as Nako Spiru, nga ana tjetër, nuk u treguan të gatshëm të bënin autokritikë për veprimtarinë e tyre në Berat, të zbulonin para Partisë prapaskenën e Beratit, të pranonin gabimet e tyre me një autokritikë bolshevikë dhe t'i dënonin ato. Përkundrazi ata mbrojtën «veprën» e tyre në Berat, duke dëmtuar kështu përsëri Partinë, duke i ntrashur gabimet, duke e thelluar më shumë çarjen e unitetit të Byrosë. Autokritika e shëndoshë e tyre do të ndihmonte që të zbulohej puna armiqësore antiparti e Velimir Stojnićit, të demaskohej prapaskena e Beratit me të gjitha veprimet e rrjedhimet e saj negative që vërtetoheshin qoftë në vijën politike,

qoftë në vijën organizative, do të ndihmonte të zhdukej mosbesimi që ekzistonte ndaj udhëheqjes së Partisë, sidomos ndaj Sekretarit të saj të Përgjithshëm dhe të rishikoheshin kështu vendimet e Plenumit të Beratit. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo tezat për revizionimin e Beratit i muarën sikur ishin të Nako Spirut dhe sikur unë i kisha bërë ato nën influencën e tij. Ata menduan se këto teza drejtoheshin vetëm kundër personit të Koçit. Ky ishte një gabim i rëndë nga ana e tyre, ishte një gjykim joobjektiv dhe shumë i ngushtë. Nako Spiru e evitoi me kujdesin më të madh diskutimin e çështjeve kryesore që ngrinin këto teza, pse një diskutim rrënjësor i tyre do t'i zbulonte petët lakrorit. Këtu është vendi të thuhet se për çështjen e Beratit u hesht dhe u mbajtën rezerva deri në fund. Ndërkaq Pandi Kristo u përpoq ta spostonte diskutimin për këto teza, duke ngritur çështjen përse unë i kisha mbajtur këto rezerva nga Berati e këtej. Në parim kjo kështu është, por nuk ishte keq, përkundrazi ishte në të mirën e Partisë dhe pra pozitive që unë i shtrova pas një kohe, kur shumë rrethana më sqaruan edhe më tepër në rezervat që kisha.

Unë nuk dija se ç'kishte ngjarë në prapaskenën e Beratit, nuk e dija rolin që kishin luajtur disa shokë në këtë prapaskenë. Unë i kundërshtova që në Berat qëndrimet e tyre, pa e ditur prapaskenën, kundërshtova haptas dhe e gjeta të gabuar veprimtarinë e Velimin Stojniçit, të cilin e kritikova hapur, para syve. Tezat për rishikimin e Beratit ishin në fakt kundër atyre që e pregatitën prapaskenën, ishin në të mirën e Partisë dhe të punës së saj normale. Në rast se Koçi Xoxe e Pandi Kristo nga njëra anë dhe Nako Spiru, nga ana

tjetër, do t'i shihnin drejt tezat dhe me një autokritikë të shëndoshë do të pranonin gabimet, çështjet do të ishin vënë në rrugë të drejtë. Por të dy palët mbajtën fshehur kartat e tyre.

Pse nuk i shikuan drejt këto teza Nako Spiru dhe Koçi Xoxe me Pandi Kriston? Unë mendoj se arësyeja e vetme është që ata nuk donin të zbulonin gabimet e tyre.

Tezat e mia nuk sollën asnjë përmirësim të gjendjes. Diskutimi devijoi në çështje praktike dhe u qëndrua në pozitat e mëparëshme. Uniteti në Byro jo vetëm s'pati asnjë përmirësim, por përçarja u thellua edhe më tepër. Unë u binda se çështja nuk u zgjidh. Detyra ime më duket se ishte të mos qëndroja në atë pikë të vdekur, ku kishte arritur puna, por të gjeja një zgjidhje tjetër. Një zgjidhje e mirë do të ishte që unë ta shtroja çështjen para Komitetit Qendror, por këtë s'e bëra dhe ky është gabim. Unë mendova se çështja mund të zgjidhej duke zgjeruar Byronë Politike me anëtarë të rinj. Kjo do të ishte një zgjidhje e drejtë.

Në Byronë Politike jo vetëm që s'kishte unitet, por e gjithë davaja bëhej në mes tre vetëve, Sejfullaut, Nakos, Koçit, me të cilët u bashkua dhe Pandi Kristua. Shokët e tjerë në fakt konsideroheshin sikur nuk kishin të bënin fare me çështjet në diskutim. Këta shokë janë kritikuar si inaktivë, pa iniciativë, pa gjykime të caktuara, të lëkundshëm, që influencoheshin shpejt, që mbanin qëndrime ngandonjëherë jo të drejta, etj., por ne, duke qenë përgjegjës, kemi harruar të kritikonim veten që këta shokë nuk i aktivizonim, nuk i mbanim në korrent sa duhej, nuk u caktonim detyra që të merr-

nin përgjegjësitë që u takonin. Në radhë të parë, shkaktar ka qenë Plenumi i Beratit, që krijoi iluzionin se i dha zgjidhje të drejtë çështjes së kuadrove të Komitetit Qendror dhe funksionimit të tij, por që në realitet nuk dha asgjë në këtë drejtim. Pastaj, mungesa e unitetit në Byro, mosbesimi te njëri-tjetri, puna personale e të tjera të meta dhe gabime që vërtetoheshin në punë, bënë që këta shokë të mos merrnin pjesë aktive dhe të gjallë në zgjidhjen e çështjeve dhe në drejtim të punëve.

Po kristalizohej mendimi se tre vetë janë në Byro, që drejtojnë dhe në mes të tyre s'ka harmoni. Prandaj mendova që duhej t'i jepej fund një situatë të tillë. Mendova që Byroja të zgjerohej edhe me shokë të vjetër, por edhe me shokë të rinj.

Për mua të vjetrit dhe të rinjtë kanë pasur kurdoherë vendin e tyre. Unë kam pasur mendimin, dhe më duket se nuk e kisha gabim, që në Komitetin Qendror veç shokëve të vjetër, besnikë e të zot, duhej të vinin edhe të rinj, që mund të mos e kishin atë stazh si të tjerët, por që me punën e tyre në Parti kishin dhënë prova se do të bëheshin drejtues të mirë. Nga të tre ata që propozova unë, njëri ishte shoku Mehmet Shehu dhe dy ishin të rinj. Mehmeti ishte po aq i vjetër, sa edhe ne, ai kishte luftuar në Spanjë, kishte luftuar dhe treguar zotësi në drejtimin e luftës dhe të Ushtrisë sonë nacional-çlirimtare, ai vazhdonte të zhvillonte më tej njohuritë e tija ushtarake. Përsa i përket dy të rinjve, është e vërtetë se Nakua influençoi në propozimin e tyre, por mos të harrojmë se nga pjesa ime unë nuk kisha dëgjuar keq për këta të dy shokë, lëre nga Nakua që po e po, por as nga Koçi, as nga njeri tjetër. Të meta këta

mund të kishin, po të gjithë shokët kanë të meta, pastaj ato të meta të pretenduara ose të vërteta që dolën mandej për këta të dy, në atë kohë, as që diheshin dhe as që ishin vënë në dukje. Të tre këta shokë që propozova unë në Byro, nuk u pranuan nga Koçi Xoxe dhe nga Pandi Kristo. Duhet të shënohet këtu se arësyet e refuzimit nga ana e tyre nuk ishin politike. Arësyet që u sollën ishin gjoja të meta personale dhe, si të rinj, u tha se duhej të bënin akoma një stazh.

Edhe pas tezave të mia, edhe pas propozimit për zgjerimin e Byrosë, ne nuk mundëm të përmirësonim situatën në udhëheqje dhe veçanërisht në Byronë tonë Politike. Por duhet të njohim se me gjithë këto të meta dhe me këtë gjendje, puna jonë kishte shkuar përpara. Kudo, në çdo sektor, ishin bërë përparime. Kjo tregon se ne mund të zgjidhnim edhe ato probleme që na dukeshin të pazgjidhshme, po të kishte më shumë vullnet të mirë, më pak pasione dhe po të ekzistonte kritika dhe autokritika e hapët bolshevike.

Për të mbajtur një situatë të sëmurë në Byronë Politike, gjatë gjithë kësaj periudhe dhe pasi u nënshkruan marrëveshjet me Jugosllavinë¹, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë vetë dhe me anë të delegatëve të tij që ka pasur këtu, ka intriguar jashtëzakonisht. Ndërhyrja e tyre në punët e brendshme tonat ishte e hapët. Deri në një pikë fajtorë kemi qenë ne

¹ Është fjala për Traktatin mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis RP të Shqipërisë dhe RFP të Jugosllavisë të 27 nëntorit 1946.

vetë që i kishim lejuar, por kjo vinte më tepër nga besimi që kishim ndaj Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Udhëheqësit jugosllavë ndiqnin me kujdes të gjitha situatat e krijuara te ne, ata mbaheshin në korrent, ata ishin në dijeni dhe me detaje të zhvillimit të punëve tona në Byro, të frymës që sundonte atje, të masave që ne merrnim ose mendonim të merrnim. Ata u vunë në korrent edhe mbi tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit. Delegati i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave i ka deklaruar gjoja Koçit se Nakua i kishte njoftuar ata për këto dhe i paska thënë atij se «Komandanti mendon keq për njerëzit jugosllavë dhe për delegatin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë». Kësaj thënjeje dhe të tjerave të këtij lloji, ne nuk mund t'u zëmë besë, sepse jugosllavët këto i deklaruan kur shoku Nako qe zhdukur nga mezi ynë. Unë jam i mendimit se janë shpifje. Dhe trockistët jugosllavë qenë të aftë për çdo shpifje. Sidoqoftë udhëheqja jugosllave ka qenë në dijeni të plotë të situatës brenda në Partinë dhe në vendin tonë. Ata përpiqeshin gjatë kësaj kohe të forconin pozitat e tyre dhe në sipërfaqe të bënë një «politikë të mirë» me të gjithë njerëzit e udhëheqjes sonë, ta kishin mirë me të gjithë. Të gjithëve u flisnin sipas qejfit, i nxitnin njërin kundër tjetrit për të mbajtur dhe ushqyer një situatë të nderë, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mundnin më vonë të impononin pikëpamjet e tyre dhe njëkohësisht të krijonin përshtypjen sikur vetëm ata ishin në gjendje të vinin rregull në vendin tonë dhe brenda në Partinë tonë. Marrëdhënjet ekonomike, që u konkretizuan tamam në këtë kohë, i dhanë një hov aktivitetit armiqësor

të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë kundër Partisë dhe vendit tonë.

MARRËDHËNJET EKONOMIKE DHE ZHVILLIMI I TYRE NDËRMJET JUGOSLLAVISË DHE VENDIT TONË

Vendi ynë, pa dyshim, kishte nevojë për ndihmë, për të ngritur ekonominë e tij të shkatërruar nga lufta. Këtë ndihmë ne do ta merrnim nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Jugosllavia, por edhe nga vendet e tjera të demokracisë popullore. Në fillim ndihma kryesore na vinte nga Jugosllavia. Por këtu duhet sqaruar se në të përfshihej edhe ndihma e Bashkimit Sovjetik. Në Paris, Mollotovi, në prezencë të Kardelit, të Mosha Pijades dhe timen, këtë gjë na e bëri të qartë¹. Ai parashtroi pikëpamjen e udhëheqjes sovjetike për rrugën në të cilën duhej të zhvilloheshin marrëdhënjet midis dy republikave tona. Kur erdhi puna në çështjet ekonomike, Mollotovi tha se «Bashkimi Sovjetik do ta ndihmojë pa kursyer popullin shqiptar që të ngrerë ekonominë e tij, por ndihmën e tij ai do ta japë nëpërmjet Jugosllavisë, thjesht për arsye politike të jashtme». Këtë gjë na e përsëriti edhe shoku Stalin, kur ne shkuan në Moskë². Jo vetëm kaq, por shoku Stalin dhe qeveria sovjetike na plotësuan të gjitha kërkesat tona. Ata na akorduan me gjithë zemër kredi dhe me leverdi të madhe për ne. Ne nuk dimë si ishte rregulluar ndihma sovjetike që

¹ Gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris (29 gusht — 15 tetor 1946).

² Gjatë vizitës në BRSS të delegacionit të RPSH të kryesuar nga shoku Enver Hoxha në korrik të vitit 1947.

na vinte nëpërmjet Jugosllavisë, por fakti është se Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar shumë Jugosllavinë, nga ana ekonomike dhe ushtarake. Ndihma që na ka dhënë neve Jugosllavia, pa asnjë dyshim, ka qenë minimale përpara ndihmës që ajo merrte nga Bashkimi Sovjetik. Po të barazojmë ndihmën direkte ekonomike dhe ushtarake që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik, kur shkuam në Moskë dhe atë që po na jep për këtë vit, mund të themi pa frikë se është dy-tri herë më e madhe nga ajo që na jepte Jugosllavia.

Konventa ekonomike¹ ishte vazhdimi i aleancës që kishim lidhur me Jugosllavinë². Kjo konventë solli me vete protokollet mbi koordinimin e planeve, mbi unifikimin e çmimeve, mbi parifikimin e monedhës, mbi shoqëritë e përbashkëta, etj. Këtu është e drejtë të thuhet se ne i pranuan dhe i nënshkruam këto protokolle. Por në të njëjtën kohë bëmë disa vërejtje, siç ishin ato për parifikimin e monedhës e unifikimin e çmimeve dhe jeta tregoi se vërejtjet tona ishin të drejta, por në atë kohë në mënyrë kërcënuese ato u përbuzën nga ana e jugosllavëve dhe u quajtën prej tyre si «obstruksion që bëhej nga ana jonë». Vërejtjet tona u kufizuan vetëm në çështje praktike dhe jo parimore. Ne nuk diskutuam sa duhet mbi kuptimin e vërtetë të koordinimit të planeve, të parifikimit të monedhës, të unifikimit të çmimeve, të heqjes së doganave, si dhe të mënyrave të

1 Konventa ekonomike midis RPSH dhe RFPJ u nënshkrua në nëntor të vitit 1946.

2 Është fjala për Traktatin e miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke midis RP të Shqipërisë dhe RFP të Jugosllavisë që u nënshkrua në korrik të vitit 1946.

veprimtarisë së shoqërive të përbashkëta, nuk përcaktuam si duhet çështjen e kreditit. Ne kishim besim të plotë te ata, kurse jugosllavët kishin qëllime të caktuara ndaj nesh përsa i përket natyrës dhe zhvillimit të marrëdhënjeve ekonomike. Qëllimet e politikës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj vendit tonë kanë qenë antimarksiste, shfrytëzuese, koloniale, në dëm të popullit tonë.

Kërkesa për koordinimin e planeve ekonomike u shërbente qëllimeve antimarksiste të udhëheqjes jugosllave. Midis dy republikave tona mund të koordinoheshin planet për objekte të caktuara në interesin e përbashkët të të dy vendeve. Por Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, nëpërmjet koordinimit të planeve, synonte që ekonomia jonë të zhvillohej vetëm nën prizmin e ekonomisë jugosllave e kondicionuar dhe e varur nga ajo. Ekonomia jonë «nuk duhej të zhvillohej e pavarur, por të vihej nën vartësinë e ekonomisë jugosllave». Këtu synonin parifikimi i monedhës, unifikimi i çmimeve, heqja e doganave dhe krijimi i shoqërive të përbashkëta. Jugosllavia, pa bërë asnjë përpjekje për të ndihmuar në të vërtetë për shfrytëzimin e plotë e të drejtë të këtyre shoqërive, mori vetë ekskluzivitetin e shfrytëzimit të tyre, ose më mirë me thënë e mosshfrytëzimit të tyre.

Në vitin 1946 u vendosën njëkohësisht edhe marrëdhënje tregëtare në mes të dy republikave tona. Në praktikë u krijua një gjendje e tillë që vendi ynë në fakt u izolua nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e demokracisë popullore përsa u përket marrëdhënjeve ekonomike. Një situatë të tillë e krijuan jugosllavët, që

përpiqeshin të zhduknin çdo iniciativë nga ana jonë në këtë drejtim. Ne kishim një akord të vogël tregëtar me Bashkimin Sovjetik, i cili na ndihmoi menjëherë pas çlirimit të vendit me grurë dhe me sende të tjera. Ndërsa ne i detyronim Bashkimit Sovjetik naftë, etj., jugosllavët u përpoqën me njëmijë mënyra, që edhe këtë detyrim që kishim ne ndaj Bashkimit Sovjetik, të mos e plotësonim dhe një marrëveshje e tillë të mos përsëritej më.

Në vitin 1946 ne kishim ngritur Komisionin e Planit, në krye të të cilit ishte Nako Spiru. Pranë Komisionit të Planit dhe dikastereve të tjera, me kërkesën tonë, ishin vendosur këshilltarë sovjetikë, të cilët që në ditët e para ndihmuan kuadrot tanë të rinj ta marrin detyrën me zell dhe të punonin me besim në të ardhshmen. Jugosllavët sollën edhe ata një numër inxhinierësh e specialistësh, që jo vetëm nuk kishin ndonjë vlerë të madhe, por që kryesisht u muarën me intriga e sabotime. E vetmja direktivë, që kishin marrë ata, ishte të vinin gurë nën rrota në rrugën tonë, të ngadalësonin sa të ishte e mundur më shumë zhvillimin e ekonomisë sonë në përgjithësi dhe plotësimin e planit në veçanti. Ata kërkonin që të dëgjohej patjetër fjala e tyre, që ata të thoshin fjalën e fundit, me pretendimin se ndihma na jepej prej Jugosllavisë.

Plani i vitit 1946 u hartua në këto kushte dhe me njerëz të rinj në këtë punë, por shumë aktivë dhe me besim në forcat e tyre. Ata kishin edhe ndihmën e këshilltarëve sovjetikë. Udhëheqësit dhe specialistët jugosllavë përpiqeshin në çdo moment të ulnin kuadrot tanë, punën e tyre, të pengonin punën, duke krijuar

teori të mëdha mbi çdo çështje, duke propozuar studime mbi studime që të ngadalësohej hartimi i planit dhe pastaj të ngarkohej me faj pala jonë, se gjoja «nuk e ka hartuar planin me kohë, nuk e ka dorëzuar me kohë në Beograd», se «plani s'ishte i studjuar mirë, prandaj duhej rishikuar me ata». Qëllimi ishte që të vononin dërgimin e mallrave, të mos i bënin investimet në kohën e duhur, me një fjalë të mos realizohej krediti, ashtu sikundër nuk u realizua.

Gjatë kësaj periudhe, përveç këtyre pengesave, jugosllavët ndërnuarën edhe akte kusërie të hapët kundër ekonomisë sonë, të cilat ne u përpoqëm t'i kundërshtonim. Për shembull, në çështjen e akumulimit, me gjithë kundërshtimet tona, jugosllavët vendosën arbitrarisht në disfavorin tonë. Ata me këtë gjë na kanë grabitur shuma kolosale që vleftësohen në disa milion. Gjithashtu tatimi mbi xhiron, që duhej të ishte një masë për qeverinë tonë për të bërë politikën e çmimeve dhe për të rregulluar akumulimin tonë, u vendos arbitrarisht në favorin e jugosllavëve. Edhe këtu ata na kanë grabitur miliona, të cilat dobësuan rëndë ekonominë tonë. Të gjitha grabitjet fshiheshin dhe arësytosheshin nën maskën e parullave pseudomarksiste, por sidomos nën shantazhin dhe kërcënimin ekonomik, nën presionin e vonesës së realizimit të kredisë.

Ne pamë shumë veprime të dyshimta të jugosllavëve, siç ishte çështja e përcaktimit të investimeve në shoqëritë e përbashkëta¹, si edhe çështja e përcaktimit

¹ Shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave u krijuan pas nënshkrimit të Konvetës ekonomike midis RPSH dhe RFPJ.

të kreditit. Këto ne ua vumë në dukje, që të sqaroheshin dhe çështjet të viheshin në rrugë të drejtë. Por ata s'kanë dashur kurrë t'i përcaktonin qartë këto gjëra dhe na ngrinin mungesën gjoja të besimit nga ana jonë. Ata ishin në rrugë të shtrembër, antimarksiste.

Realizimi i kreditit prej dy miliard dinarësh ishte çështja kryesore që na preokuponte, pse andej varej shumë realizimi i planit tonë. Realizimi i marrëveshjes tregëtare dhe i investimeve ishin problemet më të koklavitura. Jugosllavët, me qëllime të caktuara, e penguan këtë realizim për të qenë më në gjendje të na bënin më vonë presione. Në të gjithë sektorët e planit tonë, jugosllavët sabotuan me të dy duart. Krediti jo vetëm nuk u realizua i tëri, por edhe ai material konsumi ose investimi që erdhi, nuk na u dërgua kurrë në kohën e duhur.

Në të gjithë këtë periudhë pune, për të larguar kujdesin dhe vëmendjen e kuadrove tanë nga realizimi i planit dhe për të justifikuar mungesat e tyre të mëdha, jugosllavët nuk i lanë një minutë rehat kuadrot tanë që të merrnin frymë, të shtroheshin në punë dhe të realizonin si duhet detyrat e planit. Asnjë nga studimet nuk mori fund dhe as mund të merrte fund. Me qëllimet dhe me metodat që përdorën ata, kuadrot tanë nuk përfituan konkretisht që të rriteshin e të përparonin. Por, megjithkëto pengesa, me përpjekjet e Partisë e të qeverisë sonë, me vetëmohimin e madh të masave punonjëse, si dhe me materialin që gjendej në vend, u realizuan shumë detyra që përmirësuan kushtet e jetesës të popullit tonë.

Me veprimtarinë e tyre udhëheqësit jugosllavë sy-

nonin qëllime të shumanshme: të pengonin zhvillimin e ekonomisë sonë dhe ta vinin atë nën vartësinë e plotë të tyre, të diskreditonin Partinë tonë përpara masave të gjera të popullit si «një parti të pazonjën të vetëqeveriste vendin dhe të drejtonte fatet e popullit», të diskreditonin udhëheqjen e Partisë si të pazonjën për të përballuar situatat dhe të luftonin të gjithë ata udhëheqës, që ishin një pengesë për realizimin e planeve të tyre. Qëllimi tjetër ishte të luftonin besimin dhe dashurinë që kishte Partia jonë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe konkretisht të dobësonin besimin që kishim ne për këshilltarët sovjetikë, t'i diskreditonin këta këshilltarë dhe të na detyronin ne të kërkonim largimin e tyre. Kjo do të sillte izolimin e vendit dhe të Partisë sonë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga kampi i socializmit.

Situatat e krijuara prej udhëheqjes jugosllave kishin për qëllim të arrihej në disa konkluzione. Për arritjen e këtyre konkluzioneve të dëshiruara prej tyre, udhëheqësit jugosllavë ndërmuarën një sërë veprimesh të poshtra ndaj Partisë sonë, qeverisë sonë, ekonomisë sonë, planit dhe njerëzve tanë. Ata ngritën tezën sikur në Partinë tonë «po kristalizohej një vijë e dytë antijugosllave» dhe përgjegjëse përpara popullit për një gjë të tillë bënë udhëheqjen e saj. E tillë ishte akuza e parë që ata i bënë Komitetit tonë Qendror¹. Byroja Politike nuk e pranoi këtë akuzë, megjithëse jo të gjithë anëtarët e saj ishin të bindur për këtë vendim. Vendimi i

¹ Kjo akuzë ju bë Komitetit Qendror të PKSH në qershor të vitit 1947 me anën e një letre provokuese që i dërgoi KQ i PK Jugosllave Komitetit Qendror të PK të Shqipërisë.

Byrosë ishte i drejtë dhe përgjegjja, që ne i dhamë përfaqësuesit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, ishte plotësisht e drejtë.

Për të goditur Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj u ngrit edhe çështja e projektplanit pesëvjeçar, i rekomanduar prej qeverisë jugosllave për Republikën tonë Popullore. Në fakt çështja e projektplanit ishte një bluf. Këtë e provojnë të gjitha faktet, e provojnë dhe ca më shumë pohimet e Savo Zllatiçit, i cili zbuloi se në buxhetin jugosllav, jo vetëm nuk ishte parashikuar një kredit i madh për të subvencionuar planin tonë pesëvjeçar, por në buxhetin jugosllav nuk ishte parashikuar as kredia prej dy miliardë të tjerë që do të na jepeshin për vitin 1948. Ky kredit do të tërhiqej nga fondet gjoja rezervë të buxhetit jugosllav. Për planin pesëvjeçar nga qeveria jugosllave na është thënë se do të na akordohej një shumë prej 20-21 miliardë. Këtë thënje udhëheqësit jugosllavë e mohuan, sikundër kanë mohuar çdo poshtërsi të tyre, por fakti është se në këtë bazë u hartua projektplanit pesëvjeçar. Ky u hartua prej shokëve tanë, me ndihmën edhe të specialistëve sovjetikë. Ky projektplan u bë me shpejtësi, kuadrot tanë u lodhën së tepërmi, sepse kjo punë ishte jashtë mundësive tona dhe jugosllavët e kërkonin në një kohë rekord. Ata kishin dhënë një projektplan të tyre pesëvjeçar në vija të përgjithshme, ku duhej të mbështeteshim ne për bërjen e projektplanit tonë. Ky projekt përbënte orientimin jugosllav. Këtë projektplan u tha se Nako Spiru e ka pasë fshehur dhe s'e ka treguar. Çështjen e 20-21 miliardëve nuk e shpiku Nako Spiru nga koka, këtë ja thanë zyrtarisht jugosllavët Kiço

Ngjelës. Dhe kjo është e vërtetë. Ne besojmë shokun tonë Kiço Ngjela e jo trockistët jugosllavë, që kërkojnë t'i bëjnë varrin vendit tonë. Pra, ajo mund të shërbente si orientim dhe shërbeu. Jugosllavët sigurisht përdorën shumë djallëzi dhe fakti është kështu: njëri thoshte 10 miliardë dhe këtë e jepte si opinion aproksimativ të tij; delegati i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë Savo Zllatiç, Kiços i kishte thënë 21 miliardë, në projektplanin orientues jugosllav thuhej 13-15 miliardë dhe kjo u justifikua gjoja se vlerësimet e mëparshme mund të kenë qenë të gabuara. Të gjitha këto kanë pasur për qëllim dezorientimin tonë dhe karakterizoheshin nga mosserioziteti dhe tendencioziteti.

Orientimi i jugosllavëve për planin tonë pesëvjeçar ka qenë antimarksist dhe antishqiptar. Gjithë fryma e orientimit ishte për shfrytëzimin e vendit tonë nga ana e tyre. Ne duhet të prodhohim për jugosllavët të gjitha lëndët e para për të cilat ata kishin nevojë. Këto lëndë të para do të eksportoheshin nga ne për në metropol, në Jugosllavi dhe do të përpunoheshin atje, në fabrikat jugosllave. Në këtë drejtim u orientua prodhimi i pambukut, i bimëve të tjera industriale si dhe i naftës, i bitumit, i serës, i kromit, etj. Jugosllavia do t'i furnizonte «kolonisë së vet, Shqipërisë» sendet e konsumit të gjerë me çmime grabitqare, që nga peri deri te gjilpëra, do t'i furnizonte benzinën dhe vajgurin, si dhe poçet e llambave, ku do të digjej produkti i nxjerrë nga nëntoka jonë, por i përpunuar në Jugosllavi dhe i shitur te ne me çmime të larta. Kjo është tamam politika e trusteeve kapitaliste dhe monopoliste amerikane. Orientimi i jugosllavëve ishte pra që në vendin tonë të mos

zhvillohej as industria dhe as klasa punëtore, që vendi ynë të varej tërë jetën nga Jugosllavia. Disa fabrika ose punishte që do t'i jepeshin vendit tonë dhe që parashikoheshin në projektplanin jugosllav, jo vetëm ishin qesharake, por edhe nuk u sollën. Jo vetëm kaq, por udhëheqësit jugosllavë dhe përfaqësuesit e tyre këtu, rrëmbyen edhe ato maqineri pak a shumë të mira që kishim ne dhe i çuan në Jugosllavi. Bile ata na kanë rrëmbyer edhe maqineri nga reparacionet.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë e quajti projektplanin pesëvjeçar, që hartuam ne, «autarqik», «ireal», etj. Një vlerësim i tillë nuk ishte i drejtë. Projektplani ynë s'ishte as autarqik, as ireal, ai u mbështet mbi kredinë e premtuar nga jugosllavët. Komiteti ynë Qendror nuk gaboi kur aprovoi projektplanin pesëvjeçar, nuk gabuan në këtë çështje as Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, as shoku Nako Spiru. Zhvillimin e pavarur ekonomik të vendit tonë dhe ndërtimin e socializmit në Shqipëri me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, e të vendeve të demokracisë popullore, sidomos të Jugosllavisë, trockistët jugosllavë e quajtën autarqik. Kjo ishte një dredhi e shpifje pa baza për të luftuar orientimin e drejtë të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë. Në atë projektplan ka pasur disa formule të pasakta dhe disa teprime, por s'e bënin këto thelbin e çështjes. Këto teprime ne ja kemi hedhur në kurriz Nako Spirut, por edhe kjo s'është e drejtë. Këtë projektplan, të hartuar me një shpejtësi të madhe, e kemi studjuar edhe ne, e kemi pranuar edhe ne, prandaj në qoftë se në të ka gabime, faji është i të gjithëve dhe jo vetëm i shokut Nako.

Projektplani parashikonte që në vendin tonë të zhvilloheshin bimët industriale dhe në radhë të parë pambuku, në dëm të cerealeve e sidomos të misrit. Këtu ne ramë në grackën e ngritur nga udhëheqja jugosllave që na thoshte «mos u preokuponi për bukën, fusha e Banatit prodhon për ju dhe për ne». Me qëllimet që ndiqnin ndaj vendit tonë trockistë jugosllavë, kjo do të thoshte që ata, duke pasur problemin e bukës në dorë të tyre, ta përdornin atë si shpatën e Damokleut mbi kokën e popullit tonë, për t'i zhdukur atij pavarësinë e për ta bërë skllav.

Çështja e bukës është një nga problemet më të mëdha e më të vështira për vendin tonë, aq më tepër po të marrim parasysh vështirësitë e mëdha që do të hasnim në planifikimin e prodhimit bujqësor, në kushtet e ekzistencës së pronës së vogël private në fshat. Ky problem e ka preokupuar shumë popullin tonë, prandaj përpjekjet kryesore të tij janë përqëndruar me të drejtë në sigurimin e bukës. Çështja e bukës është një çështje parimore. Të varesh nga jashtë për një prodhim të tillë të dorës së parë, nuk është e drejtë, pse mund të të ngjasin shumë të papritura. Kjo s'do të thotë se ne duhet ta orientojmë vendin vetëm në prodhimin e misrit dhe të grurit. Jo. Ne duhet ta orientojmë fshatarin tonë edhe në mbjelljen e zhvillimin e bimëve industriale, por kjo të bëhet në mënyrë të studjuar, duke shfrytëzuar edhe hapjen e sa më shumë tokave të reja.

Për zhvillimin e industrisë dhe përpunimin në vend të lëndëve të para, ne mendojmë që orientimet tona në plan jo vetëm ishin të drejta, por edhe se kemi qenë modestë.

Të gjithë kemi pasur bindjen e plotë se projektplanit që bëme, në vija të përgjithshme, ishte i drejtë dhe këtu nuk kemi gabuar aspak. Ky projektplan, si çdo projekt, duhej diskutuar, korigjuar dhe pastaj aprovuar. Asnjëherë ne nuk kemi menduar që ky projektplan ishte definitiv. Ai nuk shkoi as në Beograd për t'u parë; atje shkuan vetëm orientimet kryesore. Ne prisnim përgjegjen, e cila na erdhi me vonesë (për këtë do të flas më vonë) dhe kjo përgjegje na erdhi si një akuzë e rëndë dhe e poshtër që i bëhej Komitetit tonë Qendror¹ nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë po përgatiste goditjen kundër Partisë sonë, për nënshtrimin e saj dhe të vendit tonë, ai po përgatiste goditjen kundër kampit të socializmit në sektorin e Shqipërisë. Direktivat kryesore të projektplanit tonë pesëvjeçar Zllatiçi i çoi në Beograd, jo me qëllim që të ndihmohej vendi ynë, por për t'i pasur si mbështetje për sulmin kundër Partisë sonë. Meqenëse çështja e projektplanit nuk ishte e mjaftueshme për një sulm të tillë, udhëheqësit jugosllavë përgatitën edhe akuza të tjera të poshtra për të acaruar akoma më shumë gjendjen.

Ata përdorën çështjen e hekurudhës, ndërtimin e së cilës Partia ja kishte besuar rinisë. Në hekurudhë u shfaqën më mirë se kudo hovi i madh i rinisë sonë punonjëse, heroizmat e saj, vendosmëria e saj. Rinia ishte e para në punë e në përpjekje, ajo ishte një forcë e madhe e Partisë sonë. Këtë forcë krijuese të popullit

¹ Kjo akuzë ju bë Komitetit Qendror të PKSH nga KQ të PK të Jugosllavisë në nëntor të vitit 1947.

dhe të Partisë sonë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë u përpoq ta godiste, ta dekurajonte. Goditja e jugosllavëve në hekurudhë ishte njëkohësisht një grusht kundër Partisë dhe qeverisë sonë. Mosrealizimi i detyrave në hekurudhë do të ishte për ne një humbje e madhe ekonomike dhe politike. Këtë e kishte kuptuar mirë Partia jonë, ja kishte mësuar mirë edhe rinisë, e cila nuk ja bëri fjalën dysh Partisë. Hekurudha qe terreni, ku u ballafaquan në shkallë të gjerë njerëzit tanë me njerëzit jugosllavë. Rinia jonë, kuadrot e Partisë dhe të rinisë, që kanë punuar në hekurudhë dhe drejtuan punimet atje, e kanë bërë detyrën me heroizëm dhe me vetëmohimin më të madh, me një dashuri të madhe për Partinë dhe për popullin tonë. Hekurudha u mbarua në afatin e caktuar, vetëm me vullnetin e rinisë sonë të drejtuar nga Partia. Kurse Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe gjithë njerëzit e tij që ishin në hekurudhë, inxhinierë, gjeometra e të tjerë, kanë sabotuar punimet e hekurudhës. Për jugosllavët ndërtimi i këtij objekti ishte një fushë sabotimi për të krijuar situata të vështira, për të pregatitur argumenta false për të goditur Partinë tonë. Të gjitha dokumentat që kanë Partia dhe shteti ynë për këtë aksion të madh e vërtetojnë plotësisht këtë gjë. Jugosllavët, që punonin në hekurudhë, që prej drejtorit dhe deri te përgjegjësi i Partisë, nuk kanë qenë përveçse antimarksistë, njerëz të OZNA-s dhe ustashë¹, të edu-

¹ Pjestarë të bandave reaksionare të Paveliçit në të ashtuquajturin «shtet i pavarur kroat» gjatë viteve të Luftës së dytë botërore.

ar me pikëpamje shfrytëzuese dhe koloniale ndaj vendit tonë. Njerëzit jugosllavë në hekurudhë i kanë luftuar kuadrot tanë, i kanë përbuzur, i kanë akuzuar e kanë shpifur shumë poshtërsi për ta. Njerëzit jugosllavë sillëshin ndaj shqiptarëve në hekurudhë si padronët e metropoleve që kanë vënë indigjenët të ndërtojnë hekurudhat në kolonitë e Afrikës. Një situatë të tillë nuk e pranuan njerëzit e Partisë dhe të rinisë sonë. Dhe ata kishin të drejtë. Sigurisht, kanë ngjarë edhe incidente të vogla në një aksion kaq të rëndësishëm, por jugosllavët i frynë këto dhe dolën me konkluzionin se në «Shqipëri është krijuar një front antijugosllav dhe ky front antijugosllav ka arritur kulmin në hekurudhë». Këtu nuk bëhej fjalë për gabime të vogla që mund të kishte bërë një i ri, këtu bëhej fjalë për çështje të mëdha politike. Jugosllavët na akuzuan ne, se çështjet e kishim parë shumë nga ana praktike dhe kishim harruar anën politike. Kjo s'është aspak e vërtetë. Ishin ata që e kishin harruar anën politike ose më mirë të themi i kishin parë çështjet në një mënyrë politike të shtrembër, antimarksiste, koloniale.

Për të forcuar edhe ca më shumë tezën e «frontit antijugosllav që po krijohej në Partinë dhe në vendin tonë», jugosllavët, që nga përfaqësuesit zyrtarë të qeverisë e të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe deri te specialistët, filluan të bëjnë edhe shpifje të tjera. Ata përhapën fjalë se përbuzeshin teknikët jugosllavë, se atyre nuk u jepeshin shtëpi të mira, etj.

Por guximi i tyre shkoi edhe më larg. Ata përdorën për qëllimet e tyre edhe vizitën e delegacionit të Partisë

e të Qeverisë sonë në Bashkimin Sovjetik. Kjo vizitë i dogji pa masë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Me Bashkimin Sovjetik ne nënshkruam një marrëveshje ekonomike me anën e së cilës ai angazhohej të na jepte një ndihmë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë sonë. Kjo ndihmë ishte një goditje kundër qëllimeve të udhëheqësve jugosllavë që dëshironin ta kthenin vendin tonë në një koloni të tyre, që vendi ynë të punonte për t'i dhënë metropolit jugosllav lëndën e parë. Me fabrikat që na jepte Bashkimi Sovjetik do të ngrihej industria në vendin tonë, do të përpunoheshin lëndët e para në vend, do të shpëtonte populli nga blerja e shumë sendeve të manifakturuara jashtë. Nga ana tjetër, ngritja e industrisë do të sillte forcimin e klasës sonë punëtore, forcimin e Partisë e të shtetit tonë. Bashkimi Sovjetik na akordoi kredi dhe na dha një sasi maqinash shirëse e traktorësh që kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e bujqësisë sonë.

Partia jonë këtë ndihmë që na dha Bashkimi Sovjetik ja bëri të njohur popullit. Mirëpo këtë veprim të drejtë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave e quajti «një politikë antijugosllave». Këtë e tha hapët përfaqësuesi zyrtar i qeverisë jugosllave. Për trockistët jugosllavë, të vendosje marrëdhënje politike dhe ekonomike me një shtet tjetër socialist, donte të thoshte të «ishje antijugosllav»! Jugosllavët i shihnin me mëri të madhe përpjekjet e Partisë sonë për të forcuar miqësinë me Bashkimin Sovjetik. Njerëzit tanë, që punonin në këtë drejtim, akuzoheshin prej zyrtarëve jugosllavë për gjëra të paqena, herë drejtpërdrejt, herë tërthorazi, duke u thënë «se Jugosllavia nuk propagan-

dohet sa duhet», gjë që donte të thoshte se «shumë po e popullarizoni Bashkimin Sovjetik»; herë të tjera ata akuzonin njerëzit dhe Partinë tonë sikur orientoheshin nga Perëndimi, si nga Franca dhe Italia, qoftë në lëmin tregëtar, qoftë në lëmin kultural. Këto ishin shpifje të poshtra. Partia jonë, qoftë në politikë, qoftë në marrëdhënjet tregëtare, qoftë në ato kulturele, nuk është orientuar kurrë nga Perëndimi. Përse bëhej një akuzë e tillë, kjo s'ka nevojë për shpjegime. Udhëheqësit jugosllavë deshën që ne të orientoheshim për çdo gjë nga vendi i tyre. Njerëzit, që nuk vepronin kështu, duhej të goditeshin, dhe të zëvendësoheshin. Ky ishte qëllimi i tyre.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë e përgatiti gjithë këtë terren, duke shpifur andej-këtej, kundër Partisë dhe njerëzve tanë, për të mbështetur akuzën e tyre të poshtër që i dha shkas analizës sonë të fundit të gabuar në Plenumin VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në këtë akuzë thuhej sikur Komiteti ynë Qendror bënte një politikë antijugosllave, se ai kishte lejuar dhe krijuar një front antijugosllav dhe se politika e qeverisë sonë ndaj Jugosllavisë ishte diametralisht në kundërshtim me aspiratat dhe qëndrimin e popullit tonë. Atje thuhej sikur Komiteti Qendror i Partisë sonë kishte bërë një politikë shkëputjeje nga Jugosllavia në fushën ekonomike, sikur orientimi i ekonomisë sonë ishte i gabuar dhe këtë gjoja e tregonte qartë projektplanin ynë, i cili paska qenë i real, autarqik dhe nuk përputhej në asnjë mënyrë me vendimet e të dy komiteteve qendrore të partive tona. Një orientim i tillë i gabuar, thoshin ata, shihet edhe në

sektorë të tjerë të aktivitetit të vendit tonë, si në kulturrë, në arësim, në hekurudhë, në miniera, etj.

Më në fund atje akuzohej veçanërisht Nako Spiru, përgjegjësi për çështjet ekonomike të vendit tonë, si një nga shkaktarët e kësaj situatë, akuzohej se kish pasë luajtur një rol të çuditshëm në këtë punë dhe porositej Komiteti ynë Qendror të shihte se mos kishte gisht armiku që marrëdhënjet në mes të dy vendeve kishin arritur në një gradë shumë të keqe. Në këtë akuzë përmendeshin edhe emra të tjerë. Atje theksohej gjithashtu se Shqipëria, më parë se të bënte ndonjë marrëveshje me ndonjë vend tjetër, duhej të merrte pëlqimin e Jugosllavisë. Kjo tezë drejtohej hapët kundër marrëveshjes ekonomike që disa muaj më parë qeveria jonë kishte nënshkruar me qeverinë sovjetike.

Këto ishin me pak fjalë akuzat kundër Komitetit Qendror të Partisë sonë. Këto akuza, pregatitën analizën e Plenumit VIII të Komitetit Qendror dhe daljen e rezolucionit të tij. Për analizën dhe gabimet që u bënë aty do të flasim më poshtë. Këtu do të vazhdojmë mbi qëllimet e akuzës jugosllave dhe veprimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë pas analizës sonë.

Kritika kishte për qëllim kryesor ta bënte vendin tonë një republikë të shtatë të Jugosllavisë, ta nënshtronte atë nën urdhërat dhe direktivat e Beogradit, vendi ynë të bëhej një koloni e Jugosllavisë dhe pavarësia e tij të ishte formale, e mbuluar dhe e maskuar me formulat e pseudopavarësisë borgjeze. Kritika kishte për qëllim ta shkëpuste Shqipërinë nga kampi i socializmit, ta armiqësonte atë me Bashkimin Sovjetik dhe ta

tërhiqte Partinë tonë në rrugën antimarksiste. Shqipëria për trockistët jugosllavë ishte ai shtet i vogël i kampit të socializmit, ku ata do të bënë eksperimentin e parë për realizimin e vijës së tyre tradhëtare kundër kampit të socializmit. Ata kishin punuar me kohë në këtë drejtim, por rezistenca e Partisë sonë nuk ishte shuar dhe ishte shumë larg nga shuarja. Partia jonë kishte forcë të madhe në vetëvete. Prandaj udhëheqësave jugosllavë u duhej të punonin për ta shuar këtë forcë.

Për t'ja arritur këtë qëllim, para së gjithash, duhej të mposhtej vullneti i Komitetit tonë Qendror dhe i Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, te i cili ata shihnin një pengesë të madhe. Akuzat e poshtra të udhëheqjes trockiste jugosllave, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë sonë, më parë se kundër Nako Spirut, drejtoheshin kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, sepse ai ishte i pari përgjegjës për «politikën e gabuar» të Komitetit Qendror. Ata e njihnin mirë situatën në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror të Partisë sonë, ata kishin dijeni për divergjencat që ekzistonin midis anëtarëve të Byrosë, si në mes të Nakos dhe Koçit, si dhe për gjendjen e krijuar midis meje dhe Koçit. Ata e dinin gjithashtu se pikëpamjet e Nakos, në lidhje me marrëdhënjet me Jugosllavinë, në të gjitha pikat që ishin të drejta, puqeshin me ato të miat. Ata e dinin fare mirë që Nakua nuk bënte asgjë në këtë drejtim pa u këshilluar dhe pa marrë aprovimin tim. Jugosllavët i kishin mbështetur llogaritë e tyre në situatën që ekzistonte në Byronë tonë Politike, situatë që u detyrohej, në radhë të parë, intrigave të tyre të poshtra. Trockistët jugosllavë i ndihmoi shumë edhe gabimi më i madh që ka bërë Nako

Spiru, vetëvrasja e tij. Analiza në Plenumin VIII ishte një fitore e madhe për jugosllavët. Ata krijuan në Partinë tonë situatën që dëshironin.

Pas analizës gjendja u ndërlikua shumë. Me anën e presionit, të shantazhit e të luftës psikologjike, ata mundën të sigurojnë aprovimin e propozimeve të tyre të para. U pranua që plani ishte ireal dhe autarqik, u pranua që «vija jonë politike dhe ekonomike, si dhe ajo në sektorin ushtarak ishin të gabuara dhe rrezikonin Republikën tonë Popullore e Partinë tonë». U varros projektplanit pesëvjeçar. U pranua të bëhej vetëm plani për vitin 1948. U zhduk akordi tregëtar midis dy vendeve tona. U krijua Komisioni i koordinimit të planit në bazat që dëshironin ata dhe filloi nga puna. Por çështja nuk qëndroi me kaq, ajo do të shkonte edhe më tej. Planit as që realizohej. Angazhimet jugosllave për mallra të konsumit, për materiale dhe për investime, nuk u plotësuan. Të gjitha këto çështje mbyteshin nën një burokraci të madhe dhe me studime të pambaruara ekonomiko-sociale. Po na huanin sisteme të gabuara për të asgjësuar fitoren e pushtetit popullor në lidhje me zbatimin e reformës agrare e për çështje të tjera. Po kritikoheshin format e organizimit të ndërmarrjeve tona e propozoheshin të reja, të cilat synonin të zhduknin çdo pengesë për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë mbi baza antimarksisiste. Nënveftësimi i kadrove tanë arriti kulmin.

Komisioni i koordinimit të planeve, i ngritur për të ndihmuar realizimin e planeve tona, për të ndërhyrë pranë qeverisë jugosllave që të shpejtohej ardhja e materialeve dhe e investimeve dhe për të ndihmuar në zbatimin në jetë të planit, vepronte për qëllime të tjera

krejt të kundërta. Ai de fakto po merrte formën e një qeverie të Jugosllavisë në Shqipëri. Asnjë veprim s'mund të bëhej nga ministritë tona, pa aprovimin e Komisionit të koordinimit ose më mirë me thënë, pa aprovimin e kryetarit të këtij komisioni, Kraigerit. Puna arriti deri atje sa që ai kërkoi që ministrat tanë të venin t'i jepnin raport dhe të merrnin urdhëra prej tij. Kjo do të thosh-te likuidim i qeverisë sonë.

Jugosllavët propozuan që të gjitha shoqëritë e përbashkëta të shpërndaheshin e të shndërroheshin në ndërmarrje nën kontrollin direkt të Komisionit të koordinimit dhe të Kraigerit. Këto shoqëri të përbashkëta, që duhej të drejtoheshin nga qeveria shqiptare e ndaj të cilave jugosllavët nuk i kishin përmbushur asnjëherë detyrimet e tyre, tani e tutje duhej të shkëputnin krejtësisht edhe ato lidhje të dobëta që ekzistonin me dikasteret e ndryshme të qeverisë sonë.

Komisioni ynë i Planit të Shtetit filloi të humbiste pak nga pak funksionet e tij dhe të bëhej një apendis pa kurrfarë kompetence. Njerëzit kryesorë të Komisionit të Planit preokupoheshin me diskutime të pambaruara me Kraigerin dhe në studime të pambaruara mbi gjoja zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë sonë socialiste, parë nën prizmin e Jugosllavisë.

Një farë komision kontrolli që erdhi nga Jugosllavia, pa pasur asnjë të drejtë, kontrolloi shoqëritë e përbashkëta dhe nxori një raport «monumental», një nga dokumentat më të poshtra antishqiptare, i vetmi dokument i firmuar prej tyre, ku akuzohej qeveria shqiptare dhe, pra, Komiteti ynë Qendror për shumë gjëra monstruoze. Për këtë përgjegjësi e madhe i bie sidomos Pandi

Kristos. Për mosdërgimin e materialeve dhe mosrealizimin e investimeve nga ana e Jugosllavisë na ngarkohej faji neve me një cinizëm të pashoq, të denjë vetëm për armiq të dhe imperialistët amerikanë e anglezë. Këto pa asnjë ndryshim përngjishnin me shantazhet e misioneve angleze gjatë luftës. Gjysma e vitit po kalonte dhe në vend që të realizoheshin nga kredia afro një miliard e tetëqind milion, ishin realizuar vetëm rreth 200 milion. Presioni dhe shantazhet në një nga sektorët më të rëndësishëm të jetës së vendit, në atë të ekonomisë, bëheshin me qëllime të caktuara. Ata pregatisnin terrenin për zhdukjen e formave organizative ekzistuese, për të bashkuar krejt ekonominë tonë me atë të Jugosllavisë, për të zhdukur çdo pengesë nga ana ndërkombëtare dhe për ta paraqitur mbasandaj çështjen e madhe të bashkimit si një «fait accompli» që bëhej me dëshirën e plotë të Partisë dhe, pra, të popullit tonë.

Në një situatë të tillë, me gjithë pasojat negative të analizës së Plenumit VIII, kishte kundërshtime të hapëta ndërmjet nesh dhe jugosllavëve, kishte përpjekje serioze, kishte mosmarrëveshje.

Jugosllavët kërkuan prej nesh largimin e këshilltarëve sovjetikë. Ne asnjëherë nuk kemi qenë të bindur për ikjen e këshilltarëve sovjetikë, por nën presionin e tyre ne lëshuam në këtë drejtim dhe gabuam. Gabimi ynë ishte se pranuan deri diku pikëpamjen jugosllave, ramë me ta në kompromis që të kërkonim nga qeveria sovjetike largimin e disa këshilltarëve, pse gjoja, në këtë mënyrë si po zhvillohej ekonomia jonë, mund të bëjmë edhe pa ta, por ne kemi nevojë për teknikët sovjetikë. Ky ishte një «modus vivendi» bajat.

Gjendja e krijuar në ekonomi pas Plenumit VIII shkaktoi dëme të mëdha te ne. U shtrenjtua jeta, u ngrit inflacioni, u dobësua shumë furnizimi, plani s'po realizohej, u vështirësua grumbullimi i misrit dhe i të gjitha prodhimeve bujqësore, çmimet po ngriheshin dita-ditës. Jugosllavët me paturpësi kërkonin që ne të përmbushnim detyrimet ndaj tyre, kurse ata s'mbanin asnjë detyrim ndaj nesh. Kjo është një pasqyrë e shkurtër e gjendjes ekonomike që u krijua.

Edhe në sektorët e tjerë po zhvillohej një situatë po kaq e rrezikshme dhe me qëllime të caktuara e të koordinuara nga ana e jugosllavëve.

Në këtë kohë udhëheqja jugosllave kërkoi ardhjen e një divizioni jugosllav në zonën e Korçës. Historia e ardhjes së këtij divizioni është e njohur. Qëllimi i jugosllavëve ka qenë i shumëfishtë: pikësëpari, të krijonte në vendin tonë, në kokën e Partisë sonë, një psikozë luftar iminente dhe mendimin se një rrezik i madh kërcënonte Shqipërinë nga Jugu. Jugosllavët e paraqitnin çështjen sikur ne do të sulmoheshim nga anglo-amerikanët dhe monarko-fashistët grekë, dhe gjoja për këtë kishin informata të sigurt. Kjo u bë me qëllim që Komiteti ynë Qendror të preokupohej seriozisht për këtë çështje dhe të harronte të gjitha të tjerat dhe në këtë situatë «kaq kritike» të krijohej përshtypja në Parti se Jugosllavia ishte një aleate vigjilente dhe e gatshme të jepte ndihmën e saj imediate.

Në momentet kur jugosllavët ngritën çështjen e divizionit, situata në Greqi ishte e turbullt, kishte filluar ofensiva e forcave demokratike, prandaj nuk kishte arsye të forta që të vërtetonin alarmin që dhanë jugoslla-

vët. Ardhja e këtij divizionj në atë kohë dhe shpallja e zonës së Korçës zonë jugosllave, siç kërkuan jugosllavët, ishte një akt pa precedent që mund të krijonte një incident me karakter ndërkombëtar. Ajo mund të shfrytëzohej nga imperializmi si një kërcënim lufte nga ana jonë, pse një akt i tillë i kapërcente kufitë e një vetëmbrojtjeje dhe se në këtë rast hynte në veprim Traktati i miqësisë dhe i ndihmës reciproke. Ardhja e divizionit dhe shpallja e Korçës zonë jugosllave, do të kishte pasoja të rënda në popullin tonë, i cili do të alarmohej pa masë dhe pa qenë nevoja, do të shkaktonte konsekuenca shumë serioze si nga ana politike, ashtu edhe nga ana ekonomike.

Qeveria sovjetike s'kishte aspak dijeni për propozimin jugosllav. Vetëm kur e vumë ne në korrent, ajo mësoi se ç'bëhej dhe dha mendimin se nuk e shihte aspak të arësyeshme të pranohej një propozim i tillë. Këshilla e drejtë e qeverisë sovjetike na përforcoi mendimin për të mos pranuar ardhjen e divizionit. Jugosllavët na kritikuan ne dhe veçanërisht mua që lajmërova qeverinë sovjetike dhe që s'isha i bindur për ardhjen e divizionit në Korçë.

Ardhjen e divizionit në Korçë jugosllavët kishin ndër mend ta përdornin edhe për qëllime të tjera. Ata ishin në marrëdhënje të këqia me Bashkimin Sovjetik, u përpoqën të na shtinin edhe ne në armiqësi me të, Gjenerali Kupreshanin, një antisovjetik me damkë, arriti sa të thoshte monstruoze të më të ndytë se «Bashkimi Sovjetik do ta sakrifikojë Shqipërinë te imperialistët». Kupreshanin, besnik i trockistëve të Beogradit, e barazonte politikën e drejtë të Bashkimit Sovjetik me

politikën e njerëzve që bënë Mynihun. Përfaqësuesit trockistë të Beogradit, që nga Savo Zllatiç dhe Josip Gjergja e deri te Spiro Sergjentiç, u shprehën po në këtë mënyrë të poshtër antisovjetike. Qëndrimi i një divizioni jugosllav në Korçë dhe dërgimi edhe i divizioneve të tjera, gjoja për të mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e vendit tonë, do t'u shërbente udhëheqësve jugosllavë si mbështetje për të imponuar pikëpamjet e tyre dhe për të shtypur me forcë çdo rezistencë të Partisë sonë.

Pas dështimit të planit për dërgimin e divizionit, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe Titua u munduan të mbanin në Shqipëri po atë psikozë luftime. Përfaqësuesi jugosllav në Shqipëri u orvat të bindë Komitetin Qendror dhe Shtatmadhorinë tonë se duhej të merreshin masa të jashtzakonshme ushtarake, «të ndërrohej karakteri i ushtrisë dhe organizimi i saj, të ndërtoheshin ura të reja dhe ato që ishin të zmadhoheshin, pse në to do të kalonin tanksa të rëndë që do të vinin nga Jugosllavia për të përballuar situatën, të ndërtoheshin shumë kilometra rrugë me karakter ushtarak dhe strategjik, të ndërtoheshin vija të reja telegrafike, të mobilizoheshin 10 000 vetë të tjerë të rinj dhe një sasi e madhe mushkash për ushtrinë» e shumë masa të tjera të kësaj natyre. Dhe të gjitha këto duhet të bëheshin brenda 2-3 muajve, sepse rreziku ishte iminent.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi ushtarak i Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë në një mënyrë të poshtër u përpoq të vërtetonte se ushtria jonë «ishte shumë e dobët dhe mund t'i rezistonte një sulmi monarko-fashist vetëm 10 ditë». Duke qenë kështu, thoshin ata,

«nga mosardhja e divizionit në qarkun e Korçës, për të cilin fajtor ishte Sekretari i Përgjithshëm i Partisë do të vihej në rrezik Shqipëria e Jugut». Përfaqësuesi i Beogradit deklaroi se «Jugosllavia nuk do të ishte në gjendje t'i vinte në ndihmë Shqipërisë, pasi forcave të saj që ndodheshin në Mal të Zi e në Kosovë do t'u duheshin 15 ditë për të ardhur deri në Shkumbin, por deri atëhere çdo gjë do të kishte mbaruar, monarko-fashistët dhe anglo-amerikanët do ta kishin pushtuar Shqipërinë e Jugut. Çështja do të merrte karakter ndërkombëtar, do të kishte ndërhyrje të OKB-së me komisione speciale dhe në këto kushte Jugosllavia do ta kishte të vështirë të hynte në luftë». Këtu jugosllavët, për të na frikësuar, vinin në dyshim vetë Traktatin e miqësisë e të ndihmës reciproke. Nga ana tjetër, kërkuan me këmbëngulje që ne t'i kërkonim qeverisë sovjetike të ndryshonte mendimin për ardhjen e divizionit në rrethin e Korçës dhe na porositën që «në rast se ajo nuk ndërronte mendim, të insistonim dhe t'i kërkonim arsëyet me këmbëngulje». E gjithë kjo bëhej me qëllim që ne të vepronim në këtë çështje me rëndësi, pa pëlqimin e qeverisë sovjetike dhe të armiqësoshim me Bashkimin Sovjetik. Kjo ishte një vepër e poshtër, e denjë për trockistët.

Në të gjitha këto çështje ne nuk ishim dakord me jugosllavët, ne i gzykonim ato krejt ndryshe, me përjashtim të shokut Shule¹.

Kristo Themelko për një kohë të gjatë ishte transmetuesi i pikëpamjeve të gabuara të jugosllavëve, ishte

¹ Kristo Themelko.

dakord me këto pikëpamje, atij i qe lëkundur mjaft besimi te Komandanti. Këto ishin gabime shumë të rënda për shokun Shule, por do të jetë gabim t'i marrim ato të shkëputura nga të gjitha rrethanat e krijuara. Shoku Shule i njohu ndershmërisht këto gabime, bëri një autokritikë të shëndoshë, të drejtë dhe të hapët dhe e dënoi ashpërsisht rrugën e gabuar, ku e kishin influencuar jugosllavët. Nuk mund të kuptohen ndryshe këto gabime të Shules që nuk pajtohen me klasën e tij, me të shkuarën e tij revolucionare dhe me luftën e tij të vendosur për popullin e Partinë, përveçse me influencimin e madh nga ana e jugosllavëve, nga besimi i plotë që ai kishte në ta dhe nga gjendja që ishte krijuar në Partinë tonë. Këto janë rrethanat lehtësuese të gabimeve të Shules.

Duke qenë nën influencën e plotë të jugosllavëve, Kristo Themelko mendonte krejtësisht si ata dhe i quan te me vend të gjitha tezat e tyre. Ne s'ishim dakord me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, që nga ndërhyrja në çështjet ushtarake dhe deri te ardhja e divizionit në Korçë. Ne i quanim të marrura të gjitha masat për çështje ushtarake që propozuan ata, por pas insistimit të tyre, pranuan të bëheshin urat, rrugët, të bëheshin vijat telefonike etj., përveç mobilizimit të 10 000 vetëve dhe kafshëve që do të kryheshin jashtë planit tonë dhe me kredi speciale të akorduara nga buxheti jugosllav. Ne kishim bindjen e plotë se asnjë nga këto masa nuk do të realizohej.

Përse udhëheqësit jugosllavë e paraqitën gjendjen kaq alarmante dhe propozuan masa kaq të mëdha, saqë edhe një kalama e kuptonte fare lehtë se punë të tilla

jo vetëm s'mund të kryheshin kurrë brenda dy muajve, por dhe s'kishte asnjë arsye serioze që të bëheshin? Propozimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë u bënë për herë të parë me anën e shokut Shule dhe më vonë drejtpërdrejt prej Savo Zllatiçit. Shoku Shule, i influencuar shumë prej tyre, dy-tri herë shtroi në Byronë Politike çështjen se të gjitha masat e propozuara në lëmin ushtarak, nuk mund të zgjidheshin me format konstitucionale që ekzistonin, prandaj duhej të bëhej bashkimi i popullit tonë me popujt e Jugosllavisë dhe kjo duhej të bëhej shpejt. Kushtet, sipas tyre, ishin pjekur dhe nuk duhej pritur në asnjë mënyrë. Jugosllavët kërkonin nga Shulja të dinin mendimin tim për propozimet e tyre, por e këshilluan atë që në rast se unë nuk i pranoja ato, t'i paraqiste si propozimet e veta. Dukej qartë se dyshimi i tyre ndaj meje po forcohej.

Më në fund, Savo Zllatiçi vetë na propozoi që ne t'i kërkonim Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Ne i dhamë përgjigje me letra Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për të gjitha këto çështje. Këto letra janë dokumenta me rëndësi për Partinë tonë. Ne nuk ishim dakord me pikëpamjet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe ky nuk mundi të merrte dot nga ne atë që dëshironte, domethënë aprovimin tonë për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë.

Po në këtë kohë, jugosllavët, në fillim me anën e Shules dhe mbasandaj direkt nga përfaqësuesi ushtarak i Titos në Shqipëri, gjeneral Kupreshanin, shtruan çështjen e krijimit të komandës unike. Me anën e Shules,

kur ky shkoi në Beograd, u propozua dhe u vendos që Shtatmadhuria të ndryshonte strukturën. Të kishte një nënministër të luftës dhe të gjithë sektorët e ushtrisë të vareshin nga nënministri i luftës. Brenda në këta sektorë hynte edhe Shtatmadhuria. Ky veprim i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë që rrezikonte zbulimin e qëllimeve të tyre më vonë u ndryshua përsëri, pas sugjerimeve që i bënë Shules. Qëllimi i jugosllavëve ishte spostimi i Komandantit të përgjithshëm nga drejtimi i komandës së ushtrisë sonë. Kjo desh të thoshte «t'i hiqej kryq Komandantit të Përgjithshëm», siç i kishte thënë me të drejtë shoku Mehmet Shehu, Pëllumb Dishnicës që përkrahte propozimin jugosllav. Pas përgjegjeve tona në letrat që përmendëm më lart, të gjitha këto propozime ranë.

Duhet të theksojmë se të gjitha këto propozime dhe masa që kërkonin të merrnin dhe të realizonin jugosllavët, po bëheshin me një ngutësi të madhe. Ata kishin frikë se mos demaskimi i tradhëtisë së tyre nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik do t'ua digjte kartat në duar, prandaj nguteshin për të na tërhequr edhe ne në rrugën antimarksiste, për të krijuar një blok kundër kampit të socializmit.

Ne ishim krejt të ndërgjegjshëm se veprimet e jugosllavëve s'ishin të drejta, por, pa qenë në dijeni të tradhëtisë së tyre, na duhej të ishim të kujdesshëm dhe të ecnim me ngadalë. Jugosllavët, nga ana tjetër, në këtë situatë krijuan në Byronë tonë një atmosferë të tillë, sa që vihej në diskutim në se duhej të këshilloheshim me shokët sovjetikë për këto çështje apo s'duhej, në se duhej t'i mbanim ata në korrent apo jo. Ta shtroje çësh-

tjen kështu, ishte gabim. Ne i shfaqëm Savo Zllatiçit pikëpamjen tonë, duke i thënë se një qëndrim i tillë ndaj njerëzve sovjetikë dhe qeverisë sovjetike nuk ishte i drejtë. Ai u orvat ta justifikojë e të thotë se këto janë çështjet tona të brendshme, prandaj për to nuk mund të njoftojmë shokët sovjetikë pa i diskutuar më parë vetë. Ata kërkonin ta vinin Bashkimin Sovjetik përpara «fait accompli»-ve, të kurdisura me intriga dhe veprime antimarksiste. Një situatë të tillë ne i dhamë fund.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, pas letrave tona dhe pas dështimit të planeve të tyre, na çoi përsëri Savo Zllatiçin me propozime të reja. Ai propozonte bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë jodrejtëpërdrejt, por me forma ekonomike të tilla që de fakto donin të thoshin një bashkim i vërtetë. Këto forma ishin po ato që u përmendën më lart e u përdorën pas analizës sonë të fundit. Pastaj na u propozua një alternativë e tillë: ose të qëndronim në gjendjen ekzistuese, duke i konkretizuar më mirë lidhjet që ekzistonin (por kjo do të thoshte sipas tyre «të hidhje hapa prapa dhe s'ishte mirë»), ose të priteshin marrëdhënjet. Të gjitha këto propozime u paraqitën si të Savo Zllatiçit, të pranuar në parim prej Komitetit Qendror të PKJ. Ato duhej të studjoheshin e të diskutoheshin nga ne, kurse përfundimin e bisedimeve e propozimet tona duhet t'ja jepnim Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Një veprim i tillë bëhej me qëllim që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë nga një anë të mos merrte mbi vete asnjë përgjegjësi, por këtë t'ja linte një farë Savo Zllatiçi, nga ana tjetër të kup-

tonte mendimin tonë dhe sidomos të merrte vesh në se ishim në korrent të konfliktit që ekzistonte midis Partisë Bolshevike të BS dhe Partisë Komuniste Jugosllave dhe cili ishte qëndrimi ynë në këtë çështje.

Pak ditë pas paraqitjes së propozimeve të mësipërme ne u vumë në dijeni të letrës së parë të Partisë Bolshevike, drejtuar Titos dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave. Letra e Partisë Bolshevike na ndihmoi të kuptonim si duhet lodrën armiqësore antishqiptare të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ne ndaluan menjëherë largimin e këshilltarëve sovjetikë. Jugosllavët, kur panë se këshilltarët sovjetikë nuk u larguan nga Shqipëria, gjë që e prisnin me padurim dita-ditës, kuptuan se çdo manevër e tyre kishte dështuar dhe filluan menjëherë nga shpifjet e poshtra, nga kërcënimet e hapëta, nga ultimatumet. Savo Zllatiçi, Josip Gjergja dhe gjeneral Kupreshanin u larguan në mënyrë brutale dhe armiqësore nga vendi ynë. Titua ju drejtua Komitetit tonë Qendror me një letër të ulët, me të cilën akuzon atë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë për gjëra të paqena. Ai u përpoq të fuste përçarje në Byronë Politike dhe të krijonte në Partinë tonë një situatë tjetër të vështirë, si ajo që u krijua në prak të Plenumit VIII, por çdo veprimtari e tyre keqbërëse kundër vendit tonë, kundër Partisë dhe popullit tonë, tashmë s'pinte ujë. Letrat e Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike kishin ndihmuar Partinë tonë të shpëtonte nga thonjtë e trockistëve jugosllavë, të shpëtonte njëkohësisht popullin dhe vendin tonë nga katastrofa ku kërkonin ta tërhiqnin këta tradhëtarë.

Para se të shohim gabimet që u bënë në analizën e Plenumit VIII është e domosdoshme të shohim edhe marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovjetik.

MARRËDHËNJET TONA ME BASHKIMIN SOVJETIK DHE QËNDRIMI I UDHËHEQJES JUGOSLLAVE NDAJ KËTYRE.

Partia jonë dhe Komiteti Qendror nuk kanë gabuar në qëndrimet e mbajtura ndaj Partisë Bolshevike dhe Bashkimit Sovjetik. Lufta heroike e Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit ka qenë një nga faktorët kryesorë që shpejtuan formimin e Partisë sonë. Sulmi kundër Bashkimit Sovjetik nga ana e hitlerianëve ishte një goditje edhe për gjithë komunistët e grupeve të ndryshme komuniste, sepse ata shihnin te Bashkimi Sovjetik atdheun e lavdishëm të socializmit, forcën e madhe që mbronte paqen, popujt e robëruar, popujt kolonialë e gjysmëkolonialë dhe gjithë njerëzimin përparimtar. Bashkimi Sovjetik ishte mbështetja dhe ndihma e vetme për të gjithë popujt përparimtarë të botës. Ai na jepte shpresa dhe forcë për të luftuar skllavërimin e kapitalistëve dhe latifondistëve gjakpirës, ai dhe Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit ishin për komunistët shqiptarë dhe për gjithë njerëzit e shtypur të Shqipërisë, fari që shkëlqente dhe hidhte dritë në rrugën tonë. Partia jonë e lidhi luftën e popullit tonë me luftën e Bashkimit Sovjetik. Që prej traktit të vet të parë dhe deri në fund të Luftës nacional-çlirimtare, Komiteti ynë Qendror e mësoi Partinë ta dojë Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin. Partia i shpjegoi popullit, që në orët e para të luftës, se fitorja do të ishte e jona, pse ne

ishim të lidhur me Bashkimin Sovjetik dhe se Gjermania fashiste do të thyhej, kurse Bashkimi Sovjetik ishte i pathyeshëm. Populli ynë e kishte të qartë se fitorja e tij ishte e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me fitoret e popujve të Bashkimit Sovjetik. Çdo ditë organizatat e Partisë sonë vinin në korrent popullin dhe ushtrinë tonë për luftën e Bashkimit Sovjetik, për sukseset e saj, prandaj çdo ditë shtohesh dashuria e popullit tonë për Bashkimin Sovjetik, për Ushtrinë e Kuqe, për shokun Stalin. E gjithë kjo punë i detyrohej Partisë sonë dhe vijës së saj të drejtë.

Në muajt e parë të çlirimit, kur Partia dhe shteti ynë i ri po hidhnin themelet e politikës së jashtme dhe çapat e parë të rindërtimit, Bashkimi Sovjetik na dha një ndihmë të drejtëpërdrejtë. Në çdo konferencë ndërkombëtare ai mbronte popullin tonë. Kudo dëgjohej zëri i fuqishëm i Bashkimit Sovjetik në mbrojtje të të drejtave të popullit tonë dhe të lirisë së tij nga anglo-amerikanët, në mbrojtje të pavarësisë dhe të integritetit tokësor të vendit nga lakmitë e anglo-amerikanëve dhe satelitëve të tyre monarko-fashistëve grekë. Ato ishin momente shumë të rënda, që u kapërcyen me rezistencën e paepur të Partisë dhe të popullit tonë, por këtë ja detyrojmë edhe ekzistencës e përkrahjes së Bashkimit Sovjetik. Në këto rrethana populli ynë u lidh edhe më ngushtë me Bashkimin Sovjetik. Një gjë e tillë i detyrohet Partisë sonë dhe Komitetit Qendror të saj që ndoqën një vijë politike të drejtë. Ndihma e Bashkimit Sovjetik dhe e Partisë Bolshevike nuk ju kursye Partisë sonë. Përveç ndihmës së madhe morale, s'mungoi të na vinte dhe ndihma ekonomike.

Por dashurinë që ushqente Partia jonë dhe besimin e madh që kishte ajo ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë Bolshevike, ndaj shokut Stalin dhe njerëzve sovjetikë që ndodheshin në Shqipëri, nuk e shihnin me sy të mirë udhëheqësit trockistë jugosllavë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë e konsideronte Shqipërinë si një vend që duhej të ishte nën tutelën e tij. Ne, sipas udhëheqësve jugosllavë, ishim një shtet i vogël që nuk mund të mbroheshim as të zhvilloheshim pa ndihmën e Jugosllavisë. Sipas tyre, Bashkimi Sovjetik «ishte larg, ishte një shtet i madh e i fuqishëm, që nuk mund të interesohej direkt për Shqipërinë». Meqenëse ndihmat ekonomike të BS na jepeshin nëpërmjet Jugosllavisë, në këtë spekulohesh dhe lihej të kuptohej sikur KQ i PKJ dhe Titua ishin marrë vesh me Bashkimin Sovjetik që për Shqipërinë të interesohej Jugosllavia. Këtë qëndrim mbanin ata ndaj nesh, ndërsa para Bashkimit Sovjetik përpiqeshin me demagogji të fshihnin lodrën e tyre.

Qëndrimi i Bashkimit Sovjetik ndaj popujve të tjerë ishte krejt i ndryshëm nga ai i Jugosllavisë. Stalini, në darkën që dha për delegatët e qeverisë Finlandeze, pas nënshkrimit të traktatit sovjeto-finlandez, ndërmjet të tjerave tha:

«Shumë njerëz nuk besojnë se mund të ekzistojnë marrëdhënje barazie midis një kombi të madh dhe një kombi të vogël. Por ne, njerëzit sovjetikë, konsiderojmë se të tilla marrëdhënje mundet dhe duhet të ekzistojnë. Njerëzit sovjetikë konsiderojnë se çdo komb, pavarësisht në se

është i madh ose i vogël, ka veçoritë e veta cilësore, specifikën e vet, e cila i takon vetëm atij dhe që nuk e kanë kombet e tjerë. Këto veçori përbëjnë atë kontribut që sjell çdo komb në thesarin e madh të kulturës botërore dhe e plotëson atë, e pasuron atë. Në këtë kuptim të gjitha kombet, të vegjël dhe të mëdhenj, ndodhen në pozita të njëjlojta dhe çdo komb është i barabartë me çdo komb tjetër»¹.

Njerëzit sovjetikë i kanë parë marrëdhënjet me vendin tonë në këtë prizëm që na mëson Stalini. Dhe në asnjë moment nuk e humbëm besimin që kishim në ta. Trockistët jugosllavë na kanë sulmuar me gjithë arsenalin e tyre për të goditur besimin që kishte Partia jonë ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë Bolshevike dhe ndaj njerëzve sovjetikë në Shqipëri. Ata i kishin shfaqur haptas pakënaqësitë e tyre. Vetë Titua dhe shokët e tij më të afërt ishin ankuar se «ne merrnim ndihma nga jugosllavët, por kurrë s'hoqëm dorë nga Bashkimi Sovjetik».

Lufta e trockistëve jugosllavë kundër vijës së drejtë të Partisë sonë ishte frontale dhe shtrihej në të gjithë sektorët kyçe: në orientimin politik të përgjithshëm të Partisë dhe të qeverisë, në ekonomi dhe në ushtri.

Në orientimin politik të Partisë, trockistët jugosllavë nuk mundën të korrnin ndonjë sukses; në lëmin e ekonomisë, me anën e të cilit ata do të bënin presion, mundën të lëkundin disi besimin e Komitetit Qendror

1 «Pravda», Nr. 104 (10845) d. 13 prill 1948.

të Partisë sonë përse i përket dobisë së qëndrimit të këshilltarëve sovjetikë në vendin tonë. Pas analizës së Plenumit VIII, pas presioneve dhe shantazheve të udhëheqjes jugosllave, ne pranuan tezën e tyre se gjoja s'kishim nevojë për këshilltarët sovjetikë, por vetëm për teknikët. Çështja e këshilltarëve nuk mund të ndahej nga ajo e teknikëve. Këshilltarët dhe teknikët sovjetikë përbënin një të tërë. Megjithatë, ne nuk ishim aspak të bindur për atë që thoshim.

Në të njëjtën kohë trockistët jugosllavë na atakuan edhe në frontin e ushtrisë, por atje s'patën sukses. Me këmbëngulje dhe me shantazhe të shumanshme ata u përpoqën të largonin nga ushtria këshilltarët ushtarakë sovjetikë. Qenja e këshilltarëve sovjetikë në ushtrinë tonë i prishte të gjitha planet e tyre antisovjetike, anti-marksiste. Ata dëshironin që ushtria jonë të pranonte dhe të adoptonte pikëpamjet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë përse i përket artit ushtarak dhe organizimit të saj. Goditjet e trockistëve jugosllavë në ushtri ishin shfaqur edhe para analizës së Plenumit VIII. Këto goditje në fillim u bënë indirekt, duke kritikuar dhe goditur Shefin e Shtatmadhorisë sonë, shokun Mehmet Shehu. Një qëndrim i tillë po kristalizohej pak nga pak jo vetëm kundër shokut Mehmet, por edhe kundër meje. Kundër meje kjo nuk bëhej e hapët akoma, por tërthorazi aty delte, pasi unë përkrahja qëndrimin e shokut Mehmet, isha unë që e kisha propozuar Mehmetin për në Byronë Politike dhe për arsye se isha Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë.

Jugosllavët arritën të influenconin një sërë shokësh të Drejtorisë politike të ushtrisë sonë. I pari ishte

Pëllumb Dishnica, i cili shfaq konkretisht mendimin për ndryshimin e orientimit në ushtri dhe paraqiti tezat për riorganizimin e saj. Tezat e Pëllumb Dishnicës ishin tezat e jugosllavëve. Shoku Mehmet Shehu më raportoi gojarisht mbi këtë çështje dhe unë e gjeta të drejtë pikëpamjen e tij. Tezat e Pëllumbit ishin të gabuara në parim. Atje s'ishte çështja e marrjes eksperiencë nga ushtria jugosllave, atje ishte çështja të ndryshohej orientimi politik i ushtrisë sonë, të braktisej eksperiencia e ushtrisë sovjetike. Këtë rrezik unë e kuptova menjëherë, prandaj thirra Pëllumb Dishnicën për ta sqaruar. Orientimet në ushtri janë vendosur nga Komiteti Qendror, i thashë Pëllumb Dishnicës, me to nuk luhet dhe as që lejoj që ato të vihen në diskutim. Pëllumbi, pas këshillës që i dhashë, pohoi se «u sqarua», kurse në mbledhjen e Plenumit VIII tha se në realitet nuk ishte sqaruar. Bile, në mënyrë provokuese, ai pyeti gjeneral Shulen po për këtë problem dhe pasi u pa qartë që pikëpamjet e tyre përputheshin, ai shtoi: «po Komandanti mendon ndryshe nga ne».

Udhëheqësit jugosllavë influencuan rëndë njerëzit tanë në Drejtorinë politike kundër orientimit të drejtë të Partisë në ushtri dhe, çka ishte më e rrezikshme, kishin tronditur besimin te Komandanti i Përgjithshëm. Kjo ishte pikënisja që do t'i çonte njerëzit e Drejtorisë politike në gabime më të rënda. Më vonë shoku Shule dhe Pëllumb Dishnica, duke u bërë zëdhënës të udhëheqjes jugosllave, kërkuan me këmbëngulje largimin e këshilltarëve sovjetikë nga ushtria jonë.

Pas Plenumit VIII gjendja u acarua edhe më shumë. Jugosllavët kujtuan se ishte momenti për të ndry-

shuar situatën edhe në ushtri. Ata e konsideronin ushtrinë tonë, ushtrinë e një populli të pavarur, si një armatë jugosllave dhe shokët e Drejtorisë sonë politike punonin sikur ushtria jonë të ishte një armatë midis armatave të tjera jugosllave. Vukmanoviç Tempua, në një vizitë që bëri në Drejtorinë tonë politike, kritikoi haptas udhëheqësit e ushtrisë sonë, tamam sikur jugosllavët të ishin drejtuesit e vërtetë të saj.

Pas Plenumit VIII popullarizimi i Bashkimit Sovjetik kaloi në plan të dytë. Përkundrazi Jugosllavia delte mbi të gjithë në propagandën tonë. Instruktorët sovjetikë përbuzeshin paturpësisht dhe viheshin në lojë prej jugosllavëve. Jugosllavët përdorën sharjet më të poshtra antisovjetike. Ata i konsideronin këshilltarët sovjetikë si një pengesë për punën e tyre dhe në realitet ashtu ishte. Ata haptas shfaqnin pikëpamjen e tyre «se nuk mund të shkonte puna në ushtri, po të mbaheshin akoma këshilltarët sovjetikë, nuk mund të punohej me dy lloj këshilltarësh». Ata i nënvleftësonin këshilltarët sovjetikë dhe bënin çdo gjë për t'i përçmuar me arrogancën dhe mendjemadhësinë e tyre. Një frymë të tillë përpiqeshin të përhapnin edhe në shokët tanë. Ata mundoheshin të na bindnin se gjoja ne s'ishim në gjendje të shfrytëzonim eksperiencën sovjetike, se eksperiencia sovjetike merrej nga jugosllavët dhe pas një përpunimi të hollësishëm adaptohej për kushtet e vendeve e ushtrive tona. Pra neve s'na mbetej gjë tjetër veçse të merrnim «artin ushtarak jugosllav dhe ta aplikonim, pse ai i përshtatej më shumë ushtrisë sonë». Por Komiteti ynë Qendror nuk u lëkund dhe përpjekjet e tyre dështuan. Jugosllavët prisnin me padurim largimin e

sovjetikëve, por kur panë se asnjë nga këshilltarët sovjetikë nuk u largua, filluan luftën më të ndytë kundër nesh. Tërbimi i klikës titiste dhe i delegatëve jugosllavë në Shqipëri arriti kulmin. Nën pretekste false, ata prenë marrëdhënjet që ekzistonin midis ushtrive tona.

ANALIZA E PLENUMIT VIII TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË DHE GABIMET TONA TË MËDHA.

Analiza në Plenumin VIII të KQ, të cilën mund ta quajmë gabimin më të madh që ka bërë Komiteti ynë Qendror gjatë gjithë jetës së tij, u bë nën nxitjen direkte të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ajo u mbështet në akuzën e pathemeltë, antimarksiste e antishqiptare të udhëheqjes trockiste jugosllave dhe në situatën e vështirë që ekzistonte në Byronë tonë Politike dhe në udhëheqje në përgjithësi. Qëllimi i trockistëve jugosllavë ka qenë të likuidonin udhëheqjen e shëndoshë të Partisë dhe, në radhë të parë, Sekretarin e Përgjithshëm të saj dhe pastaj shokun Nako Spiru e Mehmet Shehu, si njerëz të padëshirueshëm për Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave. Me një goditje të tillë ata mendonin të shuanin çdo rezistencë serioze që pengonte realizimin e qëllimeve të tyre. Cilat ishin pikat kryesore, ku mbështetej kritika jugosllave që i dha shkas analizës që u bë në Plenumin VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë?

1.— Në Shqipëri ishte krijuar një front antijugosllav.

2. — Projektplani pesëvjeçar, i hartuar nga pala shqiptare, ishte autarqik dhe ireal.

3. — Shqipëria nuk duhej të bënte asnjë marrëveshje me shtete të tjera, pa lejën e Jugosllavisë.

4. — Politika e qeverisë shqiptare ishte në kundërshtim flagrant me aspiratat e popullit shqiptar dhe se për faj të saj marrëdhënjet e Shqipërisë me Jugosllavinë ishin për tokë.

5. — Në të gjithë këtë punë armiqësore Nako Spiru ka luajtur një rol të çuditshëm. Në këto pozita kanë qenë edhe shokë të tjerë.

6. — Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë duhet të shohë mirë se këtu mos ka gisht armiku.

Këto pika kryesore, ku bazohej kritika jugosllave duhen analizuar me kujdes, pse në to përmbledhen të gjitha qëllimet antimarksiste e antishqiptare të udhëheqjes jugosllave.

Çështja «e shkëputjes» të vendit tonë nga Jugosllavia, ashtu si e kuptojmë ne, d.m.th. heqje dorë nga bashkëpunimi, është një akuzë krejtësisht e pathemeltë dhe shpifarake. Asnjë veprim i Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe asnjë veprim i izoluar i ndonjë anëtari të Partisë nuk është bërë në këtë drejtim. Komiteti ynë Qendror çështjen e bashkëpunimit me jugosllavët e ka shtruar gjithmonë drejt, ndërsa ata vetë i ndërtuan këto marrëdhënie në rrugë të shtrembër, për qëllime të caktuara antishqiptare dhe antimarksiste. Në qoftë se ne do të donim «të shkëputeshim» nga Jugosllavia dhe të ecnim në rrugë të shtrembër, do të kishim hequr dorë nga ndihma jugosllave dhe do të ishim orientuar nga

Perëndimi, ose nga plani Marshall. As Partia jonë, as Komiteti Qendror i saj dhe asnjë anëtar i Partisë sonë s'ka punuar në këtë drejtim.

Atëhere ku mbështetej akuza që na bëhej? Jugosllavët i shqetësonte orientimi i drejtë i Partisë sonë për zhvillimin ekonomik të vendit jo vetëm me Jugosllavinë, por dhe me Bashkimin Sovjetik. Këtë orientim ata e quanin shkëputje nga Jugosllavia. Jugosllavët e dinin fare mirë ç'situatë të favorshme dhe entuziaste kishte krijuar Partia jonë në masat e popullit shqiptar për Jugosllavinë e re, por kjo atyre nuk u mjaftonte, ata kërkonin nënshtrimin e plotë të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Si argument për të vërtetuar tezën e tyre ata përdorën çështjen e projektplanit pesëvjeçar. Por ky argument nuk qëndronte aspak më këmbë. Të supozojmë për një minutë që projektplanin ynë pesëvjeçar ishte autarqik, ireal, i fryrë, etj., etj. Ku e çonte vendin tonë një projektplan i tillë i fryrë, etj., etj.? Që ky plan ireal e shkëpuste Shqipërinë nga Jugosllavia duhet ta çonte dhe ta lidhte diku gjetkë, me një vend tjetër. Që ta çonte Partia vendin tonë dhe ta lidhte këtë me shtetet e Perëndimit, s'kishte asnjë të dhënë, pse të tilla pikëpamje s'ka pasur kurrë në Partinë tonë. Atëhere mbetej vetëm lidhja me Bashkimin Sovjetik. Por si mund të kuptohej një gjë e tillë, kur Bashkimi Sovjetik dhe Stalini na kishin këshilluar si duhet t'i kemi ne marrëdhënjet me jugosllavët dhe jugosllavët me ne? Në qoftë se dëshira e madhe nga ana jonë, që të kishim me Bashkimin Sovjetik edhe marrëdhënje ekonomike, do të ishte e tepruar, Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin do të na këshillonin, sikundër që na kanë këshilluar urtë-

sisht, se si duhej t'i kishim marrëdhënjet me Jugosllavinë. Dhe ne këshillat e shokut Stalin i kemi dëgjuar dhe zbatuar me vendosmërinë më të madhe. Pra të kishim marrëdhënje me Bashkimin Sovjetik, s'ishte një gabim. Por edhe sikur plani pesëvjeçar të ishte autarqik ose ireal, siç thoshin jugosllavët, një gjë e tillë nuk le aspak të dyshohet se ne dëshironim të kishim marrëdhënje me Bashkimin Sovjetik në dëm të Jugosllavisë. Një marrëzi dhe poshtërsi të tillë mund ta thoshin vetëm jugosllavët. Këto ishin shpifje të alambikuara. Në qoftë se projektplanin ynë ishte i gabuar, ai duhej të korrigjohej dhe asgjë tjetër.

Përse ky projektplan lidhej me çështje politike dhe përdorej për të goditur vijën tonë dhe për ta quajtur këtë të gabuar? Ne mendojmë se një shtet, në qoftë se ka kohë dhe kuadro, mund të bëjë dhe pesë plane, t'i çjerrë katër dhe të mbajë vetëm një, më të mirin. Ne nuk na u dha mundësia, as ta studjonim edhe atë një, në se ishte i mirë apo i keq dhe ta korrigjonim atje ku s'ishte i mirë. Por çështja nuk ishte te plani. Nën pretekstin e projektplanit goditej vija e Partisë sonë, Komiteti Qendror dhe udhëheqësit e saj dhe çka ishte më e rëndë, goditeshin Bashkimi Sovjetik, këshilltarët sovjetikë dhe orientimi i drejtë i tyre. Për këtë qëllim, pse të shkojmë më tej, jugosllavët nuk kishin parashikuar as kreditin më të vogël për vendin tonë në buxhetin e tyre të planit pesëvjeçar. Ata gjykonin: në rast se ata ja arrinin qëllimit, të bashkonin Shqipërinë me Jugosllavinë me metodat e tyre, atëhere çështja e planit pesëvjeçar rregullohej fare lehtë; në rast se dështonin në planin e tyre, atëhere s'kishte pse Jugosllavia të çante

kokën për të ndihmuar Shqipërinë, se do të krijohet kjo situatë që u krijua.

Unë e shpjegova më lart se për ne plani s'ishte as ireal, as autarqik, dhe, në rast se kishte disa ekzagjerime, ato ndreqeshin, nuk ishin kushedi se çfarë. Për këto ekzagjerime është akuzuar Nakua sikur kishte bërë diçka të madhe. Kjo s'është e drejtë. E para, në qoftë se këto ekzagjerime janë bërë, s'është faji vetëm i Nakos, po i gjithë Komitetit Qendror që nuk i korrigjoi. Por edhe sikur t'ja lëmë Nakos në kurriz ato ekzagjerime, ato s'ishin gabime vije të rrezikshme. Mbasandaj, kush mund të ketë pretendimin që s'bëhen gabime në punë? Shumë të tjerë kanë bërë gabime edhe më të mëdha dhe Partia i ka korrigjuar ato gabime, jo këto që ishin të vogla. Por unë dëshiroj të them këtu se, përsa i përket planit pesëvjeçar orientimi ynë ka qenë nga më të drejtët nga ana politike dhe nga ajo ekonomike, kulturele dhe shoqërore. Orientimi ka qenë që vendi ynë, si një republikë e pavarur e kampit demokratik, të ndërtonte socializmin me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, të Jugosllavisë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, duke mobilizuar të gjitha forcat e gjalla të popullit të vet nën drejtimin e Partisë Komuniste të tij. Orientimi i planit tonë luftonte çdo frymë shfrytëzimi dhe kolonizimi imperialist, synonte ndërtimin e industrisë dhe elektrifikimin e vendit, synonte ngritjen dhe forcimin e klasës punëtore të Shqipërisë, zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë sonë në rrugën e drejtë të socializmit. Jugosllavët ishin për një orientim të kundërt. Shqipëria për ta nuk duhej të zhvillonte industrinë, por lëndët e para të nëntokës së saj të shkonin

për t'u përpunuar në Jugosllavi. Bujqësia, sipas tyre, duhej të zhvillohej në atë drejtim, që Shqipëria të bëhej një çiflik i madh i Jugosllavisë dhe bujqit tanë t'i furnizonin asaj gjithë lëndën e parë, që do të punohej atje. Shqipëria do të merrte çdo send të fabrikuar nga Jugosllavia deri edhe bukën. Kjo do të ishte një vartësi e plotë në rrugën koloniale dhe imperialiste.

Ideja që ne të hartonim planin pesëvjeçar u hodh nga jugosllavët për të bërë goditjen kundër nesh dhe kundër specialistëve planovikë sovjetikë që na ndihmuan për hartimin e këtij projektpiani të drejtë. Jugosllavët, duke goditur këtë projektpan, nuk kishin për qëllim çështjen e një ose dy fabrikave që ishin vënë të tepërta në të, por qëllimet e tyre ishin politike. Ata s'kishin asnjë qëllim që të bëhej një plan pesëvjeçar për Shqipërinë, por kishin qëllimet që u thanë. Do të ishte një kritikë pa kripë që nuk do të qëndronte në këmbë, në rast se jugosllavët mbeteshin vetëm në akuzat dhe shpifjet e tyre në lidhje me planin tonë pesëvjeçar. Ata e rrethuan këtë çështje me shpifje të tjera.

Jugosllavët na kritikuan dhe na paralajmëruan që, para se të bënim ndonjë marrëveshje me ndonjë shtet tjetër, të merrnim pëlqimin e qeverisë jugosllave. Kjo tregon fare qartë se si e konsideronte Jugosllavia vendin tonë. Pastaj ne s'kishim bërë me asnjë shtet marrëveshje, përveçse një akord krediti me Bashkimin Sovjetik. A ishte ky një gabim? Krediti që na jepte Bashkimi Sovjetik a ishte në dëmin e vendit tonë dhe të marrëdhënjëve me Jugosllavinë? As që është e nevojshme t'i japim përgjegje kësaj pyetjeje. Por është fakt që jugosllavëve kjo s'u pëlqeu aspak, pse u prishte planet e

tyre antimarksiste. Ata donin ta mbanin vendin tonë të izoluar krejt dhe të bënin me të ç'të donin. Me të drejtë populli ynë i ishte mirënjohës Bashkimit Sovjetik për ndihmën e madhe që po i jepte. Por kjo s'u pëlqente udhëheqësve jugosllavë. Ju i dini veprimet e poshtra të ambasadorit jugosllav në Moskë, i cili me presione armiqësore kërkoi nga ministri ynë t'i tregonte çfarë marrëveshjesh ekonomike kishte nënshkruar Nako Spiru kur shkoi në Moskë. Shoku Nako Spiru jo vetëm nuk nënshkroi atje asnjë marrëveshje, por nuk u takua me asnjë personalitet sovjetik, përveçse me njerëzit e VOKS-it¹.

Forcimi i lidhjeve të vendit tonë me Bashkimin Sovjetik i preokuponte jashtëzakonisht udhëheqësit trockistë jugosllavë. Pas kthimit të delegacionit tonë qeveritar nga Moska, Kosmerli² i deklaroi zyrtarisht shokut Hysni Kapo se «pas kthimit të Gjeneral Hoxhës nga Moska ka ndryshuar politika e qeverisë shqiptare ndaj Jugosllavisë». Këto janë vepra të hapëta armiqësore, antishqiptare dhe antisovjetike, që nuk duan shpjegime të gjata për t'i bërë të qarta. Për ata qeveria jonë dhe në krye Sekretari i Përgjithshëm i Partisë dhe Kryeministër i Republikës Popullore të Shqipërisë bënë një politikë antijugosllave. Këtë e thanë gjithashtu edhe në akuzat e tyre më vonë.

Kritikën lidhur me krijimin e «frontit antijugosllav

1 VOKS — (Vsjesojuznoje Obshestvo Kulturnoj Svjazi s Zagranicjejj) — Shoqëria për marrëdhënjet kulturalë të BRSS me vendet e huaja.

2 Drago Kosmerl, këshilltar i legatës jugosllave në Tiranë.

në Shqipëri», Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe vegla e tij Savo Zllatiç e mbështetën me shpifjet kundër njerëzve tanë në hekurudhë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë e kishte ngritur këtë çështje edhe më parë, po ne i kishim hedhur poshtë shpifjet e tyre. Të gjitha ato ne i gjetëm krejtësisht të pathemelta dhe këtë e vërtetuam. Partia ka raportin e Komisionit të Kontrollit, ka raportet e organizatave të Partisë në hekurudhë që vërtetojnë se akuzat jugosllave jo vetëm ishin false, por në to del një gjë shumë e madhe dhe e vërtetë, që jugosllavët kanë qenë sabotatorë, provokatorë, armiq të pushtetit tonë, të rinisë sonë, të Partisë sonë. Shokët e Partisë dhe ata të organizatës së rinisë sonë në hekurudhë janë treguar nga njerëzit më besnikë dhe vigjilentë për të ruajtur punën dhe djersën e popullit tonë dhe të Partisë, janë treguar njerëz të pjekur për moshën e tyre të re.

Duke ngritur çështje të tilla, jugosllavët kishin qëllime të shumta. Çështja ishte të godisnin hovin e rinisë dhe të udhëheqsave të saj, ta lidhnin këtë çështje veçanërisht me persona si Nako Spiru dhe indirekt me Kryeministrin, të diskreditonin qeverinë për këtë ndërmarrje kaq të madhe. Ata pretendonin se në hekurudhë ishte harruar nga ne dhe nga të rinjtë një çështje politike me rëndësi, aleanca me Jugosllavinë. Në qoftë se ka pasur njerëz që e kanë parë këtë çështje drejt, kemi qenë ne dhe njerëzit e rinisë në hekurudhë, kurse jugosllavët kanë bërë çmos që të armiqësonin rininë, ta shtypnin iniciativën, hovin, entuziazmin dhe zotësinë e saj. Askush nuk mund të pretendojë se s'mund të ngjasin mosmarrëveshje të vogla në një aksion kaq të

madh. Vetëm jugosllavët nuk pranonin asnjë gabim, kurse sabotimet e tyre bënë mu. Asgjë nuk kanë marrë seriozisht jugosllavët në punimet që u ndërmuarën në vendin tonë. Kjo i ka nevrikosur me të drejtë njerëzit tanë, por ata kurrë nuk e kanë humbur durimin dhe masën. Njerëzit tanë e kanë mbrojtur aleancën me Jugosllavinë, prandaj kanë bërë edhe lëshime që nuk mund t'i quajmë oportuniste, por mirëbesim, ose më mirë besim të tepruar.

Me shpifjet që ndërmuarën jugosllavët «për të provuar» se në Shqipëri ishte krijuar një «front kundër Jugosllavisë», nuk do të mundnin dot t'ja mbërrinin plotësisht qëllimit. Kryesore për ta ishte të goditej udhëheqja e Partisë dhe e qeverisë në personin e Enver Hoxhës që ishte përgjegjës përpara Partisë për zbatimin e drejtë të vijës së saj, për koordinimin e punës dhe kontrollin e shokëve në punë. Dhe këtë jugosllavët e bënë.

Politika e qeverisë shqiptare, thanë jugosllavët, është diametralisht në kundërshtim me ndjenjat e popullit. Kjo shqip do të thotë se qeveria është antipopullore dhe për këtë ka disa përgjegjës të dënueshëm, ndër të cilët kryesorë, kuptohet se ishin Kryeministri, mbasandaj Nako Spiru, Mehmet Shehu dhe «gjithë klika» që në bazë të këtyre «akuzave», u dënua nga Plenumi VIII i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Titua në letrën e tij të fundit akuzon drejtpërdrejt Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë për këtë gjë. Por në atë kohë goditja haptas e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë sonë do të ishte shumë e zorshme për jugosllavët, pse s'kishin ku mbështeteshin për një gjë

të tillë. Ata do ta atakonin atë tërthorazi dhe do të korrnin suksese. Nako Spiru ishte më i volitshëm për t'u goditur, jo pse kishte gabuar në qëndrimin ndaj Jugosllavisë, por se kishte grindje në Byro, kishte armiqësi kundër Nako Spirit dhe indirekt kundër Komandantit. Përçarja që ekzistonte në Byronë tonë Politike, përçarje që ata jo vetëm e dinin, por e kishin krijuar vetë dhe i kishin hedhur vazhdimisht zjarr për ta nxitur, krijonte mundësinë për suksesin e manevrës jugosllave. Por edhe kjo nuk mjaftonte për të pasur sukses, duhej të akuzoheshin Nako Spiru e shokë të tjerë dhe indirekt Komandanti me shpifje dhe kërcënime nga më të poshtrat, siç ishte ajo që në veprimtarinë e Partisë sonë «mund të ketë gisht armiku». Kjo donte të thoshte po atë që tha Pandi Kristua me plot gojën në mbledhjen e Komitetit Qendror se «Nako Spiru ishte spiun». Pra, kuptohet vetëvetiu se çfarë situatë u krijua dhe kundër kujt u krijua kjo situatë. Pas vetëvrasjes së shokut Nako, Zllatiçi u thotë shokëve tanë të kenë mendjen, se edhe në Partinë Jugosllave ka pasë gjëra të tilla dhe Sekretari i Përgjithshëm i saj, Gorkiç ka tradhëtuar dhe ka qenë një spiun. Kujt i drejtoheshin këto akuza? Sigurisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë sonë. Shoku Mehmet Shehu ishte vënë po në këto pozita. Kjo situatë e rëndë u krijua prej jugosllavëve me qëllime të caktuara dhe e drejtuar kundër vijës së Partisë sonë dhe kundër njerëzve të caktuar. Ata goditën vijën dhe parimet e drejta që ndiqte dhe nga të cilat frymëzohej Partia jonë.

Udhëheqësit jugosllavë, siç e përmenda edhe më sipër, i kanë bërë Komitetit Qendror të Partisë sonë

edhe një kritikë tjetër, me të cilën pretendonin se në Partinë tonë po konkretizoheshin dy vija, pra, njëra e gabuar. Për këtë vijë të dytë të gabuar, sipas thënjeve të jugosllavëve, e kishte fajin gjithë Komiteti ynë Qendror. Ne e hodhëm poshtë këtë kritikë të parë. Në Byronë Politike kemi qenë të një mendimi, të paktën në formë, pse më vonë u tha se disa shokë të Byrosë në thellësi s'kishin qenë dakord me atë vendim që u muar atje. Dokumenti që i përgatita Zllatiçit si përgjegje, e që më vonë u kritikua ashpër nga disa për mosbesim ndaj jugosllavëve dhe për qëndrim të gabuar, ka qenë nga më të drejtët. Atje vlerësohej drejt situata nga ana jonë, dhe në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, viheshin në dukje të metat tona dhe të jugosllavëve, viheshin në plan të parë dhe të drejtë shmangjet dhe vonesat e jugosllavëve në dërgimin e materialeve, nga të cilët kondicionohej realizimi i planit tonë e shumë gjëra të tjera.

Pas kësaj kritike të parë të jugosllavëve, pse nuk mori zjarr Komiteti ynë Qendror dhe Byroja e tij Politike dhe të zhvilloheshin çështjet si u zhvilluan pas akuzës së dytë? Këtë situatë ne duhet ta analizojmë, sepse ka rëndësi. Kritika e parë e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë ka qenë si me thënë një provë e përgjithshme për ta, për të studjuar efektin dhe forcat tona, si edhe deri ku do të kishin sukses argumentimet e tyre sado pa asnjë bazë. Kjo kritikë s'pati sukses. Byroja jonë i hodhi poshtë këto akuza, pse ishin të pathemelta. Me të tilla akuza ata nuk mundën të krijonin atë gjendje që dëshironin në Byro, sido që në të nuk kishte unitet. Është fakt se ndaj një

akuze të tillë, me gjithë lëkundjet e disa anëtarëve, dëlëm me një vendim unanim. Kjo nuk ju leverdiste jugosllavëve.

Prandaj, në akuzën e dytë jugosllavët plotësuan akuzën e parë me gjëra të reja, ndër të cilat ishte përdorimi i emrave. Në këtë mënyrë do të merrte zjarr Byroja jonë Politike, sikundër që mori. Divergjencat e Byrosë ata i përdorën si armën kryesore që do t'u jepte suksesin në goditjen e vijës së Partisë sonë. Taktika e përdorur prej jugosllavëve kësaj radhe u thoshte hapët Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos se «lufta juaj ndaj Nakos dhe Komandantit është me baza: këtu ka gisht armiku, Nako Spiru luan një rol të çuditshëm, Enver Hoxha e përkrah atë qind për qind, rruga juaj, pra, tani është e hapur, o burra goditni». Orientimi i jugosllavëve dukej hapët: nga një anë akuzohej rëndë një pjesë e shokëve të Byrosë Politike dhe nga ana tjetër inkurajohej pjesa tjetër të hynte në luftë kundër tyre. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo ishin të predispozuar dhe të gatshëm të hynin në këtë qorrrokak, ku na futën jugosllavët. Ata kishin arritur në konkluzionin se «situata ishte aq e nderë, sa që një ditë do të rriheshim në Byro», dhe prisnin që «të na jepej një grusht i rëndë nga jashtë». Grushti, erdhi, pra duhej vepruar. Dhe u veprua në rrugën që dëshironin jugosllavët, në rrugën e gabuar, nga më të gabuarat.

Këtu duhet të ndahen përgjegjësitë e gjithsecilit, pse këtu është rruga kryq, ku u ndeshën pasionet, «parti pris»-të, meritë, gabimet e njërit dhe të tjetrit, u goditën kuadrot kryesorë të Partisë me të drejtë dhe pa të drejtë, u akuzuan për çka kishin bërë dhe për çka

nuk kishin bërë. U godit dhe u trondit çka është më e rëndësishmja vija e Partisë, u lëkund krejt uniteti në Byro, u godit Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, për gjëra që s'kishte bërë dhe jo vetëm që s'kishte bërë, por dhe që nuk i kishte parë aq keq këto gjëra, etj. Fakti është se Koçi Xoxe tok me Pandi Kriston i dhanë tonin analizës së Plenumit VIII. Të tjerë i pasuan dhe të tjerë u influencuan kush më shumë dhe kush më pak prej tyre. Koçi Xoxe me Pandi Kriston dolën në sy të gjithë shokëve, sikur i kishin parë drejt të gjitha gjërat që ngriheshin. Ata, të influencuar shumë nga orientimi i gabuar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, gabuan rëndë. Këta të dy çështjen e shikuan më tepër në lidhje me persona dhe në këtë drejtim ata prapë shikonin gabim dhe jo objektivisht.

Kritika e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë na tronditi të gjithëve dhe në radhë të parë mua. Por e vërteta është se, kur Savo Zllatiçi ekspozonte pikëpamjet e tij, unë isha plotësisht i bindur se ato nuk ishin të drejta. Unë s'isha dakord me ato, bile ndërhyra në mes të ekspozes së Zllatiçit duke i thënë: «Këto që po na thua, janë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe në këto argumentime mbështetet Komiteti Qendror i PKJ»? Savo Zllatiçi m'u përgjegj me ton të egër: «Jo vetëm që të gjitha këto janë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, por ato i ka studjuar dhe aprovuar Titua». Në fund të ekspozesë i kërkova të na i jepte këto me shkrim, përgjegjja e tij në fakt ishte refuzim.

Dispozicioni im, pas ekspozesë së Zllatiçit, ka qenë të mblidhnim edhe ne argumentat tona për t'ju përgjegjur Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Vlerësimi që bënin jugosllavët për Nakon mua më dukej i çuditshëm dhe këtë ja kam shprehur edhe Koçit: «Kjo është një akuzë e rëndë», i kam thënë, Koçit, logjika ta do që t'i ketë bërë më pak përshtypje, pse ai mendonte shumë ndryshe nga unë për Nakon. Pra, dispozicioni im që në fillim ishte që çështjet të shtroheshin në Byro, pasi të mblidhnim edhe ne argumentimet tona. Këtë mendim në dukje e aprovoi edhe Koçi dhe kështu vepruam. Veç e veç ne i vumë në korrent shokët për kritikën e udhëheqjes jugosllave, vumë në korrent edhe Nakon, pa ja thënë akuzën e rëndë direkte që i bënin atij jugosllavët. Ky qëndrim i fundit ndaj shokut Nako, më duket se nuk ka qenë i drejtë nga ana jonë. Nakos ne duhej t'ja thoshim të gjitha. Unë kam qenë kurdoherë i mendimit që çështjet e brendshme në Byro të zgjidheshin drejt. Kundërshtimet e Koçit dhe të Pandit me Nakon kanë qenë një sëmundje e vjetër, që ishte shtuar shumë (sikundër-që ekspozova edhe më lart), saqë çdo veprim timin ata e shihnin si të diktuar dhe të influencuar nga Nakua. Ky s'ishte një gjykim i drejtë.

Është e vërtetë që në mbledhjen e Byrosë Politike ne vumë në rendin e ditës, në radhë të parë, çështjen e kritikës që na bëhej nga jugosllavët, sidomos në fushën ekonomike. Por mbledhja e Byrosë për një problem me kaq rëndësi u bë me shumë gabime. Në të nuk u thirrën anëtarë dhe kandidatë të saj, bile nuk u thirrën as ata shokë që akuzoheshin pa të drejtë dhe që do të kritiko-

heshin në këtë mbledhje. Çështja e Nakos në Byro nuk u shtrua ashtu si qe menduar dhe vënë në rendin e ditës të mbledhjes. Këtë procedurë e kemi quajtur të drejtë, ndërsa kërkesën e Nakos që, kur mori vesh akuzën e rëndë që i bëhej, kërkonte leje të përgatitej, ne e kemi quajtur të padrejtë dhe sikur bëhej prej tij me qëllime të errëta, etj.

Por le ta gjykojmë në dritën e sotme atë situatë. Nakua akuzohej nga jugosllavët se kishte lidhje me armikun. E vogël ishte një gjë e tillë? Ne i lamë një ditë Nako Spirut të mendohej dhe të përgatitej. Kjo s'ishte aspak e drejtë, mbasi çështja s'ishte e thjeshtë. Ka gjashtë muaj që ne po punojmë për këtë analizë dhe vetëm tani mundëm t'i shtrojmë këto çështje të mëdha në Parti. Ne nuk i dhamë Nakos 5 ditë të mendohej, të përgatitej, të shpjegohej. Edhe një kriminel i lihet kohë të mendohet dhe jo një shoku si Nako Spiru. Me të kërkuar Nakua lejë, shokë të Byrosë Politike, si Koçi, Pandi, etj., u ngritën kundër tij në mënyrë të ashpër, armiqësore. Në atë moment ne duhet të njihnim gabimin tonë, diskutimi nuk u përqëndrua në ato çështje ekonomike, ku gjoja bazohej në sipërfaqe kritika jugosllave. Kjo u harrua fare, u la mënjanë dhe mbi-sundoi lufta kundër Nakos. Problemi u spostua atje ku e kishin qëllimin jugosllavët dhe ku ishin të predispozuar Koçi Xoxe me Pandi Kriston. Shoku Nako Spiru, sigurisht duke menduar se nga një situatë e tillë nuk kishte dalje tjetër për të, vrau veten. Ky ishte gabimi më i madh që ka bërë Nakua në jetën e tij revolucionare, por këtu ka përgjegjësi dhe gabime edhe Byroja Politike. Nako Spiru nuk mendoj si komunist i fortë,

megjithëse situatat ishin shumë të rënda për të. Sado e rëndë që të jetë situata për një komunist, ai nuk duhet ta vrasë veten kurrë, por t'i përballojë këto situata, të pranojë kritikën dhe dënimin në rast se është fajtor dhe të ketë kurdoherë besim te drejtësia e Partisë.

Vetëvrasja e Nakos ndihmoi të pranohej qind për qind akuza e poshtër e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Pas vetëvrasjes së Nakos u krijua një atmosferë e tillë që çështjet të zhvilloheshin ashtu sikundër u zhvilluan. Kritika e jugosllavëve u pranua padiskutim. Jo vetëm kaq, por përpjekjet dhe pikëpamjet e drejta të miat, të Nakos dhe të shokëve të tjerë, u kthyen të gjitha kundër nesh dhe u shfrytëzuan për të vënë në dukje mosbesimin tonë ndaj «vijës së drejtë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë». Tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit, përgjegjja ime Savo Zllatiçit për kritikën e tyre të parë, të gjitha këto u studjuan dhe u përdorën për të treguar se mosbesimi ndaj Jugosllavisë ka ekzistuar te unë dhe te Nakua që prej kohe. Veprimet e rinisë në hekurudhë u dënuan si vepra armiqësore kundër jugosllavëve dhe kundër vijës së Partisë sonë dhe u hodhën kryesisht në kurrizin e Nakos. U hodhën poshtë të gjitha raportet e Komisionit të Kontrollit dhe të shokëve të Partisë në hekurudhë, si pa gjë të keqe. Gjërat që sot vërtetojnë saktësinë e pikëpamjeve të drejta të njerëzve tanë në hekurudhë, atëhere u mblodhën me imtësi për të vërtetuar të kundërtën, në drejtimin që u interesonte jugosllavëve. Nakua hyri në radhën e spiunit dhe të tradhëtarit të Partisë. Çështja e tij u gjykua përfundimisht.

Shoku Mehmet Shehu gjithashtu u akuzua «si njeri që kishte bërë një politikë tipike personale, që e kishte drejtuar ushtrinë në shkëputje nga Jugosllavia dhe dëshironte ta zhvillonte atë në mënyrë të pavarur», «planet e Mehmet Shehut në ushtri ishin jashtëzakonisht të fryra dhe puqeshin me planin pesëvjeçar të Nakos, Mehmet Shehu ishte kundër jugosllavëve, Mehmeti puqej, pra, me Nakon», pra edhe ai futej në listën e «armiqve».

Po çështja e sovjetikëve si shpjegohej në këtë mes? Hapët nuk u atakuan ata, por e gjithë kjo punë ishte njëkohësisht antisovjetike. «Sovjetikët u gabuan, u orientuan keq, u gënjyen nga Nakua dhe të tjerët». «Sovjetikët janë me dorë në zemër, thuhej, e hapën zemrën dhe kështu kishin vepruar, dhe armiqtë si Nakua përfituan nga kjo cilësi e sovjetikëve». Këto gjëra me dashje ose padashje ishin një goditje për sovjetikët. Të tilla pikëpamje mbizotëruan gjatë gjithë analizës. U arrit saqë edhe pikëpamjet e drejta prosovjetike të Nakos, Mehmetit, etj., dhe punën e madhe dhe të drejtë në këtë drejtim të paraqiteshin në një aspekt krejt të shtrembër dhe jo objektiv.

Po çështja e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë si u shtrua? Dihet fare mirë se në ç'pozita të këqia dhe të padrejta u vu ai. Sekretari i Përgjithshëm u atakua ashpër dhe në radhë të parë nga Koçi dhe nga Pandi. Patjetër ai s'u cilësua si Nakua dhe as si të tjerët, por fajtori kryesor dilte ai, pasi të gjithë ata që u dënuan, vepronin nën mbrojtjen e tij, përdornin me vend dhe pa vend autoritetin e tij. Për përçarjen që ekzistonte në Byro, shkaktar kryesor në analizë dilte Nakua, por

Komandanti, «duke qenë i influencuar prej tij», ka qenë dhe ai fajtor i madh dhe shkaktar i krijimit të një situatë të tillë. Ky ishte qëllimi që deshën të arrinin jugosllavët dhe këtij qëllimi ata ja arritën.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo shkuan nga gabimi në gabim. Koçi ngrii çështjen e një grupi të rrezikshëm me të gjitha tiparet e një fraksioni në kokën e Partisë. Në analizën e Plenumit VIII për të gjithë shokët u krijua përshtypja se Partinë e shpëtoi nga ky fraksion i rrezikshëm Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo që i kishin parë «drejt» të gjitha këto çështje më parë, kurse të tjerët, me Komandantin në krye, kishin gabuar rëndë. Pas Plenumit VIII doli rezolucioni dhe çështjet u shtruan në Parti, gati si u shtruan në Komitetin Qendror të Partisë, me një përjashtim të vogël, që Sekretari i Përgjithshëm nuk u zu në gojë. Por efekti me dashje, pa dashje, u arrit atje ku qëllonin jugosllavët. Për trockistët jugosllavë kjo ka qenë zgjidhja më e kënaqshme, ndërsa për Partinë tonë ka qenë zgjidhja më e shtrembër e më e rrezikshme. Prandaj, është urgjente që këto gabime të mëdha t'i korrigjojmë, t'i vëmë drejt çështjet me drejtësinë e vërtetë që karakterizon Partinë tonë, të mos kemi frikë dhe ndrojtje nga Partia për të dalë përpara saj me një autokritikë të shëndoshë bolshevike dhe nga këto gabime ne të mësojmë shumë, të mësojë edhe Partia nga gabimet e udhëheqjes së saj, që të mos gabojmë në të ardhshmen.

Cilat janë konkluzionet që duhet të nxjerrim ne nga ky vlerësim i ri që i bëjmë analizës së vjetër të Plenumit VIII dhe Rezolucionit të tij?

Analiza e Plenumit VIII, e nxitur nga jugosllavët

me qëllime armiqësore, antiparti, antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike, nuk mund të ishte një analizë e drejtë, marksiste-leniniste. Ajo ishte e gabuar, prandaj edhe rezolucioni, që doli si rrjedhim i saj, nuk mund të jetë veçse i gabuar. Analiza dhe Rezolucioni i Plenumit VIII e çonin Partinë tonë në pozita antimarksiste dhe në rrugën e solidarizimit me grupin trockist të Titos. Puna që u bë në këtë plenum dhe vendimet që dolën prej tij kanë dëmtuar rëndë Partinë tonë, pse kanë goditur vijën e drejtë të saj, kanë goditur unitetin e udhëheqjes sonë, kanë goditur, dënuar dhe diskredituar ashpër shokë udhëheqës për gabime që ata nuk kanë bërë, kanë goditur pa kurrfarë baze Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, kanë tronditur pozitën e tij në sy të anëtarëve të Komitetit Qendror e të Partisë. Një gjë e tillë ka dëmtuar rëndë unitetin e udhëheqjes dhe autoritetin e saj.

Analiza dhe Rezolucioni i Plenumit VIII goditën centralizmin demokratik, demokracinë e brendshme të Partisë, mbytën kritikën dhe autokritikën, futën metoda ushtarake në udhëheqje, shkelën parimet organizative të Partisë, forcuan kontrollin e organeve të Sigurimit të Shtetit mbi Partinë dhe e shtynin shtetin tonë në rrugën e një shteti policor.

Analiza dhe Rezolucioni i Plenumit VIII krijuan në Parti një psikozë jomarksiste në drejtim të intelektualëve komunistë, që shiheshin si të dyshimtë, gjë që e bënte Partinë të orientohet në politikën e kuadrit në rrugë sektare.

Analiza dhe Rezolucioni i Plenumit VIII ishin një fitore për trockistët jugosllavë, pse e bënë Komitetin

tonë Qendror të bjerë në pozita të gabuara e të pranojë forma organizimi ekonomik që çonin në likuidimin e qeverisë sonë, në forcimin e kolonizimit të vendit tonë nga trockistët jugosllavë.

Vija e Partisë sonë ka qenë e drejtë, orientimi i saj ka qenë i drejtë. Në asnjë moment ne nuk kemi gabuar në lidhje me miqësinë dhe aleancën me Jugosllavinë. Marrëdhënjet ekonomike me Jugosllavinë i kemi parë drejt, bile kemi pasur besim të madh, të tepruar. Kritikat nga ana jonë për punën që zhvillonin jugosllavët në Shqipëri kanë qenë të drejta dhe me vend. Këtu e kam fjalën për akuzat që na bënë jugosllavët, pse gabimi i ndonjë të riu në hekurudhë, nuk mund të vërtetojë aspak se Komiteti ynë Qendror ka pasur një vijë të shtrembër.

Të gjitha akuzat e jugosllavëve bien dhe nuk janë përveç se shpifje të trilluara për qëllime të caktuara, të cilat i treguam më lart. Akuzat kundër shokëve Nako Spiru, Mehmet Shehu e shokëve të tjerë, se gjoja ata kishin dëmtuar vijën e Partisë në lidhje me Jugosllavinë, bien të gjitha. Këta shokë në këtë drejtim nuk kanë gabuar në vijë, përkundrazi kanë qenë në vijë të drejtë dhe kanë luftuar për këtë vijë të drejtë.

Çështja e shokut Nako Spiru. Shoku Nako Spiru s'ka qenë as spiun, as tradhëtar i Partisë, kjo nuk vërtetohej në asnjë mënyrë. Çështja e ngritur kundër tij, qe një shpifje e poshtër e jugosllavëve. Shoku Nako ka anët e tij pozitive dhe negative, si revolucionar, si anëtar partie dhe si udhëheqës i Partisë. Nakua ka luftuar për Partinë dhe për popullin që nga krijimi i Partisë deri sa u vra, ai nuk është lëkundur asnjëherë në luftë. Por

në punën e tij janë vërtetuar edhe gabime, të cilat duhen përcaktuar mirë. Nako Spiru ka qenë një shok me një ambicie të sëmurë dhe patjetër një e metë e tillë të një udhëheqës dëmton rëndë punën. Mund të korrigjohet Nakua nga një e metë e tillë e rrezikshme? Ne mendojmë se po. Partia jonë rrëzon male dhe jo të mos ndreqë njerëzit që kanë të meta dhe që bëjnë gabime. Po a u bënë përpjekjet e duhura për ta ndihmuar shokun Nako ta korrigjonte këtë të metë që do të influente në gabimet e tij? Në themi se nuk u bënë, përkundrazi të gjitha rrethanat e krijuara e nxitën dhe e forcuan këtë të metë të tij. Nakua e zhvilloi veprimtarinë e tij në rrethana të sëmura dhe këto rrethana ne duhet t'i marrim parasysh për të gjykuar të metat dhe gabimet e tij. Ambicien e sëmurë të Nakos e zhvilluan jugosllavët për qëllimet e tyre, e zhvilloi Plenumi i Beratit dhe puna pas këtij plenumi, e zhvilloi besimi i madh që ai kishte në aftësitë e tij. Dhe ai gaboi në këtë drejtim, por në këtë drejtim gabuan edhe të tjerë.

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë në asnjë rast nuk e ka lejuar Nakon që ambicien e tij ta përdorte në dëm të Partisë dhe të shokëve. Kur Nako Spiru fliste për kuadrin, lidhur me këtë ai kishte mendimet e tij dhe e sillte çështjen tërthorazi që ky problem nuk mund të zgjidhet me këtë qëndrim që mbante Koçi. Unë i kam luftuar pikëpamjet e tija të gabuara dhe i kam thënë: «Unë nuk lejoj në asnjë mënyrë të përsëritet Berati. Çështja e kuadrit duhet të zgjidhet në mënyrë marksiste dhe me një kritikë e autokritikë të shëndoshë». Mua më duket se shokët e tjerë të Byrosë Politike nuk kanë

qenë objektivë aq sa duhet ndaj Nakos. Nako Spiru nuk ishte i kënaqur për vendin që kishte. Shokët, që e kishin parë këtë tendencë të Nakua, veçanërisht në Plenumin e Beratit dhe pas Beratit, nuk e kritikuan këtë ambicie të sëmurë të tij. Më vonë disa shokë e akuzuan atë se ai u afrua me mua që të zinte vendin e Koçi Xoxes. Ai mund ta ketë pasur një synim të tillë, por unë nuk ja kam ushqyer, përkundrazi kam luftuar çdo nënvleftësim të tij për shokët e tjerë. Mua më duket se shokët e tjerë s'kanë vepruar aq objektivisht në këtë drejtim.

Nakua ka qenë një shok mjaft pesimist dhe nervoz, dy të meta karakteri të rrezikshme për një udhëheqës. Por më e keqja është se Nako Spiru tregojë pesimist më shumë për punën e të tjerëve. Ai i nxinte edhe më tepër gabimet e shokëve. Nako Spiru, siç thamë, kishte një besim të madh në veten dhe në punën e tij, në zotësinë e tij, gjë që shumë herë e çonte në nënvleftësimin e të tjerëve. Ai bënte çmos të vinte në dukje zotësinë e punën e tij personale. Pa ja mohuar zotësinë dhe cilësitë, pse cilësi Nakua kishte, qëndrimi i tij ishte i sëmurë. Dhe të gjitha këto lidheshin me ambicien e tij.

Një gabim i madh i Nako Spirut ka qenë shikimi jo i drejtë i çështjes së rinisë. Nako Spiru ka punuar për forcimin e organizatës së rinisë, por ai që në fillim ka pasur tendencën që puna e rinisë të zhvillohej në mënyrë disi të pavarur nga Partia. Këtë tendencë ja kam goditur disa herë që në kohën e luftës. Këtë tendencë pas Plenumit të Beratit ai e përforcoi dhe ja la trashëgim Liri Belishovës e disa shokëve në udhëheqje të rinisë. Nakua, edhe kur iku nga rinia, punën me rininë

vazhdonte ta shihte si sektorin e tij të punës. Të gjithë udhëheqësit duhet të interesohen për rininë, këtë nuk e kundërshton asnjëri, por Nakua në këtë çështje s'ishte në rrugë të shëndoshë. E dimë ç'është rinia për Partinë tonë, por Nako Spiru këtë çështje nuk e shihte nga pozitë e Partisë, por nga pozita personale dhe arrinte shumë herë t'ua kundërvinte kuadrot e rinisë atyre të Partisë dhe të bënte krahasime aspak të drejta në mes organizatës së rinisë dhe Partisë. Edhe çështjen e kuadrit të rinisë Nakua nuk e shihte me sy të shëndoshë, nga pozitë e Partisë. Nakua e konsideronte rininë si një ushtri të tij, në kuptimin që atje ai i kishte pozitë e forta dhe mund të fliste nga ajo platformë. Kjo ishte një pikëpamje e gabuar e Nako Spirit.

Të qëndrosh në pozitë e vjetra dhe të thuash se Nako Spiru ishte kundër klasës punëtore, kjo do të jetë gabim. Shoku Nako nuk ishte kundër klasës punëtore. Ai kishte gabime në orientimin e tij për çështjen e kuadrit. Nakua kishte preferencë për intelektualët, për njerëzit e mësuar, të cilët i përkrahte më shumë. Por ai nuk ka përkrahur intelektualët sabotatorë, siç e akuzuan jugosllavët, dhe siç u formua opinioni në kohën e analizës së Plenumit VIII. Kjo s'është e drejtë të thuhet. Mund të ketë raste që Nakua i ka nënvleftësuar shokët punëtorë dhe mund të nxirren edhe konkluzione nga një qëndrim i tillë, por në kohën e analizës në Plenumin VIII të KQ u thanë shumë gjëra të mbledhura në mënyrë të shkëputur dhe u arrit në konkluzionin e gabuar se Nako Spiru ka qenë armik i klasës punëtore. Kushi është armik i klasës punëtore, ai është armik i Partisë sonë, i popullit tonë, i marksizëm-leninizmit.

Byroja jonë Politike ka bërë mbledhje të panumërta për çështjen e kuadrit, atje është diskutuar mbarë e pra-pë për njerëzit, janë bërë kritika për shokët, por asnjëherë nuk i ka shkuar njeriut ndër mend që të akuzojë Nako Spirun se ai ka qenë kundër klasës punëtore dhe që të kritikohet rëndë për këtë devijim. Kjo s'ka ngjarë. Është fakt se në mbledhjet e Byrosë, as Nako Spiru dhe as Koçi Xoxe s'i përtypnin fjalët kundër njëri-tjetrit. Konkluzioni se Nako Spiru ka qenë kundër klasës punëtore u arrit vetëm në analizën që u bë në Plenumin VIII. Dhe një konkluzion i tillë nuk është i drejtë.

Nakua pas Plenumit të Beratit ka bërë gabime në udhëheqje, gjë që ka dëmtuar unitetin e Byrosë. Por përsëri këtë punë të gabuar dhe të dëmshme të Nakos, duhet ta marrim brenda situatave të sëmura dhe gabimeve të tjera që janë vërtetuar në Partinë tonë pas Plenumit të Beratit, ne duhet të marrim parasysh edhe gabimet e shokëve të tjerë, dispozicionin e tyre, të marrim parasysh intrigat dhe punën e madhe armiqësore të jugosllavëve. Po i muarëm gabimet e Nakos të shkëputura nga këto gjëra, ne do ta dënojmë atë pa të drejtë.

Shoku Nako Spiru e donte dhe kishte besim të madh te Bashkimi Sovjetik. Thënjet e disa shokëve se ai gjoja ka pas thënë se «në Bashkimin Sovjetik ka parë njerëz që shetisnin zbathur, ose se i dehën në kolkoz për të mos parë gjëkafshë, etj.», mund t'i ketë thënë dhe s'ka bërë mirë, por ato nuk mund të vërtetojnë se Nakua ishte antisovjetik. Ka të tjera aktivitete më të mëdha që tregojnë se Nako Spiru ka qenë një mik i Bashkimit Sovjetik.

Nakua ka pasur një animozitet të tepruar dhe të

dëmshëm ndaj Koçi Xoxes dhe punës së tij. Po kjo gjë ka ekzistuar edhe nga ana e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos në drejtim të Nakos. Të dy anët gaboheshin. Asnjëra anë nuk i lëshonte anës tjetër dhe kjo ishte e dëmshme për Partinë. Çështjet duheshin sqaruar drejt me një kritikë të shëndoshë dhe autokritikë bolshevike nga të dy palët. Por kjo s'u bë. Për këtë, nga ana e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos jam ngarkuar edhe unë me faje të mëdha. Po ku del influencimi im i gabuar prej Nakos dhe ku janë gabimet e mia të mëdha? Kjo çështje meriton një sqarim të vogël.

Pikëpamjet e mia për çështjen e kuadrit s'kanë qenë të gabuara, unë asnjëherë s'jam influencuar nga gabimet e Nakos. Pikëpamjet e mia për rininë gjithashtu s'kanë qenë të gabuara dhe kurrë s'jam influencuar nga gabimet e Nakos. Kurrë s'kam lejuar, përkundrazi kam kritikuar ambicien e Nakos, punën e tij personale, arrogancat dhe lëshimet e tij dhe të shokëve të tjerë, kurdoherë kur kam qenë në dijeni të këtyre të metave. Unë e çmoja dhe e ndihmoja Nakon në punë, sikundër që ndihmoja edhe të tjerët. Nakua vinte shpesh te unë dhe kjo s'më prishte asnjë punë, përkundrazi më mbante në korrent të çështjeve, ai më pyeste dhe merrte këshillën time. Vetëm Nakua më mërziste pa masë me pesimizmin dhe me mënyrën se si e shikonte ai çështjen e kuadrit. Për çështjen e kuadrit unë kisha pikëpamjet e mia dhe më duket se ato s'kanë qenë të gabuara. Nakua nuk pranonte si duhej pikëpamjen time lidhur me propozimet për zgjidhjen e çështjes së kuadrit dhe korrigjimin e gabimeve që kishte. Këtu kishte «parti-pris» nga ana e tij, por nga ana ime s'ka pasur as influencime dhe as

gabime të mëdha, kurse gabime të vogla patjetër ka pasur.

Koçi Xoxe është përgjegjës kryesor për gabimet organizative që janë vërtetuar në Partinë tonë. Ashtu si vepronte ai, me dyshimet që kishte, me meritë që ekzistonin në mes shokëve të Byrosë, me nënçmimin e rolit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, çështjet e mëdha organizative të Partisë i shpëtonin kontrollit dhe ndihmës së Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror. Raportet që paraqiteshin rrallë prej Koçi Xoxes ishin fare formale dhe thjesht informative. Monopolizimi i punës në duart e sekretarit organizativ dhe eliminimi i rolit të vërtetë të Sekretarit të Përgjithshëm ishte një dëm i madh për Partinë dhe një gabim i rëndë i Koçi Xoxes. Në Parti u krijuan pikëpamje të gabuara e të rrezikshme sikur Partia kishte dy udhëheqës: Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen, se i pari drejtonte shtetin dhe i dyti Partinë. Ky ishte një koncept krejt i gabuar që s'ka të bëjë aspak me ndërtimin e Partisë sonë. Nga këto pikëpamje rrodhën pastaj shumë gabime, siç është mosdhënja llogari, që do të thotë shkelje e centralizmit demokratik, shkelje e demokracisë së brendshme të Partisë, shkelje dhe mbytje e kritikës dhe e autokritikës. Nga këto erdhi shkelja e parimit të udhëheqjes kolegjiale, që vendoset vetëm në bazë të kritikës e të autokritikës dhe të luftës së kontradiktave. Stalini na mëson:

«Të mendosh se mund t'u shpëtosh këtyre kontradiktave, do të thotë të gënjesh vetëveten. Engelsi kishte të drejtë kur thoshte se kontra-

diktat brenda partisë nuk mund të fshihen për një kohë të gjatë, se këto kontradikta zgjidhen me luftë».¹

Stalini vazhdon:

«...burimet e kontradiktave brenda partive proletare janë dy rrethana...

Së pari, presioni i borgjezisë dhe i ideologjisë borgjeze...

Së dyti, përbërja heterogjene e klasës punëtore...»²

Koçi Xoxe pra, këtë parim të madh s'e mbante parasysht dhe gabonte në këtë drejtim. Kontradiktat dhe përpjekjet në udhëheqje ai i merrte në planin personal si kritika kundër personit dhe punës së tij, për të cilën ai kishte mendimin se ka qenë e pagabuar dhe e pakritikueshme. Dhe këtu ka pasur te Koçi Xoxe një dozë egoizmi dhe mendjemadhësie.

Duke i gjykuar kështu çështjet, a e ka merituar shoku Nako Spiru dënimin që i kemi dhënë? Ai e dënoi veten e tij me vetëvrasje dhe kjo e dëmtoi Partinë tonë. Në rast se nuk do të qe ndërhyrja e poshtër, antimarksisiste dhe antishqiptare e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në rast se puna jonë do t'i nënshtrohej një kritike dhe autokritike serioze e bolshevike, ne do të shëroheshim nga sëmundjet që na ki-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 9, f. 12

² J. V. Stalin. Veprat, vëll. 9, f. 9,10

shin pllakosur dhe Nako Spiru do të qëndronte përsëri në mes nesh. Sot, duke e parë dhe duke e analizuar kësh-tu gjendjen, qartë dhe pa «parti-pris». Nako Spirun duhet ta konsiderojmë si një viktimë të intrigave të poshtra që ka luajtur Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave në kurrizin e Partisë sonë, duhet ta konsiderojmë si një viktimë që e dënoi veten me vetë-vrasje, i mposhtur nga qëllimet armiqësore të klikës trockiste të Titos. Dhe ky më duket se është një gjykim i drejtë për shokun Nako Spiru.

Çështja e shokut Mehmet Shehu më duket se është më e thjeshtë se e Nako Spirit. Ai akuzohej për pikë-pamje të gabuara në lidhje me çështjet e ushtrisë, për plane të fryra, për shkëputje nga Jugosllavia dhe këndej delte se Mehmet Shehu ishte i lidhur me Nakon për të goditur dhe shtrembëruar vijën e Partisë, etj. Këto s'qëndrojnë aspak në këmbë. Këto akuza nuk janë përveçse pranimi në blok i tezave antimarksiste jugosllave, që drejtoheshin kundër ushtrisë sonë dhe kundër ushtrisë sovjetike e këshilltarëve sovjetikë në Shqipëri. Ato kishin për qëllim të godisnin orientimin e drejtë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë në çështjet ushtarake dhe të unifikonin ushtrinë tonë me atë jugosllave. Për jugosllavët Mehmet Shehu nuk jepte asnjë siguri për zbatimin e vijës së tyre, prandaj me kohë ata kishin pregatitur fushën për ta goditur. Çështja e mosmarrëveshjeve të tij me Drejtorinë politike, etj., është rrjedhim i politikës armiqësore të jugosllavëve. Këtu nuk përjashtohen të metat që mund të ekzistojnë, por gjëja më e rrezikshme ishte se Drejtoria politike, me Kristo Themelkon dhe me Pë-

llumb Dishnicën, ishte nën influencën direkte të jugosllavëve.

Nuk përjashtohet mundësia që edhe disa shokë në Shtatmadhori të jenë influencuar në punë nga pikëpamjet e Drejtorisë politike dhe në qëndrimin e tyre ndaj Mehmetit. Është akuzuar Mehmeti për mungesë bashkëpunimi në Shtatmadhori, për monopolizim pune, etj. Nuk përjashtohet që në ato situata të ketë pasur ndonjë shfaqje të tillë, por jo në atë shkallë dhe në atë frymë që u ngritën në analizën e Plenumit VIII. Shoku Mehmet Shehu nuk meritonte as akuzat dhe as dënimin që ju dha. Këto s'ishin me vend. Shoku Mehmet është një shok që kërkon llogari dhe, ata që bënin llafe e thurnin intriga, e quajtën këtë monopolizim pune. Mehmet Shehu është një shok që ka luftuar. Këtë e themi, sepse në analizën e Plenumit VIII u bënë përpjekje që edhe kjo anë shumë pozitive e tij të errësohej. Mehmeti ka aftësi ushtarake, ai ka dhënë kontribut të çmueshëm në luftë, si dhe në organizimin e modernizimin e ushtrisë sonë. Shoku Mehmet Shehu e ka mbrojtur si vijën e përgjithshme të Partisë, ashtu edhe vijën tonë të drejtë në ushtri, me vendosmërinë e një antari të denjë të Komitetit Qendror. Unë dëshiroj dhe kjo është rruga e drejtë që të njihen mirë anët pozitive të shokut Mehmet, kurse të metat në punë të vlerësohen drejt, duke mos i shkëputur nga rrethanat e gabimet e shokëve të tjerë. Një veprim i kundërt nuk është objektiv dhe të çon në konkluzione të gabuara.

Çështja e kuadrove të tjerë më të ulët, që u bënë objekt i goditjeve nga analiza e Plenumit VIII, duhet të shihet nën këtë prizëm, me këto pikëpamje të drejta

dhe të korrigjohen masat e marurra kundër tyre, duke i rehabilituar këta shokë dhe duke i caktuar në vende të përshtatshme për ta.

ÇESHTJA E «FRAKSIONIT NË KOKË TË PARTISË».

Nuk ka pasur fraksion në kokën e Partisë. Këtë përcaktim, që nuk është i drejtë, e bëri Koçi Xoxe. Analiza që po bëjmë e rrëzon këtë tezë të gabuar. Praktika e gjërave nuk e vërteton aspak përkufizimin teorik të fraksionit. Fraksioni është diçka e organizuar, me qëllime të caktuara politike dhe organizative antiparti, kundër vijës politike dhe organizative që ka vendosur Kongresi i Partisë dhe Komiteti Qendror. Një fraksion i organizuar brenda në parti do të thotë organizim i një lufte ideologjike të mbështetur me vepra kundër parimeve marksiste-leniniste, që përbëjnë themelet e Partisë sonë dhe nga të cilat ajo drejtohet. Ky organizim dhe këto qëllime nuk kanë ekzistuar.

Është e drejtë të thuhet se Nako Spiru ka pasur gabime në punën e tij, por këto gabime mund të degjeneronin në një punë antiparti dhe fraksioniste, në rast se i linim të trasheshin. Kjo mund të ngjasë kur Partia nuk i sheh, i mbulon dhe nuk i korrigjon gabimet që bën ky ose ai njeri, cilido qoftë. Po që se këto gabime i quajmë fraksion në kokën e Partisë, ç'ëmër mund t'u vëmë gabimeve të mëdha të bëra në analizën e Plenumit VIII që mund të çonin në fraksionin më të rrezikshëm që do të kishte parë Partia jonë dhe që do ta çonte atë dhe popullin tonë në greminë, sikundër po e çojnë Ju-

gosllavinë Titua, Gjilasi, Kardeli, Rankoviçi dhe të tjerë? Në analizën e Plenumit VIII të KQ ka pasur gabime parimore, u godit uniteti i Partisë, u goditën vija dhe orientimet e drejta të Partisë, u godit uniteti i kampit të socializmit, u godit Bashkimi Sovjetik. Dhe këto ishin shumë fort të organizuara dhe bile nën orientimin e drejtëpërdrejtë të klikës trockiste të Beogradit. S'i lejohej Partisë të mos bëjë një krahasim të këtyre dy situatave dhe këtë krahasim Komiteti Qendror do ta bëjë, sepse ka një rëndësi të madhe, siç kanë një përgjegjësi të madhe njerëzit që përgatitën Plenumin VIII.

Po t'i kuptojmë drejt këto situata, t'i ndiejmë thellë gabimet dhe t'i njohim me plot ndërgjegje ato, ne themi se Partia jonë do të forcohet shumë dhe do të shpëtojë nga rreziqet e ardhshme. Në rast se nuk kuptohen drejt të gjitha këto, ne themi se Partia do të vuajë në të ardhshmen dhe do të ketë rreziqe për të. Këto çështje të mëdha të Partisë duhet të shikohen nga pozitat e Partisë dhe jo nga pozita personale. Prestigji i personit, i kujtdo qoftë, që nga Sekretari i Përgjithshëm dhe deri te komunisti më i thjeshtë, në asnjë mënyrë nuk mund të vihet mbi prestigjin e Partisë. Në rast se nuk kemi kurajën t'i shtrojmë drejt çështjet përpara Partisë, në rast se nuk kemi kurajën t'i dalim me ballë hapët Partisë për gabimet që kemi bërë dhe t'ja shpjegojmë asaj hapët dhe jo në mënyrë të përciptë këto gabime të hidhura, ne e kemi dëmtuar rëndë Partinë tonë.

Me anën e Rezolucionit të Plenumit VIII i janë thënë Partisë shumë gjëra të padrejta, se ka devijime, se ka pasur fraksion në kolë të Partisë, se Nako Spiru është spiun, etj. Koçi Xoxe, në fjalën që mbajti në dhje-

tor të vitit të kaluar me rastin e hapjes së Shkollës së Partisë, duke bërë fjalë për marrëdhënjet me Jugosllavinë, në mes të tjerash ka thënë: «Këto marrëdhënje që janë mbështetja kryesore për ndërtimin dhe për sigurimin e jetës sonë, që kanë lindur dhe janë forcuar në luftën e përbashkët dhe që sot, më shumë se kurrë interesat e popullit tonë kërkojnë që të bëhen më të forta dhe më të shëndosha, ata (këtu mendohet për njerëzit që do të dënoheshin nga analiza si Nako Spiru etj.), duan t'i paraqesin me një ngjyrë tjetër, me ngjyrën e errët të marrëdhënjeve imperialiste. Të mohosh këto marrëdhënje të drejta dhe t'i shtrosh këto në planin e marrëdhënjeve imperialiste ose të krijosh dyshime dhe mosbesime mbi këto, do të thotë të jesh krejt i dezorientuar, i shkëputur nga vija e Partisë dhe nga marksizëm-leninizmi, ose për rastin tjetër t'i bësh me qëllime të errta prej armiku». Tani duhet t'i njohim sa të gabuara kanë qenë këto pikëpamje të Koçi Xoxes dhe në ç'rrugë të vështirë e çonin ato Partinë tonë. Fjalimi i Koçi Xoxes përgatiti terrenin për një vijë të gabuar antishqiptare, antimarksiste. Gjendja që shtronte ai, s'ishte reale, ajo përgatiste terrenin për Plenumin VIII.

Po në këtë referat Koçi Xoxe, duke vënë përpara Partisë rrezikun që i vinte Partisë nga njerëz si Nako Spiru, thotë: «këta zvogëlojnë rolin që ka në Ballkan dhe në politikën ndërkombëtare Jugosllavia Federative...». Një pikëpamje e tillë të çonte në orientime shumë të gabuara dhe të rrezikshme, antimarksiste e antisovjetike. Duhet ta themi se nga besimi i madh që kishim te Jugosllavia ne bëmë këto gabime. Kjo është e vërteta dhe tani në dritën e kësaj analize të re duket sa

rëndë gaboheshim. Jugosllavët kishin tendenca të theksuara shoviniste e megalomane. Ata kërkonin që rreth Jugosllavisë të lidheshin fort të gjitha vendet e demokracisë popullore të Ballkanit, si dhe vendet e tjera të demokracisë popullore dhe kështu Jugosllavia të bëhej «epiqendra dhe koka» e kampit të socializmit. Kjo donte të thoshte të godisje Bashkimin Sovjetik dhe të shkurojë vendin e parë të socializmit.

Qëllimi i analizës sonë nuk është që t'i themi Partisë se Nako Spiru ose ndonjë tjetër nuk kanë gabuar, ose kanë gabuar për çështje të vogla, që edhe kjo ka rëndësinë e saj. Por rëndësia më e madhe për Partinë tonë qëndron në faktin që nga e gjithë analiza e punës sonë, të nxjerrim konkluzione të drejta që do ta armatosin Partinë për të luftuar në të ardhshmen kundër shfaqjeve të gabuara.

Partia nuk e harron për asnjë sekond rolin udhëheqës të Bashkimit Sovjetik në kampin socialist. Të gjithë trockistët jugosllavë e të tjerë deviatorë të djathtë nacionalistë janë përpjekur jo vetëm ta errësojnë këtë realitet, por ta sulmojnë e ta luftojnë Bashkimin Sovjetik. Qëllimi i këtyre armiqve të socializmit ishte i njëllajtë me atë të imperializmit. Ata deshën të rrënjosnin në partitë e tyre pikëpamjet oportuniste, revizioniste, të likuidonin partinë komuniste të tyre dhe t'i degjenerojnë vendet e demokracisë popullore në demokraci borgjeze. Kjo do të thotë të krijosh terren të favorshëm për kapitalizmin në vendet e reja të demokracisë popullore. të krijosh bloqe armike të socializmit brenda në kampin demokratik antiimperialist. Pra vigjilenca nga ana e Partisë sonë duhet të jetë e madhe në këtë drejtim, për

të mbrojtur marksizëm-leninizmin, ideologjinë e vërtetë të Partisë sonë dhe për të luftuar pamëshirë pikëpamjet borgjeze dhe mikroborgjeze në Parti, për të mbrojtur me këmbëngulje Bashkimin Sovjetik dhe kampin e socializmit.

Tani duhet të kthehemi dhe t'i themi Partisë të vërtetën, të dalim të bindur nga kjo analizë për gabimet e rënda që janë bërë, pse përndryshe nuk mund të bindim asnjëri në Parti, në rast se nuk jemi të bindur vetë. E kundërta do të sjellë rreziqe të mëdha, do të qëndrojmë po në situatat e vjetra të gabuara, do t'u hedhim një cipë të hollë gabimeve, Partia do të çorientohet dhe do të përgatitet terreni për rreziqe të tjera në të ardhshmen, sepse lufta e Partisë sonë nuk mund të mbarojë me kaq. Duhet ta urresh armikun që ta luftosh atë si duhet, është e domosdoshme të njohësh mirë gabimet, që edhe ato të mund t'i luftosh si duhet dhe t'i korrigjosh. Duhet të jemi vigjilentë për gabimet e të tjerëve, por njëkohësisht duhet të kontrollojmë veten tonë, të kontrollojmë gabimet tona dhe t'i korrigjojmë ato. Gabimet në udhëheqje janë nga më të rrezikshmet, pse me shembullin e udhëheqjes rritet Partia dhe me punën e kësaj rritet udhëheqja. Këto janë dy gjëra të pandara dhe të njëjta.

Çështja e luftës së klasave. Partia jonë nuk është influencuar nga deviacioni i madh i Partisë Jugosllave në lidhje me luftën e klasave. Ne nuk kemi gabuar në këtë drejtim, por letrat e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të PKJ janë për ne një mësim i madh, janë një armë e fortë për Partinë tonë që të ruhet nga këto rreziqe. Në letrën e Partisë Bolshevike, drejtuar

Titos me shokë thuhet: «Në Partinë Komuniste Jugosllave nuk ndjehet fryma e politikës së luftës së klasave. Rritja e elementëve kapitalistë në fshat gjithashtu edhe në qytet kryhet me hapa të mëdhenj, kurse udhëheqja e partisë nuk merr masa që të kufizohen elementët kapitalistë. Partinë Komuniste Jugosllave e nanurisin me teorinë oportuniste të kalbur të integritit paqësor të elementëve kapitalistë në socializëm, të huajtur nga Bershtajni, Folmari, Buharini»¹. Partia jonë s'ka bërë lëshime në këtë drejtim, përkundrazi dita-ditës ajo e ka ashpërsuar luftën e klasës si në fshat, edhe në qytet, ajo ka goditur pa mëshirë kulakët, bejlerët latifondistë, tregëtarët e mëdhenj, spekulatorët, fajdexhinjtë e të tjerë dhe nuk ka lejuar as në fshat, as në qytet që këta të ngrenë krye dhe i ka çarmatosur. Megjithatë ekziston kurdoherë rreziku i ringjalljes së tyre, në rast se Partia e dobëson luftën e klasës, pse sikundërqë na mësojnë letrat e Partisë Bolshevike, nuk duhet të nxjerrim një deduksion se nuk ekziston rrezik i forcimit të elementëve kapitalistë. Lenini më 1920 ka thënë:

«Derisa ne rrojmë në një vend me ekonomi të vogla fshatare, për kapitalizmin në Rusi ka një bazë ekonomike më të shëndoshë, se sa për komunizmin.»²

«Sepse... prodhimi i vogël lind kapitalizmin

¹ Letër e KQ të PK (b) të BS, drejtuar KQ të PKJ 27 mars 1948. AQP.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 595.

dhe borgjezinë vazhdimisht, çdo ditë, çdo orë, në mënyrë spontane dhe në shkallë të gjerë»¹.

Partia jonë në asnjë moment nuk duhet të dehet nga sukseset e arritura, nga reformat e thella shoqërore që janë kryer në vendin tonë, nga sukseset që ka arritur në këtë drejtim dhe të neglizhojë luftën e klasave ose ta dobësojë atë. Partia jonë duhet të ketë kurdoherë parasysh atë çka na mëson letra e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në të cilën thuhet:

«Askush nuk e mohon thellësinë dhe karakterin rrënjësor të transformimeve shoqërore që u kryen në BRSS si rezultat i Revolucionit socialist të Tetorit. Por nga ky fakt PK(b) e BS asnjëherë nuk ka nxjerrë konkluzionin mbi dobësimin e luftës së klasave në vendin tonë ose që nuk ekziston rreziku i forcimit të elementëve kapitalistë. . . Dihet se gjatë një kohe prej 15 vjetësh pas Revolucionit të Tetorit nga rendi i ditës i Partisë sonë nuk u hoq çështja në fillim mbi masat për kufizimin e elementëve kapitalistë në fshat dhe, më pas, mbi likuidimin e kulakëve si klasë e fundit kapitaliste. Nën-vleftësimi i kësaj eksperience të PK(b) të BS në çështjen e sigurimit të kushteve themelore për ndërtimin e socializmit në Jugosllavi është i mbarsur me rreziqe të mëdha politike dhe është i palejueshëm për marksistët, sepse nuk mund të ndërtohet socializmi vetëm në qytet,

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 8.

vetëm në industri, ai duhet ndërtuar gjithashtu në fshat, në bujqësi¹.

Sa rreziqe të mëdha mund të na kërcënojnë ne komunistët shqiptarë, në rast se nuk i kemi kurdoherë parasysh këto parime të mëdha të leninizmit, pse Shqipëria është një vend bujqësor, ku mbisundon prona e vogël private e fshatarit, i cili është në një shkallë mjaft të prapambetur dhe ku ekzistojnë mentaliteti i vjetër, injoranca, fanatizmi, etj. Ne duhet të ruhem nga rreziku që mund të na shpjerë në mendimin e gabuar se, meqë kulakët në fshat i kemi zbritur në një shkallë me fshatarin e varfër ose të mesëm në lidhje me tokën dhe me gjendjen ekonomike të tyre, ne kemi zhdukur atë si kulak, si klasë të fundit kapitaliste dhe këndej të harrojmë të bëjmë diferencimin klasor në fshat, ta shohim fshatarësinë si gjë të vetme e të tërë dhe Partia të mos mobilizohet për largimin e vështirësive që rrjedhin nga rritja e elementëve shfrytëzues në fshat. Kulakun në fshatin tonë ne e gjejmë në aktivitet të madh, duke na sabotuar në të gjitha problemet e ekonomisë bujqësore, si edhe në çështje politike. Kulaku përpiqet të mbjellë pakënaqësi në fshat, të futet në pushtet prej nga mund të drejtojë punët sipas qejfit të tij dhe të sabotojë, të futet në organizatat e masave në fshat dhe deri në kooperativat bujqësore të punës.

Kooperativave bujqësore të punës ne duhet t'u bëjmë një rishikim të shumanshëm, sepse në ndërtimin dhe

¹ Letër e KQ të PK (b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

organizimin e tyre janë bërë gabime parimore që shtrembërojnë kuptimin e vërtetë dhe qëllimin që kanë ato në përgjithësi dhe kooperativat bujqësore të punës veçanërisht. Jugosllavët janë përpjekur me ligjet dhe rregulloret e ndryshme që na kanë huajtur, të na çorientojnë në çështjen e fshatit. S'ka asnjë dyshim se gjendja ekonomike e fshatarit tonë është përmirësuar shumë. Por ndërsa nga një anë ne bëmë reformën agrare, që ishte një vepër e pavdekshme e Partisë sonë dhe kulakët i shpronësuam nga parcelat e mëdha të tokës, me ligjet e taksave u lamë mundësi kulakëve dhe një pjese të fshatarësisë së mesme me mentalitet kapitalisti të vogël që të pasurohen, duke mos i detyruar ata asgjë shtetit, duke mos kontribuar në ndërtimin e ekonomisë së përbashkët të popullit. Në ligjin tonë mbi tatimin e ekonomisë bujqësore, vetë tarifa, megjithëse e bazuar në baza progresive, d.m.th. tatim sipas të ardhurave, favorizon fshatarin e pasur dhe godit shtresat e varfëra fshatare. Sipas këtij ligji një ekonomi fshatare që do të kishte të ardhura nga 90 000 deri në 100 000 lekë në vit, do të tatohej me 15 000 lekë plus 43%, kurse një ekonomi tjetër fshatare me të ardhura mbi 100 000 lekë, do të tatohej me 20%. Në ligjin e lartpërmendur, që është nga çdo pikëpamje një ligj në vijën e drejtë, ata na kanë huajtur dhe kanë bërë të depërtojë vetëm në tarifën një gabim i tillë antimarksist që lejon pasurimin e kulakëve, që është karakteristikë e pikëpamjeve antimarksiste të udhëheqjes jugosllave. Këtej dhe në format e tjera të gabuara që përmendëm më lart e kanë burimin vështirësitë ekonomike tonat dhe çka është më e rrezikshme një mungesë e luftës së klasave në fshat do të na dëm-

tonte pamasë. Për të luftuar në këtë drejtim, ne duhet të mos lëkundemi, të vëmë mbi baza të drejta kooperativat bujqësore të punës, të krijojmë sa më shumë kooperativa të shitblerjes, ta mësojmë fshatarin të çojë prodhimet në to dhe ta largojmë nga spekulimi dhe tregu i zi, të godasim spekulatorët në fshat dhe kooperativat bujqësore të punës t'i vëmë në baza të drejta e t'i ndihmojmë shumë që të bëhen model për fshatarët rreth e rrotull.

Duhet të kemi kurdoherë parasysh mësimet e Leninit mbi kooperativat, i cili na mëson se:

«Do të ishte një ide krejt absurde po të mendohej se këto ekonomi mund të transformohen me ndonjë mënyrë të shpejtë, me ndonjë dekret duke influencuar mbi to nga jashtë»¹.

Lenini thotë:

«fshatarët janë njerëz shumë praktikë, tepër të lidhur me ekonominë e vjetër bujqësore dhe nuk pranojnë ndryshime pak a shumë të rëndësishme vetëm në bazë të këshillave dhe udhëzimeve të librave»².

Vladimir Iliçi na mëson se kooperativa e punës duhet të ndihmojë fshatarët rreth e rrotull. Në asnjë mënyrë kooperativa nuk duhet të shkëputet nga populli fshatar, por ta tërheqë këtë duke e ndihmuar konkretisht dhe

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 211.

² Po aty.

duke i treguar me shembuj se jeta në kooperativë përmirësohet nga vetë puna kolektive edhe pa ndihmën financiare të shtetit. Të mos t'i harrojnë komunistët mësimet e Leninit, pse ne në punën me kooperativat kemi nga këto gabime, për të cilat flet Lenini, prandaj të kemi kujdes. Shteti ynë duhet të përdorë drejt kreditë bujqësore, me të cilat të ndihmohen kooperativat bujqësore të punës, fshatarët e varfër dhe pastaj të mesëm. Por Lenini thotë se detyra jonë është që ndihma e shtetit të kuptohet drejt nga fshatarët, pasi

«fshatari është mësuar prej shekujsh e shekujsh të pësojë vetëm shtypje nga ana e pushtetit shtetëror, prandaj ai është mësuar të mos i be-sojë lehtë çdo gjëje që vjen nga shteti».¹

Ne bëmë reformën agrare, atje nuk kemi thënë shprehimisht se toka është e nacionalizuar, por në ligjin e reformës agrare thuhet se askush s'ka të drejtë ta shesë ose ta blejë tokën. Kjo është një çështje parimore, ku do të bazohet kolektivizimi i ardhshëm i bujqësisë. Duhet ta vëmë drejt dhe të mos gabohemi nga pikëpamjet se gjoja fshatari ynë, në kushte të prapambetura dhe «specifike», do ta quajë këtë si të dëmshme për të.

Lenini na mëson gjithashtu se:

«prona private mbi tokën duhet përgjithësisht të likuidohet, domethënë e drejta e pronësisë mbi gjithë tokën duhet t'i takojë vetëm gjithë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 213.

popullit; toka duhet të disponohet nga institucionet demokratike lokale»¹.

Ne duhet të ecim me kujdesin më të madh, sikundër që na këshilloi shoku Stalin kur ishim në Moskë, për çështjen e fshatarësisë, të cilën nuk duhet ta trembim me programin maksimum të Partisë sonë. Duke i zbatuar me përpikmëri këshillat e paçmueshme që na dha shoku Stalin mbi këtë çështje, ne duhet të ecim me hapa të sigurtë dhe të matur në lidhje me fshatarësinë, të njohim mirë kushtet e fshatarit tonë, mentalitetin e tij dhe vija e Partisë sonë të mos lëkundet për asnjë çast nga parimet e marksizëm-leninizmit. Është një punë shumë e vështirë për Partinë tonë puna në fshat, e cila duhet të na bëjë më të fortë për të kapërcyer vështirësitë. Në letrën e Partisë Bolshevike drejtuar KQ të PKJ thuhet:

«Në kushtet kur në Jugosllavi nuk është bërë nacionalizimi i tokës, kur ekziston pronësia private mbi tokën dhe shitblerja e saj, kur në duart e kulakëve janë grumbulluar parcela të konsiderueshme tokash, kur përdoret puna me mëditje, etj., nuk mund të edukohet partia në frymën e shuarjes së luftës së klasave dhe të pajtimit të kontradiktave klasore, pa e çarmatosur kështu partinë përballë vështirësive kryesore të ndërtimit të socializmit»².

Nga këto thënje të rëndësishme të letrave të Par-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 24, f. 533.

² Letër e KQ të PK (b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

tisë Bolshevike ne duhet të nxjerrim mësim për të luftuar me ashpërsinë më të madhe lëshimet ose gabimet që mund të shfaqen. Vendi ynë është një vend bujqësor, fshatarësia te ne përbën pjesën më të madhe të popullit, prandaj këtu duhet të vëmë kujdesin më të madh për të ruajtur qartësinë në çështjen e rolit udhëheqës të klasës punëtore. Letrat e Partisë Bolshevike na mësojnë:

«Marksizëm-leninizmi konsideron në Evropë, duke përfshirë edhe vendet e demokracisë popullore, klasën punëtore dhe jo fshatarësinë si klasën pararojë e deri në fund revolucionare. Përsa i përket fshatarësisë, shumica e saj, d.m.th. të varfërit dhe të mesmit, mund të jenë ose janë tanimë në aleancë me klasën punëtore, ndërsa roli udhëheqës në këtë aleancë i takon klasës punëtore»¹.

Këtu kanë devijuar udhëheqësit jugosllavë. Fshatarët e varfër dhe të mesëm në vendin tonë kanë besimin më të madh te Partia jonë, pse ajo u dha tokën dhe me udhëheqjen e saj të drejtë ua përmirësoi jashtëzakonisht kushtet ekonomike të tyre. Fshatarësia jonë e njuh rolin drejtues të Partisë dhe e do atë. Kjo do të thotë se fshatarësia e varfër dhe e mesme e ka përqaftuar aleancën me klasën punëtore dhe rolin drejtues të kësaj të fundit në këtë aleancë. Por Partisë sonë i vihet detyra e madhe që ta forcojë dita-ditës këtë aleancë. Kjo do të arrihet duke zbatuar me vendosmëri dhe urtësi parimet e mëdha të marksizëm-leninizmit, duke luftuar me ashpërsi

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

kundër teorive të kalbura oportuniste të integritit paqësor të elementëve kapitalistë në socializëm dhe duke mos e parë ndërtimin e socializmit në qytet të shkëputur nga ndërtimi i socializmit në fshat.

Partia dhe organizata e Frontit. Partia jonë ka huajtur mjaft forma nga organizimi i frontit në Jugosllavi, por si fuqi kryesore udhëheqëse e luftës dhe e gjithë jetës së vendit është konsideruar Partia dhe jo Fronti. Trockistët jugosllavë në këtë çështje me kaq rëndësi të madhe kishin devijuar plotësisht. Udhëheqësit jugosllavë, si fuqi kryesore udhëheqëse, kanë konsideruar Frontin Popullor, ndërsa partinë janë përpjekur ta shkrijnë në këtë front, meqë, si thotë Titua me shokë, Partia Komuniste Jugosllave nuk mund të ketë një program tjetër të veçantë nga ai i Frontit Popullor.

Fronti në vendin tonë ka qenë dhe është një organizatë e gjerë e masave që drejtohet nga Partia. Në përcaktimet tona ka dalë kurdoherë e theksuar se Partia është në krye të Frontit, se Partia është kolona vertebrale e Frontit. Masat e gjera të popullit tonë, shumë herë nuk e përmendnin emrin e Frontit, por vetëm emrin e Partisë. Ato thonë: «Këtë e urdhëroi Partia», «Në kohën kur erdhi Partia në fuqi» e të tjera shprehje të tilla. Në këtë drejtim mund të themi se ka qenë neglizhuar roli dhe organizimi i shëndoshë i Frontit. Në Frontin tonë nuk ka pasur parti të tjera përveç Partisë sonë dhe anëtarët e tij nuk kanë qenë të pakontrolluar, bile mund të themi se ne kemi qenë ca sektarë në këtë drejtim. Në Frontin tonë është bërë kurdoherë diferencimi dhe në çdo periudhë janë hedhur jashtë dhe demaskuar njerëzit e reaksionit. Në një moment dhe pi-

kërisht në Mbledhjen e Beratit, me insistimin e delegatit jugosllav, ne futëm në Front disa armiq, që s'e kishin vendin në këtë organizatë. Politika oportuniste e Sejfulla Malëshovës dhe lëshimet tona për një kohë të shkurtër bënë që disa elementë të kamufluar gjatë kohës së luftës, të vazhdonin të qëndronin në Front dhe të zinin poste drejtuese në të. Ata u zbuluan, u demaskuan dhe u qëruan.

Gabimi ynë i madh ishte se, përveç formave organizative që kemi marrë hua nga jugosllavët, ne e mbajtëm në gjysmilegealitet Partinë tonë, duke ndjekur shembullin e gabuar të tyre. Partia jonë, që prej çlirimit të plotë të Shqipërisë, është në fuqi, por ne s'e kemi legalizuar akoma atë. Gjatë kësaj periudhe, me dashje ose pa dashje, ne e kemi fshehur flamurin e Partisë sonë nën maskën e Frontit. Kur e ndjenim thellë dhe drejt rolin drejtues të Partisë, përse ramë në këtë gabim të madh? Pa dyshim, influencimi jugosllav na ka bërë të gabojmë, por Partia jonë e njeh dhe e kupton sa i rëndë qe ky gabim, që na e ndriçojnë letrat e Partisë Bolshevike në të cilat theksohet:

«Lenini ka thënë se Partia është arma më e rëndësishme në duart e klasës punëtore. Detyra e udhëheqësve është ta mbajnë këtë armë në gatishmëri luftarake. Por derisa shokët jugosllavë fshehin flamurin e Partisë dhe refuzojnë të vënë në dukje para popullit rolin udhëheqës të partisë, ata e dobësojnë këtë armë të klasës punëtore, ulin rolin e partisë, çarmatosin klasën punëtore. Është qesharake të mendosh që për shkak të një dredhie të vogël të shokëve jugosllavë, armiku do të

heqë dorë nga lufta. Pikërisht për këtë gjë partia duhet mbajtur në gatishmëri luftarake, për luftën kundër armiqve dhe jo të vihet në gjumë, jo të fshihet flamuri i saj, jo të nanuriset ajo me mendimin që në qoftë se nuk do t'i jepet shkak, armiku do ta pushojë luftën, do të ndalojë organizimin e forcave të veta në formë legale ose ilegale»¹.

Vërtetësinë e madhe të thënjeve të Partisë Bolshe-vike ne mund ta ilustrojmë me shumë veprime tona në jetën e Partisë dhe të Frontit tonë, me mënyrën si i kuptonim ne marrëdhënjet reciproke në mes tyre. Ne kemi pasur kurdoherë frikë se, duke vënë drejt rolin e Partisë në Front, mos frikësonim elementët reaksionarë të kamufluar. Ne jo vetëm që fshihnim anëtarësinë tonë në Parti, po e gjenim të drejtë që disa ministra, anëtarë partie, të panjohur nga masat e gjera të Frontit si të tillë, të vazhdonin të ruanin fshehtësinë e qenjes së tyre si anëtarë partie. Kjo bëhej që të mos i jepej qeverisë sonë ose Kuvendit Popullor fytyra e vërtetë e një qeverie komuniste ose e një kuvendi popullor, ku mbizotëronin komunistët. Ky ishte një gabim nga ana jonë. Ne e bëmë këtë gjoja për t'u dhënë të kuptonin elementëve armiq të kamufluar, që s'ishte nevoja të organizoheshin qoftë legalisht, qoftë ilegalisht, sepse njerëz që s'ishin komunistë, merrnin pjesë në qeveri dhe gjatë. Por me këto ne s'e gënjem e s'e penguem dot elementin reaksionar të organizohej brenda në Front dhe jashtë

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

Frontit. Këtë e tregoi puna armiqësore e disa deputetëve dhe armiqve të tjerë, që ishin kamufluar në Front.

Të gjitha zyrat e Partisë i fshihnim pas zyrave të Frontit dhe anëtari i Partisë e fshihte anëtarësinë në Parti, që është mburrja dhe nderi më i madh i tij, nën maskën e anëtarësisë në Front.

Qortimet e drejta të Partisë Bolshevike që i bëhen udhëheqjes jugosllave për gabimet e saj, janë po aq të vërteta edhe për ne. Në letrën e Partisë Bolshevike thuhet se:

«... Partia Komuniste në Jugosllavi vazhdon të qëndrojë në gjendje gjysmilege, pa marrë parasysh se ajo erdhi në fuqi këtu e tre vjet e gjysmë më parë, se brenda partisë nuk ka demokraci, nuk ka zgjedhje, nuk ka kritikë dhe autokritikë, se KQ i PKJ në shumicën e vet përbëhet jo nga anëtarë të zgjedhur, por të kooptuar»¹.

Po të studjojmë çështjen e funksionimit të Komitetit tonë Qendror, do të shohim po ato gabime, që janë vërtetuar edhe në Partinë Komuniste Jugosllave. Jo vetëm se zgjedhja e Komitetit Qendror nga Konferenca e parë e Vendit e PKSH u bë me shumë të meta, por ne vazhduam të bëjmë një sërë kooptimesh jashtë rregullave të Partisë. Këto kooptime u bënë tamam pas analizave tona jo të drejta në Plenumin II në Berat e në

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

Plenumin VIII të Komitetit Qendror të Partisë. Ato nuk u bënë prej konferencave, por prej Komitetit Qendror. Tani kemi një Komitet Qendror prej 25 vetësh, nga të cilët 16 janë anëtarë dhe 9 kandidatë. Nga këta vetëm 8 anëtarë janë të zgjedhur nga Konferenca e parë e Vëndit e PKSH, kurse gjithë të tjerët, anëtarë dhe kandidatë, që arrijnë shumën 17 veta, janë të kooptuar. Kjo s'është e rregullt dhe e drejtë. Anëtarët e komiteteve të Partisë poshtë dhe sekretarët të gjithë, emëroheshin nga lart. Në Parti, që nga lart e deri poshtë, nuk kishte zgjedhje. Të gjitha mbledhjet dhe konferencat e Partisë bëheshin të fshehta, si në kohën e ilegalitetit më të madh. Vendimet e Partisë nuk publikoheshin, ato u bëheshin të njohura masave të popullit tërthorazi, me anën e Frontit dhe në emër të Frontit. Stalini vetë me gojën e tij motmot më parë, na tha tekstualisht se «nuk mund të kuptohet që një parti që është në pushtet, të mos jetë e legalizuar». Ne akoma nuk e kemi legalizuar Partinë tonë dhe nuk kemi thirrur kongresin e Partisë. Ky është një gabim parimor, që duhet ta ndreqim shpejt, pse këtej e kanë burimin shumë gabime të tjera.

Nga ato që u përmendën më lart del se Partia jonë vuan nga mungesa e demokracisë së brendshme të vërtetë, e kritikës dhe e autokritikës së shëndoshë bolshevike që nga kreu e deri poshtë në celulë. Anëtarët e Partisë kanë frikë të flasin se mos merren me sy të keq.

«Është plotësisht e kuptueshme — thuhet në letrën e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave — që, në një situatë të kështillë në Parti, kur nuk ka zgjedhje të organeve udhëheqëse, por ka vetëm emërimet nga lart, nuk mund të bë-

het fjalë mbi demokracinë brenda partisë... anëtarët e partisë kanë frikë të shfaqin mendimin e tyre, kanë frikë të bëjnë kritikë mbi rregullat në parti dhe preferojnë të heshtin që të mos u nënshtrohen represioneve¹. Ne kemi plot shembuj tipikë që i vërtetojnë këto gjëra të sëmura në Partinë tonë. Analizat që kemi bërë dhe që po bëjmë i vërtetojnë plotësisht kritikën e drejtë të Partisë Bolshevike. Ne kemi shembuj që tregojnë se sekretarë celulash dhe komitetesh partie, për të ruajtur prestigjin personal e për të fshehur gabimet e tyre me autoritetin e Partisë, kanë shpërdoruar autoritetin e tyre, kanë mbytur kritikën dhe autokritikën në këto forume duke shkuar deri atje sa të nxjerrin jashtë nga celula anëtarin e Partisë që ka guxuar të shprehej në kundërshtim me pikëpamjen e tyre. Këto kanë ekzistuar poshtë, në bazë, por këto janë pasqyrim edhe i punës në qendër.

Anëtari i Partisë, apo anëtari i Komitetit Qendror ka secili vendin e vet, të gjithë jemi anëtarë të Partisë, jemi ngarkuar me funksione dhe përgjegjësi të veçanta për t'i shërbyer vetëm Partisë dhe jo njerëzve të veçantë. Të gjithë kemi të drejtë të kritikojmë dhe të kritikohemi, pa asnjë përjashtim. Patjetër kritika duhet të jetë e shëndoshë dhe nuk mund të bëhet në rrugë. Çdo anëtar i Partisë e di ku duhet ta bëjë kritikën dhe atje ai duhet ta bëjë atë me forcë dhe pa asnjë frikë. Askush s'duhet ta presë hidhur kritikën e shëndoshë që i bëhet, përkundrazi, duhet të gëzohet se ajo ka qëllim edukues.

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

Gjithashtu, anëtari i Partisë, kur gabon duhet të bëjë autokritikë bolshevike të hapët, pa pasur frikë dhe pa kujtuar se do të poshtërohet prej kësaj. Përkundrazi, ai që e përdor kritikën dhe autokritikën si duhet, ashtu siç na mësojnë Lenini dhe Stalini, do të shëndoshet, do të përtëritet dhe do të ecë përpara në rrugën e drejtë të Partisë sonë me forca të reja dhe të shumëfishuara.

Nga mungesa e kritikës dhe e autokritikës në udhëheqje dhe në gjithë Partinë ne kemi pasur dëme të mëdha që i kemi paraqitur gjatë këtij referati. Kjo ka dëmtuar unitetin e udhëheqjes, që është me shumë rëndësi për Partinë tonë. Nga këto gabime kanë rrjedhur dhe kanë zënë vend edhe shfaqjet e para të rrezikshme të metodave ushtarake të urrejtshme në Partinë tonë. Veprimet në Plenumin e Beratit, tendencat e vërtetuara në Plenumin VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, qëndrimet e gabuara ndaj Nako Spirut, mosthirrja në mbledhjen e Byrosë ose të Komitetit Qendror e atyre anëtarëve dhe kandidatëve të këtyre forumeve që do të kritikoheshin, për t'u dhënë mundësinë të thoshin fjalën e tyre, të kritikoheshin dhe të kritikonin, të gjitha këto dhe të tjera tregojnë se ne nuk e përdorëm si duhet dhe drejt armën e shëndoshë të Partisë, kritikën dhe autokritikën. Këto janë shfaqje të urreyera të arbitraritetit për Partinë tonë, këto tregojnë se ne kishim lejuar të futeshin në Parti metodat ushtarake, forma të shtrembëra organizimi të Partisë, të huajtura prej trockistëve jugosllavë.

Veprimet tona në analizën e Plenumit VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë mund t'i krahasojmë me pikëpamjet e gabuara të Ko-

mitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave. Në mënyrën e veprimit, në mënyrën e gjykimit dhe në dënimin që u dhamë Nako Spirut, Mehmet Shehut dhe shokëve të tjerë, ne gjejmë analogji me veprimet dhe vendimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë kundër shokëve Zhujoviç dhe Hebrang. Në analizën e Plenumit VIII, që u nxit nga trockistët jugosllavë, nuk mund të mos gjejmë pasqyrimin e pikëpamjeve të tyre antimarksiste, antisovjetike dhe kundër Partisë sonë. Letra e Partisë Bolshevike thotë:

«Mjaftoi për shembull që shoku Zhujoviç të shfaqte mosaprovimin e tij në mbledhjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave për projektin e përgjegjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, letrës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të BS, që ta përjashtoj në atë menjëherë nga Komiteti Qendror. Si duket Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave e shikon partinë jo si një organizëm vetëveprues, që ka të drejtë të shfaqë mendimin e vet, po si një detashment partizan, anëtarët e të cilit s'kanë të drejtë të diskutojnë çështjet e ndryshme, por duhet pa diskutim të vënë në veprim të gjitha dëshirat e «kryetarit». Kjo quhet te ne kultivimi i metodave ushtarake në parti, gjë krejt e papajtueshme me principet e demokracisë së brendshme të partisë në partinë marksiste. Siç dihet, Trocki gjithashtu tentoi në kohën e tij të mbjellë në Partinë Bolshevike metodat ushtarake të udhëheqjes, porse ai u demaskua dhe u dënua nga partia me në krye Leninin, metodat ushtarake u përmbysën,

kurse demokracia e brendshme në parti u ruajt si principi më i rëndësishëm i ndërtimit të partisë»¹.

Një rrezik tjetër që ka ekzistuar në Parti është qenja e sekretarit të Komitetit Qendror për kuadrin njëkohësisht edhe ministër i punëve të brendshme. Në lidhje me këtë çështje në letrën e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave thuhet:

«Është karakteristike që, sekretari i Komitetit Qendror të Partisë për kuadrat është Ministri i Sigurimit të Shtetit. Me fjalë të tjera kuadrat e Partisë janë vënë në fakt nën vëzhgimin e Ministrisë të Sigurimit të Shtetit. Sipas teorisë marksiste, Partia duhet të kontrollojë gjithë organet shtetërore të vendit, duke përfshirë edhe Ministrinë e Sigurimit të Shtetit, kurse në Jugosllavi ngjet diçka e kundërt, se Partinë në fakt e kontrollon Ministria e Sigurimit të Shtetit. Siç shihet nga kjo gjë shpjegohet që vetëveprimtaria e masave të Partisë në Jugosllavi qëndron jo në nivelin e duhur.

Kuptohet që nuk mund të konsiderojmë marksist-Internist bolshevik një organizim të këtyllë të Partisë Komuniste»².

Huajtja e një forme të tillë organizimi i ka sjellë Partisë sonë dëme të mëdha. Pa hyrë në hollësi dhe pa

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

² Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 27 mars 1948. AQP.

dhënë shembuj që ka mjaft, duhet pranuar se të gjitha gabimet, për të cilat fola gjatë referatit tim, janë të lidhura dialektikisht me qenjen e sekretarit organizativ edhe si ministër i punëve të brendshme. Këtë gabim me rëndësi duhet ta njohim mirë, pse prej tij kanë rrjedhur shumë gjëra të këqia, si mbytja e kritikës dhe e auto-kritikës, mungesa e demokracisë së brendshme të Partisë, hyrja e metodave ushtarake dhe të tjera të këqia. Këtë duhet ta njohim dhe ta kuptojmë drejt, përndryshe do të ketë rreziqe edhe në të ardhshmen. Sa për shembuj, që ilustrojnë gabimet që janë bërë në këtë drejtim, mund të japim plot. Është ngritur, për shembull, çështja se gjoja anëtarët e Partisë që punojnë në organet e Sigurimit të Shtetit janë më besnikët e Partisë. Po të shtrohet kështu çështja, është krejt e gabuar. Po pse është ngritur kjo çështje në këtë mënyrë? Unë them se kjo e ka origjinën në gabimin e organizimit tonë që pamë më lart. S'ka dyshim se shokët që punojnë në organet e Sigurimit të Shtetit janë besnikë të Partisë dhe ata duhet ta kryejnë detyrën me besnikëri, por kjo nuk do të thotë aspak se anëtarët e tjerë të Partisë, që punojnë në sektorë të ndryshëm janë më pak besnikë se ata. Sigurimi i Shtetit është një sektor shumë i rëndësishëm i Partisë sonë, por kjo nuk do të thotë se, duke zgjedhur njerëz besnikë të Partisë për të punuar në këtë sektor, këta duhet të kenë nën kontrollin e tyre Partinë dhe njerëzit e tjerë që janë besnikë të Partisë sa edhe ata. Është vetëm Partia ajo që i kontrollon të gjithë. Kështu duhet kuptuar kjo çështje nga cilido, tjetër rrugë nuk ka.

Shoku Nesti Kerenxhi në mbledhjen e Byrosë po-

hoi se nga Ministria e Punëve të Brendshme është lëshuar një qarkore, me anën e së cilës u rekomandohej të gjitha organeve të Sigurimit të Shtetit që të kontrollojnë anëtarët e Partisë në gjithë veprimtarinë dhe jetën e tyre private, lidhjet që ata kanë, grindjet në mes tyre ose në familje, jetën e tyre ekonomike, në se u mjafton rroga apo jo, të kontrolloheshin se mos, të shtyrë nga nevojat financiare, ata marrin të holla nga reaksionarët dhe bëhen vegla të armikut, etj. Një orientim i tillë shumë i gabuar, për të cilin Koçi Xoxe ka një përgjegjësi të madhe, i vinte anëtarët e Partisë në të vërtetë nën vëzhgimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nën mbikqyrjen e kësaj ministrie. E gjithë kjo mjafton të vërtetojë vijën e gabuar në këtë drejtim.

Por ka edhe shumë veprime të tjera që Koçi Xoxe, si sekretar i Partisë për kuadrot, ka lejuar të zhvillohen në këtë drejtim shumë të gabuar. Në mbledhjet e celulës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, që është një celulë si e gjithë dikastereve të tjera, nuk mund të shkonte përveçse një njeri i caktuar i komitetit të Partisë të dikastereve që kishte lidhje nga ana e funksionit të tij me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Duke qenë se komiteti i Partisë i dikastereve nuk mund të kontrollonte punën e Partisë në celulën e Ministrisë së Punëve të Brendshme është e qartë se Partia nuk mund të kontrollonte punën e saj në këtë ministri. Pse ngjiste një gjë e tillë? Kjo ngjiste sepse mbledhja e celulës së këtij dikasteri, nuk ishte një mbledhje partie, ku të rriheshin problemet e Partisë në dikaster. Mbledhjet e celulës në Ministrinë e Punëve të Brendshme kishin një karakter thjeshtësisht pune sigurimi. Ra-

portet që i vinin komitetit të Partisë për dikasteret, ose Komitetit Qendror, nuk ishin raporte partie, nëpërmjet të cilave të shihej si ecte puna e Partisë në këtë dikaster, por raporte për persona. Në rastin kur anëtari i një komiteti qarkor të Partisë nuk ishte në pozita të shëndosha partie, por në ato të armikut, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të Seksionit të kuadrove të KQ për ta këqyrrur këtë punë nga afër, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjës se ky seksion i KQ s'duhet të interesohet për këto çështje, pasi atë e ka marrë në dorë sigurimi për ta zgjidhur. Si mund të lejohet që Partia, Komiteti Qendror më ekzaktërisht, të mos interesohet për çështjen e një komiteti qarkor, ku punët nuk shkojnë mirë, ku paraqiten çrregullime, abuzime ose ka punë armiqësore? Partia duhet të bëjë punën e vet deri në fund dhe sigurimi gjithashtu të kryejë detyrën që i ka ngarkuar Partia deri në fund. Këto dy veprime duhet të koordinohen dhe të puqen përsëri në një vend, në Komitetin Qendror të Partisë. Është Partia që do t'i diktojë drejtimin sigurimit, do ta kontrollojë atë dhe jo sigurimi t'i diktojë Partisë vullnetin dhe pikëpamjet e tija. Nuk lejohet që sigurimi të ndjekë çështjen e një elementi armik të futur në Parti dhe kjo të vazhdojë ta konsiderojë atë si një anëtar të shëndoshtë të vetin, etj. Në rast se rrethanat e lypin që për një kohë duhet mbajtur konspiracioni për të zgjeruar hetimet dhe për të zbuluar rrethin më të gjerë të këtij armiku të infiltruar në Parti, sigurimi nuk mund të veprojë pa vënë në dijeni udhëheqjen e Partisë, e cila të marrë masat që gjykon të arësyeshme për të koordinuar punët në këtë drejtim. Sigurimi nuk mund të

veprojë kurrë i shkëputur nga Partia dhe nga drejtimi i sigurtë i saj.

Tipike gjithashtu janë rastet që kanë ngjarë në Shkodër dhe në Berat, ku shefat e sigurimit kanë shkuar dhe kanë kontrolluar zyrat e komiteteve të Partisë për të parë se në ç'gjendje ishin dhe si mbaheshin dokumentat e Partisë. Tipike janë edhe raportet që i vinin Sigurimit të Shtetit nga shefat e sigurimit në qarqe, në të cilat raportohej mbi gjendjen e anëtarëve të komiteteve të Partisë të këtyre qarqeve.

Mund ta marrim me mend se çfarë kritike dhe autokritike dhe çfarë demokracie e brendshme mund të ekzistonte në Partinë tonë në një situatë të tillë kaq të rëndë në Parti, të krijuar nga këto akte të palejueshme dhe antimarksiste. Këtu nuk duhet të kemi iluzione dhe të mbrohemi ose të fshehim një gjë që s'e fshehim dot. Në Partinë tonë ka pasur frikë të flitej hapët, të kritikohet pa drojtje, ose të bëhet autokritikë e drejtë, pse shpesh autokritika, në vend që ta rehabilitonte shokun fajtor, e dënonte atë ca më tepër, sepse kthehej në armë për ta goditur arbitrarisht atë që bënte autokritikën. Prandaj heshtej, fshiheshin gabimet, krijohej mosbesim ndaj shokëve deri në drejtësinë e Partisë. Shokë të vjetër komunistë, me lot në sy kanë kërkuar të heqin dorë nga postet që u kishte ngarkuar shteti, pse shikonin që bëheshin veprime të padrejta. Ata drejtoheshin deri në instancën më të lartë të Partisë, por dhe atje nuk dëgjoheshin me vëmendje. Çështje alarmante kjo, që duhet të na bëjë të mos na zërë gjumi, të japim alarmin në Parti për të luftuar pamëshirë këto tendenca antimarksiste. Dhe këto do t'i luftojmë, duke

i vënë Partisë në duart e saja armën e sigurtë të kritikës dhe të autokritikës së shëndoshë, ashtu siç na mëson Stalini i madh.

Disa shokë konfundojnë rolin e Partisë me atë të sigurimit dhe i quajnë jo të gabuara veprime të tilla, që nuk janë veçse veprimtari policore. Partia duhet të jetë vigjilente, të kontrollojë veprimtarinë e çdo anëtari të saj për të mbrojtur radhët e veta, por nuk duhet harruar roli i madh edukues i saj. Ne dimë se ka anëtarë të mirë, por ka edhe të dobët, që mund të largohen nga Partia. Detyra e Partisë është që, me një punë të madhe edukative, me një kujdes të veçantë për rritjen e kuadrove, ashtu siç na mëson Stalini, të kujdesemi për kuadrot si bahçevani i mirë që kujdeset për pemën, që e ujit, e krasit dhe e rrit me një dashuri të madhe, të bëjmë të gjitha përpjekjet që këta anëtarë partie t'i ndreqim dhe t'i hedhim jashtë Partisë vetëm atëhere kur nuk kanë asnjë shërim dhe asnjë vlerë për Partinë.

Në Partinë tonë, si në të gjitha partitë e tjera, ka anëtarë partie që janë dënuar për faje të rënda që kanë bërë, por që nuk kanë marrë dënimin maksimal, nuk janë nxjerrë jashtë Partisë. Këta anëtarë janë si njerëzit që kanë hequr një sëmundje të rëndë, ndaj të cilëve detyra e doktorit është t'i shërojë me të gjitha forcat, t'u japë jetë dhe fuqi. Kështu duhet të veprojë Partia me këta njerëz, t'i shërojë dhe jo t'u japë shqelmin. Partia, derisa s'i ka përjashtuar nga gjiri i saj, ka kurdoherë shpresë në ta. Stalini na mëson se njerëzit mund të korrighohen dhe këtë ne e njohim nga historia e partive politike. Te ne nuk është vepruar kështu, në rrugën e drejtë të Partisë. Njerëzit që janë dënuar për fajet

që kanë kryer, janë përbuzur e izoluar, bile është dhënë urdhër që ata të vëzhgohen nga të katër anët çfarë bëjnë, me kë piqen etj., etj. Këto janë tamam metoda policore, që s'kanë të bëjnë me rolin edukues dhe me vigjilencën e shëndoshë të Partisë. Në rast se ne nuk e kuptojmë drejt këtë çështje, atëhere i kemi shndërruar komitetet dhe celulat e Partisë në zyra të thjeshta të policisë dhe të sigurimit.

Duhet të kuptojmë mirë se futja e metodave të tilla në Parti, çon në goditjen e hapët të parimeve marksiste-leniniste të ndërtimit të Partisë. Por duhet të kuptojmë mirë edhe rolin e detyrat e organeve të Sigurimit të Shtetit. Këto organe drejtohen nga Partia, ashtu si çdo organ tjetër shtetëror; ato janë organe të ngarkuara me detyra të mëdha për mbrojtjen e fitoreve të luftës, për mbrojtjen e Republikës sonë Popullore, për mbrojtjen e pushtetit popullor nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Ato duhet të konsiderohen e të dashurohen si të tilla dhe të ndihmohen në punën e tyre për të mos i lënë asnjë rast armikut të na dëmtojë. Kjo është detyrë e të gjithëve. Arma e Sigurimit të Shtetit është një armë shumë e vlefshme dhe e dashur e Partisë sonë, sukseset e saj në plotësimin e detyrave, që prej ngritjes së saj e tëhu, duhet të çmohen drejt. Kështu duhet ta kuptojë këtë çështje e gjithë Partia.

Letrat e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave janë dokumenta të rëndësishme, të cilat Partia jonë dhe gjithë anëtarët e saj, që nga udhëheqësit dhe deri te anëtari më i thjeshtë, duhet jo vetëm t'i lexojnë, por t'i studjojnë dhe të nxjerrin prej tyre konkluzione në lidhje

me punën tonë në të shkuarën dhe në të ardhshmen. Njerëzit e Partisë sonë, të armatosur me mësimet e mëdha të marksizëm-leninizmit, të kontrollojnë punën e tyre, të mbrojnë vijën e Partisë, duke korigjuar gabimet e bëra dhe duke luftuar gabimet në të ardhshmen. Ne duhet t'i zbatojmë si duhet mësimet e të madhit Lenin dhe të Stalinit, pse vetëm kështu Partia jonë do të ecë e sigurtë në rrugën e bolshevizimit të saj dhe të anëtarëve të saj. Lenini thotë:

«Qëndrimi i një partie politike kundrejt gabimeve të veta është një nga kriteret më të rëndësishme dhe më të sigurta të seriozitetit të partisë dhe të zbatimit në fakt të detyrave të saj kundrejt klasës së vet dhe kundrejt masave punonjëse. Të pranosh haptazi gabimin, të zbulosh shkaqet e tij, të analizosh rrethanat që e shkaktuan atë, të shqyrtosh me kujdes mjetet për ta ndrequr gabimin — ja kjo është shenja e një partie serioze, ja kjo është kryerja nga ana e saj e detyrave të veta, ja ky është edukimi dhe mësimi i klasës dhe pastaj edhe i masës»¹.

Të mos harrojmë dhe të kemi kurdoherë parasysh fjalët e arta të Vladimir Iliçit:

«Të gjitha partitë revolucionare, që kanë humbur deri më sot, — kanë humbur pse u është rritur mendja, dhe nuk kanë ditur të shohin se

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 49.

ku qëndron forca e tyre, kanë pasur frikë të flasim për dobësitë e veta. Por ne nuk do të humbasim, sepse nuk kemi frikë të flasim për dobësitë tona, dhe do të mësojmë t'i kalojmë dobësitë»¹.

Partia jonë, udhëheqësit dhe gjithë anëtarët e saj duhet t'i ndjekin me besnikërinë më të madhe mësimet e paçmueshme të mësonjësve të lavdishëm të Partisë sonë, Leninit dhe Stalinit. Partia jonë e udhëheqja e saj nuk do të kenë frikë t'i shohin në sy gabimet e tyre, t'i njohin këto me ndershmëri dhe t'i luftojnë pamëshirë që të mos përsëriten më, për të mirën e Partisë sonë dhe të pullit tonë.

Shokë,

Analiza që ne i kemi bërë punës së Partisë sonë është e bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në dritën që na dhanë letrat historike të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Në bazë të kësaj analize të gjerë dhe të hollësishme të punës së Partisë, Plenumi XI i Komitetit Qendror ka marrë vendime që kanë një rëndësi shumë të madhe për Partinë tonë. Plenumi e pa të nevojshme të theksojë në mënyrë të veçantë se Partia jonë duhet të mobilizojë të gjitha forcat e saja për të vënë në jetë drejt dhe sa më parë vendimet e tij. Letrat e Partisë Komuniste

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 343.

të Bashkimit Sovjetik duhet të punohen në të gjitha organizatat e Partisë dhe të shërbejnë për të vënë më mirë në jetë vendimet e Plenumit XI.

E gjithë Partia duhet të mobilizohet që t'u shpjegojë masave punonjëse, gjithë popullit tonë, rolin e vërtetë e të madh të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste Bolshevike e të Stalinit të madh, si dje në luftë, edhe sot në paqe. E gjithë Partia duhet të mësojë nga mësimet e mëdha të Partisë Komuniste Bolshevike e të shokut Stalin, mikut të shtrenjtë të popullit tonë, të përfitojë nga eksperiencia e paçmueshme e Partisë Komuniste Bolshevike dhe e Bashkimit Sovjetik në të gjitha drejtimet dhe ta zbatojë atë në praktikë, sipas kushteve tona, për ndërtimin e socializmit.

Përballë kampit demokratik dhe antiimperialist, përballë kampit që lufton për një paqe dhe demokraci të vërtetë, me Bashkimin Sovjetik në krye, qëndron kampi imperialist e antidemokratik, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe me vendet e tjera imperialiste, që ndjek një politikë agresive kundër vendeve të demokracisë popullore, kundër paqes dhe lirisë së popujve, për të vendosur hegjemoninë e tij në të gjithë botën, për të skllavëruar dhe robëruar popujt. Imperialistët pregatisin plane agresive, ata nxisin luftën kundër Bashkimit Sovjetik e vendeve të demokracisë popullore, ata pregatisin kasaphanën e re, siç bëri dje Hitleri, për t'i vënë popujt nën skllavërinë e tyre. Kundër këtij kampi lufton në ballë të forcave demokratike Bashkimi i madh Sovjetik, vendi i socializmit.

Pra, të gjithë anëtarët e Partisë, të gjitha organizatat e saja, të jenë kurdoherë të mobilizuara për të

shpjeguar në masat punonjëse zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare, të shtojnë në to urrejtjen kundër armikut të njerëzimit, armikut të madh të vendit tonë, imperializmit amerikan dhe anglez, pasardhës besnikë të Hitlerit, që përpiqen të skllavërojnë botën.

Grupi trockist i Titos devijoi nga marksizëm-leninizmi, refuzoi si armik ndihmën e këshillat e Partisë Komuniste Bolshevike dhe të partive të tjera motra, tradhëtoi çështjen e socializmit, çështjen e internacionalizmit proletar dhe është hedhur në prehrin e imperialistëve, në luftë të turpshme dhe të ndytë kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Partisë së lavdishme Bolshevike, kundër gjithë kampit të socializmit.

Në rrugën e tyre antimarksiste, trockistët jugosllavë janë përpjekur të tërheqin edhe Partinë tonë. Me një veprimtari djallëzore dhe të poshtër ata janë munduar t'i imponohen Partisë dhe vendit tonë, të zhdukin pavarësinë e Partisë dhe të popullit shqiptar, ta kthejnë vendin tonë në një koloni të tyre. Por të gjitha orvatjet e tyre kanë hasur në rezistencën e madhe të Komitetit Qendror të Partisë sonë, e cila, më në fund, me ndihmën e Partisë Komuniste Bolshevike, dërmoi definitivisht këto orvatje të poshtra dhe shpëtoi nga kthetrat e grupit renegat të Titos.

E gjithë Partia jonë duhet të mobilizohet për të kuptuar mirë dhe qartë e për t'u sqaruar sa më mirë masave punonjëse tradhëtinë e madhe të grupit trockist të Titos ndaj çështjes së internacionalizmit proletar, ndaj çështjes së kampit të socializmit, për të kuptuar ndihmën e madhe që na dhanë Partia Bolshevike dhe Stalini i madh të shpëtonin vendin dhe Partinë tonë nga

gremina, ku donte të na çonte grupi tradhëtar i Titos dhe të gjenim rrugën e marksizëm-leninizmit.

Duke marrë parasysh nivelin e ulët ideologjik të masave të gjera të Partisë sonë, duhet të merren menjëherë masat e duhura për një punë të organizuar dhe sistematike, për të forcuar edukimin marksist-leninist dhe për të ngritur nivelin ideologjik të kuadrove të Partisë. Përcaktimin e Leninit se:

«rolin e luftëtarit pararojë mund ta kryejë vetëm ajo parti që udhëhiqet nga një teori pararojë»¹

ne duhet ta kemi gjithmonë parasysh në tërë madhësinë e kuptimit të thellë të tij dhe të na bëjë të marrim të gjitha masat për të zgjidhur këtë problem shumë të madh.

E vërteta është se zbatimi i detyrave konkrete në këto vjete të çlirimit, dhënja pas punëve praktike ka bërë që të lihet pas dore puna për ngritjen ideologjike të kuadrove. Mungesa e një pune sistematike e të vazhdueshme ka pasoja të rënda në Partinë tonë. Shoku Stalin, duke theksuar rrezikun e një pune të tillë, ka thënë:

«... në qoftë se propaganda jonë e partisë fillon të çalojë, në qoftë se fillon të dobësohet puna e edukimit marksist-leninist të kuadrove tanë, në qoftë se dobësohet puna jonë për ngritjen e ni-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 435-436.

velit politik dhe teorik të këtyre kuadrove dhe si pasojë vetë kuadrot nuk interesohen më për perspektivën e përparimin tonë, nuk e kuptojnë më drejtësinë e çështjes sonë dhe shndërrohen në prakticienë pa perspektivë... atëhere duhet paktjetër të dobësohet gjithë puna jonë e shtetit dhe e Partisë. Duhet pranuar, si një aksiomë, se sa më të lartë të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove të çdo sektori të punës së shtetit dhe të partisë, aq më e mirë dhe më frytdhënëse është vetë puna, aq më të efektshme janë rezultatet e punës, dhe anasjelltas, sa më të ulët që të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove, aq më të mundshme janë gabimet dhe dështimet në punë... »¹.

Partia jonë e ndjen thellë këtë mungesë dhe ka nevojë të madhe dhe urgjente që ta përmirësojë dhe të ngrejë në një nivel më të lartë punën për ngritjen ideologjike të kuadrove.

Shoku Stalin ka theksuar vazhdimisht nevojën e madhe dhe të domosdoshme që kuadrot të përvetësojnë shkencën marksiste-leniniste, nevojën e madhe të studimit të teorisë marksiste-leniniste. Në Kongresin XVIII të Partisë Komuniste Bolshevike ai ka thënë:

«po të dinim t'i pregatisnim ideologjikisht kuadrot tanë të çdo sektori dhe t'i kalitnim politi-

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 246-247.

kisht në mënyrë të tillë që ata të mund të orientoheshin lirisht në gjendjen e brendshme dhe ndërkombëtare, po të arrinim t'i bënim ata marksistë-leninistë plotësisht të pjekur, të aftë për të zgjidhur pa gabime serioze çështjet e drejtimin të vendit, — atëherë ne do të mund t'i quanim me plot të drejtë të zgjidhura nëntë të dhjetat e të gjitha çështjeve tona¹.

Që këtej edhe një herë më fort duhet të dalë nevoja e domosdoshme që Partia jonë të kuptojë thellë rëndësinë e madhe të studimit të teorisë marksiste-leniniste që është arma kryesore e një partie revolucionare.

Prandaj duhet të merren masa për të forcuar Shkollën e Partisë dhe të krijohen kurse në qendra të tjera, ku të shkojnë anëtarët e Partisë për t'u armatosur me shkencën marksiste-leniniste. Të vihet si detyrë kryesore para anëtarëve të Partisë dhe të inkurajohen e të ndihmohen ata që të mësojnë në mënyrë individuale shkencën marksiste-leniniste, në radhë të parë Historinë e Partisë Komuniste Bolshevike, bazat e marksizëm-leninizmit, Statutin e programin e Partisë dhe ligjet themelore të kalimit prej kapitalizmit në socializëm në vendin tonë.

Është detyrë e të gjithë anëtarëve të Partisë që të studojnë për të zgjeruar sa më shumë njohuritë e përgjithshme të tyre, të zhvillojnë intelektin e tyre dhe, krahas punës ku janë vendosur, të ndjekin edhe shkollat.

Partia gjithashtu duhet të botojë, për të vënë në

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 247.

duart e anëtarëve të saj, sa më shumë libra teorike marksiste-leniniste.

Detyra kryesore e Partisë sonë është të përvetësojë bazat e teorisë marksiste-leniniste, pse pa një përgatitje të tillë veprimtaria e Partisë ndërpritet, rruga e saj errësohet, gjë që bën të vërtetohen gabime të rënda që i kushtojnë shumë shtrenjtë Partisë dhe vendit. Prandaj duhet të studjojmë me të gjitha forcat teorinë marksiste-leniniste që i ndriçon rrugën Partisë sonë dhe ta përhapim atë sa më shumë e në çdo formë në masat e Partisë.

Një rëndësi të madhe kanë në këtë çështje edhe botimet e shtypi i Partisë, i cili duhet të luajë një rol të dorës së parë për të ushqyer masat e Partisë me lëndë të nevojshme teorike për të përhapur propagandën në radhët e komunistëve në një shkallë më të gjerë.

«Zëri i Popullit», që në bazë të vendimit të Komitetit Qendror do të rifillojë botimin e tij të përditshëm, duhet të jetë një armë e fortë dhe e shëndoshë në duart e Partisë për të shpurë vijën e Partisë në masa, për të forcuar organizatën e Partisë, për ta pajisur Partinë me eksperiencën e nevojshme që ajo të realizojë sa më mirë detyrat e mëdha që i shtrohen përpara, edhe për të ngritur më lart nivelin politik të anëtarëve të Partisë.

Në vijën e Partisë, në bazë të teorisë marksiste-leniniste, të zgjerohet dhe të intensifikohet kudo lufta kundër pikëpamjeve borgjeze dhe antimarksiste dhe veçanërisht në shkollat e vendit tonë. Shkollat, nën drejtimin e pushtetit tonë popullor, nën udhëheqjen e Partisë, duhet të jenë nga çdo pikëpamje qendra, ku të formohen kuadrot e ardhshëm të edukuar në baza të shën-

dosha me teorinë marksiste-leniniste. Për të tillë kuadro vendi ynë ka shumë nevojë. Prandaj të luftohet në mënyrë që të likuidohet çdo gjë që pengon mbarëvajtjen e shkollës sonë në këtë drejtim. Të merren masa për të likuiduar tekstet e vjetra dhe për t'i zëvendësuar ato me tekste të reja, në bazë të eksperiencës së Bashkimit Sovjetik, duke ja përshtatur atë kushteve tona.

Propaganda e Partisë e ngritur në nivelin e duhur dhe puna për ngritjen ideologjike të kuadrove të Partisë janë nga detyrat më të mëdha dhe më të rëndësishme të Partisë.

Krahas me këto, Partia duhet të zgjidhë një nga detyrat e mëdha të saj: studimin e gjendjes reale të vendit në bazë të marksizëm-leninizmit dhe përgjithësimin e eksperiencës së nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të tij në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Nga ana tjetër, duhet të forcohet më shumë puna e propagandës dhe e agjitacionit në masa. Masat tona punonjëse, i gjithë populli duhet të sqarohen rreth problemeve të vendit, rreth problemeve ndërkombëtare, të kuptojnë situatën dhe detyrat dhe të mobilizohen për kryerjen e tyre. Është detyrë e organizatave të Partisë, e çdo anëtarit të Partisë të shpien vijën e Partisë në masat e gjera të popullit, të ngrenë ndërgjegjen e tyre dhe t'i mobilizojnë ato për zbatimin e vijës së Partisë.

Të gjitha organizatat e Partisë duhet të zhvillojnë një propagandë dhe agjitacion të gjerë dhe sistematik për t'u shpjeguar masave rëndësinë e vendimeve të qeverisë, rëndësinë në radhë të parë të planit të shtetit, t'i mobilizojnë ato për realizimin e tejkalimin e tij. Anëtarët e Partisë duhet të japin shembullin në gjithë këtë

punë të madhe dhe të dinë të organizojnë më së miri punën për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit.

Partia jonë duhet të legalizohet menjëherë si Parti që udhëheq e drejton tërë jetën e vendit tonë në krye të masave punonjëse, në krye të të gjitha organizatave të masave për ndërtimin e socializmit. Mbajtja e Partisë deri sot në gjysmlegalitet e ka dëmtuar atë, ka dobësuar influencën e saj, ka penguar zhvillimin më të madh të saj dhe rritjen e autoritetit e të lidhjeve të saja me masat. Është e qartë se aty ku pakësohet, si në rastin tonë, roli politik i Partisë, duke e fshehur këtë në Frontin Demokratik, megjithëse është në fuqi, krijohet terreni për lindjen e tendencave antiparti që dëmtojnë rëndë Partinë.

Është nevojë urgjente për vetë jetën dhe forcimin e Partisë sonë që të likuidohen menjëherë të gjitha pikëpamjet e huaja, antimarksiste e antiparti që kanë depërtuar në Partinë tonë. Përsa i përket ndërtimit të demokracisë së brendshme të Partisë, të rivendosen parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të Partisë e të demokracisë së brendshme të saj. Për këtë Komiteti Qendror, në radhë të parë, ka marrë vendim të thërresë Kongresin I të Partisë, ku do të shqyrtohet e gjithë veprimtaria e saj, do të aprovohet Statuti dhe programi i Partisë, do të zgjidhet demokratikisht Komiteti Qendror dhe pastaj në të gjitha organizatat e Partisë do të ketë zgjedhje demokratike.

Nga ana tjetër, Komiteti Qendror ka marrë masa që t'i japë fund qenjes së sekretarit organizativ të Partisë si ministër i punëve të brendshme, pse kjo është krejt

e huaj dhe e ka dëmtuar shumë Partinë. Është e domosdoshme të bëhet e qartë se funksioni i ministrit të punëve të brendshme duhet të konsiderohet si një funksion shtetëror, i cili është, si gjithë të tjerët, nën drejtimin e nën kontrollin e Partisë dhe të mos lejohet ta kontrollojë ai Partinë, siç ka ngjarë në vendin tonë.

Partia jonë duhet të forcohet në pikëpamje organizative në bazë të parimeve leniniste të ndërtimit të Partisë.

Parimi kryesor mbi të cilin ndërtohet një parti revolucionare, një parti marksiste-leniniste është parimi i centralizmit demokratik. Centralizëm demokratik do të thotë:

1. — Të gjitha organet drejtuese të Partisë zgjidhen demokratikisht nga poshtë-lart dhe nuk emërohen ose kooptohen.

2. — Organet drejtuese janë të detyruara të japin periodikisht llogari para anëtarëve që i kanë zgjedhur mbi veprimtarinë e vet dhe të krijojnë të gjitha mundësitë që pjesëmarrja e tyre në diskutime dhe në marrjen e vendimeve të mos pengohet.

3. — Centralizmi demokratik kërkon patjetër një disiplinë të çelniktë, por të ndërgegjegjshme, që pakica t'i nënshtrohet shumicës. Disiplina e çelniktë kërkon patjetër diskutim, luftë mendimesh,

«Po kur merr fund lufta e mendimeve, — thotë shoku Stalin, — kur përfundon kritika dhe merr vendimi, uniteti i vullnetit dhe uniteti i veprimit të të gjithë anëtarëve të partisë është korniditë e domosdoshme, pa të cilën nuk mund të

mendohet as një parti unike, as disiplina e hekurt në parti»¹.

4. — Vendimet e organeve më të larta të Partisë janë të detyruara për organet më të ulëta.

Është e nevojshme të theksohet mirë që të merren masa për të likuiduar të gjitha metodat antidemokratike, ushtarake e policore, pikëpamjet antimarksiste e anti-parti që kanë depërtuar në Partinë tonë dhe të vendoset demokracia e brendshme e Partisë, ashtu si na mësojnë Lenini e Stalini.

Demokracia e brendshme e Partisë është një kusht i domosdoshëm për ekzistencën e fuqizimin e Partisë. Ajo e forcon disiplinën e Partisë, por ajo është kundër metodave ushtarake e policore.

Anëtari i Partisë duhet ta ndjejë veten në Parti si në shtëpinë e vet. Atij duhet t'i respektohen të gjitha të drejtat.

Në Parti të gjitha çështjet duhet të zgjidhen në bazë të kritikës e të autokritikës. Anëtari i Partisë ka të drejtë të thotë fjalën e tij, të kritikojë këdo dhe për kritikën e drejtë që bën, nuk mund në asnjë mënyrë të ushtrohet mbi të represion moral. Pjesëmarrja e gjallë e anëtarëve të Partisë, rrahja e mendimeve, diskutimi i lirë, zbatimi i vendimeve të marrura, bëjnë esencën e demokracisë së brendshme të Partisë.

Shoku Stalin, duke shpjeguar esencën e demokracisë së brendshme të Partisë, thotë:

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 186.

«Demokracia e vërtetë qëndron në faktin që në organizatën e partisë të veprojnë masa e partisë, që masa e partisë të zgjidhë si çështjet e partisë, ashtu edhe çështjet e përgjithshme praktike, që masa e partisë të marrë vendimet e saj dhe t'ua ngarkojë si detyrë organizatave të saja që t'i zbatojnë këto vendime»¹.

Demokracia e brendshme e Partisë forcon unitetin e Partisë, kompaktësinë ideologjike të saj, disiplinën e ndërgjegjshme dhe centralizmin e Partisë.

Parimi i demokracisë së brendshme të Partisë kërkon patjetër një kritikë dhe autokritikë të shëndoshë bolshevike. Pa kritikë dhe autokritikë, nuk është e mundur të realizohen parimet organizative leniniste-staliniane të ndërtimit të Partisë. Autokritika është një ligj i zhvillimit të një partie marksiste-leniniste. Ajo është një armë e shëndoshë në duart e Partisë që e forcon atë dhe e bën të zonjën të kapërcejë vështirësitë e të ecë përpara.

«Vetëm partitë, që kanë perënduar dhe që janë të dënuara të zhduken, — thotë shoku Stalin, — mund të kenë frikë nga drita dhe nga kritika. Ne nuk kemi frikë as nga njëra, as nga tjetra, nuk kemi frikë sepse ne jemi një parti që ecën gjithmonë përpara, që ecën drejt fitores. Ja sepse autokritika... është një shenjë që tregon

¹ Çështje të ndërtimit të Partisë (Libri I). Tiranë, 1948, f. 57.

forcën e madhe dhe jo dobësinë e partisë sonë, është një mjet për forcimin dhe jo për çthurjen e saj»¹.

E gjithë Partia jonë, të gjithë anëtarët e Partisë duhet të edukohen në këtë metodë, që është metoda e edukimit të kuadrove me frymë revolucionare. Çdo qëndrim tjetër ndaj kritikës dhe autokritikës është anti-marksist dhe jo i denjë për komunistët. Të mos pranojnë kritikën, të mos bëjnë autokritikën, do të thotë të kesh frikë, të ruhesh para Partisë, ose të mos duash të njohësh gabimet. Në të dy rastet ky është një qëndrim i dëmshëm për Partinë. Partia jonë duhet të edukohet me frymën revolucionare, ashtu si na mësojnë Lenini dhe Stalini.

Pa zhvilluar kritikën e autokritikën gjerësisht në organizatat e Partisë, është e pamundur të gjykohen çështjet drejt, është e pamundur të shkohet përpara, është e pamundur të forcohet Partia. Mosvendosja e kritikës e autokritikës u le vend metodave të huaja e anti-marksiste në Parti që e dobësojnë dhe e brejnë Partinë nga brenda.

Duhet t'u jepet fund gjithashtu në Parti të gjitha metodave të punës jomarksiste përse i përket gjykimit të kuadrove. Kuadrot e Partisë duhet të çmohen dhe të gjykohen nga puna e tyre, nga rezultatet në punë, nga mënyra se si e kanë mbrojtur ata vijën e Partisë dhe jo nga opinionet personale të rrjedhura nga paragjykitime prapanike dhe mikroborgjeze.

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 7, f. 123-124.

Është e domosdoshme të thëksohet për Partinë tonë nevoja e vendosjes së unitetit dhe e punës kolegjiale në të tëra organizatat e Partisë, që nga lart e deri poshtë. Nuk mund të lejohet që problemet e Partisë të mos shtrohen ose të shtrohen në një mënyrë të përciptë, vetëm sa për të informuar dhe që zgjidhja e tyre të bëhet në mënyrë personale dhe të shkëputur.

Punët e Partisë duhet të zgjidhen të tëra në bazë të normave të Partisë, në bazë të parimit të madh të centralizmit demokratik. Vetëm në këtë bazë çështjet e Partisë mund të gjejnë zgjidhje të drejtë, ndryshe do t'u lihet vend gabimeve të rënda në Parti, si pasojë e një pune individuale, e shkëputur nga Partia, e parë dhe e gjykuar jo nën prizmin e vijës dhe të interesave të Partisë, por nën prizmin e interesave, paragjykimeve e prapamendimeve personale.

Gjykimi i çështjeve nën prizmin personal, është një metodë pune primitive për Partinë që nuk pajtohet aspak me parimet e një partie marksiste-leniniste, është shpeshherë rezultat i një fodullëku të madh që rrjedh nga mbiçmimi i vetes dhe nga përbuzja e shkelja e centralizmit demokratik. Kjo metodë likuidon pjesëmarrjen e Partisë në diskutimin e gjerë e të lirë të çështjeve, likuidon luftën e mendimeve, kritikën e autokritikën, e cila duhet të jetë metodë e punës së një partie revolucionare. Një punë e tillë personale, larg parimeve themelore të një partie marksiste-leniniste, që bazohet në opinionin personal, në paragjykime mikroborgjeze e në prapamendime ngushtësisht personale dhe egoiste, nuk duhet të lejohet në Partinë tonë, sepse një metodë e tillë është antimarksiste dhe vdekjeprurëse për Partinë.

Eliminimi i një mënyre të tillë pune dhe vendosja e punës kolegjiale në organet e Partisë, do të ruajë dhe do të forcojë unitetin e organeve drejtuese të Partisë dhe të të gjitha organizatave të saj.

Po kështu është e domosdoshme të kuptohet më drejt e të ngrihet më lart çështja e ndjenjës së përgjegjësisë personale që duhet të ketë çdo anëtar partie e sidomos çdo udhëheqës në detyrat që i janë ngarkuar. Puna kolegjiale dhe respektimi i parimeve marksiste-leniniste në punën e Partisë duhet të bëjnë që çdo kuadër i Partisë ta ndjejë më fort përgjegjësinë që ka dhe të realizojë më mirë detyrat e tija në bazë të vendimeve dhe të vijës së Partisë.

Duhet të ngrihet në një shkallë më të lartë vigjilencë revolucionare në Parti, për të ruajtur vijën e Partisë, për të ruajtur Partinë nga shtrembërimet që mund t'i bëhen vijës së saj, për të ruajtur Partinë nga goditjet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit na ka dhënë shembullin e shkëlqyer se si ruhet uniteti dhe vija e Partisë në çdo kohë nga armiqtë e betuar të saj e të proletariatit. Në shembullin e Partisë Bolshevike duhet të forcojmë edhe ne vigjilencën revolucionare në Partinë tonë.

Duhet të likuidohen sa më parë metodat policore të vigjilencës që e kufizojnë këtë dhe që në të vërtetë nuk mund ta ruajnë Partinë si duhet. Në këtë drejtim duhet të kuptohet edhe informacioni në Parti, d.m.th. jo një informacion me karakter policor, por një informacion që t'i japë Partisë të gjitha mundësitë që ajo të shohë qartë si zbatohet vija e saj, të nxjerrë në shesh shtrembërimet dhe gabimet dhe të mund të marrë me kohë ma-

sat e nevojshme. Të jesh vigjilent do të thotë të zbulosh shtrembërimet e vijës së Partisë, të zbulosh punën armike e antiparti. Partia të bëjë që çdo anëtar partie të mësojë se ajo ruhet duke ruajtur të pastër vijën e saj marksiste-leniniste.

Duhet të forcohen lidhjet e Partisë me masat. Kjo është jo vetëm një nga detyrat kryesore të Partisë, por një kusht i domosdoshëm për vetë ekzistencën e saj. Kjo do të thotë, në radhë të parë, që anëtari i Partisë jo vetëm të jetë në mes të masave punonjëse, t'i mësojë dhe t'i drejtojë ato, por të ketë gatishmërinë e plotë për të dëgjuar zërin e tyre, sugjerimet e tyre, mendimet e tyre, të dijë të mësojë nga ato, të kuptojë nevojat e tyre dhe t'u përgjigjet me kohë këtyre nevojave.

Në periudhën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë një rëndësi shumë të madhe duhet t'i japim çështjes së zhvillimit në shkallë të gjerë në masat punonjëse të kritikës e autokritikës, të kontrollit nga poshtë, çështjes që ato të mësojnë për të zbuluar të metat e gabimet në punë, të marrin pjesë aktive në ndreqjen e tyre. Anëtarët e Partisë duhet ta kuptojnë mirë këtë detyrë shumë të rëndësishme, pa të cilën nuk mund të shkojnë përpara në ndërtimin e socializmit.

Për të forcuar lidhjet e Partisë me masat, të gjithë anëtarët e Partisë duhet t'i orientojnë masat politikisht dhe t'i mobilizojnë ato për realizimin e vijës së Partisë. Ata duhet t'i lidhin masat punonjëse me vijën e Partisë.

Në radhë të parë, organizatat e Partisë duhet të drejtojnë më me vendosmëri e pa hezitim luftën e klasave, luftën kundër armiqve të rrugës sonë. Duhet të jetë e qartë se në këtë periudhë të ndërtimit të socia-

lizmit, në këtë periudhë tranzicioni nga kapitalizmi në socializëm, lufta e klasave nuk zbutet. Armiqtë e socializmit, klasat e privileguara të së kaluarës, që janë goditur nga reformat tona e që vazhdimisht po goditen, nuk e lënë për asnjë çast luftën e tyre kundër rrugës sonë, kundër ndërtimit të socializmit. Armiqtë e brendshëm e të jashtëm më tepër e shtojnë luftën e tyre, më tepër e në çdo formë i shtojnë përpjekjet e tyre për të penguar rrugën tonë drejt socializmit, për të goditur e përmbysur pushtetin tonë popullor, për të rivendosur pushtetin e tyre të urryer kapitalist.

Anëtari i Partisë duhet të jetë në mes të masave punonjëse, luftëtar i shquar kundër armiqve të klasës punëtore, kundër armiqve të socializmit dhe të mësojë e të udhëheqë masat në luftën për ndërtimin e socializmit.

Anëtari i Partisë duhet të sigurojë simpatinë e masave, të fitojë besimin e tyre. Por që të mund të fitojë simpatinë e besimin e tyre, në radhë të parë, anëtari i Partisë duhet të zhvishet nga të gjitha mbeturinat mikroborgjeze, nga të gjitha të metat që mund të ketë, siç janë ambicia, egoizmi e fodullëku dhe të jetë shembull thjeshtësie. Në qoftë se sillesh fodull me masat, në qoftë se ato fillon t'i shikosh së largu dhe që nga lart-poshtë, nuk mund të bëhesh udhëheqësi i tyre, nuk mund t'i drejtosh masat në vijën e Partisë, nuk mund t'i mësosh ato dhe aq më pak të mësosh prej tyre. Në këtë mënyrë shkëputen lidhjet e Partisë me masat dhe Partia shkon drejt likuidimit, drejt asgjësimit të saj.

Organizatrat e Partisë duhet të forcojnë punën e tyre për të bashkuar masat e gjera punonjëse, punëtorët,

fshatarët e varfër e të mesëm dhe intelektualët patriotë në Frontin Demokratik, dhe të kenë sidomos në kujdesin e tyre të veçantë forcimin për ditë e më shumë të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë e varfër e të mesme, nën udhëheqjen e klasës punëtore, në luftë për realizimin e vijës së Partisë, për shkuarjen në socializëm.

Duhet të forcohet dhe të shtohet në masat e popullit dashuria dhe respekti i thellë që ato duhet të kenë për ushtrinë tonë, mbrojtësen e garancinë e kufive, të pavarësisë së atdheut, roje besnike e fitoreve socialiste dhe e interesave të popullit tonë.

Komiteti Qendror i Partisë, si rezultat i gjithë analizës që u bë në Plenumin XI, ka marrë vendime shumë të rëndësishme, që hedhin poshtë të tëra vendimet e masat e padrejta që janë marrë në situata të sëmura dhe që kanë për qëllim të forcojnë udhëheqjen e Partisë, ta shëndoshin Partinë, të gjallërojnë e të vendosin punën e saj në baza të drejta marksiste-leniniste.

Është detyrë e organizatave të Partisë edhe e çdo anëtarit të Partisë që të vërë të gjitha forcat dhe në frymën e kësaj analize, të realizojë në jetë sa më parë dhe sa më mirë këto vendime.

*Botohet për herë të parë sipas
origjinalit që gjendet në Ar-
kivin Qendror të Partisë*

FJALA E MBYLLJES MBAJTUR NË AKTIVIN E PARTISË NË KORÇË

11 tetor 1948

U tha këtu se kam rezistuar dhe jam përpjekur për të mbrojtur vijën e Partisë nga goditjet jo të drejta që i janë bërë. Unë s'kam bërë përveçse detyrën time, ashtu si kam ditur dhe pa kursyer asgjë nga vetja për Partinë tonë.

Edhe unë jam si ju, një anëtar i Partisë, po që më është ngarkuar një përgjegjësi e madhe. Partia më mësoi, më rriti, më forcoi; çdo gjë ja detyroj Partisë, dhe çdo gjë, forcat e mia, jetën time do t'ja kushtoj Partisë, ashtu sikundër po bëni edhe ju të gjithë. Por në situatat tepër të koklavitura unë kam bërë edhe gabime në punën time, gabime pa dashur, por që kanë rënduar në punë, unë jam i ndërgjegjshëm për to dhe këto më janë bërë mësim.

Shokë, unë e mbrojta vijën e Partisë sonë, pse atë e mbronte gjithë Partia jonë. Atë do ta mbroja më drejt dhe më fort, po të mos isha aq i izoluar nga ju, nga masat e gjera të Partisë sonë, po, nga masat e gjera të Partisë, që të ngjallin, të forcojnë, të ndihmojnë, të japin kurajë dhe vullnet.

Ju thoni me plot të drejtë se po rilindni. Por më pyesni edhe mua, se çfarë ngjau te unë? Edhe unë rilinda si ju, bile më shumë se ju. Ju jeni në kontakt të përditshëm me masat e popullit, nga ku merrni frymë e jetë, por unë s'kisha kontakt të gjerë as me ju. Nga kjo unë vuaja pa masë, më besoni shokë të mi.

Unë po ringjallem, shokë, më tepër se ju, pse po dal nga një rreth i mbyllur, ku fermentonin sëmundje të ndryshme të rrezikshme dhe të huaja për Partinë tonë. Tani dal në ajër të pastër dhe marr frymë lirisht. Ne të gjithë marrim frymë lirisht, si ushtarë të Partisë, ushtarë të çelniktë që jetën tonë dhe çdo gjë që kemi të shtrenjtë e kemi vënë pa rezerva në shërbim të saj dhe të popullit tonë.

I pakufishëm ka qenë besimi im te Partia, te anëtarët e Partisë, por nuk e di a mund ta kuptoni ju atë çka ndjej unë sot, kur marr kontakt në shkallë të gjerë me anëtarët e kuadrot e saj. Ndryshe do të kishin shkuar punët, sikur kjo gjë t'ishte bërë më parë.

Unë tani jam një njeri i ri me forca të përtëritura dhe të mëdha, të cilat do të vihen në shërbimin e Partisë sime, sepse ajo m'i dha këto forca. Momente të rënda janë këto nga ku kalojmë ne, por aq sa janë të rënda dhe të koklavitura momentet, aq më e fortë bëhet Partia jonë.

Parti revolucionare, Parti luftëtare është kjo e jona. Me kurajë, me heroizëm, me vendosmëri dhe pjekuri po i kapërcen pengesat dhe rreziqet, sido që këto s'kanë qenë të vogla.

Partia jonë po kalitet në luftë. Në këtë luftë ajo farkëton njerëzit e rinj, të devotshëm deri në vdekje për

kauzën e saj dhe të popullit, për kauzën e socializmit. Ç'po shoh unë te ky aktiv? Unë shoh Partinë tonë heroike, të gjallë, të pavdekshme, që lufton me vendosmëri kundër trockistëve jugosllavë që kanë kërkuar t'i bënin varrin Partisë dhe popullit tonë, kundër gabimeve dhe fajeve të rënda të disa kuadrove në Partinë tonë dhe me sa drejtësi, mprehtësi, intrasigjencë dhe kujdes të veçantë i ndihmon, u jep dorën njerëzve të sëmurë të saj, u jep dorën që t'i shërojë pse janë njerëzit e saj, gjaku i saj, bën të gjitha përpjekjet që t'i ndreqë dhe t'i futë në radhë, në luftën për ndërtimin e socializmit, për ndërtimin e jetës së re, t'i futë si njerëz të rilindur të Partisë, si njerëz të rinj.

Gjatë kohës heroike të luftës, kam shkuar nga aktivi në aktiv, kemi punuar tok për të ndërtuar Partinë tonë, për të forcuar luftën kundër okupatorit. Atëhere kemi qenë më të rinj, por nga lufta dhe nga vdekja s'kemi pasur kurrë frikë, Partinë e kemi dashur me gjithë shpirt.

Sot në këtë aktiv dhe në këto momente të vështira, nga ku kalon Partia, jemi po ne, që nga lufta dhe nga vdekja s'kemi frikë, që Partinë e duam me një dashuri të shumëfishuar, sepse kemi luftuar për të, në luftën më heroike që ka parë populli ynë, sepse me mijëra shokë tanë janë vrarë për Partinë, me Partinë në zemër. Por në këtë aktiv ne jemi më të pjekur, lufta e paresh-tur ka qenë për ne një shkollë e madhe dhe kjo na bën që këtë çështje kaq të madhe, kaq të rëndësishme dhe jetike, ta gjykojmë drejt, pa drojtje, t'i vëmë punët drejt dhe në vend, që të mos luhet më me jetën e Partisë dhe me interesat e shenjta të saj. Jo, shokë, unë jam

tani më se i bindur se s'do të ngjasin kurrë më gabime të tilla që ta dëmtojnë kaq rëndë Partinë. Partia s'do të lejojë kurrë më që ajo të dëmtohet qoftë nga udhëheqësi më i lartë ose nga anëtarë më i thjeshtë në rast se këta harrojnë dhe shkelin detyrat e tyre.

Partia do t'i luftojë pa mëshirë, të gjithë ata që nuk do të zbatojnë ose do të shtrembërojnë vijën e saj, parimet dhe normat e saja.

Mësimet e Leninit dhe të Stalinit po e udhëheqin Partinë tonë në rrugën e drejtë dhe ka njerëz me mijëra e me mijëra Partia jonë që ta mbrojnë këtë rrugë të drejtë. Letrat e Partisë Bolshevike qenë një ndihmë e madhe për Partinë tonë.

Unë u njoha në këtë aktiv me shokë, që s'i kisha parë kurrë, që s'i kisha dëgjuar kurrë si flisnin dhe si mendonin. Po jua them haptazi shokë, atë që mendoj. Kurrë s'jam ndjerë kaq i gëzuar. Shumë kam mësuar nga gjithshka thanë këtu shokët. Sa drejt mendojnë këta shokë dhe sa drejt e me kurajë e mbrojnë rrugën e drejtë të Partisë, sa e duan Partinë tonë, Partinë Bolshevike dhe shokun tonë të shtrenjtë Stalin!

Kam parë dhe dëgjuar shokë të tjerë, që i kam njohur pak ose ju kam njohur emrat dhe aktivitetin e tyre të raportuar nga shokët, të cilët i kanë pas parë nën prizma të sëmurë dhe pra me gjykime jo të shëndosha. Shokët kanë cene, kanë të meta, por jo ashtu si m'i kanë paraqitur. Si mundet këta njerëz, gjoja të sëmurë, të mbrojnë aq mirë, aq me zjarr, aq me drejtësi, pa pasione dhe me gjakftohtësi çështjen e madhe të Partisë?

Disa që e shohin shumë ngushtë dhe me paragjykimë kuadrin, s'mungojnë t'i përgjegjen kësaj pyetje duke

thënë se «janë demagogë ose oportunistë». Dhe një gjë e tillë mund të ngjasë, por unë u them këtyre: ngadalë, se pastaj e vramë kuadrin, e vdiqëm kuadrin, goditëm Partinë. Shokë që kanë një të shkuar të mirë, që kanë luftuar dhe luftojnë për Partinë, të mos i akuzojmë me kaq lehtësi si oportunistë dhe demagogë, por në qoftë se i kanë këto të meta, t'ua themi. Kuadri është pjesë jetësore e Partisë. Të gjykohet kuadri me aq lehtësi, me «parti pris», me pikëpamjet e sëmura të vjetra dhe me paragjykimet jo të shëndosha, kjo nuk lejohet më. Kjo mbaroi. Kuadri të vlerësohet nga besnikëria ndaj Partisë dhe kauzës së komunizmit, të vlerësohet nga zotësia dhe nga puna, etj. Udhëheqësit e Partisë duhet t'i njohin mirë kuadrot në luftë dhe në jetë, në zbatimin e direktivave të Partisë. Udhëheqësit e Partisë nuk duhet ta njohin kuadrin vetëm nga organet e posaçme që janë ngarkuar për këtë gjë pranë Komitetit Qendror, por duhet ta njohin dhe vetë personalisht.

Një udhëheqës, që qëndron larg kuadrit, s'mund të quhet një udhëheqës i shëndoshë, s'mund të bëjë dot mirë detyrën e tij; ai jo vetëm që duhet të bëjë përpjekje që ta njohë personalisht kuadrin, por duhet njëkohësisht ta ndihmojë, ta mësojë, të mësojë edhe ai vetë prej tij. Kjo gjë nuk ka qenë praktikuar drejt në Partinë tonë. Veçanërisht anëtarët e Komitetit Qendror edhe deri te unë, duhet të mbajmë kontakte të shpeshta me kuadrot e Partisë dhe jo vetëm me sekretarët e Partisë, me ministra e zëvendësministra, me shefa, por të krijojmë mundësitë e të mbajmë lidhje sidomos e medoemos me njerëzit e bazës së Partisë.

Shokët këtu folën shumë gjëra të mira, kritikuan drejt dhe me kurajë gabimet e njerit e tjetrit, dhanë ilaçin e përshtatshëm për shërimin e sëmundjeve. Këto qëndrime e mësimet do t'i shërbejnë shumë në radhë të parë, udhëheqjes së Partisë, por do t'i shërbejnë edhe gjithë Partisë.

Në radhë të parë udhëheqja e Partisë dhe shumë organizata të tjera të Partisë në rrethe të ndryshme, duhet të mësojnë shumë nga punimet e rëndësishme të këtij aktivi të organizatës së Korçës. Unë do t'ju them përshtypjet e mia që kam për këtë aktiv. Ky ka qenë në lartësinë e duhur në rrahjen e një çështjeje kaq të rëndësishme. Kam qenë i preokupuar dhe thoshja me vete a do të mund dot Partia ta kuptojë përnjëherësh këtë çështje të madhe dhe mjaft të koklavitur që po ngjet në Partinë tonë? A do të jemi dot ne në gjendje t'ja shtrojmë e t'ja bëjmë të qartë Partisë këtë gjë, në një kohë kaq të shkurtër, duke marrë parasysh kohën që na ndan nga kongresi?

Kisha të drejtë të shqetësohesha, sepse Kongresi ynë I i Partisë duhet të jetë një kongres i një partie të shëndoshë revolucionare dhe jo një kongres i një grupi, si grupi nacionalist Tito. Këtë s'mund të mos e mendoja, sepse ne sapo kishim dalë nga një sëmundje e rëndë, që na e kishte shkaktuar grupi i Titos. Duhej shëruar radikalisht kjo sëmundje e rëndë, që të shkonim në kongres të shëruar.

Tani, shokë, jam i bindur qind për qind se ne do të shkojmë të shëruar në kongres. Kongresi ynë do të jetë kongresi i një partie revolucionare, sepse Partia jonë është revolucionare, e tipit të ri leninist-stalinian. Aktivitet

që po bëjmë e provojnë këtë. Ju e kuptuat përnjëherësh shpejt dhe drejt këtë çështje kaq të rëndësishme të Partisë, e mbroni me aq zjarr jetën e Partisë, vijën e drejtë të saj, jetën e popullit tonë. Partia jonë po forcohet dhe kalitet dita-ditës në rolin e saj të avangardës. Shokë të Partisë, unë pashë këtu, në këtë aktiv, njerëzit e thjeshtë të Partisë sonë t'i thellojnë problemet dhe të ndjejnë përgjegjësitë e mëdha që kanë, të bëhen luftëtarët e papërkulur për mbrojtjen e Partisë, gjaku, mishi dhe koska e së cilës jeni ju. Pashë shpërthimin me tërë madhështinë e tyre të vendosmërisë, të vullnetit të Partisë për të rivendosur si duhet të gjitha parimet dhe normat e Partisë, që ishin ndrydhur, që ishin marrë nëpër këmbë, që ishin shkelur arbitrarisht. Tani të gjitha këto i rifitoi Partia jonë dhe s'do të ketë zot që t'ja rrëmbejë, t'ja shkelë ose t'ja shtrembërojë. Ne këto do t'i mbrojmë deri në vdekje dhe ne do të triumfojmë kundër kujtdo qoftë që do të guxojë edhe një herë të godasë Partinë tonë, unitetin, vijën e drejtë të saj, kundër cilitdo qoftë që do të guxojë të përcmojë ose të godasë qoftë edhe një grimë atdheun e parë të socializmit, Partinë e lavdishme Bolshevike të Leninit me në krye shokun tonë të shtrenjtë, të madhin Stalin.

Ju, shokë, jo vetëm që e kuptuat këtë problem të madh si duhet, por me një kurajë dhe pjekuri të madhe politike i shkuat çështjes deri në fund. Kjo është siguria për të ardhshmen. Partia jonë është e pavdekshme, ajo po ecën në rrugën e bolshevizimit. Interesat e Partisë mbi çdo gjë tjetër — kjo del nga çdo fjalë e juaj që thatë këtu dhe çdo diskutim i juaj tregon drejtësinë e

Partisë, forcën për mbrojtjen e Partisë, që është qëllimi i vetëm i jetës sonë.

Shokë, ne po shkojmë në kongres të armatosur dhe suksesi i kongresit është i siguar. Vullneti i plotë i Partisë sonë të pastër dhe të shëndoshë do të triumfojë, vija e Partisë do të jetë nga më të qartat, Komiteti Qendror, do të jetë një organ revolucionar, me një unitet të çelniktë, sepse do të zgjidhet nga gjiri i luftëtarëve revolucionarë të Partisë sonë.

Kongresi do të vulosë unitetin e vërtetë në udhëheqjen tonë dhe kjo do të jetë një nga fitoret e mëdha të Partisë sonë.

Diskutimet tuaja, sipas mendimit tim, ishin aq të mira, saqë pak gjëra kam për të theksuar dhe këto gjëra jo se ju s'i keni parë drejt, përkundrazi, por dëshiroj t'i theksoj edhe një herë.

Shumë shokëve mund t'ju jetë dukur se ka pasur një dozë ekzagjerimi në diskutimet e disave që kanë bërë kritikën e gabimeve që janë vërtetuar në praktikë. Sidoqoftë, edhe në këto raste, duhet të kemi parasysh se në zjarrin e diskutimeve kanë qenë të theksuara dashuria për Partinë, preokupimi për punën e Partisë dhe të popullit, qëndrimi luftarak kundër padrejtësive që bëhen.

Së pari desha të theksoj, se *çështja e sigurimit* duhet të kuptohet drejt nga gjithë Partia, sepse mund të ketë rreziqe në këtë drejtim. As ekzagjerime dhe qëndrime të gabuara nuk duhet të ketë nga ata që e kritikojnë sigurimin, por as prekje në sedër nga njerëzit e sigurimit nuk duhet të ketë.

Çështjen e gabimeve në vijën e sigurimit duhet ta shohim kurdoherë nga platforma e Partisë, pse po e pa-

më nga platforma personale, gabuam dhe dëmtuam rëndë Partinë dhe interesat e popullit.

Sigurimi është arma e mprehtë dhe e dashur e Partisë, sepse mbron interesat e saj dhe, pra, të popullit kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Si e tillë çdo anëtar i Partisë duhet ta dojë dhe ta ndihmojë Armën e Sigurimit me të gjitha mundësitë. Për popullin, nga ana tjetër, ajo duhet të jetë një nga armët më të dashura pse mbron interesat e tij. Në këtë drejtim sigurimi me punë dhe me sjellje të drejta duhet t'i forcojë çdo ditë pozitën e tija në popull. Nuk duhet të mendohet në asnjë mënyrë sikur Arma e Sigurimit kontrollon popullin, sepse po të mendohet kështu, vajhalli ynë. Sigurimi kontrollon armiqtë e Republikës dhe të Partisë sonë, dhe për armiqtë ai është tmerr.

Në sigurim janë vërtetuar gabime parimore, si edhe në praktikë. Sigurimi kontrollonte Partinë dhe njerëzit e saj. Nuk po zgjatëm këtu, sepse e keni të qartë. Tani ky gabim i madh parimor dhe gabimet në praktikë, duhet të kuptohen mirë nga gjithë Partia, në radhë të parë nga njerëzit e sigurimit, sidomos nga ata që i kanë bërë gabimet. Këto gabime kanë qenë të palejueshme, të rënda dhe të dëmshme. Këto gabime i dënuam rëndë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përsëriten.

Tani, në rast se shkojmë nga një ekstrem në tjetrin dhe nuk e shikojmë Armën e Sigurimit nga platforma e Partisë, do të gabojmë rëndë. Në qoftë se fillojmë ta shohim me bisht të syrit sigurimin, si një gjë të huaj dhe të dëmshme, atëhere e kemi dëmtuar Partinë, kemi dobësuar Armën e Sigurimit, e kemi hedhur tej nga gjiri i Partisë, larg nga ndihma e saj. Kjo është në fitim të

armikut. Një qëndrim i tillë mund të ketë dhe rreziqe të tjera, sepse në një gjendje të tillë, do të ketë dekurajim në njerëzit e sigurimit, të cilët do ta shohin veten të përbuzur, të mënjanuar, kështu këta do të hezitojnë në kryerjen e funksionit të tyre të rëndësishëm, kurse lufta kundër armikut do të dobësohet. Në këtë mënyrë ne do të çonim ujët në mullirin e armikut dhe do t'i bënim varrin vetes me duart tona.

Njerëzit e sigurimit duhet të njohin gabimet e tyre, të mos i përsërisin më, por duhet nga ana tjetër, të shtojnë besimin në veten dhe në punën e tyre, të jenë shumë vigjilentë, të mprehtë dhe të pamëshirshëm për armikun.

Njerëzit e Partisë duhet të dinë se Arma e Sigurimit është një armë speciale, që ka rregullat dhe sekretet e saja, që nuk mund t'i dijë kushdo. Në hollësi këto i di vetëm Komiteti Qendror. Komiteti i Partisë i rrethit dhe sekretarët do të mësojnë një sërë gjërash nga siguri, në ato drejtime që do të përcaktojnë KQ i Partisë. Sekretet e Sigurimit të Shtetit, nuk mund të bëhen punët e të gjithëve. Jo, këtë s'e lejon Partia. Duhet të dimë se njerëzit e sigurimit kanë misione të posaçme dhe s'ka pse t'i dijë çdo njeri.

Njerëzit e sigurimit të jenë modestë, po, të sjellshëm, po.

Së dyti desha të theksoj se *çështja e lokalizmit* që është shfaqur te puna e Koçi Xoxes, mund të bëhet shkak i një gabimi të rrezikshëm për Partinë tonë, në rast se nuk kuptohet drejt.

Do të gabonim në qoftë se çështjen e lokalizmit e konsiderojmë si një shfaqje tipike korçare dhe t'i kon-

siderojmë shokët komunistë korçarë të gjithë si lokalistë dhe që të mendojnë në këtë drejtim gabimisht si Koçi Xoxe. Po, do të bëjmë gabim në qoftë se mendojmë kështu. Një mendim i tillë i gabuar, do të krijojë një situatë të vështirë në Partinë tonë dhe do të lejojë në Partinë tonë të zhvillohet kjo frymë, për të cilën po e kritikojmë Koçi Xoxen. Para së gjithash, në Partinë tonë nuk ka komunistë korçarë, gjirokastritë, vlonjatë, etj., por ka vetëm komunistë shqiptarë dhe vetëm komunistë shqiptarë. Në Partinë tonë Komuniste nuk maten njerëzit e Partisë nga pozita që janë korçarë, shkodranë, durrsakë, etj., por maten nga lufta dhe puna për Partinë, maten nga besnikëria e tyre ndaj Partisë, ndaj çështjes së komunizmit, ndaj çështjes së popullit. Me i matë njerëzit e Partisë nga vendi e nga origjina e vendlindjes së tyre, do të thotë të largohesh nga uniteti i tërësisë në planin nacional. Me qenë lokalist, do të thotë të qëndrosh në pozita nacionaliste borgjeze në planin nacional. Ky është një devijim, që të çon në rrugë të gabuar, të bën të braktisësh pozitat internacionaliste edhe në shkallën më të gjerë ndërkombëtare.

Këtë gabim, në të cilin ra Koçi Xoxe, nuk mundet në asnjë mënyrë t'ua ngjitim edhe shokëve të tjerë të Korçës. Në asnjë mënyrë jo.

Shokë korçarë janë vënë në poste të rëndësishme të Partisë dhe të shtetit, ata i kanë merituar ato poste me besnikërinë e tyre, me luftën dhe me zotësinë e tyre. Por që Koçi Xoxe ka sjellë një pjesë nga këta kuadro në ato vende, nga që çështjen e kuadrit e ka parë nga platforma personale ose nga p'atforma sektare dhe lokaliste. kjo nuk mund të njollosë ndërgjegjen e pastër

të shokëve korçarë, që nuk mendojnë si Koçi Xoxe në këtë drejtim. Koçi Xoxe mund të ketë menduar dhe ka menduar të bëjë një politikë personale dhe në këtë politikë personale ai ka kujtuar se mund të ndihmohej prej shokëve korçarë, kurse këta të fundit, nuk kanë menduar kështu. Këtu s'duhet të bëjmë konfondime, sepse do të bënim gabime të rënda dhe do t'i sillnim kokëçarje Partisë, gjë që asnjë nga ne nuk dëshiron por, në të kundërtën, lufton që të mos ngjasë një gjë e tillë. Disa nga këta shokë korçarë, që janë sjellë ndër këto vende prej Koçi Xoxes, kanë bërë gabime, po gabime kanë bërë edhe të tjerë. Këto gabime të gjithë duhet t'i kuptojnë dhe t'i ndreqin. Në rast se ka shokë, dhe pa përmendur në se janë korçarë apo çfarëdo qofshin, që akoma janë në pozita të vjetra, akoma s'kanë arritur të kuptojnë gabimet e tyre, në rast se akoma ata e shohin Partinë nën prizmin personal, nën prizmin e lokalizmit, ose në rast se ka të atillë shokë, që ngurrojnë të njohin gabimet e tyre, ose kanë frikë t'i thonë, duke kujtuar se Partia «do t'i marrë me gurë», është në interesin e Partisë dhe të tyre që t'i braktisin shpejt ato pozita të gabuara, sepse po të mos dalin nga këto pozita të gabuara, atëhere Partia do t'i zërë me gurë, dhe kur ata të dalin nga ato pozita, Partia do t'u japë dorën dhe do t'i shërojë, do t'i bëjë njerëz të rinj dhe të vlefshëm, që t'i shërbejnë Partisë me besnikëri deri sa të vdesin.

Së treti, *çështja e Komitetit Qendror*. Pas këtyre gabimeve që janë vërtetuar në Partinë tonë dhe në udhëheqje, duhet të ruhemi nga disa pikëpamje të rrezikshme, që mund të shfaqen dhe të dëmtojnë rëndë Partinë dhe udhëheqjen e saj. E kam fjalën për disa kokë

të sëmura dhe antiparti që i karakterizon ndjenja e mosbesimit në udhëheqjen e Komitetit Qendror.

Anarkistët, që s'janë veçse trockistë dhe agjentë të imperializmit, kanë qëllim në radhë të parë të zhdukin udhëheqjen dhe format e qeverisjes së drejtë, me një fjalë të shndërrojnë dhe të shpartallojnë Partinë Komuniste, regjimin demokratik popullor dhe ta zëvendësojnë atë me regjimin e terrorit fashist dhe imperialist. Analizoni punën armiqësore të trockistëve jugosllavë. Qëllimi kryesor ka qenë me shemb udhëheqjen tonë, me forcë organin policor brenda dhe jashtë Partisë, me shkatërrue format organizative të shtetit dhe të Partisë sonë, me asgjësue fitoret e mëdha të luftës sonë. E tëra kjo do të thotë me likuidue Partinë dhe me e shndërrue Republikën tonë Popullore në një demokraci borgjeze nën thonjtë e imperializmit. Ky ka qenë synimi kryesor. Edhe veprimet e tyre janë zhvilluar në një rrugë të caktuar, në bazë të së cilës qëndronin provokacionet, shantazhet, terrori, frika, kërbaçi, shpifja, diskreditimet dhe vrasjet. Një punë e tillë antiparti në një shkallë kaq të gjerë, të mos gënjehemi se s'ka lënë gjurma të këqia, të mos na zërë gjumi dhe të mos themi që çdo gjë u ndreq menjëherë. Jo, duhet punë dhe vigjilencë e madhe, duhet ashpërsi e drejtë kundrejt shfaqjeve të gabuara nga ana e disa njerëzve që kanë lakra në kokë.

Ka disa njerëz, të cilët quhen komunistë, por që s'e meritojnë ta mbajnë këtë emër, që u duket e lehtë të ngrihen në aktiv, ose të flasin në çdo qoshe, gjoja në bazë të demokracisë në parti, të lirisë së fjalës e të shfaqjes së mendimeve, se «s'kam besim te Komiteti Qendror» se «s'kam besim te sekretari i Partisë» ose «te

ai o te ky anëtar i KQ». Po te kush e ka besimin ky «komunist»? Pa asnjë dyshim ky e ka besimin te reaksioni amerikan dhe anglez. Ky nuk është përveçse një trockist, një anarkist, një armik i Partisë.

Kur një komitet qendror partie tradhëton, atë parti e hedh poshtë dhe zgjedh një komitet të ri. Ky është një operacion shërimi dhe partisë i shtohet dashuria, besimi dhe besnikëria ndaj komitetit qendror të ri, dhe jo t'i errësohet dhe t'i pakësohet. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi.

Kur në një komitet qendror gabojnë një sërë shokësh, komiteti qendror i godit këta shokë, merr masa edukative kundrejt tyre dhe komiteti qendror spastrohet dhe shëndoshet. Ky është një operacion shërimi dhe partisë i shtohet dashuria e besimi dhe besnikëria ndaj KQ dhe jo t'i errësohet dhe t'i pakësohet. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi.

Disa njerëz, me qëllim, o pa qëllim, nga mungesa e një ngritjeje teorike të mjaftueshme, kujtojnë, për të theksuar lirinë e fjalës dhe të demokracisë së brendshme të Partisë, se bëjnë mirë që të përdorin me vend e pa vend fjalë të tilla si: «ne i japim grushtin edhe KQ», «ne e rrëzojmë dhe KQ» ose «KQ të rrijë urtë se mos i japim një grusht».

Të tilla shprehje, të thëna në këtë mënyrë, nuk janë të lejueshme në Partinë tonë. Këto janë trockiste. Kur bën gabim ndonjë anëtar i KQ, ose një pjesë e KQ, kritikohet, por në rrugën e drejtë, duke mbrojtur si tërësi Komitetin Qendror, unitetin e tij dhe njerëzit që e udhëheqin drejt këtë Komitet Qendror.

Komiteti Qendror është koka e Partisë, trupi pa

kokë nuk rron dot, ashtu si nuk rron dot koka pa trupin. Këto janë një.

Në rast se ndokush na ngrihet dhe hedh shqelma kundër KQ pa kurrfarë arsëye, vetëm për t'u treguar si shumë i zgjuar dhe gjoja se i paska kuptuar mirë normat e Partisë, ai s'është përveçse një antiparti.

Kur ka bërë gabim KQ, të kritikohet dhe ai është i detyruar ta ndreqë gabimin, të bëjë autokritikë përpara Partisë. KQ i Partisë është drejtimi, koka që udhëheq. Ta mbash atë nëpër gojë në çdo qoshe, me një mendjehetësi të çuditshme, do të thotë ta goditësh besimin ndaj Komitetit Qendror dhe ndaj Partisë, ndaj drejtësisë së vijës së saj dhe gjithë normave të saja. Kjo do të thotë të jesh një trockist-anarkist.

Nga këto pikëpamje, që janë të huaja për Partinë, dobësohet gjithë puna e Partisë, krijohet mosbesimi në direktivat e dala nga KQ; këndej rrjedh moszbatimi i urdhërave, i ligjeve, dyshimi në to. Krijohet konfuzioni, anarkia, shkelet centralizmi demokratik, s'ka më disiplinë të hekurt dhe të vetëdijshe, urdhërat e organeve më të larta nuk zbatohen nga organet më të ulëta. Çdo anëtar partie ka të drejtë të kritikojë dhe të bëjë vërejtjet e tija të drejta dhe të studjuara mbi një çështje, por direktivën e dhënë duhet ta zbatojë. KQ ose forumi më i ulët është i detyruar t'i marrë, t'i studjojë, t'i shqyrtojë këto vërejtje të shokëve dhe në rast se janë të drejta, të korrigjojë qëndrimin e vet, t'i bëjë korrigjimet e duhura direktivës që ka lëshuar. Kjo është ndihma e çmueshme që i jep Partia udhëheqjes së saj, e cila ushqimin e madh dhe të vetëm e ka të gjithë Partia. Por të gjitha këto procese duhet të zhvillohen

në këtë prizëm sipas parimeve të marksizëm-leninizmit mbi të cilat bazohet Partia jonë.

Në këto dallgë nga ku kaluan Partia jonë dhe KQ, detyra e të gjithë anëtarëve të Partisë është të mbrojnë drejt dhe fort prestigjin, autoritetin e KQ, se armiku kurdoherë këtu ka synuar dhe këtu do të drejtohet kurdoherë goditja e tij më e madhe.

DISA FJALË PËR KOÇI XOXEN,
PANDI KRISTON, E TË TJERË.

Koçi Xoxe i fsheh të vërtetën Partisë. Me këtë ai e dëmton rëndë Partinë, përveç dëmit që i ka shkaktuar asaj më parë. Një qëndrim i tij i tillë, kundrejt Partisë së vet, nuk është i denjë për një anëtar partie, por Koçi Xoxe nuk mund të përfaqësojë klasën punëtore, sepse një qëndrim i tillë e ndan përgjithmonë nga ajo klasë, që është baza e Partisë sonë.

Për të, është momenti t'i thotë vetes ndal dhe të bëjë një kthesë të menjëhershme për të mos dalë përgjithmonë nga binarët e marksizëm-leninizmit.

Koçi Xoxe duhet të realizojë dhe të jetë i bindur se gjithë puna e tij, që prej Beratit dhe deri sot, ka ngjyrën dhe metodat e theksuara të trockizmit.

Siç del nga analiza që bëmë dhe nga faktet e reja që sollët ju në diskutimet tuaja, Koçi Xoxe ka qenë solidar me trockistët jugosllavë në gjithë punën e tyre armiqësore kundrejt Partisë dhe vendit tonë.

Shokë, Byroja Politike e Partisë ka humbur një kohë të paçmueshme prej 5 muajsh dhe për këtë ka

përgjegjësi Koçi Xoxë e Pandi Kristo. Pesë muaj kemi luftuar në Byro që Koçi Xoxë e Pandi Kristo të njihnin gabimet e mëdha të tyre dhe të likuidohej kjo çështje e sëmurë dhe e rrezikshme. Këta akoma s'po binden dhe po vazhdojnë ta dëmtojnë rëndë Partinë. Letrat e PK (b) të BRSS na e ndritën krejt rrugën tonë. Partia në aktivet e saj të tanishme, më ndihmoi jashtëzakonisht të kem tani çdo gjë më të qartë.

Masat që duheshin marrë kundrejt Koçi Xoxes, Pandi Kristos, etj., i kam propozuar unë në KQ. Komiteti Qendror i diskutoi lirisht propozimet e mia dhe i pranoi pas një diskutimi të gjatë e jo duke ngritur gishtin, siç tha një shok këtu.

Masat që mori KQ kishin kurdoherë një karakter edukativ. Gjëja e parë ishte që këta të njihnin ndershmërisht gabimet e rënda të tyre, të bënin autokritikë bolshevike. Gjëja e dytë ishte që këta të hiqeshin nga ato funksione ku kishin gabuar.

KQ e ka për detyrë dhe këtu më duket se nuk gaboi, që të mos t'i flakte këta njerëz në rrugë, në rast se njihnin ndershmërisht gabimet e rënda të tyre, por t'i ndihmonte deri në fund, t'u jepte dorën bolshevike, dhe t'i tërhiqte nga buza e honit. Kështu na mëson shoku Stalin, t'i ruajmë kuadrot. Shihni sa me urtësi të madhe ka vepruar shoku Stalin dhe Partia Bolshevike në lidhje me udhëheqjen e PKJ! Edhe pas tri letrave që Partia Bolshevike u drejtoi trockistëve jugosllavë, me gjithë refuzimin e tyre kategorik për të marrë pjesë në mbledhjen e Byrosë Informative, kjo e fundit, para se të gjykonte çështjen «Mbi gjendjen në Partinë Jugosllave», e ftoi përsëri për të fundit herë udhëheqjen troc-

kiste jugosllave të vinte të merrte pjesë në mbledhje dhe aty të zgjidhej kjo çështje.

Kur unë kam bërë propozimet për masat kundrejt këtyre shokëve, kam pasë për qëllim të vetëm të ndihmoj Partinë dhe njëkohësisht t'i shpëtoj këta shokë për Partinë. Kam peshuar gabimet e tyre të rënda, por kam peshuar dhe armiqësinë e jugosllavëve. KQ dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të jenë të pamëshirshëm kundër atyre që gabojnë rëndë, por kurdoherë të matur dhe të drejtë, ashtu si na mëson Stalini. Duhet t'i shpëtojmë njerëzit, t'i shpëtojmë kuadrot, t'i ndihmojmë kuadrot, por «kjo ndihmë ka një kufi», thofë shoku Stalin.

Në lidhje me masat e marrura kundrejt tyre nga ana e KQ është thënë kudo nga Partia, në aktivet e ndryshme, se s'janë të rënda dhe Partia s'i pranon. Dhe këndej del, natyrisht, se ekziston në këtë çështje një dezakord në mes të Partisë dhe të KQ.

Kjo është e domosdoshme të sqarohet. KQ nuk ka qenë në pozita «mëshire» dhe «liberalizmi», kur mori këto masa kundrejt këtyre shokëve. Arësyet ishin ato që thashë më parë, dhe e dyta, sepse Koçi Xoxe, Pandi Kristo, u shfaqën «pa rezerva» solidarë me të gjitha punimet dhe vendimet e Plenumit XI. Ata pohuan se «s'kishin asnjë rezervë», sido që autokritika s'ishte në lartësinë e duhur.

Pas këtyre deklaratave, KQ rifilloi përsëri një kritikë kundrejt tyre, përse i përket autokritikës së tyre jo në lartësinë e duhur të udhëheqësve. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo prapë pohuan se KQ kishte të drejtë dhe premtuan se ata do të dalin përpara Partisë me një autokritikë të hapët, krejt të hapët.

Përsa i përket Kristo Themelkos, ai i njohu ndershmërisht gabimet e tij shumë më përpara nga mbledhja e Plenumit XI. Në Plenumin XI ai bëri një autokritikë të shëndoshë dhe shkoi përpara. Përsa u përket Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, deklaratat në Plenumin XI, s'ishin të sigjerta dhe në fakt autokritika e tyre përpara Partisë ka qenë dredharake, bile ka shkuar duke u dobësuar. Në aktivin e parë për këtë çështje në Tiranë, m'u bënë pyetje nga shokë aktivistë se ç'mendoja për autokritikën e Koçi Xoxes në Plenumin XI. U jam përgjegjur se Koçi Xoxe kishte hyrë në rrugë të mirë, por i duhej të bënte përpjekje të mëdha për të njohur mirë gabimet e tij të rënda. Pas pesë orëve, si thashë këtë mendim dhe pas autokritikës së Koçi Xoxes, unë isha në kundërshtim me autokritikën e tij. Koçi Xoxe në vend që të shkonte përpara, u praps. E kritikova personalisht dhe e këshillova për ta ndihmuar që të dalë sa më shpejt nga ky qorrrokak, e kritikova dhe hapët përpara aktivitet të Tiranës. Koçi Xoxe më tha se kisha të drejtë dhe se në Korçë ai do të fliste hapët.

Këtu ky u rezervua edhe ca më tepër. Më duket se KQ dhe unë e bëmë detyrën kundrejt Koçi Xoxes. Por edhe pas këshillave të KQ dhe të miat, por edhe sidomos pas zërit të fuqishëm të të gjithë Partisë, që e gjykoi çështjen e tyre me kaq gjakftohtësi dhe drejtësi, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo mbetën në rrugë të shtrembër dhe të gabuar. Natyrisht pas aktiveve e diskutimeve në parti u krijuan situata të reja, të ndryshme nga ato kur KQ mori vendimin për ato masa, për ato momente, për ato rrethana dhe me ato qëllime që thashë.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo i muarën qëllimet e larta edukative të KQ si një dobësi nga ana e KQ dhe jo si një ndihmë e vërtetë, që u jepej atyre dhe, duke qëndruar kurdoherë në pikpamjet e vjetra, ata kujtuan se kjo çështje kaq e madhe do të kalonte me lehtësi në Parti, se Partia do t'i pranonte pa diskutim vendimet në lidhje me masat që kishte marrë KQ kundrejt tyre. Ata qëndronin në pozitat e vjetra të konsiderimit të Partisë jo si një organizatë vetëvepruese, por si një detashment partizan. Këta të dy janë larg dhe nuk i kanë kuptuar si duhet letrat historike të Partisë bolshevike. Njëkohësisht, duke pasur këto pikëpamje kundrejt Partisë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo në vend që të bënin përparime në autokritikën e tyre, bënë shumë hapa prapa.

Por ç'rezultoi nga kjo taktikë e tyre? Në këtë taktikë këta i dhanë përsëri një grusht Komitetit Qendror, përsëri kryen një veprim me ngjyra të theksuara troc-kiste. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, nga një anë e gënijn Plenumin XI me premtime, se do të thelloheshin në analizën e gabimeve të tyre e do të bënin autokritikë të shëndoshë përpara Partisë, nga ana tjetër u munduan ta nxirrnin veten të larë në të ashtuquajturën autokritikë në aktivet e Partisë, duke menduar se do të gjenin aty përkrahje. Aktivet, në të kundërtën, pas fakteve të reja që dolën mbi veprimtarinë antiparti të Koçi Xoxes, kërkuan me të drejtë masa më të rënda nga ato që kishte marrë KQ. Por kjo i la shteg të mendohet se KQ ka qenë në pozita oportuniste. Kështu deri në fund Koçi Xoxe e Pandi Kristo e kanë goditur drejtësinë dhe prestigjin e KQ.

Jo, Komiteti Qendror s'ka qenë në pozita oportuniste, kur ka marrë ato masa edukative kundrejt këtyre anëtarëve të tij. Ato masa karakterizojnë drejtësinë e madhe të Komitetit Qendror, për ta ruajtur Partinë, për ta spastruar e shëndoshur atë, për të shpëtuar kuadrot kurdoherë në interesin e Partisë.

Por unë jam qind për qind i sigurt, se Komiteti Qendror, pas qëndrimit negativ të këtyre anëtarëve, s'mund të qëndrojë aspak në ato pozita, që disa kohë më parë kanë qenë të drejta, por që në situatat e reja duhet të ndryshohen. Kjo situatë lyp masa të tjera më të rënda. Unë jam plotësisht i bindur se KQ ka qenë dhe do të jetë qind për qind me Partinë dhe s'do të ketë forcë që ta shpartallojë këtë unitet të çelniktë të Partisë sonë dhe të Komitetit Qendror.

Përsëri unë u kujtoj Koçi Xoxes, Pandi Kristos e të tjerëve, ta dëgjojnë zërin e fuqishëm të Partisë që i këshillon të ecin në rrugën e drejtë, të dëgjojnë këshillimet e urta të Komitetit Qendror dhe të kthehen përnjëherë, urgjentisht, në rrugën e drejtë të Partisë¹.

Të gjitha forcat tona t'i vëmë pa asnjë rezervë deri

¹ Koçi Xoxe e Pandi Kristo jo vetëm nuk u kthyen në rrugën e Partisë, por e thelluan edhe më shumë qëndrimin armiqësor duke u përpjekur t'ua fshihnin komunistëve dhe popullit fajet e tyre të mëdha. Ndërkaq u zbuluan fakte të reja rreth këtyre fajeve, që shkonin deri në krime të shëmtuara. Në bazë të të gjithë këtyre fakteve Kongresi I i PKSH i përjashtoi nga Partia, kurse gjykata popullore, pasi shqyrtoi krimet e tyre, i dënoi si armiq të popullit. Koçi Xoxe si përgjegjës kryesor mori ndëshkimin më të rëndë.

në vdekje në shërbim të Partisë sonë, që ajo të ecë kurdoherë në rrugën e lavdisë, në rrugën e Partisë së lavdishme Bolshevike, në rrugën që na tregon shoku ynë i shtrenjtë Josif Visarionoviç Stalin.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
originalit që gjendet në Ar-
kivin Qendror të Partisë*

**RAPORT NË KONGRESIN I TË PKSH
«MBI PUNËN E KOMITETIT QENDROR DHE
DETYRAT E REJA TË PARTISË»**

8 Nëntor 1948

I

**LUFTA E POPULLIT DHE E PARTISË KOMUNISTE TË
SHQIPËRISË PËR ÇLIRIM**

Shokë,

Dje, Partia jonë dhe populli ynë festuan me entuziazmin më të madh dhe me mirënjohje të pakufishme përvjetorin e Revolucionit të madh të Tetorit dhe shprehën dashurinë e besnikërinë e tyre të madhe ndaj atdheut të lavdishëm të socializmit, ndaj Partisë së madhe Bolshevike dhe shokut të madh Stalin, pse me ta janë të lidhura fitoret që kanë korrur Partia jonë dhe populli ynë, liria e pavarësia, vendosja e regjimit demokratik popullor dhe shkuarja me hapa të sigurtë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Populli ynë i vogël, gjatë gjithë historisë së tij ka luftuar pa pushim dhe ka derdhur gjak për të këputur zinxhirët e robërisë që i kishin hedhur imperialistët e ndryshëm gjakpirës. Me Heroin tonë Kombëtar në krye, Gjergj Kastriotin — Skënderbeun — populli ynë luftoi me heroizëm të shquar për një çerek shekulli. Ai kurdoherë dilte fitues mbi hordhitë e imperatorisë otomane, sepse ai luftonte për lirinë, për pavarësinë, për tokën. Luftërat e popullit shqiptar janë shtypur me gjak nga imperialistët e ndryshëm; populli ynë është bërë monedhë shkëmbimi prej tyre. Shqipëria jonë përdorej prej imperialistëve për të kënaqur etjet e shërbëtorëve të tyre. Por populli ynë, nëpërmjet kaq fatkeqësive e mjerimeve të panumërta, intrigave e kërcënimeve, nuk e përkuli kurrë kurrizin. Vullneti i tij i hekurt për të fituar lirinë qëndroi kurdoherë lart si malet tona dhe u rezistoi valëve të tërbuara të armiqve, ashtu si malet tona u rezistojnë kohëve dhe stuhive. Populli ynë ka qenë i vetmuar në përpjekjet e tija dhe drita e shpëtimit lindi për të, kur triumfoi Revolucioni i madh i Tetorit. Që në atë kohë aguan shpresat e lirisë te populli ynë dhe populli ynë shikoi që atëhere dhe do të shikojë tërë jetën e tij nga Revolucioni i madh i Tetorit. . . Regjimet antipopullore dhe shkelësit e vendit tonë u përpoqën me të gjitha mjetet që drita e madhe e Revolucionit të Tetorit të mos depërtonte në errësirën mesjetare që mbulonte popullin tonë; por asgjë s'i pengoi idetë e lavdishme të Revolucionit të Tetorit, veprën e pavdekshme të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit të hynin në vendin tonë, të ngjallnin e të forconin në njerëzit e thjeshtë të popullit tonë besimin në luftën kundër sa-

trapëve dhe ta forconin këtë luftë dita-ditës, derisa populli t'ua mbërrinte qëllimeve të tij, të arrinte në ditën e sotme. Patriotizmi i popullit tonë, që kurrë s'ishte shuar gjatë historisë së tij, pas Revolucionit të madh të Tetorit hodhi themele të çelnikta...

Reperkusionet e thella të Revolucionit të madh të Tetorit, madhështia e ideve të Leninit dhe të Stalinit, drejtësia e pavdekshme e popullit, që vendosej në një të gjashtën e botës, e zgjuan popullin tonë, i shtuan besimin e tij në fitoren e ardhshme dhe tanimë ai e kuptoi se për të fituar, duhej të luftonte më me heroizëm. Shtresat e gjera të fshatarësisë sonë të varfër, punëtorja jonë, që vuante në mjerim e nën kërbaç dhe inteligjencia patriote, forcuan ndërgjegjen e tyre. Në shkollën e Revolucionit të madh të Tetorit u përgatitën masat punonjëse të popullit tonë për luftë kundër feudalizmit, kundër imperializmit, kundër kapitalit, si dhe kundër shfrytëzimit e shtypjes shekullore. Në shkollën e madhe të Revolucionit të Tetorit u edukuan revolucionarët e vendit tonë që do të organizonin rezistencën kundër regjimit shtypës të Ahmet Zogut. Në shkollën e Revolucionit të madh të Tetorit, në bazat e shëndosha të marksizëm-leninizmit, në bazë të mësimëve të mësuave të lavdishëm të proletariatit ndërkombëtar, Marks-Engels-Lenin-Stalin, u themelua, u çelnikos dhe luftoi me heroizëm Partia jonë, që çoi popullin shqiptar në fitoret më të mëdha që ka parë në historinë e tij... Revolucionit i madh i Tetorit i dha hov lëvizjes demokratike në vendin tonë dhe influenca e tij ishte direkte dhe e madhe në luftën e Vlorës, në Kongresin e Lushnjës dhe në Revolucionin e Qershorit të 1924-s. Kur

gjithë bota imperialiste i kishte shpallur luftë Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, në një vend të vogël e me male, të Ballkanit, në vendin tonë, parlamenti shqiptar mbajti zi për vdekjen e të madhit Lenin, kurse qeveria demokratike e asaj kohe¹ vendosi marrëdhënje diplomatike me qeverinë sovjetike. Me këtë mënyrë, përballë Evropës reaksionare, populli i vogël shqiptar shfaqte me guxim dashurinë e tij ndaj popullit sovjetik, ndaj regjimit socialist. Një gjë e tillë i shqetësoi shtetet imperialiste të Evropës dhe të Ballkanit, sepse kërcënonte pozitën e imperializmit në një pikë të vogël të fushës së gjerë të intrigave të tyre, por në një pikë nevralgjike.

GJENDJA E MJERUESHME E POPULLIT GJATË REGJIMIT TË ZOGUT

Përpara këtij rreziku, më 24 dhjetor 1924, imperialistët anglezë, amerikanë, italianë, jugosllavë e të tjerë, duke përdorur rusët e bardhë të Vrangelit², reaksionarët shovinistë serbo-kroatë dhe duke organizuar nga brenda feudalët e spiunët, vunë me forcë në krye

¹ Është fjala për qeverinë e kryesuar nga Fan Noli që erdhi në fuqi si rezultat i fitores së Revolucionit demokratik të Qershorit të vitit 1924.

² Mbeturina të ushtrisë cariste të komanduara nga gjenerali Vrangeli, që u vendosën në Jugosllavi pas disfatës së tyre në Rusinë Sovjetike. Këto forca muarën pjesë tok me ushtrinë monarkiste Jugosllave për të sjellë në fuqi Ahmet Zogun.

të shtetit shqiptar agjentin e tyre Ahmet Zogun, shtypën lëvizjen demokratike, vendosën terrorin dhe shfrytëzimin kapitalist. Përpara këtyre ngjarjeve imperialistët italianë, jugosllavë dhe në radhë të parë ata anglezë detyruan ministrin sovjetik të largohet nga Tirana.

Mbi kurrizin e popullit shqiptar imperialistët vendosën regjimin gjakatar të Zogut, regjim satrapësh, regjim i «portës së hapur» dhe i kapitullimit pa kushte përpara ndërhyrjes së huaj imperialiste.

Politika e jashtme e regjimit të Zogut determinohej kryesisht nga këta faktorë:

a. Nga sundimi i klasës feudalo-borgjeze, shtypëse, shfrytëzuese, hajdute, armike e betuar e popullit dhe shërbëtore besnike e imperializmit.

b. Nga një ekonomi shumë e prapambetur, e keqësuar nga shkatërrimet e Luftës së parë botërore dhe e shtrydhur pa mëshirë nga klasa sunduese e kapitali i huaj, gjë që forconte shtypjen dhe shtonte mjerimin e popullit tonë.

c. Nga kontradiktat dhe pazarllëqet e fuqive imperialiste, të mëdha e të vogla (Itali, Gjermani, Angli, Amerikë, Jugosllavi, Greqi), në kurriz të Shqipërisë, për shkak të pozitës së saj të privilegjuar në Adriatik dhe mbi kanalin e Otrantos si edhe për qëllime shfrytëzimi ekonomik të pasurive të nëntokës dhe të mbitokës.

Një politikë e determinuar nga faktorë të tillë dhe e ndjekur në mënyrë konsekuente dhe barbare nga regjimi i Zogut ishte kundër interesave jetike të popullit tonë dhe çonte me siguri në humbjen e independencës

dhe të sovranitetit kombëtar, sikundërqë ngjau më 7 prill 1939.

Politika e jashtme e Zogut ishte krejt antipopullore dhe antishqiptare. Ahmet Zogu dhe klika e tij kishte për qëllim që, me ndihmën e huaj të forconte brenda regjimin e tij satrap dhe kusar, të pasuronte veten dhe klikën e tij, natyrisht, duke shfrytëzuar deri në palcë popullin shqiptar dhe duke e shitur më në fund Shqipërinë të huajt. Kurrë Zogu dhe regjimi i tij nuk luftoi për të mbrojtur interesat në lëmin ndërkombëtar dhe pavarësinë e Shqipërisë; ai jo vetëm s'kërkoj zbrazen, por njohu, de fakto, okupacionin e Sazanit nga Italia dhe, si shpërblim për ndihmën që mori nga Pasiçi¹ më 1924, i dha Jugosllavisë Shën Naumin dhe një pjesë të Vermoshit; ai nuk punoi për zhdukjen e vendimit të 9 nëntorit 1912 të Konferencës së ambasadorëve që i njihte Italisë një pozitë të privilegjuar në Shqipëri dhe që ishte një akt ndërkombëtar poshtërues për popullin tonë e në kundërshtim me statusin juridik të Shqipërisë si shtet i pavarur. Asnjëherë nuk ngriti zërin për të mbrojtur e për të forcuar pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, por ai i vuri kazmën kësaj, duke krijuar grindje me fqinjët, me qëllime armiqësore e në interes të Italisë fashiste. Në kundërshtim me ndjenjat dhe

¹ Pasiç (Nikolla), (1845-1925), udhëheqës reaksionar i borjezisë serbe. Kryeministër i Serbisë dhe më vonë i Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene (Jugosllavisë). Shovinist i tërbuar dhe armik i betuar i kombit shqiptar. Përgjegjës për masakrat e kryera kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit, të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Ndihejmoi për ardhjen në fuqi të Zogut më 1924.

interesat e popullit shqiptar, Zogu dhe regjimi i tij, ndihmoi agresorët fashistë në Abisini dhe në Spanjë. Me shpifje të poshtra dhe me terror brenda, Zogu dhe regjimi i tij i bënte një luftë të egër Bashkimit Sovjetik. Zogu dhe regjimi i tij me plot ndërgjegje ja hapi fashizmit italian dyert e Shqipërisë dhe pregatiti 7 prillin.

Zogu e orientoi politikën e tij ndaj imperializmit në përgjithësi dhe ndaj fashizmit italian në veçanti dhe ai e klika e tij gjakpirëse, e korruptuar dhe shfrytëzuese gjetën përkrahjen e tyre, pse politika e tij mercenare, politika e klasës feudale dhe borgjeze pajtohej krejt me qëllimet e imperialistëve dhe ai s'ishte veçse një vegël e bindur e këtyre të fundit.

Në fillim Zogu luajti politikën e «portës së hapur» dhe lidhi traktate e akorde me shumë shtete, sidomos me Anglinë, Amerikën, Jugosllavinë, Greqinë dhe Italinë. Ç'qëllime kishin këto shtete ndaj Shqipërisë?

Karakteristikë e përbashkët e këtyre qëllimeve ishte zotërimi i bregdetit tonë, që sundon kanalin e Otrantos dhe shfrytëzimi i pasurive tona natyrore. Anglo-amerikanët me anë marrëveshjesh ekonomike, synonin ta transformonin vendin tonë në një bazë sundimi dhe penetracioni imperialist në Ballkan; Jugosllavia me Greqinë synonin ndarjen e Shqipërisë në mes të tyre, kurse Italia aneksimin e plotë të Shqipërisë. Që të gjithë, pra, kishin për qëllim zhdukjen e Shqipërisë si shtet independent e sovran dhe skllavërimin e popullit tonë.

Ahmet Zogu, armik i betuar i popullit shqiptar, duke shqelmuar interesat jetike të popullit tonë dhe për të përmbushur interesat personale e të klikës së

tij, e nxori Shqipërinë në ankand dhe, në bazë traktatesh, ai e padronët e tij imperialistë, i ndanë kokrra-kokrra pasuritë e vendit tonë: fushat e malet tona, minierat e skelat, pyjet e ujërat tona, duke marrë kështu nëpër këmbë e në mënyrë brutale, pavarësinë e vendit dhe interesat jetike të masave punonjëse të Shqipërisë.

Me akordet tregëtare dhe marrëveshjet e tjera Zogu u njohu këtyre shteteve trajtimin e «kombit më të favorizuar»¹, gjë që lehtësonte shumë hyrjen e kapitalit të huaj në Shqipëri.

Zogu i dha Anglisë dhe veçanërisht «Anglo-Persian Oil kompani» pothuaj gjithë monopolin e shfrytëzimit të naftës në Shqipëri. Zogu përfundoi me Anglinë më 1925 një marrëveshje tregëtare provizore, e cila më 1931 u zëvendësua me një traktat lundrimi e tregëtie në bazë të «reciprocitetit» dhe të «kombit më të favorizuar». Se ç'kuptim kanë këto fjalë, mjafton të përmendet se më 1933, brenda 9 muajve, Shqipëria importoi nga Anglia 36 000 sterlina mall dhe eksportoi në Angli vetëm 37 sterlina mall.

Ministri anglez në Shqipëri, Sër Robert Hoxhson (1928-1936), këshilltar intim i Zogut, zbatoi me besnikëri politikën antishqiptare të qeverisë së tij. Në këtë kohë Anglia me Italinë kishin ndarë zonat e influencës së tyre dhe «Anglo-Persian Oil kompani» më 1932 koncesionet e vajgurit ja shiti shoqërisë AIPA. Ministri anglez

¹ Në bazë të këtij parimi, në marrëdhënjet ndërkombëtare njëra palë i krijon palës tjetër kushte favorizuese. Shtetet imperialiste e përdorin këtë parim si armë për gllabërimin ekonomik të shteteve të vegjël dhe të dobët, duke siguruar lehtësira të njëanshme.

Hoxhson e përdorte Shqipërinë si monedhë shkëmbimi dhe, në bashkëpunim me Zogun, e shisnin vendin tonë te Italia. Imperializmi anglez, me anën e oficerëve të tij pranë Zogut, mbante tok me këtë, kamxhikun, burgun dhe litarin për të shtypur çdo lëvizje të popullit shqiptar. Kjo zgjati deri më 1939, kur Anglia dhe Çambërleni i lanë krejt dorë të lirë Italisë fashiste që të kryente agresionin e armatosur të 7 prillit 1939.

Më 28 dhjetor 1925, Zogu i dha formë ligjore letrës së 25 qershorit 1922 të qeverisë shqiptare drejtuar SHBA-së. Me anën e kësaj letre Amerikës jo vetëm i njihej trajtimi i «kombit më të favorizuar», por praktikisht i jepeshin çelësat e Shqipërisë. Kjo letër është një nga dokumentat më të turpshme dhe më të rrezikshme për pavarësinë e vendit tonë. Amerika kurrë nuk ja njohu Shqipërisë të drejtën e «kombit më të favorizuar» dhe më 1926 Zogu e uli përsëri tarifën doganore për importimet amerikane, kurse mallrat e pakta shqiptare, që eksportoheshin në Amerikë, nuk gëzonin trajtim të njëjlojtë. Më 29 qershor 1925, Zogu i dha me qira për dy vjet «Standard Oil kompani of Nju Jork» 51 000 hektarë tokë për 30 000 dollarë.

Qeveria e Zogut përfundoi një sërë akordesh dhe traktatesh konsullore si dhe një traktat pajtimi me qeverinë e SHBA-së, megjithëse, siç pohon vetë ajo, nuk ishte e shtytur aq nga rregullimi i çështjeve, sa nga dëshira që t'i përgjigjej propozimit dhe kërkesës së qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Zogu u hapi derën agjentëve të spiunazhit amerikan, të cilët vinin në formën e misionarëve si Kenedi, të filantropëve dhe edukatorëve si Erikson, që mori

koncesionin e shkollës së Kavajës dhe si Herri Fulc, drejtor i shkollës teknike, kuadër me rëndësi i shërbimit informativ amerikan dhe armik i tërbuar i popullit shqiptar. Të gjithë këta dhe të tjerë, jo vetëm bënë punën e informatorit, por, sikundër dëshmuuan edhe më vonë sabotazhet e Maliqit, të Kuçovës, gjyqi i deputetëve tradhëtarë, etj., ata kishin përgatitur njerëzit e tyre, për të punuar në të ardhshmen kundër Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Imperialistët anglo-amerikanë kurdoherë kanë qenë dhe janë armiq të egër e të vendosur të popullit dhe të vendit tonë. Ata e kanë përdorur Shqipërinë gjithmonë si monedhë shkëmbimi për transaksionet e tyre ndërkombëtare. Me anën e Zogut ata tentuan të nënshtronin direkt Shqipërinë nga ana ekonomike, politike ushtarake, por gjetën konkurentë, dhe në radhë të parë Italinë fashiste. Edhe këtë herë si gjithnjë ata e përdorën Shqipërinë si monedhë shkëmbimi duke i lënë dorë të lirë Italisë në Shqipëri. Por ngjarjet e mëpas-tajme treguan se ata kurrë nuk hoqën dorë nga qëllimet e tyre ekspansioniste ndaj Shqipërisë.

Greqia dhe Jugosllavia, me anën e traktateve dhe të akordeve ekonomike e konsullore, u përpoqën të realizonin qëllimet e tyre politike në Shqipëri. Që të dyja (Jugosllavia më 22 qershor 1926 dhe Greqia më 13 tetor 1926) nënshkruan me qeverinë e Zogut traktate tregëtie dhe lundrimi me klauzolën e «kombit më të favorizuar». Për Jugosllavinë traktati shënonte avantazhe të dukshme ekonomike, se ai i lejonte kësaj shfrytëzimit e tregjeve shqiptare të Veriut (Shkodër, Tropojë, Kukës) e të Liqenit të Shkodrës, si dhe i jepte avantazhe

strategjike me të drejtën e lundrimit në liqen e në Bujanë dhe mundësinë për një aktivitet politik intensiv kundër shtetit shqiptar. Shkëmbimet kryesore ekonomike me Greqinë bëheshin në rrjetin Janinë-Gjirokastrë dhe Selanik-Korçë, domethënë në të dy krahinat e rivendikuara nga Greqia.

Qeveria e Zogut përfundoi edhe mjaft akorde konsullore dhe administrative me këto vende dhe që të gjitha preknin në mënyrë të dukshme interesat e Shqipërisë.

Problemi i minoriteteve ka qenë një «mollë sherri» midis vendit tonë nga njëra anë dhe Greqisë e Jugosllavisë nga ana tjetër dhe është përdorur nga të dy palët për të armiqësuar popujt tanë njëri me tjetrin.

Jugosllavia me Greqinë, duke përdorur rivendikime tokësore, akte agresive e terroriste dhe marrëveshje ekonomike e konsullore, janë munduar të copëtojnë Shqipërinë si shtet i pavarur. Regjimi i Zogut, vegël e fashizmit, ka pasur si një nga gurët themelore të politikës së tij, urrejtjen kundër serbit e grekut. Kjo politikë ka bërë punën e fuqive të mëdha imperialiste që e konsideronin Ballkanin si fuçi baruti, së cilës i vinin zjarrin sa herë që u leverdiste.

Marrëdhënjet ekonomike të Shqipërisë me Anglinë, SHBA-në, Greqinë dhe Jugosllavinë rreth vitit 1930 ranë për shkak të krizës së përgjithshme që shpërtheu në botën kapitaliste, për shkak të ndarjes së zonave të influencës midis fuqive të mëdha imperialiste dhe, sidomos, për shkak të penetrimit absolut të kapitalit italian në Shqipëri. Regjimi i Zogut u bë vegël direkte e fashizmit italian dhe i hapi këtij gjithë dyert për koloni-

zimin e Shqipërisë, për agresionin e 7 prillit, për dorëzimin e vendit në mënyrë të turpshme dhe tradhëtare të armiqtë e betuar të popullit tonë, të fashistët italianë.

Zogu u bë vasal i Musolinit. Si shpërblim, ky i fundit më 1928, e bëri mbret kundër vullnetit të popullit dhe Zogu hyri në shërbim direkt të Musolinit. Ambasadori i Italisë fashiste në Tiranë ishte sunduesi i vërtetë. Të gjitha traktatet dhe marrëveshjet e Zogut me Italinë fashiste kishin një objektiv: kolonizimin e Shqipërisë.

Me marrëveshjet ekonomike e financiare dhe me traktatet e aleancës, Italia fashiste në krye të pak vjetëve, arriti jo vetëm të shtinte në dorë gjithë pasuritë tona të mbitokës dhe të nëntokës, por praktikisht ta mbyste vendin tonë dhe ta detyronte popullin shqiptar që, edhe për kokrrën e misrit, të vështronte nga Italia. Kurrë ndonjëherë populli ynë nuk vuajti nga një varfëri aq e madhe dhe nga ofendimet e të huajve aq të poshtra, sa nga fashizmi italian nën regjimin kriminal të Zogut.

Tregëtinë, blegtorinë, pyjet, minierat, bujqësinë, financat, postat, komunikacionet detare dhe ajrore, gjithshka, Zogu ja shiti Italisë. Me traktatin e tregëtisë dhe të lundrimit të vitit 1924, ratifikim që hyri në fuqi më 29 janar 1926, tregu shqiptar u bë treg italian; prodhimet italiane u përjashtuan nga taksat, shtetasit italianë kishin të drejtë të bënin tregëti në Shqipëri. Tregëtia jonë e jashtme u bë monopol i kapitalit italian. Me konventën për organizimin e skelës së Durrësit, porti ynë i parë ra në duar të italianëve dhe bashkë me Vlorën dhe Sazanin u kthyen, nga Italia, në baza për sundimin e Shqipërisë.

Një rrjet i gjerë shoqërisht shfrytëzimi italiane shtrinë thonjtë e tyre mbi vendin tonë, në bazë të koncesioneve kapitulluese që u bëri Zogu: SVEA (Società Valorizzazione Economica Albania) që e para që, me një borxh minimal prej 50 milion franga ari, më 15 mars 1925 nguli dhëmbët e helmatorit të kapitalit italian në trupin e Shqipërisë; AIPA (Azienda Italiana Petrolii Albania) thithi gjakun e ekonomisë sonë, vajgurin; EIAA (Ente Industria Attività Agrarie) mori në koncesion tokat e gjera të Sukthit dhe të Rushkullit për 99 vjet, praktikisht u bë pronare e tyre dhe krijoi skelë më vete në Porto Romano, duke i shpëtuar çdo kontrolli të qeverisë kukull të Tiranës. Të tjera shoqëri shfrytëzonin transportet, pyjet, minierat e kromit e të hekurit, serën e Selenicës, etj. I gjithë aparati i tyre i gjerë përbëhej jo vetëm nga kusarë me çizme, që vidhnin dhe pinin gjakun e popullit tonë, por nga agjentë të stërvitur të SIM-it dhe të OVRA-s, të cilët ditën e agresionit të 7 prillit dolën hapët me uniformat e tyre fashiste.

Akordet për krijimin e «Bankës Kombëtare të Shqipërisë», huaja prej 100 milion franga ari në dhjetë vjet (1931), akordi për sistemimin e financave të shtetit shqiptar, huaja bujqësore prej 10 milion franga ari, huaja për krijimin e monopolit të duhanit, qenë shpërblimi që i dha fashizmi italian klikës qeveritare të Zogut për të marrë tapitë e Shqipërisë, për të kolonizuar vendin tonë; ato mbushën xhepat dhe shtuan kapitalet e Zogut me shokë në bankat angleze e zvicerane, kurse popullin tonë e çuan në buzën e varrit: tregëtia vdiq, bujqësia vdiq, industria nuk ekzistonte, pse nuk u leverdiste kapitalistëve italianë që të ngrihej. Në këtë periudhë në

vendin tonë u vërtetuan dhe vdekje nga uria. Vetëm klika feudalo-borgjeze e Zogut, e cila paguhej për këto krime, rronte në lukse dhe në pallate.

Ndërhyrja e fashizmit italian u bë më brutale dhe më e egër pas traktateve të Tiranës («Traktati i miqësisë dhe i sigurimit midis Shqipërisë dhe Italisë», 27 nëntor 1926 dhe «Traktati i aleancës difensive midis Shqipërisë dhe Italisë», 22 nëntor 1927), të cilët e vunë hapët Shqipërinë nën protektoratin e Italisë. Artikulli 2 i traktatit të 1927-s thotë: «Dy palët e larta kontraktuese do të përdorin të gjithë kujdesin dhe mjetet e tyre për të garantuar sigurimin e shteteve të tyre».

Një klauzolë e tillë i hapte portën ndërhyrjes ushtarake italiane; mjaftonte një provokacion i vogël, nga ana e fashistëve shqiptarë dhe i kurdisur nga fashistët italianë, për të krijuar rastin e volitshëm. Dhe Italia e tentoi këtë provokacion me «kryengritjen» e Ethem Totos më 1937. Kjo aleancë i jepte fund publikisht pavarësisë së Shqipërisë. Ministritë ranë në duart e italianëve dhe në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë mbi organizimin ushtarak të Shqipërisë (1936), ushtria u vu nën kontrollin e italianëve; çdo plan vinte nga Roma dhe dihej nga Roma. Sazani, i mbajtur me forcë nga Italia që në Luftën e parë botërore dhe Durrësi, u fortifikuan nga italianët dhe, në bazë të planeve të italianëve e nën drejtimin e tyre u ndërtuan aerodrome, u bënë fortifikime në kufi me Jugosllavinë dhe me Greqinë. Gjithashtu armatimi i ushtrisë mbretërore ishte italian dhe këta dinin edhe sa fishekë kishte çdo ushtar shqiptar. Të gjitha këto shpunë në kapitullimin e turpshëm të ushtrisë mbretërore më 7 prill 1939 përpara agresionit fashist.

Në shkolla u bë i detyruar mësimi i gjuhës italiane, u hapën shkolla profesionale dhe fetare italiane; të dërguarit e Partisë Fashiste Italiane hodhën bazat e një partie fashiste shqiptare me elementët më të korrup-tuar të vendit, të cilët, bashkë me agresorët fashistë di-tën e 7 prillit, u hodhën kundër popullit shqiptar.

Pra, ato që e karakterizojnë politikën e jashtme të regjimit të Zogut janë marrëdhënjet në baza kapitaliste dhe imperialiste me shtetet e tjera. Këto e ulën vendin tonë në një vend kolonial, legalizuan shfrytëzimin më të egër të popullit dhe kërcënuan e zhdukën independencën dhe sovranitetin e vendit tonë. Kjo ishte tradhëtia e Ahmet Zogut, armik i betuar i popullit tonë.

Politika e brendshme e Zogut karakterizohet nga një shfrytëzim barbar dhe total të fshatarësisë së var-fër e të mesme dhe të punëtorisë së vendit tonë. Popu-lli ynë ka hequr mjerimet dhe vuajtjet më të zeza nga re-gjimi i Zogut, i cili kishte përdorur çdo gjë për të mposh-tur energjitë e popullit tonë; ai e kishte hedhur vendin në një kaos të madh ekonomik dhe një rrjet i madh shfrytëzuesish i klikës së tij dhe i borgjezisë tregëtare, i mbështetur në regjimin shtypës policor, kishte mposh-tur çdo përpjekje për zhvillimin e përparimin e ekono-misë dhe të vendit.

Periodha historike para dhe gjatë sundimit otoman në Shqipëri është periodha e sistemit shoqëror feudal.

Para sundimit otoman pasuritë e mëdha tokësore ishin pronë e dyerve (oxhaqeve, principatave) të mëdha të vendit. Kontradiktat midis feudalëve vendës, për të zgjeruar secili sa më shumë latifondin e vet, e shtonin edhe më tepër shtypjen dhe shfrytëzimin feudal që ka-

rakterizon raportet ekonomike të këtij sistemi shoqëror.

Forcimi dhe zgjerimi i perandorisë otomane në Ballkan, sollën domosdo edhe sundimin turk në vendin tonë. Rezistenca e paorganizuar dhe e shpërndarë e feudalëve vendës, nuk mundi t'i bënte ballë invazionit të ushtrisë turke. Me ardhjen e turqve në Shqipëri u zhdukën feudalët vendës dhe latifondet e tyre u bënë pronë e Portës së Lartë të Stambollit. Kështu vendi ynë humbi pavarësinë dhe pronësinë mbi tokën.

Nën sundimin e sanxhakbeut turk, bujku ju nënshtrua një shfrytëzimi të egër. Fshatari tani, si rob i tokës, duhej të punonte për të paguar haraçin¹, mirinë² e detyrime të tjera feudale për të mbajtur qeveritarët turq, jeniçerët e ushtrisë turke.

Por megjithkëto, fshatarësia jonë nuk i ndaloi përpjekjet dhe luftën e saj kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër sundimit otoman. Lufta e fshatarësisë sonë për tokën dhe për çlirimin ka qenë shekullore.

Në periudhën e parë të sundimit turk filluan të lindin në vendin tonë feudalët e rinj. Vasalët e sulltanit, ushtarët dhe kalorësit e mirë, që shërbenin për qëllimet pushtuese të Portës së Lartë formuan klasën feudale të spahinjve³. Feudalët që lindën në këtë fazë janë feudalë ushtarakë të patrashëgueshëm. Kjo është një karaktere-

1 Haraç — taksë e veçantë që paguanin të krishterët në kohën e Turqisë dhe që arrinte nga 20-50% të prodhimeve.

2 Miri — taksë mbi tokën.

3 Kështu quheshin në sistemin feudal ushtarak turk feudalët, të cilët ishin të detyruar të shkonin në luftë si kalorës të armatosur në bazë të thirrjes së sulltanit.

ristikë e veçantë e feudalizmit turk në këtë kohë. Në këtë fazë të feudalizmit format e shfrytëzimit ishin haraçi, taksat për bagëtitë dhe të dhjetat mbi prodhimet që i paguheshin sulltanit. Feudalët e rinj filluan ta zgjeronin sundimin e tyre edhe mbi ato krahina të vendit që kishin mbetur të lira. Këta bënin presion që fshatarët e katundeve të lira të bëheshin bujq të tyre, që çdo familje fshatare të paguante një tribut të veçantë në favor të feudalit, kërkonin që të shtohet tributi në favor të sulltanit dhe të shkonin ushtarë. Por këta ndeshën në rezistencën e fshatarëve të lirë, që nuk pranonin t'i nënshtroheshin shfrytëzimit dhe sundimit të tyre. Revoltat e Himarës, të Mirditës, të Dukagjinit, etj. (nga fundi i shekullit të 15-të e deri në fillim të shekullit të 17-të), drejtoheshin kundër këtyre feudalëve dhe zaptesve turq. Në Kuvendin e Shënpalit, fshatarët e Mirditës vendosën t'u bien feudalëve vendës; kryengritja u bë, por në fund u shtyp (1614-1618). Me gjithë qëndresën dhe kryengritjet e fshatarëve, feudalët vendës vazhdimisht i forconin pozitat e tyre ekonomike dhe politike. Lufta midis tyre dhe kundër fshatarësisë së lirë pati si rezultat zmadhimin e forcës dhe të influencës së tyre. Në këto kondita, sulltani shtërngohet t'i njohë si zotër të vendit. Këta bëhen feudalë të trashëgueshëm dhe marrin në dorë pushtetin politik. Toka u bë pronë private e tyre. Shfrytëzimi në këtë fazë bëhet në forma edhe më të rënda. Tani fshatari, veç tributit, duhej t'i jepte feudalit gjysmën ose të tretën e prodhimeve të tokës dhe të bënte punë angari për të.

Porta e Lartë e Stambollit, për të rivendosur autoritetin e pushtetit të saj në vendet e sunduara, shpalli

Tanzimatin¹, me qëllim që të ndalonte shkatërrimin e perandorisë duke krijuar një shtet të centralizuar absolut. Pasi eliminoi feudalët e mëdhenj dhe bejlerët, që dilnin pengesë për zbatimin e reformave tanzimate, qeveria turke vuri në zbatim sistemin e ri të taksave për gjithë fshatarësinë. Kështu shfrytëzimi u bë më i rëndë. Veç së tretës së produkteve, tani fshatarit i ngarkoheshin edhe taksat e rinj. Reformat tanzimate patën si rezultat që feudalët e trashëgueshëm të bëhen funksionarë shtetërorë, që ngarkoheshin prej sulltanit edhe për vjeljen e taksave.

Prandaj, Tanzimati revoltoi fshatarësinë, e cila nuk donte në asnjë mënyrë të pranonte këtë formë të re shtypjeje. Kështu në fazën e parë kemi revoltat e fshatarësisë së madhe (familje të pasura), që, të udhëhequra nga Zylyftar Poda dhe nga Zenel Aga Gjoleka, etj, ngrenë krye kundër Tanzimatit. Në fazën e dytë, kemi lëvizjen e vegjëlisë fshatare, që, e udhëhequr nga Rrapo Hekali, lufton jo vetëm kundër sulltanit, po edhe kundër feudalëve Vrionas, të cilët rrethohen në kalanë e Beratit, kapen dhe varcn. Kjo lëvizje e vegjëlisë fshatare arrin të rrethojë Gjirokastrën, por në Palavli të Delvinës u thye.

Me gjithë shtypjen e madhe të sunduesve turq dhe

¹ Tanzimati (arabisht) — Kështu u quajtën të gjitha reformat që u shpallën nga Sulltan Abdyl Mexhiti me dekretin (fermanin) e Gjylhanesë më 1839 dhe që kishin për qëllim rimëkëmbjen e autoritetit shtetëror turk me anë të centralizimit burokratik të administratës sipas shembullit të shteteve evropiane.

të feudalëve të vendit, vegjëlia fshatare i vazhdoi përpjekjet e saja kundër shtypësve. Në Shalë, mbliidhet vegjëlia fshatare në një kuvend dhe organizon lidhjen «Djelmnia e Shalës», me në krye Mehmet Shpendin, me qëllim që të mbronte të drejtat e vegjëlisë fshatare. Kjo lidhje mundi të sabotonte vendimet e pleqësisë që kërkonte të shtypte vegjëlinë fshatare, por më në fund Mehmet Shpendi bëri kompromis (1895). Gjithashtu «Lëvizja e Plugut» e vegjëlisë fshatare të bajrakut të Dibrës (1906) dhe lëvizjet e tjera të Kosovës e të krahinave të tjera në kohën e xhonturqve, janë fakte që tregojnë përpjekjet që ka bërë fshatarësia për t'u çliuar nga sundimi otoman dhe nga feudalët e vendit.

Edhe në këtë kohë fshatarët, çifçinjtë e çifliqet shiteshin dhe bliheshin akoma si një plaçkë tregu. Njëri feudal ja shiste feudalit tjetër krejt një katund me të gjithë bujqit, mjetet e punës, pyjet, ujërat, etj. Gjithashtu fshatarët e blenin bashkërisht tokën e katundit të tyre nga feudali, duke e larë detyrimin e kësaj blerjeje për disa vjet rresht.

Në prakun e shpartallimit të perandorisë turke, bejlerët e vendit muarën flamurin e nacionalizmit, të vetëqeverimit, me qëllim që të ruanin dhe të konsolidonin pozitën e tyre ekonomike dhe politike. Edhe kur vendi ynë fitoi pavarësinë politike nacionale, kryengritjet vazhduan. Luftërat e fshatarëve me në krye Haxhi Qamilin kundër Esat Pashës e feudalëve të Beratit dhe të Elbasanit, tregojnë dëshpërimin dhe urrejtjen e vegjëlisë kundër shtypësve shekullorë.

Periodha e parë e regjimit të Zogut karakterizohet nga përpjekjet e bejlerëve e të agallarëve të moderuar

për të vendosur pushtetin e tyre. Zogu, pasi shtypi rezistencën e disa elementëve përparimtarë, mundi të merrte pushtetin në duart e tija.

Në regjimin e Zogut vazhduan po ato raporte ekonomike feudale të trashëguara nga sundimi turk. Pushteti ishte në duart e bejlerëve, të rritur dhe të edukuar në ambientin e perandorisë turke, me frymë dhe koncepte anadollake. Këta njerëz nuk mund ta çonin shoqërinë tonë përpara, sepse këta kishin interesa të kundërt me masat popullore të shtypura. Duke pasur vetë pushtetin absolut në shtet, shfrytëzimi i fshatarësisë vazhdoi po me ato ligje dhe po me ato forma të kohës së sundimit otoman. Ligjet e tyre ishin sheriat¹, mexheleja², etj.

Vazhdimi i raporteve feudale deri në këtë kohë në vendin tonë për shkak të sundimit otoman, shpjegon faktin që borgjezia nuk mundi të zhvillohej me kohë. Megjithatë borgjezia tregëtare në këto kondita u zhvillua mjaft. Kështu për arësye të kontradiktave që shfaqen midis kapitalizmit që lind dhe zhvillohet nga një anë dhe feudalizmit që fillon të zhduket nga ana tjetër, feudalët e disa krahinave të Shqipërisë, sidomos ata të Shqipërisë së Jugut shkojnë në dekompozim. Çifliqet e këtyre i blejnë gradualisht tregëtarët e fshatarët e pasur, të cilët formojnë kështu borgjezinë agrare.

Kjo borgjezi lidhet me mbeturinat e feudalizmit

¹ Sheriat — «Ligji i shenjtë» — nga arabishtja. Tërësia e normave fetare dhe juridike të së drejtës muslimane, krijuar në vendet e Lindjes në shekullin XII.

² Mexheleja — Kodi civil i vjetër i perandorisë osmane.

dhe mbron kështu format e shfrytëzimit feudal në fshat. Kulakët e fshatit po e zgjeronin zotërimin e tyre mbi tokën. Qehajallarët, paria e fshatit, shërbëtorë besnikë dhe vegla të regjimit e të feudaleve, të favorizuar nga autoritetet e pushtetit të Zogut, rrëmbenin me forcë dhe me dredhi tokat e fshatarëve të shtypur. Nga ana tjetër, njerëzit e klikës së Zogut si Musa Juka, [Abdurrahman] Krosi e kompani, me qëllim që të zgjeronin çifliqet e tyre, i detyronin fshatarët, me frikësime dhe terror, që të braktisnin tokat e tyre.

Kështu shohim që çifliqet e mëdha nuk u zhdukën, sidomos në Shqipërinë e Mesme. Por, si për çifçinjtë, ashtu edhe për fshatarësinë tjetër, jeta u bë e padurueshme, varfëria dhe mjerimi arritën kulmin. Me të ardhurat e tokës, bujku nuk mund të siguronte as bukën e gojës.

Bujqësia në vend që të përparonte, shkante tatë-pjetë dhe arësyeja themelore për këtë prapambetje të bujqësisë shpjegohet me faktin se gjatë regjimit të Zogut, nuk ndryshuan raportet feudale dhe format e vjetra të shfrytëzimit në fshat mbetën të paprekura. Shteti nuk bënte asnjë përpjekje për zhvillimin e bujqësisë. Prodhimet bujqësore, për shkak të zhvlehtësimit të tyre, u pakësuan mjaft. Sipërfaqe të gjera tokash liheshin për kullotë, pse kështu, pronari i tokës, pa kokëçarje, siguronte të ardhura të mira nga prodhimet blegtorale ose nga lëshimi me qira i tokës për kullotë. Nga ana tjetër, zhvillimi i bujqësisë nuk mund të arrihet me metoda primitive të punimit të tokës dhe me parmendën e drunjtë, derisa nuk hyjnë në prodhim mjetet e veglat e reja.

Si pasojë e shfrytëzimit të saj deri në palcë, fsha-

tarësia ngeli shumë prapa. Sëmundjet dhe varfëria po ja brenin jetën. Askush nuk interesohej për ngritjen dhe edukimin e saj. Arësimi dhe kultura në kohën e Zogut nuk ishin për fshatarësinë. Fshatari konsiderohej nga klasat në fuqi si njeri me dinjitet të ulët, si njeri i përbuzur. Për të përbulluar jetesën ai hynte vazhdimisht në borxh dhe borxhi nuk lahej kurrë, derisa më në fund detyrohej të shiste kaun e vetëm, arën e mbjellë (selem) e pastaj edhe tokën e tij. Kështu fshatarët e pasur, kulakët e fshatit dhe borgjezia e qytetit, i zgjeronin sipërfaqet e tokave të tyre duke blerë tokat e bujqve të varfër dhe të mesëm, të cilët, duke mbetur pa tokë, për të siguruar kafshatën e gojës, ktheheshin në punëtorë ose emigronin në vende të huaja. Por fshatarët e patokë nuk gjenin punë, se regjimi i Zogut dhe borgjezia e vendit s'kishin bërë asgjë për ngritjen e industrisë në vendin tonë. Për ta nuk kishte rrugëdalje tjetër, veçse të jepnin ryshfete për t'u regjistruar xhandarë, ose të bëheshin shërbëtorë të klasave në fuqi, për 30 lekë në muaj.

Në këtë gjendje të mjeruar, në këtë varfëri të madhe, dëshpërimi i fshatarësisë arriti kulmin. Fshatarët shpesh u rezistonin zotërve të tyre, që kërkonin të tretën e prodhimeve. Këta u rezistonin autoriteteve të vendit, që u konfiskonin plaçkat e shtëpisë dhe bagëtinë, për të larë taksat e rënda, xhelepin e borxhet fajdexhinjve. Edhe kundër pronarëve të tokave, kundër bejlerëve dhe agallarëve, bujqit ngrinin krye pareshtur. Për shembull konflikti midis fshatarëve dhe Maliq Frashërit për malin Goricë në Korçë dhe ai midis fshatarëve të katundit Krinë dhe Emin Kokalarit në Gjirokastër, etj.,

janë manifestime të urrejtjes së madhe të fshatarësisë kundër feudalëve. Për çdo tentativë të fshatarëve kundër feudalëve, regjimi i Zogut përdorte shtypjen në mënyrën më çnjerëzore. Gjyqet e shumta mbi këto çështje, gjatë sundimit të Zogut, tregojnë qartë sa e madhe ishte shtypja që i bëhej fshatarësisë sonë. Sallat e gjyqeve mbusheshin plot me fshatarë të varfër dhe të raskapitur që kërkonin drejtësi, por e drejta nuk dilte në shesh për vjete me radhë, derisa, me një nen të ligjeve të mbetura nga koha e sundimit të Turqisë, u merrej gjëja e gjallë e toka duke mbetur me gisht në gojë.

Sado që shumë herë u fol me fjalë të bujshme për një reformë agrare në Shqipëri, kjo nuk u bë kurrë, as më parë, as gjatë regjimit të Zogut, sepse klikat që mbanin pushtetin politik, zotëronin dhe çifliqet e mëdha. Zbatimi i reformës agrare ishte bërë një nevojë e domosdoshme për fshatarësinë e të gjitha vendeve. Jehona e Revolucionit të madh të Tetorit, për ndryshimin e raporteve në fshat, u përhap në të gjitha vendet. Edhe fshatarësia jonë, e frymëzuar nga fitoret e fshatarësisë ruse, i ngjalli shpresat për një reformë agrare. Edhe në kohën e shkurtër të qeverimit të Fan Nolit u fol për një reformë agrare, por u mjaftua me konfiskimin e pasurive të të ikurve. Zogu, me qëllim që të fitojë simpatinë e fshatarësisë, me qëllim që të kërcënojë rivalët e tij (feudalë, sipërmarrës, etj.), me qëllim që të tregohet edhe në botën e jashtme si mbret i ri reformator, premtoi edhe zbatimin e reformës agrare në Shqipëri. Por e ashtuquajtura reformë agrare e Zogut u kufizua vetëm me cedimin të pak sipërfaqeve të vogla tokash moçalishite të Myzeqesë dhe të Jubës së Durrësit e në sasi fare

të pamjaftueshme, disa familjeve kosovare. Qysh atëhere këto toka nuk u përmirësuan dhe shumë nga këto familje, pushteti ynë i vendosi në toka të tjera. Familjet kosovare, që u vendosën nga «reforma agrare» e regjimit të Zogut, gjetën më tepër vdekjen, se rrojtjen. Në fshatin Stani i Bobos të Lushnjës, ku qenë vendosur nja 30 familje, fshatarët tregojnë se në një ditë kanë varrosur 7 vetë. Duhet pasur parasysh se edhe ato sipërfaqe fare të vogla tokash, që ju ceduan emigrantëve kosovarë, ishin shtetërore. Çifliqet e feudalëve të mëdhenj mbetën fare të paprekura. Bile, me pretekste të ndryshme, u zgjeruan tokat e Abdurrahman Krosit ose të vetë Ahmet Zogollit. Për të pasur një ide mbi sipërfaqet që zotëronin feudalët tradhëtarë të vendit, po japim këto shifra: 7 familje kishin mbi 1 000 ha. tokë secili, me një total prej 14 554 ha. Ja disa nga këta feudalë: Shefqet Verlaci kishte 3 700 ha. tokë pyll dhe 1 761 rrënjë ullinj. Familja e Biçakçiut 2 061 ha. tokë, kullotje e pyll dhe 1 276 rrënjë ullinj. Vrianasit 6 315 ha. tokë, Nuredin Vlora 2 990 ha. tokë dhe Resulajt 1 541 ha., pa përmendur për këta, pasuritë e tjera të patundshme të tyre si dyqane, shtëpi, hotele, etj.

Sa për industrinë, nuk mund të flitet fare në këtë periudhë të errët të këtij regjimi. Industria e lehtë, që përbënte një pjesë shumë të vogël të ekonomisë, nga ana teknike, ishte fare primitive. Nën drejtimin direkt të kapitalit tregëtar feudalo-borgjez të vendit, i cili sapo kishte filluar të shtrihej fare pak në industri, industria nuk mori asnjë zhvillim, sepse ishte e mbështetur kurdoherë në ndihmën e në drejtimin e dëshiruar nga kapitali i madh financiar italian, interesat e të cilit nuk paj-

toheshin me zhvillimin e industrisë së lehtë në vendin tonë. Kështu që edhe ato pak fabrika të vogla që ekzistonin, ishin në gjendje të vajtueshme, të prapambetura dhe të vendosura pa kriter e ku ishte dëshira e pronarit, larg lëndës së parë, që në pjesën më të madhe silllej nga jashtë. Përsa i përket shfrytëzimit të nëntokës, ai bëhej i tëri nën drejtimin direkt të kapitalit të madh financiar italian. Ndërkaq, banka, arma e kapitalit italian, si institut krediti për të financuar e ndihmuar zgjerimin e kapitalit italian në radhë të parë dhe pastaj kapitalin tregëtar të vendit, fajdexhinjtë e spekulatorët, që thithnin gjakun e masave punonjëse të vendit tonë, shërbeu për kolonizimin e Shqipërisë. Të ardhurat shtetërore bazoheshin kryesisht mbi taksat e rënda që binin mbi kurrizin e fshatarësisë punonjëse dhe të shtresave të varfëra të popullit si dhe në huanë italiane, e cila i jepej regjimit shtypës të Zogut kundrejt koncesioneve të mëdha, që ishin baza e përgatitjes së okupacionit të hapët fashist që i përgatitej vendit tonë.

Kapitali ishte koncentruar në disa duar dhe orientimi i tij ishte vetëm në tregëti. Kjo ndodhte për shkak të importimit të mallrave të manifakturuara, që tregu italian i ofronte tregut shqiptar, duke thithur kështu të gjithë arin dhe valutën e vlefshme që ndodheshin në vendin tonë. Gjendja e eksportimeve dhe e importimeve, në kohën e këtij regjimi shtypës, na tregon varfërimin e vendit tonë, rënjen e madhe ekonomike dhe uljen e prodhimit. Eksportimet tona përbëheshin kryesisht nga lëndët e para dhe sendet ushqimore, të cilat, për shkak të dobësimit të fuqisë blerëse të popullit dhe të gjendjes së vajtueshme të masave punonjëse, grumbu-

Iloheshin prej eksploatuesve dhe eksportoheshin në Itali. Sa për importimet, ato përbëheshin prej sendeve të manufaktuara, që tregu italian i ofronte kolonisë së tij, Shqipërisë.

Buxhetet e periudhës së errët të regjimit të Zogut vënë në dukje natyrën e këtij regjimi shtypës dhe policor dhe prapambetjen ekonomike që ekzistonte në këtë periudhë. Investimet në këto buxhete nuk kapnin më shumë se 3% të shpenzimeve buxhetore, kurse shpenzimet për ushtrinë dhe xhandarmërinë arrinin në 45-50% dhe vetë pallati i mbretit shpenzonte 3,7% të të gjithë buxhetit shtetëror.

Arësimi i popullit ishte në gjendje të vajtueshme dhe zhvillohej me një ngadalësi të jashtzakonshme. Lufta e feudalëve sundues dhe e klikës së Zogut, ishte e egër kundër arësimit të masave të popullit. Arësimi ishte i rezervuar për klasën drejtuese dhe kishte pakujdesi e paaftësi në organizimin dhe zhvillimin e tij. Ky arësim s'ishte aspak profesional e teknik dhe analfabetizmi kishte zënë rrënjë të thella. Populli ynë ka pasur kurdoherë dëshirë të madhe për arësim dhe kulturë, por fati i tij ra në duart e regjimit të Zogut dhe dyert e arësimit u mbyllën për të. Përhapja e arësimit në fshatra, në kohën e regjimit të Zogut, ishte në gjendje të mjeruar, ndryshonte nga një krahinë në tjetrën dhe bëhej sipas interesit të Zogut dhe të klikës së tij. Djalit të fshatarit dhe të punëtorit i ishin mbyllur dyert e shkollave të mesme. Gjithashtu arësimi i mesëm ka qenë shumë i kufizuar, jashtëzakonisht i kufizuar, por megjithkëtë gjendje, klika e Zogut më 1935 dhe në çdo kohë, ngrinte zërin e jepte alarmin për rrezikun e «superprodhimit

intelektual». Në atë vit, në parlament, Fejzi Alizoti dha alarmin: «Sot në Shqipëri kemi tri gjimnaze dhe po të bëjmë një hesap, këto shkolla vazhdimisht do të nxjerrin, për 10-15 vjet, 500-600 kandidatë për nëpunës dhe do të vijë një kohë që djemtë e shkollave do të bëhen dhe çirakë bakajsh... Unë me këtë program që është sot jam i bindur që këto pare që prishen për arësimin, shkojnë kot». Kjo e karakterizonte politikën e Zogut për arësimin. Edhe këshilltari i Ministrisë së Arësimit të asaj kohe, një fashist italian, në raportin që i dërgonte Zogut më 1937, thoshte: «Shkolla e mesme, në qoftë se nuk është e rregulluar mirë dhe në qoftë se nuk u përgjigjet nevojave të kombit, është ajo që formon papunësinë intelektuale dhe papunësia intelektuale është më e rrezikshmja midis formave të papunësisë për shtetet që duan rregullin e mirë dhe solidaritetin shoqëror në vend të subversizms bolshevike». Dhe për arësimin teknik e profesional në Shqipëri po ai këshilltar fashist italian i Ministrisë së Arësimit të Zogut, shkruante: «Deri sot mungojnë konditat për të ndërmarrë një industrializim të gjerë dhe është ndofta ky fati më i mirë i Shqipërisë, sepse popujt që kanë ose rrahin të kenë industrializimin më të gjerë, janë përgjithësisht popujt më të paqetë». Regjimi fashist i Zogut, regjim otoman, e mbante popullin shqiptar në shtypjen mesjetare.

As nuk mund të bëhej fjalë nën regjimin e Zogut për mbrojtjen e shëndetit të popullit. Ky ishte në mjerrim të madh dhe sëmundjet e ndryshme e të rrezikshme kositnin popullin tonë.

Regjimi i Zogut ishte regjimi i litarit dhe i plumbit dhe popullit tonë i kishte vajtur thika në koskë. Por

me gjithë shtypjen dhe terrorin, greva e punëtorëve të naftës në Kuçovë më 1933, grevë e organizuar e klasës punëtore kundër regjimit të Zogut dhe kapitalit italian që shfrytëzonte Kuçovën, demonstrata e bukës në Korçë në shkurt të vitit 1936, e organizuar dhe e drejtuar nga grupi komunist i Korçës, lufta e vetë këtyre grupeve komuniste shqiptare, sido që jo të bashkuara ideologjikisht dhe organizativisht, rezistenca e elementëve progresistë dhe patriotë kundër regjimit dhe përgatitjes së okupacionit të vendit tonë, dëshmojnë se, me gjithë terrorin dhe shtypjen mesjetare të Zogut dhe me gjithë demonstracionet navale të Italisë fashiste, populli ynë heroik i rezistoi me forcë kësaj politike të katastrofës dhe të skllavërimit.

Populli ynë, që më 7 prill 1939 nën udhëheqjen e komunistëve të grupeve e më pas të Partisë Komuniste të Shqipërisë do të çohet në këmbë i tëri, për të luftuar me heroizëm dhe për të bërë luftën më të lavdishme që ka bërë populli ynë gjatë historisë së tij shekullore.

Politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik, që nga Revolucioni i madh i Tetorit, ka pasur për qëllim paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

1. — Regjimi sovjetik është për paqen dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, për barazi të plotë dhe për respektimin e sovranitetit të shteteve të mëdha e të vogla.

2. — Bashkimi Sovjetik nisat nga koncepti leninist mbi koekzistencën e dy botëve, kapitaliste e socialiste dhe njeh mundësitë e bashkëpunimit midis tyre.

3. — Duke u nisur nga fakti i rrethimit kapitalist

dhe duke pasur qëllim ndërtimin e shoqërisë së re socialiste, Bashkimi Sovjetik ka qënë i interesuar direkt për të pasur miq rreth e rrotull dhe paqe në botë.

Shteti sovjetik me krijimin e tij u deklarua kundër luftës, u propozoi paqe të gjithëve dhe punoi aktivisht për këtë; ai pranoi Brest-Litovskin¹ dhe më 6 nëntor 1918 Kongresi VI i jashtëzakonshëm i Sovjetëve adoptoi një rezolutë, ku u propozonte qeverive të Anglisë, të Francës, të Shteteve të Bashkuara dhe të Japonisë, t'i jepnin fund intervencionit dhe të fillonin bisedimet. Por ushtritë e imperialistëve vazhduan luftën e tyre të poshtëre. Atëhere, me apelin e Partisë Bolshevike, nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit, popujt sovjetikë u ngritën në këmbë për të mbrojtur atdheun e tyre kundër shkelësve të huaj. Ushtria e Kuqe shtyu agresionin dhe u hodh në sulm, derisa i likuidoi të gjithë intervencionistët e huaj dhe veglat e tyre, rojet e bardha të Kollçakut e të Denikinit.

Më 1920, Rusia Sovjetike përfundoi paqen me Shtetet Baltike. Duke folur për çështjen e paqes me Estoninë, Lenini ka thënë:

«Kjo është një dritare që punëtorët rusë shpuan në Evropën Perëndimore, është një fitore e padëgjuar mbi imperializmin botëror, një fitore që ndërron kursin e revolucionit proletar

¹ Traktat i përfunduar midis Rusisë Sovjetike dhe qeverive të Gjermanisë, të Austrisë, të Bullgarisë dhe të Turqisë në qytetin Brest-Litovsk më 3 mars 1918, që i dha fund pjesëmarrjes së Rusisë në Luftën e parë botërore.

rus dhe që përqëndron gjithë forcat në rindërtimin e brendshëm të vendit»¹.

Me gjithë intrigat e imperialistëve, më 1921 ajo përfundoi akorde miqësore me shtetet e Lindjes: Iranin, Afganistanin, Turqinë e Mongolinë dhe më pas vendosi inarrëdhënje të mira edhe me Kinën.

Në konferencat e Gjenovës dhe të Hagës² (1922) diplomacia imperialiste u mundua të krijojë një front antisovjetik, por diplomacia e Leninit, duke njohur mirë kontradiktat e brendshme të kampit imperialist, diti ta thyejë këtë front dhe t'i shkallmojë planet agresive të armiqve të shtetit sovjetik.

Shteti sovjetik ishte i pamposhtur, i fuqishëm dhe i qëndrueshëm. Autoriteti i tij ndërkombëtar rritej përditë më shumë dhe nuk mund të izolohej. Më 1924, qeveritë kapitaliste u bindën për këtë dhe, të shtyra nga nevoja për të forcuar marrëdhënjet ndërkombëtare dhe nga opinioni publik, u detyruan të njohin Bashkimin Sovjetik.

Bashkimi Sovjetik luftonte me forcë e kurajë për paqen dhe demaskonte pa mëshirë politikën dyfaqëshe të vendeve imperialiste, që me fjalë ishin për paqen dhe çarmatimin, por me vepra bënë një ndarje të re të bo-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, bot. 3 rus., f. 23.

² Konferenca ndërkombëtare të organizuara nga shtetet imperialiste në Gjenovë të Italisë (prill-maj 1922) dhe në Hagë të Hollandës (qershor-korrik 1922), në të cilat shtetet imperialiste u munduan t'i zgjidhnin çështjet ekonomike e financiare në dëm të interesave ekonomike e politike të Bashkimit Sovjetik.

tës, armatosnin dhe nxitnin Gjermaninë kundër Bashkimit Sovjetik.

Bashkimi Sovjetik propozoi një plan për çarmatim të vërtetë e të përgjithshëm, ai lidhi pakte mossulmimi me një sërë shtetesh kufitare dhe, kur pllakosi kriza ekonomike e përgjithshme në botën kapitaliste (1929-1933), qeveria sovjetike goditi tentativat e qeverive borgjeze për ta futur edhe Bashkimin Sovjetik në rrethin e tyre ekonomik të kalbët. Ajo propozoi që akordet politike të mossulmimit, që Bashkimi Sovjetik kishte përfunduar me një sërë shtetesh, të plotësoheshin me një pakt ndërkombëtar mossulmimi ekonomik, i cili do t'u lejonte gjithë vendeve të bashkëpunonin në paqe, pa varësisht nga regjimi i tyre i brendshëm¹.

Në këtë kohë fashizmi ngre kokën. Më 1931 Japonia sulmon Mançurinë dhe më 27 mars largohet nga Lidhja e Kombeve; Italia kërkon me kërcënim rishikimin e Versajës²; në janar 1933 Hitleri vjen në fuqi dhe më 19 tetor 1933 edhe Gjermania largohet nga Lidhja e Kombeve dhe fillon përgatitjet për luftë me parullat e «ah-marrjes» e të «Kryqëzatës» kundër bolshevizmit.

Qeveritë reaksionare të Perëndimit i tolerojnë të

¹ Përfundimi i paktit mbi mossulmimin ekonomik u propozua nga qeveria e Bashkimit Sovjetik në Konferencën ekonomike botërore të Londrës, që u mbajt nga 12 qershori deri 27 korrik 1933. Propozimet e Bashkimit Sovjetik nuk u përkrahën nga kjo konferencë. Pas diskutimesh të pafrytshme ajo dështoi.

² Gjermania dhe Italia fashiste kërkonin me këmbëngulje rishikimin e Traktatit të paqes të Versajës të 29 korrikut 1918 me qëllim që të kënaqnin lakmltë e tyre për një rindarje të re të botës.

gjitha këto dhe shpresojnë ta hedhin Gjermaninë hitleriane kundër Bashkimit Sovjetik. Qeveria sovjetike e kuptonte qartë natyrën agresive të fashizmit; ajo u përpoq t'u hapte sytë popujve dhe të grumbullonte forca antifashiste. Në Konferencën ndërkombëtare të çarmatimit (1933) delegacioni sovjetik paraqiti një projekt-konventë për të përcaktuar agresionin. Kjo vlente për ndalimin e agresionit dhe për forcimin e paqes e të bashkëpunimit ndërkombëtar, për një sistem sigurimi kolektiv.

Bashkimi Sovjetik ishte faktor paqeje, ai demaskonte pa mëshirë hipokrizinë e pacifizmit borgjez dhe të fashizmit. Më 1934 Lidhja e Kombeve i propozoi Bashkimit Sovjetik që të bëhej anëtar i saj. Bashkimi Sovjetik nuk refuzoi, se mendonte që, me gjithë të metat e saja, Lidhja e Kombeve mund të bënte shërbime të mira për çështjen e paqes dhe më pas, në kohën e luftës së Abisinisë e të Spanjës, kur krijuesit e saj, Anglia dhe Franca i braktisën parimet e saj, ishte Bashkimi Sovjetik ai që mbrojti dhe kërkoi respektimin e statuteve të Lidhjes së Kombeve kundër agresorëve fashistë.

Popujt që e ndjenin rrezikun e një agresioni gjerman u afruan me Bashkimin Sovjetik. Në maj 1935 Franca dhe Çekosllovakia përfunduan me Bashkimin Sovjetik një pakt ndihme reciproke, ndërsa reaksionarët anglezë, të shqetësuar nga pakti franko-sovjetik, më 18 qershor 1935 përfunduan një akord naval me Gjermaninë.

Bashkimi Sovjetik luftoi për një front të përbashkët kundër agresionit fashist. Po demokracitë e Perëndimit, duke përfshirë edhe SHBA-në ndoqën një politikë kapitullimi para agresorëve fashistë. Politika e tyre e tolerancës, e mosndërhyrjes dhe bile e inkurajimit ndaj

politikës agresive fashiste, dobësia e tyre përpara shantazheve e metodave gangstere të fashistëve dhe urrejtja e tyre kundër Bashkimit Sovjetik u dhanë kurajë fashistëve të kryejnë agresionet e poshtra kundër Mançurisë në Lindjen e Largët, kundër Abisinisë në Afrikë dhe kundër Spanjës në Evropë, që ishin edhe anëtare të Lidhjes së Kombeve. Fashistët po mobilizonin forcat e tyre për luftë dhe po armatoseshin. Në nëntor 1936 Gjermania dhe Japonia firmuan paktin e quajtur anti-komintern, ku aderoi edhe Italia e Musolinit. Nën parullën e luftës kundër komunizmit, fashistët pregatisnin Luftën e dytë botërore. Më 1938 Hitleri realizoi Anshlusin, d.m.th. bashkimin me Austrinë, coptoi Çekosllovakinë, duke shkëputur krahinën e Sudetëve dhe, më pas, në mars 1939, pas Mynihut, zaptoi gjithë Çekosllovakinë. Më 7 prill 1939 Italia fashiste sulmoi Shqipërinë. Sa më shumë cedonin qeveritë borgjeze, aq më të egra bëheshin kërkesat e Hitlerit. Qeveritë reaksionare të Francës dhe të Anglisë, duke i bërë kurban Hitlerit një nga një shtetet e vogla dhe interesat e paqes dhe të vetë popujve të tyre, dëshironin ta hidhnin Hitlerin nga Lindja, kundër Bashkimit Sovjetik. Çambërleni¹ me Daladierin² kurdisën Mynihun, krimin më të fëlliqur, kapitullimin e politikës demokrate borgjeze përpara fashizmit. Mynihu është fryti i politikës antipopullore e anti-komuniste të qeverive imperialiste anglo-franceze, tradhëtia më e poshtër ndaj detyrimeve ndërkombëtare.

Ngjarjet e Çekosllovakisë qenë prova e zjarrit për

1 Nevil Çambërlen (1869-1940), kryeministër i Anglisë.

2 Eduard Daladier (1884), kryeministër i Francës.

demokracitë Perëndimore dhe shënuan mbarimin e tyre. Vetëm Bashkimi Sovjetik, luftëtar besnik për çështjen e paqes, besnik i detyrimeve të marrura, mbrojtës konsekuent i lirisë dhe i pavarësisë së popujve dhe armik i vendosur i agresorëve fashistë, u tregua menjëherë i gatshëm që të shpëtohej Çekoslovakia. Në atë çast frike, tradhëtie, paniku dhe çorientimi që kapi vendet kapitaliste përpara sulmeve kusare të Hitlerit, vetëm Bashkimi Sovjetik nuk e humbi qartësinë, por ishte gati të respektonte deri në pikën e fundit detyrimet e marrura, të mbronte paqen dhe demokracinë kundër fashistëve që po ndiznin luftën.

Çambërleni me Daladierin e quajtnë Mynihun si një triumf të politikës së tyre. Mynihu në fakt qe këmbana e vdekjes së politikës së tyre të pavarur. Po dhe pas Mynihut, edhe kur rreziku gjerman trokiste në portat e tyre dhe i kishte hedhur në alarm popujt e tyre, të cilët vetëm në aleancën me Bashkimin Sovjetik shikonin shpëtimin e paqes, qeveritë reaksionare të Anglisë dhe të Francës vazhduan politikën e tyre antisovjetike kundër interesave të paqes e të vetë popujve të tyre. Ata bënë një lodër dinake dhe shumë të rrezikshme për ta futur në kurth Bashkimin Sovjetik, po në kurth ranë vetë. Nën presionin e opinionit publik dhe nga veprimet agresive gjithmonë më të hapëta të Hitlerit, qeveritë e Francës dhe të Anglisë, u detyruan të hyjnë në bisedime me Bashkimin Sovjetik. Bisedimet vazhduan katër muaj dhe s'përfunduan gjë, sepse qeveritë angleze dhe franceze nuk donin që të përfundonin gjë me Bashkimin Sovjetik, përkundrazi, njëkohësisht, ato vazhdonin bisedime me Hitlerin për ta hedhur kundër BRSS.

Në një artikull të shkruar në «Pravda» më 29 qershor 1939 me titull «Qeveritë angleze dhe franceze nuk duan pakt të barabartë me BRSS» dhe që bëri bujë në gjithë botën, Andrei Zhdanovi shpjegon shkaku e vovimit që sillnin anglo-francezët në përfundimin e paktit. Duke përmendur një sërë faktesh, ai përfundon: «Të gjitha këto tregojnë se anglezët dhe francezët nuk duan të përfundojnë me BRSS një pakt që të bazohet mbi parimet e barazisë e të reciprocitetit megjithëse ata bëjnë përditë be se edhe ata janë për «barazinë», por duan një pakt, ku BRSS të luajë rolin e hyzmeqarit, që mban mbi supet e tij të gjithë peshën e detyrimeve. Mirëpo, asnjë vend që e respekton veten nuk do të pranonte një pakt të tillë, në qoftë se nuk do të donte të bëhej një lodër në duart e njerëzve që dëshërojnë të përdorin të tjerët për të nxjerrë gështenjat nga zjarrt. BRSS, forca, fuqia dhe meritat e të cilit njihen nga tërë bota, nuk mundet akoma më shumë të pranojë një pakt të atillë».

Ngjarjet e mëvonshme vërtetuan saktësinë e fjalëve të Andrei Zhdanovit. Bisedimet u prenë dhe dështuan me gjithë përpjekjet dhe vullnetin e mirë të qeverisë sovjetike. Në këtë kohë Gjermania i propozoi Bashkimit Sovjetik një pakt mossulmimi.

«...Pakti i mossulmimit është pakt paqeje midis dy shtetesh» — ka thënë shoku Stalin më 3 korrik 1941, duke folur për këtë pakt. prandaj qeveria sovjetike e pranoi. «Ç'përfituam ne, me lidhjen e paktit të mossulmimit me Gjermaninë?» — pyet shoku Stalin — «Ne i siguroam vendit tonë paqe për një vit e gjysmë

dhe mundësinë e përgatitjes së forcave për t'i bërë ballë Gjermanisë fashiste, në se ajo, në kundërshtim me paktin, do të rrezikonte të sulmonte vendin tonë. Ky është një përfitim i qartë për ne dhe humbje për Gjermaninë fashiste»¹.

Ngjarjet i dhanë gjithmonë të drejtë politikës së paqes e të bashkëpunimit ndërkombëtar të ndjekur nga Bashkimi Sovjetik si para luftës, si gjatë luftës dhe pas luftës. Politika e jashtme sovjetike e vendosur në themet e caktuara nga Lenini dhe e drejtuar në mënyrë gjeniale nga Stalini, i cili zhvilloi dhe i thelloi principet e Leninit mbi marrëdhënjet ndërkombëtare, u lejoi popujve sovjetikë të ndërtojnë në paqe shtetin e tyre socialist, të rritin rolin dhe autoritetin e tyre ndërkombëtar, të bëhen faktori ndërkombëtar në ruajtjen e paqes, në dërmimin e plotë të hordhive gjermano-fashiste dhe në zhvillimin e sotëm të situatës ndërkombëtare. Sot asnjë problem ndërkombëtar nuk mund të zgjidhet drejt pa Bashkimin Sovjetik dhe kundër pikëpamjeve të Bashkimit Sovjetik.

OKUPACIONI FASHIST ITALIAN I VENDIT TONË

Më 7 prill të vitit 1939 vendin tonë e pllakosi robëria e rëndë. Pcpulli ynë përpara këtij rreziku të madh që e kërcënonte për vdekje, ndodhej i çarmatosur krejt.

¹ J. V. Stalin: Mbi luftën e madhe patriotike të BS. Botim i MMP, Tiranë, 1952, f. 5.

Armët, që ekzistonin dhe që ja kishte lejuar Italia fashiste Zogut, ndodheshin në duart e një ushtrie mbretërore; aspak të edukuar për të mbrojtur interesat e popullit dhe pavarësinë e vendit, por e edukuar dhe e stërvitur për të mbrojtur interesat e regjimit feudalo-fashist të Zogut. Ajo ishte një ushtri reaksionare e një regjimi reaksionar, ishte një ushtri e komanduar prej oficerësh reaksionarë, besnikë të regjimit të Zogut dhe të fashizmit. Zogu dhe ushtria e tij ishin krejt të shkëputur nga masat e popullit, kurse shteti shqiptar ishte i izoluar krejt nga bota e jashtme. Kudo në aparatet e shtetit dhe të ushtrisë kishin hyrë, që përpara 7 prillit, organizatorë fashistë italianë, që pregatitën me imtësi kolonën e pestë. Ushtria e Zogut kapitulloi para invadimit fashist. Kjo vërtetoi edhe një herë në vendin tonë, thënjet e Marksit, sipas të cilit:

«Monarkia nuk mundet kurrë ta rrezikojë veten me luftën revolucionare, me kryengritjen e përgjithshme, me terrorin revolucionar. Ajo preferon më parë të bashkohet me armikun e saj më të egër, se sa të bashkohet me popullin: kryengritja e masave, kryengritja e përgjithshme e popullit janë mjete që pushteti mbretëror ka frikë t'i përdorë...»¹.

Populli shqiptar përpara invadimit u çua i tëri në këmbë duke kërkuar armë për të luftuar okupatorin, por regjimi i Zogut në asnjë mënyrë nuk ja dha këto armë;

¹: K. Marks — F. Engels, Veprat, bot. 2 rus., vëll. 6, f. 418.

kështu që populli ynë nuk mundi dot të organizonte luftën dhe të godiste si duhej okupatorin që në ditët e para të okupacionit. Përpyekjet me italianët në portin e Durrësit me Mujo Ulqinakun si dhe në Sarandë, në Shëngjin e në Vlorë, u shtypën nga forcat e mëdha të okupatorit. Populli ynë përkohësisht u mposht dhe vendi ynë u okupua, por në asnjë moment populli ynë nuk u përkul e nuk e pranoi okupacionin. Sigurisht muajt e parë të robërisë shkaktuan një çorientim në masat e gjera të popullit, të cilat u gjendën të izoluara nga bota e jashtme dhe të tradhëtuara nga regjimi i mëparshëm i Zogut. Njëkohësisht politika skllavëruese dhe kolonizuese e fashizmit italian filloi që në ditët e para të vendosej me forcë në vendin tonë. Të gjitha veprat e kryera nga fashizmi italian, gjatë regjimit të Zogut, tani marrin formë legale dhe organizohen më fort për të fuqizuar diktaturën fashiste. Me anën e qeverive kuislinge fashizmi italian u përpoq të gënjejë opinionin shqiptar për qëllimet e vërteta të okupacionit dhe t'i japë atij përshtypjen se kishte ardhur në Shqipëri për të shpëtuar popullin shqiptar nga Zogu e klikat e tij, duke thënë se Shqipëria vazhdonte të ishte një shtet i pavarur. Por populli shqiptar nuk i gëlltiste këto. Në ditët e para të okupacionit dhe për një kohë të gjatë, fashizmi italian filloi të marrë masat për ta fortifikuar si duhej vendin tonë dhe ta bënte atë një fushë, nga ku do të përgatitej për sulmet e ardhshme kundër popullit grek e popujve të tjerë të Lindjes. Përgatitje të tilla, si ndërtime rrugësh me karakter strategjik, fortifikime të ndryshme në kufi kundrejt Jugosllavisë dhe Greqisë, si dhe kazerma e depo ushtarake, bënë që për një mo-

ment të krijohej iluzioni në shtresat e popullit dhe sidomos në krahun e punës, se gjoja po përmirësohej jeta e tyre. Por kjo nuk vazhdoi shumë, pse gjendja ekonomike në vendin tonë, pas ardhjes së fashizmit, filloi të marrë teposhtë. Njëkohësisht fashizmi italian, me anë të shkollave që ai kërkoi t'i italianizonte, me anë të demagogjisë dhe të metodave që ai përdorte për të korrutuar të rinjtë, u përpoq të çorientojë rininë tonë, ta godasë dhe ta shkëpusë nga rezistenca eventuale që ajo do t'u bënte metodave të urryera të fashizmit. Fashizmi s'pati asnjë sukses. Urrejtja e madhe e popullit shqiptar, ndaj armikut të vjetër të tij, shkoi dita-ditës duke u shtuar dhe çorientimi në radhët e masave të popullit tonë nuk vazhdoi për shumë kohë. Urrejtja filloi të manifestohet në ngjyra politike dhe në aksione të hapëta kundër okupatorit dhe qeverisë kuislinge. Nga rezistenca pasive, që i bëhej okupatorit, masat e popullit me në krye elementët komunistë të grupeve dhe patriotë të tjerë, filluan grevat e hapëta në punëtorira dhe në kantiere, filluan demonstratat e popullit dhe të rinisë, si ato të shkollës teknike, të gjimnazit të Shkodrës, të fabrikës STAMLES, demonstratat e 28 Nëntorit në Tiranë dhe në Korçë, etj. Filloi demaskimi në shkallë të gjerë kundër fashizmit. Populli ynë përgatitej për luftë, u ringjall në popull besimi në forcat e tija dhe ai ndjeu thellë se kundër okupatorit dhe tradhëtarëve duhej të organizohej për një luftë të ashpër dhe të gjatë. Përballë përgatitjeve të fashizmit dhe organizimit të reaksionit, populli shqiptar dhe elementët përparimtarë dhe revolucionarë po hidhnin me guxim hapat e parë të rezistencës së armatosur dhe bënë përpjekje për organizimin e udhë-

heqjes së kësaj rezistence. Të dy anët po përgatiteshin për përpjekjet e ardhshme dhe për luftën pa mëshirë në mes të tyre.

Fashizmi italian para e pas invadimit të vendit tonë, kishte punuar gjerësisht për grumbullimin dhe organizimin e reaksionit shqiptar si brenda shtetit shqiptar, ashtu dhe jashtë. Brenda shtetit tonë, klika e Zogut, shtresa e feudalëve, e borgjezisë pasanike e tregëtare dhe gjithë pjesa e kulakëve, e lidhur drejtpërdrejt për interesat e saj të klasës, me feudalët latifondistë dhe me borgjezinë tregëtare e pasanike të qytetit, kanë qenë mbështetja kryesore në vend për Italinë fashiste. Për një periudhë shumë të gjatë, gjatë regjimit të Zogut, Italia fashiste, bashkë me Zogun e kishte përgatitur këtë terrën. Klasa sunduese në vendin tonë, shihte te Italia fashiste të vetmin përkrahës, për mbrojtjen e regjimit të saj dhe të pasurive të saja. Mungesa e një organizimi të shëndoshë të elementit përparimtar në vendin tonë, mungesa e një partie komuniste të organizuar, që të drejtonte politikisht e ushtarakisht rezistencën dhe luftën kundër Zogut si dhe mungesa e grumbullimit dhe e organizimit të elementit revolucionar si punëtorja, fshatarësia e varfër dhe e mesme, si dhe inteligjencia me pikëpamje demokratike të përparuara në një front të vetëm popullor për fitoren e të drejtave demokratike dhe për luftën kundër regjimit të Zogut e invadimit italian, i cili prej vjetësh dukej i qartë në horizontin e vendit tonë, bënë që Zogu dhe Italia fashiste të kishin suksese në organizimin e shpejtë të reaksionit të brendshëm. Jashtë vendit tonë, Italia fashiste i kishte organizuar dhe i mbante gati të gjithë krerët reaksionarë

të emigracionit politik, në konflikt me Zogun, aspak për çështje parimi, por kryesisht si rezervë për sundimin në të ardhshmen të popullit shqiptar. Në bazë të platformës politike të tyre, si të Zogut, ashtu dhe të krerëve të emigracionit politik shqiptar jashtë, ka qenë shtypja e popullit shqiptar, shfrytëzimi i egër i popullit tonë nga ana ekonomike dhe politike, ka qenë antikomunizmi më i egër dhe armiqësia kundër Bashkimit Sovjetik. Gjithë reaksioni, pra, i brendshëm dhe i jashtëm u bë vegla e padronit të ri, që okupoj Shqipërinë dhe veproi pa rezerva nën urdhërat e tij, për të mbështetur fuqimisht politikën e fashizmit italian në Shqipëri. Italia fashiste, me qeveritë e njëpasnjëshme kuislinge, si ato të Shefqet Vërlacit, Mustafa Krujës, Maliq Bushatit, Eqrem Libohovës, etj. dhe, e mbështetur nga gjithë reaksioni shqiptar, bënë çmos që, me terror e me demagogji, të gënjenin masat e gjera të popullit për qëllimet e vërteta të okupacionit, t'i çorientonin këto politikisht, të pengonin organizimin dhe rezistencën e tyre, t'i largonin nga lufta çlirimtare, të luftonin me ashpërsinë më të madhe dhe të përpiqeshin të izolonin nga këto masa, udhëheqësen heroike dhe flamurtaren e Luftës së madhe nacional-çlirimtare, Partinë tonë heroike Komuniste.

Në periudhën e parë të okupacionit, pjesa e madhe e reaksionit shqiptar e hodhi maskën, u lidh drejtpërdrejt me okupatorin dhe u hodh në luftë kundër rezistencës fillestare të popullit. Kjo pjesë u grumbullua rreth kuislingëve dhe tok me fashizmin italian filloi të gjurmojë dhe të pastrojë terrenin duke vrarë e duke burgosur elementët përparimtarë e të rrezikshëm për

regjimin fashist. Pjesa tjetër e reaksionit u mbajt si rezervë për momentet e ardhshme më të vështira që parashikonte regjimi fashist. Kjo pjesë dhe sidomos krerët Mithat Frashëri, Ali Këlcyra, etj., të lidhur ngushtë me fashizmin, vazhdonin një demagogji më të hollë dhe përpiqeshin të lidhnin pas qerres së fashizmit një pjesë të madhe të fshatarësisë së mesme dhe të elementëve të lëkundshëm dhe frikacakë. Këta krerë të reaksionit, që më vonë do të luanin një rol të poshtër në luftën kundër popullit dhe që do të udhëhiqnin «Ballin Kombëtar» dhe organizatat e tjera reaksionare, paraqiteshin me parulla pseudodemokrate dhe, në dukje, në opozicion me okupatorin. Por parulla e tyre e hapët ishte lufta kundër komunizmit dhe Bashkimit Sovjetik. Këta tradhëtarë, që më vonë do të organizonin reaksionin në «Ballin Kombëtar», kishin lidhur marrëveshje të rregullta me qeverinë fashiste italiane dhe kishin pranuar që, me ndihmën dhe nën drejtimin e fashizmit italian, të rivendosnin diktaturën fashiste në Shqipëri, të ndërtonin në Shqipëri një regjim të ri fashist nën urdhërat dhe nën drejtimin e Romës.

Pra, fashizmi italian një pjesë të reaksionit e përdorte rreth qeverisë kukull në mënyrë të hapët, për të qeverisur dhe për të zbatuar urdhërat e tij dhe pjesën tjetër, po aq besnike sa edhe kuislingët, e përdorte në prapaskenë për realizimin e një plani të vetëm, për të shtypur rezistencën e popullit shqiptar, për të demoralizuar popullin, për ta larguar këtë nga lufta çlirimtare, për të propaganduar kundër Bashkimit Sovjetik, kundër komunizmit dhe kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë, kur ajo u formua. Format e para të rezistencës së

popullit tonë, grevat, demonstratat, të shkruarit e parullave nëpër mure të qyteteve të ndryshme, që ftonin popullin të organizohej dhe të bashkohej me rezistencën, traktet e para të grupeve përpara formimit të Partisë, e bënë fashizmin të shtonte terrorin dhe reaksionin shqiptar të shtërngonte radhët e, të forconte organizimin. Fashizmi italian, tok me qeveritë kuislinge, organizoi e lidhi pas tij bajraktarët e ndryshëm reaksionarë të korruptuar, e agjentë të përhershëm të të huajve, për të mbajtur në grushtin e tyre popullsinë e Shqipërisë së Veriut, për t'i mashtruar këta e për t'i bërë mercenarë, që të shtypnin çdo tentativë organizimi kundër fashizmit dhe për t'i çuar në luftë kundër partizanëve. Fashizmi u përpoq që në fillim që ta shtypte nga të katër anët kryengritjen e popullit, ta pengonte përhapjen e saj në fshatra e në malësi dhe ta lokalizonte në qytete, për ta goditur më lehtë e më rëndë. Prandaj, fashizmi u përpoq të vërë në shërbim të tij të gjithë krerët reaksionarë të malësive dhe të spastronte gjithë foletë e rezistencës në male, që mund të bëheshin të rrezikshme. Këtë e bëri që në fillim fashizmi dhe kuislingu Shefqet Vërlaci, duke goditur patriotin Myslim Peza, i cili me një grup katundarësh qëndronte në ilegalitet në afërsitë e Tiranës. Nga ky qëllim u nis fashizmi dhe kuislingu Mustafa Kruja që të godiste në rrethet e Krujës agjentin kryesor të Zogut dhe të anglezëve Abaz Kupin, i cili, i kthyer tinëzisht në Shqipëri, qëndronte i struktur në Krujë ku, pas një kompromisi me kuislingun Shefqet Vërlaci, priste momentin e volitshëm, të diktuar nga anglezët, për të hyrë në veprim si karta e fundit e Inteligens Servis-it në Shqipëri. Mustafa Krujës dhe fashizmit

italian nuk u pëlqente lodra e Abaz Kupit. Prandaj ata e detyruan të mbante qëndrim, ose të lidhej përnjëherë me okupatorin fashist, ose të hidhej kundër tyre. Elementët zogistë të gjithë ishin në shërbim të fashizmit dhe të qeverisë kuislinge. Po, për fashizmin dhe për kuislingun Mustafa Kruja, gjithë elementi zogist dhe simpatizantët e tij, si tërësi, pa përjashtuar edhe Abaz Kupin, duhej të viheshin nën shërbimin e fashizmit italian. Një taktikë e tillë s'i pëlqente në këto momente Anglisë, sepse ajo e ruante këtë kartë për zhvillimin e mëtejshëm të situatave.

Fashizmi italian dhe kuislingët, për të penguar çdo lëvizje në male, dërguan në Jug komisarë politikë të jashtëzakonshëm, reaksionarë e kulakë në shërbim të tyre. Këta tradhëtarë, me influencën e tyre me anën e kulakëve nëpër fshatra, me anën e milicisë mercenare fashiste, si edhe me anën e forcave të xhandarmërisë dhe të italianëve do të organizonin goditjen dhe shpartallimin e çetave partizane.

Në qytete gjithë forcat e fashizmit ishin në këmbë ditë e natë për të goditur organizimin e rezistencës që shkonte dita-ditës duke u zmadhuar.

GRUPET E PARA KOMUNISTE NË SHQIPËRI PËR FORMIMIT TË PARTISË

Në bazën e organizimit të rezistencës së popullit shqiptar kundër okupacionit fashist kanë qenë grupet e ndryshme komuniste dhe elementët e tjerë patriotë, që u dhimbsej çështja e popullit. Grupet e para komuniste,

prej të cilave u formua Partia jonë, kanë një histori të tyre, kanë anën e mirë dhe të keqe të tyre që ne duhet t'i analizojmë, sepse veprimtaria e tyre përpara formimit të Partisë përfaqëson lëvizjen komuniste shqiptare. Lëvizja komuniste në vendin tonë filloi të ndihet pas Revolucionit të madh të Tetorit. Aty nga viti 1928, ne shohim shenjat e një lëvizjeje masash që sapo kishte filluar të dukej në Korçë, ku elementë përparimtarë punëtorë flisnin më hapët për komunizmin dhe idetë e mëdha të Revolucionit të Tetorit; kurse në vendet e tjera të Shqipërisë elementë përparimtarë të shkëputur dhe sidomos intelektualë që ktheheshin nga jashtë, ku kishin shkuar për të mësuar, përhapën deri në një shkallë idetë e Marksit. Në radhët e grupit të Korçës si dhe të të gjitha grupeve të tjera komuniste do të gjejmë elementë të shëndoshë punëtorë, intelektualë, studentë përparimtarë, por do të gjejmë njëkohësisht të bashkuar me ta, edhe elementë trockistë, arqiomark-sistë, që gati të gjithë kishin ardhur nga Greqia, ku kishin vajtur për të mësuar dhe për të punuar. Grupi i Korçës në radhët e tija dhe më vonë me zgjerimin e tij si grup, kishte punëtorë dhe zanatçinj të ndryshëm, të organizuar në shoqëri të ndryshme e sipas zanatit, kishte elementë punëtorë të qytetit dhe të fshatit si dhe një rreth shumë të ngushtë studentësh dhe nëpunësish të ulët. Grupi i Korçës, shumë i ngushtë, që nuk arrinte më shumë se 70 vetë, me anën e shoqërive, si ajo e «Punës», ka mbajtur lidhje me masat. Format organizative të këtij grupi kanë qenë rudimentare dhe të papërcaktuara si duhej dhe sidomos lidhjet organizative nuk kanë qenë të shëndosha. Ka pasur celula treshe,

shumë sektare, të shkëputura nga masat e grupit dhe, sido që këto i drejtonin grupet e punës dhe të simpatizantëve, puna e tyre ishte një punë e mbyllur e shumë konspirative. Kanë ekzistuar grupe simpatizantësh ose grupe edukative dhe grupet e punës, që rekrutoheshin nga organizatat punëtore ose nga grupet edukative. Njerëzit e këtyre grupeve drejtonin ato të simpatizantëve. Ekzistonte një komitet qarkor dhe një sekretariat prej tre vetësh. Në çdo shoqëri profesionale kishte fraksione të komunistëve që drejtonin dhe kontrollonin shoqëritë, sipas udhëzimeve të komitetit qarkor ose të sekretariatit. Duke pasur për qëllim të përhapte idetë komuniste, me metoda fillestare dhe të pakonkretizuara si duhej, grupi i Korçës ka bërë në fillim një punë edukative, kundër zakoneve të këqia të vjetra dhe veseve të ndryshme, ka përhapur njohuritë e para mbi shfrytëzimin e klasës punëtore, duke ngritur dhe nevojën e organizimit të saj; ka punuar për forcimin e urrejtjes kundër regjimit të Zogut dhe për fitoren e të drejtave demokratike e nacionale kundër penetracionit italian e kundër shfrytëzimit që i bënin popullit shqiptar dhe klasës punëtore feudalët e kapitalistët. Grupi i Korçës më vonë ka bërë ndryshime në karakterin e shoqërive të ndryshme të «Punës», që ishin më tepër asistenciale, duke i kthyer në organizata për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve nga eksploatimi e shtypja. Me anën e tyre, duke u ndërruar karakterin e duke i bërë edhe organizata politike kundër regjimit, për të fituar lirinë, duke forcuar edhe ndjenjën e përgjegjësisë e të solidaritetit punëtor, për greva e demonstrata si dhe për kërkesa të të drejtave të tyre, këto shoqëri u bënë njëkohësisht

një mjet për përhapjen e ideve të komunizmit. Një punë e tillë ka pasur suksese dhe, në përgjithësi e në raste të ndryshme, nga ana e grupit të Korçës janë mbajtur qëndrime të drejta, qëndrime që janë frymëzuar nga interesat e popullit shqiptar, të proletariatit dhe të Bashkimit Sovjetik. Ky grup deri diku krijoi një lëvizje kryesisht të kufizuar në shoqëritë e ndryshme punëtoreshë, patjetër, kjo ka pasur dhe influencën e vet në masat e tjera të popullit të Korçës si dhe reperkusione në një shkallë jo shumë të gjerë në opinionin shqiptar. Grupi i Korçës ka luftuar politikën e regjimit të Zogut me forma ilegale, por ka ditur, deri në një farë shkalle, të përdorë edhe format legale, ku ka pasur suksese. Shokut tonë të shquar Ali Kelmendit, i detyrohet orientimi i drejtë që i dha vijës politike të grupit të Korçës dhe në përgjithësi lëvizjes komuniste në Shqipëri. Në grupin e Korçës janë vërtetuar gjithashtu edhe gabime, që kanë penguar zhvillimin dhe zgjerimin e punës komuniste. Në Rezolucionin e parë të Partisë sonë, që doli përnjëherësh pas formimit të saj, përsa i përket grupit të Korçës shkruhej: *«Në drejtuesat e «Punës së Korçës» ka mbizotëruar lokalizmi, mungesa e shpirtit të sakrificës, monopolizimi ndër disa duar i punës me përgjegjësi. Ka mbizotëruar veç këtyre, kënaqja me rezultatet e aksioneve, gjë që çonte në mospërfitim organizativ dhe në lënjen në mëshirën e vet të elementëve dhe lëvizjeve të reja që lindeshin jashtë Korçës. Ka mbizotëruar edhe liberalizmi i organizatës kundrejt shokëve, dhe ka arritur gjer në oportunistik kundrejt elementëve të tjerë, bile dhe karshi armiqve të deklaruar të klases si Zai Fundo dhe Aristidh Qendro, gabim ky i fun-*

dit në të cilin kanë rënë edhe shokët e grupeve të tjera»¹.

Në një kohë grupi i Korçës shpërndau celulatat dhe i futi komunistët në masat për mobilizimin dhe grumbullimin e tyre, përdori format legale të luftës për të fituar të drejtat demokratike. Grupi i Korçës arriti të vërë nën drejtimin e tij shoqëritë jashtëshkollore të rinisë, të fitojë në zgjedhjet bashkiake². Po grupi i Korçës, kurdoherë i pashkundur nga sektarizmi i grupit, nuk e shtriu aktivitetin e tij në qytetet e tjera të Shqipërisë. Nga grupi i Korçës u mbrojt ideja e krijimit të frontit popullor, por pa rezultate të dukshme, sido që në Korçë ishin arritur disa suksese në këtë drejtim. Udhëheqësit e grupit të Korçës nuk shihnin më larg nga Korça, u mungonte perspektiva dhe iniciativa dhe kjo ka lidhje, gjithashtu, me pikëpamjet lokaliste të grupit.

Shoku ynë i shquar, Ali Kelmendi, vazhdimisht i persekutuar, i torturuar, i burgosur, i internuar nga regjimi i Zogut, ka dhënë një kontribut të madh për lëvizjen komuniste; ai e orientoi në një vijë të drejtë grupin e Korçës dhe gjithë komunistët, me të cilët merrote kontakt, i mësonte dhe i edukonte. Ai ndihmoi për organizimin e shëndoshë të punës në lëvizjen punëtore. Aliu zhvilloi një luftë të ashpër kundër regjimit monarkist, ndihmoi dhe frymëzoi goditjet e ndryshme që

¹ Dokumenta Kryesore të PPSII. Vëll. I, f. 16.

² Në zgjedhjet për këshillin bashkiak, që u bënë në qershor të vitit 1938, lista e blokut demokratik, që u paraqit nga grupi komunist i Korçës, fitoi 86 për qind të votave kundër listës, prapa së cilës qëndronte grupi kapitalist, Shoqëria Gjenerale e Elektrikut.

ju bënë regjimit. Ai, kudo që shkonte, mësonte komunistët të forconin punën organizative, ngjallte në ta ndjenjën e disiplinës dhe forconte ndërgjegjen e klasës, udhëzonte mbi edukimin komunist dhe teorik të kuadrove dhe luftoi me ashpërsinë më të madhe kundër elementëve armiq të klasës punëtore, fraksionistëve, trockistëve, arqiomarksistëve, që pengonin zhvillimin e lëvizjes komuniste si: Niko Xoxi, Zai Fundo, Aristidh Qendro, Andrea Zisi (Zjarri), etj. Ali Kelmendi bashkëpunoi me militantin e vjetër, punëtorin Mihal Lako, të cilin Koçi Xoxe e flaku dhe e mbante jashtë Partisë padrejtësisht. Ka bashkëpunuar gjithashtu me Pilo Peristerin, militant i vjetër e me të tjerë.

Nga gjiri i grupit të Korçës, dy herë rresht, kanë dalë dy grupe fraksionistësh: i pari, grupi i Niko Xoxit dhe i dyti, grupi i «Të Rinjve», siç u quajt në atë kohë. Në Rezolucionin e parë të Partisë shkruhet: «Më 1934 përjashtohet nga «Puna e Korçës» Niko Xoxi, për luftën e paprinciptë kundër vijës së ndjekur prej shokut Ali Kelmendi. Niko Xoxi bashkohet me ideologjinë e intelektualëve arqiomarksistë, të ardhur që nga Greqia në Shqipëri, krijon fraksionin e tij dhe lufton pjesëmarrjen e komunistëve në lëvizjen e masave duke shpikur teorinë e «kuadrove». Më vonë Niko Xoxi lot rolin e grevëthyesit pastaj të provokatorit e më në fund (në gjyqin e komunistëve, janar 1939), tradhëton haptazi»¹. Niko Xoxi, për një kohë, me demagogjinë e tij, gënjeu një sërë shokësh punëtorë të grupit të Korçës, të cilët më

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, faqe 13.

vonë e braktisën vijën e tij trockiste; gjithashtu Niko Xoxi arriti të bashkohet dhe të influencojë në vijën politike dhe organizative të grupit tjetër komunist, atij të Shkodrës dhe të grupit të «Të Rinjve», që shkëputet në vitin 1940, si fraksion nga grupi i Korçës.

Grupi i «Të Rinjve», i udhëhequr nga armiqtë e klasës punëtore dhe tradhëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Anastas Lula, me pseudonimin Qorri dhe elementi i imperializmit, Sadik Premte, me pseudonimin Xhepi ka pasur në vijën e tij politike dhe organizative devijime e gabime shumë të rënda. Grupi i «Të Rinjve» nuk kishte tiparet e një organizate aq sa edhe forma e organizimit në celula, qoftë edhe në formë shumë sektare, nuk përfillej dhe njerëzit e grupit lidheshin varg njëri pas tjetrit. Grupi nuk kishte aktivitet dhe kontakt me masat dhe, nën fjalën konspiracion, mbahej një fshehtësi e plotë e përhapjes së ideve të komunizmit. Parulla: «Të fshihet dhe të mos diktohet qenja komunist» ishte në rendin e ditës, jo vetëm përpara popullit e familjes, po edhe përpara shokëve të grupit. Lidhja me masat dhe puna me to konsiderohej prej grupit si e dëmshme, pse dëmtonte dhe rrezikonte kuadrot. Kjo ishte teoria e përgatitjes së kuadrit dhe përdorimi i tyre vetëm në kohën e volitshme. Përbërja e grupit ishte kryesisht prej studentësh, kishte pak punëtorë. Në grup kishte edhe pasanikë, pra përbërja klasore ishte një gjë pa rëndësi për ta dhe orientimi për përgatitjen e kuadrove i shpinte në kërkimin e njerëzve intelektualë të shtresës së lartë. Format, metodat dhe pikëpamjet e gabuara, bënë që të mos kishte demokraci të brendshme në grup. Urdhërat e kryetarëve duhej të zbatoheshin.

Disiplina ishte një gjë fare e kalbur dhe konsistonte në zbatimin e urdhërave të kryetarëve, urdhëra që konsistonin më të shumtën e herës në çështje personale më intime si: martesë e detyruar, predikimi i moralit të dobët, në kundërshtim diametral me moralin proletar; vjedhja e deri vrasja, ishin në rendin e ditës; korrupsioni gjithashtu. Në lidhje me familjen, grupi kishte marrë hua dhe e kishte bërë të tijën propagandën e armiqve, që komunistët nuk kanë familje dhe se familja ishte një institucion borgjez që duhej zhdukur. Njerëzit e grupit urdhëroheshin të vidhnin pasuritë e familjes dhe të ziheshin me familjet. Për grupin e «Të Rinjve» një komunist nuk mundej të donte vëllanë ose motrën e tij, se këto ishin «lidhje borgjeze».

Në grupin e «Të Rinjve» nuk kishte unitet pikëpamjesh dhe kryetarët e grupit, për të mbajtur rreth tyre elementët, që i përdornin për të luftuar grupet e tjera, kishin të zhvilluar në shkallë të gjerë oportunitizmin.

Deviacionet politike të grupit të «Të Rinjve» kanë qenë të mëdha. Ky grup nuk kishte pikëpamje të qarta politike, në lidhje me situatën e krijuar në vendin tonë. Njerëzit e grupit e quanin veten komunistë, bisedonin çështje teorike të shkëputura dhe më të shumtën e herës ushqimi i tyre teorik kanë qenë vetëm librat e antimarksishtëve, të revizionistëve të marksizëm-leninizmit, literatura arqiomarksiste e të gjithë armiqve të komunizmit dhe të Bashkimit Sovjetik. Luftën e dytë botërore, të shpërthyer nga Gjermania hitleriane, ky grup e konsideronte një gjë të mirë dhe traktatin në mes të Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë e kuptonte po në atë plat-

formë të gabuar, sikundërqë e kuptonte imperializmi anglo-amerikan. Okupacionin fashist në vendin tonë, grupi i «Të Rinjve» e konsideronte si një ngjarje jo shumë të keqe, nën pretekstin se gjoja te ne do të zmadhohet proletariati dhe atëhere do të kuptohet mirë se çfarë është kapitalizmi dhe duke u shtuar proletariati, atëhere do të krijoheshin konditat për formimin e një partie komuniste. Gjithashtu mendohej se me okupacionin italian do të bëheshin më mirë lidhjet në mes të punëtorisë shqiptare dhe italiane.

Njerëzit e grupit të «Të Rinjve» mendonin se politika e Bashkimit Sovjetik nuk ishte konsekuente e për të mirën e popullit. Mendohej gjithashtu se shteti sovjetik bënte deklaratat që s'i përgjigjeshin së vërtetës, por që ishin «një nevojë diplomatike» ose «nevojë propagandistike». Këto pikëpamje ata i merrnin hua drejtpërdrejt nga armiqtë e Bashkimit Sovjetik. Këto pikëpamje në grupin e «Të Rinjve» qëndronin në këmbë edhe pas hyrjes në luftë të Bashkimit Sovjetik, duke menduar se edhe shteti socialist nuk i deklaronte haptas qëllimet që kishte në luftë dhe se deklaratat e bëra kishin për qëllim vetëm kapërcimin e një situatë të vështirë. Duke u nisur nga kjo pikëpamje, se në qëndrimin politik mund të lejoheshin gjëra të tilla, d.m.th. qëndrime për të dalë nga situata të vështira pa qenë këto të sigjerta, mendohej nga njerëzit e grupit se, edhe thirrja që duhej t'i bëhej popullit për luftë kundër okupatorit fashist, të ishte një qëndrim i tillë, mashtrues, i përkohshëm dhe të mos vihej në dukje drejtimi i Partisë dhe ardhja e saj në fuqi. Ardhja e Partisë në fuqi, për grupin e «Të Rinjve», nuk duhej të zhvillohej drejt, por si një punë

që do të arrihej me këto manevra dhe jo në luftë dhe me lidhje të shëndosha me masat e popullit.

Nga grupi i «Të Rinjve» nuk shihej mundësia e krijimit të një partie komuniste në Shqipëri nën pretekstin se «nuk kishte proletariatin dhe nuk ekzistonte lufta e klasës». Për grupin e «Të Rinjve» fshatarësia e varfër nuk ishte një klasë revolucionare dhe as që mund të shkonte në luftë e në revolucion në aleancë me klasën punëtore, e cila nuk ekzistonte për ta. Prandaj, kryetarët e grupit të «Të Rinjve» mendonin se lufta e klasave në vendin tonë duhej të zhvillohej në familje, kundër pleqve, gjoja se ata ishin konservatorë, etj., të këtij lloji. Lufta e këtij grupi me të tilla parime ishte drejtuar kryesisht kundër grupeve të tjera komuniste dhe sidomos kundër atij të Korçës për të luftuar pikëpamjet e drejta të këtij grupi.

Grupi i Shkodrës në forma pak a shumë të organizuara lindi në vitin 1938¹. Përsa i përket vijës politike, as kryetari i grupit dhe as anëtarët e thjeshtë nuk ishin të qartë. Në përgjithësi ata e urrenin regjimin e Zogut, imperializmin dhe fashizmin, kishin simpati të madhe për Bashkimin Sovjetik, për komunizmin, por se ç'duhej të bënin dhe si duhej ta organizonin luftën, ata nuk ishin të qartë. Format e organizimit të grupit të Shkodrës ishin shumë të dobëta dhe sipas rastit ishin në formë treshe, pesëshe dhe në lidhje individuale; anëtarët lidheshin me përgjegjës të kryesor direkt ose varg njëri me tjetrin. Në grup nuk ekzistonte njësi mendimi dhe

¹ Dokumentat e njohura kohët e fundit bëjnë të ditur se organizata e parë komuniste në Shkodër u themelua më 1934. Ndërsa më 1937 u krijuan komitetet e para qarkore në Shkodër dhe në Tiranë.

veprimi, atje kishte një konspiracion të kalbur, një disiplinë formale. Në grupin e Shkodrës kishte gjithfarë elementësh të rekrutuar jo në baza të shëndosha, kishte shokë të vendosur dhe të devotshëm deri në fund për çështjen e komunizmit dhe gati të bënin çdo sakrificë, po kishte edhe elementë që s'kishin të bënin fare me komunizmin. Procesi i 1939-s nxori në shesh dobësitë e mëdha të grupit të Shkodrës. Kryetari i grupit në këtë proces tradhëtoi shokët e tij, duke treguar para policisë dhe u krijua teoria antirevolucionare, antimarksiste se gjoja komunistët mund të tregojnë para policisë pa tradhëtuar klasën punëtore. Krerët e grupit të Shkodrës, duke pasur në bazë luftën e paprincipitë kundër grupeve të tjera dhe sidomos kundër grupit të Korçës, ranë në kontakt dhe u lidhën me fraksionin trockist të Korçës, të kryesuar nga Niko Xoxi, duke krijuar kësisoj një rrjet shumë të dobët, në dy-tri qytete kryesore të Shqipërisë, përveç ndonjë elementi të shkëputur në ndonjë qytet tjetër. Megjithëse kjo lidhje formalisht u bë, akoma nuk kishte një vijë politike sado pak të kristalizuuar.

Për të organizuar gjoja më mirë punën, për të përcaktuar vijën politike dhe për të zgjeruar sferën e veprimtarisë komuniste, krerët e grupit të Shkodrës vendosën nxjerrjen e një buletini, me anën e të cilit do të sqaroheshin shokët politikisht dhe ideologjikisht dhe do të orientoheshin mbi zgjidhjen e detyrave praktike të punës së përditshme. Me anën e buletinit do të pregatitej gjoja terreni për thirrjen e kongresit, nga i cili do të themelohej partia.

Në buletinin e quajtur «Buletini jeshil» pasqyrohen

një tok teorish antimarksiste dhe gabime të mëdha politike të grupit komunist të Shkodrës, si p.sh. teoria e «rritjes dhe e ruajtjes së kuadrove», studimi dhe vlerësimi i shtre mbër i shtresave dhe klasave shoqërore në vendin tonë, «mungesa e borgjezisë dhe e proletariatit», «zanatçinjtë janë pjesa më revolucionare e Shqipërisë», «vendosja e federatës socialiste ballkanike», etj. Dalja në dritë e «Buletinit jeshil» e ashpërsoi luftën e grupit komunist të Shkodrës kundër grupit komunist të Korçës, qëndrimin politik dhe organizativ të të cilit, krerët e grupit të Shkodrës e quanin oportunist dhe e akuzonin se gjoja kishte shtre mbëruar direktivat e Kominternit. Megjithëse edhe më përpara ekzistonte një konfuzion i madh politik dhe ideologjik, dalja e «Buletinit jeshil» e thelloi edhe më tepër konfuzionin dhe filluan të lindin dhe të marrin forma teoritë antimarksishteleniniste. Si përfundim, grupi komunist i Shkodrës nuk kishte akoma një platformë politike të caktuar. Vetëm se me daljen e «Buletinit jeshil» kjo kaloi në drejtime të shtre mbëra dhe të gabuara, që sillnin shtimin përherë e më shumë të konfuzionit politik dhe ideologjik, ashpërsimin e luftës së grupit të Shkodrës, sepse padrejtësisht grupit të Korçës i ngarkohej faji i mosbashkimit, por në të vërtetë i mosnënshtrimit ndaj pikëpamjeve politike dhe formave të organizimit sipas dëshirave të krerëve të grupit të Shkodrës. Grupi i Shkodrës dhe Niko Xoxi luftuan mundësinë e krijimit të një fronti popullor antiimperialist në Shqipëri nën pretekstin se gjoja nuk ekzistonte një parti komuniste shqiptare.

Pas okupacionit, puna politike dhe organizative e këtij grupi vazhdoi po në ato pikëpamje politike dhe

organizative deri në kompromisin oportunist, socialdemokrat, që u bë në mes të këtij grupi dhe të grupit të Korçës, për formimin e një qendre të vetme drejtuese, gjë që s'dha asnjë rezultat. Por grupi i Shkodrës ka në aktivin e tij organizimin e demonstratave kundër okupatorit dhe tradhëtarëve në nëntor të 1939-s, protestat e nxënësve, përpjekjet e shokëve të grupit të Shkodrës në Tiranë për lidhjet me masat punëtore, duke u përpjekur të ngriheshin sindikatat profesionale si ato të marangozëve, të tipografëve, etj.

«Teorinë e kuadrove» dhe nxitjen e luftës së grupit të Shkodrës kundër grupit të Korçës, grupi komunist i Shkodrës e përvetësoi nga trockistët e Korçës, të kryesuar nga Niko Xoxi, kurse teoritë e martesave të imponuara, e të moralit joproletar, të vjedhjeve dhe të vrasjeve, i ka marrë më vonë nga grupi i «Të Rinjve». Teoritë e tjera të lartpërmendura, si «mungesa në vendin tonë e borgjezisë dhe e proletariatit» që «zanatçinjtë janë pjesa më revolucionare e Shqipërisë», vlerësimi i gabuar i shtresave dhe i klasave shoqërore në vendin tonë, i janë imponuar grupit nga drejtuesi i tij, trockisti Zef Mala.

Grupi i «Zjarrit» u krijua nga fillimi i vitit 1936 në Athinë me iniciativën e një farë Andrea Zisi, element arqiomarksit trockist që i vuri vetes pseudonimin Zjarri. Grupi i tij, i ashtuquajtur komunist, përbëhej në origjinë prej 4 studentësh arqiomarksistë shqiptarë që studjonin në Greqi. Më vonë, pas mjaft intrigash, Andrea Zisi mundi të futë në grupin e tij një grup tjetër që ekzistonte në Athinë, i përbërë prej studentësh shqiptarë me idera antizogiste. Në një mbledhje të ngushtë,

të provokuar prej Andrea Zisit në Athinë, ky grup u vetëquajt «Partia Komuniste Shqiptare». Asnjë aktivitet nuk u zhvillua prej këtij grupi edhe pas kësaj mbledhjeje. Me kalimin e tij nga Athina, shoku Ali Kelmendi goditi ashpër pikëpamjet antimarksiste e arqiomarksiste të Andrea Zisit dhe që këtej fillon lufta e trockistit Andrea Zisi kundër shokut Ali Kelmendi dhe parimeve të drejta të tij. Më 1939, më 7 prill, njerëzit e Zisit penguan veprimtarinë e grupit shqiptar në Athinë duke i ndaluar të vinin në Shqipëri, për të luftuar kundër Musolinit dhe këtë e fshehën nën parullën e përbashkët të trockistëve se «më parë duhej të përgatiteshin kuadrot». Vetë orientimi për rekrutimin e kuadrove, drejtohej te njerëzit me influencë. Andrea Zisi, Zjarri, me përrallën e tij të «Partisë Komuniste Shqiptare» dhe gjoja i mbështetur nga Partia Komuniste Greke, gënjeu dhe krijoi vetëbesim në disa shokë të vet kundrejt tij. Andrea Zisi, që ishte vetëcaktuar sekretar, pas ardhjes së tij në Shqipëri më 1939, filloi tratativat me kuislingun Mustafa Kruja. Në takimet e tij me kuislingun Mustafa Kruja, Andrea Zisi u bë agjent i italianëve. Kompromisi i grupit të «Zjarrit» me okupatorin përmbante këto kondita:

1. — Grupi i «Zjarrit» të pushonte menjëherë luftën kundër qeverisë së Mustafa Krujës (në realitet grupi i «Zjarrit» deri atëhere s'kishte bërë asnjë aktivitet kundër Mustafa Krujës dhe fashizmit) dhe

2. — Qeveria kuislinge e Mustafa Krujës të merrte angazhim të mos i arrestonte pjesëtarët e këtij grupi dhe të nxirrte jashtë ata që ishin burgosur.

Por i ashtuquajturi komitet qendror i grupit të

«Zjarrit», që përbëhej nga elementë heterogjenë dhe të dyshimtë, me përjashtim të ndonjërit element të pasqaruar, s'e pranoi këtë kompromis dhe përjashtoi Andrea Zisin si tradhëtar.

Karakteristikat kryesore të këtij grupi kanë qenë: një rreth shumë i mbyllur, ku fermentoheshin idera trociste dhe antisovjetike, grindje personale e tarafi, ku nuk ekzistonte veçse punë individuale e shkëputur dhe ku predominonte ideja e kompromisit. Vija politike e grupit, gjoja antizogiste, përpara okupacionit, s'dha asnjë rezultat dhe s'u bë asnjë përpjekje për realizimin e kësaj vije. Vija politike e grupit të «Zjarrit», gjatë okupacionit, s'ishte përveçse një vijë kompromisi me okupatorin. Pikëpamjet e Andrea Zisit ishin që të mos luftohej armiku, por të gjithë njerëzit e grupit të shkriheshin në organet administrative dhe policore të fashizmit. Aleanca anglo-sovjeto-amerikane shihej me dyshim të madh dhe nuk besohej në të. Andrea Zisi e orientonte grupin në dobësimin e urrejtjes kundrejt fashizmit dhe ai përdorte po ato parulla që përdorte fashizmi kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe lëvizjes nacional-çlirimtare. Grupi i «Zjarrit», të vetëquajturën parti komuniste të tyre, e maskonin dhe e quanin si një parti nacionale, për të lehtësuar bashkëpunimin e tyre me «nacionalistët» dhe krerët e këtij grupi, tok me Andrea Zisin, si Feta Butka, Hysni Lepenica, etj. Që të gjithë këta, që s'ishin veçse ballistë dhe «nacionalistë», kanë qenë që në atë kohë eksponentë të «Ballit» dhe nuk bënë gjë tjetër përveçse zbatonin platformën e «Ballit Kombëtar», që ishte kundër Luftës nacional-çlirimtare dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Në Tiranë hidheshin trakte me ngjyra të theksuara fashiste nga ana e «Zjarrit», ku ftonin popullin të luftonte kundër «kapitalit». Ndërkohë lëshoheshin disa fletushka «edukative» me shtrembërime të mëdha të marksizmit. Në të gjithë vijën e tij grupi i «Zjarrit», ishte në pozitë armikut. Një numër elementësh të pastër të grupit të «Zjarrit», në mënyrë individuale dhe të shkëputur, flisnin mirë për Bashkimin Sovjetik dhe për Luftën nacional-çlirimtare dhe nën drejtimin e këtyre, pa marrë aprovimin e qendrës së grupit u bënë disa aksione në Vlorë me frymë antifashiste.

Format organizative të grupit kanë qenë të shthurura. Andrea Zisi vetë mbante lidhjet në mënyrë individuale. Format e një farë komiteti qendror dhe të komiteteve qarkore, që thuhej se ekzistonin, ishin vetëm në kokën e Andrea Zisit Gjoja grupi kishte komitete qarkore, celula treshe, por asnjëra nga këto nuk funksiononte. Puna e celulave bëhej nëpër rrugë dhe rekrutimi i anëtarëve të rinj bëhej nëpër rrugë, duke shëtitur. Grupi s'bënte asnjë punë, as me rininë, as me granat dhe as me punëtorinë. Ky grup s'kishte veçse fare pak lidhje me masat dhe influenca e Partisë Komuniste të Shqipërisë ja likuidoi edhe këto lidhje të dobëta.

Pikëpamjet e grupit të «Zjarrit», në lidhje me fshatin ishin këto: «Të lidhemi më parë me kulakun e fshatit», pra, orientimi me fshatin drejt kulakut, agait. Në masat e punëtorisë rekrutoheshin vetëm elementë të dobët. Krerët e grupit të «Zjarrit», Andrea Zisi, Uan Filipi, Hysni Lepenica, Feta Butka, etj. ishin në origjinën e formimit të «Ballit Kombëtar». Pas likuidimit të Andrea Zisit elementë të shëndoshë të grupit të «Zjarrit»

filluan të shkunden, po duke qëndruar kurdoherë në pozitë e vjetra. Grupi i «Zjarrit» kishte pas tentuar të bashkohej që në vitin 1940-1941 me grupin e «Të Rinjve» dhe me atë të Shkodrës, po nuk arriti asnjë rezultat. Në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë grupi i «Zjarrit» u thirr dhe ai të bënte shkrirjen e tij, por Andrea Zisi e luftoi këtë gjë dhe s'pranoi. Lufta e ashpër, e ndezur në të katër anët kundër fashizmit, nën drejtimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë bëri diferencimin në masat e këtij grupi dhe qëndrimi i prerë i organit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, «Zëri i Popullit» në fillim të vitit 1943, demaskoi politikën dhe veprimtarinë trockiste e antishqiptare¹. Kjo ishte goditja vendimtare që i dha fund veprimtarisë së këtij grupi.

Elementët e shëndoshë të këtij grupi braktisën rrugën e gabuar dhe u shkrinë në Partinë Komuniste të Shqipërisë². Grupi trockist i «Zjarrit» kishte mbaruar së ekzistuari.

E tillë ishte gjendja e lëvizjes komuniste në Shqipëri dhe e grupeve të ndryshme komuniste para dhe pas okupacionit deri në formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Deri në formimin e Partisë organizimi i rezistencës dhe i luftës së armatosur kundër okupatorit dhe kuislingëve bëhej në mënyrë jo shumë të organizuar dhe me përpjekje të vazhdueshme në mes të grupeve të

¹ Është fjala për artikullin «Pak fjalë për disa shërbëtorë të fashizmit: Grupi i «Zjarrit». «Zëri i Popullit», Nr. 11-12, janar 1943. Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, f. 160.

² Shkrirja e plotë e grupit të «Zjarrit» përfundoi në mars të vitit 1943.

ndryshme mbi të cilat godiste pa mëshirë dora e okupatorit. Në mes të këtyre grupeve, në grindje njëri me tjetrin, shquhej grupi i Korçës me një vijë politike më konsekuente dhe të drejtë dhe me një organizim më të shëndoshë për luftë dhe për aksione. Grupi i Korçës ishte për sabotazhe, për demonstrata, për trakte, që të mobilizohej populli në luftë. Ky grup i hodhi gjithë anëtarët e tij në përpjekje me okupatorin, kurse grupet e tjera, të mbizotëruara nga pikëpamjet antimarksiste, nga lufta e theksuar e grupazhit, fraksioniste e trockiste, shumë herë në pozita të okupatorit, siç u shpjegua më lart dhe të dominuara nga teoritë e kalbura, siç ishin ato të «ruajtjes së kuadrit» dhe të «formimit të kuadrove», hezitonin për një kohë shumë të gjatë. Këto grupe, me përjashtim të grupit të Korçës, mbronin pikëpamjen se «kuadrot më parë duhet të edukoheshin me teorinë marksiste-leniniste, pastaj të krijonin partinë komuniste shqiptare dhe të hidheshin në luftë, vetëm kur Bashkimi Sovjetik të hynte eventualisht në luftë». Këto grupe, me pikëpamje politike të tilla të gabuara dhe me forma organizative të shthurura, harronin që armiku ishte shtruar në vatrat tona dhe po vriste e digjte popullin tonë dhe se taktika e tyre s'çonte ujë, përveçse në mullirin e okupatorit. Direktivat e Kominternit, këto grupe as bënë përpjekje t'i thëllonin, t'i kuptonin mirë dhe t'i zbatonin në jetë, por në kohën kur armiku po grinte popullin tonë, ato përpiqeshin me një luftë grupazhi e tarafi të zhvillonin një luftë kundër grupit të Korçës, duke pretenduar gjithsecili të vetëquhej parti komuniste, të predominonte mbi të tjerët dhe t'i impononte tjetrit pikëpamjet e tija. Kjo ishte luf-

ta e paprincipitë në mes të grupeve. Kjo gjë ka shkaktuar që herë pas here të hidhen trakte me qëndrime politike të gabuara, ku është shkruajtur se «luftohet për një Shqipëri sovjetike», «për një Shqipëri komuniste», «për organizimin e një ushtrie të kuqe shqiptare», dhe, në një kohë kur lidhjet e grupeve me masat kanë qenë shumë të dobëta dhe s'kishte përgatitje, është thirrur populli për kryengritje të përgjithshme. Në një kohë grupet dhe në radhë të parë grupi i Korçës dhe i Shkodrës, përpara nevojës së bashkimit, arritën të krijojnë në mes të tyre një të ashtuquajtur komitet qendror¹ në baza të kalbura, në forma organizative të gabuara dhe në baza krejt të pasinqerta. Kjo gjë s'dha asnjë rezultat, përkundrazi e zmadhoi luftën në mes të tyre. Përpara nevojës urgjente të koordinimit të aksioneve kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve u arrit marrëveshja për krijimin e një komisioni arbitrazhi të veprimtarive², komision që s'pati asnjë sukses, sepse ishte me baza krejt të gabuara. Ky komision koordinimi veprimesh në mes të tri grupeve, nuk e ndihmoi luftën kundër okupatorit.

Nga ana tjetër hovi i masave të gjera të popullit, të gatshme për luftë kundër okupatorit, demonstratat e popullit dhe të rinisë, që udhëhiqeshin nga elementët më të shëndoshë të grupeve, sabotazhet e ndryshme, të kry-

1 Është fjala për të ashtuquajturin komitet qendror të përbashkët, që doli nga bisedimet e zhvilluara në vjeshtë të vitit 1939 midis krerëve të grupit komunist të Korçës dhe grupit komunist të Shkodrës.

2 Komisioni i arbitrazhit u krijua si rezultat i marrëveshjes së arritur midis grupit komunist të Shkodrës dhe atij të Korçës në gusht të vitit 1941.

era me guxim nga elementët e shëndoshë të grupeve, të cilët nuk i përfillnin sa duhej krerët e tyre, bënë që të tronditej baza e shëndoshë e grupeve, të humbisnin besimin ndaj krerëve dhe të demaskoheshin ata. Në luftë dhe në përpjekje me okupatorin dhe me kuislingët, të bashkuar për një qëllim, për çlirimin e vendit nga okupatori, komunistët e shëndoshë të bazës së grupeve të ndryshme po lidheshin me gjak me njëri-tjetrin dhe harronin zënkat e meritë. Tani po kristalizohej në ta vija e drejtë e komunistëve dhe kërkohesh bashkimi në një parti të vetme, konditë sine qua non për organizimin e luftës së çlirimit dhe për drejtimin e saj. Komunistët e grupeve e ndjenin thellë përgjegjësinë e tyre ndaj popullit. Sado që në atë kohë Partia jonë nuk ishte formuar akoma dhe veprimtaria revolucionare e grupeve të ndryshme nuk kishte një drejtim unik dhe megjithëse populli ynë nuk e njihnte akoma mirë Bashkimin Sovjetik, ai kishte besim dhe shpresë të madhe te popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik, sepse jehona e Revolucionit të Tetorit kishte ardhur te ai dhe se në Moskë, nga Kremli, Stalini i madh drejtonte bolshevikët në fitore kundër shtypësve të vendit tonë, drejtonte Ushtrinë famëmadhe të Kuqe, që kishte rrëzuar feudalët e kapitalistët dhe kishte vendosur regjimin e proletariatit. Populli ynë nuk mund të rronte i robëruar, ai kurrë s'ë ka pranuar robërinë, nuk mund të lejonte të luhej me fatin e tij. Asambletë dhe qeveritë kukulla të Romës ishin të huaja për të. Të ashtuquajturin statut të ri¹, me të cilin gjithë të drejtat legjislative dhe ekzeku-

1 I ashtuquajturi Statuti Themeltar i Mbretërisë së Shqipë-

tive i takonin mbretit të Italisë, populli ynë e shqelmoi. Populli ynë preferoi të matej dhe u mat me okupatorët në një luftë të pamëshirshme dhe të pabarabartë. Por këtë herë, për popullin tonë, çështja nuk do të shkonte si më 1912, më 1920 ose më 1924. Kishte ardhur dita që populli ynë të qëronte hesapet me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm dhe t'i qëronte këta përgjithmonë nga kurrizi i tij plot plagë. Populli ynë kishte besim të madh në fitore, pse ai e dinte dhe e ndjente mu në zëmër se lufta e madhe çlirimtare udhëhiqej nga atdheu i lavdishëm i socializmit që kishte në krye Partinë e madhe Bolshevike dhe Stalinin e madh. Populli ynë kishte kuptuar se fati i tij luhej në këtë luftë dhe se rruga duhej zgjedhur mirë e duhej luftuar deri në fund për këtë rrugë të drejtë. Ai e kishte kuptuar se s'do ta derdhte gjakun më për Ali Beun ose Mithat Beun, ashtu sikundër që e kishte derdhur më parë për bejlerë të tjerë që i kishin bërë varrin. Këtë radhë kishte ardhur koha të forconte besimin në veten e tij dhe të drejtonte vetë fatet e tij. Kjo ishte garancia e fitores. Besimi në forcat e tija dhe te Bashkimi Sovjetik e bënë popullin tonë të hidhet në luftë, të vëllazërohet me popuj të tjerë, të cilëve ju rezervua i njëjti fat. Kur ushtria fashiste sulmoi Greqinë, populli ynë mbajti një qëndrim të drejtë kundrejt kësaj lufte grabitqare të fashizmit. Populli ynë e ndihmoi drejtpërsëdrejti luftën e popullit grek kundër fashizmit italian dhe gjerman, goditi vijat e komunikacionit të ushtrisë italiane, sabotoi mobilizimin e

risë u shpall në Romë më 3 qershor 1939 nga mbreti i Italisë fashiste.

milicisë dhe nuk pranoi që të përdorej prej fashizmit kundër popullit grek. Ushtarët shqiptarë, të mobilizuar me forcë nga Italia, nuk i ngritën armët kundër popullit vëlla grek, përkundrazi batalionet «Tomori» dhe «Taraboshi» dezertuan nga fronti.

FORMIMI I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË DHE ORGANIZIMI I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Të gjitha këto situata dhe sidomos hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftë, pas goditjes tradhëtare të Gjermanisë hitleriane kundër Bashkimit Sovjetik, ishte një thikë në zemër për gjithë komunistët e Shqipërisë dhe për të gjithë popullin tonë të etshëm për liri. Vendi dhe vepra e pavdekshme e Leninit dhe e Stalinit, që ishin aq të shtrenjta për komunistët shqiptarë, u sulmuan. S'kishte më hezitime. Komunisti që donte popullin e tij, donte po aq Bashkimin Sovjetik. Dashuria për Bashkimin Sovjetik nuk mund të shkëputej për komunistët nga dashuria për popullin e vet. Hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftë, pra, i dha hov rezistencës së popullit shqiptar dhe krijoi konditat e nevojshme për krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila u formua më 8 Nëntor 1941, në zjarrin e luftës kundër fashizmit dhe koincidoi me ditën e madhe të Revolucionit të Tetorit, nga i cili u frymëzua, me mësimet e të cilit u brumos dhe u çelnikos. Partia, e udhëhequr në çdo hap nga mësimet e mësuesve të mëdhenj të proletariatit ndërkombëtar Marks-Engels-Lenin-Stalin, duke mbajtur kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, luftoi me heroi-

zëm për lirinë e popullit të saj dhe ndoqi me besnikëri mësimet e Partisë së lavdishme Bolshevike, duke ruajtur shtrenjtë në zemër dashurinë për shokun tonë të madh, Josif Visarianoviç Stalin.

Sikundërqë thamë edhe më lart, në bazë të formimit të Partisë sonë janë grupet komuniste. Ju desh një punë e madhe themeluesve të Partisë për të ndërtuar platformën e bashkimit të grupeve në një parti të vetme. Një punë të tillë e bënë shokët komunistë të grupeve të ndryshme të painfektuar nga puna e grupeve fraksioniste dhe që ishin të vendosur ta çonin këtë çështje deri në fund, duke vënë përpara interesat e larta të atdheut e të popullit dhe duke i shqelmuar pa mëshirë tendencat e frymën e sëmurë të grupit. Në këtë punë të rëndë, po jetike për vendin tonë, shokët komunistë shqiptarë u ndihmuan me gjithë zemër prej komunistit internacionalist jugosllav Miladin Popoviçit, i cili luftoi me heroizëm deri në fund me popullin dhe Partinë tonë. Shokët komunistë shqiptarë, që ju ngarkua detyra dhe nderi i madh të formonin Partinë tonë nën terrorin e madh të armikut, në një shtëpi të varfër të Tiranës, në gjirin e popullit të varfër, për të cilin do të luftonte Partia jonë, mundën të mposhtnin rezistencën e troc-kistëve Anastas Lula dhe Sadik Premte, të krijonin Partinë dhe të zgjidhnin Komitetin Qendror të Përkohshëm të Partisë. Formimi i Partisë ishte fitorja më e shkëlqyer në historinë e popullit tonë, sepse për herë të parë ky kishte udhëheqësen e sigurt të tij, të dalë nga gjiri i tij, të formuar nga djemtë e tij, që për të mbrojtur interesat e tij, do të sakrifikonin deri në fund edhe pikën e fundit të gjakut të tyre. Një barrë e rëndë i

vihej përpara Partisë sonë të re dhe Komitetit Qendror të saj, barrë e rëndë, por e lavdishme që ata do ta kryenin me nder.

Komiteti Qendror i Përkohshëm mori përnjëherësh në dorëzim elementët e grupeve, likuidoi organizatat e kaluara me frymë fraksioni dhe grupazhi, likuidoi mënyrat e të punuarit në baza të vjetra, likuidoi celulat e vjetra sektare dhe të mbyllura në vetëvete dhe pa asnjë lidhje me masat e popullit. Komiteti Qendror i Përkohshëm ju përvesh punës për organizimin e gjithë komunistëve në celula të reja, për organizimin e komiteteve qarkore në të gjithë Shqipërinë me njerëz të rinj, të pastër dhe të vendosur për çështjen e komunizmit dhe të popullit. Ai vendosi lidhjet organike të shëndosha të Partisë në bazë të parimit të centralizmit demokratik dhe në rend të parë u vuri detyrë anëtarëve të Partisë së tipit të ri, që po krijonin, se duhej të luftonin gabimet, veçanërisht tentativat për rikrijimin e grupeve. Në radhë të parë ai i mësoi komunistët që të luftonin pa mëshirë kundër armikut të klasës dhe të Partisë. Partia jonë e re, pararoja e klasës punëtore që po krijohet, s'kishte asnjë ngjasi me ato parti të Internacionales së dytë, në të cilat mbretëronte fraksioni, oportunizmi, tarafi dhe tradhëtia ndaj interesave të klasës punëtore. Komiteti Qendror i Përkohshëm në ato momente të vështira vuri me forcë përpara Partisë detyrën që të ushtronte një vigjilencë të jashtzakonshme dhe një disiplinë të hekurt e të ndërgjegjshme për të goditur pa mëshirë elementët grupashë e fraksionistë, që nuk do t'i kishin hedhur armët, ose, që do ta godisnin Partinë pas shpine.

Komiteti Qendror i Përkohshëm në Rezolucionin e tij të parë i tha Partisë:

«Duam një parti të disiplinuar, në të cilën shokët do t'u nënshtrohen forumeve (komiteteve) më të larta, parti e cila do të jetë e zonja të udhëheqë klasën punëtore në luftë deri në fitim e cila do të jetë ngushtësisht e lidhur me të gjitha turmat punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Po të mos ndahen nga populli, nga nëna, e cila i ka lindur, komunistët do të jenë të pathyeshëm — kësh-tu na ka mësuar mësuesi ynë i madh Stalin. Të tillë parti duam»¹.

Komiteli Qendror i Përkohshëm i tha Partisë:

«Për të ruajtur Partinë nga goditjet e armikut të klasës, prej tendencave të ndryshme të taraseve, prej veprimeve shkatërruese të ndonjërit, është e nevojshme që sa më shpejt dhe sa më energjikisht të vazhdojmë pastrimin e radhëve të partisë duke mbajtur atë që është e mirë dhe duke e shkëputur nga influenca e huaj. Është e nevojshme të likuidohet kufizimi në punë, politikanllëku, liberalizmi dhe shfaqjet oportuniste»².

Në Partinë tonë të re, të porsakrijuar nga grupet e ndryshme të sëmura, u çelnikos njësia e veprimit dhe e mendimit, sepse u goditën pa mëshirë tendencat e së-

1 Dokumenta Kryesore të PPSII, Vëll. I, f. 19.

2 Po aty.

mura të fraksionizmit dhe të grupazhit, sepse u seleksionuan anëtarët e shëndoshë të grupeve, u vu kujdes i madh për të shëruar të sëmurët dhe për të hedhur poshtë të pandreqshmit. Komiteti Qendror i Përkohshëm i vuri detyrë Partisë të shumëzonte radhët e saja me elementë të vendosur për komunizmin e për luftën kundër okupatorit dhe në radhë të parë, me punëtorë, fshatarë të varfër e të mesëm, me elementë të shtresave të varfëra të qytetit nga të cilët do të dilnin udhëheqësit e shëndoshë dhe luftëtarët e shquar të Partisë sonë. Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë i vuri vetes dhe Partisë detyrën të armatoseshin me ideologjinë marksiste-leniniste, armën e paçmueshme të Partisë sonë, me mësimet e Historisë së Partisë Bolshevike dhe me shkrimet e paçmueshme të shokut Stalin, me të cilat në gji do të hidheshin në luftë anëtarët e Partisë. Komiteti Qendror i Përkohshëm i tha Partisë të donte me të gjitha forcat e shpirtit të saj Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin... Komiteti Qendror i Përkohshëm vendosi format organizative të drejta dhe lidhjet e rregullta në mes të organizatave bazë të Partisë dhe forumeve më të larta.

Komiteti Qendror i Përkohshëm i tha Partisë sonë të re:

«Për të shëndoshur gjendjen në Parti, është e nevojshme iniciativë sa më e madhe e celulave, e shokët udhëheqës duhet ta ndihmojnë me çdo mënyrë këtë iniciativë. Duhet që shokët të shkrijnë të gjithë vullnetin dhe zjarrin e mundshëm të tyre në punën e përditshme të Partisë. Duhet të zhvillojnë dashurinë për Partinë

*dhe ta ruajnë emrin tonë dhe të Partisë sonë si sytë e veta*¹.

Nga ana tjetër i këshillohej Partisë dhe anëtarëve të saj se mungesa e disiplinës, përçmimi dhe përbuzja e punës dhe e vendimeve të Partisë, është një nga dukjet më të rënda dhe më të dëmshme në organizatë. Është e domosdoshme t'u jepet fund këtyre dukjeve, është e domosdoshme disiplina e çelniktë dhe nënshtrimi patjetër ndaj gjithë vendimeve të Partisë në bazë të centralizmit demokratik. Prandaj Partia do të largojë sa më energjikisht nga radhët e saja çdo të padisiplinuar, çdo element me tendenca anarkiste oportuniste, likuidatore dhe çdo të sëmurë nga ambicia. Në Partinë tonë të re u vendos që në ditët e para konspiracioni i drejtë dhe i shëndoshë për të ruajtur sekretet e Partisë në një kohë aq të rrezikshme, kur okupatori dhe kuislingët kishin drejtuar gjithë goditjet e tyre mbi Partinë. Anëtarët e Partisë duhej të qëndronin heroikisht para armikut të klasës, para okupatorit dhe torturave të tija dhe kështu u bë. Anëtarët e Partisë sonë deri në vdekje nuk i zbërthyen dhëmbët, po rezistuan me heroizëm të madh dhe, me litar në grykë, ata brohorisnin për Partinë, për Bashkimin Sovjetik, për popullin shqiptar dhe për shokun Stalin.

Komiteti Qendror i Përkohshëm vuri drejt çështjen e rinisë, të organizimit të saj e të përgatitjes së saj luftarake. Rinia jonë heroike, nën drejtimin e Partisë dhe nën kujdesin e shokut tonë të shquar Qemal Stafa, u

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 21.

bë një nga shtyllat e shëndosha të Partisë, që do të luftonte me heroizëm të papërshkruar për popullin dhe për Partinë e saj. Gjithashtu Partia jonë i vuri vetes si detyrë lartësimin e rolit të gruas, nxjerrjen e saj sa më shpejt nga robëria, nga paragjykimet e vjetra e të këqia dhe nga injoranca, ta bënte gruan të lirë, t'i jepte kësaj mundësitë të fitonte të drejtat e saja në luftë krah për krah me burrin, ta bënte luftëtare të pamposhtur për idetë e revolucionit tonë popullor. Partia jonë e re në ballë të programit të saj kishte luftën e pamëshirshme, pa kompromis dhe deri në fund kundër okupatorit dhe kuislingëve, në aleancë me Bashkimin e madh Sovjetik. Prandaj Partia duhej të punonte me të gjitha forcat e saja për të organizuar në shkallë të gjerë rezistencën e popullit tonë, luftën e armatosur në një kryengritje të përgjithshme të popullit, duke kaluar nga fazat e guerrileve të qyteteve dhe të fshatrave, në krijimin e ushtrisë popullore; të krijonte bazën morale, materiale dhe politike të ushtrisë së popullit. Partia jonë kishte në program të grumbullonte rreth vetes dhe rreth programit të saj, gjithë patriotët shqiptarë, pa dallim kra-hine dhe feje, njerëz me parti ose pa parti, por që në zemrën e tyre vlonte dashuria për popullin e për atdheun dhe urrejtja kundër okupatorit. Të gjitha këto fuqi antifashiste dhe patriote të mëdha të popullit ajo do t'i grumbullonte dhe do t'i drejtonte në luftë, nën platformën e Frontit Nacional-Çlirimtar. Në programin e saj Partia jonë kishte luftën për pavarësinë kombëtare, për vendosjen e pushtetit të popullit dhe të një qeverie demokratike popullore në një Shqipëri të lirë dhe të spastruar nga okupatorët, nga kuislingët e feudalët dhe

nga borgjezia reaksionare. Këto ishin detyrat kryesore që Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë sonë dhe Partia jonë e re i vunë vetes së tyre. «Kështu dhe vetëm kështu do të mund të luajmë rolin e pararojës në luftën për liri të popullit të robëruar dhe të mjeruar, për çlirimin kombëtar»¹ i thoshte Komiteti Qendror i Përkohshëm Partisë së tij. Dhe me heroizëm të shquar, me vetëmohim dhe me sakrifica të papërshkrueshme nëpërmjet luftërave heroike dhe të përgjakshme, Partia jonë i kreu detyrat e veta, për të shpëtuar popullin e saj nga robëria më e rëndë dhe për ta nxjerrë në dritë e lumturi.

Partia Komuniste e Shqipërisë, megjithëse e re, me t'u organizuar dhe me t'u armatosur, filloi aktivitetin e saj, si një Parti revolucionare në krye të masave punonjëse e patriotike, në luftë për çlirimin e vendit. Partia Komuniste duhej të mobilizonte masat e gjera të popullit, t'i organizonte ato në Frontin Nacional-Çlirimtar, t'i edukonte në rrugën e revolucionit popullor dhe t'i hidhte në luftë të armatosur kundër fashizmit okupator dhe tradhëtarëve të vendit. Në traktin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, të hedhur pas formimit të Partisë më 1941, thuhet:

«Fashizmi italian që prej më se dy vjetësh na ka shkëlur vendin, ka punuar të gjitha të zezat mbi kurrizin tonë. Me ndihmën e disa shqiptarëve, vegla të tij e tradhëtarë të Shqipërisë, na ka grabitur lirinë kombëtare, është munduar të na shkombëtarizojë, të korruptojë rininë, të italianizojë shkollat. Prej më se dy vjetësh ar-

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 23.

miku e ka përdorur vendin tonë si bazë për përhapjen e tij në Ballkan dhe e ka kthyer këtë vend në fushë lufte kundër lirisë kombëtare të popujve vëllezër, grekë dhe jugosllavë, na ka bombarduar fshatrat e qytetet duke shkatërruar vatrat e pasurinë e fshatarit e të qytetarit, . . . fashizmi italian na i ka zaptuar vatrat. . . kërkon të na përçajë me anë të fesë. . . Ja ka marrë popullit bukën. . . Po e detyron katundarin të dorëzojë gjënë e gjallë e bereqetin. . . Para kësaj gjendjeje, ne nuk duhet të rrimë me duar kryq. Prandaj ne u drejtohemi të gjithë shqiptarëve të ndershëm, që e duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkojmë të gjitha forcat tona për t'i vënë në shërbim të luftës sonë për çlirimin kombëtar. Lufta e hapur është i vetmi qëndrim kundrejt zaptuesit. Çdo bir i këtij vendi të jetë një ushtar i Luftës nacional-çlirimtare. Për ta mposhtur armikun lufta jonë duhet të jetë e organizuar, e bashkuar dhe e fuqishme. Të gjithë burrat shqiptarë duhet të rrokin armët dhe të bashkohen me çetat që do të luftojnë për vatrat tona. Lufta e çetave do të jetë shprehja më besnike e vullnetit të popullit shqiptar, për t'u çliruar nga skllavëria fashiste dhe për të rojtur i lirë¹.

Kështu pra, që në fillim, Partia jonë zgjodhi rrugën e drejtë, rrugën e luftës së ashpër: deri në fund me armikun. Formimi i Partisë sonë e tronditi armikun. Pas Luftës italo-greke u trondit prestigji ushtarak i politik i Italisë fashiste dhe u shtua rezistenca e popullit shqip-

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 25-27.

tar, por filloi njëkohësisht edhe terrori i egër dhe i pashembullt mbi popullin tonë.

Formimi i Partisë Komuniste dhe aksionet e guximshme të saj në të gjitha anët e Shqipërisë, ishin një rrezik iminent për fashizmin dhe prandaj fashizmi zëvendësoi kuislingun Shefqet Vërlaci me Mustafa Krujën. Ardhja e Mustafa Krujës në fuqi përfaqëson një nga periudhat e terrorit më të madh gjatë okupacionit fashist. Fashizmi kishte ardhur në konkluzionin se as demagogjia, as kërcënimet dhe as qëndrimi i lëkundshëm i pseudodemokratëve politikanë, që përpiqeshin të fshihnin lodrën e tyre armiqësore kundër popullit, nuk shërbenin për të ulur rezistencën e popullit tonë. Kjo, përkundrazi, po zmadhohej dhe tani, nën udhëheqjen e vendosur të Partisë Komuniste të Shqipërisë, do të bënte që të merrte flakë gjithë Shqipëria. Prandaj me çdo kusht duhej të godiste Partinë Komuniste të Shqipërisë, organizatoren e luftës së çlirimit. Një terror i madh shpërtheu në të katër anët e Shqipërisë dhe reaksioni i brendshëm shqiptar në shërbim të fashizmit, kujtoi se Partia dhe lufta e saj i kishte ditët të numëruara. Fashizmi italian në platformën e tij, përveç terrorit, përdori edhe demagogjinë në shkallë të gjerë. Kundër Partisë Komuniste dhe anëtarëve të saj filloi lufta demagogjike, sipas planit të programit të Gëbelsit; lufta e Partisë sonë u quajt luftë kalamanësh dhe e njerëzve të fantaksur, pa perspektivë, të shitur te Moska dhe që i vinin kazmën Shqipërisë. Kjo luftë ideologjike dhe e armatosur njëkohësisht, lidhej me një luftë të madhe demagogjike e shpifjesh kundër atdheut të socializmit duke bërë dhe duke shpërndarë me të madhe gjithë pro-

pagandën e reaksionit ndërkombëtar e të Gëbelsit kundër Bashkimit Sovjetik. Por lufta e popullit shqiptar, e udhëhequr nga Partia shkonte përpara. Reaksionarët shqiptarë, para një shtate të tillë, ku dështonin njëra pas tjetrës demagogjia dhe aktet e tyre terroriste, menduan seriozisht për organizimin e tyre në një organizatë, që të kundërbalancoje veprimtarinë politike dhe aksionet e Partisë sonë, ta izoloni Partinë nga masat e gjera të popullit, ta pengoni Partinë në mobilizimin e popullit për kryengritjen e përgjithshme dhe t'i lehtësonin barrën okupatorit që të vazhdonte goditjen me ashpërsi manu militari¹. Një organizim i tillë i reaksionit shqiptar u arrit pas Konferencës së Pezës, ku Partia jonë organizoi Frontin Nacional-Çlirimtar nën drejtimin e saj.

Partia jonë, besnike e marksizëm-leninizmit dhe e traditave luftarake të popullit tonë, lëshoi kushtimin për luftën e ashpër kundër armikut, për kryengritjen e armatosur të popullit. Ajo mori parasysh të gjitha konsekuencat e kryengritjes së armatosur të popullit dhe i qëndroi besnike teorisë marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur, sipas së cilës:

«Nuk duhet luajtur kurrë me kryengritjen, në qoftë se nuk je i vendosur të shkosh deri në fund...». Nga ana tjetër, «me të filluar kryengritja, duhet vepruar me vendosmërinë më të madhe dhe duhet kaluar në sulm»².

Dhe Partia jonë kështu e bëri. Ajo u hodh për-

¹ Manu militari — grusht ose dorë ushtarake.

² K. Marks — F. Engels. Veprat, bot. 2 rus., vëll. 8, f. 100.

njëherësh në ofensivë. Anëtarët e Partisë sonë ishin në krye të të gjitha përpjekjeve me armikun. Armiku u mundua ta shuante valën e demonstratave të popullit tonë me anë të zjarrit dhe të hekurit, por lufta jonë jo vetëm nuk u shua, por u krijuan konditat që, nga demonstratat, të hidheshin në veprim njësitet guerrile, duke kryer atentate të panumërta kundër spiunëve dhe tradhëtarëve, duke prerë vijat telefonike, duke hedhur në erë ura dhe rrugë, duke djegur centrale dhe depo, etj. Armiku e shtoi pa masë terrorin e tij. Anëtarët e Partisë me vendosmëri dhe me shembullin e tyre personal u bënë shembull për masat e popullit; ata e mësuan popullin si të luftonte për lirinë e tij, si të merrte shembull dhe të kishte besim të patundur në Bashkimin Sovjetik, në Partinë Bolshevike dhe në shokun Stalin. Anëtarët e Partisë binin heroikisht në fushën e nderit. Më 5 maj 1942 vritet në Tiranë, në luftë me milicët e Mustafa Krujës, anëtari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, Heroi i Popullit, Qemal Stafa, një nga organizatorët e Partisë sonë, të luftës së popullit dhe i rinisë sonë. Më 16 gusht 1942 vritet në rrugët e Tiranës, në luftë me milicët, anëtari i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste të Shqipërisë, Heroi i Popullit, Misto Mame. Më 22 qershor 1942 në Shkodër, pas një rezistence legjendare, bien në fushën e nderit, për popullin dhe për Partinë, pas një luftimi të përgjakshëm me milicët fashistë, Heroi i Popullit, Perlat Rexhepi si dhe shokët e tij komunistë, Branko Kadija dhe Jordan Misja. Më 10 tetor 1942 duke luftuar heroikisht kundër qindra milicëve, të armatosur me tanksa e mitralozë, bie i mbuluar me lavdi duke u vërvitur mbi tanksin

armik, anëtari i Komitetit qarkor dhe organizator i njësiteve guerrile të Tiranës, Heroi i Popullit, Vojo Kushi dhe tok me të shokët komunistë Xhoxhi Martini e Sadik Stavaleci. Në demonstratën e Shkodrës bie heroikisht komunisti Vaso Kadija, i cili ndjek shembullin e Heroit të Popullit Koci Bakos, militant komunist i vjetër, që bie në Korçë në fushën e nderit, i goditur nga bombat e fashistëve italianë. Në Korçë varen të rinjtë Midhi Kostani dhe Kiço Greço, në Vlorë, pas një lufte të ashpër me milicët, vritet komunisti Teli Ndini. Qindra shokë të tjerë luftojnë dhe bien për atdheun dhe popullin.

Lavdi të përjetshme për bijtë e Shqipërisë që dhanë pa kursyer jetën e tyre për lirinë e popullit dhe të atdheut!

Pas formimit të Partisë, bile gjatë gjithë scancave të Mbledhjes për formimin e Partisë, një nga kryetarët e grupit të «Të Rinjve», që ndodhej në atë mbledhje, Anastas Lula, mbrojti me këmbëngulje pikëpamjet e sëmura e antimarksiste të tija dhe të grupit të vet me qëllim që të pengonte shkrirjen e grupeve për formimin e Partisë. Në mbledhje pikëpamjet e tija u luftuan ashpër dhe Anastas Lula u tregua sa për sy e faqe, se gjoja pranoi platformën për formimin e Partisë dhe se, duke bërë autokritikën e tij false, do t'u nënshtrohej pa rezerva direktivave të Partisë sonë dhe udhëzimeve të Komitetit Qendror të Përkohshëm. Ai u tregua sikur pranoi vijën politike e organizative të Partisë dhe ishte plotësisht dakord me Komitetin Qendror të Përkohshëm që u zgjodh. Të gjitha këto ishin mashtrime. Anastas Lula dhe Sadik Premte në realitet ishin kundër Partisë, vijës së saj politike e organizative dhe kundër Komite-

tit Qendror të Përkohshëm. Të dy këta krerë të grupit të «Të Rinjve», për sy e faqe, urdhëruan shkrirjen e grupit të tyre në Parti dhe i dorëzuan Partisë sonë gjoja gjithë punën e tyre. Por, nga ana tjetër, ata urdhëruan njerëzit e grupit të vazhdonin lidhjet e tyre jashtë Partisë dhe t'i forconin këto edhe më tepër. Pra ata ruajtën, fshehurazi Partisë, lidhjet organike të grupit, materialin propagandistik të tyre, shtypin e financat. Grupi i «Të Rinjve» mori urdhëra nga Anastas Lula dhe Sadik Premte të godiste organizimin e ri të Partisë nga brenda, të godiste dhe të pengonte organizimin e rinisë dhe të godiste vijën politike të Partisë që po ndërtohej. Përpjekjet me grupin e «Të Rinjve», të inkua-druar në Partinë tonë, nisën që në organizimin e celulave dhe të qarkorëve, ku elementët e grupit të «Të Rinjve» u përpoqën të mbillnin konfuzion dhe të sillnin në krye të këtyre forumeve, njerëzit më të sëmurë të grupit. Në këtë mënyrë ata u përpoqën të shtinin në dorë drejtimin dhe të krijonin mosbesim ndaj Komitetit Qendror të Përkohshëm. Kësisoj duke luftuar Komitetin Qendror të Përkohshëm, të mundnin në një kohë të volitshme ta rrëzonin atë dhe të merrnin drejtimin në duart e tyre. Elementë të grupit të «Të Rinjve» filluan sabotimin e hapët kundër organizimit të rinisë në një organizatë të vetme nën drejtimin e Partisë. Ata penguan mbledhjet dhe konferencat e rinisë me parulla disfatiste e likuidatore dhe nga ana tjetër, ata, në mënyrë ilegale, bënë mbledhje dhe merrnin direktivë të caktuara për të luftuar gjithë punën e Partisë. Kjo vepër e tyre antiparti shoqërohej fshehurazi edhe me shtyp, duke përhapur teorinë e tyre trockiste dhe shtrëmbëri-

met në vijë. Qendra e grupit të «Të Rinjve», me Anastas Lulën dhe Sadik Premten në krye, filloi të atakojë platformën politike të Partisë, përsa i përkiste luftës dhe grumbullimit të popullit në lëvizjen nacional-çlirimtare. Teoria e famshme e tyre për «ruajtjen e kuadrove» dhe e mosmarrjes pjesë aktivisht dhe fuqimisht në luftë, po ndiqej nga ana e tyre si në kohën e grupeve dhe, megjithëse Partia jonë ishte hedhur e tëra në luftë, ata kërkuan të frenonin aksionet. Për ta fshehur këtë veprimtari ata jepnin jashtë Partisë direktivat e tyre dhe, njerëz të vendosur të grupit, bënë disa atentate politike të veçuara, me qëllim që të fshihnin pikëpamjet e tyre të gabuara për luftën. Kur Partia kishte në programin e saj popullarizimin e Bashkimit Sovjetik, ata vazhdonin të mbillnin konfuzion në Parti, duke përdorur parulla trockiste, anarkiste dhe fashiste kundër Bashkimit Sovjetik, për të nënvleftësuar rolin e tij vendimtar në luftë dhe për çlirimin e popujve të robëruar. Ata luftonin bashkimin e popullit në Luftën nacional-çlirimtare, duke propaganduar fshehurazi në elementin nacionalist, mosbashkimin me Partinë. Ata ishin kundër aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë e varfër dhe të mesme, duke predikuar lënjen pas dore të fshatarësisë së varfër dhe të mesme, me të cilën, sipas tyre, nuk mundej të shkohej në luftë. Partia jonë dhe Komiteti Qendror i Përkohshëm përdorën zgjuarësinë më të madhe dhe zhvilluan një punë këmbëngulëse, për të luftuar ashpër tendencat antiparti, trockiste, fraksioniste dhe grupazhi të këtyre armiqve të Partisë. Ajo vuri gjithë forcat e saja për të sqaruar dhe për të sjellë në rrugë të drejtë gjithë elementët e shëndoshë të grupit të «Të

Rinjve». Komitetit Qendror të Përkohshëm i duhej të izolonte krerët e këtij grupi nga njerëzit e shëndoshë dhe, që ta likuidonte përgjithmonë këtë fraksion të rrezikshëm për Partinë, i duhej t'u jepte grushtin e fundit fraksionistëve Sadik Premte, Anastas Lula dhe shokëve të tyre besnikë. Anastas Lula dhe Sadik Premte qendrën kryesore të veprimtarisë së tyre e kishin në Tiranë, në Vlorë, në Korçë dhe në Elbasan. Ata mbanin në lidhje të gjithë njerëzit e tyre, të cilët i pregatisnin për goditje kundër Partisë dhe, fshehurazi nga Komiteti Qendror i Përkohshëm e duke shkelur çdo rregull partie, ata i mbanin në korrent të veprimtarisë së Partisë, të qarkoreve e të rregullave të saja dhe pregatisnin sistematikisht luftën kundër Partisë. Komiteti Qendror i Përkohshëm ndiqte me kujdesin më të madh veprimtarinë e tyre antiparti dhe në qershor të vitit 1942 mblodhi Konferencën e Partisë, ku i dha grushtin fraksionit të Anastas Lulës dhe Sadik Premtes. Në këtë konferencë, ku asistonin edhe këta dy krerë trockistë të grupit të «Të Rinjve» u demaskua gjithë vepra e tyre armiqësore e tradhëtare, organizimi i tyre i fshehtë e parullat e tyre helmuese dhe trockistët Anastas Lula e Sadik Premte e disa shokë të tjerë të tyre u nxorën jashtë Partisë. Pas kësaj vepre shpëtimtare të Partisë doli Rezolucioni i korrikut 1942 mbi këtë çështje. Komiteti Qendror i Partisë me këtë rezolucion demaskoi gjithë veprimtarinë e fraksionistëve dhe armatosi Partinë tonë të re me një eksperiencë të madhe, për të qenë vigjilente dhe e ashpër ndaj elementëve grupashë dhe fraksionistë. Kjo ishte një fitore e madhe për Partinë tonë të re, të porsalindur. Njerëzit e shëndoshë të Par-

tisë u grumbulluan edhe më fort rreth Komitetit Qendror për të mbrojtur Partinë dhe vijën e drejtë të saj. Por Anastas Lula dhe Sadik Premte, edhe pas goditjes së rëndë dhe shkatërrimit të grupit të tyre fraksionist, s'i hodhën armët. Ata vazhduan të organizonin përsëri, jashtë Partisë, goditjen kundër Partisë dhe udhëheqjes së saj. Këtë herë ata u mbështetën njëkohësisht edhe në disa elementë të tyre, që qëndronin të fshehur në Parti, në elementët nacionalistë që ishin kundër Partisë sonë dhe lëvizjes sonë nacional-çlirimtare, ata u mbështetën në krerët e «Ballit Kombëtar», te bandat e tyre të armatosura dhe te okupatori. Partia dhe Komiteti Qendror i Përkohshëm, vigjilentë dhe në dijeni të kësaj veprimtarie, vendosën kalimin në gjyqin ushtarak partizan të Anastas Lulës dhe të Sadik Premtes, si tradhëtarë të Partisë dhe të popullit. Anastas Lula u kap, u gjykua dhe u pushkatua. Sadik Premte i shpëtoi arrestimit dhe, në rrezik të asgjësohej, shpejtoi zbatimin e planit të tyre. Ai urdhëroi njerëzit e tij, që kishin infiltruar deri në Komitetin qarkor të Partisë Komuniste të Vlorës, që ta rrëzonin këtë qarkor dhe ta merrnin në duart e tyre. Këtë veprim ai e mbështeti në kryengritjen dhe në revoltimin e elementëve të tij, që kishin infiltruar në Çetën Plakë të Vlorës. Në këtë mënyrë Sadik Premte mendonte të organizonte luftën kundër Partisë, Komitetit Qendror të saj dhe vijës së drejtë të Partisë. Në këtë veprim ai ishte i mbështetur nga grupet nacionaliste-balliste të Vlorës, të kryesuara nga Hysni Lepenica. Partia e goditi rëndë këtë veprim tradhëtar të Sadik Premtes. Me shpejtësinë më të madhe u ekzekutuan urdhërat vendimtare të Komitetit Qendror të

Përkohshëm nga ana e udhëheqësve kryesorë të Partisë në Vlorë, shokëve Hysni Kapo dhe Mehmet Shehu¹. U arrestuan përnjëherësh shokët e Sadik Premtes, vëllëzërit Çakërri, Neki Ymer Hoxha (Vangjo), etj. U mposht revolta në Çetën Plakë të Vlorës. Sadik Premte i shpëtoi arrestimit, u bashkua me «Ballin» e okupatorin dhe u bë agjent i hapët i fashizmit, aq sa tani është agjent i Inteligens Servis-it². Fraksioni i Anastas Lulës dhe i Sadik Premtes mori fund. Gjithë çerdhet e tyre u shkatërruan dhe veçanërisht në Vlorë, ku Partia dhe populli i asaj krahine, i tëri i bashkuar me armë në dorë rreth Partisë, ndiqnin këmba-këmbës nëpër male Sadik Premten, i cili u fsheh në prehërin e fashistëve italianë. Partia jonë shpëtoi nga një moment shumë i rrezikshëm dhe nga një kërcënim i madh që i përgatitej nga brenda. Pas likuidimit definitiv të fraksionistëve dhe të fraksionit të Anastas Lulës dhe të Sadik Premtes, Partia jonë u forcua jashtëzakonisht brenda; u forcua disiplina e çelniktë, vigjilenca, konspiracioni, demokracia e brendshme në Parti, u forcua uniteti i Partisë dhe kompaktësia e saj. Partia jonë, e forcuar në mënyrë të tillë, u hodh në luftë dhe në aksione me forca të shumëfishu-

¹ Për të drejtuar luftën kundër fraksionit shkoll në vend Sekretari i Përgjithshëm i PKSHP shoku Enver Hoxha, i cili së bashku me shokët Hysni Kapo e Mehmet Shehu, sekretarë të Komitetit qarkor të PKSHP për Vlorën, në mbledhje e takime individuale sqaruan në radhë të parë anëtarët e Partisë për qëllimin e vërtetë dhe rrezikshmërinë e madhe të veprimtarisë armiqësore të fraksionit.

² Kështu quhet shërbimi i zbulimit dhe i kundërzbulimit në Britaninë e Madhe.

ara, për të zbatuar vijën e saj marksiste-leniniste, për shpëtimin e popullit tonë nga robëria e fashizmit dhe e tradhëtarëve.

Në këtë mënyrë lëvizja nacional-çlirimtare kaloi nga faza e demonstratave, në fazën e luftës me armë të një-siteve guerrile partizane, e cila ishte faza e parë e kryengritjes së armatosur të popullit tonë, kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Partia Komuniste parashikoi zhvillimin e Luftës nacional-çlirimtare dhe përcaktoi format më të përshtatshme të organizimit të luftës në rrugën e fitores.

Në traktin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë në prill 1942, ndër të tjera thuhet:

«Komunistë të Shqipërisë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë ju thërret që të mobilizoheni dhe të kryeni detyrën karshi popullit! Ju thërret të punoni pa u lodhur dhe pa pushim, të lidheni me shtresat më të gjera popullore, për t'u shpjeguar dhe për t'u treguar nevojën e Luftës nacional-çlirimtare, ju thërret të jeni luftëtarë të pafrikshëm, për të drejtat e popullit. Me vetëmohimin tuaj jepni shembullin të tjerëve. Merrni shembull nga Partia Bolshevike dhe të jeni me të vërtetë në ballë të luftës popullore çlirimtare duke mos kursyer as jetën! Në këtë mënyrë keni për të qenë në vendet më të rënda dhe më të rrezikshme. Shokë komunistë, Partia juaj ju thërret që të depërtoni, të mobilizoni, të lajmëroni të gjithë ata që janë të ndershëm dhe që duan të derdhin gjak për lirinë! Shokë komunistë, ngrini lart flamurin e Marksit-Engelsit-Leninit dhe Stalinit dhe bëtohuni që do ta mbani lart dhe me nder

këtë flamur në këtë luftë që shtrihet para nesh, për zhdukjen e armikut më të madh të njerëzimit, fashizmit»¹.

Në këtë mënyrë frymëzohej në punën e saj Partia jonë dhe qysh në fillim u frymëzua nga mësimet e marksizëm-leninizmit; çdo gjë ajo e shihte nën prizmin e luftës së drejtë të Bashkimit Sovjetik.

Njësitet guerrile, të krijuara në qytete dhe në fshatra, ishin reparte të vogla partizanësh, të lëvizshme, të armatosura dhe kurdoherë sulmuese që e goditnin armikun në befasi dhe kudo. Në qytete ato shkatërronin depo, sabotonin stabilimente të ndryshme të armikut, vrisnin oficerë kuislingë, italianë, spiunë, tradhëtarë. Në katunde ato godisnin vijat e komunikacionit, postat e armikut dhe arritën sa të çlironin edhe krahina, ku organizuan pushtetin popullor. Armiku e kuptoi se populli ynë qëndronte besnik i traditave të tija luftarake dhe se ishte i vendosur deri në fund për ta hedhur dhe një herë në det forcën fashiste italiane. Më 1 Maj 1942 guerrilet tona e festuan këtë ditë me luftë, duke u vënë zjarrin depove të Mavrovës, afër Vlorës. Më 24 korrik 1942 Komiteti Qendror i udhëzonte gjithë organizatat e Partisë: *«Nata e 24 korrikut duhet të jetë një natë sulmi të përgjithshëm mbi armikun. Prisni telat, shtyllat telefonike e telegrafike në gjithë qarkun tuaj. Goditeni armikun atje ku e dëmtoni më shumë!»* Dhe më 25 korrik 1942 asnjë vijë telefonike dhe telegrafike nuk punonte në gjithë Shqipërinë. Ato ishin prerë nga guerrilet tona.

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 75.

Forcat italiane në Greqi, të trembura nga kjo situatë, lajmëronin urgjent komandën e tyre: «Gjendja alarmuese e Shqipërisë na vë në rrezik forcat tona që kemi në Greqi, nuk i ndejmë shpatullat të sigurta»¹.

Në këto kohë aksione të shumta bëhen kudo. Në Tiranë digjet centrali telefonik i qytetit, hidhet në erë depua e xhenjos dhe sulmohet aerodromi nën drejtimin e Heroit të Popullit, Vojo Kushi. Në Vlorë digjen depot e municionit të Radhimës dhe në Qafën e Koçiu, afër Vlorës, hidhen në erë depo të tjera. Në Korçë digjen zyrat e fashios dhe depua e fabrikës së birrës. Në Shkodër shpërthehet burgu i qytetit dhe arratisen 30 të burgosur politikë. Në Elbasan guerrilet hedhin në erë një urë 40 metra të gjatë. Në gusht-shtator 1942 bëhen luftime të ashpra nga guerrilet e Skraparit kundër milicëve të Xhaf Balit, kurse më 5 shtator këto guerrile, pas disa ditë lufte, çlirojnë Çorovodën. Në qarkun e Gjirokastrës guerrilet spastrojnë zona të tëra dhe bereqeti, i grumbulluar në depo nga fashistët, i shpërndahet falas popullit. Në Tiranë, Heroi i Popullit, Kajo Karafili, luftëtar i shquar dhe i patrembur, jep sinjalin e atentateve politike, të urdhëruara nga Partia, duke ekzekutuar spiunin e rrezikshëm Beqir Kazazin. Në Korçë kryhet atentati kundër kuestorit, spiunit Skënder Çami. Në Kurveleshin heroik kryhen luftime, spastrohen krahina, vritet nënprefekti. Në Martanesh, Pezë, Dibër, Shkodër, Lumë e kudo në Shqipëri kërcet pushka partizane kundër okupatorit italian.

Kështu, pra, lufta e guerrileve u përgjithësua në të

¹ «Zëri i Popullit», Nr. 3-4, tetor 1942. Kronika e ngjarjeve.

gjitha krahinat e Shqipërisë. Partizanët tanë hidheshin në zjarrin e luftës, për popullin e tyre dhe, me besimin e patundur të Partia Bolshevike, mëma e shtrenjtë e Partisë sonë, ata vdisnin me emrin e Stalinit në gojë, pse ashtu i edukoi Partia e tyre. Në një nga traktet e Komitetit Qendror të asaj kohe thuhet kështu:

«Luftën tonë nacional-çlirimtare duhet ta lidhim ngushtë me luftën heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik, që gjenden në ballë të luftës çlirimtare kundër fashizmit...»

Komunistë shqiptarë,

Eksperiencia revolucionare e deritanishme le të jetë mësim për luftën e sotme. Që të jeni të denjë për besimin që populli shqiptar ka vënë në ju, vazhdoni traditën e bolshevikëve të Leninit e Stalinit duke dhënë shembullin e vendosjes revolucionare, të sakrificës, të iniciativës dhe të organizimit... Të jeni përherë në vendet më të para të luftës, atje ku më i madh të jetë rreziku»¹.

Veprimet e guerrileve tona nuk ishin veprime të izoluara, të pamatura dhe pa qëllim. Ato shoqëroheshin me mobilizimin e masave në luftën e hapët kundër armikut, me organizimin e pushtetit nacional-çlirimtar dhe me çlirimin e krahinave nga okupatori. Veprimet e guerrileve qenë shkolla e parë e luftës për partizanët tanë nga ku dolën udhëheqësit e vërtetë të popullit tonë. Veprimet e guerrileve ishin pjesa e pandarë dhe fillimi i kryengritjes së armatosur.

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 27-28.

Partia jonë udhëhiqej nga mësimet e Leninit dhe i konsideronte aksionet e guerrileve si përgatitje për të kaluar në formën më të lartë të luftës. Këto aksione ushtarake dhe politike lidheshin me aspiratat e masave dhe ishin shprehja e vendosmërisë dhe e besimit jo vetëm për Partinë, po edhe për popullin në fitoren e fundit. Kjo formë lufte ishte e domosdoshme dhe e paevitueshme. Njësitet guerrile ishin pionierët e vërtetë të lëvizjes nacional-çlirimtare. Partia jonë në këtë mënyrë zbatonte mësimet e Leninit, sipas të cilit:

«Veprimet partizane të njësiteve të luftimit përgatisin drejtpërsëdrejti udhëheqës të luftës së masave. Veprimet partizane të njësiteve të luftimit tani jo vetëm që nuk janë rezultat i mosbesimit në kryengritjen ose i pamundësisë së kryengritjes, por, përkundrazi, janë pjesë përbërëse e domosdoshme e kryengritjes»¹.

Nga guerrilet e qyteteve dhe të fshatrave dolën çetat e para të organizuara nga Partia. Nga çetat e para është ajo e patriotit Myslim Peza, në fillim, me një numër të vogël, por që më vonë u zgjerua. Në këtë çetë merrnin pjesë komunistë ilegalë, të ndjekur nga policia fashiste dhe të dërguar në të për ta organizuar. Çeta përbëhej prej fshatarësh; më vonë ajo u zmadhua me të rinj, punëtorë dhe intelektualë. U formuan çeta gjithashtu në qarkun e Beratit, të cilat kishin hyrë në luftë me milicët dhe me italianët. Në Vlorë, Gjirokastër,

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 10, f. 119.

Korçë gjithashtu njësitet guerrile po merrnin formën e çetave dhe zgjerohej pjesëmarrja e popullit në luftë.

Në këto momente Partia përpunoi tezat për thirrjen e Konferencës Nacional-Çlirimtare të Pezës.

KONFERENCA E PEZËS DHE ZGJERIMI I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Pas formimit të Partisë, sikundërqë e pamë edhe më lart, Lufta nacional-çlirimtare merr një hov të madh. Tani Partisë, që udhëheq me vendosmëri luftën, i hapen perspektiva të gjera, për t'u futur dhe për t'u lidhur më fort me masat e për të mobilizuar gjithë popullin shqiptar kundër zaptuesit. Qëllimi i Partisë ishte të fuste në lëvizje dhe në luftë të gjitha energjitë revolucionare të popullit, pse ajo e kishte kuptuar që në ditët e para të demonstratave se Lufta nacional-çlirimtare nuk mund të mbetej një luftë kuadrosh, por ajo do të ishte një luftë masash të gjera, të frymëzuara dhe të drejtuara nga Partia. Partia Komuniste, pararoja e kësaj lufte dhe pjesa më e ndërgjegjshme e popullit punonjës të Shqipërisë, e kishte kuptuar detyrën delikate të bashkimit të shtresave të ndryshme patriotë të vendit tonë. Partia në ballë të programit të saj kishte Luftën nacional-çlirimtare. Ajo derdhi gjithë energjitë e saja për drejtimin, organizimin dhe mobilizimin për në luftë të forcave antifashiste, antiitaliane dhe antigjermane të popullit tonë. Për zgjerimin e luftës Partia kishte në program të mobilizonte gjithë patriotët shqiptarë, që ishin kundër okupatorit, dhe që s'ishin komunistë, që kishin pikë-

pamje politike të ndryshme, por që në radhë të parë pranonin luftën kundër okupatorit. Nga ana tjetër, Partia ata njerëz që nuk do të mund t'i mobilizonte, duhej t'i shkëpuste nga thonjtë e okupatorit dhe t'i neutralizonte. Partia duhej ta izolonte zaptuesin dhe urrejtjen e popullit tonë kundër okupatorit ta shndërronte në luftë të hapët. Partia, me luftën e saj dhe me programin e saj, duhej t'u jepte të kuptonin njerëzve të ndershëm se më përpara duheshin thyer zinxhirët që i ishin hedhur popullit nga fashizmi. Këta zinxhirë mund të këputeshin vetëm me anën e Luftës nacional-çlirimtare — e vetmja platformë bashkimi për forcat luftëtare të popullit tonë. Stalini thotë se

«Revolucioni në Rusi nuk do të kishte triumfuar, dhe Kollçaku me Denikinin nuk do të ishin mundur, sikur proletariati rus të mos kishite pasur simpatinë dhe përkrahjen e popujve të shtypur të ish-perandorisë ruse. Por për të fituar simpatinë dhe përkrahjen e këtyre popujve, ai duhej para së gjithash të këpuste zinxhirët e imperializmit rus dhe t'i çlironte këta popuj nga shtypja nacionale.

Pa këtë do të ishte e pamundur të konsolidohej Pushteti Sovjetik, të mbillej internacionalizmi i vërtetë dhe të krijohesh ajo organizatë e mrekullueshme bashkëpunimi popujsh që quhet Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 150-151.

Edhe sot, në qoftë se popujt e shtypur nuk luftojnë armikun e përbashkët, armikun më të rrezikshëm, fashizmin, kurrë nuk do të mundin të fitojnë lirinë e tyre dhe proletariati ndërkombëtar kurrë nuk do të mund të bëjë revolucionin e tij.

Partia jonë kishte kuptuar mirë se populli kurrë nuk do të mund të fitonte lirinë e tij, në qoftë se nuk do të zhdukte më përpara fashizmin, armikun e përbashkët që shtypte punëtorin, fshatarin dhe inteligjencien patriote. Pra, gjithë populli ynë duhej ta kuptonte dhe ta përqafonte këtë vijë të drejtë të Partisë sonë. Pra, Partia e konkretizoi këtë vijë të drejtë me organizimin e Konferencës së Pezës.

Si paraqiteshin në vigjiljen e Konferencës së Pezës forcat e sigurta të Partisë në shtresat e ndryshme të popullit, të cilat ajo do t'i udhëhiqte në fitore?

Klasa jonë punëtore ishte e vogël dhe heterogjene, por e vendosur qind për qind për luftën kundër okupatorit dhe shfrytëzimit. Sado që e vogël, ajo ishte shtylla kryesore dhe themelia e Partisë sonë. Që në ditët e para të luftës ajo u hodh me vendosmëri në luftë e luftoi me heroizëm dhe, me formimin e Partisë, ajo u grumbullua rreth Partisë së saj duke kuptuar rolin historik dhe drejtues; ajo kuptoi se Partia Komuniste e Shqipërisë ishte detashmenti pararojë i organizuar i saj. Mbështetja, pra, e Partisë sonë ishte klasa punëtore.

Në radhë të dytë fshatarësia e varfër dhe e mesme, e vuajtur dhe e shtrydhur nga të gjitha regjimet, e gjakosur nga okupatori fashist dhe e lidhur ngushtë me tokën, ishte mbështetja tjetër e madhe e Partisë sonë. Fshatarësia e varfër dhe e mesme e Shqipërisë, në ale-

ancë me klasën tonë punëtore, kuptoi se, nën drejtimin e klasës punëtore dhe të Partisë, ajo do të triumfoje.

Pse fshatarësia jonë e varfër dhe e mesme u hodh e tëra në Luftën nacional-çlirimtare?

Ajo u hodh se kishte kujtimin e së kaluarës, ku kishte derdhur gjak për të huajtë dhe për feudalët e vendit, kishte luftuar për tokën, për lirinë dhe për pa-varësinë, po në vend të tyre ajo fitoi shtypjen dhe shfrytëzimin nga feudalët; se regjimi policor i klikës së Zogut, për të ruajtur pozitat e tija, si dhe okupacioni fashist, e kishin shfrytëzuar deri në palcë fshatarin, kështu që ai ishte në luftë me ta; se borgjezia e vendit, e dobët dhe pa tradita, nuk jepte asnjë garanci për fitore. Fshatarësia kërkonte çlirimin e vendit, tokën, lirinë, mirëqenjen dhe, në procesin e luftës e të revolucionit tonë popullor, u provua plotësisht sa fshatarësia mund të mbështeste shpresat e saja në borgjezinë.

Gjatë Luftës nacional-çlirimtare kundër okupatorit fashist u bë edhe diferencimi midis popullit punonjës dhe armiqve të tij. Borgjezia reaksionare dhe feudalët u bashkuan me okupatorin; ky diferencim ishte i logjikshëm dhe i natyrshëm. Ky vërteton kontradiktat në shoqëri dhe shpjegon ekzistencën e luftës së klasave midis atyre që posedojnë mjetet e prodhimit dhe atyre që janë zhveshur nga këto mjete, midis shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve. Lufta nacional-çlirimtare ishte lufta e klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë dhe kjo luftë kishte karakter çlirimtar e revolucionar. Kjo luftë nuk pajtohej me interesat e klasave në fuqi. Prandaj qëllimi dhe tradhëtia e ish-klasave sunduese gjatë Luftës nacional-çlirimtare, u përcaktuan nga konditat dhe

pozitat sociale të tyre. Borgjezia, nga frika e ndryshimeve revolucionare që po ndodhnin, sakrifikoi lirinë, pavarësinë e vendit dhe interesat kombëtare. Ky diferencim klasash u bë edhe midis fshatarësisë. Borgjezia fshatare u bashkua me organizatat e saja tradhëtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit». Kjo luftë do të bëhej gjithmonë më e ashpër gjatë revolucionit popullor.

Fshatarësia e varfër dhe e mesme kuptoi se Partia jonë Komuniste ngjalli shpresat dhe forcoi besimin e fshatarësisë, se vetëm duke luftuar nën udhëheqjen e klasës punëtore ajo do të mund të realizonte aspiratat e saja. Partia Komuniste, e udhëhequr nga parimet e marksizëm-leninizmit, nuk mund të linte pas dore çështjen e aleancës së fshatarësisë me klasën punëtore, për të arritur fitoren e revolucionit popullor. Në lidhje me këtë Engelsi thotë:

«Çështja për marrjen e pushtetit politik u bë për Partinë Socialiste një çështje e së ardhmes së afërt. Por, për të marrë pushtetin politik, kjo parti, më parë, duhet që të shkojë nga qyteti në fshat, duhet të bëhet një forcë në fshat»¹.

Duke u bazuar në këto parime Partisë Komuniste, në vigjiljen e Konferencës së Pezës, i dëlnin detyra të rëndësishme në fshat. Partia jonë i kreu me nder këto detyra, luftoi me heroizëm armiqtë e masave punonjëse

¹ K. Marks — F. Engels. Vepra të zgjedhura në dy vëllime, vëll. II, 1958, f. 399.

të fshatit, luftoi me ashpërsi manevrat dhe intrigat e kulakëve dhe të agallarëve të fshatit, që orvateshin ta shkëputnin fshatarësinë nga rruga e lavdishme e luftës. Ajo e edukoi këtë që të bëhet e ndërgjegjshme për të drejtat e saja. Demaskoi parullat dhe punën armiqësore të organizatave të «Ballit» dhe të «Legalitetit», që mundoheshin ta bënin fshatarësinë rezervë të tyre. Themelimi i Partisë Komuniste, si pararojë e klasës punëtore, e klasës më përparimtare dhe më revolucionare, ishte një ngjarje me rëndësi, aq për klasën punëtore, sa edhe për masat punonjëse të fshatit. . .

Fitoret e armatave sovjetike kundër hordhive gjermane, kundër forcave të errëta të fashizmit, që synonin robërinë dhe shtypjen e popujve, ndezën zemrat e fshatarësisë sonë për çlirim. Në fshatarët tanë u forcua besimi, se vetëm duke luftuar nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së saj, ashtu si dikur fshatarësia ruse do të mund t'ja arrinte qëllimit. . .

Në këto momente jo të gjithë intelektualët e kishin të qartë detyrën e tyre ndaj popullit dhe atdheut. Intelektualët e lëkundshëm, që në shumicën e tyre tërhiqeshin në atë kohë nga një indiferentizëm i theksuar, qëndronin sehirxhinj përpara kësaj tragjedie të madhe të popullit tonë. Intelektualët e shtresave reaksionare të borgjezisë ishin bërë vegla e hapët e okupatorit, kurse pjesa e varfër e intelektualëve patriotë ishte hedhur në luftë të hapët që në ditët e para kundër okupatorit. Intelektuali që kërkonte liri mendimi e veprimi duhej të realizonte se, për të shkëputur zinxhirët e fashizmit, që robëronte atdheun, që helmatishte mendjen dhe korruptonte shpirtat, duhej të luf-

tonte ashpërsisht. Partia duhej t'i grumbullonte këto energji të shpërndara të intelektualëve të vendit tonë shumë herë me drejtime të pacaktuara. Ajo duhej t'i kanalizonte, t'i vinte në shërbim të atdheut, të zhvillimit të drejtë të aftësive mendore e të kulturës së shëndoshë përparimtare dhe t'i drejtonte kundër një objekti të caktuar, kundër fashizmit, armikut më të madh të vendit tonë.

Rinia e vendit tonë ishte bërë flamurtare e luftës së lavdishme. Ajo s'e pranoi për asnjë moment zgjedhën e okupatorit. Shpirti i saj nuk mund të duronte atmosferën mbytëse dhe korruptuese, ku deshë ta hidhte fashizmi. Ajo s'pranoi kurrë të bëhej lodra e okupatorit dhe kurrë asaj nuk ju tremb syri, por u hodh në zjarr e në flakë me heroizëm dhe vetëmohim të patreguar në luftën për çlirimin e popullit. Në vigjiljen e Konferencës së Pezës ajo kishte bërë sakrifica të mëdha në aktivin e saj; heronjtë e saj kishin shkruar faqet e para të lavdishme të epopesë së popullit shqiptar. Lufta për çlirimin e popullit dhe të atdheut ishte bërë jetë për rininë tonë. Kjo ishte forca e madhe e Partisë sonë, që do të ecte më vonë e mbuluar me lavdi në rrugën që i caktonte Partia e saj.

Gruaja shqiptare, e shtypur egërsisht nga traditat dhe zakonet e këqia e të vjetra, nga ligjet e borgjezisë dhe të feudalizmit, e shtypur nga fashizmi, e ndjente veten e saj shumë afër Luftës nacional-çlirimtare, në të cilën ajo shihte të vetmen rrugë çlirimi. Ajo ishte gati të bënte çdo sakrificë për popullin e saj, ajo s'mund të ndahej nga burri e nga djali i saj që luftonin. Dhe ajo luftoi me heroizëm në rrugën që i caktoi Partia.

Pra, në këto rrethana, për të grumbulluar popullin shqiptar në një platformë organizative politike dhe lufte të vetme, nën drejtimin e Partisë, Partia jonë Komuniste më 16 shtator 1942 mblodhi Konferencën e Pezës, ku përveç delegatëve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, të Rinisë Komuniste, të grave shqiptare, merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e tendencave të ndryshme të nacionalistëve shqiptarë dhe të rinisë nacionaliste. Konferenca e Pezës në programin e saj politik kishte luftën e organizuar, të ashpër e pa kompromis kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Nga ana tjetër ajo vendosi krijimin e këshillave në të gjitha krahinat. Ky qe hapi i parë për krijimin në formë organizative të Frontit Nacional-Çlirimtar. Këshillat dhe rëndësia e madhe e tyre për luftën përcaktohen kështu nga Rezolucioni i Konferencës së Pezës:

«Ndër vendet e paçliruara, këshillat janë organe lufte, bashkojnë të gjitha forcat popullore-çlirimtare, bëjnë agjitacion dhe propagandë, udhëheqin luftën politike kundër armikut okupator, mobilizojnë masat popullore për luftën çlirimtare dhe njëkohësisht bëjnë mobilizimin material të sendeve të nevojshme për luftën; këshillat do të jenë këshilla masash të gjera që të grumbullojnë turmat e gjera popullore. Këshillat përgatitin armë për partizanët dhe vullnetarët e lirisë dhe i mbajnë me ushqime; popullarizojnë Luftën nacional-çlirimtare, lajmërojnë lëvizjet e armikut, fuqinë e tij, etj. Këshillat formojnë dhe organizojnë shtypin, propagandën, agjitacionin, organizojnë sabotazhin. . . Luftë të organizuar ku-

ndër Bankës Bujqësore, kundër shoqërive anonime që kërkojnë t'i rrëmbejnë tokën fshatarit... Këshillat demaskojnë gjithë përfituesit dhe ndërmjetësit e okupatorit; popullarizojnë kryengritjen e përgjithshme si një etapë të fundit, si një rrjedhje të luftës partizane; organizojnë dhe përgatitin opinionin publik, burra dhe gra, të rinj dhe të reja.

Në tokat e çliruara këshillat nacional-çlirimtare bëjnë detyrën qeveritare... vënë rregullin dhe qetësinë, bëjnë luftë kundër tradhëtarëve, bëjnë kontrollin e qarkullimit të personave, luftojnë kriminalitetin, vjedhjen, etj. Në bashkëpunim me organet ushtarake, këshillat bëjnë luftën kundër kolonës së pestë; kujdesohen për ekonominë dhe ushqimin e popullit; organizojnë tregëtinë dhe financat; mobilizojnë ushqimet dhe gjërat e nevojshme për çetat partizane dhe njësitë vullnetare; zhvillojnë arësimin dhe punën e edukatës popullore; shumojnë dhe grumbullojnë materialin për propagandë dhe agitacion, si shtypshkronja, radio, etj. Bëhet mobilizimi politik për Luftën nacional-çlirimtare, forcohet fuqia e këshillave dhe luftohet çdo armik dhe çdo rrezik. Për disa gjëra bëjnë gjyqe të vogla dhe veçanërisht duhet që këto këshilla të pajtojnë gjaqet... Rëndësia e Këshillave Nacional-Çlirimtare është e madhe. Me anë të këtyre bëhet qeveria, mobilizohet populli për në luftë e për në kryengritje. Ja, pra, rëndësia e tyre»¹.

Partia me platformën e Konferencës së Pezës i hapi

¹ Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar Nacional-Çlirimtar, f. 12-13.

luftës sonë perspektiva të gjera. Me këtë platformë të rëndësishme të Partisë sonë, do të luftohej për mobilizimin e masave të gjera të popullit në luftë, do të krijohej në luftë Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, do të krijohej shtatmadhoria e saj dhe do të forcohej pushteti popullor, i cili do të konsakrohej në formë të prerë në Kongresin e Përmetit.

Konferenca e Pezës pati reperkusione të mëdha në gjithë vendin tonë. Kudo njerëzit e Partisë organizuan këshillat nacional-çlirimtare dhe grumbulluan në to dhe rreth tyre forcat e shëndosha të popullit, patriotët e ndershëm që ju dhimbsej çështja e atdheut dhe ishin të ndërgjegjshëm për momentet e rëndësishme politike që jetonin. Një jetë e re lindi në bashkimin e popullit dhe në luftën për çlirimin e Shqipërisë. Lufta mori një hov të madh dhe aksionet e guximshme i dhanë zemër popullit dhe i ngjallën besimin në vete. Ky ishte një nga sukseset më të mëdha të politikës së drejtë dhe tejpamëse të Partisë sonë Komuniste. Në Rezolucionin e Konferencës së parë të Vendit të Partisë, mbajtur në Labinot, thuhet:

«Partia Komuniste ka qenë e para që ka lëshuar zërin e kushtrimit për bashkimin e popullit shqiptar, ajo ka qenë e para që e ka kërkuar me këmbëngulje dhe në mënyrë konkrete këtë bashkim, ajo vazhdimisht dhe me fuqi ka thirrur dhe po thërret për bashkimin e të gjitha forcave të gjalla, e të gjitha rrymave politike kundër okupatorit. Partia Komuniste ka qenë në ballë të lëvizjes nacional-çlirimtare, ka qenë në ballë të luftës, ajo e ka mobilizuar popullin dhe e ka hedhur në luftë jo ve-

*tëm me anë të agjitacionit dhe të propagandës, por si-
domos me anë të luftës»¹.*

Pas Konferencës së Pezës, që qe një sukses i madh politik i Partisë sonë, okupatori dhe kuislingët u tron-ditën. Ata sulmuan ushtarakisht Pezën, por pa asnjë sukses. Megjithëse goditjet dhe terrori po shtoheshin dita-ditës, okupatori nuk mundi të shuante hovin e madh që mori lëvizja nacional-çlirimtare, pas Konfe-rencës së Pezës. Kudo në Shqipëri, në zonat e çliruara dhe të okupuara, u formuan këshillat nacional-çlirim-tare dhe mobilizimi i masave për luftë ishte i madh. I duhej reaksionit të organizonte kundërofensivën politi-ke, për të neutralizuar këtë sukses të madh të Partisë. Partia jonë kishte thirrur në Konferencën e Pezës një sërë njerëzish, që më vonë dolën në krye të organiza-tës së «Ballit». Këta nuk muarën pjesë dhe refuzuan ftesën, po dërguan disa njerëz të dorës së dytë për të dëgjuar mbi rezultatet e konferencës. Pra, «Balli Kom-bëtar», organizata e reaksionit, kundër platformës së Frontit Nacional-Çlirimtar doli si reaksion për të neu-tralizuar dhe për të luftuar Luftën nacional-çlirimtare. Platforma e «Ballit Kombëtar» ishte një platformë de-magogjike që me ngjyra pseudodemokrate i premtonte gjoja popullit lirinë dhe të drejtat. Reaksioni mendoi se me krijimin e «Ballit Kombëtar», do të krijonte një or-ganizatë paralele me atë të Frontit Nacional-Çlirimtar, derisa edhe emri i tij i përngjiste, me fjalë të tjera, em-rit të Frontit Nacional-Çlirimtar. Në organizatën e reak-

1 Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 105-106.

sionit mungonte fjala «çlirimtar». Kjo kishte një kuptim të madh, sepse organizata e «Ballit Kombëtar», e mbështetur nga okupatori, si vegël e tij, nuk kishte në programin e saj luftën për çlirimin e popullit, por kishte në program ta luftonte kryengritjen popullore, luftën që bënte populli shqiptar dhe udhëheqësen e tij të vërtetë, Partinë Komuniste. Konturet organizative të «Ballit Kombëtar» nuk dukeshin të qarta në fillimin e daljes së tij, por ishte e qartë se kjo organizatë kishte grumbulluar dhe do të grumbullonte në gjirin e saj bejlerët, kulakët, tregëtarët e mëdhenj, pseudointelektualët, politikanët e falimentuar të çdo regjimi, kriminelët dhe hajdutët — me një fjalë llumin e shoqërisë shqiptare, gjithë elementët e klasave të privilejuara, që interesat e tyre i kishin të lidhura me okupatorin. Këtu ishte forca e «Ballit». Qëllimi kryesor i «Ballit» ishte t'i organizonte këto shtresa të reaksionit, t'i armatoste në banda dhe, me ngjyra pseudonacionaliste, t'i vinte në shërbim direkt të trupave të okupacionit, sikundër që i vuri, për të luftuar popullin shqiptar dhe Partinë Komuniste. Tok me daljen e tij, «Balli Kombëtar» nxori edhe disa grupe të armatosura të tijat në mal, si në Vlorë, në Mallakastër, në Korçë dhe në Gjirokastër. Me anën e demagogjisë «Balli» do të përpiqej të gënjente një pjesë të fshatarësisë së mesme, borgjezinë e vogël si dhe elementë të lëkundshëm dhe frikacakë, të cilët ose do t'i bashkonte me të ose do t'i neutralizonte. «Balli» filloi propagandën e tij politike duke thënë se «Fronti Nacional-Çlirimtar është një maskë e Partisë Komuniste të Shqipërisë për të gënjyer masat e popullit shqiptar dhe për t'i bërë këto të luftojnë jo për interesat e

Shqipërisë, po për interesat e Ruisisë». Ata akuzonin Partinë tonë dhe anëtarët e saj sikur luftonin për interesat e huaja dhe jo për interesat nacionale. Qëllimi i «Ballit» ishte ta izolonte Partinë Komuniste të Shqipërisë nga masat e popullit, sepse vetëm nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, populli shqiptar do të forconte luftën e tij, do të sillte vdekjen e reaksionit dhe do të përmbyste përgjithmonë pushtetin e tij. «Balli» përpigej të nënvleftësonte dhe të zhdukte Frontin Nacional-Çlirimtar, duke kërkuar që Partia Komuniste e Shqipërisë të inkuadrohej në «Ballin Kombëtar» dhe të pranonte platformën e tij politike. Kjo do të thoshte mbytje e lëvizjes nacional-çlirimtare. Kjo ishte njëkohësisht një manevër pa kripë. Përpara një situatë të tillë, të parashikuar nga Partia, kjo ndërmoi një punë dhe një luftë, që u zhvillua gradualisht deri në përpjekje me armë, për ta demaskuar e për ta luftuar këtë taktikë të reaksionit dhe të fashizmit. Dekalogu¹ i organizatës nacionaliste «Balli Kombëtar», jo vetëm që ishte një demagogji, por në të çështja e luftës kundër pushtuesve ishte e përjashtuar. Kjo, natyrisht, tregonte mirë qëllimin e «Ballit», këtu ishte pika e dobët e tij, dhe në këtë do ta godiste fort Partia jonë për ta demaskuar. «Ballit Kombëtar» ju kërkuar të tregonte me vepra se ishte në luftë me okupatorin dhe kështu do të demaskohej edhe platforma e tij demagogjike. Nga ana e Partisë u bënë

¹ Deklarata programatike e «Ballit Kombëtar» prej 10 pikash. Me anë të dekalogut, «Balli» synonte të mashtronte masat e gjera të popullit, t'i shkëpuste ato nga Partia Komuniste e Shqipërisë dhe t'i largonte nga Lufta nacional-çlirimtare.

përpjekje të dyfishta, përpjekje për ta afruar bazën e organizatës së «Ballit Kombëtar» dhe njëkohësisht u bënë bisedime edhe me krerët e tij. Në të dy drejtimet, Partia luftoi dhe hodhi poshtë gjithë tezat dhe akuzat e «Ballit Kombëtar» ndaj Frontit Nacional-Çlirimtar dhe Partisë dhe i kërkoi atij konkretisht të zbulonte letrat. Bisedimet u bënë për luftën. Bisedimet u bënë në mes të njerëzve të Partisë dhe përfaqësuesve të grupeve të armatosura të «Ballit Kombëtar», që gjoja kishin për qëllim të luftonin okupatorin. Këto s'dhanë asnjë rezultat, përkundrazi ata kishin dalë në mal për të penguar luftën e popullit shqiptar. Njëkohësisht, në këtë platformë u bisedua edhe me krerët, të cilët duke parë vendosmërinë e Partisë, kujtuan se me pranimin nga ana e tyre të komisioneve të koordinimit të aksioneve me Frontin Nacional-Çlirimtar, do të mundnin të frenonin luftën. Taktika e Partisë sonë ishte që, me anën e këtyre komisioneve të koordinimit të aksioneve, të futeshin në luftë elementët e bazës të organizatës së «Ballit Kombëtar» dhe të demaskohej kështu kjo organizatë e reaksionit në shërbim të okupatorit. Këto komisione të koordinimit mbetën një letër e vdekur. Partia jonë, me platformën e Konferencës së Pezës, duhej të zgjeronte dhe të forconte influencën e saj në masat dhe në luftë të bënte diferencimin e reaksionit, t'i shkëpuste masat përgjithmonë nga ato influenza të tij, që kishin mbetur nga e kaluara, qoftë nga një punë mashtruese dhe demagogjike, qoftë nga ndjenja e sundimit shekullor të feudalëve dhe të borgjezisë mbi popullin. «Balli», me anën e këtyre komisioneve do të përpiqej që, në vend që të bëhej luftë dhe aksionë, të bëheshin muhabete e

diskutime të pambaruara deri sa t'i vinte në vesh okupatorit qëllimi i aksionit dhe vendi ku do të bëhej aksioni. Por Komiteti Qendror i Partisë e kishte parasysh kurdoherë këtë gjë dhe ai nuk e la aspak fatin e aksioneve në diskutimet e këtyre komisioneve. Këto komisione, as nuk u mbledhën, pse «Balli Kombëtar» dhe të ashtuquajturat çetat e tija, nuk pranuan kurrë luftën dhe as që mund ta pranonin. Partia jonë ishte në luftë me organizatën e «Ballit Kombëtar», në luftë për të demaskuar «Ballin» nga ana politike dhe në goditje me çetat e tija. «Balli Kombëtar» më 15 mars 1943 firmoi protokollin Dalmaco-Këlcyra, me të cilin «Balli Kombëtar» merrte angazhim të mbronte forcat italiane që do të vepronin në Jug për të mposhtur Luftën nacional-çlirimtare. Okupatori dështoi në planin e tij me tradhëtarin Mustafa Kruja, dhe këtë e zëvendësoi me qeverinë kukull të Eqrem Libohovës, duke menduar që rrotull kësaj qeverie të grumbullonte forca të reja të nacionalistëve, për të forcuar pozitat e tija të dobësuar nga lufta jonë. Qeveria e Libohovës u premtonte koncesione e reforma këtyre pseudonacionalistëve të «Ballit Kombëtar» dhe u linte të kuptonin se u paraqiste kondita të favorshme vetëqeverimi. Njëkohësisht terrori vazhonte në të katër anët e Shqipërisë. Por qeveria e kuislingut Libohova s'ishte përveçse një urë për të sjellë në fuqi një nga eksponentët e «Ballit Kombëtar», Maliq Bushatin, i cili, duke qenë në shërbim të fashizmit dhe në lidhje direkte me «Ballin Kombëtar», do të ekzekutonte dëshirat e të dy palëve, që ishin të njëjta. Qeveria e Bushatit kishte gati në program dekalogun e «Ballit»: shovinizmin, «Shqipërinë etnike», krijimin e ushtrisë

dhe të xhandarmërisë shqiptare dhe manifestonte në dukje një farë pavarësie, gjoja nga okupatori. Qeveria kuislinge e Bushatit, në shërbim të okupatorit dhe dora e fshehur e «Ballit Kombëtar», vazhdoi politikën e Mustafa Merlikës, por me një platformë pak më të gjërë dhe më të përshtatshme, për të grumbulluar rreth vetes nacionalistët dhe për t'i vënë direkt në shërbim të okupatorit. Qeveria e Bushatit tentoi të vepronte me një elasticitet më të madh dhe të krijonte iluzionin e një vetëqeverimi në sytë e nacionalistëve dhe të popullit. «Balli Kombëtar» me traktet e tij të asaj kohe e mbështeti edhe hapët formimin e ushtrisë kombëtare shqiptare që kishte në program Maliq Bushati, i cili thirri afër tij gjeneral Parianin, një nga organizatorët e invadimit. Por borgjezia jonë ishte pa tradita dhe pa një eksperiencë të madhe. Reaksioni shqiptar, i grumbulluar në «Ballin Kombëtar», nga presioni i Luftës nacional-çlirimtare, lëkundej dhe s'kishte arritur dot dhe nuk do të arrinte të organizohej fort. Vetë brenda në organizatën e «Ballit» ekzistonte një kaos mendimesh dhe diferencimesh. Në atë kohë, në gjirin e «Ballit Kombëtar» u dukën grumbullime të ndryshme me ngjyrë partie, si grupi «radikalnacionalist» i Korçës, «28 Nëntori» i Shkodrës, grupi i «Zjarrit», që bënte pjesë si fraksion i ashtuquajtur komunist ekstremist, më vonë grupi «socialdemokrat» i Skënder Muços dhe «Partia komuniste e vërtetë» e Sadik Premtes (Xhepit). «Balli» kishte lidhje me krerët e tjerë të reaksionit dhe sidomos me bajraktarët e Veriut, por këta vepronin të shkëputur në një platformë politike të veçantë për t'u lidhur drejtpërdrejt me okupatorin. Të tillë ishin Fiqri Dinja,

Preng Cali, Cen Elezi, Muharrem Bajraktari, Murat Kaloshi etj. «Balli Kombëtar» do të vazhdonte të luante rolin e maskuar, por Partia jonë dhe Fronti Nacional-Çlirimtar me luftën e tyre heroike, ja çorrën këtë maskë. Pas Mukjes dhe Konferencës së Labinotit, «Balli Kombëtar», dhe bandat e tija hynë në shërbim të plotë dhe nën komandën direkte të okupatorëve.

Pas Konferencës së Pezës lufta e armatosur e popullit u zgjerua akoma më shumë, malet tona u mbushën me çeta dhe batalione partizanësh. U forcua njëkohësisht edhe organizimi i këshillave nacional-çlirimtare në fshatra dhe në qytete. Menjëherë pas Konferencës së Pezës filluan aksionet në stil të gjerë nga ana e partizanëve dhe Komiteti Qendror i Partisë u shkruante komiteteve qarkore të saj: *«Vetëm pjesëmarrja sa më e gjerë e punëtorisë në luftë, na siguron fitoren. Në radhën e luftëtarëve tanë të jenë punëtorë, fshatarë, të rinj, etj., që e duan atdheun, që e urrejnë armikun dhe e duan lirinë».*

Çetat partizane ishin reparte të lëvizshme, të përbëra prej një numri rreth 50 partizanësh, të ndara në skuadra, të armatosura me pushkë dhe mitralozë dhe të komanduara nga një komandant dhe një komisar. Komandanti dhe komisari përbënin komandën unike, ishin përgjegjës për punën dhe për drejtimin e çetës në luftë. Që këtu lindi në ushtrinë tonë roli i komisarit politik si edukues i reparteve partizane. Ushtria Nacional-Çlirimtare e popullit, e lindur nga gjiri i tij dhe që luftonte për interesat e tij, duhej të ishte një ushtri e ndërgjegjshme dhe njëkohësisht e ngritur politikisht që të kryente detyrën e ngarkuar nga populli. Këtë edukatë politike dhe kalitjen e ndërgjegjes Ushtrisë Nacional-

-Çlirimtare ja dha Partia me anën e komisarëve politikë dhe të anëtarëve të tjerë të saj në radhët e ushtrisë. Roli i komisarit politik ka qenë vendimtar për sukseset e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

Çetat tona partizane ishin kudo në sulm: ato prisnin komunikacionet, godisnin autokolonat dhe qendrat e ndryshme të grumbullimit të armikut, duke çliruar zona të tëra, duke e vënë armikun në një gjendje shqetësimi e pasigurie dhe duke e detyruar të gozhdonte forca të mëdha në vendin tonë. Populli ynë ndihmonte njëkohësisht me të gjitha forcat e tija luftën e madhe antifashiste, në krye të së cilës qëndronte faktori i madh i fitores, Bashkimi i madh Sovjetik dhe Ushtria e tij e Kuqe e lavdishme. Lufta jonë zhvillohej dhe sukseset e saj ishin të lidhura me luftën e Ushtrisë së Kuqe të lavdishme, e cila i jepte grushte vdekjeje ushtrisë hitleriane dhe ushtrive të tjera satelite të Hitlerit...

Krahinat e Pezës, të Skraparit, të Kurveleshit, të Martaneshit dhe të Korçës ishin çliruar gjatë vitit 1942. Deri në prill të vitit 1943 u çlirua edhe nënprefektura e Konispolit, krahina e Zagories, e Mesaplikut, e Mallakastrës, e Pogonit, e Lunxherisë, etj. Te Ura e Gjormit në Vlorë u shpartalluan 2 000 milicë dhe bersalierë dhe u vra konsulli italian kolonel Klementis. U sulmua dhe u shkatërrua qendra vajguore e Patosit, u hodh në erë Miniera e Selnicës dhe u vranë e u zunë robër qindra karabinierë. Në janar të 1943-së u çlirua me luftë Voskopoja dhe në maj çetat e Korçës sulmojnë armikun për tri ditë rresht, çlirojnë Leskovikun dhe goditin autokolonat armike në Barmash.

Lufta jonë bëri të përmbysët qeveria e Mustafa

Krujës dhe kjo u zëvendësua me qeveritë e tjera kulla të Eqrem Libohovës dhe të Maliq Bushatit. Me gjithë manevrat e okupatorit dhe të kuislingëve, hovi i luftës sonë nuk u ndërpre. Përpara rrezikut të madh që e kërcënonte, armiku filloi të përdorte forca të mëdha për të shtuar terrorin dhe represaljet. Katunde dhe krahina të tëra u dogjën nga operacionet armike, por çetat partizane e ashpësonin edhe ca më tepër sulmin. Në qershor të vitit 1943 çetat partizane të Korçës, të Gjirokastrës dhe të Beratit me një operacion të kombinuar sulmuan ushtrinë italiane në Përmet e Kuqar, ku u luftua 7 ditë rresht dhe armiku pësoi humbje të mëdha.

Më 26 qershor 1943 forca të mëdha italiane dhe banda terroriste të Isa Toskës sulmojnë Mallakastrën. Çeta partizane e Mallakastrës dhe çetat e Vlorës bashkë me gjithë popullin e armatosur të kësaj krahine të çli-ruar, u hodhën nga mbrojtja në ofensivë, duke shpartalluar forcat e armikut, që arrinin në 2 000 vetë, duke vrarë qindra prej tyre dhe duke e çuar luftën në afërsitë e Fierit dhe të qytetit të Beratit. Më 2 korrik bie heroikisht Heroi i Popullit, Asim Zeneli, në grykën e Këlcyrës, duke luftuar me një autokolonë, që tentonte të kalonte nga Tepelena për në Përmet për t'i shkuar në ndihmë garnizonit të Kuqarit dhe të Përmetit, që ndodheshin në një gjendje të vështirë nga sulmet e partizanëve. Fashistët italianë në këto luftime të gjera, që shtriheshin prej Fierit në Leskovik, prej Kurveleshit dhe Tepelenës deri në Berat, përdorën aviacionin, tanksat, autobлиндat dhe artilerinë e rëndë. Populli i Tepelenës bashkë me çetën e asaj krahine dhe me një çetë partizane të Vlorës shpartalloi gjithë forcat italiane, që ten-

tuan t'i merrnin krahët Mallakastrës. Në këtë kohë në krahinën e Kurveleshit dhe të Mesaplikut luftohej me heroizëm kundër okupatorit dhe armiku u vuri zjarrin gjithë këtyre krahinave. Në operacionin e Kurveleshit dhe të Mesaplikut armiku përdori divizione të tëra, duke sulmuar në të katër anët, por populli dhe partizanët heroikë të këtyre krahinave, rezistuan dhe luftuan me heroizëm dhe i shkaktuan dëme të mëdha armikut. Kurveleshi, Mesapliku, Mallakastra ishin bërë epiqendra të luftimeve më të ashpra midis forcave të rregullta dhe të shumta të armikut nga një anë dhe çetave partizane e popullit të armatosur nga ana tjetër. Më 14 korrik katër divizione italiane sulmojnë Mallakastrën dhe Tepelenën. Forcat tona përbëheshin prej rreth 2 000 vetësh. Luftimet vazhduan për 6 ditë rresht, armiku u dëmtua rëndë, por mundi të shkelte krahinën e Mallakastrës e të Tepelenës, ku vrau me qindra njerëz të pafajshëm dhe u vuri flakën 78 katundeve. «Balli Kombëtar», me çetën e tij të komanduar nga Tefik Cfiri e Ali Zejneli, mori pjesë krah për krah me okupatorin në operacionin e Mallakastrës.

Në qarkun e Korçës vazhdonin luftime të ashpra, sikundër edhe në Pezë. Armiku u shpartallua. Italianët sulmuan njëkohësisht zonën e Martaneshit dhe çetën partizane të Baba Faja Martaneshit dhe pas luftimesh i vunë zjarrin gjithë krahinës. Këto veprime luftarake të italianëve me mbështetjen e «Ballit Kombëtar» konsiderohen si ofensivë e përgjithshme e ushtrisë italiane, kundër forcave nacional-çlirimtare në gjithë krahinat e Shqipërisë, me qëllim që ta asgjësonin Luftën nacional-çlirimtare. Por rezultati i kësaj ofensive qe dështimi i

plotë i saj dhe forcat partizane dolën më të forta dhe më të shumta nga ky operacion i përgjithshëm. Pothuajse në të gjithë Shqipërinë e Jugut dhe në të Mesmen armiku kishte garnizone të tij të përforcuara vetëm në qytete dhe pjesërisht në rrugët e komunikacionit, ndërsa të gjitha krahinat ndodheshin të çliruara, nën kontrollin e çetave e të batalioneve partizane dhe nën drejtimin e këshillave nacional-çlirimtare, që u bënë bërthama e pushtetit popullor.

KONFERENCA E PARË E VENDIT E PKSH DHE FORMIMI I USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Viti 1943 ka një rëndësi të veçantë për historinë e Luftës sonë nacional-çlirimtare, pse është viti i ngjarjeve të rëndësishme në jetën e Partisë sonë dhe të luftës sonë duke mbajtur në supe përgjegjësinë e drejtimit të luftës dhe duke ashpërsuar këtë luftë dita me ditë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Partia jonë, në marsin e vitit 1943 dërgoi delegatët e saj në Konferencën e parë të Vendit në Labinot, ku u bë bilanci i luftës dhe i forcave të Partisë, ku u caktua vija e Partisë që duhej të ndiqej pas Konferencës së parë të Vendit dhe nga ku doli Komiteti Qendror Definitiv i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ngjarja e dytë ishte formimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

Konferenca e parë e Vendit e mbajtur në Labinot, është një ngjarje historike nga më të rëndësishmet të Partisë sonë. Sido që në kohë ilegaliteti të madh dhe në kohën që zhvilloheshin luftime të ashpra në mes të

forcave partizane dhe atyre të okupatorit, delegatët për në konferencë u zgjodhën nga Partia në mënyrën më demokratike. Partia jonë në atë kohë përbëhej prej gati 600-700 vetësh dhe delegatët në konferencë arrinin numrin gati 70. Konferenca e parë e Vendit, pasi mori në shqyrtim situatën e jashtme dhe të brendshme, pasi vuri mirë në dukje rolin e madh të aleancës antifashiste me në krye Bashkimin Sovjetik, pasi shqyrtoi imtësisht metodat dhe taktikat e okupatorit dhe të kuislingëve në Shqipëri, pasi aprovoi vijën e drejtë të ndjekur nga Komiteti Qendror i Përkohshëm i Partisë dhe pasi aprovoi luftën e ashpër dhe të drejtë që Komiteti Qendror i Përkohshëm kishte bërë kundër fraksionistëve Anastas Lula e Sadik Premte dhe shokëve të tyre, i caktoi Partisë rrugën që duhej të ndiqte në të ardhshmen:

a) Partia të zgjeronte lidhjet me masat e gjera të popullit të qytetit dhe të fshatit dhe ta ashpërsonte edhe më tepër luftën kundër okupatorit. Në Frontin Nacional-Çlirimtar të grumbullohej i tërë populli dhe të lartësohej ndërgjegjja e tij për luftën kundër okupatorit;

b) Të organizoheshin dhe të shumëzoheshin edhe më tepër këshillat nacional-çlirimtare, të cilat të bëheshin me të vërtetë organet e pushtetit demokratik popullor dhe të Luftës nacional-çlirimtare, të shkatërrohej plotësisht pushteti i vjetër;

c) Të popullarizohej Bashkimi Sovjetik, atdheu i punëtorëve dhe i fshatarëve, udhëheqësi i luftës së fuqishme për çlirimin e popujve të robëruar nga fashizmi, të popullarizohej vepra e shkëlqyer e Lenin-Stalinit;

d) Të popullarizohej dhe të ngjallej dashuria e madhe në popullin tonë për Ushtrinë e Kuqe lavdiplote, e

cila shpëtonte njerëzimin nga bisha fashiste dhe që me heroizmat e papërshkruara të saj, u sillte popujve të robëruar lirinë;

dh) Të popullarizohej koalicioni i fuqishëm i aleatëve sovjeto-anglo-amerikanë dhe lufta heroike e popujve të tjerë të robëruar të Evropës.

Konferenca e parë e Vendit përshëndeti njëzëri direktivat dhe ndihmat e Internacionales Komuniste¹ që i erdhën në ato momente Partisë sonë, të cilat i hapën perspektiva të mëdha Luftës nacional-çlirimtare dhe i lejuan vetë konferencës të zgjidhte Komitetin Qendror Definitiv.

Konferenca, duke aprovuar vijën politike dhe organizative të Komitetit Qendror të Përkohshëm të Partisë, konstatoi se Komiteti Qendror i Përkohshëm ka ditur ta ruajë Partinë nga armiqtë e saj të betuar, trockistët, arqiomarksistët, nga armiqtë e brendshëm, nga elementët antiparti përgjithësisht dhe të krijonte unitetin. Duke kritikuar nga ana tjetër gabimet dhe mungesat: si monopolizimi i punës, mungesa e iniciativës, mungesa disa herë e konspiracionit, neglizhenca dhe mungesa e ashpërsimit të luftës së duhur kundër elementit grupash, duke vënë në dukje shenjat e lokalizmit të shfaqur në Korçë dhe joashpërsinë e madhe kundër armikut, duke vënë në dukje shenja lokalizmi dhe plogështie në organizatat e Shkodrës, si dhe lidhjet e do-

¹ Direktivat e Komitetit Ekzekutiv të Internacionales Komuniste mbi luftën nacional-çlirimtare i erdhën Partisë Komuniste të Shqipërisë në dhjetor të vitit 1942.

bëta të Gjirokastrës me qendrën¹, konferenca vuri në dukje mungesat dhe lëshimet që paraqiteshin në punë dhe u vuri përpara anëtarëve të Partisë këto detyra:

a) Të forconin punën në punëtorët, si në qendrat industriale të rëndësishme të vendit tonë dhe të lidheshin organizativisht me to. Të zgjeronin punën me zanaçinjtë, të shtonin radhët e Partisë me punëtorë si edhe radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

b) Të përcaktonin rëndësinë e madhe të punës së Partisë në fshat, ku ishte burimi kryesor për luftën aktuale dhe të bënin një propagandë të shumanshme në fshat, për luftën kundër analfabetizmit dhe kundër gjithë veseve të së kaluarës.

c) Si detyrë nga më kryesoret ishte çështja e forcimit dhe e zmadhimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare që kjo të bëhej një fuqi e tmerrshme kundër okupatorit dhe garancia e sigurt dhe e fuqishme për çlirimin e popullit.

d) Puna me rininë të ishte një nga sektorët e rëndësishëm të Partisë sonë dhe të kuptohej mirë se rinia ishte burimi i gjallë i fuqive të reja dhe të shëndosha të Partisë, se rinia ishte fuqia e pashterueshme e Luftës nacional-çlirimtare. Konferenca i rekomandonte posaçërisht Partisë që t'i jepte si shembull rinisë sonë, rininë heroike të Bashkimit Sovjetik, komsomolin dhe lufta heroike e komsomolit të ishte një shembull për

¹ Gjatë vitit 1942 në Komitetin qarkor të PKSII për Gjirokastrën, të ndikuar nga Bedri Spahiu, u shfaqën prirje për autonomi. Ky komitet nuk zbatonte ose i shtrembëronte direktivat e Komitetit Qendror, nuk i raportonte atij mbi veprimtarinë e vet. Për këtë arsye udhëheqja e Partisë e shpërndau dhe organizoni zgjedhjen e një qarkori të ri.

rininë tonë se si luftohej e i shërbehej popullit të vet dhe, njëkohësisht, se si luftohej për një të ardhshme më të mirë e më të lumtur për rininë.

dh) Konferenca i rekomandonte posaçërisht Partisë të intensifikonte dhe të zgjeronte punën me gruan, ta bënte këtë të ndërgegjegjshme për detyrat e saja dhe ta fuste në luftë për lirinë e popullit të saj për të fituar njëkohësisht të drejtat e saja.

Konferenca i përcaktoi Partisë detyra organizative siç ishin ato të forcimit të punës në celula, krijimi i organizatave të Partisë në fshat, zhdukja e sektarizmit, ngritja e kuadrit, të luftohej kundër paditurisë, të edukoheshin kuadrot me frymën marksiste-leniniste dhe t'u vihej kuadrove në duar njëkohësisht edhe libri edhe pushka, të vihej në duart e anëtarit të Partisë Historia e PK(b) të BS, të krijoheshin mundësitë që shokët të mësonin në rrethe ose individualisht dhe, ajo që ishte më e rëndësishme, u rekomandohej anëtarëve të Partisë të kishin marrëdhënje shoqërore dhe komuniste në mes të tyre dhe të luftohej çdo shenjë qëndrimi komandues e ushtarak në radhët e Partisë. Konferenca i thoshte Partisë të zhdukte sektarizmin, t'u jepte mundësi shokëve të shfaqnin kapacitetet e tyre, të zhdukej drojtja në Parti, të viheshin shokë të rinj në vende me përgjegjësi dhe të zhvillohej iniciativa, të zhvillohej ndjenja e përgjegjësisë në anëtarët dhe në udhëheqësit. Përsa i përket vigjilencës revolucionare, konferenca i thekson-te Partisë:

«Duhet të zhvillohet në shokët zgjuarësia kundër provokacionit që armiku mundohet me çdo mënyrë të

futë në radhët tona, kundër armiqve të fshehtë; të luftohet importimi i çdo ideje të huaj të cilën armiqtë tanë të ndryshëm mundohen ta futin në radhët tona. . .

Duhet të luftojmë pa mëshirë kundër elementëve trockistë, kundër të gjithë deviatorëve dhe armiqve të Partisë, duhet të merret seriozisht spastrimi i Partisë nga elementët e luejtshëm, inaktivë dhe të pavendosur dhe sidomos nga elementët grupashë. Organizatat dhe anëtarët duhet të vazhdojnë pa mëshirë luftën kundër armikut të Internacionales Komuniste dhe të Partisë sonë trockistit Zai Fundo dhe elementëve të ndryshëm trockistë: Dhimitër Fallo, Aristidh Qendro, Niko Xoxi, Niko Kondi, Andrea Zisi etj.»¹.

Kështu u përcaktua vija që duhej të ndiqte Partia: Konferenca e parë e Vendit i dha Partisë Komitetin Qendror Definitiv me në krye si Sekretar të Përgjithshëm të Partisë shokun Enver Hoxha. Në Rezolucionin e Konferencës së parë të Vendit theksohej se

«Megjithëse para Partisë sonë të re paraqiten detyra të shumta dhe të rënda ajo do të shkojë me krenari drejt fitimit definitiv nën flamurin e Internacionales Komuniste, të Leninit dhe të Stalinit, dhe do të plotësojë detyrën karshi masave punonjëse dhe karshi popullit tonë.

Duhet të jemi të pamëshirshëm dhe në radhët e para të luftës kundër armikut të betuar të njerëzimit dhe të popullit tonë, kundër fashizmit.

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 118-119.

Duhet të krijojmë dhe të spastrojmë Partinë si na ka mësuar i madhi Lenin, si na ka mësuar i madhi Stalin, duke krijuar Partinë më revolucionare, dhe të marrim vend të merituar në radhët e lavdishme të Internacionales Komuniste»¹.

Konferenca e parë e Vendit i dha një hov të madh zhvillimit dhe forcimit të Partisë sonë, i dha një hov të jashtëzakonshëm Luftës nacional-çlirimtare. Njerëzit e Partisë sonë u armatosën për të korrur suksese të shkëlqyera. Komiteti Qendror Definitiv drejtoi me zgjuarësi dhe heroizëm luftën e Partisë sonë, ai zbatoi me besnikëri detyrat e rëndësishme që i ngarkoi konferenca, ai zbatoi dhe luftoi për vijën e drejtë të Partisë dhe këtë vijë të drejtë do ta mbronte deri në fund. Duke zbatuar me vendosmëri vijën politike të konferencës, duke pasur kurdoherë parasysh dhe duke luftuar deri në fund për idetë e lavdishme të Marksit-Engelsit-Leninit e Stalinit, duke ushqyer një dashuri të pakufishme për popullin shqiptar, nga gjiri i të cilit kishte dalë, duke ushqyer një dashuri të madhe për popujt e Bashkimit Sovjetik, për Partinë e lavdishme Bolshevike dhe për shokun e madh Stalin, Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj e shpuri popullin në fitoren më të madhe të historisë sonë.

¹ Dokumenta Kryesore të PPSH. Vëll. I, f. 119.

Duke parë hovin e madh që mori Lufta nacional-çlirimtare, duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte çliruar nga çetat dhe batalionet partizane, duke marrë parasysh shtimin dhe zgjerimin e këtyre formacioneve partizane dhe duke parashikuar goditjet e ashpra të mëvonshme kundër forcave të mëdha të okupatorit, Partia jonë dhe Komiteti Qendror vendosën organizimin më të përsosur të forcave partizane dhe transformimin e shpejtë të këtyre forcave në një ushtri të organizuar dhe të drejtuar nga një Shtab i Përgjithshëm. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare u formua më 10 Korrik 1943. Formimi i Shtabit të Përgjithshëm shënon një ngjarje me rëndësi historike për zhvillimin e mëtejshëm të luftës së armatosur të popullit tonë kundër okupatorëve, për formimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Pas formimit të Shtabit të Përgjithshëm u organizuan shtabet e qarqeve dhe të zonave. U kalua nga faza e çetave dhe e batalioneve në fazën e brigadave partizane. Kështu më 15 gusht 1943 formohet në Vithkuq të Korçës Brigada I Sulmuese partizane. Në këtë kohë ngjau kapitullimi i Italisë fashiste. Në këto momente fillon e hapët politika armiqësore e anglezëve kundër Luftës nacional-çlirimtare shqiptare, dhe ngjau «Mukja», vepra e oportunistit Ymer Dishnica.

Pas formimit të Shtabit të Përgjithshëm, të udhëhequr dhe të formuar nga Partia jonë, Partia mendoi t'i bëjë edhe një herë thirrje «Ballit Kombëtar» që të braktiste rrugën e tradhëtisë, të shpërndante organizatën dhe

elementët e saj të merrnin pjesë në Luftën e në Frontin Nacional-Çlirimtar, d.m.th. në luftën e paprerë kundër okupatorit fashist italian e gjerman, në luftën krah për krah me aleatët e mëdhenj anglo-sovjeta-amerikanë dhe me popujt e shtypur, veçanërisht me lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve fqinjë, të Jugosllavisë e të Greqisë dhe të njihte këshillat nacional-çlirimtare si i vetmi pushtet demokratik popullor. Njëkohësisht «Balli» duhej të spastronte radhët e tija nga elementët e lidhur me fashizmin, nga spiunët, nga kriminelët, nga spekulatorët, etj. «Balli Kombëtar» duhej të pushonte menjëherë luftën dhe propagandën antikomuniste, që ishte e papaj-tueshme me luftën për vendosjen e një demokracie popullore në Shqipëri. Kjo ishte platforma që duhej të mbronte në bisedimet me krerët e «Ballit Kombëtar» ish-anëtari i Komitetit Qendror, Ymer Dishnica dhe anëtarët e tjerë të delegacionit të Frontit Nacional-Çlirimtar, delegacion ku bënë pjesë, në mes të tjerëve edhe anëtari i Partisë Mustafa Gjinishi e Bazi i Canës, si pjesëtar i Frontit Nacional-Çlirimtar.

Delegacioni i Frontit Nacional-Çlirimtar dhe ai i «Ballit» u mblodhën në Mukje. Ymer Dishnica, duke mos i mbrojtur aspak pikëpamjet e Partisë, ra kryekëput në pozitat nacionaliste, në pozitat reaksionare dhe shoviniste të «Ballit Kombëtar». Ai shkeli vijën e Partisë, urdhërat dhe direktivat e Komitetit Qendror, mohoi Luftën nacional-çlirimtare dhe veproi në mënyrë të kundërt me direktivën e Komitetit Qendror. Ymer Dishnica, me kompromisin e tij në Mukje, e vuri «Ballin Kombëtar», që kurrë s'kishte hedhur asnjë pushkë kundër okupatorit, në një radhë me lëvizjen nacional-çlirimtare.

Nga ana tjetër ai hodhi poshtë dhe mohoi rolin drejtues të Partisë sonë, duke rënë dakord me «Ballin Kombëtar» për krijimin e «Komitetit të shpëtimit të Shqipërisë», ku të merrnin pjesë edhe ballistë dhe ky komitet të drejtonte luftën. Ymer Dishnica ra në pozitat e reaksionit dhe pranoi çështjen e «Shqipërisë etnike», parullë dhe pikëpamje shoviniste, që armiku e kishte ngritur si një armë të përçarjes me popujt fqinjë dhe kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë. Të gjitha këto vendime, pa vënë aspak në dijeni Komitetin Qendror të Partisë, Ymer Dishnica pranoi që t'i komunikoheshin popullit me trakt dhe kjo u bë. Gjithë puna e Mukjes e Ymer Dishnicës dhe e Mustafa Gjinishit ishte një tradhëti që i bëhej popullit dhe Partisë. Komiteti Qendror i Partisë sonë, në momentin që mori vesh veprën e Ymer Dishnicës dhe të Mustafa Gjinishit, e dënoi atë si tradhëti, nuk pranoi asnjë vendim që ishte marrë në Mukje, disaprovoi veprën e Ymer Dishnicës, i tërhoqi mandatin dhe lajmëroi Partinë dhe popullin. Ymer Dishnica në Mukje, në vend që «Ballin Kombëtar» ta nxirrte në dritën e vërtetë, si organizatë të reaksionit dhe të tradhëtisë, si organizatë, që kishte në program përçarjen, sabotimin sistematik kundër gjithë përpjekjeve të Partisë sonë për një bashkim të shëndoshë të popullit tonë, i dha në dorë «Ballit Kombëtar» një pretekst për të shumëfishuar intrigat e tija në popull. Fajin e madh të Ymer Dishnicës, që ishte vetëm fryt i oportunitizmit dhe i pikëpamjeve oportuniste dhe nacionaliste të tij dhe jo i Komitetit Qendror të Partisë sonë, trockistët jugosllavë e shfrytëzuan për të diskredituar udhëheqjen e Partisë sonë, duke na akuzuar nga njëra anë se ishim në

pozita oportuniste me «Ballin» dhe nga ana tjetër duke na këshilluar që t'i vazhdonim bisedimet dhe luftën kundër «Ballit» nga platforma e Mukjes. Komiteti ynë Qendror i hodhi poshtë të dyja këto pikëpamje të trocistëve jugosllavë dhe Konferenca Nacional-Çlirimtare, që u mbajt në Labinot¹ nën drejtimin e Partisë sonë Komuniste, i dha fund Mukjes dhe forcoi edhe më tepër luftën kundër okupatorit, «Ballit Kombëtar», kuislingëve dhe gjithë tradhëtarëve.

Kur rezistenca e popullit tonë kishte filluar dhe demonstratat kishin shpërthyer, Abaz Kupi, agjent i Zogut dhe i anglezëve, u kthye në Shqipëri. Duke ndënjur gjoja në gjysmilegealit, ai priste momentin e volitshëm që të dilte në skenë si protagonist për të zbatuar në vendin tonë kartën e Inteligens Servis-it. Abaz Kupi, si përfaqësues zogist aderoi në Frontin Nacional-Çlirimtar, pranoi për sy e faqe vendimet e Konferencës së Pezës, pranoi se gjoja do të luftonte kundër okupatorit dhe kuislingëve. Por në realitet ai nuk luftoi aspak dhe as i pranoi vendimet e Pezës; jo vetëm kaq, po derisa u deklarua hapët kundër lëvizjes nacional-çlirimtare, ai i luftoi këto vendime dhe e sabotonte luftën e Frontit Nacional-Çlirimtar kundër okupatorit. Taktika e Bazit të Canës ishte taktika e anglezëve, të cilët nën aleancën antifashiste, po përgatishnin reaksionin dhe po përpiqeshin të forconin pozitën e tija të tronditura nga lufta e madhe e popujve. Këtë përgatitje të reaksionit, anglezët e bënë njëkohësisht me ndihmën e fashizmit. Pra,

¹ Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare u mbajt në Labinot të Elbasanit më 4-8 shtator 1943.

Abaz Kupi, i këshilluar nga anglezët, për të mos u demaskuar, duhej të qëndronte për sy e faqe në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe, nën prestigjin e Luftës nacional-çlirimtare, i ndihmuar indirekt nga fashizmi, të grumbullonte nën drejtimin e tij, me kartën e Zogut, gjithë reaksionin shqiptar. Gjatë okupacionit italian dhe në kohën kur populli luftonte kundër fashizmit dhe tradhëtarëve, Bazi i Canës vazhdonte punën tradicionale të Zogut, duke bërë mbledhje e duke u lidhur me krerët e reaksionit dhe me bajraktarët për të goditur luftën e popullit shqiptar. Njëkohësisht, Inteligens Servis-i me agjentët e tij shqiptarë u përpoq që të delnin nga Shqipëria «figura» si Mehdi Frashëri dhe të formonin një qeveri shqiptare kukull në Londër, që të ishte një armë e anglezëve për më vonë. Bazi i Canës dhe reaksioni, nën drejtimin e misioneve angleze, kishin gjithashtu në program të krijonin e të ndreqnin disi opinionin ndaj Zogut dhe të arrinin në përfundimin që reaksioni shqiptar, në shërbim të italianëve dhe më vonë të gjermanëve, të pranonte platformën e anglezëve, d.m.th. të grumbullohej rreth Zogut. Anglezët menduan se momenti i përshtatshëm për ta luajtur kartën e Zogut, ishte kapitullimi i Italisë. Në kohën kur zhvilloheshin bisedimet në Mukje, Abaz Kupi e hoqi maskën. Ai filloi veprimtarinë e veçuar. Nën drejtimin e anglezëve ai bëri në Zall të Herit një mbledhje, ku merrnin pjesë krerët e reaksionit dhe një përfaqësues i misioneve ushtarake angleze. Aty ai krijoi «Legalitetin». Bazi i Canës, agjent i anglezëve, donte të luante rolin e arbitrit në mes të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe «Ballit Kombëtar», derisa të vinte momenti oportun për të thënë fjalën e tij të fundit.

Me traktin e tij, që hodhi me datë 19.IX.1943, Abaz Kupi, ky bajraktar kriminel, thotë: «Ndëgjohen andej-këndej sulmime reciproke në mes partinash, kjo gja ka qenë dhe asht kundër dëshirës sime». Abaz Kupi filloi bisedimet me krerët e tradhëtisë, si Lumo Skëndon, Ali Këlcyrën, Hasan Dostin, etj.; ai u lidh ngushtë me regjentin kuisling të ardhshëm, Mehdi Frashërin, i cili do të bënte lidhjet në mes të gjermanëve, anglezëve dhe Bazit të Canës; u lidh me bajraktarë të Veriut, agjentë të përhershëm dhe armiq të popullit si Fiqri Dinen, Ali Maliqin, Uke Camin, Bilal Kolën, Hysni Demën, etj. dhe tok me ta dhe me «Ballin Kombëtar» organizuan një mbledhje dhe hodhën një trakt në shtator 1943, ku bëhej fjalë për «shpëtimin e Shqipërisë nga rreziku» dhe rreziku për ta ishte lëvizja nacional-çlirimtare e popullit. Ky ishte fillimi i grumbullimit të reaksionit në një vapor të ri, në vaporin gjerman, sepse vaporin italian u mbyt. Anglezët dhe Bazi i Canës, pra, formuan «Legalitetin». Formimi i «Legalitetit» koincidoi dhe u koordinua me përgatitjet nga ana e gjermanëve të operacionit të dimrit kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Gjermanët dhe kuislingu Mehdi Frashëri dhe [Rexhep] Mitrovica e të tjerë, flisnin haptas për të mirat e regjimit të Zogut, për organizimin e shëndoshë të xhandarmërisë, të ushtrisë së tij etj. Pra, hesapet bëheshin prej anglezëve dhe gjermanëve që të goditej për vdekje Partia dhe lufta jonë dhe, me kapitullimin e Gjermanisë, të rivendosej në Shqipëri regjimi i kapitalit dhe i Zogut. Gjermanët e lanë të lirë Bazin e Canës të propagandonte. Mbledhjes së zogistëve në Zall të Herrit, anglezët donin t'i jepnin jo vetëm pamjen e një partie politike, po të

një lëvizjeje të gjerë legjitime zogiste, d.m.th. të njihej de jure restaurimi i regjimit të Zogut. Këtë ata e shpjegonin me atë se gjoja ai vazhdonte të ekzistonte, se ai ishte vendosur që më 1924 me vullnetin e popullit, se ai ishte regjimi i «Legalitetit», i krijuar më 1924 dhe se ai u mposht vetëm me forcën e bajonetave italiane, kundër vullnetit të popullit, më 7 prill 1939. Pra, sipas anglezëve dhe Bazit të Canës, regjimi i «Legalitetit» vazhdonte dhe duhej të njihej nga populli dhe sidomos nga Partia jonë si legjitim. Bazi i Canës në atë kohë i bëri apel popullit për bashkim nën flamurin e «Legalitetit» dhe jo thirrje për luftë kundër okupatorit gjerman dhe kuislingëve. Këtë platformë politike të anglezëve dhe të Bazit të Canës e kishin pranuar gjermanët dhe kuislingët. Komiteti ynë Qendror vendosi goditjen dhe demaskimin e kësaj manevre të anglezëve dhe të gjermanëve. Delegatët tanë bënë takimin e fundit me Bazin e Canës në Shëngjergj të Tiranës. Bazi i Canës mbrojt tezën e tij se regjimi i Zogut nuk ka pushuar së ekzistuari dhe se ai do të rivendoset de jure dhe de fakto, pas çlirimit të Shqipërisë. Pra, Fronti Nacional-Çlirimtar nuk duhet të ekzistojë, pse ka qenë dhe është një maskë e Partisë Komuniste dhe se Partia Komuniste do të mund të ekzistojë si Parti, nën «Legalitetin», d.m.th. nën regjimin e Zogut. Abaz Kupi citonte mësimin që i kishin mësuar anglezët. Ne ja shqelmuam të gjitha këto pretendime Bazit të Canës. Lëvizja nacional-çlirimtare nuk mund të mos luftonte kundër Zogut dhe regjimit të tij edhe me rastin e kësaj manevre të fundit të njerëzve të Zogut e të anglezëve. Populli dhe Partia jonë i thanë Bazit të Canës se ne kemi qenë dhe do të je-

mi kundër monarkisë dhe Zogut; e këshilluam Bazin e Canës të largohej nga kjo rrugë e tradhëtisë dhe se Partia jonë dhe populli shqiptar do t'i godiste pa mëshirë dhe do t'i mundte, ashtu si i kishte mundur të gjithë armiqtë e popullit. Lodra e Bazit të Canës dhe manevra e anglezëve u demaskuan në popull me deklaratën që lëshoi Fronti Nacional-Çlirimtar në atë kohë¹. Abaz Kupi doli me figurën e vërtetë të kuislingut, d.m.th. me fytyrën e agjentit të Zogut dhe njëkohësisht të anglezëve, agjent i gjermanëve si dhe i kuislingëve të tjerë. Në përpjekje të tilla Partia jonë vazhdoi luftën me heroizëm.

Me formimin e Shtabit të Përgjithshëm, filloi një etapë e re e luftës për çlirimin e vendit; kryengritja e përgjithshme e popullit, kundër okupatorit kishte filluar. Porsa u formua Brigada I, ajo u inaugurua me zjarr, kundër italianëve në Vithkuq dhe kundër gjermanëve në Barmash. Ishte momenti i kapitullimit të Italisë. Pas tri ditë luftimesh të ashpra me italianët, armiku mundi të hynte në Vithkuq, të cilin e dogji krejt. Shtabi i Përgjithshëm e zhvilloi me sukses shpirtin sulmues të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare i frymëzuar prej mësimëve të Leninit sipas të cilave:

«Pasi kryengritja të ketë filluar, duhet vepruar me vendosmërinë më të madhe dhe duhet

¹ Është fjala për Rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar mbi përjashtimin e Abaz Kupit nga Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nac.-Çl. aprovuar në mbledhjen e jashtzakonshme të 7 dhjetorit 1943.

kaluar në sulm. Mbrojtja është vdekje për çdo kryengritje të armatosur»¹.

Dhe Partia jonë e ka vlerësuar si duhet këtë parim themeltar të marksizëm-leninizmit mbi kryengritjen e armatosur. Ja si i shkruan Shtabi i Përgjithshëm në shtator të 1943-së një batalioni partizan, i cili ishte hedhur në plogështi dhe kishte humbur shpirtin sulmues:

«Prej atij shtabi nuk është kuptuar akoma taktika e luftës partizane. Partizanët nuk duhet të jenë kurrë në difensivë, kurse ndejtja e juaj në pozicione është një luftë difensive, që mund ta dërgojë ushtrinë tonë përballë një force të madhe të armikut, e cila mund ta asgjësojë. Duhet ndërruar patjetër taktika e taktika e jonë është ofensiva, kështu që me manevrime të shpejta e me goditje në vende të ndryshme të armikut, me e hutue atë... duke hedhur urat në erë, duke goditur kolonat gjermane pa pra. Të sulmoni depot e italianëve e të gjermanëve e të merrni materialin, me të cilin të armatosni të mobilizuarit për në radhët partizane»².

Orientimi që i dha Shtabi i Përgjithshëm luftës sonë qe shumë i drejtë. Ushtria jonë nuk kishte kuadro dhe këto duhej të dalnin nga vetë lufta. Parulla e Partisë ishte që kuadrot duhej të dalin nga lufta dhe Partia kështu e zgjidhi problemin e kuadrit në Luftën nacional-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 133.

² Dokumenta të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH, vëll. I, f. 100.

-çlirimtare, duke ngritur e duke edukuar njerëzit e vendosur për luftën në radhën e udhëheqësve. Kështu u veprua dhe erdhën në krye të reparteve tona punëtorë, fshatarë, intelektualë patriotë që i fituan përgjegjësitë e tyre në përpjekje të përgjakshme. Në këtë mënyrë u veprua që përbërja shoqërore e kuadrove tanë në ushtri të jetë me baza të shëndosha.

Ushtria jonë s'kishte veshmbathje dhe ushqime, s'kishte armë, por të gjitha këto u muarën në luftë. Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm e orientuan drejt Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, se ajo duhej të armatosej me armët e armikut, të cilit duhej t'ja rrëmbente duke luftuar. Ja si u shkruan komandave të qarqeve dhe grupeve partizane në gusht të vitit 1943 Shtabi i Përgjithshëm:

«Duhet pasur parasysh nga komandat se veshja dhe armatimi ynë duhet të nxirret nga armiku; burimi ynë është vetëm sulmi kundër depove të armikut; duhet të luftoni e të merrni prej armikut»¹.

Ndihma e aleatëve, Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare ka qenë vetëm simbolike. Qëllimi i anglezëve ka qenë që me ato pak rroba ose pushkë të vjetra, të ngatërronin dhe të përçanin Luftën tonë nacional-çlirimtare e jo ta ndihmonin efektivisht. Anglezët, për t'i imponuar lëvizjes sonë pikëpamjet e tyre, e përdornin furnizimin e materialit si presion e shantazh dhe, meqë ata s'kishin

¹ Dokumenta të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH, vëll. I, f. 37.

sukses në kërcënimet e tyre edhe ndihma e tyre, pra, ishte qesharake.

Shtabi i Përgjithshëm i mësoi repartet e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare që të goditnin armikun në befasi dhe ta përdornin befasinë, manevrën dhe shpirtin sulmues si armë me rëndësi në luftën kundër armikut. Në nëntor 1943 Shtabi i Përgjithshëm i shkruante Shtabit të Brigadës I:

«Taktika që përdor armiku është të sulmojë dhe të sulmojë sa më shumë që të mos na lerë të marrim frymë. Kjo është taktika jonë dhe s'duhet në asnjë mënyrë që iniciativën ta ketë ai... nuk lejohet që armiku të na gjejë në befasi»¹.

Në të njëjtën kohë Shtabi i Përgjithshëm u shkruante komandave të qarqeve dhe të zonave operative:

«Lufta që duhet t'i zhvilloni armikut duhet të mbajë karakterin e vërtetë të një ofensive të paprerë, me goditje të forta, në momente dhe në vende ku armiku nuk e pret, duke i shkaktuar kështu humbje të mëdha dhe duke ruajtur efektivat tona.

Të evitohen luftërat frontale dhe në vende e në momente ku dëshëron armiku; të mos qëndrohet kurrë në pritjen e ofensivës së armikut, por me e shkatërrue këtë ofensivë përpara se të fillojë»².

Në këtë mënyrë, duke u bazuar në artin marksist-leninist të kryengritjes së armatosur të popullit dhe në

1 Dokumenta të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të UNÇSH, vëll. I, f. 143.

2 Po aty, f. 74.

vetë eksperiencën e përditshme, Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm e orientuan drejt në pikëpamje politiko-ushtarake ushtrinë tonë.

LUFTA ME OKUPATORIN GJERMAN

Me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri fillon një etapë e re dhe e rëndë për Luftën tonë nacional-çlirimtare. Forcat partizane u ndeshën që në fillim me trupat gjermane që vinin nga Greqia në qarkun e Korçës. Që në fillim filloi terrori i papërshekruar, fshati i Borovës u zhduk krejt në zjarr e në plumb me tërë popullatën dhe me shtëpitë e tij¹. Gjermanët zëvendësuan italianët, kapën gjithë kyçet, organizuan regjencën e qeverinë kull të tyre dhe grumbulluan reaksionin kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Këtë herë s'kishte më maska: «Balli Kombëtar» doli sheshit në shërbim të gjermanëve dhe u hodh në luftë të hapët kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Po ashtu edhe «Legaliteti» si dhe gjithë tradhëtarët e tjerë. Për reaksionin ishte sulmi i fundit për jetë ose për vdekje dhe nën bajonetat gjermane ata duhej të organizoheshin, të luftonin me ashpërsinë më të madhe kundër Partisë dhe lëvizjes nacional-çlirimtare dhe, pas kapitullimit të Gjermanisë, të merrnin fuqinë në dorë. Por Partia jonë që udhëhiqte me lavdi popullin tonë në luftëra të ashpra, ua prishi planet. Lufta nacional-çlirimtare, me ardhjen e okupatorit të ri, u zgjerua edhe ca

¹ Më 6 korrik 1943 forcat partizane që kishin zënë pritë afër fshatit Barmash, kryen sulmin e parë kundër një autokolone ushtarake gjermane që kalonte nëpër rrugën Korçë-Janinë. Për ahmarrje fashistët hitlerianë e rrafshuan krejt Borovën dhe masakruan 107 burra, gra e fëmijë.

më tepër; po zgjerohej dhe forcohej Ushtria heroike Nacional-Çlirimtare. Pas formimit të Brigadës I, u formua Brigada III në Pezë dhe Brigada II në Elbasan. Gjermanët organizuan ofensivën e tyre të dimrit, e cila kishte për qëllim asgjësimin e forcave partizane e të këshillave nacional-çlirimtare dhe vendosjen e pushtetit reaksionar në shërbim të gjermanëve. Këta pasi kishin kryer operacionet e tyre të gjera paraprake në Shqipërinë e Mesme kundër Pezës dhe Elbasanit filluan ofensivën e përgjithshme të dimrit në Shqipërinë e Jugut. Në këto operacione luftarake gjermanët hodhën katër divizione të ushtrisë së tyre, përveç gjithë bandave balliste, zogiste dhe xhandarëve të regjencës. Ofensiva armike e dimrit qe një provë e rëndë për ushtrinë tonë. Forcat tona luftuan me heroizëm në kondita jashtzakonisht të vështira, në male të mbuluara me borë, pa ushqime e armatime të mjaftueshme dhe zbathur. Gjatë kësaj ofensive armiku sulmoi qendrat tona më vitale nga shumë drejtime duke përdorur taktikën e mësymjeve koncentrike. Forcat partizane luftuan me heroizëm të pashembullt. Manevrimi i kujdesshëm nga ana e Shtabit të Përgjithshëm i reparteve partizane në kondita luftarake dhe klimatike shumë të vështira, bëri të mundur që forcat tona të përballonin me sukses ofensivën armike dhe t'i shpëtonin rrezikut të asgjësimit nga armiku, shumë më superior në numër dhe në mjete. Të gjitha forcat partizane ishin në përpjekje dhe në luftë. Brigada I manevron me shpejtësi dhe lufton në Mesaplik e në Skrapar. Formohet Brigada VI. Brigada IV sulmon në Gorë dhe Opar. Më vonë, pesha e rëndë e operacionit bie mbi Brigadën V, e cila manevron dhe lufton në malet

e Kurveleshit dhe të Këndrevicës. Brigada IV e godit armikun pas krahëve dhe me një veprim të shpejtë çliron zonat e okupuara nga armiku, duke lehtësuar rezistencën e Brigadës V dhe veprimtarinë e brigadave të tjera. Brigada II dhe III u goditën në rrethet e Elbasanit nga forcat armike në numër të madh, të cilat sulmuan nga të katër anët zonën e Çermenikës për të asgjësuar forcat tona dhe Shtabin e Përgjithshëm. Në të njëjtën kohë Brigada I, pasi thyen forcat gjermane në zonën e Skraparit, çliron Skraparin, Tomorricën dhe Mokrën dhe me një pjesë të forcave të saja, me një manevrim të shpejtë, kapërcen Shkumbinin dhe hidhet në zonat e armikut në Çermenikë të Elbasanit, ku ndodhej Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, i cili sapo kishte dalë nga rrethimi i rrezikshëm i armikut. Inkursioni i Brigadës I, thellë në zonat më reaksionare, që, me një marshim të shpejtë dhe plot rreziqe, e rrethuar plotësisht gjashtë herë, kalon si rrufe nëpërmjet Skraparit, Mokrës, Çermenikës, Gollobordës, Martaneshit, Shëngjergjit, Pezës, Dumresë, Sulovës, për t'i ardhur në ndihmë Shtabit të Përgjithshëm, ishte shprehja e besimit dhe e besnikërisë së ushtrisë sonë ndaj Komitetit Qendror të Partisë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të saj; ky ishte njëkohësisht dhe një diversion në shkallë të gjerë, që tronditi armikun duke mos lejuar rifillimin e shpejtë të një operacioni të dytë nga forcat reaksionare në Shqipërinë e Mesme; ky forcoi besimin e popullit dhe shkatërroi demagogjinë e armikut që trumbetonte se u shkatërrua Ushtria Nacional-Çlirimtare. Nga ofensiva e dimrit ushtria jonë jo vetëm që nuk u asgjësua, por doli edhe më e fortë. Ndërsa në fillim të ofensivës, përveç njësiteve të

vogla partizane, ajo kishte si njësi të mëdha Brigadën I, II e III dhe pas tre muajsh luftime të ofensivës së dimrit, ushtrisë ju shtuan Brigada IV, V, VI e VII, përveç batalioneve dhe grupeve të shumta, që u formuan gjatë kësaj kohe në gjithë zonat e Shqipërisë.

Pas ofensivës së dimrit Ushtria Nacional-Çlirimtare u hodh kudo në sulm kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. U çliruan të gjitha zonat që kishte okupuar armiku dhe u çliruan edhe zona të tjera. Armiku u detyrua të mbyllet në qytetet kryesore duke u fortifikuar rreth tyre dhe duke mbajtur vetëm vijat kryesore të komunikacionit, të cilat ishin nën zjarrin e vazhdueshëm të forcave partizane, që sulmonin kolonat, hidhnin në erë urat, sulmonin tanksat, autobлиндat dhe goditnin përqëndrimet e armikut. Kjo situatë ishte kërcënuese për armikun. I shqetësuar nga një situatë e tillë, okupatori grumbulloi përsëri forca të reja për një ofensivë të re kundër ushtrisë sonë. Për dy muaj rresht gjatë prillit dhe majit 1944 armiku organizoi ofensivën e tij të verës dhe nga mbarimi i majit filloi ofensiva e dytë e përgjithshme e gjermanëve kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Katër divizione e gjysmë të ushtrisë gjermane dhe gjithë forcat e armatosura të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit» muarën pjesë në këtë ofensivë. Qëllimi i armikut ishte të godiste për vdekje ushtrinë tonë, forcën e armatosur të lavdishme të popullit tonë, të farkëtuar nëpërmjet kaq luftërash të përgjakshme, të godiste Partinë tonë heroike, udhëheqësen e lavdishme të popullit tonë dhe të Frontit Nacional-Çlirimtar dhe të ndalonte mbledhjen historike të Kongresit të Përmetit. Forcat tona nacional-çlirimtare i mbrojtën me heroizëm

zonat e çliruara, bënë të mundur që Kongresi i Përmetit të mbaronte punimet e tij në qetësi, të formoheshin njësitet e mëdha të ushtrisë, divizionet dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare të hidhej në kundërofensivën e fundit, vendimtare.

**KONGRESI I PËRMETIT DHE Mbledhja e Beratit.
Ndërtimi i shtetit të ri të demokracisë
popullore dhe lufta për çlirimin e
plotë të Shqipërisë**

Më 24 Maj 1944 u mbajt Kongresi historik në qytetin e Përmetit, i çliruar nga forcat partizane dhe i djegur 2-3 herë nga okupatorët. Në këtë kongres kishin ardhur delegatë të popullit shqiptar, të zgjedhur në mënyrën më demokratike nga gjithë anët e Shqipërisë, nga zonat e çliruara dhe të okupuara. Për të parën herë në historinë e tij pas një lufte kaq të përgjakshme, populli dërgoi një numër të madh delegatësh për të konsakruar me ligj veprat e tija të pavdekshme, për të vendosur ligjërisht pushtetin demokratik popullor, për të marrë vendime të rëndësishme për forcimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe për të caktuar vijën politike të jashtme. Kongresi i Përmetit i dha Shqipërisë Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, organin suprem legjislativ dhe ekzekutiv njëkohësisht, në një formë krejtësisht të re të demokracisë sonë popullore, ku të dy pushtetet, ai legjislativ dhe ai ekzekutiv janë të bashkuar, dalin prej popullit dhe i përkasin popullit. Këto baza të një forme qeverimi të ri, shumë të përparuar, ishin baza ku do të mbështetej regjimi i ri i popullit.

regjimi i demokracisë sonë popullore dhe që do të konsakroheshin më vonë nga Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë. Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar zgjodhi në Kongresin e Përmetit edhe Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar, organin ekzekutiv kryesor të tij, me atributet e një qeverie provizore. Kongresi i Përmetit caktoi detyrat politike në rrethanat e reja historike për të forcuar edhe më shumë luftën dhe për të zgjeruar sukseset e lëvizjes nacional-çlirimtare. Kongresi i Përmetit që përfaqësonte vullnetin sovran të popullit tonë krijoi kështu organet legjislative dhe ekzekutive të shtetit tonë të ri që po ngrihej me luftë dhe me gjak mbi gërmadhat e një shteti të vjetër feudal e borgjez. Me luftë populli ynë e përmbysi regjimin e vjetër dhe në luftë ai vendosi regjimin e ri të popullit. Këshillat nacional-çlirimtare u bënë format e qeverisjes në gjithë vendin. Në Deklaratën e Kongresit të Përmetit, në pikën e parë të vendimit të tij historik thuhet:

«Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike popullore sipas vullnetit të popullit, që sot e shpreh solemnisht në Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili është me të vërtetë një pushtet popullor, i dalë nga Lufta nacional-çlirimtare që po bën populli shqiptar»¹.

Kongresi i Përmetit u dha grushtin e vdekjes qeverive kuislinge të brendshme e tentativave të reaksionit anglo-amerikan, që kërkonin të krijonin qeverira

¹ Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nac.-çl. (1942—1944). Tiranë, 1962, f. 157.

reaksionare brenda dhe jashtë vendit tonë për t'i rrëmbyer popullit nga duart fitoret. Të gjitha këto orvatje Kongresi i Përmetit i fshiu. Kongresi ndaloi hyrjen e Zogut në Shqipëri. Në Deklaratën e Kongresit të Përmetit, në pikën e dytë dhe të tretë të vendimit thuhet:

«I ndalohet Zogut hyrja në Shqipëri, meqenëse çështja e regjimit do të vendoset nga populli, me vullnetin e tij të lirë, të popullit shqiptar, të cilin e përfaqëson vetëm Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar.

«Të mos njihet asnjë qeveri tjetër që mund të formohet brenda ose jashtë Shqipërisë kundër vullnetit të lirë të popullit shqiptar, të cilin e përfaqëson vetëm Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar»¹.

Kongresi i Përmetit, duke aprovuar vijën e drejtë politike që kishte ndjekur Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar në luftën e ashpër kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, vendosi që kjo luftë të zhvillohej ditë-ditës më e ashpër kundër okupatorëve, kuislingëve, «Ballit Kombëtar», «Legalitetit», etj. dhe të forcohej aleanca e popullit tonë me Bashkimin Sovjetik dhe me aleatët e tjerë. Gjithashtu aprovoi udhëheqjen e drejtë të Shtabit të Përgjithshëm në Luftën nacional-çlirimtare dhe udhëzimet e dhëna prej tij për formimin e reparteve të mëdha të ushtrisë si dhe dhënjen e gradave në ushtri. Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar në Kongresin e Përmetit në mes të vendimeve kryesore mori

¹ Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nac.-çl. (1942—1944). Tiranë, 1962, f. 157.

edhe vendimin me rëndësi të zhdukjes së gjithë koncesioneve të huaja. Marrëveshjet, lidhjet ekonomike dhe politike që kishte bërë qeveria e Zogut në dëm të popullit shqiptar, këto mbaruan së qeni. Gjithashtu u muar vendim të mos pranohej asnjë marrëveshje, asnjë lidhje ndërkombëtare që mund të lidhin jashtë ose brenda Shqipërisë klikat reaksionare, qoftë si grup politik, qoftë si qeveri. Në Kongresin e Përmetit, shoku Enver Hoxha u ngarkua të formonte Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe u emërua njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Partizane Vullnetare. Në ato momente të rëndësishme historike për popullin, zemrat e të gjithë delegatëve të Kongresit gufonin për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, për udhëheqësin e madh të tyre dhe të Ushtrisë heroike të Kuqe, Gjeneralisimin Stalin. Në telegramin që Kongresi i Përmetit i drejtonte shokut Stalin, në mes të tjerave shkruhet:

«Për popullin shqiptar Bashkimi Sovjetik, fortësa e pathyer e socializmit, atdheu i madh i popujve të vëllazëruar, është sot avangarda e luftës së madhe antifashiste, është shembulli më i lartë sakrificash e heroizmi, është shtylla më e fortë materiale dhe morale për të gjithë popujt e robëruar.

Për popullin shqiptar Ushtria e Kuqe është ajo që... mban mbi shpatullat e saj peshën më të rëndë të luftës dhe është garancia më e madhe për shkatërrimin e plotë të fashizmit.

Afrimi i Ushtrisë së Kuqe ka forcuar luftën tonë dhe populli ynë i shpreh mirënjohjen Bashkimit Sovjetik dhe

Ushtrisë së tij të Kuqe, e cila nën udhëheqjen Tuaj ka shkatërruar bandat kriminale të Hitlerit dhe me këtë gjë ka shpejtuar çlirimin e popujve të shtypur»¹.

Gjithë Kongresi i Përmetit u ngrit më këmbë duke shprehur vullnetin dhe dashurinë e sinqertë për Bashkimin Sovjetik, për shokun Stalin dhe brohorisnin për ta, pse ata, me luftën e tyre, ndihmonin popullin shqiptar dhe ushtrinë e tij të shkonin nga fitorja në fitore për çlirimin përfundimtar të vendit të tyre.

Jehona e Kongresit të Përmetit dhe e vendimeve të tija historike patën reperkusione të jashtzakonshme brenda dhe jashtë vendit tonë. Entuziazmi i popullit tonë ishte i papërshekrueshëm, ai tani kishte organet e tija legjislative dhe ekzekutive, kishte qeverinë e tij demokratike popullore të përkohshme, kishte Ushtrinë e tij të pathyeshme Nacional-Çlirimtare, të inkuadruar në divizione të rregullta, të cilat u formuan gjatë dhe pas Kongresit të Përmetit. Me dhjetëra brigada sulmuese shtuan radhët e ushtrisë sonë dhe në beteja u çelnikosën. Fill pas mbarimit të Kongresit të Përmetit, forcat tona, kurdoherë në luftë me armikun, përballuan ofensivën tjetër të gjermanëve, atë të muajit qershor. Ndërsa armiku përpiqej t'i mbyllte forcat tona në Shqipërinë e Jugut, t'i rrethonte dhe t'i asgjësonte, Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë i dha urdhër Divizionit I që të çante rrethimin e forcave të armikut dhe të hidhej në ofensivë për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe të Ve-

¹ Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nac.-çl. (1942—1944). Tiranë, 1962, f. 162.

riut. Ky vendim i Komandantit të Përgjithshëm për një manevër të gjerë të Divizionit I, duke u futur thellë në dispozitivin e armikut dhe duke e goditur atë në bazat e tija më të forta, në rezervat e tija kryesore, pati një rëndësi të madhe historike. Divizioni I e kreu me sukses detyrën që i ngarkoi Komiteti Qendror dhe Partia. U zhvilluan luftime të përgjakshme me forca të mëdha gjermane, me forcat e «Ballit Kombëtar» dhe të Bazit të Canës, të Muharrem Bajraktarit dhe të kuislingëve të tjerë. Sado që u rrethua tri herë nga forcat armike në qarkun e Dibrës, Divizioni I shpërtheu rrethimin, shpartalloi krejt forcat e armikut dhe do të çlironte më vonë gjithë Shqipërinë e Mesme dhe një pjesë të Shqipërisë së Veriut. Nga ofensiva e verës ushtria jonë doli më e fortë, pse në zjarrin e luftës u formua Divizioni I, Divizioni II, Brigada VIII, Brigada XII, Brigada XI, Brigada XVIII, Brigada XVII, Brigada XXIII e të tjera. Gjatë kësaj ofensive misionet ushtarake angleze, të dërguara nga qeveria angleze në Shqipëri, gjoja për të ndihmuar Luftën nacional-çlirimtare, përpara sulmit triumfues të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, përpara vendimeve historike të Kongresit të Përmetit, vepruan me të gjitha mjetet e tyre, për të dëmtuar dhe për të shuar luftën tonë. Misionet angleze në Shqipëri (nga këto kishte edhe në radhët e kuislingëve dhe në qendrën e Abaz Kupit) prisnin shumë nga ofensiva gjermane e qershorit dhe shpresonin se forcat tona, të mbyllura në një darë në Jug të Shqipërisë, do të shuheshin, prandaj ata po organizonin dhe armatosnin Bazin e Canës dhe gjithë reaktionin për t'i sjellë në fuqi, pas thyerjes së Gjermanisë. Mirëpo sulmi i Divizionit tonë të parë në Veri ua prishi

planet. Forcat e Bazit të Canës u shpartalluan brenda dy orëve, Muharrem Bajraktari dhe banditë të tjerë si Fiqri Dinja me shokë, s'gjenin vend ku të fshiheshin. Dokumentat gjermane të luftës, të kapura prej nesh, dëshmonin alarmin e tyre, pse rrezikohej rruga e tërheqjes dhe njëkohësisht shfaqnin zemërimin kundër kuislingëve të tmerruar nga lufta e ushtrisë sonë. Përpara një situatë të tillë, që rrezikonte planin e anglezëve, Shtabi i Mesdheut shumë herë rresht i dërgoi ultimatum Shtabit tonë të Përgjithshëm që të ndalonte luftën në Shqipërinë e Veriut dhe kundër Abaz Kupit, duke kërcënuar se nuk do të furnizonte më me armë. Shtabi ynë i Përgjithshëm i hodhi poshtë gjithë ultimatumet e Shtabit Aleat të Mesdheut dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare nuk e ndaloi për asnjë moment sulmin e saj të furishëm. Anglezët, duke parë se po dështonin manevrat e tyre, u përpoqën që të sillnin në Shqipëri forca parashutistësh, gjoja për të luftuar gjermanët, tok me Ushtrinë Nacional-Çlirimtare; kjo u refuzua kategorikisht nga Shtabi ynë i Përgjithshëm, sepse kjo s'ishte përveçse forma e parë e invadimit anglez. Por misionet angleze nuk i kishin hedhur armët. Ata kërkuan nga Shtabi ynë që forcat angleze, si aleate, të zbarkonin në bregdetin e Himarës dhe tok me forcat tona të çlironin Sarandën. Shtabi ynë i Përgjithshëm e pranoi këtë gjë me kondita shumë rigorozë, që, pasi të kryhej ky veprim, trupat angleze të largoheshin menjëherë nga Saranda, përndryshe do të ngjishnin konflikte. Qëllimi i anglezëve s'ishte aspak të luftonin gjermanët dhe asgjësimi i forcave angleze, që zbarkuan në bregdetin tonë, do të ishte i plotë, po të mos kishin sulmuar partizanët tanë mbi gjermanët. Saranda

u çlirua nga forcat tona dhe qëllimi i komandës angleze ka qenë që, në pamundësi të qëndronin në portin e Sarandës, këto forca angleze të hynin në thellësinë e Shqipërisë. Kjo gjë ju kërkua nga Komanda e Mesdheut, Shtabit tonë të Përgjithshëm, i cili refuzoi kategorikisht dhe kërkoi që trupat angleze të tërhiqeshin përnjëherë nga Saranda. Komanda angleze tërhoqi trupat e saj në Korfuz.

Këto suksese të mëdha u përcaktuan në radhë të parë nga udhëheqja e drejtë e Partisë sonë, nga heroizmi dhe patriotizmi i shquar i popullit dhe i partizanëve tanë, si dhe nga heroizmi i Ushtrisë së lavdishme Sovjetike që po i jepte grushtet e fundit ushtrisë hitleriane, dhe nga lufta heroike e popujve të tjerë të robëruar.

Një datë tjetër historike e popullit dhe e luftës sonë është Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nac.-Çl. të Shqipërisë që u mbajt në Berat më 20 tetor 1944. Në këtë mbledhje u muarën vendime të rëndësishme për vendin tonë, në parashikim të çlirimit të plotë të Shqipërisë dhe të vendosjes së pushtetit të popullit në një Shqipëri krejt të lirë dhe të pavarur. Që prej Kongresit të Përmetit dhe deri në Mbledhjen e Beratit lufta kishte marrë proporcione të mëdha. Pushteti i këshillave nacional-çlirimtare ishte zgjeruar dhe forcuar dhe populli shprehte në to sovranitetin e tij, populli shihte në to shprehjen e vullnetit të vetëqeverimit. Këshillat nacional-çlirimtare gjatë gjithë luftës kishin korrur suksese të mëdha, ato ishin bërë dora e djathtë e ushtrisë, kishin forcuar dhe zgjeruar arësimin; me qindra shkolla u çelën dhe me mijëra kalamaj mësonin në to, në kohën kur prindërit e tyre dhe vëllezërit e motrat luftonin kundër okupatorit.

Në gjithë Shqipërinë, në male e fusha luftohej kundër okupatorit për t'u çliruar, por, njëkohësisht, luftohej gjithashtu kundër errësirës mesjetare, kundër paditurisë, kundër analfabetizmit. Populli hoqi nga goja e tij kafshatën dhe ja dha ushtrisë. Ushtria e populli luftonin së bashku kundër armikut, për të rindërtuar jetën më të mirë. Prandaj, populli e shikonte dhe e ruante ushtrinë dhe pushtetin si sytë e ballit. Deri në Mbledhjen e Beratit, këshillat nacional-çlirimtare kanë kryer njëkohësisht rolin e pushtetit dhe rolin e organeve politike. Një nga vendimet kryesore të Mbledhjes së Beratit ishte ndarja e këtyre dy funksioneve. Këshillat nacional-çlirimtare mbetën vetëm organe të pushtetit, format e qeverimit në vendin tonë, kurse puna politike, me masat e gjera të popullit, do të kryhej me anën e organizatës së madhe politike, Frontit Nacional-Çlirimtar. Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë, duke marrë parasysh rrethanat e reja të krijuara pas Kongresit të Përmetit, si në çështjen e brendshme, ashtu dhe në atë ndërkombëtare, vendosi kthimin e Komitetit Antifashist në Qeveri Demokratike. Një vendim i tillë i rëndësishëm, kur tri të katërtat e Shqipërisë ishin të çliruara nga Ushtria Nacional-Çlirimtare dhe kur Gjermania hitleriane po hante grushtet e vdekjes dhe tradhëtarët e vendit, të shpartalluar, s'gjenin vend ku të fshiheshin, ishte i bazuar plotësisht në vullnetin e popullit, në të drejtën dhe në nevojat politike. Ky vendim me rëndësi u muar në Mbledhjen e Beratit, ku Qeveria e parë Demokratike e Shqipërisë bëri betimin përpara përfaqësuesve të popullit se, do t'i qëndronte besnike deri në fund platformës politike dhe ushtarake

të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe do të mbronte me vendosmëri vendimet e Kongresit të Përmetit.

Ndërkaq, përfaqësuesit e popullit shqiptar nga Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Beratit i shkruan shokut Stalin:

«Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë, i mbledhur në këto momente vendimtare për fitoren e popujve mbi fashizmin dhe për çlirimin e plotë të vendit tonë, përshëndet në Ju udhëheqësin e shquar të popujve sovjetikë, strategun gjenial të Ushtrisë së Kuqe heroike, mikun dhe mbrojtësin e madh të popujve të shtypur, përshëndet në Ju, luftën heroike të popujve sovjetikë, të cilët me vetëmohimin e pashoq, ndër betejat legjendare, u dhanë grushtet e vdekjes hordhive të Hitlerit dhe satelitëve të tij dhe shpëtuan kështu botën nga rreziku më i madh që e kërcënonte.

Luftëtarët e ushtrisë Suaj famëmadhe, betejat glorioze dhe fitimplote të Stalingradit, Moskës e Leningradit, prej ku filloi shkatërrimi i armikut, forcuan ndër popujt e robëruar besimin në fitoren dhe u dhanë një hov të madh luftërave të tyre për liri.

Nën udhëheqjen Tuaj gjeniale, Ushtria e Kuqe kaloi nga fitorja në fitore dhe, pasi çliroi tokat e veta, ajo ngadhënjimtare po marshon në zemrën e armikut të urryer, i cili i plagosur për vdekje po jep shpirt.

Te Ushtria e Kuqe ne shohim forcën kryesore që shkatërroi armikun e betuar të njerëzimit, dhe prandaj, ajo është për ne simboli i madh i luftës për liri, i luftës antifashiste, është garanci shumë e madhe për të drejtat tona. Për këtë, ne i jemi mirënjohës Bashkimit

Sovjetik dhe populli ynë nuk ka për ta harruar kurrë ndihmën e madhe dhe se lufta heroike e Ushtrisë së Kuqe na shpëtoi nga katastrofa»¹.

Populli ynë dhe Ushtria e tij Nacional-Çlirimtare me luftën e tij të pareshtur i ka shkaktuar armikut dëme të mëdha dhe ka gozhduar divizione të tëra gjermane në vendin tonë. Ajo do ta vazhdojë këtë luftë çlirimtare me ashpërsinë më të madhe, duke lidhur kështu ngushtë vendin tonë me aleatët e mëdhenj dhe me gjithë blokun antifashist.

Ndërsa në Berat zhvillohej mbledhja, forcat tona ndodheshin në ofensivën vendimtare për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Ushtria jonë tani kishte divizione dhe korparmata dhe numëronte një efektiv rreth 70 000 vetësh. Asnjëherë vendi ynë nuk kishte pasur një ushtri kaq të fortë. Ndërsa Brigada I, IV, XXIII, XVII, VIII dhe XXI ishin hedhur në sulmin vendimtar mbi Tiranën, të gjitha forcat e tjera ndodheshin në ofensivë të pandërprerë për çlirimin e qyteteve të Shqipërisë. Divizioni II ishte duke luftuar për çlirimin e Shqipërisë së Veriut. Lufta për çlirimin e Tiranës ka qenë kurorëzimi i veprimeve luftarake të ushtrisë sonë, pasi aty luftimet muarën karakterin më të ashpër dhe këto luftime përfunduan në rrethimin e në asgjësimin e forcave armike, të cilat, kundrejt forcave tona, ishin superiore në numër e në mjete. Më 17 Nëntor u çlirua Tirana, kryeqyteti i

¹ Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nac.-çl. (1942—1944). Tiranë, 1962, f. 298-299.

Shqipërisë së re dhe më 29 Nëntor u çlirua Shkodra, e gjithë Shqipëria.

Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë sonë i dha urdhër Divizionit V dhe VI të ndiqnin këmba-këmbës armikun edhe jashtë tokave tona, në tokat e Jugosllavisë. Divizionet tona e përmbushën me nder dhe lavdi detyrën. Sado që hasën vështirësira dhe pengesa në punën e tyre nga ana e Komandës jugosllave, divizionet tona s'ju ndanë asnjë minutë armikut, ato çliruan Kosovën, ndihmuan fuqimisht çlirimin e Malit të Zi e të Bosnjës dhe e përzunë armikun deri në Vishegrad. Qindra dhe qindra dëshmorë ranë në tokën jugosllave për çlirimin e popujve të Jugosllavisë gjatë luftimeve të divizioneve tona në Jugosllavi. Gjaku i dëshmorëve tanë që ra në tokat e Jugosllavisë çimento i miqësinë e ngushtë dhe vëllazërimin në mes të dy popujve tanë. Trockistët dhe tradhëtarët e Beogradit heshtnin për luftën e divizioneve tona në tokën e tyre, por as trockizmi, as fashizmi nuk do ta fshijnë gjakun e dëshmorëve tanë, s'do të ketë forcë që ta bëjë ujë gjakun e heronjve tanë. Popujt vëllazër të Jugosllavisë s'do t'i harrojnë kurrë bijtë e popullit të vogël shqiptar që luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Në Luftën e madhe nacional-çlirimtare populli ynë i vogël pësoi humbjet dhe dëmet më të mëdha që ka parë në historinë e tij. Populli ynë i vogël i dha luftës 28 000 dëshmorë ushtarakë dhe civilë, 4 000 invalidë qind për qind dhe 8 600 të tjerë 50 për qind. Lufta na dogji 62 475 shtëpi; u dëmtuan me qindra mijë kafshë të trasha dhe të imta, u shkatërrua bujqësia; u hodhën në erë të gjitha urat, të mëdha e të vogla; centrale elektri-

ke e miniera u dogjën dhe u hodhën në erë portet e Vlorës, të Durrësit, të Sarandës, të Shëngjinit dhe të Semanit etj. Por nga ana tjetër Ushtria Nacional-Çlirimtare i shkaktoi dëme të mëdha armikut italian e gjerman.

U vranë nga Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare 26 594 italianë e gjermanë, u plagosën 21 245 dhe u zunë rob 20 800 vetë. U zunë dhe u shkatërruan tanksa, autobli-nda, automobila në një numër më tepër se 2 100 copë, u rrëzuan 5 aeroplana, u zunë topa, mortaja, mitraloza që kalojnë numrin 4 000. Janë hedhur në erë depo me municion e të tjera materiale që kalojnë numrin 216. Përveç këtyre janë shkatërruar, djegur e hedhur në erë sasira të mëdha municioni, vija telefonike, kantiere dhe stabilimente të tjera që përdroreshin nga armiku. Kështu u mbyll etapa e Luftës nacional-çlirimtare e popullit tonë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Kjo fitore u arrit në saje të sakrificave e të shpirtit luftarak e patriotik të popullit tonë, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë dhe në saje të sakrificave e të heroizmit të popujve sovjetikë e të luftës së tyre të lavdishme.

Më 29 Nëntor 1944 flamuri i lirisë, flamuri i punëtorëve, i fshatarëve dhe i gjithë patriotëve të vendit tonë, i mbajtur lart nga dora e çelniktë e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila nëpërmjet kaq luftërash të përgjakshme e çoi popullin e saj në fitoren e tij të madhe dhe të plotë, valoi për herë të parë në gjithë Shqipërinë e çliruar përgjithmonë nga okupatorët, nga zgjedha e bejlerëve dhe e borgjezisë.

Për të parën herë u vendos në vendin tonë regjimi i popullit, demokracia popullore. U realizua ëndrra she-

kullore e popullit tonë të shumëvujtur për të cilën kishte luftuar shokuj me radhë.

Lavdi popullit tonë heroik, të papërkulur dhe ngadhjimitar!

Lavdi dëshmorëve heroikë të popullit tonë, që derdhën gjakun pa kursyer për popullin tonë, për demokracinë popullore, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë!

Lavdi popujve të Bashkimit Sovjetik, Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe shokut të shtrenjtë dhe të zemrës së popullit tonë Josif Visarionoviç Stalinit, me ndihmën e të cilëve ne fituam lirinë, pavarësinë, demokracinë popullore!

Lavdi Partisë sonë heroike, që e udhëhoqi popullin në rrugën e sigurtë të fitores së tij të plotë dhe të shkëlqyer mbi okupatorët dhe tradhëtarët dhe që asnjëherë nuk u mposht e nuk do të mposhtet kurrë, por do ta çojë vendin tonë me vendosmërinë më të madhe dhe me sigurinë më të madhe në rrugën e ndërtimit të socializmit, do t'i sigurojë popullit jetën e lumtur!

Lavdi ushtrisë sonë heroike, Ushtrisë Popullore, që doli nga gjiri i vuajtur i popullit dhe nëpërmjet betejash të përgjakshme, doli fitimtare dhe i siguroi për jetë popullit lirinë, pavarësinë dhe mirëqenjen!

NDËRTIMI I SHQIPËRISË SË RE¹

Çlirimi i plotë i Shqipërisë ishte rezultati i luftës heroike të popullit shqiptar, i cili nuk kurseu asgjë për të fituar lirinë dhe pavarësinë, por përkundrazi i vuri të gjitha forcat e tija në aleancën e luftës çlirimtare. Njëkohësisht çlirimi i Shqipërisë ishte rezultati i heroizmit të pashoq të Partisë sonë Komuniste dhe të politikës së saj të drejtë dhe tejshikuese, e cila u vu në krye të popullit për të udhëhequr dhe për të luajtur rolin historik të drejtuesit vendimtar të fateve të popullit tonë. Pa udhëheqjen e Partisë sonë, populli nuk mund të kishte korrur fitoret e mëdha, që i dhanë lirinë dhe vendosën në vendin tonë demokracinë e vërtetë.

Çlirimi i Shqipërisë dhe i popullit tonë i dedikohet gjithashtu luftës heroike të popujve të Bashkimit So-

¹ Disa nga statistikat që janë përdorur në këtë pjesë të raportit nuk janë të sakta, për arsye se në atë kohë shërbimi statistikor në Shqipëri ende nuk ishte i përsosur dhe nuk kishte siguruar të dhëna të plota mb: baza shkencore.

vjetik, të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, të udhëhequra nga Partia plot lavdi Bolshevike e Lenin-Stalinit dhe nga udhëheqësi gjenial, Stalini i madh. Besimi i patundur në ta, bënë që ne të ndjekim rrugën e drejtë dhe të mos gabojmë kurrë. As që mund të mendohet se ne dhe shumë popuj të tjerë, shumë më të mëdhenj dhe të fuqishëm në Evropë, të fitonin lirinë e tyre, pa luftën heroike të Bashkimit Sovjetik, që ishte faktori kryesor i fitores.

Çdo fitore e jona në lëmin ushtarak dhe politik, ishte e lidhur ngushtë me fitoret ushtarake dhe politike të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë, duke luftuar për vijën e drejtë të bazuar në marksizëm-leninizmin, duke i shikuar çështjet nën prizmin e politikës së drejtë të Bashkimit Sovjetik, duke e lidhur luftën e saj ngushtë me luftën heroike të Bashkimit Sovjetik, korri gjithë këto fitore për popullin tonë. Gjithashtu populli ynë e lidhi ngushtë luftën e tij me luftën e gjithë popujve të robëruar, që luftonin kundër fashizmit dhe në radhë të parë me luftën heroike të popujve fqinjë, jugosllavë dhe grekë.

Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, me çlirimin e vendit, i viheshin përpara detyra të rënda që ajo duhej t'i përmbushte me një mobilizim total të popullit tonë, me organizimin e pushtetit popullor dhe të aparateve qendrore e lokale dhe me një spastrim rrënjësor të mbeturinave të fashizmit dhe të reaksionit në vendin tonë, që pa asnjë dyshim do të tentonin të ngrinin krye dhe të sabotonin veprën e madhe të rindërtimit të vendit tonë, të shkatërruar jashtëzakonisht shumë nga lufta.

Asaj, në radhë të parë i duhej të zhdukte mbeturi-

nat e fashizmit dhe të çarmatoste krejt bejlerët dhe borgjezinë e vendit, të mahur nga fashizmi dhe nga gjaku që i kishin pirë popullit, duke spekuluar mbi jetën e tij dhe duke e shitur popullin tonë në çdo moment te i huaji. Lufta nacional-çlirimtare e mudi klasën e privilegjuar në vendin tonë, duke zhdukur mbështetjen e saj të armatosur, fashizmin italian e gjerman. Reaksioni i vendit tonë kishte mbaruar ushtarakisht dhe kishte humbur çdo shpresë për ta goditur popullin nga brenda, përveçse me ndihmën dhe mbështetjen e reaksionit anglo-amerikan. Që në muajt e parë të çlirimit u ngritën, pra, gjyqet e popullit, që gjykuan me ashpërsinë dhe me drejtësinë më të madhe kriminelët e luftës.

Nga ana tjetër duhej çarmatosur reaksioni dhe borgjezia e vendit nga ana ekonomike dhe për këtë pushteti ynë ka qenë i pamëshirshëm. U konfiskuan menjëherë dhe u shtetëzuan të gjitha pasuritë e tradhtarëve dhe të kuislingëve¹; u konfiskuan pasuritë e panumërta të tregëtarëve spekulatorë dhe u detyruan këta të paguajnë taksat e luftës²; u konfiskuan të gjitha ndërmarrjet dhe fabrikat e tregëtarëve spekulatorë, të cilët i kishin vënë gjithë këto pasuri duke shfrytëzuar gjakun dhe djersën e popullit. U hodhën jashtë nga tokat bejlerët dhe agallarët, që shekuj me radhë pinin gjakun e katundarit dhe u pregatit kështu ndarja e tokës

¹ Konfiskimi dhe shtetëzimi i të gjitha pasurive të tradhtarëve dhe kuislingëve u bë me ligjin: «Mbi konfiskimin e pasurive të tundshme e të patundshme të të arratisurve politikë», të datës 15 dhjetor 1944.

² Është fjala për ligjin «Mbi tatimin e jashtëzakonshëm për fitimet e luftës», të datës 13 janar 1945.

ndër katundarët, d.m.th. nisi aplikimi i vërtetë i reformës agrare. Gjithashtu Partia dhe pushteti popullor shtetëzuan të gjitha minierat dhe ndërmarrjet, që ishin koncesione ose në duart e të huajve. Në këtë mënyrë u formua sektori ekonomik i shtetit, mbi të cilin do të mbështetej pushteti ynë, për të rindërtuar vendin shumë të shkatërruar. Pushteti popullor e gjeti vendin në një gjendje të vajtueshme. Krahina të tëra ishin djegur dhe popullsia ishte jashtë, pa strehë, ushqimet mungonin, urat ishin hedhur në erë, ishin shkatërruar rrugët, mjetet e komunikacionit pothuajse nuk ekzistonin fare dhe çdo transportim furnizimesh ishte shumë i vështirë. Pushteti ndërmori me shpejtësi ndreqjen e urave dhe në një kohë rekord u ndreqën 2 031 metra linear ura duke u bërë kështu i mundshëm trafiku. Ndreqja e urave vazhdoi në vitin 1946, 1947 dhe deri më 1948 dhe brenda këtyre viteve u ndërtuan edhe 1 094 metra linear të tjera. Nga ana tjetër u rimëkëmbën dhe u vunë në funksionim gjithë centralet elektrike, që ishin të shkatërruara dhe të dëmtuara nga lufta; filloi ndërtimi i shtëpive të djegura, rimëkëmbja e të gjitha fabrikave dhe e punishteve të vjetra që ekzistonin, por që ishin shkatërruar dhe dëmtuar rëndë nga lufta. Gjatë katër vjetëve Partia dhe pushteti ndërmuarën një sërë ndërtimesh të rëndësishme si ndreqje portesh, kanale vaditëse e bonifikimi, ndërtesa industriale, ndërtesa me karakter të përgjithshëm, ndërtimin e hekurudhave Durrës—Peqin dhe Durrës—Tiranë.

Pasqyra e ndërtimeve që prej çlirimit dhe deri në fund të shtatorit 1948 mund të përmbliidhet në tabelën e mëposhtme: [e vlerësuar në lekë]

Ndërtimet	1945	1946	1947	1948
Ura	85124000	13734000	29232000	7182000
Rrugë	8000000	74400000	8000000	32800000
Porte	15000000	5000000	5000000	16200000
Kanale vaditëse	—	31080000	39540000	28980000
Bonifikime	—	93740000	63898000	82775000
Ndërtesa industriale	—	20326500	48033000	174375000
Ndërtesa me karakter të përgjithshëm	—	112954070	180180130	153817000
Ndërtime hekurudhash	—	—	367220000	239120000
Ndërtime me karakter të përgjithshëm	50960000	58182400	178440000	83127000
Selita 1	—	—	27414780	39900000

Siç shihet, një përpjekje e jashtzakonshme është bërë nga populli ynë, i cili u mobilizua i gjithë për rindërtimin e vendit dhe punoi me një heroizëm të paparë kurrë në historinë e vendit tonë, për të rindërtuar jetën e tij më të mirë, për të ndërtuar socializmin në vendin e tij. Sakrificat të panumërta dhe heroizmat të patreguara janë bërë nga klasa jonë punëtore, në radhë të parë, për të arritur me sukses zbatimin e direktivave të Partisë dhe të shtetit. Morali i punëtorëve tanë, i rinisë sonë heroike, i katundarëve që me shumicë të madhe vinin e punonin në ndërmarrje të ndryshme, në ndërtime e në bonifikime, i grave të Shqipërisë, që u mobilizuan në shkallë shumë të gjerë, ishte i lartë. Gjithë masat e popullit tonë, nën udhëheqjen e klasës punëtore, të Partisë dhe të qeverisë së tyre popullore, me

1 Hidrocentrali «V. I. Lenin» në Selltë.

mundime dhe me djersë, por kurrë të lodhur, e ndër-ruan faqen e Shqipërisë së shkatërruar brenda një kohe jashtzakonisht të shkurtër. Puna vullnetare nga ana e masave të gjera të popullit, me punëtorët tanë në krye, bëri që të lehtësohet jashtzakonisht barra e pushtetit dhe të mund të realizohen gjithë këto ndërtime në një kohë, kur dilnim nga një luftë kaq e madhe, që na kishte shkakuar kaq viktima dhe kaq shkatërrime në ekonominë tonë. Por populli ynë, që luftoi me heroizëm për çlirimin e vendit dhe për pushtetin e tij demokratik popullor, kishte kuptuar më së miri, se gjithë shpresat për të shkuar përpara, duhej t'i vinte në radhë të parë në forcat e pashteruara dhe të fuqishme të tija dhe se kësaj radhe, vërtet duhej të bënte sakrificat të mëdha, por ishte i sigurtë se ai punonte për veten e tij dhe jo për të tjerët, punonte dhe ndihmonte Partinë dhe pushtetin e tij, të cilët do ta çonin me sigurinë më të madhe në rrugën e mirëqenjes, në rrugën e socializmit. Orientimi që u dha Partia dhe pushteti ndërtimeve në vendin tonë, ishte nga më të drejtët. Ai u përgjigjej në radhë të parë nevojave urgjente të momentit dhe perspektivës së sigurtë drejt rrugës së socializmit, ku e çon vendin tonë Partia jonë Komuniste. Një orientim i tillë i drejtë bëri që përmirësimi i jetës së popullit tonë të jetë i dukshëm dhe i kënaqshëm, që në vitet e para të çlirimit, të zgjidhen probleme të furnizimit me sende ushqimore që në ditët e para të pasluftës, të mos ketë uri buke dhe të merreshin masa të menjëhershme për riorganizimin e mjeteve të komunikacionit që ishin krejt të shkatërruara dhe që ishin një problem nga më të koklaviturit e më të rëndësishmit në vendin tonë.

Orientimi ynë, në të ardhshmen, në lëmin e ndërtimeve do të jetë në ngritjen e fabrikave të reja dhe të banesave të përshtatshme për punëtorinë tonë si dhe për nevojat shtetërore dhe të popullsisë. Do të zgjerohet rrjeti hekurudhor dhe rrugor, duke përmirësuar gjendjen e tyre. Investime të reja do të bëhen në industri si dhe në bujqësi, për të shtuar rendimentin e minierave tona dhe të tokës sonë.

INDUSTRIA DHE MINIERAT

Vendi ynë ka kondita natyrore për zhvillimin e industrisë së lehtë. Te ne ekziston ulliri dhe janë gjithë mundësitë për mbjelljen e duhanit, të pambukut, të panxharit, etj. Pas shtetëzimit të fabrikave të vogla dhe të punishteve, pushteti popullor munda t'i mëkëmbë këto duke i grumbulluar, duke i vendosur në vende të përshtatshme dhe duke i rregulluar në kritere të shëndosha teknike e lokale, rregulloi organizimin serioz teknik dhe kontabël të tyre, duke racionalizuar teknikët e paktë që ekzistonin.

Kapitali i huaj italian e ka penguar zhvillimin e industrisë sonë të vogël. Edhe ato fabrika, që ata lejuan të ngriheshin, si fabrikat e cigareve me një rendiment mjaft të madh ishin për nevojat e tyre. Siç dihet, zhvillimi industrial ka në bazë centralele elektrike. Në vendin tonë, ku ekzistojnë ujëra dhe burime të mëdha energjitike, këto ishin lënë krejt pas dore. Në kohën e regjimit të Zogut dhe të fashizmit u ngritën disa centrale termike. Kuptohet vetëvetiu se energjia që i furnizohej

industrisë ishte e paktë dhe e kushtueshme. Këtë trashëgim të paktë ne e futëm në veprim dhe fabrikat tona të tanishme, në shumicën e rasteve, janë pajisur me motorat e vet. Në vitin 1933 ishin instaluar 13 centrale elektrike me një kapacitet 3 200 kw. dhe me një prodhim vjetor rreth 3 000 000 kw. orë. Më 1939—1944 kapaciteti i tyre u rrit në 4 700 kw. me një prodhim vjetor prej 6 500 000 kw. orë dhe sot është rreth 7 400 kw. me një prodhim vjetor prej 9 200 000 kw. orë. Më 1945 prodhimi total vjetor ishte shumë më poshtë nga ai i vitit 1939. Por kjo shtohet me përpjekjet serioze për vënjen në eficiencë të industrisë gjatë vitit 1946—1947, kur e tërë industria kaloi në duart e shtetit. Gjatë vitit 1947 industria jonë kaloi nga organizimi i parë provizor, në organizimin e ndërmarrjeve industriale në baza hozrashoti; u krijuan 46 ndërmarrje me karakter të përgjithshëm shtetëror si dhe 13 ndërmarrje me karakter lokal. U bë racionalizimi në shkallë të gjerë i industrisë, u bë grumbullimi i uniteteve të vogla në unitete të mëdha si p.sh. i fabrikave të vajit, të tisazhit, të trikotazhit, i ofiçinave etj. Më 1947 u bënë më tepër se 45 milion lekë investime, kurse për vitin 1948 janë parashikuar më tepër se 300 milion lekë. Tok me organizimin dhe përmirësimin e industrisë sonë të lehtë, u përmirësua dhe u shtua edhe prodhimi dhe, sido që është larg që kjo të përmbushë nevojat e popullit, u shtua kapaciteti i prodhimit në vaj, makarona, sapun, lëkurë, këpucë etj. U shtua gjithashtu edhe numri i punëtorëve, të cilët në vitin 1938 nuk ishin më tepër se 3 000 vetë.

Por orientimi ynë në industri do të jetë shtimi i objekteve industriale dhe kjo gjë do të bëhet në bazën

e një ndihme të paçmueshme të aleatit tonë më besnik, Bashkimit të madh Sovjetik... Në bazë të marrëveshjes së datës 25 korrik 1947 gjatë dy vjetëve të ardhshëm do të na vijnë nga Bashkimi Sovjetik një kombinat i madh tekstili prej 21 000 boshte me një kapacitet që kapërcen 20 milion metra pëlhurë në vit, një fabrikë sheqeri me një kapacitet prej 10 000 ton sheqer në vit dhe një fabrikë lëkurësh me një kapacitet 500 ton lëkurë të punuara në vit. Me ngritjen e këtyre fabrikave do të përmbushen në përgjithësi nevojat e vendit me këta artikuj. Kombinati i tekstilit, së bashku me qytetin e punëtorëve prej 4 600 banorësh si dhe fabrika e sheqerit do të fillojnë të ngrihen që në mars të vitit 1949 dhe në mbarim të vitit 1951 këto do të hyjnë në funksionim. Në kombinatin e tekstileve dhe në fabrikën e lëkurëve do të punojnë lart nga 2 500 punëtorë. Përveç këtyre fabrikave, gjatë vjetëve 1949—1950 Partia e shteti kanë në perspektivë ngritjen e një fabrike për vajëra vegjetale, ngritjen e një impianti për imprenjimin e drurit, të një fabrike çimentoje, të një fabrike këpucësh, mbarimin e hidrocentralit të Selitës si dhe studimin për shfrytëzimin e ujërave të tjera. Nga ana tjetër do të shtohet kapaciteti i fabrikave të tullave dhe do të përfundojnë punimet e filluara në fabrikën e tekstil-indusit¹, në uzinën e pjesëve të këmbimit si dhe pajisja e racionalizimi i disa industrive ekzistuese.

Përsa u përket minierave, vendi ynë është i pasur

¹ Është fjala për një fabrikë tekstilësh të pambukta, punimet për përfundimin e së cilës u ndërpre në për arsye se filluan punimet për ndërtimin e Kombinatit të tekstileve «J. V. Stalin».

në minerale dhe deri tani llogaritet se gjenden 25-26 lloj mineralesh. Gjatë okupacionit gjithë minierat tona pjesërisht u shkatërruan nga sulmet e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe më pas u hodhën në erë nga gjermanët, por sot janë rindërtuar të gjitha në saje të punës e të sakrificave të mëdha të klasës sonë punëtore dhe të popullit tonë. Në minierat tona sot punojnë lart nga 4 000 punëtorë dhe të gjitha drejtohen nga punëtorët tanë, të edukuar nga Partia jonë Komuniste. Pasqyra e mëposhtme tregon zhvillimin e industrisë në vendin tonë për vitet 1938—1948 [e llogaritur në përqindje]:

Emërtimi	1938	1945	1946	1947	1948
Prodhimi i përgjithshëm					
Industrial	100	68,93	111,05	152,04	290,73
Nga ky:					
Industria	100	78,03	105,40	167,69	322,60
Minierat	100	52,86	121,04	125,19	234,39
Prodhimi industrial					
Spektori shtetëror		100	374,94	618,67	1180,73
Nga ky:					
Industria		100	723,48	1594,67	3067,85
Minierat		100	244,21	232,60	472,02
Prodhimi industrial					
Spektori privat	100	44,31	18,72	—	—
Nga ky:					
Industria	100	67,51	29,32	—	—
Minierat	100	3,30	—	—	—

Perspektivat e zhvillimit të minierave tona janë të mëdha. Në radhë të parë do të shtohen nafta, sera, kromi, qymyri, bakri etj. Gjatë vitit 1949—1950 parashi-

kohet ngritja e një rafinerie të re me një kapacitet rreth 500 ton naftë trajtimi brut në ditë dhe që plotëson nevojat tona në karburant dhe lubrifikant. Parashikohet shumëzimi i prodhimit të naftës në shkallë të gjerë, i bitumit, i kromit, i qymyrit, i bakrit blistër etj. Një orientim i tillë i drejtë i Partisë sonë në zhvillimin në shkallë të gjerë të industrisë sonë është baza e shëndoshë për shkuarjen tonë në socializëm. Një orientim i tillë do të forcojë klasën punëtore, që udhëheq masat e gjera të popullit në ndërtimin e jetës më të mirë. Zgjerimin dhe forcimin e industrisë sonë të lehtë dhe të rëndë ne ja detyrojmë ndihmës së madhe të Partisë Bolshevike, shokut Stalin dhe shtetit sovjetik, të cilët na ndihmojnë pa kursyer në këtë drejtim si dhe në të gjitha drejtimet, që populli ynë të forcojë dhe të modernizojë ekonominë e tij dhe të shohë ditë më të bardha. Për këtë ndihmë kaq të madhe e të sigurtë, që forcon njëkohësisht pozitën tona ekonomike e politike, që forcon sovranitetin e independencën e shtetit tonë, gjithë masat punonjëse të vendit tonë me klasën punëtore në krye dhe me pararojën e saj heroike, Partinë Komuniste të Shqipërisë, do t'i jenë mirënjohëse për jetë Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin dhe do të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre që realizimet në industri, në bujqësi e gjetkë të jenë çdo ditë e më tepër konkrete për përparimin e vendit tonë.

BUJQËSIA

Ç'U DHA REVOLUCIONI POPULLOR FSHATARËVE PUNONJËS

Revolucioni popullor i vuri pikë varfërimit dhe degradimit të fshatarësisë. Fitorja e luftës u dha zemër fshatarëve të cilët, si rezultat i luftës së mbarë popullit punonjës të udhëhequr nga Partia, panë të përmysej në sytë e tyre klasa feudale. Ata dëgjuan zërin e fortë të Partisë se bejlerët e agallarët kishin perënduar e nuk duheshin njohur më si zotër të tokës, nuk duheshin njohur më borxhet dhe kamatat e tyre.

Ndryshimet politike e ndryshimet në pushtet, që janë rezultat i revolucionit tonë popullor dhe rezultat i udhëheqjes së ndritur të Partisë sonë Komuniste, besnike e mësimeve të marksizëm-leninizmit, bënë që fshatarët punonjës të marrin frymë lirisht. Këto ndryshime bënë që ata të shohin se kishte ardhur dita e tyre, kishin lindur rishtas dhe këtë herë jo për vuajtje e mjerime, por për të jetuar një jetë, që, me djersën e tyre e nën udhëheqjen e Partisë, do të vinte gjithmonë duke u përmirësuar nga një ditë në tjetrën.

Në revolucionet borgjeze ndryshimet në ekonomi sjellin ndryshimet në pushtet, kurse në revolucionet popullore¹ ndryshimi fillon menjëherë në pushtet dhe i

¹ Është fjala për revolucionet popullore që udhëhiqen nga partia e klasës punëtore dhe zhvillohen si revolucione socialiste.

bie barra këtij të fundit, pushtetit popullor, që të bëjë ndryshimet në ekonomi, të ngrjë sistemin ekonomik në pajtim me interesat e fituesve të revolucionit, në pajtim me interesat e popullit punonjës.

Është e vërtetë që puna për këtë ndryshim, ashtu siç thamë, nisi qysh në luftë e sipër; në luftë u goditën bashkë me okupatorin edhe tradhëtarët; në luftë e sipër u bë edhe diferencimi i klasave, por puna më e madhe në këtë drejtim mbetej pas çlirimit.

Për të ndërtuar ekonominë e re popullore duheshin bërë reforma rrënjësore me karakter ekonomik, kjo ishte detyra e Partisë ndaj masave punonjëse për kondita më të mira ekonomike.

Nga këto, reforma më e rëndësishme dhe më e ngutshme ishte reforma agrare. Ajo i përmbysi një herë e mirë raportet e vjetra të pronësisë mbi tokën, çliroi fshatarësinë nga padrejtësia dhe shtypja shekullore, i bëri bujqit e varfër zot të prodhimit të tokës, që kishin punuar për llogari të bejlerëve dhe të agallarëve, kufizoi në mënyrë të dukshme shfrytëzimin e njeriut prej njeriut, dërmoi dhe likuidoi përgjithmonë ekonominë e feudaleve, që patën gënjyer dhe grabitur për shekuj shtresën e varfër fshatare.

Në politikën e Partisë sonë në fshat dhe në zbatimin e reformës agrare ne kemi pasur edhe të meta. Kështu shpjegohet që me gjithë parullën, që të mos njiheshin padronët nga bujqit, u hartua ligji mbi qiranë bujqësore, që i detyronte fshatarët-bujq, deri në zbatimin e plotë të reformës agrare, t'u jepnin pronarëve deri në 30% të prodhimit të tokës, ligj i cili nuk u prit mirë dhe ngjalli pakënaqësi në fshatarët. Kështu ndodhi

në fillim që ligji i reformës agrare nuk lejonte të merrshin masa shpronësimi rrënjësore¹.

Por këto të meta janë ndrequr shpejt dhe janë të një rëndësie të dorës së dytë, në krahasim me sukseset e arritura në punën tonë në dobi të fshatarësisë.

Ja rezultatet.

Para zbatimit të reformës agrare pronësia mbi tokën ishte në këtë mënyrë:

Kategoria e pronarëve	Familje		Toka që posedonin		Mesatarja në ha. për familje
	Nr.	%	ha.	%	
1) Latifondistë	7	0,008	14554	3,70	2079
2) Pronarë të pasur	4713	3,034	91133	23,16	19
3) Çifliqë të shtetit	—	—	50000	12,71	—
4) Pronarë të mesëm e të vegjël	128961	83,080	237668	60,43	1,8
5) Fshatarë pa tokë	21544	13,880	—	0,00	0,0
	155225	100%	393355	100%	—

Zbatimi i reformës agrare pati këto efekte:

Kategoria e pronarëve	Nr. 1 pronarëve	Shpronësuar		
		Ara ha.	Ullinj rrënjë	Kafshë pune
Pronarë të shpronësuar tërësisht ²	8714	54499	287944	
Pronarë të shpronësuar pjesërisht ³	10641	64997	125259	5923
Çifliqë të shtetit ⁴	—	50000	—	—
Ente fetare ²	—	3163	61024	—
	19355	172659	474227	5923

¹ Si «Ligji mbi qiratë bujqësore» i 14 janarit 1945, që u njihte të drejtën pronarëve të merrnin nga bujqit 20-30% të

Nga toka e shpronësuar përfituan:

Kategoria e familjeve	Familje Nr.	Toka ha.	Ullinj rrënjë	Kafshë pune Nr.
1) Familje të varfëra	48667	155159	238727	5923
2) Familje pa tokë	21544			
3) Sektori i shtetit	—	17500	235500	—
	70211	172659	474227	5923

Përveç 172 659 ha. tokë të shpronësuar, që ju nda fshatarëve të varfër dhe fshatarëve pa tokë, reforma agrare mati dhe ndau edhe 147 341 ha. që, në bazë të ligjit, u takonte pronarëve bujq që e posedonin dhe e

prodhimin për vitin 1944 — 1945, ashtu edhe «Ligji mbi reformën agrare» i 29 gushtit 1945, që u linte çifligarëve 20-40 ha. tokë. nuk i përgjigjej politikës së Partisë për zhdukjen e bazës ekonomike të feudalizmit, si rrjedhim nuk i plotësonin dëshirat e fshatarësisë së varfër, prandaj edhe nuk u pritën mirë prej saj. Këto gabime, që u ndreqën shpejt nga Partia, u ndikuan nga qëndrimet oportuniste të Sejfulla Malëshovës.

2 Në pronarët e shpronësuar tërësisht hyjnë latifondistët, tregëtarët, zanatçinjtë, nëpunësit, entet fetare dhe fshatarët e çdo kategorie që nuk ushtronin bujqësinë.

3 Në pronarët e shpronësuar pjesërisht hyjnë të gjithë ata fshatarë, që ushtronin vetë bujqësinë, por që kishin tokë më tepër se sa u takonte në bazë të ligjit të reformës agrare.

4 Çifliqet e shtetit ishin prona të gjera që edhe këto punoheshin nga fshatarët, me të tretë (1/3) ashtu siç ishin marrëdhënjet e zakonshme të sistemit feudal. Këto toka, me zbatimin e reformës agrare, ju ndanë fshatarëve që përfitonin nga ligji.

punonin vetë. Në këtë mënyrë reforma agrare mati dhe shpërndau konformë ligjit gjithsejt 320 000 ha. tokë.

Pas çlirimit, pas zbatimit të reformës agrare dhe deri më sot, gjendja e pronësisë mbi tokën ka ndryshuar dhe paraqitet kështu:

Llojet e ekonomive	Familje Nr.	Tokë në posedim ha.	Mesatarja për familje në ha.	Ullinj rrënjë	Mesatarja për familje në rrënjë
1) Ekonomi individuale	139994	369068	2,6	1480314	10,2
2) Koop. bujqësore Nr. 56	2428	10870	4.5	6100	2,5
3) Sektori i shtetit	—	17500	—	235500	—
4) Entet fetare	—	1062	—	8086	—
	142422	398500	—	1730000	—

Këto shifra flasin vetë. Më parë jo vetëm pjesa më e mirë e tokës, ajo më pjellorja ishte në dorë të feudalëve, por edhe pyjet, kullotat e ujërat ishin kryekëput në duart e tyre dhe shfrytëzoheshin për ta.

Ndarja e tokës nga reforma agrare mori fund më 17 nëntor 1946, me habitjen dhe tronditjen e armiqve. Por edhe pas kësaj kohe procesi i rregullimit të raporteve mbi pronësinë e tokës vazhdoi, gjë kjo e nevojshme, pasi në fillim u bënë mjaft gabime; gabime ka akoma sot, prandaj përpjekjet për ndreqjen e tyre duhet të jenë të vazhdueshme.

Me zbatimin e reformës agrare u arrit:

a) likuidimi i feudalizmit;

b) krijimi i konditave për kalimin nga ekonomitë e vogla individuale, që ngjallin kapitalizmin në fshat, në ekonomi kolektive, kooperativiste, socialiste;

c) u krijuan në bujqësi konditat për përmirësimin e modernizimin e saj, kondita të domosdoshme për zhvillimin e mbarë të ekonomisë sonë popullore.

Reforma agrare nuk ishte një punë tekniko-administrative e organeve tona të pushtetit dhe as një punë e lehtë. Çështja ishte për të përmbytur një klasë, që kishte sunduar me shekuj, një klasë me traditat e saja politike dhe ekonomike.

Ndarja e tokës paraqiste vështirësitë e saja, një luftë më vete. Partia u mobilizua e tëra e me të bashkë gjithë fshatarët punonjës. Sa për kulakët, ata, në fillim u munduan të ngjallnin mosbesim, duke thënë se «për t'u bërë reforma agrare duhen vjete, duhen teknikë». Ata ushqyen parullat e klerit, «toka është e zotit» etj. Po kur e panë se këto ishin të pavlefshme për t'i bërë ballë sulmit të forcës së masave punonjëse të udhëhequra nga Partia, hynë vetë në komitetet e fshatarëve të varfër¹ për të sabotuar, për të përkrahur veten dhe farefisin e tyre.

Si rrjedhim i parimit marksist, sipas të cilit ashpërsimi i luftës së klasës i bën armiqtë më të egër e më të vendosur për luftë, kulakët arritën të hedhin edhe bomba kundër fshatarëve që merrnin tokën e tyre. Gjyqet e popullit treguan se shpronësimi i tokës ishte plaga që i kishte dhëmbur më shumë borgjezisë së fshatit.

¹ Komitetet e fshatarëve të varfër, u krijuan nga Partia për zbatimin e shpejtë dhe të drejtë të reformës agrare.

Por, me gjithë të metat që paraqiste vetë ligji në fillim, të meta që ishin edhe për efekt të influencës së politikës agrare nga udhëheqja trockiste e Partisë Komuniste Jugosllave, me gjithë sabotimin e ndërgegjshëm të disa teknikëve, me gjithë rezistencën e elementit kundërshtar, me gjithë mungesën e të dhënave dhe të kuadrove për një ndërmarrje të tillë, në sajë të punës së Partisë e të përkrahjes së plotë të masës fshatare të varfër e të mesme, reforma agrare u krye dhe pas një viti u ndanë tapitë e para e në përgjithësi puna u bë mirë.

Fshatarët konstatuan në fakt, qenjen e tyre në fuqi, kujdesin dhe interesimin e madh të Partisë dhe të pushtetit. Kjo gjë e bëri fshatarin tonë të fitojë kurajë, që nuk e kishte pasur kurrë, të njohë forcat e tija, të formojë bindjen se, ashtu si fitoi luftën e udhëhequr nga Partia, me Partinë mund të korrë suksese të tjera.

Fshatarësia u bind se vetëm Partia jonë, e frymëzuar nga mësimet marksiste-leniniste, e mbështetur në fitoret e mëdha dhe në eksperiencën e çmueshme të atdheut të socializmit, të Bashkimit të madh Sovjetik, ishte e zonja të bënte një reformë të tillë në interes të masave punonjëse.

Fitorja e revolucionit popullor për fshatarësinë, ashtu si për mbarë popullin punonjës, hapi faqen e një historie të shkëlqyeshme. Ndarja e tokës, pa dyshim, ishte puna e parë, por Partia dhe shteti nuk u mjaftuan vetëm me këtë për fshatarësinë, e cila doli e dëmtuar rëndë nga zgjedha e dyfishtë dhe nga lufta. Me gjithë vullnetin e mirë të tyre, fshatarët e varfër nuk ishin në gjendje të merrnin veten pa një përkrahje. Kësaj detyre nuk i mungoi Partia dhe shteti. Kjo ndihmë ka qenë

e gjithanshme dhe, me forcimin e pushtetit, ka ardhur vit për vit duke u shtuar. Kështu p.sh. kemi:

Lloji dhe njësia	1938	1945	1946	1947	1948	% 1938 1948
Farëra kv.	13050	30000	30016	99645	69883	535
Pleh kimik kv.	—	—	5110	35957	41918	—
Fid. fryt. rrënjë	98000	—	24000	125800	209500	213
Fid. pyjore rrënjë	20000	—	60000	1200000	5335950	26679
Vegja insekt. lekë	—	—	18000000	39546673	60687588	—
Kredit agrar lekë	—	—	12434733	4118677	13017293	—
Kuadro bujq. nr. prej të cilëve:	243	—	—	—	1124	462
të lartë	86				155	
të mesëm	127				438	
të ulët	30				531	

Politika jonë në këto ndihma ka qenë dhe do të jetë që të përfitojnë në radhë të parë kooperativat dhe fshatarët e varfër.

Ndryshimi i pronësisë dhe i marrëdhënjeve mbi tokën, fillimi i përdorimit të mjeteve të përparuara, ndihma e madhe materiale nga ana e shtetit dhe konditat e reja politiko-shoqërore në vendin tonë, bënë që fshatarët të ndodhen para një gjendjeje të re. Djersa dhe mundimi i bujqve të varfër, nuk shkon në dobi të pronarëve të djeshëm të tokave; ata janë zot të frytit të punës së tyre. Ndërsa para çlirimit fshatarët punonjës ishin robër të rraskapitur, të zhveshur, të uritur e të përbuzur, me fitoren e Luftës nac.-çl. dhe pas kësaj, ata shpëtuan nga kjo gjendje dhe kanë filluar të ngrenë në mënyrë të dukshme ekonominë e tyre, të sigurtë se, me udhëheqjen e Partisë dhe me punë të paprerë, do të gëzojnë ditë më të mira. Ne mund të shprehemi me fjalën e shokut Stalin:

«Tani fshati nuk mund të quhet më njerë për fshatarin»¹.

Siç dihet, deri në çlirimin e Shqipërisë më 1944, toka zotërohej në radhë të parë nga feudalët, kulakët dhe pjesërisht nga fshatarë të varfër. Si rezultat i marrjes së pushtetit në duart e popullit, me ndryshimin e raporteve ekonomike, politike dhe shoqërore, përveç sektorit privat në bujqësi, u krijuan konditat për dy sektrë të rinj: sektori i kooperativave të tipit socialist dhe sektori fund e krye socialist i shtetit.

A. Kooperativat bujqësore. — Në vendin tonë s'ka pasur kooperativa. Kooperativizmi është një sektor i ri i ekonomisë bujqësore me baza socialiste, për të cilin Partia dhe shteti do të bëjnë gjithshka për ta zgjeruar. Përkrahja do të jetë e gjithanshme: materiale, organizative, instruksionale dhe politiko-kulturale.

Ne kemi parasysh në këtë rast atë që shkruan Lenini:

«Çdo rend shoqëror lind vetëm me përkrahjen financiare të një klase të caktuar... ne duhet ta kuptojmë dhe të vëmë në jetë të vërtetën se në kohën e sotme rendi shoqëror, që ne duhet të përkrahim në mënyrë të veçantë, është rendi kooperativist»².

Sektori i kooperativave në bujqësi është i ri në ven-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 52.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 526.

e gjithanshme dhe, me forcimin e pushtetit, ka ardhur vit për vit duke u shtuar. Kështu p.sh. kemi:

Lloji dhe njësia	1938	1945	1946	1947	1948	% 1938 1948
Farëra kv.	13050	30000	30016	99645	69883	535
Plech kimik kv.	—	—	5110	35957	41918	—
Fid. fryt. rrënjë	98000	—	24000	125800	209500	213
Fid. pyjore rrënjë	20000	—	60000	1200000	5335950	26679
Vegja insekt. lekë	—	—	18000000	39546673	60687588	—
Kredit agrar lekë	—	—	12434733	4118677	13017293	—
Kuadro bujq. nr. prej të cilëve:	243	—	—	—	1124	462
të lartë	86				155	
të mesëm	127				438	
të ulët	30				531	

Politika jonë në këto ndihma ka qenë dhe do të jetë që të përfitojnë në radhë të parë kooperativat dhe fshatarët e varfër.

Ndryshimi i pronësisë dhe i marrëdhënjeve mbi tokën, fillimi i përdorimit të mjeteve të përparuara, ndihma e madhe materiale nga ana e shtetit dhe konditat e reja politiko-shoqërore në vendin tonë, bënë që fshatarët të ndodhen para një gjendjeje të re. Djersa dhe mundimi i bujqve të varfër, nuk shkon në dobi të pronarëve të djeshëm të tokave; ata janë zot të frytit të punës së tyre. Ndërsa para çlirimit fshatarët punonjës ishin robër të rraskapitur, të zhveshur, të uritur e të përbuzur, me fitoren e Luftës nac.-çl. dhe pas kësaj, ata shpëtuan nga kjo gjendje dhe kanë filluar të ngrenë në mënyrë të dukshme ekonominë e tyre, të sigurtë se, me udhëheqjen e Partisë dhe me punë të paprerë, do të gëzojnë ditë më të mira. Ne mund të shprehemi me fjalën e shokut Stalin:

«Tani fshati nuk mund të quhet më njerë për fshatarin»¹.

Siç dihet, deri në çlirimin e Shqipërisë më 1944, toka zotërohej në radhë të parë nga feudalët, kulakët dhe pjesërisht nga fshatarë të varfër. Si rezultat i marrjes së pushtetit në duart e popullit, me ndryshimin e raporteve ekonomike, politike dhe shoqërore, përveç sektorit privat në bujqësi, u krijuan konditat për dy sektrë të rinj: sektori i kooperativave të tipit socialist dhe sektori fund e krye socialist i shtetit. ;

A. *Kooperativat bujqësore.* — Në vendin tonë s'ka pasur kooperativa. Kooperativizmi është një sektor i ri i ekonomisë bujqësore me baza socialiste, për të cilin Partia dhe shteti do të bëjnë gjithshka për ta zgjeruar. Përkrahja do të jetë e gjithanshme: materiale, organizative, instruksionale dhe politiko-kulturale.

Ne kemi parasysh në këtë rast atë që shkruan Lenini:

«Çdo rend shoqëror lind vetëm me përkrahjen financiare të një klase të caktuar. . . ne duhet ta kuptojmë dhe të vëmë në jetë të vërtetën se në kohën e sotme rendi shoqëror, që ne duhet të përkrahim në mënyrë të veçantë, është rendi kooperativist»².

Sektori i kooperativave në bujqësi është i ri në ven-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 52.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 528.

din tonë, por anëtarët e Partisë dhe gjithë fshatarët duhet të kuptojnë mirë se kooperativat janë organizata të shëndosha, që nuk mund t'i pengojë asgjë të ecin përpara e të bëhen ashtu siç ka thënë shoku Stalin:

«...Leva të përparimit ekonomik, leva të zhvillimit socialist të bujqësisë»¹.

Kooperativat bujqësore përbëjnë formën më të lartë për të bashkërenditur interesat personale me interesat e përgjithshme të shtetit. Të kemi të qartë fjalët e Leninit:

«...sepse me ekonominë e vogël s'mund të dilet nga skamja»².

Bujqësia duhet të sigurojë me plan bukën e popullit, lëndët e para për industrinë, të ardhurat nacionale. Ekonomi të planifikuar nuk mund të ketë përveçse në sektorin shtetëror dhe në atë kooperativist, kurse prona e vogël e veçuar private, nuk e siguron këtë dhe shpesh bëhet shkak i anarkisë në prodhim. Në ekonomitë e vogla bujku është i detyruar të mbjellë nga të gjitha ç'i nevojitet, pa i studjuar konditat për prodhim. Një gjë e tillë ka tërë mundësitë të evitohet në ekonomitë e mëdha të kolektivizuara, ku çdo bime mund t'i rezervohet toka që i përshtatet më mirë.

Pastaj, bujqit e vegjël në pronat e tyre, nuk shfytë-

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 12, f. 162.

² V. I. Lenin, Veprat, vëll. 30, f. 152.

zojnë dot racionalisht forcat, kuptojnë me vështirësi nevojën e zbatimit të një agroteknike të përparuar dhe nuk kanë mundësi të blejnë ose të përdorin mjetet e mekanizuara në punë, të cilat influencojnë shumë në shtimin dhe përmirësimin e prodhimit. Për këto dobi kryesore e të tjera, që janë të shumta e të rëndësishme, pse kooperativizmi, sikurse thotë Lenini, është një hallkë themelore e kryesore për ndërtimin e socializmit në fshat, sepse kooperativizmi është në gjendje të përmbledhë gjithë fushat kryesore të jetës politike, ekonomike e kulturale të popullsisë fshatare, Partia dhe shteti ynë do ta përkrahin pa rezerva këtë rrugë kooperativiste.

A ka pasur Partia sukses në këtë sektor pune të aktivitetit ekonomik?

Fakti që nga hiçi kemi:

Viti	Nr. i koop.	Nr. i famll. anëtarëve	Sipërf. tokë ha.	Nr. i krahitë punës	Nr. i kafshëve të punës	Ullinj rrënjë
1946	7	217	942,80	570	260	
1947	21	1825	3671,80	1988	1137	
1948	56	2428	10870	6481	2882	6100

tregon se ne kemi sukseset e para të kësaj pune. Suksesi më i madh duket në rezultatet që kanë arritur vetë kooperativat. Kështu nga puna e organizuar dhe mobilizimi me gjithë shpirt i pjesës më të madhe të kooperativistëve, plani i mbjelljeve për vitin 1947 u realizua 101%. Rezultatet në prodhim qenë 25-30% më të larta në krahasim me ato të fshatarëve jashtë kooperativave. Përfitimet kanë rritur ndërgjegjen për punë të kooperati-

vistëve dhe ata këtë vit punojnë me rregull, organizim dhe entuziazëm më të madh. Plani i mbjelljeve të pranverës që kaloi u realizua 108,50% dhe u shtua së tepërmi në bimë industriale, perime dhe patate. Në kooperativat bujqësore është njohur dhe është shfrytëzuar mirë puna e mjeteve të mekanizuara. Në vitin 1948 kooperativat po punojnë 3-4 herë më tepër sipërfaqe me traktor se sa më 1947. Kanë blerë ose kanë marrë me qira nga SMT-të maqina mbjellëse, korrëse, korrëse-lidhëse, shirëse, shkoqëse misri, triora, etj.

Në këtë mënyrë punët janë kryer me kohë dhe është kursyer një sasi e konsiderueshme krahë pune.

Në kooperativat nuk punohet më me parmenda druri.

Kooperativat zënë vendin e parë në përdorimin e plehrave kimike, në luftimin e sëmundjeve të pemëve e të kafshëve, në mirëmbajtjen e gjësë së gjallë (disa prej tyre kanë ndërtuar ose janë duke ndërtuar stallá moderne), në sistemimin e tokave dhe në bonifikimet, etj.

Kooperativat bujqësore janë bërë shembull për përmbushjen dhe tejkalimin e detyrimeve të grumbullimit të bereqetit, kanë shitur tërë tepricat e prodhimeve të tyre vetëm në kooperativat e shitblerjes dhe të konsumit.

Pjesëmarrja e gruas në prodhim është shtuar së tepërmi dhe në kooperativa bëhet dhe luftë e rreptë kundër analfabetizmit. Rëndësi e veçantë i është dhënë gjithashtu plotësimit të nevojave të mëdha të kuadrit. Fshatarët e thjeshtë, që deri dje kujtohej se nuk vlenin asgjë, sot ata kryejnë mirë punën e tyre si llogaritarë, brigadierë, teknikë bujqësorë, sekretarë, kryetarë të kooperativës dhe organizatorë të mirë.

Në aksione lokale dhe nacionale, kooperativistët janë të parët vullnetarë dhe jo vetëm kaq, po ata bëhen shembull për vullnetin e tyre, për disiplinën dhe rendimentin në punë. P.sh. nga të 14 të rinjtë e kooperativës së Dobraçit që shkuan në turnin e parë në hekurudhë, 13 prej tyre u kthyen sulmues. Por, krahas me këto suksese, puna në kooperativat bujqësore ka pasur mjaft të meta, bile dhe të meta parimore.

Mbi të gjitha, kooperativat bujqësore nuk kanë qënë ndërtuar plotësisht mbi baza socialiste; statuti i tyre dhe tërë forma organizative janë mbështetur ose janë kopjuar pikë për pikë nga Jugosllavia, fryt i punës së udhëheqjes antimarksiste në Partinë Komuniste Jugosllave.

I jemi mirënjohës Partisë Komuniste Bolshevike dhe Stalinit të madh, që na ndihmuan t'i ndreqim këto gabime dhe të ndjekim me besnikëri rrugën e marksizëm-leninizmit për tërë politikën ekonomike në fshat.

Në statutin e vjetër të kooperativave bujqësore kanë ekzistuar këto shtrembërime:

Ndarja e prodhimeve bëhej 40% në bazë të tokës dhe 60% në bazë të punës, ndarje që u interesonte kulakëve dhe më mirë se në të kaluarën. Kjo lejonte shfrytëzimin dhe ngjalljen e kapitalizmit brenda në kooperativa, gjë që ka shkaktuar pakënaqësi dhe që ka penguar së tepërmi forcimin e kooperativave dhe pjesëmarrjen e rregullt të të gjithë anëtarëve në punë.

Numri i bagëtive dhe sasia e tokës që u mbetej familjeve anëtare për përdorimin privat nuk ishte i kufizuar. Kështu që disa herë anëtarët e kooperativave, shumicën e ditëve të punës, e harxhonin jo për koope-

rativën, por për punën e tyre në arë, pranë shtëpisë ose me ruajtjen dhe mbajtjen e bagëtisë, jashtë pronës së kooperativës.

Këto të meta dhe të tjera, siç ishin mosçaktimi i minimumit të ditëve të punës që çdo anëtar duhej të bënte në kooperativë gjatë vitit, kondita që, për të ngritur një kooperativë, duhej të ishin të paktën 25-30 familje bujqësore dhe mbi 200 ha. tokë, etj., kanë bërë që puna në kooperativa të mos vejë aq mirë sa duhej dhe të mos krijoheshin konditat për ngritjen e më tepër kooperativave.

Por, përveç këtyre, si rrjedhim dhe i këtij statuti, në kooperativa ka pasur edhe të meta të tjera, që në radhë të parë janë:

1. — Mungesa e një organizimi të shëndoshë si rrjedhim edhe i paaftësisë së duhur drejtuese dhe i mungesës së eksperiencës në punë.

2. — Mungesa e një plani të detajuar e komplet dhe pa ndarje të mirë të forcave.

3. — Mungesa e vigjilencës, një e metë e rëndësishme, rëndon mbi disa organizata të Partisë.

Në përgjithësi, në ngritjen e kooperativave bujqësore nuk është shikuar me kujdes përbërja. Nuk ka qenë e qartë se anëtarë të kooperativave mund të bëhen vetëm fshatarët e varfër dhe të mesëm. Në disa kooperativa dhe sidomos në Shkodër u futën kulakë, elementë të ndërgjegjshëm për shkatërrimin e kooperativës, elementë armiq, që u futën kontrabandë për të ruajtur privilegjin mbi tokën, elementë të cilët tani po dalin jashtë kooperativave.

Ka raste pastaj që puna e Partisë është mjaftuar

vetëm deri në ngritjen e kooperativës. Një veprim i tillë është krejt i gabuar. Një kooperativë e porsangritur, ku mungon eksperiencia e punës dhe e organizimit, ka nevojë të domosdoshme për ndihmën e pushtetit dhe të Partisë. Aty ka vetëm një gjë pozitive: dëshirë për të punuar në kolektivitet. Kjo dëshirë duhet të kanalizohet.

Shoku Stalin thotë:

«Do të ishte një gabim akoma më i madh të mendohej se anëtarët e kolkozeve tashmë janë bërë socialistë. Jo, duhet të punojmë akoma shumë për ta transformuar fshatarin kolkozian për të ndrequr psikologjinë e tij individualiste dhe për ta bërë atë punonjës të vërtetë të shoqërisë socialiste»¹.

Pastaj duke mos u shkëputur nga fakti që në kooperativa hyjnë kulakë, nuk lejohet një lënje e kooperativave në fatin e tyre. Edhe këtë gjë shoku Stalin e shpjegon kështu:

«Nuk mund të mos ketë elemente të luftës së klasave në kolkozet, derisa atje vazhdojnë të ekzistojnë mbeturinat e psikologjisë individualiste dhe bile kulake, derisa atje vazhdon të ekzistojë një farë pabarazie në gjendjen materiale»².

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 161.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 160.

Deri këto kohët e fundit kooperativat bujqësore mbanin lidhje dhe u jepej ndihmë e pamjaftueshme nga Komiteti i përgjithshëm i kooperativave. Çështja e centralizimit të kooperativave, si organizata grupi ishte kuptuar keq, kuptohej sikur shteti nuk duhej të pleksej në punët e tyre. Ato ishin lënë të mbyllura në vetëvete. Për t'i ndihmuar ato, Partia dhe pushteti popullor duhet t'i udhëheqin, t'i koordinojnë këto me planin e shtetit, t'i bëjnë pjesë të pandara të sistemit ekonomik të demokracisë popullore në zhvillimin e tij drejt socializmit.

Me qëllim që të evitohen këto të meta, në datën 11-13 shtator një komision iniciator, duke u mbështetur mbi parimet dhe statutin e ekonomive të përparuara kolkoziane të Bashkimit të madh Sovjetik, hartoi një projektstatut të ri, i cili, i vënë për aprovim para fshatarëve kooperativistë, u përqaftua me entuziazëm.

Ky projektstatut që u hartua mbi baza të drejta marksiste-leniniste, natyrisht, e ashpërsoi edhe më tepër luftën e kulakëve dhe pati si rrjedhim aktivizimin e tyre për të kundërshtuar.

Projektstatuti i ri i kooperativave bujqësore është një sukses për Partinë tonë, pse i vë kooperativat në baza të drejta marksiste-leniniste, është një sukses për kooperativat bujqësore të ngritura, të cilat e kanë dashur me kohë këtë statut. Ai na siguron mbarëvajtjen e kooperativave ekzistuese dhe garanton shtimin e madh të kooperativave. Tani nga ana e fshatarëve ka mjaft kërkesa që kërkojnë ndihmën e pushtetit për t'u organizuar në kooperativa. Prandaj është detyrë e organizatave të Partisë që ta studjojnë me kujdes projektstatutin e kooperativave.

Por kjo nuk do të thotë se puna jonë është zgjidhur me projektin ose statutin e ri. Bindja e fshatarëve të varfër dhe të mesëm mbi leverdinë dhe domosdoshmërinë e kalimit të tyre nga ekonomi të vogla, të veçuara e të varfëra, në rrugën e ekonomive të mëdha, të bashkuara kooperativiste, socialiste, do të arrihet vetëm nga një punë e madhe politike dhe organizative prej organeve të Partisë sonë.

Pa një punë të tillë dhe të paprerë, edhe në qoftë se do të ngrihen kooperativa, ato ose do të shkrihen përsëri ose do të jenë gjithmonë të dobëta. Shoku Stalin ka thënë:

«Sukseset ekonomike, qëndrueshmëria dhe jeta e tyre varen tërësisht dhe plotësisht nga sukseset e punës organizative dhe të punës politike të Partisë, se pa këtë kusht sukseset ekonomike mund të jenë si të ndërtuara mbi rërë»¹.

Ngritja e kooperativave bujqësore, rritja e ekonomisë kolektive fshatare, transformimi socialist i fshatit, forcon pozitën e Partisë dhe lidhjen e ngushtë me masat fshatare. Mbi këtë çështje Lenini shkruan:

«Vetëm në rast se do të jetë e mundur t'u tregohen me fakte fshatarëve epërsitë e punimit të tokës në mënyrë të përbashkët, në mënyrë shoqërore, kolektive, në artel; vetëm kur të jetë e mundur të ndihmohet fshatari me anën e eko-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 107.

*nomisë shoqërore, me anën e ekonomisë së artel-
lit, vetëm atëhere klasa punëtore, që mban në
duart e veta pushtetin shtetëror, do t'i provojë
fshatarit se ajo ka me të vërtetë të drejtë, do të
tërheqë me të vërtetë në anën e saj, përgjith-
monë dhe si duhet, masën shumë milionshe të
fshatarësisë»¹.*

Kooperativizmi është e ardhshmja jonë, prandaj kooperativistët të tregohen të denjë për punën e tyre socialiste që kanë nisur, të mos kursejnë asgjë që puna e tyre të shkojë mbarë, të përdorin me kujdes mjetet e punës dhe të prodhimit, të bëhen shembull i gjallë për fshatarët e tjerë që i rrethojnë, të zgjerojnë përditë sipërfaqet e mbjella dhe të bëjnë që numri i tyre të shtohet çdo ditë e më tepër; e kjo duke mos harruar asnjë moment se edhe ata, pak më parë, ishin ekonomi të veçuara.

B. Sektori shtetëror në bujqësi. — Është sektor i ri fund e krye socialist, që, siç thamë, lindi pas çlirimit dhe përmbledh feramat, fidanishtet dhe ullishtet e organizuara në ndërmarrje bujqësore shtetërore.

Në qoftë se ndonjëri do të thoshte se shteti ka pasur edhe më parë tokë, ai do të harronte se shteti i atëhershëm ndryshon në themel nga i sotmi, do të harronte se sektori ynë shtetëror ka ndryshim me sektorin shtetëror kapitalist feudal që përfaqëson gjithmonë interesin e disa individëve dhe që jo vetëm nuk është në luftë me sektorin privat, por si pjesë e tij, e ndihmon atë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 210-211.

Shteti ynë nuk drejtohet nga ekonomia, por ai drejton ekonominë.

Roli i sektorit shtetëror në bujqësi është i madh, në të do të rritet dhe do të zhvillohet lëvizja revolucionare e prodhimit dhe e shkencës në këtë degë. Është sektori ku do të gjejnë aplikim të plotë mekanizimi dhe metodat më të larta agroteknike, është sektori që do të bëhet shembull dhe do të ndihmojë me farëra, fidane, damazë të zgjedhur dhe kuadro të specializuar kooperativat bujqësore dhe bujqit e tjerë. Ky do të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të furnizimit të qyteteve dhe të qendrave industriale me perime, pemë, qumësht dhe prodhime të ndryshme.

Duke u mbështetur mbi rolin shumë të rëndësishëm të tyre, që sot është akoma i vogël, Partia dhe shteti do të tregojnë kujdes të posaçëm që ndërmarrjet tona bujqësore të rriten e të forcohen.

Në fakt, si sipërfaqe, sektori shtetëror ka ardhur vit për vit duke u rritur.

Viti	Ullinj rrënjë	Sipërf. përgj. ha.	Tokë nën kulturë ha.	Livadhë ha.	Kullota ha.	Pyje ha.	Toka in- produktive ha.
1938	—	316	106	26	114	50	20
1945	—	8379	3294	348	1554	2187	1047
1946	—	9091	3659	449	1649	2287	1047
1947	230000	13491	6963	558	1400	3516	1054
1948	230000	16390	9168	557	2167	3510	987
	5500	1110					
Shuma	235500	17500					

— Stacionet bujqësore e fidantshtet lokale.

Një shtim i njëjlojtë progresiv me atë të sipërfaqeve është bërë edhe në kafshë të prodhimit e të punës dhe në mjete të mekanizuara.

Shtimi i sipërfaqeve të mbjella dhe i mjeteve të punës e të prodhimit ka dhënë këto rezultate në produkte:

Viti	Drithëra	Blmë industriale	Perime e patate	Bimë foragjere	Ullinj e fryte	Qumësht
	kv.	kv.	kv.	kv.	kv.	hl.
1945	18700	30	8550	4780	1960	1300
1946	31100	105	10760	5000	34570	3050
1947	13800	8230	16100	25260	25930	5000
1948	24640	5980	74240	95500	36730	13800

Shifrat e prodhimit pasqyrojnë edhe destinacionin e sipërfaqeve në pajtim me qëllimin e këtyre ndërmarrjeve. Sipërfaqja, që është pakësuar në vitin 1948, është vetëm ajo e bimëve industriale, e cila për orientim të gabuar dhe për mungesë studimesh ishte rritur në proporcion të zhdrejtë me 1947-n. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore gjatë kësaj kohe janë vërtetuar një sërë të metash, të cilat kanë penguar mbarëvajtjen e këtij sektori dhe që është dashur një punë e madhe për eliminimin sa më shpejt të tyre.

Këto të meta mund të përmbliidhen:

1. — Për mungesë eksperience dhe aftësie drejtuese dhe organizimi i brendshëm pothuaj ka çaluar mjaft, në të gjitha ndërmarrjet.

2. — Ka munguar iniciativa dhe në fillim nuk është kuptuar autonomia e ndërmarrjes, nuk është kuptuar ndërtimi i tyre mbi baza hozrashoti.

3. — Sidomos në kuadrin teknik ka munguar ndër-

gjegjja e plotë dhe ana kontabël ka qenë mjaft prapa.

4. — Nuk janë plotësuar nevojat me punëtorë krahu, nuk është bërë aq punë sa duhet për ngritjen e tyre profesionale, politike dhe kulturele e sidomos në vjetët e kaluar, kanë qenë të dobëta konditat e punës dhe të pagesës.

Sidoqoftë, aty ku përpjekjet kanë qenë më të mëdha, rezultatet kanë qenë më të mira. Kështu p.sh. Ndërmarrja «Maliq Muço» e krahasuar me Ndërmarrjen «Çlirimi» ka pasur ndryshime. Ndërsa e para ka pasur progresivitet në prodhime dhe në ngritjen e kuadrit, ka shfrytëzuar dhe ka ruajtur mirë inventarin e saj, ka bërë me kohë punimet, ka realizuar planin financiar dhe të investimeve dhe ka mbajtur lidhje të mira me fshatarët përreth, e dyta, duke marrë parasysh dhe arësyet objektive në barazim me të parën, nuk ka realizuar planin e prodhimit financiar dhe të investimeve, nuk ka perfeksionuar sa duhet kuadrin, nuk ka ruajtur dhe mirëmbajtur kafshët e punës, etj.

Anëtarëve të Partisë dhe mbarë punonjësve në këto ndërmarrje u bie barra të bëjnë që ky sektor shumë i rëndësishëm në bujqësi, tërësisht socialist, të luajë rolin që i përket: të luajë rolin e pararojës në ngritjen dhe modernizimin e bujqësisë, të ndjekë shembullin e sovkozeve sovjetike.

Duhet të forcohet dhe të modernizohet organizimi i brendshëm mbi baza hozrashoti. Fermat, fidanishtet dhe ullishtat tona duhet të bëhen vatra të përhapjes së një pune shkencore. Të aplikohen në to qarkullimi i rregullt bujqësor, të bëhen prova dhe eksperimente në çdo drejtim, të bëhet seleksionimi dhe përmirësimi i gjithë bi-

mëve dhe kafshëve dhe të shtohen farërat, fidanet e damazët nga më të mirët. Ndërmarrjet tona bujqësore të përdorin metodat më të reja dhe më frytdhënëse të agroteknikës, të shfrytëzojnë mësimet e shkencës revolucionare sovjetike, mbështetur mbi marksizëm-leninizmin. Puna me mjete të mekanizuara, qarkullimi bujqësor, përdorimi i plehrave kimike dhe shërbimet agroteknike duhet të japin jo vetëm prodhime rekord, por të kush-tojnë edhe më lirë se sa në kooperativat bujqësore dhe në sektorin privat.

Ndërmarrjet tona bujqësore duhet të shtojnë çdo ditë e më tepër aktivitetin për edukimin kultural dhe profesional të personelit punëtor të tyre, të shtojnë nxënësit në ekonomi dhe të bëhen qendra që, me anë të shembullit, të përhapin eksperiencën e tyre jo vetëm në kooperativat bujqësore dhe në fshatarët përreth, por edhe larg tyre dhe të shtojnë çdo ditë e më tepër sipërfaqen e mbjellë me toka të pavëna nën kulturë. Partia dhe shteti do të bëjnë që roli i këtij sektori të bëhet çdo ditë më i madh, sepse ai është baza për përparimin e shpejtë të bujqësisë, është shkolla, ku mund të mësojnë në praktikë teknikën moderne të gjithë bujqit dhe kooperativat bujqësore.

...Partia dhe qeveria, besnike të vijës së tyre, për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë, ngritën stacionet e maqinave dhe të traktorëve si ndërmarrje të formës socialiste, të cilat kishin për barrë të ndihmonin në rradhë të parë kooperativat dhe fshatarët e varfër në punimin e tokave që përfituan.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve duke ndihmuar fshatarin e varfër dhe të mesëm, krijojnë bazat

teknike për kalimin në format më të larta socialiste të punimit të tokës.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve, duke pasur si parim ngritjen sa më të lartë të prodhimit bujqësor, ndihmojnë në shkallë të gjerë për futjen dhe përhapjen kudo të metodave agroteknike të përparuara në punimet bujqësore.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve luajnë rol të madh dhe të rëndësishëm në zhvillimin dhe forcimin e kooperativave bujqësore. Faktor me rëndësi për përparimin e kooperativave dhe të mbarë bujqësisë është, pa dyshim, përdorimi në shkallë të gjerë i maqinerisë bujqësore në punimet e ndryshme bujqësore, për vetë faktin se zëvendësimi i mjeteve primitive me mjetet e reja, lejon shtimin dhe përmirësimin e prodhimit dhe si rrjedhim ngritjen e standardit të jetesës për masat punonjëse të fshatit.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e madhe që ka mekanizimi në bujqësi, Partia dhe qeveria i kushtojnë dhe do t'i kushtojnë një kujdes të posaçëm zhvillimit të mëtejshëm të SMT-ve, prandaj edhe nuk do të kursejnë investime kapitalesh për këtë qëllim.

Që në vitin 1947, Partia dhe qeveria filluan të krijojnë stacionet e maqinave dhe të traktorëve.

Tani stacionet e maqinave dhe të traktorëve janë të pajisura me këto maqineri:

Trak.	Mot.	Plugje	Disqe	Lesa	Maqina				
					mbjellëse	korr. lidh.	korr. kosit.	shirëse	lidhëse
167	163	128	120	2500	83	32	140	300	15

Për plotësimin dhe krijimin e stacioneve të reja të maqinave dhe të traktorëve filluam të sjellim nga Bashkimi Sovjetik traktorë dhe maqina bujqësore. Kjo është ndihma vëllazërore e popullit të madh sovjetik, me të cilën ai shpreh dashurinë për popullin tonë dhe garancinë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë sonë.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve, në krahasim me sipërfaqen e përgjithshme të tokave të punueshme, në vitin 1946 kanë punuar 10% të tokave, në vitin 1947 — 60% dhe deri më 15 tetor të vitit 1948 — 140%. Punimi i kryer nga një traktor prej 15 kuajsh fuqi në vitin 1946 ka qenë vetëm 29 ha. në vitin 1947 — 89,8 ha. dhe në vitin 1948, deri më 15 tetor — 118,5 ha.

Në sektorin kooperativist janë bërë punime të ndryshme me mjete të stacioneve të maqinave dhe të traktorëve: në vitin 1946—1947—200% dhe në vitin 1947 — 1948—400%.

Siç shihet edhe nga shifrat e sipërme stacionet e maqinave dhe të traktorëve nga viti në vit bëjnë më shumë punime dhe luajnë një rol gjithnjë më të madh.

Gjatë këtij viti, përveç punimeve të mësipërme, janë hapur dhe përfutur 3 235 ha. toka të reja. të cilat janë vënë nën kulturë për herë të parë.

Gjatë dy vjetëve jetë dhe aktivitet të stacioneve të maqinave dhe të traktorëve ka pasur përmirësime të vazhdueshme në shfrytëzimin e maqinerisë. Grafiku i punës në çdo vit shënon ngritje progresive, gjë që i kushtohet organizimit dhe përpjekjeve të punonjësve të këtij sektori. Por duhet të theksojmë se disa stacione të maqinave dhe të traktorëve japin një rendiment akoma të ulët. Kështu p.sh. SMT-ja e Korçës ka punuar 76 ha.

për çdo një traktor 15 kuajsh fuqi kurse SMT-ja e Shkodrës ka punuar 115 ha. për çdo një traktor 15 kuajsh fuqi. Me këto rezultate që ka arritur SMT-ja e Shkodrës, duken përpjekjet e mëdha që janë bërë në këtë drejtim, megjithëqë jemi akoma larg atyre mundësive që kanë stacionet e maqinave dhe të traktorëve.

Eksperienca gjatë punës dhe përpjekjeve, na tregoi se të metat kryesore në organizimin e punës në stacionet e maqinave dhe të traktorëve janë:

1. — Punonjësit e SMT-ve, në disa raste, nuk i kanë punuar mirë tokat e fshatarëve, nuk kanë bërë përpjekje që, duke punuar mirë, të kontribuojnë në shtimin e prodhimit.

2. — Kualifikimi i kuadrove nuk është bërë sa duhet dhe gjendja e tyre sot, nga pikëpamja e aftësisë teknike, është e ulët. Po në këtë mënyrë nuk i është dhënë rëndësia e duhur edukimit politik të kuadrove.

3. — Deri tani në SMT-të organizimi i punës nuk ka qenë në nivelin e duhur, gjithashtu deri më sot vihet re se disiplina ka qenë e dobët në disa punonjës të SMT-ve.

4. — Mënyra e pagesës së traktoristëve dhe e brigadierëve, jo në bazë të punës dhe të kualitetit të saj, por në bazë të kohës, nuk është e drejtë.

5. — Mosshfrytëzimi i plotë i forcës së maqinerisë në të gjitha llojet e punimeve, shpenzimi i pakujdesshëm i materialeve dhe humbja e karburantëve u reflektuan në ngritjen e kostos së punimit të tokave.

6. — Riparimi i maqinave nuk është bërë në kohën e duhur dhe kualiteti nuk ka qenë i mirë, gjë që pakëson jetën e maqinave dhe i nxjerr jashtë përdorimit para kohe.

Me gjithë të metat që u thanë më sipër, SMT-të në periudhën e organizimit të tyre, në më të shumtën e herës, i kanë kryer detyrat që u janë ngarkuar, duke ndihmuar në ngritjen e prodhimit bujqësor dhe në përparimin e sektorit kooperativist.

Në gjendjen e sotme shtrohet si detyrë e madhe dhe mjaft e rëndësishme, zgjerimi dhe forcimi i mekanizimit të bujqësisë dhe në radhë të parë i mekanizimit në shkallë sa më të gjerë në sektorin kooperativist.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve duhet të bëhen faktorë kryesorë për zbatimin e metodave agroteknike të përparuara në punimet bujqësore, si formë e re më e përparuar për zhvillimin e bujqësisë mbi baza socialiste.

C. Sektori privat në bujqësi. — Zbatimi i reformës agrare, rezultat i vendosjes së pushtetit tonë popullor, goditi për vdekje kapitalizmin dhe feudalizmin në bujqësi, por kjo nuk do të thotë se në fshat u krijua një klasë homogjene. Ne kemi sot në fshat fshatarë të varfër, të mesëm dhe kulakë, këta të fundit, megjithëse kanë humbur pjesë të tokës dhe janë privuar nga mundësia që të punojnë të tjerët për ta, bëjnë çmos për të fituar pozitat e humbura.

Është e vërtetë se kulakët janë shpronësuar tërësisht ose pjesërisht dhe kanë humbur privilegjet, por ata si individë e si mentalitete, do të ekzistojnë akoma edhe për mjaft vjet.

Politika e Partisë është të bëjë diferencim të drejtë, të përkrahë në maksimum fshatarët e varfër, të përkrahë dhe të edukojë fshatarët e mesëm dhe, bashkë me të parët, t'i ndihmojë këta për të aderuar në koope-

rativa bujqësore, t'u bëjë luftë të vazhdueshme kulakëve dhe mentalitetit të tyre. Parulla jonë kryesore do të jetë: kufizimi i kulakëve në fshat.

Roli i sektorit privat në konditat e sotme të fshatit është jashtëzakonisht i madh. Të kemi parasysh se nga 317 000 ha. tokë e kultivueshme, 288 630 ha. ose 91,05% e saj ndodhet në duart e privatëve. Pikërisht për këtë shkak pikëmbështetja e ekonomisë bujqësore sot për sot qëndron në këtë sektor.

Revolucioni popullor krijoi për fshatarët tanë, për zhvillimin e bujqësisë, kondita të reja. Po të mos u merrreshin bejlerëve me forcë sipërfaqet e mëdha të përshtatshme për toka buke, që shfrytëzoheshin vetëm si kullotë, nuk do të mendohej kurrë përmirësimi i bujqësisë sonë.

Fshatarët e përkrahën dhe muarën pjesë në Luftën nac.-çl., jo vetëm se Partia u tregoi se kështu u hiqej qafe okupatori dhe shtypësit e brendshëm, porse ajo i siguroi se me këtë gjë, ndërroheshin nga themeli marrëdhënjet ekzistuese, krijoheshin kondita për një jetë të re, një jetë, që do t'u jepte mundësi fshatarëve punonjës të ngrenë nivelin e tyre ekonomik e kultural dhe jeta e tyre të përmirësohet nga dita në ditë, nga viti në vit.

Përpara fshatarëve, që përfituan tokë dhe që u ndihmuan që në ditët e para nga pushteti popullor, u shtrua detyra e shtimit të prodhimit, për të siguruar bukën, e cila nuk mund të arrihej veçse me shtimin e sipërfaqeve të mbjella dhe me përdorimin e metodave të reja agroteknike. Me qëllim që të ngrejë mirëqenjen e fshatarësisë dhe të mbarë popullit, Partia vuri si detyrë që fsha-

tarët të mobilizohen për të punuar sa më shumë dhe sa më mirë tokat e tyre.

Kësaj detyre ju përgjegjën në radhë të parë fshatarët e varfër, ata që përfituan tokë nga reforma agrare. Rezultatet në këtë drejtim janë shumë të mira.

Me gjithë mungesën e madhe të pendëve të punës dhe mungesat e tjera pas luftës, nga përpjekjet e mëdha, nga puna plot entuziazëm dhe vetëmohim, nga puna e ndërgjegjshme dhe për vete, nga ana e fshatarëve tanë, janë arritur këto rezultate:

Emërtimi	Njësia e matjes: ha.						% 1938- 1948
	1938	1944	1945	1946	1947	1948	
Sipërfaqja e punuar	221030	247645	223110	263630	305000	317000	143
prej sëcilës:							
Sekt. shtetit	316	316	8379	9091	13491	17500	51,80
Sekt. koop.	—	—	—	943	3672	10870	—
Sekt. privat	220714	247329	214731	253596	287837	288630	130

Me gjithë shtesën e dukshme të sipërfaqes së punueshme, te ne ka akoma shumë tokë të pavënë nën kulturë. Përpjekjet nga ana e organizatave të Partisë për të hapur toka të reja dhe për të mos mbetur sipërfaqe pa mbjellë nga ato që kemi sot, duhet të jenë të mëdha dhe të vazhdueshme.

Një punë e madhe është bërë për shtimin e rendimentit të prodhimit për ha. dhe një sërë masash janë marrë për përmirësimin e agroteknikës.

Është shtuar së tepërmi puna e instruksionit në krahasim me vitin e parë të çlirimit; vit për vit janë ndarë sasira më të mëdha farërash, plehrash kimike,

veglash të ndryshme, janë organizuar SMT-të, etj. Një punë e madhe dhe me efekt është bërë në sistemimin dhe bonifikimin e tokave. Ja, p.sh.:

Emërtimi	Njësia e maties: ha.						
	1938	1944	1945	1946	1947	1948	% 1938- 1948
Vaditja	18500	20000	20000	22700	25000	31000	167,5
Kullim me sistem	1500	2600	2600	4300	7300	18423	1228,2
Tokë e re	—	—	—	—	—	780	—

Megjithkëtë, duhet të pohojmë se rezultatet në shtimin e prodhimit për ha. nuk janë fort të kënaqshme. Në përgjithësi bujqit akoma nuk po shkëputen në mënyrë të vendosur nga mjetet dhe mënyrat e punës të praktikuara deri më sot. Nuk po zbatojnë agroteknikën e përsosur, nuk kujdesen që prodhimi të mos dëmtohet nga koha e pjekjes deri në konsum, etj.

Vetë Ministria e Bujqësisë, për mungesë kuadrosh në numër, në kualitet dhe për shkak të mungesës së ndërgjegjes së plotë të disave prej tyre, nuk ka dhënë aq sa ishte e nevojshme për njohjen e agroteknikës nga ana e fshatarëve.

Gjithë këto të meta ulin prodhimin, dëmtojnë ekonominë e çdo bujku, nuk lejojnë që ngritja e ekonomisë sonë të përgjithshme të bëhet me një ritëm më të shpejtë. Puna e organizatave të Partisë duhet të konsistojë në eliminimin e këtyre të metave. Sidoqoftë, te fshatarët ka një ndryshim të madh në jetën e tyre ekonomike me paraluftën, ndryshim si nata me ditën. Punojnë dhe ma-

1 Gjatë vitit 1945 nuk janë bërë punime.

rrin tërë prodhimin për vete, nuk ka më pjesëtarë të djersës së tyre, nuk ka më spekulatorë që t'ua blejnë prodhimet lirë dhe t'ua shesin plaçkën shtrenjtë, nuk ka më ndërmjetësa.

Bujku shkon sot në arë me vullnet të plotë dhe plot besim në forcat e veta, plot besim në të ardhshmen e tij dhe të fëmijëve të tij.

Fshatarët kanë filluar të jetojnë ndryshe, të hanë mirë; kjo shpjegon edhe mungesën e prodhimeve bujqësore me bollëk në treg.

Në këtë ndryshim ata shohin konkretisht veprën e madhe të Partisë, jetën në pushtetin popullor dhe lidhen më ngushtë me të. Fakti që u përgjigjen gjithë parullave të Partisë, fakti që presin me entuziazëm planet dhe orientimet e reja në bujqësi dhe çfarëdo thirrje (68% të të rinjve që muarën pjesë në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë erdhën nga fshatrat), tregon që fshatarët tanë e kanë kuptuar mirë gjendjen e krijuar për ta dhe detyrat që u takojnë në gjirin e Republikës sonë Popullore.

Të metat në realizimin e mbjelljeve për disa kultura, vështirësitë në grumbullimin e bereqetit dhe të prodhimeve të tjera, moskorrektësia në disa raste për pagimin e taksës mbi ekonominë bujqësore, etj., nuk mund të merren si gjëra të përgjithshme. Ato e kishin burimin në vetë sistemin e grumbullimit¹, në taktin e

¹ Sistemi i grumbullimit të prodhimeve bujqësore u vendos në qershor të vitit 1946. Në bazë të tij fshatarëve u merreshin të gjitha topricat e prodhimit të drithërave. Pas Kongresit I të PKSH ky sistem u anulua dhe u vendos sistemi i ri i grum-

dobët të punës nga disa organizata tcna, në gabime në politikën e çmimeve dhe kryesisht në luftën që bëjnë kundër nesh elementët kulakë, të cilët vazhdimisht bëhen pengesë.

Orientimi që Partia i ka dhënë bujqësisë në fillim, ka qenë i drejtë. Ne patëm parasysh atë që ka thënë Lenini:

«Duket sikur kjo është një luftë vetëm për bukën; në të vërtetë kjo është luftë për socializëm»¹.

Mirëpo, pas marrëveshjes me Jugosllavinë dhe sidomos pas Plenumit VIII, ky orientim deri diku u shtrembërua.

Plani i vitit 1948 e ka mbushur këtë boshllëk që kishte filluar të lindë në bujqësinë tonë.

Zhvillimi i kulturave ka shkuar në këtë mënyrë:

Njësia e matjes: ha.

Emërtimi	1938	1944	1945	1946	1947	1948	% 1938- 1948
Sipërf. e mbjellë prej së cilës:	221030	247645	223110	263630	305000	317000	143
a) Cereale	211800	233885	211850	250300	275185	269200	127
b) Bimë industriale	2930	4300	3120	4100	13565	25120	857
c) Perime e patate	3800	3700	5040	5930	8003	11350	299
ç) Kultura për ushqim kafshësh	2500	3700	3100	3300	8247	11330	453

bullimit, i cili stimulonte fshatarët për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 546.

Pasqyra tregon jo vetëm se sipërfaqja e mbjellë është shtuar, por është shtuar sidomos edhe ajo e kulturave industriale, e perimeve dhe e bimëve për ushqimin e kafshëve. Kjo do të thotë se bujqësia jonë ka hyrë në rrugën e përmirësimit, po bëhet më produktive dhe po krijohen mundësitë e një qarkullimi më të mirë bujqësor për shfrytëzimin racional të tokës, konditë për ngritjen e pjellshmërisë së qëndrueshme nga të gjitha kulturat bujqësore, për ngritjen e forcave prodhuese dhe për shtimin e blegtorisë sonë. Dhe bujqësia nuk duhet kuptuar vetëm me kulturat e arave.

Vendi ynë për pozitën e tij gjeografike, për klimën dhe tokën që ka, lejon jo vetëm që të zhvillohen e të prodhohen tërë kulturat e arave, por lejon, me leverdi të lartë, rritjen e kulturave të ndryshme drusore. Ne kemi vende për portokalle, ullinj, hardhi e pemë të ndryshme të çdo lloji deri në gështenjat, që preferojnë klimën e malësive tona.

Mund të themi me plot gojën se jemi një vend i privilegjuar nga natyra. Për shtimin e kulturave drusore përpjekjet tona konkretizohen në:

Njësia e matjes: rrënjë

Kultura	1938	1944	1945	1946	1947	1948	% 1938- 1948
Pemë fryt.	1200000	2000000	2100000	2500000	3078000	3280000	273,38
Ullinj	1600000	1616000	1616000	1616000	1646000	1730000	108,1
Agrume	100000	102000	107000	108000	109000	110000	110
Vreshta							
Pjergull	41599537	41020000	37025000	25240000	23800000	20920000	50,4

Nga kjo pasqyrë bie në sy zbritja e kulturës së hardhisë. Kjo rrjedh jo nga mungesa e mbjelljeve, po nga dëmi i shkaktuar në vreshta nga filoksera, sidomos në Pogradec-Korçë. Për të mënjanuar dëmin e paevitueshëm të armikut të kësaj kulture, janë ngritur dhe po organizohen fidanishtet antifilokserike me një sipërfaqe 114 ha. dhe që kapaciteti i tyre i prodhimit më 1952 do të arrijë dhe do të jetë vazhdimisht 3 000 000 hardhi të shartuara në vit.

Insekte dhe sëmundje të shumta ka edhe në gjithë bimët e pemët e tjera, luftimit të cilave qeveria i ka kushtuar kujdes të veçantë. Por kjo punë mund të japë rezultate të mira vetëm me një organizim dhe mobilizim të vullnetshëm të mbarë popullit në kohë të caktuar, me anën e organizatave të Partisë. Në këta sektorë të bujqësisë ka shumë punë për të bërë. Me dhjetëra mijë ulla dhe pemë të egra mund të shartohen. Në kodra dhe në fusha ka vende të përshtatshme për të mbjellë njërën ose tjetrën pemë. Vendi ynë mund të arrijë jo vetëm të plotësojë nevojat e konsumit të brendshëm, që do të vijë duke u rritur pareshtur, por mund dhe duhet të bëjë që të eksportojë me shumicë agrume, ulla ose vajin e tyre dhe pemë të çdo lloji.

Duke marrë parasysh klimën, tokën, nivelin agroteknik në vendin tonë dhe nevojat e vendit, bujqësia duhet të orientohet në mbjelljen e cerealeve për të siguruar bukën e popullit dhe tagjinë e kafshëve. Ne nuk duhet të importojmë drithëra.

Për të shfrytëzuar mirë kushtet klimaterike të disa zonave, për të përballuar nevojat për lëndë të parë të industrisë sonë që po ngrihet dhe për eksportim të le-

verdishëm, do të mbjellim bimë industriale, që bëhen mirë te ne.

Perime dhe patate duhet të mbjellim sa më shumë, sepse mungesa e tyre është e madhe.

Klima shumë e mirë e bregdetit tonë, e përshtatshme për ullinj e agrume, duhet të na nxitë t'i shtojmë në maksimum këto kultura. Po kështu duhet të bëjmë edhe për hardhitë dhe për të gjitha llojet e ndryshme të pemëve frytore se ka vend, nga bregdeti e deri në lartësitë malore.

Për të përballuar nevojat e mëdha për ushqimin e kafshëve në planet tona të mbjelljeve, vend të rëndësishëm do të zënë bimët foragjere, në krye të të cilave është jonxha.

Përsa i përket sektorit privat të bujqësisë duhet ditur se copëtimi i tokës, nuk lejon përdorimin e mjeteve dhe të teknikës moderne, si rrjedhim përparimi i tij dhe pra, i mbarë bujqësisë është i ngadalshëm dhe i vështirë.

«Në qoftë se ekonomia fshatare mund të zhvillohet më tej — sipas Leninit — duhet të sigurohet në mënyrë të qëndrueshme edhe hapi i mëtejshëm, dhe hapi i mëtejshëm është patjetër që ekonomia e vogël dhe e veçuar fshatare, që është më e prapambetura dhe më pak e leverdishmja, duke u bashkuar dalëngadalë, të krijojë ekonominë e madhe bujqësore shoqërore»¹.

Bujqësia jonë për nevojë të strukturës së përparuar të ekonomisë zhvillohet sot në bazë të një plani të caktuar, por megjithëse shteti ka mundësinë e kontrollit

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 336-337.

në sektorin privat, përsëri mbështetja e planit mbi këtë sektor nuk është në të gjitha rastet e sigurtë.

Për të gjitha këto ne duhet të bëjmë që çdo fshatar individual të mendojë se e ardhshmeja e tij është jeta kooperativiste.

BLEGTORIA

Për shekuj me radhë, një pjesë e madhe e popullit tonë është marrë me blegtori; mbajtja e gjësë së gjallë ka qenë traditë e rrënjosur në vendin tonë. Rëndësia e blegtorisë është mjaft e madhe, se një pjesë e mirë e të ardhurave të ekonomisë së vendit rrjedh nga gjëja e gjallë. Ky sektor i ka siguruar vazhdimisht popullit ushqime dhe veshmbathje.

Konditat shoqërore, ekonomike dhe bujqësore të masave fshatare dhe të blegtorëve në të kaluarën nuk lejonin veçse një farë shtimi të numrit të blegtorisë, por jo në lartësinë kualitative të saj.

Zonat bujqësore të fushave, ku duhej të ekzistonte një blegtori prodhimtare dhe e kombinuar me një bujqësi racionale, ishin pronë e feudalo-borgjezëve. Në këto kondita të shfrytëzimit në fshat, nuk kishte mundësi zhvillimi i blegtorisë e si rrjedhim nuk mund të bëhej edhe rritja racionale e gjësë së gjallë. Bujqit dhe blegtorët e mesëm dhe të varfër ishin aq të shtypur ekonomikisht, sa që ata vetë nuk mund të bënin asgjë për blegtorinë, pasi ata nuk kishin të siguruar as bukën e gojës. Qiratë, xhelepi dhe çmimet e padrejta, të diktuar nga tregëtarët ortakë të çifliksahibinjve, u thithnin fshatarëve të ardhurat nga bujqësia dhe blegtorija; në fakt

ata ishin gjithnjë në prakun e urisë. Në këto kondita nuk mund të pritej në asnjë mënyrë një ndryshim pozitiv në blegtorinë tonë.

Këtyre vështirësive që kanë penguar zhvillimin e blegtorisë në cilësi, masat fshatare dhe blegtorët u kanë bërë ballë vetëm duke ruajtur me sakrifica të mëdha numrin e bagëtisë së tyre.

Pasuria jonë blegtorale duke u krahasuar me pasurinë blegtorale të vendeve fqinjë vihet mirë në dukje në tabelat e poshtshënuara:

Për km.2		(Statistikë e vitit 1938)			
Emërtimi	Shqipëri	Jugosllavi	Greqi	Bullgari	Itali
Gjedha	14	15	7,3	18	23
Buallica	0,8	0,14	0,45	4,34	0,04
Dhen	57	34	62	85	23
Dhi	33	7	40	12	5
Derra	4,7	10	10	11	4
Kuaj	1,9	5	2,7	5	3
Mushka	0,4	0,74	136	0,8	1,33
Gomarë	1,61	0,48	2,13	6,6	2,53
Shpendë	37	83	86	98	194

Për 1000 banorë		(Statistikë e vitit 1938)			
Emërtimi	Shqipëri	Jugosllavi	Greqi	Bullgari	Itali
Gjedha	389	267	139	308	169
Buallica	21	2,4	8,6	72	0,27
Dhen	15,67	595	1197	1467	245
Dhi	928	126	773	204	41
Derra	15	200	91	168	79
Kuaj	54	81	53	81	22
Mushka	10	12	26	3	9
Gomarë	44	8	55	20	18
Shpendë	1037	1390	1640	1640	1402

Nga analiza e këtyre tabelave, në radhë të parë na rezulton se vendi ynë është mjaft i pasur në bagëti të imta, me 2,5 krerë për çdo banor. Gjithashtu në gjedha numri për banorë është mjaft i lartë në krahasim me këto shtete. Por superioriteti i vendit tonë kufizohet vetëm në këto dy lloje të gjësë së gjallë, kurse numri i njëthundrakëve dhe i shpendëve është relativisht i ulët, ndërsa numri i derrave për frymë të popullsisë është jashtëzakonisht i vogël (Shqipëri 15/1 000, Jugosllavi 200/1000).

Rritja e derrit, që është kafshë me aftësi të madhe për prodhim mishi, është penguar nga paragjykimet prapanike të fetarëve injorantë. Me orientimin tonë të ri duhet të vëmë të gjithë kujdesjet që numri i tyre të shtohet aq sa kjo kafshë të furnizojë gjysmën e gjithë mishit që prodhon vendi ynë.

Gjatë dhjetë vjetëve 1938—1948 blegtoria jonë ka pësuar ndryshime të mëdha. Kemi pasur një pakësim të ndjeshëm në numrin e gjësë së gjallë. Dëmet e luftës kanë vazhduar gjatë gjithë kohës së okupacionit prej fashistëve, nazistëve dhe prej mercenarëve tradhëtarë të vendit.

Pastaj vjen periudha pas çlirimit, në të cilën gjëja e gjallë shtohet vazhdimisht, për të arritur vendin e mëparshëm. Ja të dhënat statistikore në këtë sektor të llogaritura në krerë:

Lloji i gjësë së gjallë	1938	1945	1940	1947	1948
Gjedha	418000	393000	397000	405000	408000
Buallica	21500	15000	16500	19000	20800
Dhen	1850000	1650000	1720000	1835000	1860000
Dhi	1000000	900000	980000	1065000	985000
Derra	25000	20000	23000	26000	25000
Njëthundrakë	123000	113000	116200	120600	126000
Shpendë	1550000	1150000	1300000	1350000	1600000
Blotë [në zgjoje]	62500	50500	51000	52000	60000

Dëmet që i janë shkaktuar blegtorisë nga okupatori dhe tradhëtarët përfaqësojnë 15-20% të kapitalit blegtoral të Shqipërisë dhe përmbledhin grabitjet, therjet e mëdha dhe dëmtimet e gjësë së gjallë gjatë përpjekjeve.

Megjithëse në përgjithësi vendi ynë paraqitet me një blegtori të madhe në numër, prapëseprapë kjo gjë e gjallë nuk ka prodhuar dhe nuk prodhon sasi të mjaftueshme prodhimesh blegtorale për të plotësuar nevojat e popullit.

Tabela e mëposhtme, vë në dukje sasinë e prodhimeve kryesore të blegtorisë që i takon çdo banori për vitin 1948:

Lloji	Njësia e matjes	Prodhimi më 1948.	Njësia e matjes	Konsumi për banorë më 1948
Mish	kv.	155000	kg.	14,2
Qumësht e nën-prodhimet e tija	kv.	1227000	kg.	122

Në të kaluarën vendi ynë konsiderohej një eksportues i këtyre prodhimeve dhe në fakt një sasi djathi, mishi dhe vezësh shkonte në tregje të huaja. Por duhet shënuar se ky eksportim nuk ishte një tepricë reale e dalur pas plotësimit të konsumit në vend, po ishte pjesa që masat punonjëse nuk mundnin ta konsumonin për shkak të konditave ekonomike të tyre shumë të vështira. Kjo shpjegon edhe faktin se tregu ynë në atë kohë paraqitej i bollshëm në prodhime blegtorale.

Në fakt vendi ynë ka pasur gjithnjë mungesë në prodhime blegtorale, në radhë të parë se gjëja e gjallë,

me gjithë densitetin e saj të lartë, paraqitet në rendiment shumë ulët. Prodhimi mesatar në qumësht i lopëve tona arrin në 300 litra në vit, i deleve 38-40 litra, kurse këtë prodhim në shtetet me blegtori pak a shumë të zhvilluar e gjejmë pesëfish në lopët dhe dyfish në delet. Pesha në mish e gjedhave tona shkon mesatarisht në 70 kg. për kokë, ajo e deleve 10-12 kg., kurse në vendet e zhvilluara në blegtori këto pesha shkojnë respektivisht në 200 kg. dhe 25-30 kg.

Mungesa e strehimit, mungesa e ushqimit si në sasi, ashtu dhe në cilësi, sidomos mungesa e rezervave ushqimore për dimër, pakujdesia në mirëmbajtjen e kafshëve, etj., sjellin si pasojë uljen e prodhimit në qumësht, mish, lesh si dhe uljen e kualitetit të tyre. Në këto kondita të vështira, bagëtia jonë është e destinuar të pësojë humbje në ngordhje, pakësim në kapacitetin e prodhimit dhe uljen e rezistencës ndaj sëmundjeve. Një faktor negativ në këtë drejtim është shterpësia, e cila megjithëse nuk tregon shenja trashëgimie, vjen nga konditat e këqia të ambientit të blegtorisë dhe pakëson pjelljen: në pela 30-45%, në lopë 20-30% dhe në dhen e dhi 10-15%.

Konditat e mbarështrimit në shumë raste, nuk janë të tilla që të favorizojnë një prodhim maksimal, siç është p.sh. praktika jo e mirë e therjes së qingjave në moshë të njomë me një peshë prej 6 kg. mish për kokë.

Duke i vështruar përciptas prodhimet e blegtorisë sonë, ngjet që, duke i krahasuar me gjënë e gjallë të racave më të mira, të nënvleftësohen pa asnjë të drejtë bagëtitë tona.

Kushtet e rritjes së gjësë së gjallë në vendin tonë

janë primitive. Rrethanat në të cilat është mbajtur ajo e kanë bërë bagëtinë tonë që të ketë një rezistencë të gjithanshme. Ajo u ka rezistuar sëmundjeve të ndryshme infektive, i ka dhënë krahë bujkut për nevojat e tija të bujqësisë, të transportit, të veshmbathjes dhe të ushqimit. Ndërsa gjëja e gjallë e vendit tonë jeton dhe prodhon në këto kondita, kafshët e racave të huaja nuk do të mund të jetonin.

Për të gjitha të metat nga pikëpamja kualitative që mendohet se i ka gjëja e gjallë e Shqipërisë, kemi shenja të cilat na tregojnë se kjo, po të bjerë në kondita më të mira trajtimi, jep prodhime më të larta dhe mund të arrijë të krahasohet shumë mirë me raca të huaja të përmirësuara.

Duke gjetur një bazë më të mirë ushqimore në livadhe të pasura, lopa e Shkodrës është zhvilluar shumë mirë në krahasim me ato të krahinave të tjera, megjithëse prejardhja e saj është e njëllotë. Kjo lopë ka përmirësuar prodhimin e qumështit dhe ka dhënë individë të dalluar (siç është një lopë e Qendrës së studimit zooteknik në Shkodër) që ka prodhuar brenda një viti mbi 2 500—3 000 litra qumësh ose 8 herë më shumë se sa lopa mesatare e zonave të tjera. Ky prodhim është i mirë jo vetëm për Shqipërinë, po për çdo vend të botës, po të merret parasysh madhësia e saj.

Një rast tjetër konkret të cilësive të larta trashëgimore të gjësë së gjallë shqiptare, e gjejmë në delen rude, e cila, duke u rritur me kujdes dhe duke pasur kullotë të mirë, është zhvilluar në drejtim të peshës trupore dhe në kualitetin e leshit, shumë më tepër se dhentë e tjerë të vendit.

Gjatë okupacionit është provuar superioriteti i kuajve tanë në krahasim me kuajt e racave të seleksionuara të ushtrive të huaja. Kuajt e vendit, megjithëse të veçjël dhe të lehtë, janë të fortë, të sigurtë në këmbë dhe me kërkese më të pakta për punën që kryejnë; ndërsa kuajt e huaj nuk rezistojnë aspak në konditat e vështira të maleve, ata të vendit kanë një qëndrueshmëri të madhe. Por, siç konstatohet nga tabela e densitetit të njëthundrakëve, kuajtë janë shumë të paktë në numër. Vendi ynë ka nevojë të madhe për kuaj, si për punime bujqësore, ashtu dhe për transport. Shtimit të kuajve t'i jepet rëndësi edhe për nevojat e Ushtrisë sonë Kombëtare. Jo vetëm që numri i kuajve në vendin tonë është i paktë, por edhe mungesa e pajimeve të tyre ka qenë një pengesë për mirëshfrytëzim të numrit të paktë që kemi.

Vlen të shënohet në këtë rast se gjedha e Mursisë ka ruajtur madhësinë dhe robustencën origjinale, pasi në Mursi ka gjetur kondita ushqimore dhe klimaterike të përshtatshme.

Partia dhe pushteti ynë popullor, duke dashur t'u sigurojë masave punonjëse kondita jetese më të mira dhe në anën tjetër, duke marrë parasysh mundësitë e mëdha që ka blegtorja e vendit për t'u përmirësuar, i kanë kushtuar një kujdes të veçantë këtij sektori të rëndësishëm dhe kanë marrë një sërë masash për përmirësimin e lartësimin e blegtorisë.

Një ndër masat e para në këtë drejtim ka qenë ajo e kufizimit dhe e disiplinimit të therjes së gjedhëve. Kjo masë e drejtë ndihmoi në shtimin më të shpejtë të gjedhëve të dëmtuar nga lufta, ndihmoi për plotësimin

e nevojave të fuqisë tërheqëse për bujqësi. Me këtë kufizim të therjes, vetëm gjedhët e pavlefshëm për prodhim dhe riprodhim shkojnë në thikë dhe si rrjedhim kemi një proces të seleksionimit pozitiv.

Reforma agrare ishte një ndër veprat më favorizuese të Partisë dhe të pushtetit për blegtorinë, megjithëse pëshpëritjet dhe parullat e të prekurve paralajmëronin një dëmtim të madh të saj. Numri i madh i bujqve, që u sistemuan në toka nga reforma, janë bërë pronarë bagëtish, që nuk i kanë pasur më parë. Ne sot shohim një shpërndarje më të drejtë të blegtorisë dhe shenjën e një shtimi të numrit të bagëtisë.

Organizimi më i mirë i shërbimit sanitar veterinar, për zbulimin dhe luftimin e sëmundjeve në mënyrë më decizive, ka kontribuar drejt përmirësimit shëndetësor të gjësë së gjallë. Ndërsa më 1933 janë vaksinuar në përgjithësi 400 000 krerë, më 1948 numri i vaksinimeve të gjësë së gjallë është rritur në 850 000 ose 212,5%. Shërbimi i Laboratorit bakteriologjik veterinar ka zgjeruar aktivitetin në prodhimin e biopreparateve, duke përballuar pjesën më të madhe të nevojave të vendit në këto prodhime. Brenda 4 vjetëve të fundit është dyfishuar numri i qendrave të pajisura me teknikë për të mbikqyrur shëndetin e blegtorisë dhe për të këshilluar masat fshatare për zbatimin e metodave më të mira të higjienës; janë shtuar trifish klinikat veterinare gjatë 4 vjetëve dhe janë ngritur ose modifikuar 6 thertore sipas kushteve të nevojshme higjienike.

Partia dhe pushteti u kanë vënë një rëndësi të madhe investimeve në favor të blegtorisë. Qysh në vitin 1946 u fillua ndërtimi i baxhove në kondita higjienike

të mira për industrializimin e prodhimeve të bulmetit. Është studjuar mungesa e ujit të pishëm për bagëti në verë dhe janë ndërtuar lera për të depozituar ujin.

Partia dhe pushteti, duke i dhënë rëndësinë e merituar problemit të njohjes së mëtejshme të cilësive të vlefshme të gjësë së gjallë shqiptare dhe me qëllim që t'i kushtohet një kujdes metodik i veçantë përmirësimit të blegtorisë, krijuan Qendrën e studimit zooteknik në Shkodër. Duke i dhënë gjithë ndihmën dhe mjetet që i nevojiten kësaj qendre, është synuar që kjo të arrijë sa më shpejt në prodhimin e damazëve dhe në konstatimin e vlefës së racave në provë kryqëzimi.

Kontrollimi funksional i gjësë së gjallë për seleksionimin sistematik po kryhet edhe në sektorin privat. Gjedhet e dalluara në rrethin e Shkodrës dhe dhinë «Saana» në qytetin e Tiranës kontrollohen rregullisht një herë në muaj.

Në fermat shtetërore, gjatë dy vjetëve të fundit janë seleksionuar, rritur dhe dërguar në zonën e Korçës qindra desh rudë për të kryqëzuar delen komune të atyre rretheve.

Kujdesi për modernizimin e bletës gjatë tre vjetëve të fundit ka qenë i madh. Punishtja e re për zgjoje bletësh ka prodhuar sasira të mëdha zgjojesh moderne për bletë. Kjo ka bërë që afro 20% e bletëve tona të shfrytëzohen në mënyrë racionale. Ndërsa gjatë gjithë regjimit antipopullor të Zogut janë vënë në përdorim rreth 300 copë zgjoje gjysmëmoderne, gjatë tre vjetëve, që nga çlirimi, ky numër arrin në afro 7 000, kurse deri në fund të këtij viti do të kemi 10 000 të tilla. Kjo masë ka sjellë një përmirësim në prodhimin e mjaltit, pasi

prodhimi i një zgjoi modern është 250% i zgjoit primitiv.

Krimbi i mëndafshit, i cili në kohët e lashta ka qenë rritur e përhapur gjerësisht si artizanat shtëpiak në vendin tonë, gjatë regjimit të Zogut dhe okupacionit u shkatërrua, se luftohej ashpër nga importimet e tekstileve artificiale. Sot Partia dhe pushteti e përkrahin këtë kulturë të thjeshtë. Është importuar farë e mëndafshit të zakonshëm, që ushqehet me gjethe mani dhe farë nga Bashkimi Sovjetik e llojit të krimbit, që ushqehet me gjethe dushku. Megjithëse në lidhje me përhapjen e kësaj kulture, jemi në fillim të punës, prapëseprapë, gjatë këtij viti në ato pak qendra, ku u zhvillua rritja e krimbit, u prodhuan rreth 130 kv. mëshikëza.

Paralelisht me këtë aktivitet të gjerë blegtoral është bërë një propagandë e mirë edhe për popullarizimin e të rejave të shkencës. Broshura, pllakata dhe fletë volante me material të thjeshtë mbi shumë probleme të blegtorisë, janë shpërndarë dhe janë punuar me kuadrot e ulët dhe me masat e gjera fshatare. Kjo punë, megjithëse e vogël në krahasim me nevojat e vendit tonë, zë një vend të rëndësishëm në faktorët nxitës të transformimit pozitiv të blegtorisë sonë.

Por masa më e rëndësishme që hap perspektiva të gjera për zhvillimin e blegtorisë ka qenë ajo që përmbysi sistemin feudalo-borgjez në blegtori. Pushteti ynë popullor, duke parë se një pjesë e mirë e gjësë së gjallë në vendin tonë ishte përqëndruar në duart e disa kapitalistëve dhe kulakëve, të cilët kishin arritur me anën e dallavereve dhe grabitjeve, të grumbullonin tufa të mëdha bagëtish, duke shfrytëzuar deri në palcë bariun

dhe duke spekuluar në kurriz të popullit me çmimet e ekzagjeruara të prodhimeve të tyre, studjoi dhe promulgoi ligjin mbi shtetëzimin e tufave të mëdha.¹

Ky ligj kaq i drejtë, sa dhe ai i reformës agrare, jo vetëm që çliroi nga skllavëria çobanët, që ishin klasa më e shtypur dhe e shfrytëzuar e vendit tonë dhe kufizoi spekulimin e pronarëve në tregun e zi në prodhimin blegtoral, po njëkohësisht krijoi një sektor të ri të ekonomisë shtetërore, duke përforcuar dhe më tepër ekonominë socialiste në sektorin shtetëror në përgjithësi.

Armiaqtë e popullit dhe të prekurit nga ky ligj u munduan të shtrembëronin qëllimin e vërtetë të këtij ligji dhe me gjithfarë parullash të tyre u përpoqën të frikësonin pronarët e vegjël dhe të mesëm, duke thënë se kjo masë do të rëndonte edhe mbi ta eventualisht. Këta shpresonin se, me alarmin e tyre, pronarët e vegjël dhe të mesëm do të dëmtonin bagëtinë, duke e shitur dhe duke e therur. Si përherë, faktet provojnë se asnjë nga parullat e tyre nuk gjeti vend në masat e gjera të popullit, i cili ka besim të plotë në masat dhe reformat e Partisë dhe të pushtetit.

Me shtetëzimin e tufave të mëdha u bë i mundshëm krijimi i ndërmarrjeve shtetërore blegtorale, të cilat sot për sot kanë rreth 100 000 krerë bagëti. Këto e mbarështrajnë bagëtinë me anën e brigadave të tyre tip. Puna në këto brigada është duke u racionalizuar në mënyrë që të jetë sa më e volitshme për barinj të dhe e përshtatshme për bagëti. Gjatë këtij viti dhe sidomos në

¹ Ligji «Mbi shtetëzimin e tufave të mëdha» u shpall nga Kuvendi Popullor më 11 maj 1948.

muajt e parë pas shtetëzimit, ndërmarrjet blegtorale kanë pasë dëme të ndishme nga sëmundjet, pasi bagëtia e grumbulluar nga burime të ndryshme solli në brigada një numër sëmundjesh.

Një nga të metat në këto ndërmarrje është organizimi i dobët i shërbimit për bagëtitë brenda brigadave, mosmbajtja në rregull e evidencave të ndryshme dhe mungesa e një pune të organizuar për ngritjen politike dhe profesionale të barinjve. Me kapërcimin e këtyre pengesave, këto ndërmarrje po bëhen shtylla të forta për përmirësimin e blegtorisë.

Spektori kooperativist në blegtori porsa ka filluar, por nuk duhet harruar se, me zhvillimin e kooperativave bujqësore, janë hapur mundësira për kolektivizimin e tufave të bagëtisë dhe, me sigurimin e konditave më të mira, bëhet i mundshëm edhe lartësimi kualitativ i saj.

Me shtetëzimin e tufave të mëdha, sektori privat blegtoral mbetet në duart e masave punonjëse, të cilat kanë të gjithë përkrahjen nga ana e pushtetit për shtimin dhe përmirësimin e gjësë së gjallë me anë stacionesh dhe të damazëve të ndryshëm.

Mungesa e ushqimeve është bërë një faktor pengues i zhvillimit të blegtorisë. Pa një bazë të shëndoshë ushqimore çdo përmirësim në blegtori do të jetë i përcipët. Duhet të zgjidhet ky problem dhe të shtohen ushqimet në mënyrë që të zbulohet i gjithë kapaciteti prodhues i blegtorisë sonë.

Në të kaluarën blegtoria ushqej në formë ekstensive. Sot një pjesë e mirë e kullotave përdoret për kultura bimore; por në këto nuk është përhapur sa duhet kultura foragjere e sidomos ajo e jonxhës.

Sot për sot, sasi të e ushqimeve që prodhohen nga bujqësia për blegtorinë janë të pakta dhe të pamjaftueshme.

Me shtimin e ushqimeve për blegtorinë do të shtohen mundësitë e rritjes kuantitative dhe kualitative të gjësë së gjallë. Nga ana tjetër shumë lëndë ushqimore shkojnë dëm për mungesë kujdesi. Lendet e lisit, të ahut dhe gështenjat e egra, sikur të shfrytëzoheshin me vend e sistematikisht, kishin për të ndihmuar shumë për blegtorinë. Vetëm me këto ushqime mund të rriteshin dhe të majeshin mijëra derra në malësitë e ndryshme të vendit tonë.

Indrustria e bulmetit, si prodhim kryesor i blegtorisë, nuk ka arritur të nxjerrë artikuj të standartizuar dhe të kualitetit të lartë. Puna e racionalizuar që po organizon shteti për këtë qëllim duhet të japë frytet që kërkohen.

Gjithë prodhimet blegtorale janë në sasira shumë të pakta në krahasim me nevojat. Për të pakësuar këtë deficit i është dhënë një rëndësi e veçantë shfrytëzimit të peshkimit.

Peshkimi, i prapambetur në të kaluarën dhe i ushtruar me metoda spekuluese nga regjimet antipopullore, sot gjen përkrahjen e Partisë dhe të pushtetit. Janë bërë investime në mjete gjuetie dhe janë përgatitur kuadro për një shfrytëzim më të mirë të ujërave tona. Janë ngritur kooperativa peshkatarësh dhe sektori shtetëror, për të parën herë, hyn edhe në lëmin e peshkimit të rëndë detar. Me vrullin që ka marrë zhvillimi i sektorit shtetëror të peshkimit po krijohen mundësitë e një prodhimi vjetor të kënaqshëm.

PYJET

A. *Vlefia e pasurisë pyjore.* — Në një vend malesh si Shqipëria, ku 34% të sipërfaqes janë vende me lartësi përmbi 900 m. nga niveli i detit, pyjet kanë një rëndësi të madhe jo vetëm për prodhimet e shumta që i sigurojnë vendit, por edhe se influencojnë mbi klimën përgjithësisht dhe përbëjnë një faktor nga më të rëndësishmit për zhvillimin e një bujqësie të përparuar.

Megjithëse për vendin tonë mungon një statistikë e saktë dhe e plotë për pyjet, nga shënimet e ndryshme, kjo pasuri përmbledhet si vijon:

Kategoritë e pyjeve	Sipërfaqe ha.	%/ mbi sipërfaqen tokësore	Fuqia lëndore	
			Materiali në këmbë m ³	Rritja vjetore m ³
Pyje produktive	529450	—	84690000	982900
Pyje të degraduara	350000	—	7875000	525000
	879450	32	92565000	1507900
Prozhme	250000	9	750000	62500
Pyje dhe prozhme	1129450	41	93315000	1570400

Këto pyje sipas natyrës dhe sipërfaqes së tyre ndahen si vijon: pyjet të larta ha. 379 450 d.m.th. 43% të pyjeve.

Pyje të ulëta ha. 500 000 " 57% të pyjeve.

shuma 879 450

pyje fletorë	ha. 641 999 d.m.th.	73% të pyjeve
pyje rrëshinorë	" 158 301 "	18% të pyjeve
pyje të përzier	" 79 150 "	9% të pyjeve

Llojet kryesore të drurëve që përmbajnë pyjet e Shqipërisë janë këto: Lisat (dushqet) e ndryshëm 38⁰/₀, ahu 26⁰/₀, pishat dhe bredhat 18⁰/₀, frashëri dhe shkoza 10⁰/₀, të ndryshëm 8⁰/₀.

Nga shifrat e mësipërme del se ç'rëndësi të madhe ekonomike përfaqëson për vendin tonë një pasuri e tillë. Në gjendjen e saj të sotme nga kjo pasuri sigurohet një prodhim vjetor prej 1 500 000 m³ dhe po të trajtohet në mbështetje të shkencës pyjore dhe të shfrytëzohet në mënyrë racionale dhe me mjete moderne, do të jepte në të ardhshmen jo shumë të largët një prodhim prej 3 500 000 m³ në vit, që do të mbulonte tërësisht nevojat e vendit që shkojnë gjithnjë duke u rritur dhe do të ushqente një eksportim materialesh druri që kërkohen në tregjet e jashtme.

Përveç prodhimeve kryesore nga pyjet tona sigurojmë edhe prodhime të dyta që vijnë:

Vallanidh (Quercus Vallonea)	prodhimi vjetor	250-300	ton.
Cërmëdëll (Rhus Cotinus)	" "	400-500	"
Qelbës (Pistacia Terebinthus)	" "	300	"
Shqindi (Pistacia Lentiscus)	" "	400	"

Prodhimet e mësipërme përmbajnë tanin për regjien e lëkurëve.

Përrall (Quercus coccifera)	" "	50	"
Pefkë (Lëvore pishe)	" "	150	"
Shelg (Salix Alba)	" "	200	"
Vërrë (Alnus Glutinosa)	" "	100	"
Rrëshina	" "	100	"
Shqopë (Brujira)	" "	600	"
Xhukë jonc	" "	500	"

Duhet pasur parasysh se me një vleftësim integral të prodhimeve pyjore mund të nxirren me anën e transformimeve kimike të tyre: krezot, aceton, acid acetik, alkool metilik, katran dezinfektant, etj.

Shënojmë se nga 1 m³ trup e degë, që nuk përdoren si dru punimi, mund të nxirren me anën e distilimit të tyre mesatarisht 110 kg. qymyr, 5 kg. alkool 85 gradësh, 20 kg. katran përveç asfaltit, yndyrna të ndryshme dhe kreozotite.

Nga gjithë këto del se sa pak rëndësi i është dhënë shfrytëzimit të gjithanshëm dhe industrializimit të kësaj pasurie kaq të vlefshme.

B. *Gjendja në të kaluarën.* — Përsa i përket të drejtës së zotërimit të pyjeve në të kaluarën, ligji mbi pyjet dhe kullotat, dekretuar më 27.V.1925, me nene të posaçme, u kishte lënë shteg klikave sunduese që të njiheshin pronarë legalë të çdo pylli të rëndësishëm.

Në mbështetje të këtij ligji, deri në çlirimin e vendit ishin njohur si:

1. Pyje private ha.	63000	d.m.th.	5%	të sipërf.	pyjore
2. " komunale "	16000	"	1%	"	"
3. " shtetërore "	1050450	"	94%	"	"
nga të cilat:					
a) Pyje	"	800450			
b) Prozhme	"	250000			

Sipërfaqja e pyjeve private shkonte gjithmonë duke u rritur dhe megjithëse përqindja e madhe e pyjeve si «toka të vdekura, që nuk janë nën zotërimin e askujt» konsiderohej si shtetërore, ajo ishte gjithmonë nën lakminë e klikave sunduese, të cilat sa herë që mendonin se prej saj mund të nxirret ndonjë përfitim, menjëherë deklaroheshin pronarë të saj dhe hynin në marrëveshje me sipërmarrës për shfrytëzim. Shtetit i liheshin pyjet më të largta, të degraduara dhe gjithë ato pyje që nuk

paraqisnin mundësi shfrytëzimi imediat. Nga të 63 000 ha. pyje të njohura private dhe që përfaqësonin pyjet më të mira dhe në kushtet më të favorshme për t'u shfrytëzuar, 99% e tyre ishin pronë e feudalëve si Zogu, Vërlaci, Vrioni, Juka, etj., kurse vetëm 1% e tyre mbe-
tej nën zotërimin e kulakëve dhe të tregëtarëve.

Kështu në Shkodër nga të 1 969 ha. pyje të njohura private, 1 887 ha. kanë qenë pasuri e Jukëve; në Elbasan nga të 6 700 ha. pyje private, 5 481 ha. kanë qenë pasuri e Vërlacit dhe në Dibër nga të 3 450 ha. pyje private, të 3 450 ha. kanë qenë pasuri e Zogut. Regjimet antipopullore të së kaluarës, duke mos dashur të njohin rëndësinë e madhe të pasurisë pyjore të vendit, nuk i kushtonin kësaj as kujdesin më të vogël. Përkundrazi, që nga kohët më të lashta të dominacionit otoman e këtej ato u kanë shkaktuar pyjeve shumë dëme të mëdha.

Sipërfaqja prej 350 000 ha. pyje të degraduara si dhe sipërfaqet e mëdha të zhveshura që paraqet vendi ynë, janë konsekuencë e prerjeve, shpyllëzimeve dhe e kullotave pa kriter si dhe e zjarreve që janë ushtruar sistematikisht e vazhdimisht në pyjet tona. S'ka dyshim se edhe nga të 250 000 ha. prozhme, një pjesë e mirë e tyre dikur kanë qenë sipërfaqe pyjesh produktive. Shumë vende, sot të zhveshura, mbahen mend nga pleqtë tanë të kenë qenë të mbuluara me pyje, por zjarret e vëna këtyre, nga ushtritë e huaja dhe nga ato mercenare të vendit tonë, kanë shkaktuar rrënimet që kemi sot.

Okupatorët nazi-fashistë mënjanë me shfrytëzime të gjera në pyje për të furnizuar ushtritë e tyre me dru punimi e dru zjarri dhe për të shtuar eksportimin në

vendet e tyre, dhe në anën tjetër me zjarret që u vinin pyjeve dhe me shpyllëzimet sistematike që kryenin me qëllim që të siguronin kalimin e autokolonave, lëvizjen e trupave dhe sigurimin e ushtrisë nga goditjet e partizanëve, kanë shkaktuar dëme kolosale në pasurinë tonë pyjore.

Afërsisht këto dëme llogariten në 15 687 ha. pyje me një vlerë prej 87 237 730 franga ari.

Shfrytëzimi i pyjeve asnjëherë nuk është mbështetur në një plan, që të kishte parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, ngritjen e industrisë, ndërtimin e hekurudhave, ndërtimet detare, etj. Ai bëhej kryesisht për dru zjarri dhe qymyr dhe nevojat e vendit plotësoheshin duke importuar lëndë nga jashtë. Kështu që kjo pasuri kaq e madhe nuk vleftësohej dhe nuk përdorej për të mirën e vendit. Aty-këtu kemi pasur vetëm disa sharra uji primitive me prodhim të ulët.

Shfrytëzimi, kur bëhej, kryhej pa asnjë kriter dhe në mënyrën më barbare. Ai kishte për qëllim të vetëm që, duke ushqyer eksportimin, t'u siguronte shfrytëzuesve kapitalistë të vendit fitime të konsiderueshme.

Për të kënaqur sipërmarrësit, që merreshin me shfrytëzimin e drurëve të zjarrit dhe për të mbushur xhepat e tyre, klikat sunduese, me qëllim gjoja të inkurajonin eksportimin e mallrave të vendit tonë, nxuarën më 23.IV.1934 një shtojcligji, që përjashtonte nga taksa prodhimet pyjore, që eksportohehin. Kështu nga viti 1935 gjer më 1938 janë eksportuar jashtë shtetit, në Itali 12 700 m³ dru punimi (dërrasa, trupa arrash, etj.) dhe 130 000 m³ dru zjarri e qymyr në Itali, Greqi, Egjipt e Tripoli. Nga prodhimet e dyta janë eksportuar 10 000

kv. vallanidh në Greqi e Itali dhe 5 000 kv. shqopë në Itali, Francë e Angli.

Në anën tjetër, për të plotësuar nevojat e vendit me dru punimi, të cilat mund të përgatiteshin nga pyjet tona, importoheshin për vit 11 000-14 000 m³ lëndë e punuar (dërrasa, binarë, etj.).

Si eksportues kryesorë të druve të zjarrit dhe të lëndëve për industri kanë qenë Spiro Kallço, Pandeli Nova, Petraq Feri, Kolë Biba, etj. prapa të cilëve fshihet Abdurrahman Krosi e kompani.

Nga viti 1925 edhe në shfrytëzimin e pyjeve, ashtu si në gjithë degët e tjera të ekonomisë, fillon hyrja e kapitalit të huaj dhe kryesisht e kapitalit italian.

Kështu shteti gjerman për të përballuar reparacionet që kishte kundrejt Francës në lëndë druri, me qëllim që të ruajë pyjet e tij dhe për të siguruar lëndë me shpenzime sa më të ulëta, me anë të shoqërisë INAG mori në koncesion për një periudhë prej 25 vjetësh shfrytëzimin e zonës pyjore «Mamurras-Mali i Bardhë-Mali Skënderbej». Edhe hekurudhat e shtetit italian me anën e shoqërisë AIBA, për të siguruar lëndë lisi për nevojat e tyre, muarën në koncesion pyllin Molungë për 5 vjet dhe për një sasi prej 12 000 m³ material druri.

Po ashtu pyjet e Drinit ju dhanë në koncesion Fuat Dibrës, i cili ja cedoï një shoqërie franceze, që nuk filloi dot shfrytëzimin e tyre.

Koncesioni i parë për rrënjën e shqopës, për gjithë Shqipërinë, u muar prej Sali Vuçiternit, i cili, pas kushedi se çfarë dallaveresh këtë koncesion ja pat ceduar shoqërisë italiane Karlo Vajsmuth e kompani. Kjo shoqëri, pas një punimi të parë që i bënte në vend, rrënjës

së shqopës, e eksportonte në Itali, Francë, Angli e gjetkë.

Shoqëria EIAA, me qëllim të caktuar për të bërë hapin e parë drejt kolonizimit, bleu nga Toptanasit pyjet e Sukthit e të Kodër-Laçit. Me shpyllëzime në shkallë të gjerë kjo shoqëri eksportoi drejt Italisë për vjete me radhë dhe më shumë në mënyrë kontrabande, dru zjarri e lëndë.

Në dhënjen e gjithë këtyre koncesioneve, dallavere të mëdha janë luajtur në kurriz të popullit dhe në dëm të vetë pasurisë pyjore.

Shfrytëzimet janë kryer në mënyrën më vandale dhe kanë rënduar përgjithësisht mbi pyjet afër komunikacioneve dhe gjatë bregdetit. Këto shfrytëzime u kanë sjellë fitime të mëdha shfrytëzuesve më fort, sepse këta kanë spekuluar në kurriz të punëtorëve të pyllit, të cilët shfrytëzoheshin në mënyrën më çnjerëzore duke u detyruar të punonin në kondita të vajtueshme.

Shfrytëzimi i pyjeve nga kapitali i huaj, përveç dëmeve materiale që i ka sjellë popullit dhe ekonomisë sonë, ka dëmtuar edhe nga ana politike, sidomos, duke i hapur rrugën kolonizimit të vendit tonë.

Regjimet antipopullore nuk preokupoheshin aspak për dëmet. Aq më pak mendonin ata për vlerësimin e pyjeve, për mbrojtjen e tyre, për përmirësimin e pyllëzimitin e vendeve të zhveshura, për ngritjen e kuadrove teknikë, për organizimin e shërbimit dhe për vënjen e bazave të një silvikulture të përparuar.

Kështu shpjegohet edhe fakti që, me gjithë shfrytëzimet që bëheshin, nuk mendohej për ngritjen e industrisë së drurit në vend dhe shfrytëzimin integral të prodhimeve të drurit.

Me okupacionin nazi-fashist kjo gjendje u keqësua edhe më fort. Shfrytëzimi u bë edhe më i rëndë. Filloi ngritja e sharrave motorike, numri i shoqërive italiane për shfrytëzimin e pyjeve u shtua, dëmet që u shkaktoshin pyjeve u bënë më të rënda.

Për leverdi të tyre okupatorët suallën sharra motorike të mëdha për të siguruar lëndën industriale për ndërtimet ushtarake strategjike. Bishat nazi-fashiste u vërsulën pa mëshirë nëpër pyjet më të çmueshme të vendit tonë, në pyjet prej pishë të zonës Kryezi, Qafë e Malit e Goskë, në Qafë Shtamë, në Llogara, në pyjet prej lisi të zonës Resheli të Librazhdit, etj., duke shkatërruar zonat më të mira pyjore, që do t'i vlenin aq shumë popullit tonë për ndërtimin e jetës së re, për ndërtimin e socializmit.

C. *Gjendja pas çlirimit.* — Pushteti popullor pas çlirimit, me të marrë fuqinë në dorë, duke e njohur rëndësinë ekonomike, klimaterike dhe shoqërore të pyjeve të vendit, mori masën e parë dhe shumë të rëndësishme: nacionalizimin e pyjeve¹. Kështu një nga pasuritë më të mëdha të vendit tonë kaloi në duart e pushtetit si pasuri e përbashkët e popullit. Pyjet u bënë pasuri socialiste. Me pyjet u shtetëzuan edhe sharrat². Lindi për herë të parë sektori shtetëror socialist në shfrytëzimin dhe industrializimin e lëndës së drurit. Ju dha fund eksplotimit të pamëshirshëm të punëtorëve, të popullit

1 Shtetëzimi i pyjeve u bë me ligjin e Reformës agrare të 29 gushtit 1945.

2 Shtetëzimi i sharrave u bë me dekretligjin e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 233 datë 18 prill 1946 me titull «Mbi shtetëzimin e maqinave bujqësore e të sharrave».

dhe të sharrave. Pyllit ju dha vendi i tij i rëndësishëm që ka për jetën dhe ekonominë e një populli dhe u krijuan mundësitë që kjo pasuri e madhe t'i shërbejë popullit të porsadalë nga lufta për ndërtimin e vendit dhe të socializmit.

Detyra më e rëndësishme në këtë situatë ju ngarkua ndërmarrjeve të sharrave për të prodhuar lëndën e nevojshme për ngritjen e urave, të rrjetit telefonik, të galerive të minierave, të shkollave, të shtëpive të djegura dhe të çdo objekti tjetër që kishin shkatërruar okupatorët. U vunë në lëvizje sharrat e dëmtuara nga lufta dhe u ngritën të tjera të reja.

Që në vitin 1945 kishim 16 sharra, 7 me motor dhe 9 me ujë që prodhonin mesatarisht 50 m³ dru punimi (dërrasa, binarë, etj.) në ditë.

Këtu poshtë po japim një pasqyrë përmbledhëse të ngritjes së këtyre sharrave, të shfrytëzimit dhe të furnizimit të tyre me lëndë druri si dhe të prodhimit të kryer gjatë viteve të fundit:

Objekti	Njësi e matjes	Vitet				
		1945	1946	1947	1948	
					parash.	realiz.
Sharra të ngritura:	numri	16	19	19	24	24
a) motorike	"	7	9	9	15	15
b) me ujë	"	9	10	10	9	9
Trupa të prerë	m ³	9174	19839	43000	77000	
Lëndë e prodhuar	"	5837	13519	17000	55000	

Pas çlirimit Partia dhe qeveria, për të përballuar nevojat e ngutshme me lëndë punimi për ndërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta si dhe për zhvillimin e industrisë dhe të hekurudhave, intensifikuan shfrytëzimin e pyjeve. Njëkohësisht ato filluan një punë siste-

matike për të bërë hapat e parë drejt një silvikulture të përparuar.

Filloi një mbrojtje e organizuar e pyjeve nga prerjet abuzive, nga zjarret, nga kullotjet e tepruara dhe nga dëmet e tjera. U hartua një program vlerësimi i pasurisë pyjore dhe filloi zbatimin e tij duke bërë,

- pyllëzime dhe sistemime malore,
- prerje dhe përmirësime në pyjet e degraduara.

Në këtë drejtim janë arritur rezultate të dukshme, të cilat janë fillimi i atyre që parashikohen të arrihen në një të ardhshme fare të afërt.

Këtu poshtë po japim një pasqyrë krahasuese të veprimtarisë në këtë drejtim, e cila vë në dukje rezultatet e arritura në sektorin e pyjeve dhe sa pak bëhej në të kaluarën në këtë sektor.

Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet					% 1938 1948
		1938	1945	1946	1947	1948	
Pyllëzim	ha.	4	—	13	240	440	11000
Sist. malore	m ³	—	—	—	—	925	—
Përmir. pyje	ha.	—	—	—	500	800	775
Fidanish. pyjore	"	4	—	8	21	31	
Pastr. pyje	"	—	—	—	10000	2000	
Fidanish. shkollë	"	—	—	—	16	21	
Ndalim kullotje	"	—	—	—	13000	101734	
Pyje mbrojtëse	"	—	—	—	1500	8025	
Luft. insekt.	"	—	—	—	—	597	
Shfryt. pyjore:							
a) dru punimi	m ³	20000	36000	50000	90000	160000	800
b) dru zjarri	mst.	1000000	1200000	1400000	1500000	1500000	150
Mbarështr. pyjesh	ha.	—	—	—	—	1250	
Inventariz.	"	—	—	—	—	25000	
Stud. pyjesh	"	—	—	—	5000	100000	
Konferenca	nr.	—	—	—	7000	3000	
Rrugë pyjore	km.	—	—	—	—	17	

U hodhën bazat e një organizimi më të përshtatshëm të shërbimit pyjor, i cili shkon duke u përmirësuar. Për këtë qëllim u ngritën dhe po ngrihen kuadrot teknike, të pajisur jo vetëm me cilësi teknike që lyp një shërbim i tillë, por edhe me cilësitë e një morali të lartë dhe sipas frymës së re. Po bëhen në këtë drejtim pregatitjet e nevojshme për të ngritur një shkollë pyjore të mesme, që është e para shkollë e këtij lloji në vendin tonë. Është zhvilluar një propagandë e gjerë për mbrojtjen e pyjeve në masat e popullit, të cilat kanë filluar të kuptojnë rëndësinë e madhe ekonomike të pyjeve.

Si rezultat i këtij veprimi mjafton të vërehen prerjet e pakta abuzive që kryhen ndër pyje, zjarret e kufizuara që vërtetohen dhe sidomos pjesëmarrja e dalluar e masave të popullit vullnetarisht, në fushatën e pyllzimeve.

Ja disa të dhëna mbi dëmet nga zjarri:

Më 1938 zjarre ndër pyje ranë në 800 ha., më 1945 — në 500 ha., më 1946 — në 240 ha., më 1947 — në 56 ha., më 1948 — në 21 ha., d.m.th. më 1948 zjarre në pyje nuk ranë as në 3% të sipërfaqes së përshtatshme më 1938.

Të mëdha ishin dhe janë nevojat për lëndë druri dhe në radhë të parë për lëndë punimi për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta, për ngritjen e industrisë sonë të re, për ndërtimin e hekurudhave të para në vendin tonë. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet fakti se përballimi i këtyre nevojave është bërë mjaft i nxituar, duke kryer shfrytëzime të tepruara në zona pyjore të kufizuara dhe më të lehta për shfrytëzim. Nuk

janë kryer prerjet e pyjeve në mbështetje të një plan-shfrytëzimi, i cili duhej të kishte si parim vazhdueshmërinë e tyre.

Në këtë drejtim e meta kryesore qëndron në mosnjohjen e pasurisë sonë pyjore dhe në mungesën e studimit mbi pyjet.

Gjithashtu ngritja e stabilimenteve për punimin e drurit, vendosja dhe kapaciteti i tyre janë parë vetëm nën prizmin e përgatitjes së lëndës së drurit për të përballuar nevojat e ngutshme pa marrë parasysh fuqinë prodhuese të pyllit. Nuk është dhënë rëndësi dhe nuk është ndjerë nevoja e madhe e çeljes së rrugëve pyjore për të përgatitur lëndë druri nga sipërfaqe pyjore të mëdha, që mbeten të pavleftësuar. Transportimi i trupave prej pyllit deri në sheshet e sharrave është bërë me mjete primitive dhe me mundime të mëdha për punëtorinë; nuk është parë aq sa duhet nevoja e mekanizimit të transportit për këtë qëllim.

Përpunimi i lëndës së drurit në asortimente të ndryshme nuk ka qenë racional; janë vërtetuar raste që nga lëndë të drurit të kualitetit të parë, janë përgatitur asortimente që mund të nxirreshin nga lëndë të kualitetit të dytë.

Vleftësimi dhe shfrytëzimi i prodhimeve të dyta nuk është bërë në sasinë e duhur.

Punëtorët e pyllit si edhe ata të sharrave nuk janë trajtuar sipas natyrës së punës së rëndë që ata kryejnë dhe janë paguar më pak në krahasim me punëtorët e tjerë që punojnë në kushte jo më të vështira se ata. Në shumë raste puna u është dhënë në formë sipërmarrjeje dhe me të njëjtin shpërblim, pa marrë parasysh

kushtet e ndryshme nga një pyll në tjetrin, duke shkak-tuar pakënaqësira ndër ta.

Ka pasur raste, ku puna në pyll u ka qenë lëshuar sipërmarrësve, të cilët kanë përfituar në kurriz të punëtorëve.

Furnizimi i punëtorëve me ushqime dhe veshmbathje si dhe banesat e tyre nuk kanë qenë organizuar si duhet. Edhe këtu ka pasur dallim midis punëtorit të stabilimentit dhe atij që punon në pyll, në dëm të këtij të fundit.

Punëtorët nuk kanë qenë pajisur me veshmbathje të posaçme dhe në masë më të madhe nga punëtorët e tjerë si e lyp natyra e punës së tyre. Nuk kanë qenë aplikuar siç duhet normat e puna me gara.

Të gjitha këto kanë penguar rritjen e rendimentin në punë nga ana e punëtorëve. Ruajtja, shtimi dhe vlerësimi i plotë i pasurisë pyjore është për ne një detyrë e madhe për të cilën brezat e ardhshëm do të kërkojnë llogari.

Nga vetë rëndësia që kanë pyjet për ekonominë e vendit, nga trajtimi dhe kultivimi i tyre në periudha të gjata dhe për t'u siguruar brezave të ardhshëm jetë të begatshme, dalin të qarta detyrat tona dhe perspektivat për të ardhshmen:

— Forcimi i organizimit të shërbimit pyjor duke plotësuar numrin e kadrove teknike dhe duke i perfeksionuar ata që janë.

— Krijimi i një legjislacioni pyjor të qartë dhe të harmonizuar nga njëra anë me nevojat e popullit dhe nga ana tjetër me kriteret më të përparuara për ruajtjen, përmirësimin dhe shtimin e pasurisë pyjore.

— Shfrytëzimi racional i pyjeve sipas normave teknike dhe çelja e një rrjeti rrugësh për të vleftësuar sipërfaqe të mëdha pyjesh që mbeten të pavleftësuar.

— Vleftësimi dhe shfrytëzimi në shkallë të gjerë i prodhimeve të dyta pyjore.

— Zëvendësimi i druve të zjarrit me qymyrguri në qendrat e mëdha të banimit për të pakësuar presionin e madh që ushtrohet me anën e prerjeve në pyjet e ulëta.

— Përmirësimi i instalimeve në sharra dhe plotësimi i tyre me impiante plotësuese për punimin racional dhe integral të lëndës së drurit dhe instalim stabilimentesh për staxhionimin dhe shtimin e qëndrueshmërisë së drurit.

— Studimi dhe inventarizimi i pyjeve më të rëndësishme për të njohur fuqinë lëndore të tyre dhe mundësitë e shfrytëzimit.

— Përpilimi i planeve të mbarështimit dhe plan-shfrytëzimit për pyjet që janë objekt shfrytëzimi.

— Trajtimi i drejtë e në baza socialiste i punëtorëve të pyllit dhe të sharrave.

— Zhvillimi i propagandës pyjore për të ngritur dhe për të ngjallur gjithmonë e më shumë ndërgjegjen e dashurinë ndër masat e popullit për pyllin.

— Përmirësimi i pyjeve të dëmtuara, pyllëzimi i vendeve të zhveshura të rrjetit rrugor, krijimi i parqeve publike dhe sistemimi i përrrenjve të dëmshëm në lidhje me bonifikimin e fushave.

— Me pyllëzimet jo vetëm duhet të shtohet sipërfaqja pyjore, po dhe të edukohen masat e popullit që ta ndjejnë një vepër të tillë, ashtu sikundër është, një detyrë që kanë brezat e sotëm ndaj brezave të ardhshëm.

DETYRAT TONA NË FUSHËN E BUJQËSISË

Shokë,

Po t'u hedhim një vështrim të shkurtër ndryshimeve historike dhe politiko-ekonomike e posaçërisht ekonomisë sonë bujqësore në vendin tonë gjatë kësaj periudhe do të shohim se, me gjithë vështirësitë, pengesat dhe luftën e ashpër të elementëve kapitalistë në fshat, Partia dhe qeveria jonë mundën t'i zgjidhin drejt problemet e ekonomisë bujqësore gjatë kësaj periudhe. Por megjithkëtë ne nuk duhet të qetësohemi dhe të mendojmë se gjithshka është kryer dhe është kryer pa gabime. Në vjetët e ardhshëm në ekonominë bujqësore na vihen përpara detyra të mëdha dhe vepra madhështore; prandaj, në rast se nuk i analizojmë gjithë të metat e gabimet tona, që janë bërë në lëmin e ekonomisë bujqësore, në rast se nuk ja nënshtrojmë kritikës dhe nuk i njohim ato gabime, ashtu siç na mëson Partia, atëherë për ne do të jetë vështirë t'i përmbushim detyrat tona në të ardhshmen.

Në ekonominë tonë bujqësore filluan të bëhen ndryshime politiko-ekonomike; ndryshohen marrëdhënjet e njerëzve ndaj tokës, ndryshohen edhe vetë njerëzit. Këto ndryshime duhet ta vënë bujqësinë tonë në rrugën e vërtetë socialiste dhe për këtë duhet të vihen përpara Partisë, për sektorin e bujqësisë, këto detyra kryesore:

— Të zhvillohet emulacioni socialist në ekonominë bujqësore, si kusht i domosdoshëm për forcimin e vendit tonë, për ngritjen e të gjithë ekonomisë sonë popullore,

për sigurimin e mëtejshëm të mirëqenjes së popullit tonë, si kusht për të shtuar elementin socialist në fshat. Në ç'rrugë do t'i zgjidhim këto?

I. Me shtimin e sipërfaqeve dhe të rendimentit:

1. — Duhet që nga viti në vit të shtojmë sipërfaqet e tokave për mbjellje, duke çelur toka të reja, duke tharë kënetat dhe moçalishte, në mënyrë që këto t'i shfrytëzojmë për mbjellje, duke shtuar sipërfaqen e vreshtave, të ullishtave dhe të kulturave të tjera nëpër bregoret e vendit tonë. Ne kemi mundësi që në 4-5 vjetët e ardhshëm t'i shtojmë sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme në më tepër se 400 000 ha.

2. — Krahas me shtimin e sipërfaqeve të mbjella, të ngremë rendimentin mesatar të arave tona në jo më pak se 25%. Kjo do të na lejojë t'i sigurojmë në të ardhshmen popullit tonë prodhimet e nevojshme bujqësore dhe bukën.

3. — Me qëllim që të sigurojmë ngritjen e hovit për shtimin e rendimentit në bujqësi është e domosdoshme të fillojmë menjëherë nga puna për organizimin e një baze të shëndoshë për farëra. Gjithashtu të studjohet imtësisht çështja e përdorimit të farërave të ndryshme në lidhje me gjendjen bujqësore të krijuar në vendin tonë.

4. — Të zgjidhet sa më parë çështja e kuadrove teknikë, e agronomëve me shkollë të mesme, etj., me qëllim që të plotësohen nevojat për agronomë, sidomos në zonat kryesore të bujqësisë.

5. — Të përhapen në fshatarësinë tonë me çdo mjet njohuritë agronomike dhe të bëhet çdo përpjekje që fshatarësia jonë të aplikojë metodat më të përparuara për punimin e tokave dhe në shërbimet për kulturat e ndryshme; të shtohet plehërimi i tokave me plehra kimike dhe natyrale.

6. — Të bëhet punë sqaruese, në mënyrë që të ngrihet e të forcohet disiplina në fshatarësinë punonjëse, për të realizuar angazhimet e marrura prej saj, për të përmirësuar punën kualitative në bujqësi, për punimin e tokave të reja, që i jepen si tokë suplementare dhe për respektimin e afateve për mbjellje, prashitje e shërbime të tjera, që të vjelë me kohë prodhimet bujqësore dhe t'i dorëzojë shtetit me kohë detyrimin e saj.

II. Zhvillimi i sektorit të kooperativave bujqësore:

1. — Të mbahet parasysh se ngritja dhe zhvillimi i këtij sektori është një punë e rëndësishme e dorës së parë për Partinë tonë. Vazhdimisht ta studjojmë, ta drejtojmë dhe ta forcojmë lëvizjen kooperativiste në fshat.

2. — Ta shtojmë punën sqaruese në fshat mbi lëvizjen kooperativiste dhe mbi rëndësinë që ka ajo dhe rolin që luan në ngritjen e mirëqenjes së fshatarësisë.

3. — Fshatarëve, që shfaqin dëshirën për krijimin e një kooperative bujqësore, t'u jepet ndihma e gjithanshme në organizimin e punës dhe pastaj në forcimin e kooperativës. Gjithashtu t'u jepet ndihma për të organizuar punimin e pronës shoqërore sipas shërbimeve

agronomike dhe t'u akordohen kreditë e nevojshme agrare. Si mjet bindës për fshatarët, të përdoret eksperiencia dhe praktika e kooperativave bujqësore që ekzistojnë.

4. — Në asnjë mënyrë të mos lejohet që të shkelet parimi i hyrjes së lirë (me vullnet) në kooperativa dhe të mos shkelen parimet demokratike në kooperativat bujqësore që ekzistojnë sot.

Në kooperativat që ekzistojnë:

a) Të eliminohen plotësisht të gjitha gabimet dhe të metat që u shkaktuan për arsye të aplikimit të statutit të mëparshëm, i cili sipas gjendjes së tij, reflektonte parimet antimarksisteleniniste të udhëheqjes trockiste jugosllave dhe ringjallte marrëdhënjet kapitaliste në kooperativat bujqësore.

b) Të forcohen kooperativat me anën e shtimit të inventarit bujqësor, të fuqisë tërheqëse, me ndërtime, me kafshë të kooperativës, me shtimin e sipërfaqeve për mbjellje dhe të rendimentit.

c) Të zhduken të metat e shpërblimit të secilit sipas tokës, papërgjegjësia personale në punë dhe barabarësia që kanë penguar ngritjen e rendimentit e të normave në punë, gjë që ka penguar zhvillimin ekonomik të kooperativave.

ç) Të hapen më mirë dyert e kooperativave që ekzistojnë sot për pranime anëtarësh të rinj nga gjiri i fshatarësisë së varfër e të mesme, që e kuptojnë dhe e përqafojnë rrugën kooperativiste. Të dënohen ato raste, kur në kooperativë nuk pranohen anëtarë të rinj, vetëm

për shkak se këta nuk kanë hyrë qysh në fillim në kooperativë.

d) Është e domosdoshme që kooperativat të pastrohen nga kulakët dhe tregëtarët, që kanë hyrë kontrabandë dhe që i minojnë ato përbrenda, duke përhapur parulla të dëmshme, helmatusese, duke bërë punë kundërrevolucionare, dhe duke hedhur parulla kundër Partisë për zhvillimin e mëtejshëm të kooperativave.

dh) Për asnjë moment të mos harrojmë se anëtari i sotshëm i kooperativës dje ka qenë fshatar individual dhe prandaj ka nevojë të domosdoshme për një edukim me frymën e besnikërisë për kauzën tonë të kolektivitetit, me frymën e interesave shoqërore të ekonomisë kooperativiste, prandaj na ngarkohet detyra që të punojmë sistematikisht e me dashuri për edukimin politik të anëtarëve të kooperativës. Të rritim e ta edukojmë aktivin tonë kooperativist dhe kuadrot drejtues të kooperativave. Këtu është çelësi i sukseseve tona kooperativiste.

III. Në ndërmarrjet shtetërore bujqësore:

1. — Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë të Partisë në ndërmarrje duhet të mobilizohen tërësisht për zhvillimin e vazhdueshëm të këtyre ndërmarrjeve, që të bëhen shembull për fshatarësinë tonë në punën shkencore të bujqësisë socialiste. Këto ndërmarrje të bëhen burim i madh jo vetëm për përhapjen e eksperiencës bujqësore socialiste, por edhe për shpërndarjen e

farërave, të damazëve dhe të prodhimeve të tjera bujqësore në fshatarësinë tonë.

2. — Duke u bazuar në mundësitë tona, të planifikojmë ngritjen e një sërë ndërmarrjesh të reja shtetërore dhe të marrim masa konkrete për zgjerimin dhe forcimin e atyre që ekzistojnë sot duke i pajisur këto me mjete dhe kuadro teknikë.

3. — Një pjesë e ndërmarrjeve bujqësore të likuidojnë prapambetjen në ekonominë e tyre me anën e një drejtimi më të mirë, të shtojnë rendimentin, të shfrytëzojnë racionalisht të gjitha tokat në bazë të një agroteknike të lartë, të shfrytëzojnë të gjitha maqineritë, mjetet dhe forcat e veta. Të organizojnë më mirë e me nikoqirllëk ndërmarrjet, duke zbatuar një regjim kursimesh në shpenzimin e mjeteve financiare dhe të materialeve, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet përmirësuese në drejtim të uljes së kostos së prodhimeve.

4. — T'i jepet fund në ndërmarrjet lëvizjes së kuadrove që shkaktohen nga një organizim jo i drejtë i punës, nga shpërblimi jo i drejtë e pa stimul, nga mungesa e sigurimit të banesave dhe të kushteve të favorshme të jetesës si dhe nga puna e dobët politike me masat. Detyra jonë është që kuadrot t'i rrënjosim në ndërmarrje, t'u krijojmë konditat e domosdoshme për jetesën e tyre dhe për punën, të organizojmë drejt punën e shpërblimit dhe të punojmë sistematikisht për ngritjen e përgjithshme të nivelit politik të punëtorëve. Të mos harrojmë se kuadrot, punëtorët definitivë në ndërmarrjet bujqësore, sikurse edhe klasa punëtore e ndërmarrjeve industriale, janë baza e Partisë sonë nga e cila kjo nxjerr forca të reja.

IV. Në punën e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve:

1. — Të zgjerohen vazhdimisht parqet e traktorëve; në bazë të këtyre të shtohen sistematikisht stacionet e maqinave dhe të traktorëve dhe të zgjerohen zonat e shërbimit. Të shfrytëzohet kapaciteti i traktorëve dhe i maqinave të tjera bujqësore për arritjen e normave të caktuara për to dhe të merren gjithë masat për arritjen dhe tejkalimin e këtyre normave. Të bëhet rregull dhe të respektohet nga ana e SMT-ve, që në radhë të parë të kryhet puna e kooperativave bujqësore, e fshatarëve të varfër dhe pastaj me radhë ajo e fshatarëve të mesëm.

2. — Të caktohet si rregull rigoroz kryerja me kohë e riparimeve të maqinerisë duke siguruar plotësisht riparimin kualitativ. Të sigurohet ndërtimi dhe kompletimi i ofiçinave riparuese me vegla e maqineri. Të zhduket papërgjegjësia personale për shërbimet në traktorë, të rregullohet organizimi i punës dhe të bëhen shpërblime të drejta. Traktorët dhe maqineritë të shfrytëzohen në maksimum, të kursehet karburanti dhe të bëhet një luftë sistematike për kursimin e shpenzimeve në SMT-të.

3. — Të bëhet një luftë e vendosur kundër punës së dobët dhe të ngrihet puna kualitative në alat sipas rregullave agroteknike të përcaktuara. Të përcaktohen mirë, në bazë të kontraktimit, detyrimet që marrin SMT-të ndaj kooperativave dhe fshatarësisë punonjëse për një punë kualitative e në afat, dhe, kur nuk plotësohen kon-

ditat e kontratos, të zbatohet e drejta e shpërblimit palës kontraktuese që dëmtohet. Gjithashtu kuadrove dhe punëtorëve të SMT-ve t'u kërkohet llogari, kur kryejnë punë të pandërgjegjshme.

4. — Zgjerimi i parqeve të traktorëve dhe të maqinave të tjera bujqësore kërkon tre-katërfishimin e numrit të kuadrove të kualifikuar në SMT-të; me kuadrot që ekzistojnë sot të bëhet një punë e paprerë për të ngritur në mënyrë të ndjeshme kualifikimin e tyre. Që të edukohen kuadrot e të arrihet ngritja e tyre, duhet të kujdesemi për to, duke u krijuar kushte të favorshme jetese.

V. Për sektorin privat:

1. — Partia dhe gjithë organizatat bazë duhet të mos harrojnë se sektori më i rëndësishëm si peshë sot është ekonomia private, individuale, jo aq produktive, por që i jep mundësi të vazhdueshme ngjalljes së kapitalizmit. Prandaj, për konditat e punës së sotme të Partisë në fshat, të kemi parasysh fjalën e Leninit të madh:

«Të dimë të biem në marrëveshje me fshatarin e mesëm — pa hequr dorë për asnjë minutë nga lufta kundër kulakut dhe duke u mbështetur në mënyrë të shëndoshë vetëm te fshatarësia e varfër...»¹.

2. — Në mënyrë sa më të vendosur duhet të kufi-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 207.

zojmë kulakët e fshatit duke zbatuar m'ërë tatimin progresiv mbi ekonominë. Të ndihmojmë fshatarët e varfër me kredi dhe mjete pune dhe të sqarojmë e të nxitim fshatarët e varfër e të mesëm që të hyjnë në rrugën kooperativiste, si rrugë e vetme për përparimin e fshatarëve punonjës. Të kemi parasysh se procesi i kalimit në kooperativizëm është i zorshëm dhe i gjatë.

VI. Në blegtori:

Krahas me shtimin e mëtejshëm të numrit në blegtori, detyrë e dorës së parë duhet të jetë për ne përpjekja për shtimin e prodhimeve blegtorale. Organizatat tona të Partisë duhet të bëjnë që në këto 2-3 vjetët e ardhshëm të krijohen gjithë kushtet që prodhimet blegtorale të shtohen, të paktën 25%. Në kooperativat dhe në ndërmarrjet shtetërore bujqësore e blegtorale kjo shtesë duhet të jetë më e lartë.

Po si mund ta arrijmë këtë? Për këtë:

1. — Të mësohen dhe të binden fshatarët për nevojën e mirëmbajtjes së kafshëve që të japin prodhime më të larta. Të bëjmë që fshatarët dhe blegtorët të sigurojnë ushqimin për gjithë vitin dhe strehë gjatë periudhës së dimrit. Të mësojmë fshatarët si të përgatiten dhe të vlerësojnë ushqimet e thata të dorës së dytë (grirje, zierje në ujë, krypje, etj.) dhe si mund të shfrytëzohen më mirë kullotat. Me këto masa sigurohen e shtohen prodhimet blegtorale 5-7%.

2. — Të përhapim sa më shumë mbjelljen e bimëve të ndryshme për ushqimin e kafshëve si të hasëlleve dhe

të leguminozeve, në krye të të cilave qëndrojnë jonxha e tërfili. Po të ecim dalëngadalë në përhapjen e këtyre bimëve, jo vetëm që pengojmë zhvillimin e blegtorisë, po dhe praktikimin e një bujqësie të përparuar e produktive në kulturat e arave. Jonxha, faktor i dorës së parë për sigurimin e ushqimit të mirë e të shumtë për bagëtinë dhe faktor shtimi i pjellshmërisë së tokës, për 2-3 vjet duhet të zërë një sipërfaqe prej 30-35 000 ha.

3. — Të bëjmë gjithë përpjekjet për përmirësimin e racave të vendit, të cilat megjithëse sot paraqiten të dobëta, kanë cilësi të rralla e janë produktive, cilësi të cilat nuk janë njohur mirë, por që duhen studjuar me hollësi. Të përdorim damazë të përmirësuar në qendra ndërzimi dhe të shtojmë rrjetin që ekziston të këtyre qendrave; të furnizojmë fshatarët, blegtorët me desh të racës rudë.

4. — Të kufizojmë humbjet në blegtori nga përçindja e lartë e sterilitetit të kafshëve dhe të pakësojmë në minimum ngordhjen e kafshëve të paralindura dhe të kafshëve të rritura. Kjo, kryesisht, mund të arrihet duke u mësuar fshatarëve mirëmbajtjen dhe duke aplikuar në masë mbrojtjen profilaktike e kurative. Të përmirësojmë e të zgjerojmë shërbimin veterinar, duke e pajisur atë me gjithë mjetet e punës. Të shtojmë numrin e laboratorëve diagnostik-veterinar dhe Laboratorin bakteriologjik-veterinar ta ngremë në një institut për studime shkencore veterinare.

5. — Të studjojmë, të gjejmë dhe të shfrytëzojmë ekzistencën e rezervave suplementare në blegtorinë tonë. Kështu p.sh. duke therur qingjat e një viti, vetëm pas 1,5-2 muaj më vonë nga ç'theren, çdo kokë do të

shtonte 5-6 kg. Kjo do të thotë që të kemi një shtesë 15-20 000 kv. mish më tepër në vit. Problemi i sigurimit të mishit është një çështje me rëndësi, por mund dhe duhet ta zgjidhim. Një ndihmë e dorës së parë është prodhimi i peshkut. Peshkatarët tanë duhet të arrijnë të nxjerrin 40-50 000 kv. peshk në vit.

6. — Të ndihmohen, duke i furnizuar me damazë të përmirësuar dhe me çdo mundësi tjetër, anëtarët e kooperativave bujqësore për të përmirësuar kafshët e kolektivizuara ose ato që i kanë në shërbim vetjak. Të jenë të preferuar në shërbimin veterinar-zooteknik dhe t'u sigurohen në radhë të parë kooperativave bujqësore kullotat më të mira.

7. — Të përmirësojmë në mënyrë të ndjeshme punën e ndërmarrjeve blegtorale të porsangritura, të shtojmë numrin e bagëtisë dhe prodhimin e tyre. Të sigurojmë rentabilitetin e të gjitha ndërmarrjeve dhe të përgatitim e të perfeksionojmë kuadrot e nevojshëm e definitivë për blegtorinë. Këto janë detyrat kryesore për organizatat bazë të Partisë në lidhje me këtë sektor.

VII. Në sektorin e ekonomisë pyjore:

Nga edukimi i popullit, nga rrënjosja e dashurisë për rritjen dhe mbrojtjen e pyjeve, varet kryesisht suksesi në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë pyjore. Prandaj, të gjitha përpjekjet tona janë të lidhura ngushtë me ato të mbarë popullit.

1. — Të rregullohet mirë administrimi i ekonomisë pyjore të vendit, të përfundohet inventarizimi i pyjeve.

Të studjohen me kujdes kapaciteti i pyjeve tona dhe shfrytëzimi i tyre, pa dëmtuar kapitalin pyjor të vendit tonë.

2. — Të merren masa konkrete për përtëritjen e pyjeve të dëmtuara nga okupacioni, në mënyrë që brenda 8-10 vjetëve të sigurohet plotësimi i sipërfaqeve me pyllëzime të reja. Për këtë qëllim të zgjerojmë fidanishtet që kemi sot e, në rast nevojë, të krijojmë fidanishte të reja. Të sigurojmë mbrojtjen e pyjeve, të evitojmë prerjen abuzive dhe të aplikojmë metodat agro-pyjore për rritjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve.

3. — Të perfeksionojmë punën e industrisë së sharrave tona, duke i pajisur ato me mjete teknike më të mira. Të ngrejme rendimentin e tyre prodhues dhe të përmirësojmë konditat e jetesës së punëtorëve pyjorë. Të bëhet me ta një punë e shëndoshë edukimi politiko-kultural. Të mobilizohen punëtorët dhe tërë punonjësit e industrisë së sharrave për arritjen dhe tejkalimin e planit të prodhimit, pasi nga zbatimi dhe tejkalimi i këtij plani varet zbatimi i planit të shumë ndërtimeve në vendin tonë.

VIII. Për kuadrot e specializuar në bujqësi:

Roli i kuadrove të kualifikuar dhe të ndërgjegjshëm është faktor i madh në përmirësimin e bujqësisë. Me kuadro të tillë do të arrihen prodhime të larta dhe do të edukohet fshatarësia për në rrugën kooperativiste-socialiste.

Ç'detyra i dalin Partisë në këtë punë të madhe për edukimin e kuadrove të specializuar?

Të bëhet një punë e madhe për edukimin politik të nxënësve, duke shtuar në ta dashurinë dhe besnikërinë për Partinë dhe popullin tonë. Për këtë:

1. — Të bëhet një rishikim i programeve që kemi sot në shkollat dhe kurset bujqësore. Të flaken nga programet, gjithë pjesët e dëmshme të kopjuara nga jashtë dhe që s'janë në frymën dhe për rrugën tonë. Të pasurohen programet me mësimet e shëndosha të Miçurinit e të akademikut Lisenko dhe, për përvetësimin e veprave të tyre, të përkthehen këto sa më shpejt në gjuhën tonë.

2. — Të praktikohen edukatorët e shkollave në kurse të veçanta e seminare për të mundur që ata të njohin dhe të përvetësojnë mësimet e shkencës materialiste sovjetike. Të shtojmë sistematikisht në edukatorët e shkollave, interesimin për të përvetësuar veprat e mëdha të Marksit-Engelsit-Leninit dhe të Stalinit.

3. — Të bëhet detyrë për agronomët, veterinerët, zooteknikët, inxhinierët e pyjeve dhe punonjësit në laboratore që të studiojnë dhe të përvetësojnë mësimet e shkencëtarëve sovjetikë dhe t'i zbatojnë në praktikë për të përmirësuar shpejt bujqësinë dhe blegtorinë tonë.

4. — Të kujdesemi për kuadrot tanë teknikë të bujqësisë, ta ndjejmë nevojën e tyre dhe t'i ndihmojmë në zgjidhjen e problemeve të tyre ekonomike, shoqërore dhe kulturele. Të nxitim dhe të stimulojmë mirë ata që dallohen në punë. Të nxitim dhe të përkrahim metodat e reja në punë dhe t'u japim tërë mundësitë punonjësve për eksperimente. Të ngrihen dhe t'u jepen përgjegjësitë që meritojnë kuadrove më përparimtarë.

Shokë,

Këto janë detyrat më të mëdha që shtrohen për t'u kryer sot e tutje nga punonjësit e bujqësisë. Ne mendojmë se këto detyra janë edhe mjaft të vështira, por me vullnetin e fortë, me abnegacionin dhe me kurajën që u jep Partia atyre dhe mbarë popullit punonjës, nën udhëheqjen e Partisë, mund të realizohen.

Në këtë mënyrë do të përparojë jo vetëm bujqësia, por mbarë vendi ynë.

TREGËTIA

Lufta kundër okupatorëve për çlirimin e Shqipërisë i la vendit tonë plagë të rënda. Për shërimin e këtyre plagëve, tregëtia duhej të luante një rol me rëndësi. Duhej siguruar buka e popullit, duhej furnizuar populli me sende të domosdoshme, duhej prerë hovi i spekulimit, duhej goditur sektori privat, që i pinte gjakun popullit, duhej ngritur dhe forcuar sektori i shtetit edhe në tregëti. Për këtë gjë qeveria jonë demokratike mori menjëherë masa.

A. Sektori shtetëror i tregëtisë. — U ngrit enti parashtetëror i drithërave, që filloi grumbullimin e tyre. Na erdhën ndihmat e para në bereqet nga Bashkimi Sovjetik. Pas Plenumit V, Partia e diktoi dhe e goditi vijën e shtrembër, të futur në tregëti nga oportunisti dhe shërbëtori i borgjezisë, Sejfulla Malëshova. Partia mori masa dhe e vuri ekonominë në rrugën e socializmit.

U aplikuan tatime të zakonshme dhe të jashtzakon-

shme. Në prill të 1946-s filluan blokimet dhe shtetëzimet e mallrave që dispononin tregëtarët e mëdhenj.

U ngrit dhe u organizua sektori i shtetit dhe ai kooperativist; u fillua një luftë e ashpër kundër sektorit privat, qoftë nëpërmjet furnizimeve më të drejta, që i bëheshin popullit, qoftë edhe me forma të tjera goditjeje. Tregëtia grosiste kaloi e gjitha në duart e shtetit. Rrjeti tregëtar detajist privat, në një pjesë të madhe u likuidua dhe u kufizua në aktivitetet e tij. Duke llogaritur qarkullimin e përgjithshëm të mallrave të konsumit direkt të viteve 1946-1947 duket qartë rritja e madhe e aktivitetit të sektorit të shtetit.

Më 1946 qarkullimi i përgjithshëm i mallrave të konsumit direkt arrinte afërsisht në 6 100 000 000 lekë; nga ky qarkullim kemi këto raporte në sektorët e ndryshëm: sektori i shtetit — 835 728 000 lekë, sektori kooperativist — 207 507 000 lekë, sektori privat — 4 904 924 000 lekë.

Ndërsa më 1947 nga qarkullimi i përgjithshëm i mallrave të konsumit direkt, që arrijnë në 5 500 000 000 lekë afërsisht, kemi këto raporte në sektorët e ndryshëm: sektori i shtetit — 2 538 000 000 lekë, sektori kooperativist — 984 000 000 lekë, sektori privat — 1 977 796 000 lekë.

Gjatë viteve 1946—1947, me mallrat që u gjetën në vend, me prodhimet e industrisë sonë dhe me grumbullimet e ndryshme, u bë furnizimi i popullit dhe i qendrave të punës, u plotësuan disa nevoja urgjente. Por me këtë gjendje mallrash, mund të bëhej më tepër, po të qenë luftuar më shumë shrrëgullimet në shpërndarjen e mallit. Mosardhja e mallrave nga Jugosllavia ka

shkaktuar mungesa të mëdha në furnizimin e popullit dhe si rrjedhim edhe masat tona punonjëse kanë duruar privacione të mëdha. Kjo gjendje ka pasur efekt shumë edhe në mosnxjerrjen e prodhimeve për treg nga fshatarët.

Problemi i tregëtisë ka një rëndësi të madhe, sepse është një pjesë e rëndësishme e planit të shtetit tonë; ky është i lidhur drejtpërdrejt me jetën e popullit tonë, me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë, prandaj duhet t'i kushtohet një kujdes i madh nga Partia dhe nga punonjësit në këtë sektor. Duhet të forcohet, të organizohet e të zgjerohet rrjeti tregëtar, që t'i shërbehet sa më mirë popullit. Kuadrot tanë duhet të fitojnë sa më tepër eksperiencë, të specializohen sa më mirë e të kryejnë me ndërgjegje detyrat që u ngarkohen.

Të furnizohen në radhë të parë qendrat e punës dhe punonjësit më të mirë të vendit. Të përfitojnë më mirë dhe më shumë, ata që i japin më tepër shoqërisë.

Organet tona duhet ta kenë vazhdimisht nën kontroll tregun privat, të mos ta lejojnë në asnjë mënyrë që të spekulojë; por duhet pasur kujdes që çdo masë kufizimi kundër tij, të jetë e studjuar.

Të bëhen përpjekje më të mëdha në mënyrë që çmimet e mallrave të konsumit për popullin të zbresin sa më shumë.

Partia jonë, duke pasur parasysh perspektivën e zhvillimit të ekonomisë dhe për të siguruar nevojat kryesore të popullit, ngriti në sistem edhe çështjen e grumbullimit të disa prodhimeve bujqësore e blegtorale. Grumbullimet kanë pasur anët e tyre pozitive. Këto kanë kontribuar në plotësimin e nevojave të popullit e të

industrisë sonë dhe kanë siguruar edhe sasira mallrash për eksportim. Në kuadrin për realizimin e grumbullimeve janë përdorur dhe janë vënë në zbatim metoda e sisteme të ndryshme, disa prej të cilave kanë qenë mjaft të përparuara, por nuk duhet përjashtuar se në sistemin e grumbullimeve janë bërë edhe gabime, qoftë në shtruarjen e problemeve nga lart, qoftë edhe në realizimin e tyre në praktikë. Influenca e trockistëve jugosllavë edhe në këtë sektor na ka futur në qorrrokak me disa metoda e masa, për të cilat ata kanë insistuar për t'i zbatuar. Nga disa njerëz sistemi i grumbullimit nuk është parë si një sistem i drejtë dhe i pandarë nga rruga jonë për në socializëm, janë bërë plane të fryra, pra të perealizueshme dhe shtrembërime në realizimin e tyre.

Çështjes së grumbullimeve Partia duhet t'i vërë kujdesin e duhur si në kuptimin e vetë problemit, si në shtruarjen dhe realizimin e planit të shtetit, ashtu edhe në marrëdhënjet me fshatin e me fshatarët, në mënyrë që grumbullimet të bëhen mjet i rëndësishëm për shtimin e prodhimit, për inkurajimin sa më tepër të fshatarësisë në qarkullimin e prodhimeve të tyre dhe për zhdukjen e kontradiktave ndërmjet fshatit dhe qytetit. Njëkohësisht të bëjmë diferencimin e elementit armik dhe kulak, të cilët duhet t'i ndalojmë që të na pengojnë dhe t'i luftojmë pa mëshirë.

Në kuadrin e tregëtisë sonë një rëndësi të madhe ka edhe tregëtia e jashtme.

Më 1945 ne krijuam marrëdhënjet e para me Bashkimin Sovjetik që qenë një ndihmë e madhe për popullin tonë. Në këto kondita të vështira të pasluftës na erdhën nga Bashkimi Sovjetik sasira të mjaftueshme

bereqeti dhe artikuj të tjerë për nevojat e industrisë dhe të bujqësisë sonë. Marrëdhënjet e drejta, që krijuam me Bashkimin Sovjetik, u shtrembëruan më vonë nga influenca e poshtër dhe nga vija grabitqare e kolonizatore e udhëheqjes trockiste jugosllave, e cila punoi sistematikisht për të na veçuar edhe në këtë sektor nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë e tjera popullore, duke na imponuar që gjithë tregëtinë tonë për importime e eksportime ta zhvillonim vetëm me Jugosllavinë.

Republika jonë Popullore tani ka marrëdhënje tregëtare me Bashkimin Sovjetik në radhë të parë dhe me shtetet e tjera të demokracisë popullore, si me Bullgarinë, Çekoslllovakinë, etj. Ndihamat e para në bereqet nga Bashkimi Sovjetik na shpëtuan nga situata të vështira. Marrëdhënjet e drejta me këto vende do të na ndihmojnë në zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë sonë. Nga Bashkimi Sovjetik do të importojmë artikuj të nevojës së parë për konsum dhe maqineri të ndryshme për ngritjen e industrisë dhe zhvillimin e bujqësisë, kurse ne do të eksportojmë prodhimet e nëntokës, që nuk i ripunojmë dot në vend dhe tepricat nga prodhimet bujqësore e blegtorale, jashtë nevojave të vendit. Të bëjmë përpjekje që të shtojmë si sasi artikujt që eksportojmë sot dhe të bëjmë ç'është e mundur të sigurojmë dhe artikuj të tjerë të rinj, që të krijojmë sa më shumë deviza për të përballuar importimet.

B. *Spektori kooperativist.* — Marrja e pushtetit në dorë nga populli krijoi kondita të favorshme për masat punonjëse të qytetit e të fshatit që të ngrejnjë organizatat e tyre kooperativiste, për t'i shpëtuar shfrytëzimit të

spekulatorëve dhe të ndërmjetësive të tregut të zi. Këto organizata gjetën përkrahjen direkte të Partisë sonë dhe të pushtetit popullor.

Pas çlirimit u krijuan kooperativat e konsumit në radhë të parë dhe të shitblerjes më vonë, të cilat kanë pasur si detyrë të organizonin shpërndarjen e ushqimeve dhe të artikujve industrialë, të krijonin burime të reja me prodhime bujqësore dhe blegtorale, me punimin dhe konservimin e tyre, të luftonin për uljen e çmimeve e të kostos, për përmirësimin e jetës së masave punonjëse të qytetit e të fshatit dhe mbi të gjitha të zhvillonin një luftë të vendosur kundër sektorit privat spekulator. Në këto organizata masat e gjera të qyteteve kanë gjetur një mbështetje efektive në përmirësimin e jetës së tyre.

Me gjithë influencën e dëmshme, të huajtur nga Jugosllavia, kooperativat gjatë këtyre viteve u zhvilluan dhe u zgjeruan mjaft. Sot në gjithë qytetet e vendit tonë ka kooperativa konsumi dhe bashkime kooperativiste. Në kooperativat e konsumit numërohen 31 057 anëtarë me 158 429 frymë.

Kooperativat e shitblerjes në fshat aktivitetin e tyre e filluan me shpërndarjen e artikujve industrialë. Më vonë ato praktikuan dhe zgjeruan aktivitetin e grumbullimit të artikujve bujqësorë e blegtoralë. Sot kooperativat e shitblerjes përfshijnë 66% të popullsisë sonë fshatare. Shpejtësia me të cilën u ngritën dhe u zgjeruan këto kooperativa, tregon sa e shëndoshë qe përkrahja që gjetën këto organizata në masat punonjëse të fshatit.

Aktiviteti i kooperativave do të ishte akoma më i madh dhe roli i tyre do të ishte më pozitiv, në qoftë se

do të furnizoheshin më mirë. Kështu ato do të plotësonin më mirë nevojat e popullit dhe do të favorizonin edhe grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Në këtë sektor ka edhe të meta të tjera. Kooperativat e konsumit në qytete dhe ato të shitblerjes në fshat janë konsideruar si dyqane të thjeshta dhe jo si organe ekonomike të vetë masave. Kooperativat e konsumit dhe të shitblerjes duhet të zhvillojnë një luftë të ashpër kundër sektorit privat dhe të luajnë rolin aktiv në forcimin e ekonomisë sonë të re. Ato duhet të ndihmohen dhe të inkurajohen në tërë aktivitetin e tyre nga sektori i madh i shtetit dhe të shtrihen në gjithë lokalitetet.

ARËSIMI POPULLOR DHE KULTURA

Socializmi dhe demokracia lindin kulturën më të lartë nga kultura kapitaliste. Ai është destinuar që të krijojë bollëkun jo vetëm në anën materiale, por dhe në kulturën intelektuale, e cila duhet të ushqejë me përmbajtjen e saj të lartë ideologjike, gjithë popullin, gjithë punonjësit e shoqërisë socialiste.

Njerëzit e shoqërisë socialiste, si na mësojnë klasikët e marksizëm-leninizmit, duhet të jenë njerëz me kulturë, me ideale të larta, me kërkesat dhe shijet e larta kulturore dhe morale, duhet të qëndrojnë më lart se njerëzit e qytetërimit borgjez, jo vetëm nga pikëpamja morale, po dhe nga pikëpamja mendore.

Partia Komuniste e Shqipërisë, që në ditët e para të çlirimit të vendit tonë, në çështjen e zhvillimit të kulturës dhe të arësimit ka shkuar pas rrugës dhe ekspe-

riencës së madhe të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, pas rrugës së Bashkimit të madh Sovjetik.

Pak kohë para Revolucionit të madh socialist të Tetorit, në vitin 1913, Lenini tregonte se Rusia cariste ishte një nga shtetet më të prapambetura të Evropës nga pikëpamja kulturale.

«... katër të pestat e fëmijëve dhe të të miturve në Rusi nuk përfitojnë nga arësimi popullor!!»¹

shkruante Lenini.

Si rezultat i Revolucionit të Tetorit dhe i udhëheqjes gjeniale të Leninit dhe të Stalinit në BRSS u zhvillua revolucioni i madh kultural, që ka transformuar vendin në një nga shtetet më të përparuara të botës nga pikëpamja kulturale. Lenini thoshte:

«Më parë, gjithë mendja e njeriut, gjithë gjenia e tij krijonte vetëm për t'u dhënë disave të gjitha të mirat e teknikës dhe të kulturës dhe për t'ua hequr të tjerëve më të domosdoshmen — arësimin dhe zhvillimin. Kurse tani të gjitha mrekullitë e teknikës, të gjitha realizimet e kulturës do të bëhen pasuri e gjithë popullit, dhe tani e tutje kurrë ndonjëherë mendja dhe gjenia e njeriut nuk do të shndërrohen në mjete dhune, në mjete shfrytëzimi»².

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 19, f. 137.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 537.

Dhe ne shohim se kultura sovjetike, që zhvillohet në bazë të ideologjisë përparimtare të marksizëm-leninizmit, është një fuqi kolosale në duart e masave punonjëse, në luftën e tyre për paqen dhe për ndërtimin e komunizmit.

Popullin shqiptar shekuj të tërë e mbanin në errësirë e në padituri. 500 vjet turqit vepronin në Shqipëri, sikur të ishin zotër të vendit, duke mbjellë «kulturën» e tyre. Ata u zëvendësuan nga imperialistët e shteteve të tjera, pastaj okupatorët fashistë italo-gjermanë.

Populli ynë që gjendej nën zgjedhën e rrëmbyesve imperialistë dhe klikës feudale antipopullore të Zogut, nuk kishte mundësi të krijonte dhe të zhvillonte kulturën e tij, artin, muzikën dhe letërsinë kombëtare.

Më tepër se 80% e të gjithë popullsisë së Shqipërisë ishte analfabete. Me qëllim që fëmijët e katundarëve të mos mundnin të hynin në shkollën e mesme, ku mësonin fëmijët e klasave të privilegjuara, ekzistonte shkolla fillore katërvjeçare e katundit, kurse në qytetet shkolla fillore, që ishte kursi pesëvjeçar i të mësuarit, u jepte mundësi nxënësve që të vazhdonin studimet e tyre në shkollat e mesme.

Pagesa e lartë e taksave shkollore, konkuret dhe pengesat e tjera pengonin fëmijët e masave punonjëse që të hynin në shkollat e mesme.

Në Shqipërinë e vjetër, mësuesi ishte një krijesë e përbuzur. Sipas një qarkoreje të Ministrisë së Arësimit në vitin 1938, kontrollimi i punës së shkollës i ngarkohej xhandarit analfabet; po ai ngarkohej që të vërente sjelljen e mësuesve.

Çdo krahinë e veçantë arësimin fillor e kishte rre-

gulluar në një mënyrë më vete, prandaj nuk është e rastit që në qarkun e Gjirokastrës p.sh. për çdo 1 000 banorë, shkollën e ndiqnin 88 nxënës prej tyre 55 djem dhe 33 vajza, kurse në Shkodër që ishte qendër e reaksionit klerikalo-bajraktar, për çdo 1 000 frymë e ndiqnin 17 nxënës prej të cilëve 1 vajzë.

Gjatë 18 vjetëve, që nga viti 1920 deri në vitin 1939 në Shqipëri ishin shtuar vetëm 190 shkolla fillore. Në vitin 1939 në Shqipëri numëroheshin 5 biblioteka me 25 000 vëllime, po edhe këto libra, që në më të shumtën e rasteve ishin me përmbajtje antipopullore, mund t'u shërbenin vetëm intelektualëve borgjezë dhe përfaqësuesve të klasave të privilegjuara.

Kështu qëndronte puna në Shqipërinë e mëparshme.

Pas mbarimit të Luftës nacional-çlirimtare dhe pas përforcimit të rendit të ri popullor demokratik, në Shqipëri funksionet e punës kulturele edukative fitojnë gjithnjë rëndësi më të madhe. Në plan të parë vihen problemet e arësimit të edukatës ideo-politike të masave popullore, të pajisjes së tyre me teoritë revolucionare marksiste-leniniste dhe të zhvillimit të shkencës. Plo-tësimi i këtyre detyrave kërkon nga populli i Shqipërisë një tension të madh krijues dhe kapërcimin e vështirësive serioze.

A. Arësimi popullor. — Sikurse dihet, baza e zhvillimit të kulturës është para së gjithash organizimi i arësimit popullor. Themeluesit e marksizëm-leninizmit e shikonin gjithnjë shkollën si armë të rëndësishme në çështjen e luftës për çlirimin e masave punonjëse. Marksizëm-leninizmi prej një kohe të gjatë ka demaskuar legjendën hipokrite të borgjezisë mbi karakterin e arësi-

mit dhe të shkollës apolitike që, sipas tyre, qëndron përmbi klasat dhe mbi partitë.

«Arësimi, — thotë shoku Stalin, — është arma, efekti i së cilës varet prej atij që e ka në duar dhe nga ajo, se cilin duhet të godasin me këtë armë»¹.

«Detyra jonë në fushën e arësimit, — thoshte Lenini në vitin 1918, — është e njëjta luftë për përmbysjen e borgjezisë; ne deklarojmë hap-tazi se shkolla jashtë jetës, jashtë politikës, është gënjeshtër dhe hipokrizi»².

Në udhëzimet dhe dokumentat kryesore të Leninit dhe të Stalinit ne shikojmë se detyrat e arësimit përcaktohen në transformimin e shkollës nga armë e dominimit të klasës së borgjezisë, në armë të zhdukjes së plotë të ndarjes së shoqërisë në klasa, në armë të ndryshimit komunist të shoqërisë.

Në fjalimin e tij gjeneral programatik në Kongresin III të Komsomolit në vitin 1920 Lenini caktoi dallimin parimor të shkollës sovjetike nga shkolla e vjetër e kohës para revolucionit dhe tregoi nevojën e shfrytëzimit kritik të kulturës së vjetër.

Duke folur mbi rëndësinë e përvetësimit sistematik dhe me këmbëngulje të dijenive, Lenini theksonte se:

«Komunist mund të bëhesh vetëm atëherë, kur ta kesh pasuruar mendjen tënde me njoh-

¹ J. V. Stalin, «Çështje të Leninizmit». Bot. X rus., f. 610.

² V. I. Lenin, Veprat, vëll. 28, f. 83.

jen e të gjitha diturive që ka përpunuar njerëzimi»¹.

Që të mos kishte shkëputje midis shkencës dhe jetës, midis teorisë dhe praktikës, Lenini kërkonte një rregullim të tillë të arësimit, që do të mësonte rininë të aplikonte në jetë dijet e fituara dhe që të merrte pjesë aktive në ndërtimin e jetës së re.

Shkolla duhet të jetë përqesja e ideve dhe e parimeve të politikës së Partisë, e detyrave dhe e qëllimeve të saja në masat punonjëse; ajo duhet të rrënjosë parimet e reja socialiste të edukimit, duhet të edukojë fëmijët e të gjitha shtresave të të gjithë popullsisë në bazë të këtyre parimeve, duhet të luftojë kundër çfarëdo ideologjie të huaj për ne dhe kundër influencës së huaj mbi fëmijët. Këto janë udhëzimet kryesore të shkencës marksiste-leniniste në çështjet e arësimit, të cilat ne nuk duhet t'i harrojmë.

Si qëndron puna në fushën e arësimit popullor?

1. — Detyra e parë qëndronte në atë që, për t'u bërë arësimi plotësisht i mundshëm për popullin, duhej që ky të merrej duke filluar nga shkolla e ulët fillore, deri në institutin e lartë mësimor.

Të mësuarit u bë pa pagesë dhe i mundshëm për të gjitha masat punonjëse, pavarësisht nga gjinia e tyre, gjendja materiale, pavarësisht nga besimi, i lirë nga paragjykimet dhe besimet e kota.

Rrjeti shkollor dhe numri i nxënësve në shkollë rritej në mënyrë të furishme.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 320.

Në vitin 1938 kishte 643 shkolla fillore, në të cilat mësonin më pak se 1/4 e fëmijëve të moshës shkollore, rreth 52 024 nxënës dhe mbaronin shkollën vetëm shumë pak, kurse në vitin 1945 d.m.th. në vitin e parë pas çlirimit të Shqipërisë, ne kemi 928 shkolla fillore me rreth 78 000 nxënës; në vitin 1947 numri i shkollave fillore u rrit në 1 755 me 140 000 nxënës, kurse në vitin 1948 numri i shkollave arriti në 1893.

Gjithashtu rritet disa herë rrjeti i shkollave shtatëvjeçare dhe të mesme. Në vitin 1948 ne kemi 107 shkolla shtatëvjeçare dhe 18 shkolla të mesme. Në disa rajone malore çelen shkolla verore dhe, në ato qendra banimi ku akoma nuk paraqitej mundësia për të çelur shkolla, u vu në praktikë metoda e mësuesve shetitës.

Gjatë këtyre viteve u ndërtuan qindra ndërtesa të reja shkollore. Për fëmijët që banojnë larg nga shkollat, pranë shkollave hapen konvikte, ku me bursa shtetërore mësojnë nxënësit, që nuk kanë shkollë në vendet e tyre të lindjes.

Kushtet e favorshme, që u krijuan si rezultat i çlirimit të Shqipërisë, për zhvillimin e arësimit popullor, dhanë mundësi që t'i afrohem realizimit të njërës prej fitoreve më të rëndësishme të revolucionit kultural — zbatimit të detyrimit shkollor të përgjithshëm fillor në qytete dhe në katunde.

Shoku Stalin, në fjalimin e mbajtur në Kongresin XVI të PK(b) të BS ka thënë:

«Gjëja kryesore tani është të kalojmë në arësimin fillor të detyrueshëm. Them «kryesore», se

*pse një kalim i tillë do të ishte një hap vendimtar në çështjen e revolucionit kulturor*¹.

Nga 2 602 në 2 378 qendra të banuara të Shqipërisë, është zbatuar detyrimi shkollor i përgjithshëm fillor, duke përfshirë 93,7% të fëmijëve të moshës shkollore në vitin 1947—1948. Ky është një realizim i madh i popullit tonë.

Një dëshmi e qartë, që tregon kujdesin e madh të shtetit për arësimin popullor janë fondet, që caktohen për nevojat e kulturës dhe të arësimit.

Në vitin 1946 pushteti popullor shpenzoi për arësimin popullor 47 929 410 franga.

Për një vit e 9 muaj, 1946—1947, për arësimin popullor dhe për kulturën ishin caktuar 310 681 831 lekë; edhe më shumë u shtuan shpenzimet në vitin 1948; shpejt u ndryshua edhe karakteri i shpenzimeve për nevojat e arësimit. Tani u shfaqën artikuj krejtësisht të rinj të shpenzimeve si për sigurimin material të nxënësve, për punën shkencore, për pajisjen e mjetet mësimore, për tekstet dhe për të tjera. Ndërkaq, në vitin 1938—1939 për arësimin ishin caktuar 2 735 000 franga nga 3 727 850 franga që ishte shuma e përgjithshme e shpenzimeve për nevojat kulturele. Nga ky fond, për shkollat e fshatit, ku jeton 82% e gjithë popullsisë së vendit, ishin caktuar vetëm 1 298 000 franga, kurse vetëm për shpenzimet e oborrit të Zogut ishin caktuar 678 000 franga.

Shkolla e vjetër nuk ishte unike. Ekzistonin gjim-

¹ J. V. Stalln. Veprat, vëll. 12, f. 291-292.

naze shtetërore dhe private, progjimnaze, shkolla fillo-re, fetare, etj. e secila prej tyre kishte afate të ndryshme të të mësuarit, duke mos qenë lidhur në unitet me shkollat e tjera. Shkollat gjendeshin nën influencën e këtyre ose atyre grupeve reaksionare e imperialiste, angleze, franceze, italiane, katolike, muslimane, etj.

Programet nuk ishin të detyrueshme për shkollat dhe kurrë nuk realizoheshin. Secili mësues përdorte tekstet që i pëlqenin. Problemi i shkollës popullore qëndronte në atë: që të realizohej parimi i shkollës unike.

Sistemi ynë i arësimit popullor, pas reformës së zbatuar në vitin 1946—1947, i jep mundësi secilit shtetas të vendit tonë të shkojë pa pengesa prej shkallëve më të ulëta të arësimit në më të lartat. Është vendosur tipi i vetëm i shkollës me një afat mësimi: fillorja katër vjet, shtatëvjeçarja shtatë vjet, duke përfshirë edhe katër vjet të fillores dhe shkolla e mesme me një afat prej katër vjetësh. Pranimi në shkollë është vendosur prej moshës shtatë vjeç.

Është bërë unifikimi i programeve; programet mësimore janë ligji i jetës shkollërore dhe të njëjta për të gjitha shkollat, për këtë ose atë lëndë e klasë.

Programet e shkollës së tanishme parashikojnë për nxënësit njohuri më të thella, më të gjera dhe më të gjithanshme se sa ato që jepte shkolla e vjetër.

Shkenca e lartë, uniteti i teorisë me praktikën që edukojnë të mësuarit në nivelin e lartë ideologjik, janë ato parime me rëndësi dhe shenja dalluese të shkollës së re, të cilën ne po e krijojmë.

Duke hequr të panevojshmet: mësimin e fesë, gjuhën latine, greqishten e vjetër, të ashtuquajturën shken-

cë «Mbi jetën», etj., i është dhënë kujdes i madh të mësuarit thellësisht të gjuhës amëtare dhe letërsisë, matematikës, fizikës, kimisë, historisë, gjeografisë, biologjisë dhe kushtetutës.

Në këtë vit shkollor në të gjitha shkollat e mesme hyri të mësuarit e marksizëm-leninizmit dhe të gjuhës ruse. Në të gjitha mësimet, duke marrë parasysh specifikën e tyre, bëhet te nxënësit formimi i botëkuptimit dialektik materialist, edukohen te ata shprehjet e arësyetimit dialektik.

Një pjesë e pashkëputur e punës mësimore-edukative e shkollës po bëhet puna jashtë klasës e jashtë shkollës me nxënësit, gjë që nuk ka qenë në shkollën e vjetër. Puna jashtë klasës dhe jashtë shkollës është një mjet me rëndësi për edukimin komunist të fëmijëve. Ajo plotëson dhe zhvillon njohuritë e nxënësve që i kanë marrë gjatë mësimeve, u jep atyre shprehitë e punës shoqërore, i largon prej rrugëve dhe prej sjelljeve të këqia.

Një nga problemet kryesore në fushën e arësimit popullor ishte nevoja e riorganizimit rrënjësor të shkollës, e ndryshimit parimor të krejt veprimtarisë së saj, e ndryshimit të përmbajtjes ideologjike të arësimit shkollor. Shkolla duhej bërë me të vërtetë revolucionare, e dalluar parimisht prej çdo shkolle të shtetit borgjez.

Lenini ka thënë:

«...në vend të studimit të vjetër mekanik, të mënyrës së vjetër për t'i mësuar gjërat përmendësh, të disiplinës së vjetër të shkopit ne duhet të vëmë zotësinë për të përvetësuar gjithë

diturinë njerëzore, dhe ta përvetësojmë në mënyrë të tillë, që komunizmi të mos jetë për ne diçka e mësuar përmendësh, por të jetë një gjë që e keni mësuar ju vetë, një gjë që përfaqëson ato konkluzione që janë të pashmangshme nga pikëpamja e arësimit të sotëm»¹.

Shkollës i janë paraqitur kërkesa historike: të edukojë njerëz të zhvilluar nga të gjitha anët, me arësim të lartë e të kulturuar, besnikë të pakufi për atdheun e vet dhe për popullin, që të dinë të lidhin teorinë me praktikën dhe t'i aplikojnë njohuritë e tyre në jetë.

Natyrisht, shkolla nuk mund t'i zgjidhë këto probleme, në qoftë se ajo nuk do të rindërtojë në mënyrë rrënjësore përmbajtjen e punës së vet.

«...krahas me transformimin e shoqërisë së vjetër kapitaliste — ka thënë Lenini në fjalimin e mbajtur në Kongresin e tretë të Komso-molit — arësimi, edukimi dhe formimi i brezave të rinj, që do të krijojnë shoqërinë komuniste, nuk mund të mbeten ashtu siç ishin»².

Shkolla jonë është thirrur të edukojë njeriun e ri, të çliuar prej psikologjisë skllave të shoqërisë kapitaliste, njeriun me vullnet të palëkundur, të ndershëm, që nuk ka frikë prej vështirësive dhe që di t'i përballojë ato.

A mund vallë ne ta rindërtojmë shkollën në këtë mënyrë?

Gjatë këtyre vjetëve në këtë drejtim është bërë

¹ V. I. Lenini. Veprat, vëll. 31, f. 321.

² V. I. Lenini. Veprat, vëll. 31, f. 315.

një punë e madhe; janë punuar dhe u janë dhënë shkollave programet e reja, tekstet, orientimi metodik mbi dhënjen e mësimit, është organizuar puna me arësimitarët, është vendosur me një mënyrë tjetër kontrolli i tyre.

Mirëpo, kjo punë në esencën e saj, sapo është filluar dhe deri tani është bërë shumë pak.

Cilësia e të mësuarit dhe puna e të edukuarit të shkollarëve vazhdon të mbetet akoma në një nivel shumë të ulët ideologjik dhe shkencor. Shkaqet kryesore janë niveli i ulët ideo-politik dhe shkencor, si dhe pregatitja metodike e dobët e arësimitarëve.

Një nga konditat vendimtare të sigurimit të cilësisë së punës të shkollave është problemi i kuadrove pedagogjike.

Lenini ka thënë:

«Mësuesi popullor duhet të ngrihet në vendin tonë në një nivel të atillë, që nuk ka qenë, nuk është dhe nuk mund të jetë kurrë në shoqërinë borgjeze»¹.

Shoku Stalin duke ngritur dhe duke vlerësuar lart rolin e mësuesve ka theksuar që:

«Falanga e mësuesve popullorë përbën një nga pjesët më të nevojshme të ushtrisë së madhe të punonjësve të vendit tonë, që po ndërtojnë jetën e re mbi bazën e socializmit»².

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 520.

² J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 3.

Mësuesve u është besuar një punë e shenjtë dhe shumë e çmuar, edukimi i brezit të ri, që po rritet, dhe kanë fatin të ndihmojnë në punën e madhe të ngritjes arësimore të punëtorëve. Problemi ynë kryesor është ta ngremë mësuesin, ta bëjmë atë një nga ndihmësat tanë të parë, ta çlirojmë mësuesin prej paragjytimeve të vjetra, me frymën e të cilave ai edukohej dhe në radhë të parë ta çlirojmë atë prej paraqitjes hipokrite të shkollës apolitike.

Pjesa më e madhe e mësuesve ka filluar detyrën në shkollë pas çlirimit të Shqipërisë. Në vitin 1938—1939 ne kishim jo më shumë se 1 400 mësues. Prej 3 100 mësuesve të shkollave fillore që kemi tani, vetëm 800 kanë arësimin e mesëm pedagogjik, më shumë se 1 300 mësues kanë arësimin shtatëvjeçar ose 2-3 klasë të shkollës së mesme dhe afro 1 000 të tjerë kanë vetëm arësimin fillor. Prej 143 mësuesve të shkollave të mesme, 48 vetë kanë arësimin e lartë të mbaruar ose të pambaruar.

Duke marrë parasysh gjendjen dhe nivelin e ngushtë pedagogjik dhe politik të arësimitarëve, duhet të bëhen përpjekje të mëdha për ta përmirësuar këtë situatë. Ministria e Arësimit duhet të organizojë studimin me korrespondencë të arësimitarëve, që nuk kanë arësimin e nevojshëm; gjithashtu duhet t'u japë ndihmë të madhe dhe të nevojshme metodike dhe duhet të ngrihet me të madhe përpara mësuesve eksperiencia e pasur e shkollës sovjetike. Nga ana tjetër Ministria e Arësimit dhe komitetet ekzekutive nuk kanë treguar kujdesin e nevojshëm për konditat dhe nevojat e jetesës së mësuesve. Organizatat lokale të Partisë nuk i kanë kushtuar kuj-

desin e nevojshëm edukimit politik të përditshëm të arësimtarëve ose janë marrë fare pak me të.

Partia jonë duhet të kërkojë me këmbëngulje prej organizatave lokale të Partisë dhe prej Ministrisë së Arësimit përmirësimin vendimtar dhe të shpejtë të krejt punës për edukimin dhe përgatitjen e kuadrove pedagogjike.

Mësuesi shqiptar duhet të kuptojë me kthjelltësi dhe me vetëdije parimet kryesore të shkollës së re, duke u bazuar në eksperiencën e shkollës sovjetike. Për këtë do të duhet të mësojë dhe gjuhën ruse. Mësuesit duhet të jenë pjesëtarë aktivë të punës së madhe shoqërore-politike dhe kulturalo-arësimore në mes të popullit dhe të fitojnë dashurinë dhe respektin e popullit tonë.

Pikësëpari mësuesit i duhet sqaruar se ai nuk mund të edukojë njeriun e pjekur politikisht për idealet e tij dhe për përpjekjet e tija në mënyrën e tij të arësytimit, pa pasur lidhje me realitetin që e rrethon, pa pasur lidhje me ato probleme, të cilat vihen përpara nesh. Që të luftojmë ato pikëpamje që janë të huaja për ideologjinë socialiste, për popullin dhe që janë në luftë me gjithë qëndrimet jo të shëndosha dhe reaksionare, që mund të ekzistojnë në arësytimet e nxënësve, mësuesi duhet t'u edukojë nxënësve bindje politike dhe pikëpamje gjatë procesit të punës. Në krejt veprimtarinë edukative të nxënësve, mësuesit duhet të kenë të qartë favorizimet e rendit politik, që ekziston në Shqipëri dhe perspektivat socialiste të çlirimit të tij, progresivitetin dhe revolucionin e ideve të asaj rruge, në të cilën po ecën Bashkimi Sovjetik dhe popujt e demokracive popullore, duke theksuar humanizmin e madh të këtyre

ideve. Njëkohësisht duhet të zbulojmë para rinisë gjithë kalbësirën e rendit borgjez kapitalist, gënjeshtërinë e ideve të tij, gënjeshtërinë e lavdërimit të demokracisë kapitaliste dhe të bëhet luftë e të zhduket nga ne kultura reaksionare borgjeze e Evropës Perëndimore.

Gjithashtu një rëndësi të jashtzakonshme ka organizimi i arësimit profesional-teknik. Mungesa e kuadrove të kualifikuar është një nga vështirësitë serioze të ndërtimit dhe të zhvillimit të vendit tonë.

Përveç 815 studentëve, që ndjekin shkollat e larta jashtë atdheut, në Bashkimin Sovjetik dhe në vende miq të demokracive popullore, u ngrit për herë të parë në vendin tonë Instituti i lartë pedagogjik, i cili ka degën e gjuhës e të letërsisë, të historisë, të gjeografisë, të matematikës, të fizikës, të biologjisë dhe të kimisë.

Pas çlirimit u krijuan dhe u zhvilluan shkollat e mesme profesionale e teknike. Tani ne kemi në Tiranë shkollën teknike me 488 nxënës, teknikumin financiar ekonomik me 211 nxënës, teknikumin e gjeometrave me 61 nxënës, shkollën artistike muzikore me 111 nxënës, shkollën sportive me 35 nxënës, shkollën mjekësore me 54 nxënës dhe shkollën e bujqësisë me 230 nxënës. Përveç këtyre në 8 shkolla të tjera profesionale me një afat mësimi prej 2-3 vjetësh (bujqësore, industriale, etj.) mësojnë 703 nxënës.

Një rëndësi të jashtzakonshme ka likuidimi i analfabetizmit dhe arësimi i të rriturve. Sikundër dihet në Shqipërinë e vjetër 83% e krejt popullsisë ishte analfabete. Gjatë viteve të kaluara në bashkëpunim të gjerë me organizatat e masave është zhvilluar një punë e ma-

dhe për zhdukjen e analfabetizmit. Në vitin 1945—1946 numri i analfabetëve në moshën 14-40 vjeç ishte afërsisht 317 000 vetë. Gjatë vitit 1945—1948 janë regjistruar në kurset kundër analfabetizmit 233 342 vetë nga të cilët kanë mësuar 109 189 vetë.

Siç duket, me gjithë rezultatet e mira, me një përpjekje dhe punë më të organizuar, mund dhe duhet të arrihen përpjekje më të mëdha, duke pasur parasysh dëshirën dhe entuziazmin e madh që shprehin masat për të mësuar.

Përveç kurseve për zhdukjen e analfabetizmit u krijua dhe një rrjet shkollash të natës për të rriturit. Në vitin 1946 nga këto shkolla mbaruan 10 010 vetë. Në vitin 1947—1948 ka 570 shkolla fillore nate me 21 350 nxënës, 26 shkolla shtatëvjeçare me 2 059 nxënës dhe 3 shkolla të mesme me 338 nxënës. Por në punën e tyre këto shkolla kanë pasur mjaft të meta dhe nuk i është kushtuar kujdes i duhur, si nga ana e organizatave tona të Partisë, ashtu dhe nga ana e organeve të arësimit popullor e të organizatave të masave.

Kujdesi për edukimin fizik e moral të fëmijëve është bërë një çështje shtetërore, shoqërore dhe e Partisë. Për herë të parë i është dhënë rëndësi organizimit të edukatës parashkollore të fëmijëve. Organizimi i rrjetit të instituteve parashkollore si kopshtet e fëmijëve, etj., zgjidh problemin e rëndësishëm të pjesëmarrjes së gruas në prodhim dhe hedh baza të shëndosha për edukimin shpirtëror dhe fizik të fëmijës.

Dëshiroj të them disa fjalë mbi udhëheqjen e punës së arësimit popullor.

E meta kryesore në punën e Ministrisë së Arësimit qëndron në atë që udhëheqësit dhe punonjësit e arësimit popullor nuk kanë përvetësuar seriozisht doktrinën e njohur të Leninit mbi udhëheqjen, nuk dinë të dallojnë problemet kryesore dhe vendimtare, nga zgjidhja e të cilave varet sukcesi i gjithë punës dhe nuk dinë të mobilizojnë në to punonjësit e arësimit. Mërrin tepër me çështjet e vogla të përditshme aktuale dhe nuk përqëndrohen e nuk nxjerrin në plan të parë problemet kryesore politike e pedagogjike, janë lidhur pak me arësimin e masave, nuk marrin parasysh dhe nuk shfrytëzojnë eksperiencën e mësuesve dhe të shkollave përparimtare.

Të gjitha këto ngjajnë për shkak se udhëheqësit e arësimit popullor, nuk studjojnë thellësisht dhe çdo ditë teorinë marksiste-leniniste, veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, pedagogjinë sovjetike si një shkencë të re sovjetike mbi edukimin dhe mbi të mësuarit e fëmijëve...

Organizatata tona të Partisë kanë treguar pak kujdes për punën praktike të shkollave dhe të organeve të arësimit popullor, nuk kanë ndrequr me kohë gabimet e punonjësve të arësimit popullor dhe ngandonjëherë u kanë dhënë drejtime jo të drejta.

Në udhëheqjen e punës së arësimit popullor si edhe në çdo çështje tjetër duhet të mos harrohen mësimet e shokut Stalin, i cili thotë:

«Të drejtosh mirë, do të thotë:

*së pari, të gjesh zgjidhjen e drejtë të çështjes. . .
së dyti, të organizosh zbatimin e zgjidhjes së drejtë . . .*

së treti, të organizosh kontrollin e zbatimit të kësaj zgjidhjeje ...»¹.

Partia jonë duhet të shqyrtojë çështjen e shkollës, si çështje politike dhe gjithë punën në shkollë si një pjesë e luftës sonë për ndërtimin e socializmit.

B. Ngritja kulturale e masave. — Para çlirimit të Shqipërisë puna kulturale-edukative në masat e popullit, ka qenë shumë e ulët. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare në çetat partizane dhe në zonat e çliruara formohen grupe të ndryshme si teatrale, korale dhe muzikore, organizohet rrjeti i agjitorëve të cilët luanin një rol të rëndësishëm në zhvillimin kultural të masave.

Pas çlirimit të Shqipërisë u formuan intsitucione të ndryshme kulturale e arësimore si shtëpi kulture, biblioteka, salla leximi, grupe teatrale, etj. Në këto qendra kulturale janë organizuar shfaqje dhe ekspozita, janë mbajtur konferenca e referate që u kanë shërbyer mijëra njerëzve. Por duhet theksuar se deri tani këto qendra nuk kanë marrë zhvillimin e nevojshëm dhe nuk e kanë kryer si duhet rolin e tyre shumë të rëndësishëm, nuk kanë mundur akoma të bëhen qendra të vërteta kulturale dhe t'u shërbejnë gjerësisht masave.

Një zhvillim të mirë ka marrë veprimtaria teatrale e amatorëve. Kolektiva teatrale lindën jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra. Për të përgatitur udhëheqësit e këtyre kolektivave janë ngritur kurse të posaçme.

Zhvillimi i punës së bibliotekave dëshmon rritjen e kulturës së popullit. Biblioteka qendrore kombëtare

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 133.

në qytetin e Tiranës gjatë vitit të fundit ka shtuar fondin e librave në 65 000 ekzemplarë dhe tani ka 130 858 vOLUME librash.

Në vitin 1946 kishte 6 biblioteka me 96 219 ekzemplarë; në vitin 1947 kishte 10 biblioteka me 132 634 ekzemplarë dhe më 1948—186 686 ekzemplarë. Në vitin 1947 ishin dhënë 79 834 libra për lexim, kurse gjatë 7 muajve të vitit 1948 janë dhënë 75 682 libra. Në vitin 1947 në fshatra u krijuan 72 biblioteka dhe në vitin 1948 numri i tyre u rrit në 373.

Në nëntorin e 1945-s u krijua organizata e parë e shkrimtarëve, Lidhja e Shkrimtarëve që ka dhe organin e saj «Literatura jonë». Një drejtim të mirë mori puna letrare e Lidhjes së Shkrimtarëve pas Konferencës së dytë të shkrimtarëve, që u mbledh në qershorin e 1946-s. Që prej kësaj kohe gjithnjë më shumë bëhet i theksuar drejtimi i ri në letërsi, lufta për ideologjinë socialiste, për realizmin socialist, duke përdorur eksperiencën e rrugëve të zhvillimit të letërsisë sovjetike.

Një rol të madh luajti për ne në këtë drejtim vendimi i Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike, referati i shokut Zhdanov mbi revistat «Ylli» dhe «Leningrad». Shoku Zhdanov thotë: «*Leninizmi niset nga parimi: se letërsia jonë nuk mund të jetë apolitike, nuk mund të përfaqësojë në vetëvete «artin për art», por është thirrë të realizojë një rol përparimtar dhe të rëndësishëm në jetën shoqërore*». Dhe më poshtë shoku Zhdanov thotë: «*A na përshtatet neve, përfaqësuesve të kulturës sovjetike përparimtare, patriotëve sovjetikë, roli i përlules para kulturës borgjeze? Ose roli i nxënësve? Natyrisht letërsia jonë, që pasqyron një rend më të lartë se çdo*

rend tjetër demokratik-borgjez një kulturë shumë herë më të lartë se sa kultura borgjeze. ka të drejtë t'u mësojë të tjerëve moralin e ri të mbarë njerëzimit».

Në tematikën dhe në përmbajtjen e veprave letrare duken tema të reja mbi patriotizmin e ri, mbi heroizmin e popullit në luftë e në punë, mbi dashurinë për atdhe dhe për popull, mbi miqësinë dhe vëllazërimin me popujt e tjerë progresistë dhe në radhë të parë me popujt e Bashkimit Sovjetik.

Një influencë të madhe ka letërsia sovjetike, të cilën populli ynë gjithnjë më shumë e më shumë po e njeh, e do dhe e çmon. S'ka dyshim se letërsia sovjetike duhet të ndriçojë rrugën e letrarëve tanë. Gjatë kohës së kaluar ishin përkthyer dhe shtypur libra, po tani janë përkthyer e po përkthehen veprat më të mira të letërsisë sovjetike...

Por akoma nuk është çdo gjë në rregull në punën tonë në frontin letrar; shumë prej letrarëve tanë merren pak me punën krijuese dhe, nuk janë ndihmuar, edukuar e inkurajuar sa duhet shkrimtarët e rinj.

Ngritja politike e kulture e masave matet mjaft dhe nga ngritja e tirazhit të shtypit.

Në Shqipërinë e vjetër botoheshin pak gazeta e revista dhe kishin një tirazh të vogël, që nuk kapërcente të 8 000 kopjet.

Në vitin 1948 dalin më shumë se 25 gazeta e revista me një tirazh prej 1 milion ekzemplarë e ky tirazh vjen duke u ngritur. Kështu p.sh. gazeta «Bashkimi» në vitin 1945 kishte një tirazh mesatar 4 700 copë në ditë, në vitin 1946 u rrit në 14 000 copë, në vitin 1947 në 17 000 copë dhe tani në 27 000 në ditë.

Instituti i studimeve shkencore, i krijuar pas çlirimit të Shqipërisë ka 65 bashkëpunëtorë dhe përbëhet prej: 1) Seksionit të gjuhës dhe të letërsisë; 2) Seksionit të historisë, të sociologjisë dhe të ekonomisë; 3) Seksionit të shkencave të natyrës; 4) Biblioteka. Ky institut ka marrë përsipër mjaft studime dhe veprimtaria e tij e re po zhvillohet në degë të ndryshme. Po është e nevojshme të shënohet se puna shkencore e institutit sapo zhvillohet. Prandaj, ka nevojë për një ndihmë të madhe. Instituti nuk u është afruar akoma plotësisht çështjeve aktuale të zhvillimit të ekonomisë popullore të Shqipërisë dhe të shfrytëzimit të pasurive të saj. Zhvillimit të punës shkencore Partia duhet t'i kushtojë më shumë kujdes.

Duke u mbështetur në eksperiencën e teatrit sovjetik u krijua dhe u zhvillua në vendin tonë Teatri popullor shtetëror. Krahas tij lindi nevoja e ngritjes së nivelit kulturalo-arësimor, ideo-politik dhe profesional i aktorëve.

Teatri është bërë mjaft popullor në vendin tonë... Gjithashtu janë organizuar koncerte muzikore. Një përhapje të gjerë ka marrë folklori i pasur i vendit tonë. Janë krijuar këngë të reja mbi Luftën nac.-çl. të popullit tonë dhe mbi punën e tij sot.

Kinemaja në vendin tonë luan një rol kryesor në ngritjen e kulturës së masave. Filmat sovjetikë kanë luajtur rolin kryesor në tërheqjen e masave të gjera të popullit në këto qendra të rëndësishme edukative dhe kulturele.

Siç dihet, sporti gëzon një popullaritet të madh në vendin tonë. Po, duke marrë parasysh rëndësinë e kul-

turës fizike dhe të sportit, si një mjet edukativ me rëndësi për forcimin fizik të brezit të ri, për edukimin e njerëzve të shëndoshë dhe me vullnet, Partia, qeveria, organizatat e masave dhe sidomos organizatat fiskulturale duhet t'i japin fiskulturës akoma një hov më të madh. Ato duhet t'i kushtojnë një kujdes më të mirë organizimit e zhvillimit të fiskulturës dhe sportit në masat e popullit, po sidomos në të rinjtë.

Partia Komuniste e Shqipërisë i jep një rëndësi të jashtzakonshme zhvillimit të të gjitha formave dhe të të gjitha llojeve të punës kulturele e arësimore, politike, edukative e shkencore, zhvillimit të arësimit popullor, të edukatës dhe të mësuarit të fëmijëve. Mendimet e shokut Stalin të shfaqura për kulturën revolucionare dhe socialiste, për përvetësimin e teknikës, për edukimin e moralit komunist dhe patriotizmit, mbi sjelljen komuniste ndaj punës, do të jenë për ne udhëheqje dhe program për veprim, i adaptuar në konditat tona nacionale dhe sipas kërkesave të popullit tonë.

SHËNDETESIA

Pas çlirimit, shteti dhe Partia i dhanë rëndësi të veçantë mbrojtjes së shëndetit të popullit që ishte dëmtuar rëndë, sidomos nga vuajtjet dhe privacionet e mëdha të kohës së luftës. U muarën masat e para: u ngrit aparati i nevojshëm, punonjësit e shëndetësisë u bënë nëpunës të shtetit, u ngrit një shërbim mjekësor falas, farmacitë u shtetëzuan¹. U organizua lufta kundër së-

¹ Farmacitë private u shtetëzuan me dekretligjin e Pre-

mundjeve kryesore: malarjes, tuberkolozit, sifilizit dhe sëmundjeve epidemike, që dëmtojnë rëndë shëndetin e popullit dhe si konsekuencë ulin dhe fuqinë e tij prodhuese. U muarën masa për mbrojtjen e nënës dhe të fëmijës. U hodhën bazat e legjislacionit tonë sanitar mbi parime shkencore e demokratike.

Sukseset kanë qenë të çmueshme: është ngritur një rrjet i gjerë institutesh profilaktike e kurative; numri i spitaleve nga 8 me një kapacitet prej 810 shtretër, që ishte më 1938, arriti në 12 me 2 180 shtretër, përveç 29 spitaleve rurale; janë ngritur sanatoriume, maternitete, poliambulanca e ambulanca në numër të madh, preventoriume dhe çerdhe fëmijësh.

Lufta kundër sëmundjeve që janë plagë sociale, ka pasur rezultate. Lufta kundër malaries ka marrë proporcione të konsiderueshme dhe infeksioni malarik në popull ka zbritur nga 60% në 41% dhe vazhdimisht po zbret. Masat profilaktike kanë shpëtuar nga infeksioni malarik punëtorët dhe rininë tonë në kantieret e ndryshme, sidomos në hekurudhën Durrës-Peqin e Durrës-Tiranë.

Po bëhet depistimi sistematik i tuberkulozit e i sifilizit si në të rritur dhe në fëmijë; njëkohësisht janë marrë edhe masa kurative. Hapja e instituteve të reja dhe përmirësimi i gjendjes sonë ekonomike që do të ngrejë nivelin e jetesës së masave tona punonjëse, do

sidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 242 datë 20 prill 1946: «Mbi shtetëzimin e farmacive private, produkteve farmaceutike, mjeteve dhe laboratorëve të tyre.

të kontribuojnë mjaft në luftën kundër këtyre sëmundjeve të rrezikshme.

Me masat energjike që janë marrë, sëmundjet ngjitesë dhe epidemike, si tifua ekzantematike dhe tifua abdominale janë pakësuar në minimum. Është luftuar gjithashtu me sukses difteriti dhe lija ndër fëmijët.

Një kujdes i madh i është kushtuar mbrojtjes së mëmës dhe fëmijës. Të kujdesohemi për mëmën dhe fëmijën, sepse andej varet e ardhshmja e popullit tonë. Organet e pushtetit, në bashkëpunim me organizatën e gruas ta kenë kurdoherë parasysh këtë problem të madh të shtetit dhe të Partisë sonë.

Janë marrë masat e para për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve tanë duke përmirësuar konditat e tyre të punës dhe të jetesës.

Higjiena e popullit, në përgjithësi, është akoma shumë e ulët. Ligji mbi higjienën e sendeve ushqimore dhe të lokaleve publike është një masë me rëndësi. Edhe në këtë sektor ka përmirësime, po mbetet akoma një punë shumë e madhe për t'u bërë në këtë drejtim, sidomos për edukimin sanitar të masave të gjera të popullit. Këtu mund të ndihmojnë me dobi organizata e gruas, e rinisë si dhe Kryqi i Kuq.

Pushteti ynë popullor ka pasur suksese edhe në përgatitjen e kuadrove mjekësorë, mungesa e të cilëve ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Ne kemi marrë masa për t'u bërë ballë nevojave imediate: kemi çelur shkolla për infermiere, për mami, për laborante, për radiologë, për agjenta shëndetësorë dhe për kryepunëtorë të luftës kundër malaries. Sot ne i plotësojmë nevojat tona të domosdoshme me kuadro të ulët mjekësorë, që kanë da-

lë nga këto shkolla. Sivjet u hap edhe shkolla trevjeçare, e cila do të nxjerrë ndihmësmjekë të aftë. Kemi dërguar jashtë shtetit 115 studentë për mjekësi. Një ndihmë të çmuar po na japin mjekët sovjetikë, të cilët, së bashku me mjekët shqiptarë, punojnë me dashuri për të mjekuar të sëmurët tanë.

Kemi pasur dhe kemi akoma mungesa prodhimesh farmaceutike. Po edhe në këtë lëmë kemi bërë përpjekje: për herë të parë në vendin tonë këtë vit u ngrit një laborator farmaceutik, që është bërthama e industrisë farmaceutike në Shqipëri.

Problemi i shëndetit të popullit meriton gjithë kujdesin tonë. Ky është i lidhur me tërë zhvillimin e jetës sonë të re, me realizimin e planit të shtetit, me ngritjen e ekonomisë sonë, me ndërtimin e një jete të gëzuar e të lumtur për masat punonjëse të vendit. Në këtë sektor na shtrohet si detyrë që ta organizojmë e ta forcojmë sa më shumë luftën kundër sëmundjeve, po njëkohësisht të forcojmë masat profilaktike dhe higjienën e popullit në qendra pune, në fshat e në qytet, të zhvillojmë edukatën sanitare të popullit tonë, të shtojmë e të perfeksionojmë kuadrot tanë të mjekësisë dhe t'i orientojmë nga shkenca marksiste-leniniste, të shtojmë e të modernizojmë institutet tona shëndetësore.

FORCIMI I PUSHTETIT POPULLOR TË KËSHILLAVE

Me anën e Luftës nacional-çlirimtare, u rrëzua pushteti i vjetër i regjimeve antipopullore si në esencë, ashtu edhe në formë. Regjimi i vjetër shtypës u zëv-

ndësua me regjimin e popullit. Në kohën e luftës u shembën format e pushtetit të komuneve, nënprefekturave dhe prefekturave, në të cilat populli nuk kishte aspak të bënte, po ishin të gjitha organe të regjimeve shtypëse, regjimeve të xhandarit dhe të të emëruarve nga pushteti qendror, i cili i kishte ngritur apostafat për të nënshtruar krejt popullin, për t'i nxjerrë taksat, për të rekrutuar me forcë popullin në milici, me një fjalë për të ruajtur interesat e reaksionit dhe të borgjezisë. Pushteti i vjetër u vu i tëri nën shërbimin e regjimeve antipopullore e fashiste, por lufta e popullit tonë e dënoi këtë dhe vendosi pushtetin e tij popullor. Forma e këtij pushteti të ri të popullit ishin këshillat nacional-çlirimtare, që gjatë gjithë kohës së luftës kanë luajtur njëkohësisht rolin e vetëqeverisjes së popullit dhe ndihmësit kryesor të luftës. Në Mbledhjen e Beratit, kur u krijuan më vete organizatat e Frontit Nacional-Çlirimtar, nën udhëheqjen e Partisë, këshillat nacional-çlirimtare, që më vonë u quajtën këshilla popullore (me çlirimin e plotë të Shqipërisë) muarën gjithë funksionet e pushtetit popullor. Në kohën e luftës, populli ynë i ngriti këto këshilla sipas direktivave të drejta të Partisë dhe mori pjesë gjerësisht në to. Këshillat muarën me të vërtetë formën më demokratike, në to u zgjodhën njerëz të popullit, nga më të mirët, nga shtresat e punëtorisë dhe të fshatarësisë së varfër dhe të mesme si dhe patriotë të tjerë, që mbronin interesat e vërteta të popullit dhe ndihmonin me të gjitha forcat e tyre për zhvillimin dhe forcimin e luftës. Për herë të parë në jetën e saj vegjëlia kishte organet e veta të pushtetit, ku në to shprehej lirisht dhe me anën e tyre mbronin interesat e saja ve-

tjake. Kuptohet vetëvetiu që detyra kryesore e këshillave nacional-çlirimtare gjatë kohës së luftës ishte të ndihmonin luftën, të krijonin bazën materiale për luftën, të rekrutonin popullin në rreshtat e Luftës nacional-çlirimtare dhe të propagandonin gjerësisht çështjen e luftës kundër okupatorit, si atë politike, ashtu dhe atë të armatosur. Por përveç kësaj këshillat nacional-çlirimtare nuk munguan të kryenin edhe detyrën e qeverimit në të gjitha zonat e çliruara. Nën kujdesin e këshillave, u çelën nëpër fshatra shkolla fillore dhe kurse kundër analfabetizmit; këshillat zgjidhnin çështjet që dilnin në fshat, bënin ligje, jepnin dhe vendime, pajtonin gjaqet, etj. Në këtë drejtim këshillat nacional-çlirimtare kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe. Me çlirimin e plotë të Shqipërisë, Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, që u zgjodh në Kongresin e Përmetit me atributet legjislative dhe ekzekutive, ishte Kuvendi Popullor Provizor, i cili e qeveriste Shqipërinë e re, me anën e Komitetit Antifashist dhe të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, e cila u emërua në Mbledhjen e dytë të këtij këshilli në Berat. Detyrat e Këshillit Antifashist dhe të Qeverisë Demokratike pas çlirimit, ishin të stabilizonin gjendjen e krijuar nga lufta, të ndërmerrenin rindërtimin e shpejtë të vendit, të krijonin nga të katër anët këshillat nacional-çlirimtare dhe të pregatisnin zgjedhjet e përgjithshme të popullit, për të thirrur Asamblenë Kushtetuese, për të vendosur përfundimisht formën e regjimit dhe për t'i dhënë Shqipërisë së re Statutin themeltar. Pas rimëkëmbjes së fillimit, Partisë dhe pushtetit tonë ju vu përpara detyra për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese dhe përgatitja e aprovimi i Statutit themel-

tar të shtetit tonë të ri. Fitoret e popullit duhej të konsakroheshin me Statutin themeltar. Bazat e demokracisë popullore dhe të Republikës sonë u hodhën në male, në luftën e përgjakshme kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Thirrja e Asamblesë Kushtetuese, shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe aprovimi i Statutit, përfaqësonin aspiratat e popullit tonë. Partia dhe qeveria ja përmbushën këto dëshira. Më 2 Dhjetor të vitit 1945, ditën e zgjedhjeve që ka një rëndësi të madhe historike për popullin tonë, populli votoi lirisht për të zgjedhur përfaqësuesit e tij dhe, i pjekur politikisht gjatë luftës së madhe të çlirimit, ai diti ta përdorë si duhet të drejtën e votës. Në regjimet e kaluara ai e kishte humbur këtë të drejtë, sepse ligjet elektorale ishin anti-popullore dhe antidemokratike; vullneti i popullit shkelej nëpër këmbë dhe ekzistonte vetëm kërbaci i prefekteve dhe i nënprefekteve. Por më 2 Dhjetor të vitit 1945 populli zgjodhi njerëzit e tij dhe u caktoi këtyre detyrat. Porosia e popullit u krye dhe u shpall Republika Popullore, regjimi i vegjëlisë, që përfaqësonte aspiratat e popullit, interesat e idealet e masave punonjëse. Asambleja Kushtetuese aprovoi Statutin themeltar, që ishte një nga statutet më përparimtare të botës. Ai konsakron parimin se pushteti ynë buron dhe i takon popullit, dhe ky parim në Republikën tonë Popullore nuk është formal. Në një vend ku populli dhe Partia është në fuqi, sovraniteti i popullit është një realitet. Statuti ynë konsakron parimin e zgjedhjeve të lira dhe votimin direkt, të përgjithshëm, të barabartë dhe të fshehtë. Në bazë të këtij parimi të madh demokratik janë bërë zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese dhe më vonë zgjedhjet e

këshillave popullore të lokaliteteve dhe të rretheve. Statuti konsakron parimin e revokimit të përfaqësuesve të popullit nga ana e zgjedhësve dhe populli e ka përdorur këtë të drejtë kundër gjithë atyre armiqve që punonin në dëm të interesave të tij. Statuti caktoi të drejtat e shtetasve dhe vuri garanci për respektimin e tyre. Statuti hodhi bazat dhe është burimi i legjislacionit tonë të ri.

Me aprovimin e shpalljen e ligjit themeltar të Republikës sonë Popullore u caktuan në formë definitive këshillat popullore si bazë dhe si organe të pushtetit popullor. Këshillat popullore janë organe të pushtetit në lokalitet dhe në rreth dhe organizata të fuqishme, me të cilat Partia dhe shteti organizojnë udhëheqjen shtetërore. Me anën e këshillave popullore Partia jonë lidhet me masat e gjera punonjëse në fushën e aktivitetit shtetëror. Organizimi i këshillave popullore shkoi duke u zhvilluar dhe duke u përmirësuar. Ky organizim, megjithëse ishte sipas konferencave të Pezës, të Labinotit, të Kongresit të Përmetit dhe të Mbledhjes së dytë të Beratit, nuk ishte i plotë. Pas çlirimit u shkua në modernizimin e këtij pushteti dhe në shtimin e detyrave dhe të kompetencave të këshillave popullore dhe të komiteteve të tyre ekzekutive në kondita të reja, pse përpara këshillave popullore, që ishin organet e pushtetit popullor, shtroheshin detyra të rëndësishme. Ato duhej të bëheshin armë e fortë në duart e Partisë dhe të pushtetit të popullit për zhdukjen e mbeturinave të fashizmit, për çarmatosjen e reaksionit dhe të borgjezisë, për ngritjen e ekonomisë popullore, për drejtimin e shumanshëm të vendit; ato duhej të bëheshin armë e fortë

për ndërtimin e socializmit. Pjesëmarrja e popullit nuk duhej të kufizohej vetëm në zgjedhjet e këtyre këshillave, por të shtrihej edhe në administrimin efektiv të punërave të tyre.

Për këtë arsye zgjedhja e këshillave të reja në njësitë administrative lokale ishte e nevojshme. Zgjedhja e këshillave të reja do të ndryshonte dhe përbërjen e tyre shoqërore. Në organet lokale të pushtetit tonë kishin arritur të infiltronin dhe elementë armiq, kulakë të fshatit, që bëheshin pengesë për mbarëvajtjen e punës së këshillave dhe për zbatimin e ligjeve dhe të reformave tona. Elementë të tillë ka akoma në këshillat popullore, por vrulli i punës dhe lufta e pamëshirshme duhet t'i flakë jashtë. Në këshillat duhet të hyjnë njerëz të ndershëm, besnikë për kauzën e popullit dhe të dalë nga gjiri i tij, që kanë luftuar pa u kursyer për popullin. Atje duhet të vijnë punëtorë, fshatarë të varfër e të mesëm dhe patriotë, luftëtarë të vjetër e të rinj të kauzës së socializmit.

Kuvendi Popullor pak kohë pas shpalljes së Statutit, aprovoi ligjin mbi këshillat popullore dhe më vonë ligjin mbi zgjedhjet e këtyre këshillave. Në zgjedhjet e 15 dhe 22 shkurtit të këtij viti pjesëmarrja e popullit ka qenë dërmuese: 98-99,5% dhe për Frontin Demokratik kanë votuar 99% të votuesve. Në votimet e 15 shkurtit janë zgjedhur për këshillat popullore të lokaliteteve 13 415 përfaqësues të popullit dhe zëvendës nga të cilët 705 gra. Në zgjedhjet e 22 shkurtit janë zgjedhur për këshillat popullore të rretheve 4 520 anëtarë dhe zëvendës nga të cilët 309 janë gra dhe përbërja e tyre shoqërore është punëtorë, fshatarë, zanatçinj dhe në-

punës. Sipas ligjit mbi këshillat popullore ne kishim këshilla në lokalitete, në rrethe dhe prefektura. Ky ligj parashikonte edhe këshilla popullore të komuneve. Po eksperienca e punës provoi se kjo ndarje administrative bëhej një pengesë e madhe për realizimin e rolit udhëheqës të organeve qendrore dhe për zhvillimin e iniciativës së këshillave lokale në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe në zbatimin e urdhërave dhe të udhëzimeve të dhëna nga lart. Pushteti qendror ishte larg nga populli. Me ligje të veçanta u suprimuan prefekturat dhe komunet dhe puna shkon shumë më mirë. Patjetër duhet të bëhen përmirësime të tjera për modernizimin e pushtetit tonë popullor, të ngushtohet edhe pak numri i rretheve duke u bashkuar sidomos komitetet e rrethit dhe të qytetit në një të vetëm, në mënyrë që të bashkohen më fort dhe më ngushtë masat punonjëse të qytetit me fshatarin e varfër dhe të mesëm.

Këshillat tona popullore të ngrihen mbi parimin e shëndoshë të centralizmit demokratik, sepse këto drejtojnë jetën e lokaliteteve në rreth dhe duhet të kryejnë detyra në përputhje me vijën politike dhe ekonomike të pushtetit tonë dhe në pajtim me detyrat që cakton plani ekonomik i shtetit. Interesat lokale duhet të pajtohen me interesin e përgjithshëm. Vendimet dhe udhëzimet e dhëna nga organet më të larta janë të detyrueshme për organet më të ulëta dhe centralizmi demokratik ka për qëllim të sigurojë koordinimin e punës, unitetin e punës në gjithë organet lokale në pajtim me interesin e përgjithshëm dhe me planin e shtetit. Centralizmi demokratik nga ana tjetër lejon zbatimin e masave të organeve superiore në përputhje me konditat specifike

lokale. Komitetet ekzekutive që janë organet administrative të këshillave popullore, duhet të kryejnë vetëm ato detyra, që u janë caktuar në kompetencën e tyre ekskluzive dhe të thërrasin në krahën e caktuar anëtarët e këshillit në mbledhje të zakonshme dhe të japin raport dhe llogari për punën e tyre. Të zhvillohet në gjirin e këshillave kritika dhe autokritika bolshevike dhe të vendoset demokracia e plotë, sepse vetëm kështu do të ekzistojë kontrolli i masave mbi pushtetin e tij dhe mbi njerëzit që ka dërguar në pushtet. Partia duhet të jetë vigjilente që të zbatohen me përpikmëri ligjet dhe rregulloret e shtetit, të mbrojnë punën dhe të drejtat e popullit, të forcojnë demokracinë e vërtetë në pushtet dhe të godasi pa mëshirë armiqtë, që mund të infiltrohen në të, për ta dëmtuar dhe për ta penguar veprimtarinë e pushtetit popullor. Partia jonë, udhëheqësja besnike e popullit dhe e shtetit tonë, duhet të marrë të gjitha masat, për ta forcuar dhe modernizuar pushtetin tonë. Kjo barrë i bie në radhë të parë anëtarit të Partisë, i cili duhet të marrë përgjegjësinë dhe të kryejë me zotësi dhe ndershmëri rolin udhëheqës të ndihmës, të jetë shembull në punë, në organizim, në disiplinë dhe në ndershmëri. Vetëm kështu ata do të gëzojnë simpatinë dhe besimin e popullit dhe vetëm kështu populli do të ketë besim në ta si udhëheqës. Të luftohet me ashpërsinë më të madhe burokratizmi, ngadalësia dhe arroganca, të huaja për njerëzit e thjeshtë të popullit. Njerëzit që punojnë në pushtet dhe në radhë të parë anëtarët e Partisë, duhet të dinë se janë zgjedhur atje për t'i shërbyer vetëm popullit dhe për t'i shërbyer mirë dhe me drejtësinë më të madhe dhe Partia e populli nga

ana e tyre duhet të godasin pa mëshirë gjithë ata që nuk veprojnë në këtë drejtim.

LEGJISLACIONI DHE DREJTËSIA

Në fushën e legjislacionit dhe të drejtësisë pushteti ynë popullor ka bërë reforma të mëdha. Lufta e popullit tonë përmbysi raportet e forcave të shoqërisë së vjetër; klasa punëtore, fshatarësia e varfër dhe e mesme erdhën në fuqi dhe u mposht klasa e privilegjuar e bejlerëve dhe e borgjezisë, regjimi i të cilëve ishte mbështetur në shtypjen dhe shfrytëzimin e masave punonjëse. Populli rrëzoi nga fuqia rendin juridik të borgjezisë. Ligjet dhe kodet e promulguara gjatë regjimeve antipopullore të së kaluarës, gjatë regjimit satrap të Ahmet Zogollit dhe të okupacionit të egër fashist, shprehnin vullnetin e klikave reaksionare dhe mbronin interesat e klasës shtypëse, mbronin privilegjet e bejlerëve dhe të agallarëve, të tregëtarëve të mëdhenj dhe të spekulatorëve. Ato ishin armë të forta në duart e këtyre klikave dhe të aparatit të tyre shtetëror, për të shtypur çdo lëvizje përparimtare.

Asnjë reformë nuk u bë dhe asnjë ligj nuk doli gjatë regjimeve të kaluara në favor dhe në interes të popullit. Regjimi popullor duhej t'i spastronte menjëherë këto ligje, pse ishin pengesë e madhe në rrugën e ndërtimit të jetës së re. Revolucioni popullor kishte ligjet e tij, ligje revolucionare të frymëzuara nga interesat e masave punonjëse. Shqipëria e re e vegjëlisë duhej të ngrinte rendin juridik të ri. Dhe kështu u bë. Që

pas çlirimit të Shqipërisë menjëherë u abrogua në parim legjislacioni i vjetër dhe kjo u bë, sepse ishte një pengesë për zhvillimin e raporteve të reja shoqërore dhe ekonomike. Vendin e legjislacionit të abroguar duhet ta zinin ligjet e popullit. Bazat e legjislacionit tonë të ri i hodhi Statuti themeltar dhe mbi këto baza të shëndosha ngrihej rendi i ri juridik. Shumë ligje dualën pas aprovimit të Statutit tonë. Do të përmend në vija të përgjithshme disa nga ligjet kryesore.

Pregatitja e aprovimi i kodit të punës është një fitore e madhe e masave punonjëse dhe është baza kryesore e legjislacionit tonë të punës. Ky ligj përmban të drejtat e punëtorëve dhe cakton detyrat e tyre, përcakton karakterin dhe përmbajtjen e kontratave kolektive dhe të punës, cakton shpërblimin e punës, kohën e punës dhe atë të pushimit. Në vendin tonë nuk ekzistonte asnjë ligj pune dhe punëtorit s'i njihej asnjë e drejtë. Nga mjerimi i madh që e mbulonte, ai i nënshtrohej vullnetit të punëdhënësit. Punëtori në Shqipërinë e re e ka të siguarur jetën dhe punën dhe gëzon të gjitha të drejtat, që kurrë s'i kishte gëzuar. Është caktuar 8 orëshi, punëtori ka të drejtë pushimi në vit jo më pak se dy javë dhe ky i paguhet. Për punëtorin e ri në moshë pushimi zgjat një muaj. Kodi i punës mbron veçanërisht të drejtat e fëmijëve të mitur dhe të gruas si punëtore dhe si mëmë. Punëtori përfiton nga sigurimet shoqërore pa paguar asnjë kontribut për këto sigurime. Këta dhe familjet e tyre gëzojnë një sërë të drejtash në rast sëmundjeje, pleqërie, aksidentesh në punë, barrë dhe lindje.

Kuvendi Popullor në sesionin e tij të fundit aprovoi

kodin penal të ri dhe kodin e ri të familjes. Kodi penal i ri përmban parimet themeltare të së drejtës sonë penale dhe të politikës që duhet të ndjekin organet gjyqësore, organet e prokurorisë dhe të ndjekjes në zbatimin e drejtësisë së re. Politika e Partisë dhe e pushtetit tonë në fushën e së drejtës penale ndryshon krejt nga politika e regjimeve reaksionare të së kaluarës. Për këtë shkak kodi ynë penal nuk ka asgjë të përbashkët me kodin dhe ligjet e vjetra penale. Ligjet tona penale dhe kodi i ri penal kanë për qëllim të mbrojnë nga veprat shoqërisht të rrezikshme, pushtetin e popullit, të ngritur mbi fitoret e Luftës nacional-çlirimtare, rendin e tij juridik dhe ndërtimin e tij socialist, si dhe të drejtat dhe detyrat e shtetasve. Ligjet penale të shteteve borgjeze dhe reaksionare kanë për qëllim të mbrojnë pushtetin politik të pakicës dhe shfrytëzimin ekonomik të shumicës së popullit. E drejta jonë penale ngrihet mbi bazat shkencore të marksizëm-leninizmit dhe kodi penal i ri studjon nga pikëpamja e materializmit dialektik fajin penal, qëllimin e dënimit, konditat e bazat e përgjithshme penale.

Kodi penal i ri duhet të studjohet dhe të kuptohet mirë nga gjyqtarët e rinj të popullit dhe nga kuadrot e rinj të drejtësisë.

Ligjet, që formojnë kodin e ri të familjes, zhvillojnë parimet që ka konsakruar Statuti mbi martesën dhe familjen, mbi barazinë e gruas me burrin, mbi barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martesës me fëmijët e lindur nga martesa, mbi mbrojtjen e të drejtave të gruas dhe mbi mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të fëmijëve të mitur. Duhet të theksohet se familja e ngritur

mbi këto baza të shëndosha do të jetë shtylla e shoqërisë sonë. Për këtë është e nevojshme që të ngrihet niveli politik dhe kultural i gruas dhe të nxitet pjesëmarrja e saj në prodhim.

Pushteti ynë ka bërë ligjin mbi organizimin e gjykatave ordinere dhe ushtarake, ligjin mbi prokurorinë publike, mbi Komisionin e Planit, mbi Komisionin e Kontrollit, mbi mbrojtjen e pasurive të përbashkëta të popullit dhe shumë ligje të tjera. Të gjitha këto ligje të shtetit tonë duhet të mbrohen dhe të zbatohen pikë për pikë dhe mbrojtja e ligjshmërisë sonë është një detyrë e madhe për të gjithë. Organet e shtetit dhe shtetasit duhet të respektojnë ligjet. Politika e Partisë duhet të jetë vigjilente dhe e ashpër kundër atyre që shkelin ligjet, pse vetëm kështu mbrohet Partia, populli dhe interesat e tij. Në zbatimin e ligjeve të mos bëhet asnjë lëshim, se ndryshe dobësohet forca e ligjshmërisë sonë dhe dëmtohen rëndë interesat e popullit.

Karakteri dhe organizimi i gjykatave tona duhet të pajtohen me misionin dhe detyrat e tyre. Struktura dhe përbërja e vjetër e gjykatave nuk u përgjigjet konditave të reja. Administrimi i drejtësisë, me vendosjen e pushtetit popullor kaloi në duart e masave punonjëse. Gjykatat tona duhej të zbatonin ligjet e reja dhe t'i zbatonin këto në interes të popullit, pse ky ishte qëllimi i tyre. Në zbatimin e drejtësisë së re, faktor me rëndësi ishte populli. Më parë populli mbahej larg jetës politike dhe pushteti gjyqësor ushtrohej nga gjyqtarë të emëruar nga lart, ata s'kishin asnjë lidhje me masat, nuk njihnin nevojat dhe problemet e tyre dhe kështu zbatonin ligjet, që u interesonin klikave sunduese. Pavarësia

e tyre ishte formale. Sot ngjet e kundërta, drejtësia i përket popullit, ligjet bëhen nga organet e zgjedhura prej popullit dhe vihen në zbatim nga gjyqtarë të zgjedhur prej popullit. Statuti themeltar caktoi në vijat kryesore strukturën organizative të gjykatave popullore dhe ligji mbi organizimin e gjykatave ordinere, caktoi në hollësira organizimin dhe detyrat e tyre.

Gjykatësit dhe ndihmësgjykatësit zgjidhen nga këshillat popullore, japin llogari për punën dhe janë përgjegjës përpara tyre. Gjyqtarët e rinj zgjidhen nga populli dhe duhet të dalin nga gjiri i popullit. Gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët rrojnë brenda në masat, njohin nevojat dhe problemet e tyre. Për t'i interpretuar dhe për t'i zbatuar mirë dhe drejt ligjet, gjyqtarët s'duhet që t'i shkëputin asnjëherë lidhjet e tyre me popullin...

USHTRIA KOMBËTARE

Pas çlirimit ushtria jonë duhej të transformohej nga një ushtri partizane në një ushtri të rregullt dhe moderne. Kuadrot tanë nuk kishin eksperiencë në këtë drejtim, porse Partia jonë e dinte se ushtria jonë nuk mund të modernizohej veçse në bazë të eksperiencës së Ushtrisë Sovjetike dhe se rruga që duhej të ndiqte ushtria jonë, ishte ajo e Ushtrisë Sovjetike, se vetëm duke u mbështetur në artin ushtarak stalinian mund të forcohej dhe të modernizohej ushtria jonë. Qysh pas Plenumit të Beratit¹, udhëheqja e Partisë Komuniste Ju-

¹ Është fjala për Plenumin II të KQ të PKSII që u mbledh në Berat në nëntor 1944.

gosllave ndërhyri në ushtrinë tonë. Shtatmadhuria e ushtrisë jugosllave dhe KQ i Partisë Komuniste Jugosllave u munduan qysh në fillim të mos lejonin orientimin tonë në ushtri, në drejtim të Ushtrisë Sovjetike, por të shikonim vetëm nga ushtria jugosllave. Delegatione pas delegacionesh oficerësh jugosllavë vinin gjatë vitit 1945 dhe 1946 për t'i imponuar ushtrisë sonë pikëpamjet e tyre në lidhje me organizimin dhe stërvitjen e ushtrisë sonë. Po KQ i Partisë sonë, duke e parë qartë paaftësinë e këtyre delegacioneve ushtarake jugosllave dhe duke e vlerësuar si duhet artin ushtarak sovjetik, vendosi që ushtria jonë të edukohet në bazë të artit ushtarak sovjetik. Kjo shkaktoi keqardhje dhe nervozizëm në komandën e ushtrisë jugosllave, e cila bashkë me KQ të PKJ donte që ushtria jonë të orientohet nga ushtria jugosllave në çdo pikëpamje dhe më në fund të arrinte që të shkrihej në Ushtrinë Jugosllave si një armatë e pandarë e saj. Gjatë vitit 1946 ushtria jonë u organizua sipas parimeve organizative të artit ushtarak sovjetik. Nga fundi i vitit 1946 u shfaqën kontradikta midis Shtatmadhorisë dhe Drejtorisë politike të ushtrisë sonë, të cilat kishin karakter parimor. Kontradikta e parë u shfaq e ashpër në çështjet organizative të ushtrisë. Shtatmadhuria jonë mbronte tezën e drejta të bazuara në eksperiencën sovjetike, kurse Drejtoria politike luftonte për pikëpamjet e gabuara antimarksiste të jugosllavëve, të cilët insistonin që ne të aplikojmë mekanikisht organikat e ushtrisë jugosllave, gjoja si më të përshtatshme për konditat tona. Kjo ishte lufta e hapët që i bëhej doktrinës ushtarake staliniane, Komandës sonë të Përgjithshme dhe Komandantit të Për-

gjithshëm të ushtrisë sonë. Shtatmadhoria i hodhi poshtë tezat e gabuara të këshilltarëve jugosllavë dhe të Drejtorisë politike dhe zbatoi besnikërisht vijën që i kishte caktuar Komiteti Qendror i Partisë dhe Komandanti i Përgjithshëm: modernizimi i ushtrisë sonë duhet të bëhet në bazë të eksperiencës së Ushtrisë Sovjetike të aplikuar në konditat tona.

Komanda e Përgjithshme e ushtrisë jugosllave gjeti një mbështetje të fortë në drejtuesit e Drejtorisë politike, të cilët ishin për vijën e Drejtorisë politike të ushtrisë jugosllave, dhe u përpoqën ta zbatojnë vijën antimarksiste dhe antisovjetike, kurse Shtatmadhoria mbrojti vijën e drejtë të Partisë sonë¹, vijën marksiste-leniniste. Të gjitha programet ideo-politike si dhe puna organizative e Partisë në ushtri kanë qenë të gabuara dhe e kanë dëmtuar rëndë Partinë dhe ushtrinë. Drejtoria politike u mundua që t'i impononte Shtatmadhorisë pikëpamjet e gabuara jugosllave edhe në lidhje me stërvitjen luftarake dhe në lidhje me metodën e punës në ushtri. Më në fund Drejtoria politike, e shtyrë prej jugosllavëve dhe me anën e Pëllumb Dishnicës, i propozoi haptas Shtatmadhorisë unifikimin e ushtrisë sonë me ushtrinë jugosllave, porse Shtatmadhoria këtë propozim e quajti jo të drejtë, antimarksist. Me këtë propozim jugosllavët kërkonin të likuidonin sa më parë pa varësinë e ushtrisë sonë, duke likuiduar rolin e Koman-

¹ Vijën e drejtë marksiste-leniniste, direktivat e Komandantit të Përgjithshëm në Shtatmadhori i mbronin në radhë të parë shoku Mehmet Shehu, kryetar i saj, megjithëse edhe në Shtatmadhori kishte edhe pjesëtarë që qëndronin në pozita jo të drejta.

dantit të Përgjithshëm të ushtrisë sonë. Komiteti Qendror dhe Sekretari i Përgjithshëm i dënoi këto pikëpamje antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të Drejtorisë politike dhe të grupit trockist Tito. Kontradiktat midis Drejtorisë politike dhe Shtatmadhorisë u ashpërsuan dhe më tepër derisa jugosllavët e konsideruan ushtrinë tonë si një vatër ku fermentohet gjoja ndjenja shoviniste dhe antijugosllave në kuadrin e përgjithshëm të frontit të pretenduar antijugosllav në Shqipëri. Pas akuzës së dytë të KQ të PKJ kundër Komitetit Qendror të Partisë sonë¹, punët u precipituan dhe në sektorin ushtarak. Komanda e ushtrisë jugosllave, duke mobilizuar njerëzit e Drejtorisë sonë politike dhe duke influencuar dhe në disa shokë të Shtatmadhorisë, në nëntor 1947 organizoi grushtin e fundit kundër vijës së Komitetit Qendror të Partisë sonë, kundër Komandës së ushtrisë. Plenumi VIII, që goditi gjithë vijën e Partisë sonë, goditi dhe vijën e Partisë sonë në ushtri.

Të gjitha këto gabime të rënda në sektorin ushtarak e kanë penguar ushtrinë tonë të ecte përpara në rrugën e modernizimit me ritmin e shpejtë.

Rruga, që duhet të ndjekë ushtria jonë, është rruga e modernizimit në bazë të eksperiencës dhe të artit ushtarak sovjetik. Ushtria jonë duhet të edukohet me mësimet e Marksit-Engelsit-Leninit dhe Stalinit dhe të frymëzohet me ndjenjën e besnikërisë ndaj popullit dhe atdheut tonë, me besimin e patundur në Partinë tonë Komuniste, në udhëheqjen e lavdishme të popullit tonë

¹ Akuzën e dytë Komiteti Qendror i PKJ e bëri në nëntor të vitit 1947.

dhe në Komitetin Qendror të saj, me besimin e patundur në Bashkimin Sovjetik, në Partinë Bolshevike dhe në Stalinin e madh si dhe me shpirtin e internacionalizmit proletar. Ajo duhet të forcohet dhe të qëndrojë kurdoherë vigjilente për mbrojtjen e interesave të atdheut dhe të popullit tonë, që janë të lidhura me interesat e kampit të socializmit.

ARMA E SIGURIMIT TË SHTETIT

Sigurimi i Shtetit është arma e mprehtë dhe e dashur e Partisë sonë, sepse ajo mbron interesat e popullit dhe të shtetit tonë socialist kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Si e tillë, pra, çdo anëtar i Partisë duhet ta dojë dhe ta ndihmojë Armën e Sigurimit dhe populli ynë gjithashtu duhet ta dojë dhe ta mbrojë këtë armë, pse mbron interesat vitale të tij. Vetëm armiqtë e Partisë dhe të popullit mund të mendojnë dhe të veprojnë ndryshe. Arma e Sigurimit të Shtetit që në ditët e formimit të saj i ka bërë shërbime të çmueshme popullit dhe Partisë duke zbuluar veprimtarinë armike të reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm, duke zbuluar me sukses grupet tradhëtare, që ishin në bashkëpunim me agjenturat e spiunazhit anglo-amerikan, duke i shpartalluar këto grupe përfundimisht, të cilët kishin për qëllim rrëzimin e pushtetit popullor. Arma e Sigurimit ka qenë vazhdimisht në ndjekje të kriminelëve të luftës, të cilët i kapi dhe ja dorëzoi gjyqeve të popullit. Arma e Sigurimit ka qenë në ndjekje të vazhdueshme dhe në luftë me kriminelët politikë të arratisur, të cilët

i dërmoi, i kapi dhe pjesës tjetër ja bëri jetën të padurueshme, saqë e detyroi të largohet nga vendi ynë dhe të arratiset në vende të huaja armike. Në këtë drejtim Arma e Sigurimit të Shtetit ka kryer detyra të rëndësishme, që i kishte ngarkuar Partia dhe qeveria dhe këto rezultate duhet të çmohen drejt. Po në vijën e sigurimit janë vërtetuar gabime të rënda dhe metoda të huaja trockiste të marrura hua direkt nga trockistët jugosllavë dhe të aplikuara nga Koçi Xoxe. Forma organizative e qenjes së sekretarit të Partisë për kuadrot, njëkohësisht dhe ministër i brendshëm, organizim ky antimarksist, antileninist dhe antibolshevik, tregon se Partia ishte vënë nën kontrollin e Ministrisë së Brendshme dhe në këtë drejtim janë vërtetuar gabime të palejueshme dhe të dënueshme në trajtimin e keq të kuadrove të Partisë dhe të popullit. Koçi Xoxe, me pikëpamjet e tij politike dhe organizative shumë të paqarta dhe me metoda trockiste dhe otomane, ka vepruar në sektorin e Sigurimit të Shtetit në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare, duke e komprometuar Armën e Sigurimit dhe shumë njerëz, punëtorë të sigurimit, të cilët në më të shumtën e rasteve kanë kujtuar me plot bindje se shërbenin në rrugën e drejtë të Partisë. Po kjo rrugë s'ka qenë asnjëherë rruga e drejtë e Partisë, ajo ka qenë rruga e gabuar dhe e dënuar e Koçi Xoxes dhe e trockistëve jugosllavë. Nuk mund të ekskludohet që në këtë punë, të frymëzuar nga trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe, të mos ketë dhe faje individuale, gabime të bëra nga individë, punëtorë të sigurimit. Gabime ka pasur edhe në sektorët e tjerë të punës, por këto faje dhe gabime Partia dhe shteti do t'i rishikojë me drejtë-

sinë më të madhe duke marrë parasysh edhe të shkua-
rën në luftë dhe në Parti të këtyre punëtorëve të si-
gurimit që kanë bërë gabime. Partia do të vërë të gjitha
forcat që këta punëtorë të sigurimit t'i ndreqin gabimet
e tyre, duke i njohur me ndërgjegje dhe të pu-
nojnë me ndërgjegje në vijën e drejtë që ka caktuar
Partia. Këta punëtorë të sigurimit, që kanë bërë
gabime, duhet t'ja shpërblejnë me të mira Partisë dhe
popullit për gabimet që kanë bërë. Çështja e Sigu-
rimit të Shtetit duhet të kuptohet drejt, sepse mund
të ketë rreziqe në këtë drejtim në situatat e rën-
da, të krijuara nga grupi trockist Tito dhe bashkëpunë-
torët e tij në Partinë tonë. Çështjet e gabimeve në vijën
e sigurimit duhet të shihen kurdoherë me syrin objektiv
dhe nga platforma e interesit të Partisë dhe të popullit
dhe jo nga platforma personale, pse në këtë situatë
duhet të mos harrojmë që armiku i mpreh armët kundër
Sigurimit të Shtetit që ka qenë, është dhe do të jetë
arma e pamëshirshme për asgjësimin e armiqve. Në rast
se shkojmë nga një ekstrem në tjetrin dhe nuk e shi-
kojmë Armën e Sigurimit nga platforma e Partisë, atë-
here do të gabojmë rëndë. Në rast se anëtarët e Partisë
fillojnë ta shohin me bisht të syrit Sigurimin e Shtetit,
si një gjë të huaj dhe të dëmshme, atëhere e kemi dëm-
tuar Partinë dhe popullin, e kemi dobësuar Armën e
Sigurimit, e kemi hedhur tej nga gjiri i Partisë, nga
ndihma e Partisë. Kjo është vetëm në fitimin e armikut.
Një qëndrim i tillë, jo i drejtë, sjell shumë rreziqe,
dekurajon njerëzit e sigurimit, të cilët do ta shohin ve-
ten të përbuzur, të mënjanuar dhe kështu këta do të
ngurrojnë në kryerjen e funksionit të tyre të lavdishëm

dhe të rëndësishëm dhe plot rreziqe që u ka ngarkuar Partia dhe shteti dhe lufta kundër armikut do të dobësohet. Kështu kemi çuar ujët në mullirin e armikut dhe i kemi bërë varrin me duart tona pushtetit popullor. Punëtorët e sigurimit që janë nga njerëzit besnikë dhe të vendosur të Partisë, duhet t'i njohin si komunistë ndershëmërisht gabimet e tyre, t'i luftojnë këto, të mos i përsërisin më dhe të ecin në rrugën e drejtë që u ngarkon Partia dhe shteti. Nga ana tjetër ata të shtojnë besimin në veten e tyre, të jenë vigjilentë për mbrojtjen e interesave të Partisë dhe të popullit, të jenë nga njerëzit më të dashur të popullit. Asnjë fije mëshire të mos kenë kundër armikut dhe asnjë ngurrim për ta goditur atë. Partia duhet të dijë se Arma e Sigurimit është një armë speciale, që ka rregulla dhe sekretet e saja, që ja cakton Komiteti Qendror i Partisë dhe shteti, që nuk mund t'i dijë çdo njeri qofshin këta anëtarë partie në celula ose në komitete. Udhëheqja e Partisë do t'i caktojë drejt rrugën sigurimit, do t'i caktojë rrugën në baza marksiste-leniniste dhe këto do të zbatohen me rigorozitetin më të madh dhe me mprehtësinë më të madhe, sepse kështu e lyp interesi i popullit dhe i Partisë dhe Partia nuk lejon tjetër rrugë. Çdo anëtar i Partisë duhet të dijë se sekretet e shtetit nuk mund të bëhen çështje bisedimesh, ca më shumë format e punës së sigurimit duhet të ruhen me fshehtësinë më të madhe, pse kjo është një armë shumë delikate në përpjekje çdo ditë dhe çdo orë me agjenturat e armiqve të popullit tonë, të Partisë sonë dhe të kampit të socializmit. Çdo anëtar i Partisë duhet të mos harrojë kurrë se armiku vazhdimisht do të përpiqet të futë në Partinë tonë agjen-

të provokatorë, të kamufluar, të futë agjentë provokatorë në aparatet e shtetit dhe në gjithë lëmet e aktivitetit të vendit tonë. Partia, populli ynë dhe shteti ynë duhen mbrojtur dhe në mënyrë speciale e të drejtë, në bazë të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë; Arma e Sigurimit, një nga armët më të shëndosha, do t'i mbrojë këto. Të luftojmë ekzagjerimet e dëmshme që shihen aty-këtu nëpër konferenca dhe aktive të Partisë në lidhje me punimin e Rezolucionit të Plenumit XI për çështjen e sigurimit. Të mos konfondohen kritikak e ashpra e të drejta, që duhet t'u bëhen medoemos gabimeve që janë vërtetuar në sigurim dhe njerëzve që i kanë bërë këto gabime, me kërkesa të palejueshme për zbulimin e formave organizative të kësaj arme të rëndësishme. Të luftohet gjithashtu mënyra jo e drejtë e kritikave personale, në platforma personale dhe që nga këto kritika të padrejta dhe të vogla, të arrihet në demoralizimin e kuadrove dhe në mbledhjen e pasigurisë e të konfuzionit. Këto nuk i lejon Partia. Punëtorët e sigurimit duhet të jenë besnikë të Partisë dhe të popullit, të kuptojnë mirë detyrën e rëndësishme që u ngarkohet, ta zbatojnë me vendosmëri këtë detyrë. Ata duhet të jenë të drejtë dhe të dashur me popullin, të ashpër me armikun. Duhet të kuptohet mirë prej tyre se Arma e Sigurimit mbron shtetin tonë, Partinë dhe popullin. Kjo është një detyrë e shenjtë, prandaj Partia dhe populli duhet ta ruajnë këtë armë si sytë e ballit, ta bëjnë të mprehtë, të ashpër për armiqtë, ta forcojnë dita-ditës më shumë dhe ta mbajnë kurdoherë në gatishmëri luftarake për mbrojtjen e interesave të larta të atdheut dhe të popullit.

Partia dhe qeveria muarën masat e domosdoshme dhe larguan nga Ministria e Brendshme dhe nga Arma e Sigurimit gjithë ata shokë që kishin bërë faje e gabime të rënda në këtë sektor kaq të rëndësishëm, duke sjellë në krye të këtij dikasteri me rëndësi dhe në vende të tjera të kësaj arme, shokë që do ta drejtojnë në rrugën e vërtetë të Partisë. Detyrat e rënda që u ngarkohen, ata do t'i kryejnë kurdoherë nën drejtimin e Partisë dhe me ndihmën e Partisë do ta spastrojnë Armën e Sigurimit nga metodat e dënueshme trockiste, që ishin infiltruar në të; do të ndihmojnë në rrugën e drejtë të Partisë, të shkunden, të korrigjohen gjithë punëtorët e tjerë të sigurimit dhe do t'i bëjnë të aftë dhe të zot për të vazhduar detyrën e tyre të rëndësishme.

POLITIKA E JASHTME E PARTISË SONË

A. Marrëdhënjet ndërkombëtare të shtetit të ri shqiptar. — Që prej krijimit të saj dhe deri më sot Partia jonë ka mbajtur një qëndrim politik të vendosur, të drejtë dhe konsekuent me Bashkimin Sovjetik dhe me aleatët e tjerë gjatë gjithë kohës së luftës. Partia jonë, e frymëzuar nga marksizëm-leninizmi, duke u mbështetur fuqimisht dhe duke mos u ndarë për asnjë moment nga mësimet e pavdekshme të Marksit-Engelsit-Leninit dhe Stalinit, e lidhi ngushtë e me vendosmërinë më të madhe luftën e saj dhe të popullit të saj me atë të popujve të Bashkimit Sovjetik. Politika e drejtë e Bashkimit Sovjetik dhe roli i lavdishëm i tij në udhëheqjen e luftës çlirimtare kundër nazizmit dhe fashiz-

mit, ishin orientim i drejtë për Partinë tonë. Forcimi i miqësisë së madhe dhe të sinqertë me popujt e Bashkimit Sovjetik, politika jonë e drejtë, bënë që Partia jonë të mos gabojë kurrë në rrugën e saj dhe si rrjedhim të korrë suksese të mëdha për popullin e vet. Në kohën e luftës fashizmi, kuislingët dhe reaksioni shqiptar u përpoqën me njëmijë dredhira, që ta njollojnë dhe ta pengonin politikën e drejtë të Partisë me Bashkimin Sovjetik që të futej në masat e gjera të popullit tonë dhe ta përqafonin me gjithë zemër. Fashizmi dhe reaksioni dështuan. Vepra e madhe e Leninit dhe e Stalinit, forca e pamposhtur e Bashkimit Sovjetik, u bë mbështetja kryesore që pati populli ynë në luftën e tij të përgjakshme. Që nga partizani më i thjeshtë dhe deri te komandanti më i lartë, që nga kasollet më të humbura në malet tona dhe deri në qytete, në kohën kur kërciste lufta, në çdo zemër të njeriut të thjeshtë shqiptar, emri i Bashkimit Sovjetik dhe i Stalinit përfaqësonin për të shpresën më të madhe për realizimin e ëndrrave të tyre. Ata shihnin atje shembullin për jetën e tyre të ardhshme dhe të brezave të rinj të Shqipërisë. Ky besim i madh në atdheun e socializmit, i farkëtuar nga Partia jonë, bëri që populli ynë të luftojë me aq heroizëm dhe me aq vetëmohim, sepse jo vetëm ai ishte i sigurtë për fitoren mbi fashizmin, porse pas çlirimit dhe përgjithmonë, ai do të ndërtonte jetën e tij më të mirë në atdheun e tij të lirë me ndihmën, përkrahjen dhe mbrojtjen e fuqishme të Bashkimit Sovjetik. Populli ynë e kuptoi fare mirë se ai nuk do të bëhej më monedhë shkëmbimi dhe intrigat e kërcënimet e imperializmit ndaj vendit tonë, do të mposhteshin në çdo moment, pse Shqipëria

e vogël nuk do të ishte më e izoluar dhe në fatin e dallgëve që imperializmi amerikan dhe anglez do të frynte për të hedhur botën në një kasaphanë të tretë. Populli ynë aleancën antifashiste të shteteve të mëdhenj gjatë luftës e shikoi nën prizmin e politikës së drejtë të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë dhe populli ynë i qëndruan besnikë kësaj aleance deri në fund, sepse në krye të kësaj aleance dhe faktori vendimtar i kësaj aleance ishte Bashkimi Sovjetik. Populli ynë me prova i qëndroi besnik kësaj aleance duke derdhur gjakun e bijve të tij më të mirë dhe Partia e udhëhoqi luftën me vendosmëri dhe pa kompromis deri në fund. Duke parë e duke ndjerë thellë se Bashkimi Sovjetik mbante në supet e veta peshën më të rëndë të luftës dhe duke parë manevrat e reaksionit amerikan dhe anglez, të cilët që gjatë kohës së luftës, nën flamurin e tyre pseudodemokrat e antipopullor, kërkonin rigrumbullimin e reaksionit për dobësimin e Bashkimit Sovjetik, Partia dhe populli ynë hidheshin në luftë më me guxim e më me heroizëm për realizimin e ëndrrave të tyre, pa marrë parasysh sakrificat, besnikë deri në fund të Bashkimit Sovjetik.

Një politikë të tillë të drejtë dhe konsekuente Partia jonë e vazhdoi dhe pas çlirimit të Shqipërisë. Dashuria e madhe për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për shokun Stalin ishin baza e çelniktë e gjithë politikës së brendshme e të jashtme të Partisë dhe të shtetit tonë. Ishte e pamundur të bëhej rindërtimi i Shqipërisë, ashtu si ishte e pamundur të fitohej lufta nga populli ynë, pa çelnikosur edhe më shumë dashurinë për Bashkimin Sovjetik. Vetëm kështu mund të shpjegohet entuziazmi i papërshtuar i masave të gjera

të popullit tonë, vepra e madhe e rindërtimit dhe përparimi i madh që bëri Shqipëria e re dhe demokracia popullore në vendin tonë. Të gjitha veprat e rindërtimit tonë, qoftë në lëmin ekonomik, kultural ose shoqëror janë të mbështetura fuqimisht në dashurinë, në besimin dhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik...

Në çdo çap që bënte përpara klasa jonë punëtore, fshatarësia jonë, që doli në dritë, rinia jonë heroike, gruaja shqiptare dhe gjithë masat e tjera punonjëse dhe patriote, ata kishin në mendje dhe në zemër Bashkimin Sovjetik, shokun Stalin dhe kjo i bënte më të fuqishëm dhe më të zot të kryenin me nder detyrat ndaj atdheut, ashtu si i kryenin detyrat dhe në kohën e luftës me emrin e shokut Stalin në gojë.

Imperializmi amerikan dhe anglez, si do ta shohim më poshtë, me egërsinë më të madhe e sulmuan Shqipërinë e re, demokracinë popullore në vendin tonë. Imperialistët amerikanë dhe anglezë kërcënuan shumë herë independencën dhe sovranitetin e vendit tonë, tentuan për shumë herë të zbarkonin, organizuan reaksionin e brendshëm dhe sabotazhe, i mohuan popullit tonë heroik të gjitha të drejtat ndërkombëtare dhe u orvatën, me shpifje, ta paraqesin Shqipërinë e re e të vogël si një vend që turbullon paqen dhe sigurimin botëror. Por të gjitha këto orvatje të imperializmit amerikan dhe anglez dështuan kryekëput, sepse Shqipëria e re dhe demokracia jonë popullore u mbrojtën me heroizëm nga Bashkimi Sovjetik. Shpëtimi i vendit tonë dhe i popullit tonë nga këto valë jashtzakonisht të rrezikshme i detyrohen Bashkimit Sovjetik, politikës së drejtë e heroike të Partisë sonë dhe heroizmit të popullit shqiptar. Politika e

Bashkimit Sovjetik në kohën e pasluftës është politika e mbrojtjes së paqes dhe të sigurimit, e mbrojtjes të të drejtave të popujve të mëdhenj e të vegjël nga kërcënimi i një luftime të tretë botërore, ku imperialistët amerikanë dhe anglezë e satelitët e tyre kërkojnë ta hedhin botën përsëri. Bashkimi Sovjetik me madhësi dhe me fuqi i demaskon të gjitha manevrat, shantazhet dhe kërcënimet e imperialistëve amerikanë dhe anglezë. Me anë të këtij qëndrimi heroik dhe të demaskimit të pamëshirshëm, gjithë popujt përparimtarë të botës e kanë të qartë qëllimin e kampit imperialist dhe antidemokratik, në krye të të cilit qëndrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kampi imperialist dhe antidemokratik, me në krye SHBA-në, që grumbullon në gjirin e vet gjithë reaksionin botëror dhe neofashizmin, po përgatitet për të hedhur botën në një luftë të re, më të tmerrshme se ajo e dyta. Imperializmi amerikan me shpejtësi përpiqet të rimëkëmbë fashizmin gjerman, atë japonez dhe me anë të të gjitha partive të tjera pro amerikane, që sot ndodhen në fuqi, si në Francë, Itali e gjetkë, kërkon të shtypë popujt përparimtarë, klasën punëtore dhe udhëheqëset e tyre, partitë komuniste, për të vendosur në këto vende hegjemoninë e tij. Imperializmi amerikan, me planin e tij skllavërues Marshall, kërkon të kolonizojë të gjitha shtetet Perëndimore të Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Imperializmi amerikan po përgatit kudo baza ushtarake dhe fortifikime për një luftë të tretë eventuale. Ai ndihmon haptas fashistët si në Greqi, Spanjë, Indonezi, Kinë, etj., të vazhdojnë luftën civile kundër popujve përparimtarë të këtyre vendeve dhe kundër vendosjes së sovranitetit të popujve dhe të de-

mokracisë popullore. Njëkohësisht imperializmi amerikan kërkon t'i përdorë këto fole lufte për të ndezur luftën në një shkallë më të gjerë ndërkombëtare. Me provokacione të panumërta, të hapëta, drejtpërdrejt imperializmi amerikan dhe anglez dhe satelitët e tyre përpiqen të krijojnë kondita lufte. Për të gjitha tentativa e tyre demaskohen deri në rrënjë nga politika e drejtë, e vendosur dhe tej pamëse staliniane. Politika e lavdishme staliniane i armatos gjithë popujt përparimtarë të botës, për të kuptuar lodrën dhe qëllimet e imperializmit amerikan dhe për t'i luftuar këto me ashpërsinë më të madhe. Përballë kampit imperialist dhe antidemokratik, në krye të të cilit qëndron imperializmi amerikan, sot qëndron i pathyer dhe i fuqishëm kampi demokratik dhe antiimperialist, në krye të të cilit qëndron Bashkimi i lavdishëm Sovjetik. Në kampin demokratik e antiimperialist, janë rreshtuar demokracitë e reja popullore, gjithë popujt përparimdashës në botë, për të mbrojtur me të gjitha forcat e tyre, paqen dhe lirinë. Përpara kësaj force të madhe kanë dështuar të gjitha përpjekjet e imperializmit, për të përçarë këtë kamp me kërcënime lufte ekonomike dhe politike. Imperializmi kishte menduar se Lufta e dytë botërore do ta dobësonte Bashkimin Sovjetik dhe popujt e demokracive popullore, e kështu do të mund të ndërhynte në punët e brendshme të tyre dhe t'u rrëmbente fitoret, që ata kishin korrur. Po Bashkimi Sovjetik doli më i fortë se kurrë nga lufta. Ai ishte dhe qëndron kështjellë e pamposhtur e mbrojtjes së paqes dhe e popujve të tjerë përparimtarë dhe paqedashës.

Ashtu sikur çlirimi i vendit tonë është i lidhur me

Bashkimin Sovjetik, ashtu janë të lidhura edhe sukseset e pasçlirimit në lëmin ekonomik dhe politik. Përfaqësuesit e Bashkimit Sovjetik me shokun Molotov në krye, dora e djathtë e shokut Stalin, i kanë mbrojtur kudo dhe në çdo kohë të drejtat e popullit tonë në arenën ndërkombëtare. Politika staliniane e ka përkrahur Shqipërinë e re dhe demokracinë popullore me të gjitha forcat e saja; ajo ka bërë të demaskohen të gjitha përpjekjet e reaksionit, kërcënimet dhe intervencionet e tyre në punët e brendshme të vendit tonë. Bashkimi Sovjetik ka qenë dhe do të jetë përkrahësi i fuqishëm dhe i lavdishëm i popullit tonë në rrugën e drejtë dhe paqësore që ai ndjek. Njëkohësisht me këtë mbrojtje të fuqishme në arenën ndërkombëtare Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar Shqipërinë që të ngrejë ekonominë e vet që në ditët e para të çlirimit. Marrëveshjet tregëtare dhe ekonomike që ka lidhur shteti ynë dhe ndihma e shumanshme që i është dhënë pa kursyer popullit nga ana e qeverisë sovjetike, kanë bërë që vendi ynë të shkojë përpara, të përparojë në çdo sektor dhe jeta e popullit tonë të përmirësohet. Ndhima e dhënë nga qeveria sovjetike, ka qenë e vetmja ndihmë e drejtë dhe në baza staliniane, nga e cila populli ynë ka përfituar pa masë dhe me mirënjohje ja di për të mirë. Imperializmi anglo-amerikan drejtpërdrejt dhe me organizimin e brendshëm të reaksionit, me organizimin e sabotazheve dhe grupi tradhëtar trockist i Titos, janë përpjekur me të gjitha fuqitë e tyre që ta shkëpusin Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik, të errësojnë dashurinë e madhe që ka populli ynë për Bashkimin Sovjetik, të minojnë Partinë dhe pushtetin tonë popullor, që kështu të skllavërojnë popullin

tonë. Mirëpo të gjitha këto plane djallëzore dështuan, sepse Partia dhe populli ynë i luftoi dhe i demaskoi këto plane djallëzore të tyre dhe politika e Partisë sonë qëndroi e pathyer përpara manevrave të armikut. Partia jonë dhe populli ynë janë të lidhur në aleancë të pathyeshme me Bashkimin Sovjetik dhe me popujt e demokracive popullore. Me luftën e tij heroike dhe me përkrahjen e madhe të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore, vendi ynë gëzon një simpati të madhe në arenën ndërkombëtare dhe në opinionin e popujve përparimtarë të botës. Imperializmi amerikan dhe anglez dhe satelitët e tij, me shpifjet e panumërta të tyre, jo vetëm që nuk do të mundin dot ta errësojnë këtë simpati që ka fituar populli ynë me të drejtë, por, përkundrazi, kjo do të shtohet dita-ditës më shumë. Vendi ynë është lidhur ngushtë në aleancë me popullin vëlla bullgar dhe kjo aleancë po forcohet dita-ditës. Me Rumaninë, Poloninë, Çekoslovakinë, Hungarinë, shteti ynë është i lidhur me miqësi shumë të ngushtë dhe me marrëdhënje vëllazërore në mes të popujve tanë. Populli ynë i ka lidhur fatet e tij me fatet e popujve të Bashkimit Sovjetik dhe me fatet e popujve të demokracive popullore dhe do t'i qëndrojë besnik deri në fund kësaj politike të drejtë, jetike. Garanci për këtë është Partia jonë Komuniste dhe populli ynë. Demokracia jonë popullore dhe shteti ynë është i rreshtuar me gjithë forcat e tija në kampin demokratik dhe do ta mbrojë me mish e me shpirt politikën e drejtë dhe paqësore të kampit demokratik e antiimperialist, politikën e drejtë dhe tejpamëse, paqësore të Stalinit të madh.

Partia jonë dhe populli ynë ndjejnë një dashuri të

madhe dhe një admirim të madh për popullin vëlla demokrat grek, që po e vazhdon luftën e tij të çlirimit me kaq heroizëm e prej shumë vjetësh me radhë. Është e pamundur që populli ynë të mos ta ndjejë thellë në zemër dhëmbjen e madhe të popullit grek, që i vjen nga tragjedia e shkakuar nga anglo-amerikanët, të cilët kanë ndërhyrë ushtarakisht në mënyrën më brutale. Duke shkelur çdo ligj ndërkombëtar, amerikanët po gjakosin një popull të tërë dhe përgjegjësia e kësaj tragjedie bie e rëndë mbi ta, dhe vetëm mbi ta dhe mbi shërbëtorët e tyre, fashistët gjakatarë të Athinës. Ne e duam me gjithë zemër popullin vëlla grek, luftëtar i shquar për liri e demokraci, dhe populli ynë është me të, në përpjekjet e tija vigane, sepse ai kujton luftën e përbashkët që ndërmuarëm kundër okupatorëve italianë dhe gjermanë, sakrificat dhe vuajtjet e panumërta që bëmë së bashku për të çliruar vendet tona nga robëria e rëndë e fashizmit dhe e kapitalistëve. Por populli heroik grek s'mundi ta fitonte dot lirinë, ashtu sikundër e fitoi populli ynë. Ndërhyrja e poshtër dhe brutale e imperializmit anglo-amerikan bëri që në tokën e Greqisë të vazhdojë lufta. Po populli grek nuk u mposht dhe ai nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Greke po lufton me heroizëm dhe po korr suksese. Ushtria heroike demokratike greke, i ka thyer një rën pas tjetrës përpjekjet e armikut. Populli grek dhe ushtria e tij, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Greke e demaskuan dhe e thyen ofensivën e anglezëve, ata po thyejnë një rën pas tjetrës edhe ofensivat e monarko-fashistëve dhe të amerikanëve së bashku. Populli vëlla grek është i pathyeshëm dhe ai patjetër do të triumfojë, sepse atje lufton

i madh e i vogël me një heroizëm dhe vetëmohim kundër amerikanëve dhe fashistëve grekë për lirinë dhe pavarësinë e tij. Imperializmi amerikan dhe anglez me gjithë shërbëtorët e tyre, me njëmijë intriga, shpifje, shantazhe, kërkojnë të na hedhin fajin neve, për disfatën e madhe që pësojnë nga ushtria demokratike greke, duke na akuzuar për ndërhyrje, për furnizim armësh e shumë gjëra të tjera të paqena. Por të gjitha manevrat e tyre janë demaskuar krejt, se të gjitha janë shpifje të poshtra, që kanë pasur dhe kanë për qëllim të na bëjnë përgjegjës ne për çka ndodh në Greqi. Shteti ynë kurrë nuk ka ndërhyrë dhe nuk do të ndërhyjë në punët e brendshme të Greqisë dhe furnizimi gjoja i armëve, ushtrisë demokratike nga ana jonë, nuk është përveçse shpifje e poshtër, e trilluar nga qeveritë anglo-amerikane dhe nga agjencitë e tyre si UNSCOB-i¹. Populli shqiptar as e ka furnizuar, as do ta furnizojë me armë ushtrinë demokratike greke, sepse ai kurrë nuk do t'i lejojë vetes të ndërhyjë në punët e brendshme të Greqisë. Në qoftë se reaksioni ndërkombëtar e quan armë dashurinë e madhe që ushqen populli ynë për popullin vëlla grek, në qoftë se e quan armë admirimin dhe gëzimin e madh që ndjen populli ynë për fitoret e ushtrisë heroike demokratike greke, atëherë ne e kemi thënë dhe e themi se dashuria për popullin vëlla grek dita-ditës po shtohet në zemrat e popullit tonë. Amerikanët dhe anglezët e dinë fare mirë se ne s'kemi ndërhyrë dhe as do të ndërhyjmë në punët e brendshme të Greqisë. Po këta

¹ UNSCOB — United Nations Special Commission On the Balkans — Komisioni Special i Kombeve të Bashkuara për Ballkanin.

e bëjnë këtë gjë për të fshehur dhe për të arësytuar ndërhyrjen e tyre brutale, për të shtypur popullin grek dhe për të ndihmuar ushtarakisht fashistët e Athinës. Këta e bëjnë njëkohësisht për të zgjeruar konfliktin ndërkombëtar, dhe këtu e kanë qëllimin gjithë akuzat e poshtra ndaj Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë dhe provokacionet e panumërta, që kanë bërë dhe po bëjnë në kufirin tonë të Jugut. Po asnjë kërcënim i tyre nuk mund të na trembi, sepse politika e drejtë e Partisë dhe e shtetit tonë, vigjilenca dhe mbrojtja e fuqishme e popullit dhe e ushtrisë sonë dhe politika e lavdishme e Bashkimit Sovjetik dhe e kampit demokratik antiimperialist, do të bëjnë të dështojnë të gjitha manevrat dhe intrigat e imperializmit anglo-amerikan.

Populli ynë u ka dhënë dhe do t'u japë strehë refugjatëve grekë, burrave, grave dhe kalamanëve të pafajshëm, të ndjekur këmba-këmbës, të sakatosur e të terrorizuar nga bishat monarko-fashiste, vetëm pse ata janë demokratë dhe bij demokratësh. Statuti i Republikës sonë Popullore dhe politika e drejtë demokratike e qeverisë sonë u garantojnë strehë atyre që persekutohen për aktivitet patriotik dhe demokratik. Po qeveria shqiptare ka mbajtur gjithashtu qëndrim të drejtë ndaj gjithë ushtarakëve grekë, qofshin demokratë, qofshin monarko-fashistë, që kapërcejnë kufirin tonë. Ata kurdoherë janë kapur, çarmatosur dhe vendosur në kamp përqëndrimi.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka ndjekur gjithmonë një politikë paqësore dhe fqinjësie të mirë kundrejt Greqisë dhe gjithmonë ka shfaqur vullnetin e saj të mirë, që t'i jepet fund sa më parë gjendjes së ndeme të shkaktuar në kufitë tanë të Jugut nga

politika agresive e qeverisë monarko-fashiste, që nxitet dhe përkrahet nga imperialistët anglo-amerikanë.

Qeveria shqiptare kurdoherë ka qenë e gatshme për të bashkëpunuar në kuadrin e Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e drejtë të problemit grek. Edhe tani ajo përsërit gatishmërinë e saj për të shqyrtuar përsëri çështjen e vendosjes së marrëdhënjeve diplomatike me qeverinë e Athinës, në qoftë se kjo jep shenja që heq dorë nga politika e saj provokuese e luftëdashëse dhe nga rivendikimet e çmendura tokësore në dëm të vendit tonë. Propozimet e delegacionit tonë në sesionin e tani-shëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara frymëzohen nga kjo politikë vullneti të mirë dhe paqësore. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare mbështet pa rezerva projektrezolutën e paraqitur nga delegacioni sovjetik më 29 tetor 1948, e cila, pasi stigmatizon fajtorët e vërtetë për luftën civile në Greqi, ndër të tjera rekomandon vendosjen e lidhjeve diplomatike midis Greqisë nga njëra anë dhe Shqipërisë e Bullgarisë nga ana tjetër, vendosjen e konventave kufitare midis Greqisë, Jugosllavisë, Bullgarisë e Shqipërisë, si dhe rregullimin e çështjes së refugjatëve në një frymë mirëkuptimi reciprok, në mënyrë që të rivendosen lidhje të mira fqinjësie.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë shqyrton gjithashtu me kujdes të veçantë propozimin e bërë në 5 nëntor 1948 në Komitetin politik të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, që rekomandon mbledhjen imediate në Paris të përfaqësuesve të qeverive të Shqipërisë, të Bullgarisë, të Greqisë dhe të Jugosllavisë, që të kërkojnë mundësitë e arritjes së një akordi mbi metodat

dhe procedurën që mund të adaptohen për rregullimin e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë midis tyre.

Edhe në këtë rast, e frymëzuar si gjithnjë nga politika paqësore e demokratike, ajo përsëri është gati të bisedojë në rrugën e drejtë për zgjidhjen e problemit grek dhe për vendosjen e marrëdhënjeve normale me Greqinë.

Pra, politika e jashtme e Partisë sonë dhe e shtetit tonë do të jetë forcimi dhe çelnikosja e dashurisë dhe e besnikërisë ndaj Bashkimit Sovjetik. Partia jonë dhe populli ynë do të ndjekin me besnikërinë më të madhe dhe do të luftojnë me gjithë forcat për mbrojtjen e politikës staliniane. . . Të bashkuar me Bashkimin Sovjetik, në rrugën e drejtë të tij, të bashkuar me kampin demokratik antiimperialist, populli ynë do të ecë me vendosmëri të madhe drejt socializmit për mbrojtjen e paqes dhe të sigurimit në botë. Kjo është vija e Partisë sonë në politikën e jashtme.

B. Lufta kundër ndërhyrjes anglo-amerikane. — Imperialistët anglo-amerikanë janë përpjekur gjithmonë që Shqipërinë ta përdorin si monedhë shkëmbimi në transaksionet e tyre ndërkombëtare, ta kthejnë në një bazë shfrytëzimi kapitalist dhe në një bazë observimi, intrigash dhe luftime në Ballkan.

Në politikën e tyre agresive ekspansioniste kundër kampit të socializmit, që ka në krye Bashkimin Sovjetik, ata kanë përqëndruar sulmet e tyre kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, se e kujtojnë një pikë të dobët dhe se vendi ynë, me pozitën e tij, është një thikë në zemër për planet imperialiste.

Përpjekjet e tyre për të dëmtuar popullin tonë dhe

për të luftuar demokracinë tonë kanë qenë të pareshtura dhe të turpshme.

Misionet angleze dhe amerikane, që kishin ardhur në Shqipëri gjatë periudhës së luftës, na kanë ndihmuar fare pak me armë dhe me municione, gjë për të cilën ata duhej të kishin ardhur, por qëllimet e tyre kanë qenë të tjera. Gjatë periudhës së luftës ne kemi qenë në konflikt të përhershëm me ta. Misionet në fjalë kishin ardhur për ta dobësuar luftën e popullit tonë dhe jo për ta ndihmuar; ata u përpoqën dhe u vunë në lidhje me «Ballin Kombëtar» dhe me krerët e tij që haptas bashkëpunonin me okupatorët italianë dhe gjermanë; ata u përpoqën të organizonin dhe të forconin pozitat e reaksionit; ata u munduan dhe krijuan «Legalitetin» për të luajtur kartën e Zogut; ata u përpoqën të pengonin luftën tonë kundër kuislingëve dhe tradhëtarëve; ata na kërcënonin; ata u orvatën të zbarkonin në vendin tonë gjatë kohës së luftës. Po të gjitha këto u demaskuan dhe misionet angleze dhe amerikane dështuan në planet e tyre. Pas çlirimit të Shqipërisë ata vazhduan të qëndronin në Shqipëri gjoja për të përgatitur njohjen e Shqipërisë dhe të qeverisë së saj. Po qëllimi ishte gjetkë. Pas disfatës që pësoi reaksioni i brendshëm në Shqipëri, reaksioni amerikan dhe anglez u përpoq që ta grumbullojë, t'i japë zemër dhe ta organizojë atë për ta hedhur në luftë kundër pushtetit popullor. Ai u përpoq në këtë mënyrë ta bëjë Shqipërinë një Greqi të dytë: Në të gjitha veprimet e tradhëtarëve në Shqipëri, frymëzuesit dhe organizatorët direkt kanë qenë anglezë dhe amerikanë, që ishin me misione në Tiranë. Kjo gjë është e provuar dhe e dokumentuar. Por edhe këto përpjekje të tyre

dështuan të gjitha. Populli shqiptar ishte vigjilent për të ruajtur atdheun e tij, lirinë, pavarësinë, demokracinë dhe fitoret e luftës. Nervat e popullit tonë ishin të shëndosha dhe as kërcënimet, as shantazhet e anglo-amerikanëve nuk e tronditën për asnjë moment. Anglo-amerikanët megjithëqë e panë se në vendin tonë planet e tyre dështuan dhe përpara botës u zbuluan qëllimet agresive të tyre, s'i hodhën armët. Ata filluan t'i bëjnë vendit tonë një fushatë të ashpër ndërkombëtare. Anglo-amerikanët, pa pikë turpi, na kanë mohuar të drejtat tona, që i kemi fituar me gjak, ata krijuan incidente, si ai i Sarandës, incident i krijuar kokë e këmbë nga anglezët; ata nxitin monarko-fashistët grekë, të na provokojnë dita-ditës në kufi, të na vrasin ushtarët tanë, të kërkojnë Korçën e Gjirokastrën e të tjera poshtërsi të tilla. Reaksioni amerikan dhe anglez e akuzuan vendin tonë si një vend agresor, që rrezikon paqen, që është shkak-tari i luftës në Greqi dhe se gjoja lufta në Greqi furnizohet nga ne me armë e me municione. Të tilla janë përpjekjet e reaksionit anglo-amerikan kundër vendit tonë, po të gjitha këto tentativa të poshtra, shpifëse. do të dështojnë, si dështuan dhe tentativat e para.

Gjatë luftës misionet amerikane dhe angleze, që kishin ardhur pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nac.-Çl. që ishte një ushtri alcate, kanë punuar si armiq. Ata kanë sabotuar luftën tonë, kanë tentuar të pengojnë fitoret e Frontit Nac.-Çl. të popullit tonë dhe të mbajnë në fuqi pas çlirimit një qeveri feudalo-borgjeze që t'u bënte punën. Faktet janë të shumta:

1. — Qeveritë amerikane dhe angleze nuk e kanë propaganduar drejt, por e kanë shtrembëruar luftën to-

në kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve. Më 20 tetor 1943 oficeri anglez Pitër Kemp shkruan në këtë mënyrë: «... Kur BBC-ja lavdëronte «Ballin Kombëtar», ajo kishte ndër mend të lavdëronte lëvizjen nacional-çlirimtare».

2. — Misionet angleze dhe amerikane kanë bashkëpunuar me grupet dhe me qeveritë kuislinge dhe kanë pasur kontakt edhe me okupatorët gjermanë. Ata u dhënë ndihma me armë, municione dhe ushqime «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe Bazit të Canës si dhe grupeve të Muharrem Bajraktarit e të Fiqri Dines, që të gjithë në kompromis të hapur dhe në bashkëpunim të ngushtë me gjermanët. Pranë kriminelit të luftës Abaz Kupit qëndroi deri në ditën e fundit një mision anglez me në krye kolonelin Mak Lin; me kriminelët Gjon Marka Gjoni e Kolë Bibë Mirakaj, ishte majori Niil, i cili në vigjiljen e çlirimit të Shqipërisë, shëtiste në Shkodër përkrah oficerëve gjermanë të Gestapos. Në qendrën e shtabit të kuislingëve Fiqri Dine, Xhem Gostivari, Hysni Dema, rrinte misioni anglez, i kryesuar nga majori Pitër Kemp, majori Ridël dhe kapiteni Hends. Pranë kuislingut Skënder Muço në Dukat të Vlorës qëndronte një mision amerikan.

Më 3 nëntor 1943 majori Ridël i shkruante kolonelit Haxhi Lleshi që të ndërpriste luftën kundër kuislingëve Fiqri Dine, Xhem Gostivari, Hysni Dema, etj.

Më 14 korrik 1944, nënadmiralet i ajrit Uilliam Eliot, në emër të Komandantit Suprem Aleat të Mesdheut, kërcënonte Gjeneral Hoxhën se po të godiste bandat e kriminelit Abaz Kupi, «do të ishte i shtërnguar t'i priste çdo furnizim UNÇSH».

Letra e nënadmiralit Eliot u shoqërua nga ultimatum verbal i kolonelit Palmer, i cili në momentin më kritik, kur Divizioni ynë i parë ndodhej krejt i angazhuar në luftime kundër gjermanëve, kanosej se do t'i priste divizionit furnizimin me armë. Shtabi ynë i Përgjithshëm nuk pranoi pikëpamjen e nënadmiralit Eliot dhe e refuzoi ultimatumin e kolonelit Palmer duke i vënë kështu përpara përgjegjësisë, të gjithë oficerët anglezë, që ndodheshin në Shqipëri për çdo humbje që do të pësonte divizioni si rrjedhim i një akti të atillë arbitrar dhe të padrejtë, sepse Abaz Kupi, i mbrojtur nga Kuartieri i Përgjithshëm i Mesdheut, ishte një tradhëtar që bashkëpunonte hapët me gjermanët dhe se forcat e tija mercenare ishin radhitur në një front me gjermanët kundër Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Gjithë aktiviteti tradhëtar i Abaz Kupit në bashkëpunim me gjermanët dëshmohet nga dokumentat gjermane, që janë në dorë të qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.

3. — Është provuar dhe dokumentuar se misionet amerikane dhe angleze në vigjiljen e çlirimit të plotë të Shqipërisë, tërhoqën me anë të detit dhe i shpunë në Itali kuislingët kryesorë shqiptarë: Mehdi Frashërin, Abaz Kupin, Mithat Frashërin, Ali Këlcyren, etj., për t'i shpëtuar nga hakmarrja e popullit e për t'i ruajtur si rezerva për planet e tyre armike kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

4. — Për të penguar fitoren e Frontit Nacional-Çlirimtar dhe vendosjen e pushtetit popullor në Shqipëri, qeveritë amerikane dhe angleze hynë në marrëveshje

dhe me nazistët gjermanë dhe u përpoqën të zbarkojnë në Shqipëri:

a) Është e provuar se në shtabin e Xhem Gostivarit dhe të Fiqri Dines ndodheshin 3 majorë gjermanë, të cilët drejtonin operacionet kundër partizanëve. Agjentët e Gestapos, Helmut Mauth dhe Viktor Pen, të kapur nga oficerët tanë me gjithë dokumentat e tyre, kanë pohuar përpara gjyqit të popullit sa vijon:

«Më ndërmjetësinë e majorit Niil, Korparmata XI gjermane, që vepronte në zonën e Shkodrës mori propozimin për bashkëpunimin me forcat britanike, që do të zbarkonin në Shqipëri».

b) Në muajin shtator 1944, atëhere kur Ushtria Nacional-Çlirimtare ishte në gjendje jo vetëm të kryente aksione të veçuara, po të bënte një luftë frontale kundër gjermanëve, koloneli Palmer, kryetar i misionit ushtarak britanik në Shqipëri, në letrën e tij të 16 shtatorit 1944, kërkon nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare autorizim të zbarkojnë një sërë trupash speciale. Pasi arritja e këtyre trupave nuk ishte e nevojshme, koloneli Palmer nuk u autorizua të zbarconte njerëz.

Të gjitha këto plane dhe manevra kriminale të imperialistëve anglo-amerikanë u asgjësuan nga vrulli revolucionar i luftës së popullit tonë, që udhëhiqej nga Partia e lavdishme Komuniste dhe që kishte ndihmën vendimtare të Bashkimit Sovjetik. Shqipëria u çlirua, populli fitoi, u vendos pushteti popullor dhe ju vu gardh i patundur një herë e përgjithmonë ndërhyrjes së ujqërve imperialistë.

Pas çlirimit populli shqiptar priste me plot të drejtë

që të vendoste marrëdhënje miqësore normale me ish-alcatët e luftës. Po qeveritë amerikane dhe angleze në këtë periudhë kundrejt Shqipërisë së re demokratike ndoqën një politikë më të ashpër se përpara dhe që karakterizohet me fjalën luftë; luftë në planin e brendshëm, luftë në planin ndërkombëtar për të përmbysur me çdo mjet pushtetin tonë popullor dhe për të zhdukur independencën dhe integritetin tonë tokësor. Kjo luftë është pjesë e pashkëputur e luftës kryesore midis kampit imperialist dhe kampit të socializmit, në të cilin bën pjesë me të gjitha forcat Republika jonë Popullore.

Në planin e brendshëm kjo luftë paraqitet nën këto forma:

- a) mosnjohja e qeverisë,
- b) tentativa për ndërhyrje të armatosur,
- c) spiunazh, sabotime e komplete për të përmbysur me anë të forcës pushtetin popullor.

Qeveria demokratike e Shqipërisë që në Berat kërkoi njohjen e saj nga qeveritë aleate. Ata nuk e njohën qeverinë tonë dhe pas çlirimit zgjeruan misionet e tyre në Shqipëri gjoja për t'u informuar mbi situatën e vendit përpara se të njihnin qeverinë. Në shkurt-mars 1945 misioni anglez u zgjerua dhe në krye të tij erdhi gjenerali D.E.P. Hoxhson; në maj 1945 erdhi një mision civil amerikan me kryetar J.E. Xhejkobs dhe nënkryetar agjentin e vjetër të imperializmit amerikan në Shqipëri, Herri M. Fulc. Njëkohësisht qëndronin prej mjaft kohe edhe oficerët amerikanë si Thoma Stefani, etj.

Këto misione zhvilluan një aktivitet të gjerë kriminal dhe kishin ndihmën aktive në fillim të Militari Liezon (M.L.). Po ato nuk mund të mos shikonin forcën

e pushtetit popullor, qëndrimin e vendosur të qeverisë sonë kundrejt manevrave të tyre, lidhjet e popullit me qeverinë, sukseset e realizuara nga pushteti popullor. Parulla e tyre «nuk e kemi akoma të qartë situatën» nuk pinte më ujë, prandaj duhej të bënin një veprim të ri për të mos u demaskuar fare. Kështu më 10-12 nëntor 1945, në kohën kur po ziente fushata elektorale për Asamblenë Kushtetuese dhe me qëllim që të influencojnë mbi këto zgjedhje, qeveritë angleze dhe amerikane i komunikuan qeverisë shqiptare se ishin gati ta njihnin «por me disa kondita». Kjo gjysmënjohje që një manevër politike, për të ngjallur pasiguri në popull në prakun e zgjedhjeve, që Fronti të mos fitonte një përqindje të madhe në zgjedhjet e kështu ata të kishin shtegun e hapur për presione dhe ndërhyrje të reja kundër pushtetit popullor. Po fitorja dërmuese e Frontit Demokratik i prishi planet e tyre djallëzore. Konditat angleze, që zgjedhjet të bëheshin të lira dhe korrespondentët e huaj të kishin të drejtë të hynin në Shqipëri e të raportonin mbi zgjedhjet, s'kishin baza, sepse qeveria jonë dhe ligji elektorale i kishin marrë të gjitha masat me kohë. Kështu që qeveria angleze u detyrua të plotësojë formalitetin e njohjes dhe të caktojë dhe ministrin e saj në Tiranë, Thoma Sesil Rap, i cili nuk erdhi kurrë në Tiranë, siç do ta shohim më pas. Konditat amerikane ishin më të studjuara, më armiqësore: veç zgjedhjeve të lira, qeveria amerikane kërkonte që ne të njihnim edhe traktatet e vjetra, që kishte nënshkruar satrapi Ahmet Zogolli me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një mot të tërë qeveria amerikane me anë të Xhejkobit dhe me anën e agjentëve të saj, brenda dhe jashtë Shqipërisë,

me anën e përfaqësuesve të saj në konferencat ndërkom-bëtare, sidomos në atë të Parisit dhe në Këshillin e Sigurimit, s'la gurë pa luajtur dhe presion pa bërë që ta detyronte qeverinë shqiptare t'i njihte këto traktate. Po Partia dhe qeveria jonë kundërshtoi deri në fund, sepse të njiheshin këto traktate, do të thoshte që t'i hapeshin dyert e Shqipërisë imperializmit amerikan, i cili do të mund të realizonte kështu qëllimet e tija e ta transformonte vendin tonë në një Greqi të dytë.

Qeveria angleze atëhere vendosi ta përdorte rastin e ministrit të saj si një mjet për të bërë presione dhe për të nxjerrë koncesione të papranueshme nga qeveria jonë.

Kur edhe kjo manevër dështoi, qeveria angleze krijoi një tjetër intrigë:

Më 18 maj 1946, ministri anglez në Beograd i dorëzoi ministrit tonë atje një notë të qeverisë së tij, me anën e së cilës ajo deklaronte se do të dërgonte menjëherë ministrin e saj në Tiranë. 20 minuta më vonë ministri anglez në Beograd e tërhoqi notën e sipërme nga legata jonë, me pretekst se ishte lajmëruar se më 15 maj 1946, dy luftanijet angleze, Superb e Orion, ishin qëlluar nga bateritë tona bregdetare në kanalën e Korfuzit. Kjo komedi trashanike e qeverisë angleze është tipike për të treguar se ç'manevra, ç'intriga djallëzore e provokacione të fëlliqura kurdisën imperialistët anglezë për të këputur marrëdhënjet diplomatike me ne, që në realitet nuk u vendosën asnjëherë.

Nën dritën e fakteve të shumta del e qartë se reaktionarët amerikanë dhe anglezë çështjen e njohjes së qeverisë kanë dashur ta përdorin si një armë nga njëra

anë për të bërë presione dhe shantazhe mbi qeverinë tonë dhe, nga ana tjetër, për të inkurajuar armiqtë e pushtetit popullor brenda në Shqipëri dhe kriminelët e luftës përjashta.

Që në kohën e luftës anglo-amerikanët deshën të zbarkonin në Shqipëri. Është merita e madhe e Partisë sonë që nuk pranoi zbarkimin e trupave imperialiste dhe kështu shpëtoi vendin nga një okupacion i ri mizor. Përveç kërkesave të 16 dhe 19 shtatorit të vitit 1944 imperialistët tentuan dhe më pas për ndërhyrje të armatosur direkte në Shqipëri, siç është kërkesa e feldmareshalit Aleksandër më 22 janar 1945, që misioni ushtarak aleat të vendosej me një mision ushtarak britanik mjaft të gjerë dhe me në krye një gjeneral. Qeveria dhe Partia jonë refuzoi dhe pranoi vetëm që, derisa të njihej qeveria, të qëndronte në Shqipëri misioni i vjetër, i cili në realitet përbëhej vetëm nga oficerë anglezë. Pa dyshim ultimatumit i feldmareshalit Aleksandër nuk mungoi të arrinte dhe kërkonte që «sidomos t'i tregohet Gjeneral Hoxhës se, në rast se ai nuk do të dëshironte ta pranonte propozimin për një mision, një akt i tillë do ta vononte patjetër njohjen akoma më tepër». Ai kërkonte përgjegje brenda «tri ose katër ditësh e shumta».

Qeveria britanike me anën e këtij misioni të ri, në formë, deshte të informohej mbi gjendjen në Shqipëri përpara se të njihte qeverinë. Në realitet ky mision i ri do t'i shërbente si pararojë për një ndërhyrje të gjerë të armatosur. Kjo u provua më pas, me ardhjen e misionit ushtarak të Liezonit (M.L.), i cili gjoja do të sillte ndihma, derisa të fillonte nga puna UNRRA.

Kryetari i misionit ushtarak M.L. i parashtroi qe-

verisë sonë një konditë sine qua non, d.m.th. se në rast refuzimi të konditave të tija, arritja e ndihmave të UNRRA-s në Shqipëri do të ishte e pamundur. Cilat ishin konditat e M.L., të paraqitura qeverisë sonë? Kondita e parë ishte zbarkimi në Shqipëri i 1500-1700 oficerëve dhe teknikëve anglezë për të siguruar ndarjen e ndihmave që do të sillte ajo organizatë. Ky personel do të vendosej në Portin e Durrësit, në atë të Vlorës dhe gjatë, duke pasur zona të caktuara në këto porte, d.m.th. duke pasur në duart e tyre dhe duke okupuar gjithë portet e Shqipërisë. Ky propozim sinjifikativ u refuzua kategorikisht. As numri i këtyre personave as propozimet e tjera të M.L. nuk u pranuan. Përpara qëndrimit të qeverisë shqiptare misioni i M.L. u detyrua ta zbrësë numrin e sipërshënuar në 80 persona.

Synimet e M.L. ishin të qarta: të pushtonin Shqipërinë me anë të forcës së armatosur, duke organizuar edhe kryengritjen nga brenda dhe të përmbysnin qeverinë demokratike, pushtetin popullor. Këto manevra banditësh kundër një populli të vogël heroik, që u sakrifikua për lirinë dhe pavarësinë e tij, ishin të maskuara në dëshirat gjoja filantropike. Mirëpo ato u demaskuan dhe u shkallmuan nga Partia jonë, që e kuptonte shumë mirë se ku e kishin qëllimin imperialistët.

Anglo-amerikanët janë munduar të koordinojnë zbarkimin e tyre në Shqipëri me lëvizje dhe komplete nga brenda, siç është rasti i ngjarjeve të Shkodrës në shtator 1946, të cilat nuk mund të shkëputen nga i ashtuquajti incident i kanalit të Korfuzit. Ata janë munduar njëkohësisht, duke përdorur Greqinë monarko-fashiste, të krijojnë një situatë të favorshme për ndërhy-

rje të armatosur në Shqipëri. Po edhe në këto raste, planet e tyre janë shpartalluar.

Megjithëse kishte arësye të shëndosha për të mbajtur një qëndrim tjetër, qeveria shqiptare i trajtoi kurdoherë me bujari misionet amerikane dhe angleze. Si gjeneral Hoxhsoni, si mister Xhejkobsi dhe mister Fulci si dhe të gjithë pjesëtarët e tjerë të misioneve, qarkullonin lirisht në të katër anët e Shqipërisë dhe merrnin kontakt me të gjithë ata që dëshironin. Faktet dëshmojnë se akuzat e tyre se gjoja qeveria shqiptare i pengonte «në punën e tyre», se nuk i lejonte «të qarkullonin lirisht» dhe se misionet «ishin përkufizuar në Tiranë në zyrat e tyre», janë shpiçje të thjeshta. Vetë dokumentat e nënshkruara nga gjeneral Hoxhsoni dhe nga Xhejkobsi në shumë raste e dëshmojnë këtë. Çdo lehtësi, që kërkohet nga autoritetet shqiptare, u akordohej menjëherë. Ata vetë asistuan dhe shfaqën përgëzimet e tyre për zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese më 2 Dhjetor 1945.

Po këtyre akteve dashamirësie të qeverisë shqiptare, ata u përgjigjeshin krejt ndryshe.

Gjeneral Hoxhsoni në korrik të vitit 1945, kur shkoi në Shqipërinë e Jugut është shprehur tekstualisht kështu: «Forma e qeverisë shqiptare është një diktaturë». Duke folur mbi provokacionet greke në kufi, gjeneral Hoxhsoni i ka thënë tekstualisht komandanit të Divizionit tonë III: «Provokacionet e bëra prej grekëve, nuk janë gjë tjetër veçse përshëndetje». Në lidhje me zgjedhjet gjeneral Hoxhsoni ka thënë: «Zgjedhjet në Shqipëri bëhen në kinema «Kosova» me forcën e bajonetave partizane».

Kur misioni ushtarak britanik u largua nga Durrë-

si, oficeri anglez Niil u shpreh botërisht kështu: «Ne do të kthehemi në një mënyrë tjetër». Duhet një libër i tërë për të numëruar ndërhyrjet e misionit britanik në punët e brendshme të Shqipërisë. Po këtu ne do të kufizohemi të citojmë vetëm një dokument të nënshkruar prej një personaliteti të lartë britanik në Shqipëri, dokument, i cili përmban një raport sekret dhe konfidencial P.L. — SEC-L-54-5, drejtuar zyrës së tij më 6 prill 1946: «Duhet kujtuar se gjeneral brig, Hoxhsoni që komandonte misionin ushtarak britanik ka adoptuar një qëndrim pa kompromis me qeverinë shqiptare. Ai shprehej gjithmonë në një mënyrë brutale kundrejt Shqipërisë. Ai lëvdohej shpeshherë që ka thënë: «Jashtë Hoxha». Në fillim gjenerali Hoxhson kishte të gjitha lehtësitë për të qarkulluar lirisht kudo në Shqipëri dhe fakti që këto lehtësi u kufizuan më vonë, ka rrjedhur plotësisht nga qëndrimi i tij, po megjithkëtë, gjenerali Hoxhson, deri në ditët e fundit të qëndrimit të tij në Shqipëri, ka qenë gjithmonë në pozita gjuajtjeje».

Në të njëjtën mënyrë silleshin dhe amerikanët Xhejkobs, Fulc dhe Henderson.

Por krahas këtij aktiviteti armiqësor të hapët, legal si të thuash, misionet anglo-amerikane në Shqipëri kanë zhvilluar një aktivitet ilegal të shumanshëm, që synonte t'i vinte kazmën pushtetit tonë popullor dhe vetë ekzistencës së shtetit tonë independent e sovran.

Misionet anglo-amerikane në Tiranë qenë agjuntura të vërteta spiunazhi, sabotimi dhe komplotesh të armatosura. Ato u bënë qendrat e grumbullimit, të ndërlidhjes, të organizimit e të drejtimit të të gjithë armiqve të popullit, të kriminelëve të luftës dhe të bejlerëve, të

agallarëve dhe të tregëtarëve të goditur nga reformat tona, të klanit të intelektualëve reaksionarë, të oficerëve të vjetër, të spiunëve, të grave imorale dhe të të gjithë plehrave të vendit tonë, të të gjithë armiqtve të pushtetit e të popullit shqiptar. Ato u bënë ofiçina, ku kurdiseshin komplete, sabotime, atentate, ku përgatiteshin sulme të armatosura kundër qyteteve tona dhe hartoheshin plane për zbarkim.

Në gjyqet e popullit kundër Sami Qeribashit, kundër sabotatorëve të Maliqit dhe kundër grupit të deputetëve, u zbulua deri në rrënjë, aktiviteti i vjetër armiqësor konsekuent i imperialistëve anglo-amerikanë ndaj popullit tonë, u zbuluan planet e tyre, taktika e metodat e tyre, armiqësia e tyre e betuar kundër popullit tonë, kundër pushtetit tonë popullor, kundër gjithë demokracive popullore dhe Bashkimit Sovjetik.

Pas çlirimit të Shqipërisë kanë ardhur nëpërmjet Barit 95 oficerë anglezë, si pjesëtarë të misionit ushtarak anglez; më shumë se 50 amerikanë pranë misionit ushtarak civil; 101 pjesëtarë të misionit M. L. dhe të UNRRA-s; që të gjithë këta kanë qenë agjentë dhe spiunë të imperializmit.

Gjyqi kundër Sami Qeribashit, Gjergj Kokoshit e të tjerëve zbuloi rolin armik të kolonelit Palmer dhe të majorit Smith, kurse ai i sabotatorëve të Maliqit zbuloi Herri Fulcin. Por gjyqi i deputetëve tradhëtarë hodhi dritë të plotë mbi gjithë politikën armiqësore të imperialistëve anglo-amerikanë në Shqipëri.

Misioni anglez, së bashku me fashistët italianë të mbetur në Shqipëri, më 1944 organizoi djegjen e Kuvçovës. Misioni amerikan organizoi sabotimin e Maliqit.

Ata organizuan grupin e deputetëve «komiteti qendror», i të cilëve kishte lidhje me Hoxhsonin, Fulcin, Xhejkobsin dhe me funksionarët e UNRRA-s; organizuan sabotimet në Kuçovë, Patos, Rubik; mbanin lidhje me korrespondencë me kriminelët e luftës si Jup Kazazin e Muharrem Bajraktarin dhe me kriminelët e tjerë të luftës të strehuar në Itali e në Greqi. Ata kishin pregatitur në Shqipëri prej vjetësh agjentët e tyre informatorë dhe sabotatorë. Gjyqet e popullit nxuarën në shesh aktivitetin armiqësor, të vjetër dhe të tërbuar të agjentit bandit amerikan Herri Fulc.

Misionet anglo-amerikane në Shqipëri u munduan që t'i grumbullonin e t'i organizonin gjithë armiqtë e pushtetit popullor, kriminelët e luftës të arratisur, t'i ndërlihdnin me kriminelët e luftës në Itali e në Greqi, të koordinonin aktivitetin e këtyre njerëzve e grupeve antipushtet me provokacionet dhe rivendikimet monarko-fashiste, me incidentet e kanalit të Korfuzit, me konferencat ndërkombëtare dhe me fushatat e tërbuara të shtypit reaksionar në shërbim të imperializmit, kundër pushtetit popullor, kundër integritetit tokësor, kundër independencës dhe jetës së popullit tonë si dhe kundër gjithë kampit demokratik antiimperialist, të kryenin një zbarkim anglo-amerikan në Shqipëri. Po ky zbarkim as nuk u bë, as nuk do të bëhet kurrë. Llogaritë e armiqve të vendit dhe të popullit tonë dualën të gabuara dhe me rezultate të hidhura për ta.

Imperialistët anglo-amerikanë kanë iu ituar sistematikisht të drejtat tona në fushën ndërkombëtare. Vërtet Shqipëria është një vend i vogël, po në arenën ndërkombëtare ka edhe ajo vendin e vet të merituar dhe

rëndësinë e saj, ka interesat dhe të drejtat e saja për t'i mbrojtur dhe për t'i bërë që të respektohen nga të tjerët. Republika Popullore e Shqipërisë është një faktor pozitiv për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botë dhe zë një vend nderi në kampin e fuqishëm të demokracisë, në kampin e luftës kundër planeve imperialiste. Karakteri dhe sukseset e pushtetit popullor në Shqipëri, politika e drejtë, paqësore e demokratike e qeverisë sonë, lufta e saj konsekuente për mbrojtjen e interesave kombëtare përjashta, miqësia jonë besnike ndaj Bashkimit Sovjetik dhe lidhjet tona me gjithë popujt e demokracive popullore si dhe me gjithë popujt përparimtarë të botës kanë forcuar pozitën ndërkombëtare të vendit tonë. Fakti që popullit shqiptar dhe demokracisë së tij popullore po i bëhet një luftë e padrejtë dhe e pandershme nga anglo-amerikanët dhe shërbëtorët e tyre, e justifikon rolin e demokracisë sonë në mbrojtjen e paqes dhe të sigurimit botëror, justifikon gjithashtu politikën e drejtë dhe të matur të qeverisë së Republikës sonë.

Përfaqësuesit e qeverive anglo-amerikane kanë marrë qëndrim të prerë kundër të drejtave të Shqipërisë në gjithë konferencat dhe organizatat ndërkombëtare:

a) Në Konferencën e dëmshtëpërblimeve nga Gjermania, që u mbajt në Paris më 1945, përfaqësuesit amerikanë dhe anglezë u munduan ta ndalojnë pranimin e Shqipërisë, por s'mundën, vetëm bënë që ne të na caktohet një kuotë shumë e vogël, që s'ka asnjë krahasim me dëmet e sakrificat tona gjatë luftës.

b) Pranimi i Shqipërisë në OKB që nga Konferenca e San Franciskos e deri sot është kundërshtuar me këmbëngulje nga SHBA dhe nga Angli pa asnjë arsye.

Më 13 shkurt 1946, kur Këshilli i Sigurimit në Londër mori për herë të parë në diskutim pranimin e Shqipërisë në OKB, Kadogani mbrojti shpifjet greke kundër Shqipërisë dhe deklaroi se «Greqia ka interesa në Shqipëri»; po atë ditë Bevini, duke kundërshtuar pranimin e Shqipërisë në atë kohë, midis të tjerave, deklaroi: «Po të shtërngohesha të them sonte fjalën time, do të më duhej të votoj kundër pranimin të Shqipërisë».

Dhe këtë e bëri Kadogani dy herë me radhë duke vënë veton kundër pranimin të Shqipërisë, dhe në gusht 1946 edhe në gusht 1947.

Në gusht 1946, Xhonsoni (Shtetet e Bashkuara) shfaqti dyshim mbi Shqipërinë dhe kërkoi që Këshilli i Sigurimit të mos merrte asnjë vendim mbi Shqipërinë dhe Mongolinë po të pranonte shtetet e tjera si Irlandën, Portugalinë, etj. Qëndrimi i prerë dhe i drejtë i delegacionit sovjetik, që mbrojti me vendosmëri të drejtat e Shqipërisë për t'u pranuar si anëtare e OKB-së i detyroi delegatët amerikanë dhe anglezë të zbulojnë kartat e tyre që ishin për të votuar kundër pranimin të Shqipërisë. Kështu bënë dhe më 1947. Argumentat e tyre kanë qenë se Shqipëria nuk kishte lidhje diplomatike me Anglinë dhe Amerikën, se nuk kishte njohur traktatet e vjetra, se Greqia kishte kundërshtime, pasi e quante veten në gjendje lufte me Shqipërinë dhe kishte rivendikime tokësore kundrejt saj. Më vonë, këtyre argumentave ju shtuan akuza të reja se gjoja Shqipëria prish paqen (në lidhje me incidentet e kanalit të Korfuzit) dhe se ndërhyr në punët e brendshme të Greqisë.

«Shqipëria s'është më një vend që të merret nëpër këmbë dhe as të bëhet plaçkë tregu i asaj diplomacie

që është përgjegjëse e Luftës së dytë botërore. Pozitat që zë Shqipëria në gjirin e kombeve antifashiste, nuk ja fali njeri, por i fitoi me gjak dhe me sakrificë mbi-njerëzore. Populli ynë, që u hodh pa rezerva në luftën antifashiste, për të drejtat e tija, për të drejtat e njerëzimit, për forcimin dhe triumfin e demokracisë, për liritë e popujve, kërkon me këmbëngulje dhe me ballin lart t'i respektohen të drejtat e tij. Populli shqiptar, besnik deri në fund i aleancës së madhe antifashiste, me zemërim dhe me indignacion sheh të shtyhet kërkesa e tij legjitime për të qenë anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara»¹ prej ish-aleatëve të tij, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

c) «Kur populli shqiptar luftonte trimërisht kundër fashizmit, të tjerët i hidhnin lule, por kur erdhi koha që ai të kërkonte vendin e tij kaq shumë të merituar në OKB ose në Konferencën e Paqes, i hodhën gurë»². Asnjëri s'mund të kundërshtonte të drejtën e pjesëmarrjes së Shqipërisë, viktimë e parë e agresionit të Italisë fashiste, në Konferencën e Paqes në Paris. Po Anglia me Amerikën e bënë këtë.

Ata qenë kundër regjistrimit të Shqipërisë nga Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme në listën e shteteve fituese, anëtarë të Konferencës së Parisit, kundër thirrjes së Shqipërisë në konferencë me të drejta të barabarta ose me votë konsultative.

Kur po diskutohej në seancën plenare propozimi për thirrjen e Shqipërisë, përfaqësuesi amerikan Xheim

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 3, f. 312.

² Po aty, f. 447.

Birnez u deklarua kundër Shqipërisë me këto fjalë: «Be-soj që jemi dakord me faktin se është e pamundur që të ftojmë Shqipërinë duke u bazuar në akordet e përfunduara në Moskë».

Ditën tjetër mori fjalën Lordi Aleksandër, delegat britanik, i cili tha: «Do të them pa pikë dyshimi se e përkrah plotësisht propozimin e parashtruar dje prej zotit Birnez në lidhje me këtë çështje, propozim që sy-non t'i këshillojë konferencës ta shtyjë këtë kërkesë. Nuk bashkohem aspak me propozimin e bërë dje prej zotërinjve Vishinski dhe Manuilski, të cilët këshillojnë që të shqyrtohet që tani çështja e pranimi të Shqipërisë me të drejta konsultative, duke shqyrtuar dhe vendosur veçanërisht para se të shqyrtohen gjithashtu elementet që janë parashtruar ose që mund të parashtrohen më vonë prej vendeve të tjera. Dëshiroj të vë në dukje në lidhje me këtë çështje se Shqipëria nuk është një komb aleat dhe nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara...».

Në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë ne kishim paraqitur mendimin tonë dhe kërkesat tona, të cilat jo vetëm që ishin të drejta të pamohueshme, po ishin dhe modeste. Kishim kërkuar që në artikullin 21 të projekt-traktatit me Italinë, atje ku thuhet se «Italia e njeh dhe detyrohet të respektojë sovranitetin dhe independencën e shtetit shqiptar», të shtohet dhe fjala integritet. Kishim kërkuar që të na kthehet ari i grabitur prej Italisë fashiste dhe që ishte transportuar në Gjermani; kishim kërkuar që ne të konsideroheshim si fuqi-shoqe (puissance associée); kishim kërkuar dëmshpërblime nga Italia. Të gjitha këto kërkesa tona të drejta u mbrojtën

me mish e me shpirt deri në fund nga përfaqësuesit sovjetikë si dhe nga delegacionet e demokracive popullore, po, më në fund, nën presionin e delegacioneve angleze dhe amerikane këto kërkesa u rrëzuan. Delegati britanik Hud deklaroi dhe insistoi që «Shqipëria të marrë zero dollarë». Këtë qëndrim mbajti edhe delegati amerikan, gjatë gjithë konferencës përsa u përket të drejtave tona.

Në Nju-Jork, në KMPJ, përfaqësuesi amerikan Birnez bërtiste se nuk mund të pranonte kurrë që Shqipëria të marrë dëmshpërblime nga Italia. U duk haptas se në atë konferencë, ku duhej të bëhej procesi i Italisë agresore dhe të merreshin masa kundër saj, nga shumë shtete të Perëndimit u mbrojti Italia dhe u shqelmuar të drejtat e atyre popujve që derdhën kaq gjak për liri dhe demokraci.

ç) Në sesionin e Moskës (mars—prill 1947) të KMPJ mbi përgatitjen e Traktatit të paqes me Gjermaninë, duke kundërshtuar të drejtat e Shqipërisë për të marrë pjesë në këto përgatitje, anglo-amerikanët s'patën turp të mohojnë edhe luftën e popullit tonë:

«Ne jemi të mendimit, tha delegati amerikan Mërfi, se së pari Shqipëria nuk është fqinjë e Gjermanisë dhe, së dyti, ajo nuk ka marrë pjesë në luftë kundër Gjermanisë. Vetëm disa shqiptarë të veçuar, ndoshta, muarën pjesë në këtë luftë, po veç kësaj pati edhe shqiptarë që luftuan krahas me gjermanët».

Në lidhje me këtë Vishinski bëri vërejtjen që vijon:

«Deklarata e Mërfit, se «vetëm disa shqiptarë të veçuar» muarën pjesë në luftën kundër Gjermanisë shkakton habi jo vetëm midis atyre që asistojnë në

këtë mbledhje, por në mbarë botën. Ç'do të thotë vallë, shprehja «persona të veçuar»? Qysh mund të flitet për «persona të veçuar» ose më mirë për «individë» që kanë marrë pjesë me armë në dorë në luftën kundër Gjermanisë, kur dihet se Shqipëria drejtoi kundër gjermanëve 70 mijë njerëz? Në këtë mënyrë, pra, populli i vogël shqiptar që përbëhet vetëm nga 1 milion banorë, ho-dhi kundër gjermanëve një ushtri prej 70 mijë njerëz dhe, pas kësaj, ju thoni se vetëm «shqiptarë të veçuar» luftuan kundër gjermanëve».

d) Një aspekt tjetër i politikës armiqësore të Anglisë dhe të Amerikës kundrejt Shqipërisë është dhe problemi i kriminelëve të luftës. Kriminelët shqiptarë të luftës të arratisur ndodhen kryesisht në Itali dhe në Greqi dhe atje qëndrojnë nën mbrojtjen e me përkrahjen direkte të anglo-amerikanëve. Bile ata nxiten, ndihmohen dhe organizohen nga këta për aktivitet kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Po nën juridiksionin anglo-amerikan ndodhen në Itali dhe në zonat anglo-amerikane në Austri e në Gjermani edhe kriminelët e luftës, italianë e gjermanë, që kanë kryer krime në Shqipëri. Më 20 qershor 1947 qeveria shqiptare u drejtoi nga një kërkesë zyrtare qeverive angleze dhe amerikane për dorëzimin e të gjithë kriminelëve të luftës, italianë, gjermanë dhe shqiptarë që ishin nën juridiksionin e tyre. Qeveria shqiptare paraqiti edhe listat e akuzat e veçanta për secilin. Duke shkelur të gjitha deklaratat dhe angazhimet e përbashkëta aleate të kohës së luftës si dhe vendimet e mëpastajme, qeveria angleze me letrën e saj datë 4 tetor 1947 i mohon Shqipërisë në një mënyrë arrogante të drejtën të kërkojë

dorëzimin e kriminelëve të luftës duke mos e konsideruar atë si vend aleat dhe duke u habitur që qeveria shqiptare e ngre kaq vonë këtë çështje: «...Qeveria e Madhërisë së Tij duhet të theksojë që Shqipëria në fakt nuk ka gëzuar kurrë statutet aleate dhe nuk mundet prandaj të kërkojë të drejtat si një shtet aleat...». «...Në konkluzion, qeveria e Madhërisë së Tij mundet t'i theksojë se kanë kaluar dy vjet që hostilitetet kundër Gjermanisë muarën fund dhe ajo nuk impresionohet aspak nga rëndësia e rasteve, të cilat qeveria shqiptare nuk i ka konsideruar të drejta t'i nxjerrë më parë».

dh) Pas dështimit të tentativave të para për ndërhyrje të armatosur dhe pas zbulimit e goditjes së pamëshirshme të kompleteve, të organizuara brenda me reaksionin e brendshëm dhe pasi, as me presionet as me kërcënimet dhe as me akuzat e shpifura kundër Republikës sonë Popullore në fushën ndërkombëtare, nuk realizuan dot gjë, po u demaskuan më keq, imperialistët anglo-amerikanë tentuan të organizojnë akte agresioni të hapëta, duke pasur për këtë qëllim si pretext dhe si bazë sulmi, Greqinë monarko-fashiste.

Provat e para në këtë drejtim kanë qenë incidentet e 15 majit 1946, të 22 tetorit dhe sidomos të 12-13 nëntorit 1946, kur luftanije të shumta britanike (më 12-13 nëntor 23 anije midis të cilave kishte kryqëzorë, torpedinierë, nëndetëse dhe një aeroplanmbajtëse) invaduan ujërat tona tokësore gjoja për të pastruar minat, po në realitet me qëllime të dukshme agresioni.

Ky ka qenë incidenti i provokuar me qëllim nga anglezët në Sarandë. Ju «...keni parë faktet dhe provat se si anglezët e kurdisën këtë çështje, si e frynë,

si e ngritën dhe e çuan deri në Këshillin e Sigurimit e deri në Gjyqin ndërkombëtar të Hagës për t'i provuar botës me prova të alambikuara false dhe aspak bindëse, se Shqipëria po rrezikonte paqen. Shqipëria kurrë s'ka vënë mina në bregdetin e saj, pse as ka pasur mina dhe as ka pasur mjete me se t'i vinte. Vetë dokumentat zyrtare angleze provojnë se ata e njohin ekzistencën e minave të mbetura që në kohën e luftës ndër ato ujëra, vetë ata njohin se spastrimi, që ata vetë e kanë bërë, s'është aspak i sigurt dhe se rruga e lundrimit paraqet rreziqe. Minat fare lehtë mund t'i kenë vënë vaporet britanike ose shërbëtorët e tyre të Athinës. Këtu lind pyetja: Ç'kërkonin vaporet angleze për shumë herë rresht, përse ata shkelën për shumë herë rresht sovranitetin e ujërave tona territoriale? Sigurisht, kanë pasur një qëllim. Anglezët pretendojnë se kanë të drejtën e kalimit përmes kanalit të Korfuzit me anijet e tyre «paqësore», mirëpo rruga e kalimit nëpërmjet kanalit të Korfuzit nuk është pesëqind metra larg portit të Sarandës, në bregdetin e Himarës, dhe lundrimi paqësor, nuk do të thotë me i pasë të gjithë topat të ngritur dhe të drejtuar nga portet tona. Po anijet e shërbëtorëve të tyre të Athinës, që për tetë herë rresht, të mos flasim për ato që ngjanë dhe ngjasin dita-ditës — ç'kërkonin në ujërat tona, deri dhe afër porteve tona? Apo dhe ato kishin «qëllime paqësore», kur grabitnin varkat tona me gjithë njerëz dhe i çonin në Korfuz, ose kur mitralonin bregdetin dhe fshatrat tona, ose kur qëllonin me top fshatrat e Konispolit? S'do shumë mend për t'i kuptuar pse bëheshin këto gjëra nga ana e tyre. Me gjithë votat, që anglo-amerikanët grumbullojnë kurdoherë në Këshi-

llin e Sigurimit për të aprovuar të tilla akte të kurdisura dhe agresive, e drejta është nga ana jonë dhe për të fituar të drejtat tona, ne nuk gjunjëzohemi as përpara shantazheve as përpara kërcënimeve. Dhe drejtësia do të jetë kurdoherë me të drejtët. Si argument bindës dhe të orës së fundit, që anglezët dhe amerikanët suallën për incidentin e Sarandës, ishte ky: «Qeveria shqiptare ose i ka vënë vetë minat ose e di kush i ka vënë, për arësye se ajo i ruan me xhelozinë më të madhe kufitë dhe bregdetin e saj». Por ky argument i fundit nuk provon asgjë, ose më mirë provon një gjë, të cilën ne e pohojmë me plot gojën se është fare e vërtetë, që ne i ruajmë me xhelozinë më të madhe dhe me vendosmërinë më të madhe bregdetin tonë dhe kufitë tanë të Jugut, pse ata janë të shenjtë për ne dhe se rreth tyre vërtiten ujçërit fashistë»¹.

Provokacionet në kanalim e Korfuzit imperialistët anglo-amerikanë u përpoqën t'i përdornin si pretekst për zbarkim, po objektivi i tyre dështoi dhe u demaskuan nga qeveria jonë dhe nga përfaqësuesit sovjetikë në Këshillin e Sigurimit. Qeveria angleze tani ndodhet e akuzuar përpara Gjyqit ndërkombëtar të Hagës dhe po trillon akuza e pelivanllëqe të reja për të mbuluar provokacionin e saj brigantesk që u zbulua.

C. Çështja greke. — Grupet bankare dhe militariste, që drejtojnë politikën e jashtme amerikane dhe angleze e shikojnë Republikën Popullore të Shqipërisë si një pozitë të rëndësishme për realizimin e planeve të tyre luftëdashëse e ekspansioniste kundër Bashkimit Sovje-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 4, f. 112-113.

tik dhe demokracive popullore. Prandaj janë përdorur gjithfarë intrigash, manevrash, presionesh dhe provokacionesh, gjithfarë sabotimesh, komplotesh dhe akte diversioni kundër popullit tonë trim e të papërkulur, të lidhur me mish e me shpirt me kampin e pathyeshëm të socializmit, me Bashkimin Sovjetik triumfues.

Ata janë përpjekur ta kthejnë Shqipërinë tonë të dashur, paqësore e demokratike në një Greqi të dytë ku do të mbretëronte Zogu dhe terrori i bejlerëve e i kriminelëve të luftës dhe populli do të vuante në mjerimin më të madh dhe të pashembullt në historinë e tij. Këtë nuk e arritën, po ata janë munduar të përdorin për këtë qëllim edhe Greqinë monarko-fashiste, duke ndjekur dy udhë përnjëherësh: e para, duke nxitur dhe duke përkrahur rivendikimet e çmendura greke mbi Korçën dhe Gjirokastrën, pretendimin absurd të fashistëve të Athinës se gjoja Greqia ndodhet në gjendje lufte me Shqipërinë dhe provokacionet e tyre kriminale të armatosura të paprera kundër integritetit tokësor dhe sovranitetit të Republikës Popullore të Shqipërisë; e dyta, duke marrë pjesë direkt në këto provokacione të armatosura monarko-fashiste, duke akuzuar Shqipërinë, Bullgarinë dhe Jugosllavinë si shkaktare të luftës së ashpër civile që zhvillohet në Greqi, për të cilën të vetmit përgjegjës janë ata vetë dhe veglat e tyre të Athinës, duke bërë presion direkt dhe në mënyrë demonstrative mbi qeverinë shqiptare, siç qe përçapja e kohëve të fundit anglo-franko-amerikane dhe duke ngritur problemin grek si një problem ndërkombëtar, për të krijuar trazira në Ballkan dhe për ta përdorur në fushatën e tyre kriminale për një luftë të tretë botërore.

Dihet tani se në verë të 1945-s në Greqi ishin bërë të gjitha përgatitjet për agresionin kundër Shqipërisë, që do të kombinohej me zbarkimin anglez nga deti. Po përballë qëndrimit të vendosur të popullit shqiptar dhe të politikës së drejtë dhe të patundur të qeverisë së tij këto plane dështuan.

Oficerët anglezë, si gjeneral Skobi, kanë bërë deklarata nxitëse dhe provokuese kundër Shqipërisë. Oficerët eprorë anglezë dhe amerikanë kanë ardhur vazhdimisht në kufirin greko-shqiptar, kanë kontrolluar dhe fotografuar pozicionet e kufirit tonë. Një përpjekje me rëndësi në favor të rivendikimeve greke kundër Shqipërisë ka qenë tentativa anglo-amerikane në Konferencën e Paqes në Paris, që të diskutoheshin aty rivendikimet greke. Kërkesa greke nën presionin e delegacioneve anglo-amerikane u pranua për t'u vënë në rendin e ditës. Por qëndrimi i qeverisë shqiptare qe i prerë. Më 16 shtator 1946, një ditë para se të largohej nga Parisi, Kryeministri i Shqipërisë bëri një deklaratë shtypi, ku midis të tjerave tha:

«Konferenca e Parisit, me 11 vota pro, 7 kundër dhe 2 abstenime, votoi në favor të kërkesës greke, e cila synon diskutimin e kufirit të Shqipërisë së Jugut.

Unë deklaroj solemnisht se: as Konferenca e Parisit, as Konferenca e të Katërve, as çdo konferencë tjetër goftë, nuk mund të marrin në shqyrtim kufitë e vendit tonë brenda të cilëve nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të huaj. Kufitë tanë janë të padiskutueshëm dhe askush nuk do të guxojë t'i prekë. Që të mundin të marrin një pëllëmbë tokë të vendit tonë, grekët duhet të vënë në lëvizje të tjera mekanizma. përveç votës së Konferencës së Parisit.

E gjithë bota ta dijë se populli shqiptar... nuk e ka dërguar delegacionin e tij në Paris për të dhënë llogari, por për t'u kërkuar llogari atyre që e kanë dëmtuar aq tepër dhe që ai i ka luftuar me ashpërsi gjer në fund. Ne e kemi bërë detyrën tonë ashtu si e kanë bërë edhe të mëdhenjtë. Dëshmorët tanë dhe sakrificat tona janë për ne po aq të shenjta sa janë dhe dëshmorët e sakrificat e të mëdhenjve; të drejtat tona janë po aq të shenjta, sa janë edhe ato të atyre»¹.

Qe merita e lavdishme e delegacionit sovjetik me në krye shokun Mollotov, që kërkesa e poshtër greke u hoq nga rendi i ditës së konferencës dhe diplomacia anglo-saksone pësoi një disfatë të rëndë.

Më 23 tetor 1947 Hektor Mak Niil, delegat anglez në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së e inkurajoi me këto fjalë Caldarisin: «Sipas mendimit tim është frika se mos, për shkak të trajtës që muarën vërejtjet e mia mbi aktet, dëmtohet pozita juaj në lidhje me rivendikimet për Vorio Epirin. Ato që doja të thoshja dhe natyrisht për këtë jam i sigurt se kjo duket fare qartë në tërë fjalimin tim, është se përfaqësia juaj në Paris pranoi demokratikisht qëndrimin e Konferencës së Parisit, gjë kjo që nuk dëmton aspak të drejtën tuaj, për të mbrojtur përsëri para Këshillit të Ministrave të Jashtëm, si thatë atëhere dhe ripërsëritët më vonë se do të bënit».

Qeverisë monarko-fashiste të Athinës në politikën e saj armiqësore ndaj Shqipërisë i është dhënë një ndihmë dhe nxitje e veçantë nga anglo-amerikanët nëpërmjet

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 3, f. 448-449.

Komisionit hetimor, të krijuar prej Këshillit të Sigurimit më 19 dhjetor 1946 dhe sidomos nga i ashtuquajtura Komision special për Ballkanin (UNSCOB), që u krijua më 21 tetor 1947 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Anglo-amerikanët, pasi dështuan në tentativat e tyre direkte, ngritën në OKB akuza se gjoja Shqipëria, Bullgaria dhe Jugosllavia strehojnë dhe furnizojnë partizanët grekë, se partizanët grekë hyjnë në Greqi nga vendet tona, se ne ndërhyjmë në punët e brendshme të Greqisë dhe pra, jemi përgjegjës për luftën civile në Greqi dhe rrezikojmë paqen. Fajtorët e vërtetë, intervencionistët anglo-amerikanë përdorën metodën bajate e të vjetëruar: të fshihen duke akuzuar të tjerët në Këshillin e Sigurimit. Kur diskutohej raporti i Komisionit hetimor më 25 korrik 1947, delegati amerikan sulmoi brutalisht vendet tona duke thënë: «Ne jemi të mendjes se Greqia nuk përbën një kërcënim për paqen tani për tani, dhe se përkundrazi, ne jemi të mendjes që të tri qeveritë ballkanike, me sjelljen e tyre të kaluar, përbëjnë një kërcënim të tillë. E quajmë për detyrë t'u japim një paralajmërim».

Përsëri më 20 tetor 1947, në Asamblenë e Përgjithshme, pa paraqitur as provën më të vogël, po përkundrazi, duke mbyllur sytë përpara fakteve të panumërta që e akuzonin SHBA-në, delegati i Uollstrit-it, Xhonson përsëriti po ato akuza dhe kërkoi krijimin e UNSCOB-it, i cili u krijua dhe veprroi si një agjenci spiunazhi dhe provokacioni e Departamentit të Shtetit dhe e monarko-fashizmit kundër popullit grek lirishtës dhe fqinjëve veriorë të Greqisë. UNSCOB-i vulosi të gjitha akuzat,

shpifjet, provokacionet dhe krimet e amerikanëve në Greqi. Ai ka drejtuar aktivitetin e tij, sidomos, kundër Shqipërisë. Që kur ka shkelur ai në Greqi e deri më 15 tetor 1948 janë bërë 683 provokacione të armatosura tokësore, detare dhe ajrore nga monarko-fashistët grekë. Nën flamurin e OKB-së agjentët amerikanë dhe anglezë luajnë rolin e provokatorëve dhe të prishësve të paqes. Anëtarët e UNSCOB-it marrin pjesë vetë në provokacionet dhe në luftimet kundër ushtrisë demokratike greke.

Nën flamurin e OKB-së amerikanët dhe anglezët mundohen të justifikojnë dhe të mbulojnë ndërhyrjen dhe përgjegjësinë e tyre, duke akuzuar të tjerët. Po vetë avokati i tyre i zjarrtë Spak deklaroi në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së: «Nuk besoj që kushdo goftë të mundë edhe vetëm të shpresojë, të pohojë se fqinjët veriorë të Greqisë janë nxitësit dhe shkaktarët e luftës civile që zhvillohet në këto vende. Unë personalisht nuk besoj ta kenë bërë dhe në goftë se ndokush pohon diçka ndryshe, unë mendoj se kjo është ekzagjerim».

Në Greqi ka ndërhyrje të huaj dhe kjo është shkak i luftës civile. Këtë ndërhyrje në fillim e bënë anglezët, pastaj amerikanët me doktrinën Truman. «Vetëm brenda një viti, deklaroi tani së fundi ish-kryetari i misionit amerikan në Greqi, Griswold, nga qeveria amerikane janë dërguar 20 000 tonelata material lufte të çdo lloji, janë ndërtuar gjashtë aeroporte ushtarake, që mund të presin bombarduesit e rëndë dhe janë ndrequr për arësye ushtarake skelat e mëdha të vendit».

Ja ndihma amerikane, doktrina Truman dhe plani

Marshall. Dhe shpjegimin më të mirë të doktrinës Truman e jep kasneci i njohur i imperializmit amerikan, gazetari Uolter Lipman, i cili në prill të 1947-s shkruante kështu në gazetën Nju-Jork Herald Tribun: «Ne zgjodhëm Turqinë dhe Greqinë jo sepse ato kanë vërtetë nevojë për një ndihmë, porse ato përbëjnë për ne dyert strategjike, që shpien në Det të Zi dhe në zemrën e Bashkimit Sovjetik».

Gangsterët amerikanë synojnë Bashkimin Sovjetik, atdheun e paqes dhe të socializmit, shtyllën e lirisë dhe të demokracisë në botë. Atë synojnë edhe kur sulmojnë Republikën tonë Popullore. Po tamam Bashkimi Sovjetik ju thyen turinjte, sa herë sulmojnë vendin tonë, prandaj edhe ne jemi të fortë, të pamposhtur.

Të gjitha manevrat e poshtra, që reaksioni ndërkombëtar kërkon të luajë në kurrizin e popullit tonë, demaskohen niëra pas tjetrës dhe popujt e përparuar të të gjithë botës shohin qartë sa të padrejta janë qëndrimet e qeverisë angleze dhe amerikane ndaj popullit heroik dhe paqëndashës shqiptar. Të gjitha akuzat që na bëjnë neve këto qeveri, kthehen kundër tyre dhe lodrat e qëllimet e tyre demaskohen keqas. A mundet populli ynë i vogël të kërcënojë paqen, Amerikën dhe Anglinë, sikundër pretendojnë qeveritarët anglezë dhe amerikanë? Kjo është qesharake. Populli shqiptar do të rrojë i lirë, i qetë në punën e tij paqësore dhe ndërtimore; ai do të rrojë në harmoni të plotë me gjithë popujt përparimtarë të botës.

LUFTA KUNDËR REAKSIONIT TË BRENDSHËM PAS ÇLIRIMIT

Partia dhe pushteti, pas çlirimit të Shqipërisë, për të kompletuar fitoret e korrura gjatë luftës dhe për të zhdukur mbeturinat e fashizmit, foletë e reaksionit, të spiunazhit dhe të diversantëve duhej të bënin spastrimet. Lufta duhej të bëhej e ashpër dhe kështu u bë. Kriminelë të shumtë, të shpartalluar nga lufta jonë partizane dhe tani pa mbrojtjen e armëve gjermane, ishin shpërndarë nëpër Shqipëri, fshehur nëpër male ose në shtëpitë e tyre, infiltruar kontrabandë në ushtrinë tonë ose rronin në ilegalitet në qytete e në fshatra. Forcat e armatosura të popullit tonë, Arma e Sigurimit të Shtetit, Policia dhe Mbrojtja e Popullit dhe vetë populli, që mori pjesë aktivisht, ju përveshën punës për të spastruar vendin nga këta banditë. E vetmja shpresë e reaksionit dhe e kriminelëve të luftës, të izoluar ose të organizuar në banda, që s'mundën dot të kapërcenin detin, ishin anglo-amerikanët, që ndodheshin me misionë në Shqipëri. Goditjet e forta të pushtetit tonë kundër kriminelëve të luftës, që prej dhjetorit 1944 dhe deri në fund të shkurtit 1946, bënë që ky problem të likuidohej. Ministra kuislingë, kriminelë lufte, spiunë, diversantë, zyrtarë të regjimeve të kaluara fashiste, u vranë në luftime, u kapën, u çuan përpara gjyqit dhe, për krimet e tyre kundër popullit, u pushkatuan ose u burgosën. Gjatë gjithë periudhës së aktivitetit të këtyre katër vjetëve, organet e Sigurimit të Shtetit tonë kanë qenë në luftë të ashpër dhe të vazhdueshme me mbe-

turinat e agjencive të spiunazhit, të SIM-it, të Gestapos, të Inteligens Servis-it dhe me agjencinë e spiunazhit amerikan, të cilat organizonin dhe nxisnin reaksionin kundër Republikës sonë Popullore dhe pushtetit popullor. Më 23 janar 1945 mbeturinat e armikut në qarkun e Shkodrës, ballistët e arratisur dhe njerëz të «Legalitetit», njerëzit e «Besëlidhjes» dhe kriminelë të tjerë me damkë, të mbështetur në propagandën armike dhe në intervencionin anglez tentojnë të organizojnë një kryengritje. Më 23 janar 1945 ata sulmojnë Koplkun, i cili bie për disa orë në duart e tyre. Njëkohësisht ata bëjnë disa goditje kundër komandave të vendit. Po kjo lëvizje shuhet përnjëherësh nga forcat e ushtrisë sonë.

Në janarin e 1946-s elementë të borgjezisë së pasur të vendit tonë, njerëz të lidhur me okupatorin dhe agjentë të drejtëpërdrejtë të anglo-amerikanëve, organizojnë grupe të ndryshme kundërshtarë, si «Partia Monarkiste», ku marrin pjesë elementë reaksionarë me tendenca zogiste, ish-oficerë të vjetër të Zogut, «Partia Socialdemokrate», mbeturinat e të ashtuquajturit grup «Socialist-demokrat» të «Ballit Kombëtar» gjatë luftës dhe grupi «Demokrat» me Sami Qeribashin në krye. Të gjitha këto grupe, armike të popullit dhe kundërshtarë të regjimit, krijojnë «Bashkimin», marrin lidhje me të arratisurit dhe organizohen për rrëzimin e pushtetit me forcë. Misioni anglez në Tiranë ka qenë në bazën dhe në drejtimin e këtyre grupeve. Këto grupe u zbuluan, u arrestuan dhe, duke kaluar përpara gjyqit, muarën dënimin e tyre të merituar.

Në shkurt të 1946-s u bë procesi i «Bashkimit Shqiptar» të Shkodrës. Kjo organizatë ka qenë nën drejtimin

e klerit katolik të Shkodrës dhe rrënjët e saja ishin të vjetra, që gjatë luftës. Ajo drejtchej prej klerit katolik, ku në krye qëndronin klerikët katolikë më të rëndësishëm të udhëzuar drejtpërdrejt nga Vatikani. Aktiviteti i këtij grupi përqëndrohej në hedhje traktesh dhe në ndihmën që ka dhënë për lëvizjen e 9 shtatorit të 1946-s në Shkodër, etj.

Lëvizja e 9 shtatorit 1946 në Shkodër ishte një nxitje e drejtpërdrejtë e anglo-amerikanëve, ku merrte pjesë aktivisht dhe grupi i deputetëve tradhëtarë nëpërmjet të tradhëtarit Riza Dani, në lidhje me të arratisurit, si Jup Kazazi, etj. Më 9 shtator nja 450 vetë të armatosur dhe të paarmatosur godasin qytetin e Shkodrës nga tri drejtime. Qëllimi i sulmit ishte propaganduar si pikënisja e ndërhyrjes ushtarake anglo-amerikane në Shqipëri për të përmbysur pushtetin popullor. Lëvizja u thye po atë ditë: 33 pjesëmarrës kundërshtarë u vranë në përpjekje e sipër nga forcat tona, 8 të tjerë kryesorë, të gjykuar prej gjyqit ushtarak, u pushkatuan, 200 vetë të tjerë u arrestuan, u gjykuan dhe një pjesë e tyre u lirua.

Ky ishte një grup spiunësh dhe sabotatorësh i organizuar drejtpërdrejt dhe i kryesuar nga misioni amerikan në Shqipëri, personalisht nga mister Fulci, armik i egër i popullit shqiptar dhe shef i informacionit amerikan në Shqipëri. Në këtë grup bënin pjesë sidomos ish-nxënës të shkollës teknike të drejtuar aso kohe nga amerikanët. Këta elementë ishin teknikë të korrumpuar të borgjezisë, njerëz të lidhur me fashizmin dhe me reaksionin gjatë luftës. Këta zhvilluan sabotazhe në Maliq, Kuçovë, Rubik, etj. Kryetarët e këtij grupi sa-

botatorësh si Beqir Çela, Avdyl Sharra, Kujtim Beqiri, Sulo Klosi, Selaudin Toto, etj., u arrestuan, u gjyquan dhe muarën dënimin e merituar.

Disa tradhëtarë, të kamufluar në Frontin Nacional-Çlirimtar, tentuan që para mbarimit të luftës të organizohen dhe të grumbullohen për të dalë si një parti e opozitës në Front. Një numër nga këta elementë zgjidhen si deputetë më 2 Dhjetor 1945. Nën maskën e anëtarësisë së Frontit, dhe me kartën e deputetit në xhep, të frymëzuar dhe të drejtuar nga anglo-amerikanët, tentuan të bënin «Kalin e Trojës» dhe, të lidhur me kriminelët e luftës, u organizuan të rrëzonin me forcë pushtetin. Kjo organizatë armike e popullit u zbulua; krerët si Shefqet Beja, Sheh Ibrahim Karbunara, Riza Dani, etj., u arrestuan dhe u çuan para gjyqit, ku muarën dënimin e merituar.

Mbeturina të «Ballit Kombëtar» të kamufluar po organizoheshin në ilegalitetin më të fshehtë kundër pushtetit popullor. Këta elementë që në fillim të vitit 1945, me Uan Filipin në krye, organizuan një komitet provizor të «Ballit» sipas udhëzimeve që merrnin nga «Komiteti Qendror» i «Ballit» në Itali, nëpërmjet UNRRA-s. Në këtë grup merrnin pjesë mbeturina të «Ballit», tregëtarë të tatuuar, kulakë të shpronësuar, spiunë, bejlerë, etj. Këta kishin lidhje me të arratisurit kriminelë luftime. Në program kanë pasur organizimin e atentateve dhe rrëzimin e regjimit popullor me forcë. Kjo organizatë u zbulua dhe krerët e saj si Uan Filipi, Avdyl Kokoshi, etj., kaluan para gjyqit dhe muarën dënimin e merituar.

Këto kanë qenë tentativat e dukshme të organizi-

mit të reaksionit të brendshëm, i cili, me mbështetjen e anglo-amerikanëve, që ishin në Shqipëri, tentoi për disa herë rresht të organizonte luftën kundër regjimit tonë, duke shpresuar në një zbarkim anglo-amerikan në vendin tonë. Lidhjet e këtyre agjentëve të anglo-amerikanëve, të mbeturinave të reaksionit me masat e popullit ishin krejt të dobëta dhe prandaj ata nuk mund të kishin suksesin më të vogël në përpjekjet e tyre kriminale kundër popullit. Pushteti, me anën e organeve të tij mbrojtëse, i likuidoi lehtësisht të gjitha përpjekjet e tyre. Nga këto goditje të drejta dhe të ashpra të pushtetit tonë, ky i fundit u forcua dita-ditës më shumë dhe u armatos me një eksperiencë të mjaftë për të zbuluar dhe luftuar pa mëshirë të gjithë armiqtë e popullit, që do të guxonin të ngrinin krye dhe të kërcënonin jetën e popullit tonë.

MARRËDHËNJET TONA ME POPUJT E JUGOSLLAVISË DHE LUFTA KUNDËR NDERHYRJES SË GRUPIT NACIONALIST TË TITOS

Në Luftën e dytë botërore si Shqipëria, ashtu dhe Jugosllavia ranë viktime të agresionit të fashistëve gjermanë dhe italianë. Popujt e të dy vendeve tona, të prirë dhe të inkurajuar nga lufta e lavdishme e çlirimtare e popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të ushtrisë së tij të lavdishme, nën udhëheqjen e partive të tyre komuniste, luftuan me heroizëm kundër armikut të përbashkët për të njëjtat qëllime: Lufta bëri që midis popujve tanë të hidhen bazat për të zhdukur përcarjet dhe grindjet e vjetra shoviniste, të mbjella nga regjimet reaksionare

e antipopullore të së kaluarës. Vëllazërimi në mes të popujve tanë u bë më i shëndoshë, kur dy divizionet tona u shkuan në ndihmë popujve vëllezër jugosllavë, dhe kryen me lavdi detyrën e tyre në luftërat kundër hordhive gjermane në Mal të Zi, në Kosovë e Metohi, në Bosnje e gjetkë. Gjaku që derdhën partizanët shqiptarë në tokën jugosllave, brumosi vëllazërimin midis popujve tanë. Partia dhe qeveria jonë punonin dhe e shikonin me sinqeritetin më të madh forcimin e marrëdhënjeve vëllazërore me Jugosllavinë. Të dy vendet tona gëzonin të gjithë përkrahjen dhe dashurinë e çlirimtarit të tyre të madh, Bashkimit Sovjetik. Rruga logjike në bazë të shkencës marksiste-leniniste ishte bashkëpunimi sa më i ngushtë midis dy vendeve. Në korrik të vitit 1946 u përfundua «Traktati i miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke» dhe në nëntor të vitit 1946 u nënshkrua «Konventa ekonomike» midis dy vendeve tona.

Partia dhe populli i shikonin me besim të madh këto marrëdhënje, po pikëpamjet dhe qëllimet e grupit trockist Tito ishin krejt të kundërta me ato të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe kundër interesave të popullit shqiptar, të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë kampit socialist. Në dritën e letrave historike të Partisë Bolshevike, drejtuar KQ të PKJ dhe të rezolutës së Informbyrosë, dualën qartë në dritë qëllimet dhe politika e vërtetë antimarksiste, antisovjetike, antishqiptare, kolonizatore dhe imperialiste e ndjekur nga grupi trockist Tito kundrejt vendit tonë.

Vendi ynë, i shkatërruar nga lufta, kishte nevojë për ndihmë. Këtë ndihmë ne do ta merrnim nga Bashki-

mi Sovjetik, pa të cilin nuk mund të rindërtohej Shqipëria e re, do ta merrnim nga fqinja dhe aleatja jonë Jugosllavia dhe nga demokracitë e tjera popullore...

Konventa ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishte konkretizimi i alencës në mes të dy vendeve tona. Kjo konventë solli me vete protokollet mbi koordinimin e planeve, mbi unifikimin e çmimeve, mbi parifikimin e monedhës, mbi shoqëritë e përbashkëta, etj. Partia dhe qeveria jonë i firmuan këto marrëveshje me besimin më të madh, po duke bërë vërejtje me vend në lidhje me parifikimin e monedhës, unifikimin e çmimeve, përcaktimin e formës së kreditit, investimet mbi shoqëritë shqiptaro-jugosllave. Jeta tregoi se vërejtjet tona dualën të drejta, po që në atë kohë, në mënyrë të poshtër, kërcënuese dhe në rrugën antimarksiste të bashkëpunimit në mes të dy demokracive popullore, na u përbuzën nga ana e KQ të PKJ dhe u quajtën prej tyre, që në atë kohë, si pengesa që Partia jonë krijonte për vendosjen e marrëdhënjeve midis të dy popujve vëllezër. Nga ana e KQ të PK të Jugosllavisë kishte qëllime të caktuara antimarksiste dhe antishqiptare përsa i përket natyrës dhe zhvillimit të këtyre marrëdhënjeve, si dhe mbi akordinimin e kreditit. Këto qëllime antimarksiste dhe antishqiptare të KQ të PK Jugosllave, fshiheshin nën formula marksiste të marrëdhënjeve në mes të demokracive popullore. Nën maskën e këtij bashkëpunimi KQ i PKJ kishte qëllim të shfrytëzonte në mënyrë koloniale dhe në rrugën imperialiste vendin tonë. Ekonomia jonë sipas pikëpamjeve trockiste të KQ të PKJ nuk duhej të zhvillohej e pavarur, po duhej të futej në ekonominë jugosllave. Praktikisht pra, vendi ynë izolohej

krejtësisht nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë e tjera popullore; përse u përket marrëdhënjeve ekonomike dhe duke menduar se do ta kishte çështjen ekonomike të vendit tonë në duart e veta, grupi trockist Tito do të mund të mposhte dhe politikën e drejtë të KQ të Partisë sonë kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe kampit të socializmit. Duke përfituar nga gjendja e vështirë e popullit tonë dhe nën presionin ekonomik, trockistët jugosllavë luftonin me ashpërsinë më të madhe, me demagogji, me fraza pseudomarksiste, çdo iniciativë dhe çdo kundërshtim të Komitetit tonë Qendror, që kërkonte t'i shpëtonte kësaj hallke.

Komiteti Qendror i PK Jugosllave, nuk mund të duronte një situatë të tillë, që Komiteti ynë Qendror të ngrinte ekonominë e vendit të tij në baza marksiste-leniniste, ai nuk mund të lejonte që krediti i akorduar Shqipërisë, të përdorej për të forcuar demokracinë popullore në vendin tonë, në rrugën marksiste-leniniste dhe mbi parimet e mëdha të kampit të socializmit. Komiteti Qendror i PK Jugosllave, nën maskën e këtij krediti kishte për qëllim të minonte demokracinë popullore në Shqipëri dhe jo ta forconte ekonominë tonë. Këta trockistë përdorën tërë arsenalin e tyre armik, për të goditur kuadrot tanë, për t'i dekurajuar, për të goditur punën tonë organizative dhe për të luftuar eksperiencën e vlefshme sovjetike. Me një punë të tillë armiqësore ata krijojnë situata të vështira që plani të mos dilte kurrë me kohë dhe t'ja hidhnin pastaj fajin qeverisë sonë. Kështu të gjenin pretekste për mosrealizimin e kreditit nga ana e jugosllavëve, të mos bëheshin kështu investime në kohën e duhur dhe të vonohej ardhja e

mallrave. Kjo taktikë trockiste e KQ të PKJ kishte për qëllim që ekonomia jonë të mbetej prapa, të acarohet gjendja ekonomike në vendin tonë dhe të diskreditohej Partia e qeveria në sytë e popullit; nga ana tjetër, me këtë taktikë PKJ përpiquej të ngrinte prestigjin e Jugosllavisë, e cila gjoja ishte e dispozuar të ndihmonte Shqipërinë, po se udhëheqja e Partisë Komuniste të Shqipërisë nuk ishte në gjendje të drejtonte dhe të përfitonte nga kjo ndihmë. Komiteti Qendror i Partisë sonë i kundërshtoi me këmbëngulje këto veprime anti-shqiptare dhe antimarksiste dhe kërkoi përcaktimin e mënyrave të pagesave të kreditit të dy miliardëve dhe përcaktimin e investimeve nga ana e Jugosllavisë në shoqëritë e përbashkëta. Komiteti ynë Qendror duke parë këto padrejtësi të Komitetit Qendror të PK të Jugosllavisë parashikonte se një ditë, në mënyrë briganteske dhe imperialiste, shoqëritë e përbashkëta do të hidheshin në dorën e qeverisë jugosllave dhe do të transformoheshin si aziendat e fashizmit italian. Krediti që na jepte Jugosllavia do të luante rolin e huas që i jepte dikur Italia fashiste, Shqipërisë. Komiteti Qendror i PK Jugosllave i luftoi pikëpamjet tona të drejta dhe si përgjegje të rivendikimeve të qeverisë sonë, trockisti Kidriç përgjigjet se «duhen pranuar konditat e qeverisë jugosllave dhe qeveria shqiptare nuk duhet të sjellë pengesa, se Jugosllavia bën sakrifica dhe, prandaj, duhet të nënshkruani». Ky ishte një ultimatum i poshtër trockist dhe fashist. Grupi trockist Tito s'ka dashur kurrë t'i përcaktonte drejt këto gjëra, se kishte frikë nga e drejta. Ata ishin shërbëtorë të borgjezisë, ata ishin antimarksistë.

Trockistët jugosllavë synonin qëllime të shumanshme: ekonomia jonë të numëronte në vend dhe të mos shkonte përpara. Qëllim tjetër ishte të luftonin besimin dhe dashurinë që kishte Partia jonë ndaj Bashkimit të madh Sovjetik dhe në terrenin praktik njerëzit tanë udhëheqës të humbisnin besimin ndaj eksperiencës së lavdishme sovjetike. Një veprim i tillë sillte izolimin e vendit tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga kampi i socializmit. Me këto metoda trockistët jugosllavë kishin për qëllim të diskreditonin udhëheqjen e Partisë sonë, ta paraqitnin të pazonjën, të përçanin e të eliminonin gjithë ata udhëheqës që mbronin vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe të sillnin në udhëheqje veglat e tyre, si Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston, të cilët verbërisht të shkallmonin Partinë tonë dhe veprën e madhe të popullit shqiptar. Grupi trockist Tito nuk la asnjë rast pa shfrytëzuar dhe përdori gjithfarë metodash trockiste për të goditur Komitetin Qendror të Partisë sonë, vijën e drejtë të saj, Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokët e tjerë të Byrosë, shokun Nako Spiru si dhe shokun Mehmet Shehu, etj. Po megjithkëto vështirësi të mëdha, shpifje e shantazhe, Partia jonë dhe qeveria e çuan punën përpara, korrën suksese në lëmin ekonomik dhe vija politike e Partisë sonë ishte e patundur dhe e drejtë; tentativat e trockistëve jugosllavë nuk mundën ta dëmtonin. Grupi trockist tito filloi akuzën e parë kundër Komitetit tonë Qendror dhe vijës së drejtë të Partisë duke pretenduar se Komiteti Qendror po shtrembëronte vijën dhe po kristalizohej në praktikë një vijë e dytë. Byroja Politike e KQ të Partisë e hodhi poshtë këtë akuzë të KQ të PKJ sido që Koçi Xoxe

s'ishte i bindur mbi vendimin që mori Byroja në këtë çështje dhe s'mund të ishte i bindur, sepse ai që nga Berati ishte në akord të plotë me trockistët jugosllavë dhe punonte në vijën e tyre.

Në gjithë sektorët e planit tonë, jugosllavët sabotuan me të dyja duart. Me përpjekjet e Partisë dhe të qeverisë sonë, me materialin tonë që gjendej në vend u realizuan një shumicë veprash që përmirësuan konditat e jetës në vendin tonë.

Një situatë e tillë, e krijuar dhe e mbajtur gjallë prej jugosllavëve për qëllimet e përmendura më sipër, u duhej atyre që të arrinin në disa konkluzione. Për të arritur në konkluzionet e dëshiruara prej tyre, ata ndërmuarën një sërë veprimesh të poshtira ndaj Partisë sonë, qeverisë sonë, ekonomisë sonë, planit tonë dhe njerëzve tanë.

Duke parë rezistencën e Partisë sonë ndaj veprimeve të tyre antishqiptare, grupi trockist Tito përgatiti planin për goditjen e dytë të rëndë të udhëheqjes së Partisë sonë dhe të vijës së drejtë të Partisë. Kjo goditje filloi me projektplanin pesëvjeçar ekonomik. Ky projektplan, i propozuar prej tyre, s'ishte përveçse një bluf, sepse vetë trockistët jugosllavë, me në krye Savo Zllatiç, delegat i Komitetit Qendror të PK Jugosllave, pohuan pas analizës së Plenumit VIII se në buxhetin jugosllav, jo vetëm që nuk ishte parashikuar një kredit i tillë për të subvencionuar planin tonë pesëvjeçar, po në buxhetin jugosllav nuk ishte parashikuar as kredia prej dy miliard lekë të rinj, që do të na akordoheshin për vitin 1948. Komiteti Qendror i Partisë sonë, në kundërshtim me orientimin, që kërkonin t'i jepnin ju-

gosllavët, i dha frymën dhe orientimin e drejtë këtij projektplanit pesëvjeçar. Orientimi i jugosllavëve për projektplanin tonë pesëvjeçar ishte antimarksist, anti-shqiptar dhe shfrytëzues për vendin tonë. Sipas jugosllavëve ne duhej të punonim për Jugosllavinë për gjithë lëndët e para që ata kishin nevojë, të cilat do të eksportoheshin në «metropolin» Jugosllavi dhe do të punoheshin atje, në fabrikat jugosllave. Pastaj, Jugosllavia do t'i furnizonte «kolonisë së vet, Shqipërisë» sendet e manufakturuar me çmime grabitqare, që nga peri deri te gjilpëra, do të furnizonte benzinën, naftën dhe vajgurin si dhe poçet e llambave, ku do të digjej produkti ynë, i nxjerrë nga toka jonë, i përpunuar në Jugosllavi dhe i shitur te ne me çmime të larta. Kjo nuk është përveçse politika e trusteve kapitaliste dhe e monopoleve imperialiste anglo-amerikane. Orientimi i jugosllavëve ishte pra që në vendin tonë të mos zhvillohej as industria as proletariati, vendi ynë të mbetet i prapambetur, i varur tërë jetën nga Jugosllavia me asnjë perspektivë daljeje, përveç asaj të një pune të rëndë skllavëruese.

Projektplanin ynë ishte i drejtë dhe Komiteti ynë Qendror nuk gabohej me aprovimin e këtij plani. Orientimi ka qenë që vendi ynë, si një Republikë Popullore e pavarur e kampit demokratik, të ndërtonte socializmin duke mobilizuar në radhë të parë gjithë forcat e gjalla të popullit nën drejtimin e Partisë Komuniste të tij, duke pasur dhe përkrahjen e Jugosllavisë e ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik si dhe të republikave të tjera të demokracisë popullore. Orientimi i planit tonë luftonte çdo frymë shfrytëzimi dhe kolonizimi me metoda impe-

rialiste, synonte ndërtimin e industrisë dhe elektrifikimin e vendit tonë, synonte ngritjen dhe forcimin e klasës punëtore të Shqipërisë, synonte zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë sonë në rrugën e drejtë të socializmit. Trockistët jugosllavë ishin për një orientim të kundërt.

Grupi trockist Tito, porsa mori dijeni për direktivat e përgjithshme, që i jepte Komiteti ynë Qendror qeverisë për hartimin e planit, formuloi akuzën e poshtër kundër Partisë sonë. Trockistët jugosllavë e akuzuan Partinë tonë dhe Komitetin Qendror se kishte hartuar një plan pesëvjeçar autarqik dhe ireal, jo në bazë të marrëveshjeve që ekzistonin në mes të dy vendeve, po që e shkëpuste Shqipërinë nga Jugosllavia, etj. Kjo ishte një akuzë pa asnjë bazë, por që në mënyrë trockiste luftonte zhvillimin e drejtë të ekonomisë sonë socialiste. Por argumentat për të akuzuar Komitetin Qendror të Partisë, vijën e drejtë të tij dhe njerëzit e udhëheqjes, që e mbronin vijën marksiste-leniniste të Partisë, vetëm me çështjen e planit pesëvjeçar, ishin të dobëta, prandaj grupi trockist Tito rreshtoi dhe një sërë argumentash të tjera, të poshtra dhe false. Ata akuzuan qeverinë tonë, Komitetin Qendror, Kryeministrin dhe Nako Spirun si shkaktarë se gjoja marrëdhënjet në mes të dy popujve ishin përtokë; akuzuan se gjoja ishte krijuar një front antijugosllav në Shqipëri, i cili kishte arritur kulmin në hekurudhën e rinisë; ata akuzuan veçanërisht Nako Spirun për bashkëpunim me armikun; ata e akuzuan qeverinë tonë si një qeveri antipopullore; dënuan marrëdhënjet ekonomike dhe politike që qeveria jonë kishte me Bashkimin Sovjetik dhe luftuan që ne të mos merrnim eksperiencën e vlefshme të Bashkimit Sovjetik dhe

të njerëzve të tij; ata dënuan marrjen e ndihmës materiale dhe morale direkte nga Bashkimi Sovjetik, duke i mbuluar këto me një frazeologji pseudomarksiste.

Qëllimet e akuzës kanë qenë këto: të shkatërrojnë Partinë tonë duke goditur udhëheqjen e shëndoshë marksiste-leniniste dhe personat që mbronin vijën leniniste të Partisë dhe duke prurë në udhëheqje njerëzit e tyre, me pikëpamje trockiste, për ta shndërruar Partinë tonë në një parti policeske. Të minonin Partinë tonë dhe ta mposhtnin këtë, duke e bërë vegël të tyre, për të degjeneruar Republikën tonë Popullore në një shtet borgjez dhe nën vartësinë e imperializmit. Të hidhnin në luftë Partinë dhe shtetin tonë kundër Bashkimit Sovjetik dhe kampit të socializmit. Ky plan ishte i parapregatitur me kohë nga grupi trockist Tito dhe Koçi Xoxe e Pandi Kristo, të bindur në vijën trockiste të jugosllavëve, kishin punuar për katër vjet rresht në këtë drejtim, për të arritur në Plenumin VIII të Komitetit Qendror. Trockistët jugosllavë, të mbështetur fuqimisht te Koçi Xoxe dhe shokët e tij, kishin krijuar konditat për një grusht të tillë kundër Partisë dhe popullit tonë. Me intriga të panumërta, me metoda trockiste, me vrasje të paligjshme, kishin përçarë unitetin në udhëheqje, kishin goditur shumë herë rresht vijën e drejtë të Partisë sonë, kishin shtrembëruar vijën organizative të Partisë për ta pasur si bazë për goditjen e vijës politike, kishin shkelur gjithë rregullat, mbi të cilat është ndërtuar Partia jonë, e kishin vënë Partinë nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit, kishin goditur dhe diskredituar Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, e kishin izoluar këtë nga roli i vërtetë drejtues, kishin kriju-

ar në udhëheqjen e Partisë grindje, gjoja në platforma personale, po që në realitet mbulonin luftën trockiste kundër parimeve të drejta marksiste-leniniste të Partisë, kishin krijuar mosbesimin te njëri-tjetri në anëtarët e ndryshëm të Byrosë dhe trockistët jugosllavë e Koçi Xoxe e Pandi Kristo, kishin punuar me sistem për të diskredituar anëtarët e tjerë të Byrosë si gjoja të lëkundshëm, të pazot, intelektualë të «sëmurë» dhe shpifje të tjera të këtij lloji. Gjithë këto bëheshin me qëllim për të shpartalluar unitetin e shokëve të shëndoshë rreth Sekretarit të Përgjithshëm, që mbronin vijën e drejtë të Partisë dhe të triumfante në Komitetin Qendror të Partisë sonë, platforma trockiste, antimarksiste, antishqiptare dhe antisovjetike e grupit trockist-nacionalist Tito dhe e bashkëpunëtorëve të tyre, Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe të shokëve të tyre.

Puna trockiste e Komitetit Qendror të PK Jugosllave që prej vitit 1944 dhe deri në mbarim të vitit 1947, puna armiqësore e egër e grupit trockist Tito, të ndihmuar me ndërgjegje të plotë nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, pas një pune të përgatitur imtësisht, brenda në Partinë tonë dhe në Komitetin Qendror e në Byronë Politike të saj, arriti kulmin në Plenumin VIII të Komitetit tonë Qendror. Nën presionin e tmerrshëm të grupit trockist Tito dhe të agjentëve të tij në Shqipëri, me ndihmën e Koçi Xoxes, që zhvillonte prej kaq vjetësh një punë armiqësore dhe djallëzore, u mposht Byroja Politike e Partisë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë dhe gjithë Komiteti Qendror, u shkel vija politike e drejtë e Partisë sonë, u godit rëndë udhëheqja, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë dhe shoku ynë i da-

shur Nako Spiru, që kishte mbrojtur me heroizëm vijën e Partisë dhe interesat e popullit kundër trockistëve jugosllavë në situata shumë të rënda për të, sidomos nga armiqësia e egër e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos, nuk mundi të rezistonte përpara këtyre situatave të tmerrshme dhe ai vrau veten. Trockistët jugosllavë ja arritën qëllimit dhe Koçi Xoxe e Pandi Kristo, dualën përpara Partisë si triumfues, si shpëtimtarë të Partisë. Grupi trockist Tito dhe bashkëpunëtorët e tyre Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo besuan se e mposhtën Partinë dhe tani mund të procedonin në likuidimin e saj, të kuadrove më besnikë të saj, të udhëheqësve më besnikë të saj.

Akuzat e trockistëve jugosllavë kishin për qëllim ta bënin vendin tonë një republikë të 7-të të Jugosllavisë dhe ta nënshtonin nën urdhërat e direktivat e drejtëpërdrejta të Beogradit; vendi ynë të bëhej një koloni e Jugosllavisë, të humbiste independencën dhe sovranitetin. Kështu populli ynë të shkëputej nga kampi i socializmit, të armiqësohej me Bashkimin Sovjetik, kokën dhe zemrën e kampit demokratik antiimperialist, ta tërhiqte Partinë tonë dhe popullin tonë në rrugën antimarksiste, antisovjetike.

Plenumi VIII, ku triumfuan tezat antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike të trockistëve jugosllavë dhe të Koçi Xoxes, krijoi për një kohë një situatë shumë të rëndë në Parti, e influencuan këtë të bëjë gabime të rënda dhe trockistët jugosllavë të vazhdojnë kërkesat për zbatimin përfundimtar të qëllimeve të tyre. Situata u ndërlikua në atë mënyrë që Komiteti Qendror i Partisë, nën një psikozë të tillë lufte, pranoi fajet që ai nuk i kishte bërë.

Puna mori teposhtën, plani s'po realizohej.

Po humbej koha në studime e diskutime, kurse aparati burokratik dhe sektar, që Koçi Xoxe kishte krijuar në Parti, po bënte punën e vet shkatërruese. Nën-vleftësimi dhe gjurmimi i kuadrove kishte arritur kulmin. Komisioni i koordinimit të planeve përpiqej të merrte formën e një qeverie de fakto të Jugosllavisë në Shqipëri. Funkzioni i Komisionit të Planit tonë po zhdukej, po bëhej një apendic pa kurrfarë kompetence. Një komision kontrolli erdhi nga Jugosllavia për të likuiduar shoqëritë e përbashkëta dhe t'i bënte këto, duke shkelur aktet ndërkombëtare, ndërmarrje nën drejtimin e jugosllavëve dhe t'i shkëpuste nga kontrolli i qeverisë sonë. Ky komision kontrolli në bashkëpunim me Pandi Kriston akuzuan qeverinë tonë për gjëra të turpshme dhe monstruoze, që vetëm imperialistët mund të bëjnë gjëra të tilla. Të gjitha këto bëheshin me qëllime të caktuara presioni dhe shantazhi, për të na imponuar pikëpamjet e tyre antimarksiste. Këtu ishte pregatitja e terrenit, zhdukja e formave organizative ose formave të konsakruara në aktet ndërkombëtare për të bashkuar krejt ekonominë tonë me të Jugosllavisë, për të zhdukur çdo pengesë nga ana ndërkombëtare dhe për ta paraqitur pastaj çështjen e bashkimit të të dy vendeve tona si një akt të mbaruar me dëshirën e plotë të Partisë dhe të popullit tonë. Me gjithë Plenumin VIII dhe përkuljen e Komitetit Qendror, rezistenca nuk ishte shuar. Elementët e shëndoshë të Partisë filluan rezistencën e përpjekjet me jugosllavët, filluan mosmarrëveshjet.

Situata në lëmin e ekonomisë, që qe shkaktuar nga këto veprime të trockistëve jugosllavë ishte tepër e vë-

shtirë. Po s'mjaftoi me kaq. Trockistët jugosllavë zhvilluan në të gjithë sektorët e tjerë të vendit tonë situata po kaq të vështira dhe të tëra këto ishin të koordinuara për t'ja arritur qëllimit të tyre të fundit. Grupi trockist Tito përdori taktikën e frikësimit të Komitetit tonë Qendror duke e paraqitur gjendjen ndërkombëtare si alarmuese e kërcënuese për vendin tonë. Ata kishin ngritur plane fantastike, gjoja se Shqipëria do të sulmohej, se ushtria jonë ishte e dobët e s'mund t'i rezistonte sulmit, se duheshin mobilizuar forca të tjera, se duheshin marrë masa të jashtëzakonshme ushtarake, që i kushtonin Shqipërisë qimet e kokës, etj. Kjo taktikë përdorej që Komiteti ynë Qendror të preokupohej seriozisht për këtë çështje dhe të harronte të gjitha çështjet e tjera dhe jugosllavët të sillnin ushtrinë e tyre në Shqipëri dhe në vendin tonë të krijohej një alarm i pavend. Nga ana tjetër këta kishin për qëllim që, duke u vënë Komiteti ynë Qendror përpara pamundësive për realizimin e gjithë këtij plani, që s'ishte përveçse një bluf, trockistët jugosllavë t'i impononin vendit tonë bashkimin me Jugosllavinë. Gjithë ky plan frikësimi dhe presioni u dërmua nga rezistenca e Byrosë sonë Politike. Për ta tërhequr vendin tonë në këtë provokacion me karakter ndërkombëtar, që po përgatiste grupi trockist i Titos, trockistët jugosllavë arritën të thoshnin poshtërsira të tilla se gjoja Shqipëria ishte në rrezik dhe se Bashkimi Sovjetik do ta sakrifikonte Shqipërinë te imperialistët, se Bashkimi Sovjetik ishte larg dhe nuk mund ta ndihmonte dot Shqipërinë dhe të tjera shpifje të poshtra. Trockistët jugosllavë e barazonin politikën e drejtë të Bashkimit Sovjetik me politikën e njerëzve që bënë Mynihun.

Grupi trockist i Titos vuri në dyshim aplikimin e aleancës dhe të ndihmës reciproke në mes të dy vendeve tona, që ne të pranonim pikëpamjet e tyre dhe të armiqësoheshim me Bashkimin Sovjetik. Ne nuk i pranuan këto dhe i hodhëm poshtë kërkesat e tyre. Trockistët jugosllavë akuzuan Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë për mosbesim ndaj Jugosllavisë Federative Popullore.

Lufta kundër vijës së Partisë nga ana e trockistëve jugosllavë u shpall frontale në gjithë sektorët kyç: në orientimin politik të përgjithshëm të Partisë, në ekonomi dhe në ushtri. Por, në orientimin politik të Partisë, që dallohej për besnikërinë e madhe ndaj Bashkimit Sovjetik, trockistët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre si Koçi Xoxe e Pandi Kristo, dhe në sektorin e ushtrisë shoku Kristo Themelko e Pëllumb Dishnica, të cilët ishin krejt nën influencën e plotë të udhëheqjes së PK të Jugosllavisë, që mendonin krejt si ata dhe i quanin me vend tezat e jugosllavëve, nuk mundën të korrnin asnjë sukses. Në lëmin ekonomik trockistët jugosllavë fituan pozita, të cilat ata mendonin se do t'u shërbenin, të koordinuara me aksionet e tjera, për të realizuar planet e tyre diallëzore. Jugosllavët atakuan në frontin ushtarak. Goditjet e para të trockistëve jugosllavë u drejtuan kundër Shefit të Shtatmadhorisë, Gjeneral Mehmet Shehut dhe njëkohësisht tërthorazi kundër Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë. Pas Plenumit VIII, trockistët jugosllavë fituan në ushtri pozita dhe qëllimi ishte për të sheshuar gjithë pengesat për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Jugosllavët, me ndihmën e plotë të shokut Kristo Themelko, Pëllumb Dishnica, etj., që

drejtonin dhe punonin në Drejtorinë Politike të Ushtrisë, krijuan një atmosferë lufte në Komandën e Përgjithshme ndaj Komandantit të Përgjithshëm, ndihmësit të parë të tij, Shefit të Shtatmadhorisë, Gjeneral Mehmet Shehut dhe kundër programeve të eksperiencës së lavdishme të Ushtrisë Sovjetike. Kundër kësaj të fundit u përdorën sharje dhe shpifje të turpshme për të nënvlehtësuar eksperiencën ushtarake sovjetike, Ushtrinë Sovjetike dhe oficerët sovjetikë. Trockistët jugosllavë, me këmbëngulje dhe me shantazhe të shumta, u përpoqën që t'i prisnin ushtrisë sonë eksperiencën e paçmueshme të Ushtrisë Sovjetike për edukimin dhe modernizimin e ushtrisë sonë, t'i impononin ushtrisë sonë pikëpamjet antisovjetike të tyre, me një fjalë të godisnin vijën e drejtë të Partisë sonë në sektorin ushtarak. Fakti është se jugosllavët e konsideronin ushtrinë tonë, ushtrinë e një populli të pavarur, si një armatë jugosllave dhe shokët e Drejtorisë sonë Politike me Kristo Themelkon në krye ishin të bindur dhe punonin sikur ushtria jonë ishte një armatë e Jugosllavisë. Orientimi në programe në Drejtorinë Politike dhe sidomos pas Plenumit VIII, ishin lidhur krejt me ato të Jugosllavisë. Popullarizimi i Bashkimit Sovjetik në ushtri kishte zbritur në radhë të dytë dhe ai ishte i lidhur vetëm në ditën e festave sovjetike. Shteti jugosllav, ushtria jugosllave dhe Titua ishin në radhën e parë të propagandës në ushtri. Sa për Komandantin e Përgjithshëm të ushtrisë sonë, flitej fare pak. Të tilla situata krijuan trockistët jugosllavë pas Plenumit VIII të Komitetit Qendror. Pasi ngritën të gjitha këto çështje në këtë mënyrë, ku mbretëronte shantazhi, frikësimi, kërcënimi i urisë për popullin tonë,

me një fjalë, gjithë arsenali trockist, grupi trockist i Beogradit, me ndërmjetësinë e Kristo Themelkos dhe të delegatit të saj Savo Zllatiç, i propozoi Komitetit tonë Qendror bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Në të gjithë këtë lodër të madhe armiqësore, të kryesuar nga grupi trockist Tito dhe të ndihmuar nga Koçi Xoxe e Pandi Kristo, qëllimi ishte t'i jepnin grushtin e fundit vendimtar pavarësisë së Partisë sonë dhe të Shqipërisë; të shpartallonin rezistencën e Partisë sonë dhe të popullit tonë dhe të likuidonin përgjithmonë Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë dhe shokët e tjerë të Byrosë dhe të Komitetit Qendror, që mbronin vijën e drejtë marksiste-leniniste dhe Koçi Xoxe e Pandi Kristo do të merrnin frenat e Partisë në dorë. Kështu trockistët jugosllavë, pasi t'i kishin hedhur në duart e tyre gjithë pozitën e rëndësishme dhe në radhë të parë Partinë, Sigurimin e Shtetit dhe ushtrinë, atëherë çdo gjë kishte mbaruar.

Byroja Politike e Partisë i hodhi poshtë tezat e propozuara nga Komiteti Qendror i PK Jugosllave në lidhje me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe pas këtij veprimi të rëndësishëm e tërë kalaja prej karte e trockistëve jugosllavë u rrëzua. Çështja e ardhjes së ushtrisë jugosllave në Shqipëri, çështja e masave të mëdha ushtarake, çështja e komandës unike dhe të gjitha çështjet e tjera u rrëzuan. Po trockistët jugosllavë nuk i hodhën armët. Ata rifilluan sulmet me propozime të reja për bashkëpunim në lëmin ekonomik, ata me presione të panumërta u përpoqën që Partia jonë të mos e merrte eksperiencën e vlefshme sovjetike. Byroja Politike i hodhi poshtë të gjitha kërkesat e tyre dhe tamam në këto

momente Partia jonë u vu në dijeni për letrat e famshme historike, që Komiteti Qendror i Partisë Bolshevike i kishte dërguar Komitetit Qendror të PK Jugosllave. Që atë ditë, Partia dhe populli ynë shpëtuan nga katastrofa e madhe, dhe kjo i detyrohet Partisë së lavdishme Bolshevike dhe shokut të madh Stalin. Po edhe në këto momente, kur lodra e tyre armiqësore, antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike u zbulua, trockisti Tito, duke pasur kurdoherë besim te Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, etj., i nxiti këta për herë të fundit me anën e një letre drejtuar shokut Enver Hoxha dhe Komitetit Qendror. Në këtë letër ai e akuzon haptas Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë si shkaktar të prishjes së marrëdhënjëve me Jugosllavinë dhe njëkohësisht shkaktar të përçarjes në Byro. Kjo letër qe një alarm i dytë në Komitetin tonë Qendror dhe një inkurajim për ata shokë që kishin punuar në vijën trockiste të jugosllavëve. Por çdo gjë kishte marrë fund. Çdo veprimtari keqbërës e trockistëve jugosllavë kundër vendit tonë, kundër Partisë dhe popullit tonë, kishte mbaruar. Letrat e Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike kishin shpëtuar Partinë tonë nga një shkatërrim i madh, e shpëtuan këtë nga thonjtë e trockistëve jugosllavë, shpëtuan popullin dhe vendin tonë nga një katastrofë, ku kërkonin ta tërhiqnin trockistët jugosllavë. Në çdo moment Bashkimi i madh Sovjetik dhe shoku i shtrenjtë dhe i dashur Stalin, Partia e lavdishme Bolshevike e kanë ndihmuar Partinë dhe popullin tonë. Ata e ndihmuan për herë të parë për të shpëtuar nga thonjtë e hitlerianëve, ata e ndihmuan për të shpëtuar nga thonjtë e imperializmit anglo-amerikan, ata e ndihmuan për të shpëtuar nga

thonjtë e trockistëve jugosllavë, ata e duan dhe e mbrojnë Shqipërinë e vogël demokratike nga çdo rrezik. Populli ynë dhe Partia jonë kurrë nuk do t'i harrojnë këto dhe do t'i qëndrojnë besnikë Bashkimit Sovjetik, ashtu si di të jetë besnik populli shqiptar, ashtu si e tregon historia e tij shekullore.

Pas një situatë të tillë armiqësore, të krijuar nga udhëheqja trockiste e Partisë Komuniste Jugosllave, marrëdhënjet ekonomike dhe politike në mes të dy vendeve tona duhej të spastroheshin dhe të zhdukeshin nga marrëdhënjet në mes të dy popujve tanë vëllezër të gjitha qëllimet e poshtra, shfrytëzuese, koloniale dhe imperialiste, antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike të vendosura nga grupi trockist Tito. Partia dhe qeveria jonë kërkoi që të rishikoheshin këto marrëveshje me përjashtim të «Traktatit të miqësisë dhe të ndihmës reciproke». Qeveria trockiste jugosllave e refuzoi këtë gjë dhe gjithë përgjegjësitë bien mbi të. Puna armiqësore e grupit trockist Tito nuk mund të çenojë miqësinë e ngushtë dhe vëllazërimin në mes të popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë, sepse ajo është e mbrujtur me gjak dhe politika e Partisë sonë, edhe pas momenteve të rënda që shkaktoi në vendin tonë dhe në Jugosllavi grupi trockist Tito, ka qenë dhe do të mbetet për miqësinë, dashurinë dhe aleancën e sigurtë me popujt heroikë dhe vëllezër të Jugosllavisë. Partia dhe populli ynë e ndiejnë thellë mjerimin e madh të popullit dhe të Partisë Komuniste Jugosllave, po asgjë s'mund t'u heqi besimin e patundur Partisë dhe popullit tonë, se populli heroikë vëlla jugosllav dhe elementët e shëndoshë të Partisë Komuniste Jugosllave do ta

mposhtin grupin trockist të Titos dhe do të rifitojnë jetën e tyre të re. Popujt e Jugosllavisë janë të bindur për fitoren e tyre të ardhshme dhe ne jemi të bindur për atë. Gjithashtu popujt vëllezër të Jugosllavisë e dinë mirë se te populli ynë dhe te Partia jonë ata kanë miq nga më besnikët dhe besnikërinë e tyre ndaj popujve të Jugosllavisë e kanë treguar me luftë dhe me gjak dhe populli ynë thotë se «gjaku s'bëhet ujë».

III

PARTIA

SHKATËRRIMI I PUNËS ARMIQËSORE NE GJIRIN E PARTISË SONË

Grupi nacionalist trockist Tito ndërhyri brutalisht në punët e brendshme të Partisë sonë për t'i imponuar Partisë dhe popullit tonë pikëpamjet antimarksiste, anti-shqiptare dhe antisovjetike. Ndërhyrja filloi me akuzat e pathemelta dhe të poshtra të Vukmanoviç Tempos, përfaqësues i Komitetit Qendror të PKJ në udhëtim në Shqipëri gjatë periudhës së luftës. Ky trockist e akuzoi Komitetin Qendror të Partisë sonë për oportunizëm me «Ballin». Kjo ishte një shpifje, po qëllimi i Komitetit Qendror të PKJ ishte të hidhte farën e parë të përçarjes në Komitetin Qendror të Partisë sonë dhe të krijonte kundërshtime në gjirin e Partisë, gjoja për çështje parimore. Më vonë, me letra, Titua akuzoi Miladin Popoviçin dhe Komitetin Qendror të Partisë sonë gjoja në pozita shoviniste dhe shtrembërim vije në lidhje me

Kosovën e Metohinë. Kjo ishte një shpifje dhe kishte për qëllim shoqërimin e akuzës së parë të Vukmanoviç Tempos. Ky i fundit, për goditjen e Komitetit tonë Qendror dhe veçanërisht të shokëve Enver Hoxha dhe Miladin Popoviç, pati përkrahjen e plotë e të ndërgjegjshme të Koçi Xoxes dhe të Sejfulla Malëshovës. Koçi Xoxe që në atë kohë, dakord me pikëpamjet e Vukmanoviç Tempos, ishte në kundërshtim me vijën e Komitetit Qendror, të mbrojtur nga shokët Enver Hoxha dhe Miladin Popoviç. Moskënaqësitë e tjera personale dhe gabimet, që mund të ishin vërtetuar gjatë kohës së luftës, s'ishin përveçse pretekste për të mbuluar luftën parimore dhe kundërshtimin në parim, të vijës së drejtë të Komitetit Qendror. Në aktivet e Partisë, ku u punua Rezolucioni i Plenumit XI të Komitetit Qendror, u depunua se më vonë, Koçi Xoxe i raportonte Vukmanoviç Tempos gjendjen e Partisë sonë, duke i vënë në dukje se gjoja kjo ishte e dominuar nga intelektualët, etj. Kjo gjë bëhej pa dijeninë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Kjo shpjegon tërheqjen brutale të shokut Miladin Popoviç nga Shqipëria dhe ardhjen e delegatit të KQ të PKJ Velimir Stojniçit, i cili me përkrahjen kryesore dhe të plotë të Koçi Xoxes, organizoi prapaskenën në Plenumin e Beratit.

Përse Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave i atakoi Komitetin Qendror të Partisë sonë gjatë kohës së luftës, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Miladin Popoviçin? Arësyeja është se Komiteti Qendror i Partisë sonë e edukonte Partinë tonë në frymën e drejtë marksiste dhe të internacionalizmit, se e edukonte Partinë tonë dhe e drejtonte popullin tonë në luftë, duke

e shikuar kurdoherë atë të lidhur me Bashkimin Sovjetik dhe me luftën e tij të drejtë, se e edukonte Partinë dhe popullin tonë të shikonte te Bashkimi Sovjetik, te Partia Bolshevike dhe te shoku Stalin, mbrojtësit e tij dhe të popullit të tij. Ky orientim nuk i pëlqente Komitetit Qendror të PK Jugosllave, i cili dëshironte që Partia jonë dhe populli ynë të shihnin çdo gjë të lidhur me Partinë Komuniste Jugosllave. Partia jonë e edukoi popullin t'i dojë popujt e Jugosllavisë dhe Partinë Komuniste Jugosllave, po Komiteti Qendror i kësaj të fundit nuk dëshironte pavarësinë e Partisë sonë dhe të popullit tonë. Më vonë, me çlirimin e Shqipërisë një zhvillim i tillë i drejtë i Partisë sonë do të bëhej një pengesë e madhe për qëllimet antimarksiste e anti-shqiptare të grupit nacionalist të Beogradit. Për ta ndryshuar këtë situatë u dërgua Velimir Stojniçi me direktiva të caktuara: të likuidonte Komitetin Qendror, që kishte udhëhequr Luftën nacional-çlirimtare, të likuidonte Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokun Enver Hoxha, të bënte njëkohësisht të plotfuqishëm në Komitetin Qendror Koçi Xoxen dhe të vendoste format e metodat antimarksiste në udhëheqjen dhe në organizimin e Partisë, të krijonte në Komitetin Qendror opinionin se lufta e popullit tonë i detyrohej ndihmës së Komitetit Qendror të PK Jugosllave dhe, pra, Shqipëria e re të shikonte nga Jugosllavia dhe vetëm nga Jugosllavia. Velimir Stojniçi, për të zbatuar këto direktiva kishte përkrahës kryesor Koçi Xoxen. Nako Spiru, i pakënaqur pa të drejtë, me një dozë ambicie të theksuar, ra në kurthin e ngritur prej Velimir Stojniçit dhe Koçi Xoxes. u bë flamurtar i një kauze të huaj për Partinë

tonë. Me në krye Velimir Stojniçin, Koçi Xoxe, Nako Spiru, Pandi Kristo dhe Sejfulla Malëshova organizuan në prapaskenë goditjen e vijës së drejtë të Komitetit Qendror të Partisë, goditjen e unitetit të Komitetit Qendror dhe goditjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Ky plan u bë fshehurazi dhe në konspiracion nga Komiteti Qendror dhe shoku Enver Hoxha. Kjo ishte një punë grupazhi dhe fraksionazhi. Për këtë vepër antiparti Velimir Stojniçi, thirri fshehurazi Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Nako Spirun, Sejfulla Malëshovën dhe disa shokë të tjerë të Komitetit Qendror, te të cilët ishin të bindur se këta do t'i shoqëronin në veprën e tyre antiparti. Kështu u organizua goditja e Komitetit Qendror në Berat. Rolet ishin të ndara dhe opinioni i të gjithë këtyre grupashëve fraksionistë ishte se Sekretari i Përgjithshëm i Partisë nuk duhej të qëndronte më në vendin e tij, sepse ai s'e meritonte, por u arrit në konkluzion se nuk ishte momenti i përshtatshëm dhe se u pat frikë nga ndonjë lëvizje eventuale e ushtrisë dhe e oficerëve. Goditja e Beratit ka pasur platformën e saj politike, të diktuar nga përfaqësues jugosllavë dhe të aprovuar plotësisht nga grupashët me në krye Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Nako Spirun dhe Sejfulla Malëshovën. Platforma politike ishte kjo: gjatë periudhës së luftës ishin vërtetuar gabime të rënda parimore në vijë; në vijë ka pasur oportunitizëm dhe sektarizëm; ka pasur punë personale; Partia nuk ishte një parti marksiste-leniniste; ajo po degjeneronte në një parti banditësh dhe terroristësh; se udhëheqësi i Partisë kishte bërë gabime të rënda në vijë, ishte përgjegjës kryesor dhe tërthorazi lihej të kuptohej se s'e meritonte këtë vend.

Të gjitha këto akuza, që i bëheshin vijës së drejtë të Partisë, ishin shpifje dhe të pathemelta. Gjatë luftës ka pasur gabime, por aspak të kësaj natyre, ka pasur pakënaqësira, ka pasur lëshime, po që nuk kishin dëmtuar vijën e Partisë dhe të luftës dhe këto lëshime ishin të ndreqshme me një mbledhje të rregullt dhe në bazën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë. Kishin gabuar në vijë Ymer Dishnica dhe Liri Gega, po jo Komiteti Qendror dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë. Ishte vërtetuar mostrajtimi i mirë i kuadrove, fare i mundshëm gjatë periudhës së luftës dhe në një Parti të re të porsaformuar. Koçi Xoxe e Pandi Kristo, sidomos, këto të meta dhe lëshime i muarën si goditje personale, që u bëheshin atyre pa reflektuar fare në punën e tyre aspak të shkëlqyer gjatë kohës së luftës, po përkundrazi me shumë dobësi. Prapaskena e Beratit, me platformën e saj antiparti, e kurdisur me frymë dhe me metoda trockiste ishte një puç kundër Partisë sonë dhe kundër rregullave, mbi të cilat mbështetet një parti komuniste. Në Plenumin e Beratit u shkelën gjithë rregullat e Partisë. Platformës së gabuar politike, ju shtuan pakënaqësitë personale, ju shtua shpifja për të goditur vijën e drejtë të Partisë dhe njerëzit që kishin udhëhequr popullin në fitore. Teza armiqësore e Komitetit Qendror të PK Jugosllave triumfoi në Berat: u godit uniteti i Komitetit Qendror, u godit vija e drejtë e Partisë, u godit dhe u diskreditua Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, u shkel centralizmi demokratik, u shpërdorua kritika dhe autokritika dhe këto u përdorën për të diskredituar njerëzit, u inkurajua ambicia e sëmurë, megalomania, u krijua «kulti i heronjve që shpëtojnë

Partinë» nga rreziqe të mëdha, të pretenduara, u inkurajua karrierizmi dhe u futën në Parti metoda ushtarake, anarkiste dhe puçiste, u fut arbitrarizmi. U sheshua terreni për futjen në Parti të formave organizative antimarksisteleniniste siç është ajo më kryesorja e qenjes së sekretarit organizativ, njëkohësisht dhe ministër i brendshëm. Udhëheqja trockiste jugosllave përgatiti njeriun e besuar të saj, Koçi Xoxen, për veprimtarinë e tij antiparti të mëvonshme. Njëkohësisht, u fut në Parti pikëpamja oportuniste, nacionaliste, e udhëheqjes jugosllave dhe e Sejfulla Malëshovës, pikëpamje, që shkante krahas me sektarizmin e Koçi Xoxes, që do të zhvillohej më vonë në forma katastrofale. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u armatosën në Berat për të përgatitur nënshtrimin e Partisë nën urdhërat e grupit trockist Tito. Plenumi i Beratit me ndërhyrjen brutale të delegatit të Komitetit Qendror të PK Jugosllave dhe me pranimin e plotë të tezave të tija antimarksiste dhe anti-shqiptare goditi pavarësinë e Partisë. Berati i dha të drejtën Komitetit Qendror të PK Jugosllave të thoshte fjalën e fundit vendimtare në Partinë tonë dhe të propagandohej në Parti si shpëtimtari i situatës së rëndë në Partinë tonë dhe ndihmës kryesor dhe drejtues i Luftës sonë nacional-çlirimtare.

Pas Plenumit të Beratit, Partisë i viheshin përpara detyra të rënda, por kjo s'kishte një udhëheqje monolite; kjo ishte me një Komitet Qendror të shkatërruar, ku mungonte uniteti, sinçeriteti dhe ku mbretëronte mosbesimi e nënvleftësimi, në radhë të parë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm, i cili vetëm do të mund të vendoste koordinimin e drejtë të punëve në Byro dhe

në Komitetin Qendror. Koçi Xoxe, i fryrë nga një megalomani e madhe, i mbështetur nga jugosllavët, me pozita të privileguara, në mënyra antimarksiste punonte si për zbatimin e punëve që i ngarkonte funksioni i tij edhe për ato që nuk i përkisnin funksionit të tij, por që de fakto ai e luante dhe këtë funksion, funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Për jugosllavët, për Koçi Xoxen dhe për Pandi Kriston si dhe për Nako Spirun e Sejfulla Malëshovën, në muajt e parë të çlirimit shoku Enver Hoxha ishte formal në krye të Partisë.

Një situatë e tillë në kokën e Partisë i shkaktoi dëme të mëdha Partisë dhe popullit. Nga mungesa e unitetit në Byronë Politike u dukën lëkundje në vijë; oportunizmi i Sejfulla Malëshovës kishte hedhur rrënjë dhe po bëhej i rrezikshëm, gabimet organizative po shtoheshin; Koçi Xoxe, që s'kishte aspak idenë se çdo të thoshte autokritikë, ngulmonte në gabimet e tija dhe këto gabime jo vetëm që ai i fshihte, po me qëndrime antikmuniste autoritare dhe me blofe kërkonte të fshihte edhe pazotësinë e tij në drejtimin e punëve. Shoku Nako Spiru e braktisi rrugën antimarksiste të Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos, me të cilët ishte solidar në Berat. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u armiqësuan me Nako Spirun, jo për çështje personale, por për çështje parimore. Nako Spiru u solidarizua me Sekretarin e Përgjithshëm për të mbrojtur vijën e drejtë të Partisë dhe me qëllim që të forconte pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm. Në këtë rrugë, Nako Spiru do të korrigjohej. Një kthesë e tillë nuk mund t'u pëlqente trocistëve jugosllavë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, Koçi

Xoxes dhe Pandi Kristos. Gjendja në Byro ishte e padurueshme; u goditën pikëpamjet oportuniste të Sejfulla Malëshovës, po Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo vazhduan me vendosmëri në rrugën e tyre të gabuar.

Shoku Enver Hoxha, duke mos ditur se ç'kishte ngjarë në prapaskenën e Beratit, për ta çuar Komitetin Qendror në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, paraqiti në qershorin e 1946-s para Byrosë Politike tezat e tija për revizionimin e Plenumit të Beratit. Shoku Enver Hoxha kishte gjykuar se Plenumi i Beratit, ishte sëmundja kryesore; atje e kishin burimin të gjitha gabimet dhe fatkeqësitë, që i ndodhnin Partisë pas çlirimit; atje e kishin burimin mosmarrëveshjet dhe grindjet në Byro, puna oportuniste dhe armiqësore e Sejfulla Malëshovës. Në tezat e tija shoku Enver Hoxha theksonte se ndërhyrja dhe puna e delegatit të KQ të PKJ ishte një punë armiqësore; se në Plenumin II të Beratit u godit vija e drejtë e Partisë sonë, u godit padrejtësisht udhëheqja dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë; se në Byronë tonë mungonte uniteti, kritika dhe autokritika; se si rrjedhim i Plenumit të Beratit kishte dalë çështja e spostimit në drejtimin e Partisë, ishte shfaqur dualizmi parti-pushtet dhe më në fund se ishin vërtetuar gabime organizative, që duheshin ndrequr sa më parë.

Këto teza, që koha i vërtetoi se ishin shumë të drejta, u hodhën poshtë dhe nuk u pranuan, as nga Koçi Xoxe as nga Pandi Kristo. Nga Nako Spiru u pranuan pjesërisht dhe që të tre këta shokë, që kishin bërë punën antiparti në Berat, e mbajtën sekret dhe e fshehën punën grupazhe dhe fraksioniste të Beratit. Vetëm dy ditë

para vetëvrasjes së Nako Spirut dhe me qëllime djallëzore për të influencuar Sekretarin e Përgjithshëm që të mbante një qëndrim intransigjent ndaj Nako Spirut, Koçi Xoxe i thotë shokut Enver Hoxha se gjoja Nako Spiru kishte thënë se «në rast se Enver Hoxha nuk u bindet urdhërave tona, atëhere e bindim me kobure kresë». Kjo nga ana e Koçi Xoxes ishte një punë tipike trockiste, po edhe pas vetëvrasjes së Nako Spirut, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo me zor do të pohonin deri në kohën e fundit prapaskenën e Beratit.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk mund të ishin dakord me tezat e Sekretarit të Përgjithshëm, sepse e tërë veprimtaria e tyre deri në atë kohë, do të zbulohesh dhe kjo punë e tyre ishte armiqësore ndaj Partisë. Ata s'mund të zbulonin prapaskenën e Beratit se ishin faktorët kryesorë të saj dhe fajtorë të mëdhenj. Jo vetëm kaq, po ata mbronin me këmbëngulje platformën trockiste të Beratit. Ata s'mund të dënonin veprën armiqësore të Velimir Stojnićit, sepse kanë qenë solidarë me të, sepse ky ka qenë faktori antiparti që e kishte mbështetur dhe e kishte mbrojtur Koçi Xoxen që të arrinte në këto pozita shumë të dëshiruara nga Koçi Xoxe për të ushtruar mbi Partinë pikëpamjet e tija antimarksiste. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk mund të pranonin forcimin e unitetit në udhëheqje, sepse ata ishin shkatërrarët kryesorë të kësaj përçarjeje dhe se për ata, uniteti në Parti do të arrihej vetëm kur të spastrohej nga udhëheqja dhe nga Partia shoku Enver Hoxha, Nako Spiru, dhe gjithë shokët e tjerë që s'pajtoheshin me pikëpamjet antiparti të Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos. Në tezat e revizionimit të Plenumit të Beratit çdo problem

që ngrihej shtrohej në baza parimore marksiste, po Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, për të evituar rrezikun që i kërcënonte, i degjeneruan këto në çështje personale, duke i cilësuar tezat e drejta të revizionimit, sikur këto ishin bërë nën influencën personale dhe të drejtuara vetëm në prizmin personal ndaj Koçi Xoxes. Kjo ishte një metodë tipike trockiste, që s'lejonte të zbuloheshin dhe të ndreqeshin gabimet në baza të shëndosha të kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo i fshehën gabimet e tyre të rënda nga Partia dhe duke i mbrojtur me forcë këto gabime të tyre, ata vazhduan t'i thellojnë më tepër për të shqelmuar Partinë. Trockistët jugosllavë me Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston panë një rrezik iminent që po kërcënonte zbulimin e lodrës së tyre të fëlliqur dhe në mes të mbledhjeve të Byrosë, kur punoheshin tezat e revizionimit, qeveria jugosllave, për të ndërprerë këto punime, ftoi qeverinë shqiptare të dërgojë delegacionin qeveritar në Beograd për të lidhur traktatin e miqësisë dhe të ndihmës reciproke. Për të rënduar gjoja fajet e Nako Spirut, pak ditë pas vetëvrasjes së tij, Koçi Xoxe, i këshilluar, sigurisht, prej jugosllavëve, i thotë Sekretarit të Përgjithshëm se «Nako Spiru u paskësh dhënë jugosllavëve tekstin e tezave të shokut Enver Hoxha mbi revizionimin e Plenumit të Beratit duke shfaqur dhe mendimin e tij: shihni si Enver Hoxha atakon Jugosllavinë dhe Komitetin Qendror të PK të Jugosllavisë». Në dritën e analizave duket qartë se këto kanë qenë shpifje dhe se thirrja e delegacionit qeveritar në Beograd për nënshkrimin e traktatit, në atë moment, ka qenë një mjet për të shpëtuar situatën e vështirë që

do të krijonte rishikimi i punës së Plenumit të Beratit.

Tezat e revizionimit të Plenumit të Beratit nuk u pranuan nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Që të dy këta me Nako Spirun, nuk patën kurajën bolshevike të zbulonin veprimtarinë e tyre në Berat; po megjithkëtë pozitë të dobët, shoku Nako Spiru, duke menduar se këtë gabim të tij në Berat do ta mbulonte koha, u solidarizua dhe ca më tepër me Sekretarin e Përgjithshëm.

Pas këtyre tezave, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, duke parë se situata në Byro ishte shumë e rëndë, propozoi zgjerimin e Byrosë Politike me kuadro të rinj dhe të sprovuar në luftë, me qëllim që të vendosej në Byro uniteti, të rishtroheshin problemet dhe të ndreqeshin gabimet. Këtë masë të drejtë të Sekretarit të Përgjithshëm e luftuan Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, për arësye se ata ishin kundër unitetit, se ardhja në Byro e elementëve të rinj, dobësonte pozitën e tyre dhe do të forconte pozitën e shokëve, që mbronin vijën marksiste-leniniste të Partisë. Byroja u zgjerua jo në atë formë, që propozoi Sekretari i Përgjithshëm. Në vendimin që u muar, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo votuan kundër, por gjoja ju nënshtruan vendimit të shumicës; në realitet këta të dy, s'ju nënshtruan asnjëherë vendimit të shumicës. U kërkua nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë që Koçi Xoxe të jepte raport përpara Byrosë për punën organizative. Ai e pranoi këtë pa qejf, po në realitet, ai krijoi njëmijë situata për t'ju shmangur kësaj detyre dhe nuk e bëri kurrë këtë raport, sepse ngritja e çështjeve organizative në Byronë Politike do të zbulonte njërin pas tjetrit gabimet e rënda të Koçi Xoxes, veprimtarinë e tij antiparti, do të zbulohet bash-

këpunimi i ngushtë i tij me njerëzit e Komitetit Qendror të PK Jugosllave, do të zbulohet pazotësia e tij, do të goditeshin pozitat e tija të privilegjuara e false dhe do të vendosej uniteti marksist-leninist në bazë të kritikës dhe të autokritikës, gjë e padëshirueshme nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe trockistët jugosllavë. Për të evituar dhënjen e llogarive, trockistët jugosllavë me Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston ndërmuarën një sërë aksionesh trockiste për të shpartalluar këtë rigrupim të shëndoshë shokësh që formohej rreth Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, të mbështetur nga jugosllavët, i zmadhuan edhe më tepër armiqësitë në Byro, duke forcuar luftën në baza antiparti dhe antimarksiste, me metoda trockiste, me shpifje, kërcënime, shantazhe, kundër elementit të shëndoshë të Byrosë. Taktika e këtyre ishte të diskreditonin gjithë shokët, që mbronin vijën e drejtë rreth Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, të shpifnin për Nako Spirun e Mehmet Shehun, të neutralizonin Gogo Nushin, etj. dhe të izolonin kështu Sekretarin e Përgjithshëm. Kjo do të thoshte të likuidonin Komitetin Qendror dhe të sillnin më vonë, me anën e kooptimit, njerëz të bindur të Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo për të zbatuar vijën e tyre antiparti. Pandi Kristo ka pohuar se situata në Byronë Politike ishte aq e nderë sa që ai me Koçi Xoxen prisnin «të na jepej një grusht i rëndë nga jashtë që të mblidhnim veten». Ky pohim zbuloi gjithë këtë veprimtari të trockistëve jugosllavë, të Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos. Këta të dy, me ndërgjegje të plotë dhe me metoda antiparti kishin kundërshtuar zgjidhjen e kontradiktave, që ekzistonin, me mjetet e ligjshme të

Partisë. Ata kishin punuar në rrugën e në drejtimin e grupit trockist Tito dhe kishin krijuar me ndërgegje të plotë këtë situatë të turbullt në Byro. Tani ata ishin në pritje të «grushtit të rëndë», që duhej të vinte nga grupi trockist Tito për të goditur Sekretarin e Përgjithshëm dhe gjithë shokët e tjerë, që mbronin vijën e drejtë të Partisë, për të goditur vijën e drejtë të Partisë, për të mposhtur Komitetin Qendror dhe Partinë, për ta vënë këtë në rrugën e trockizmit dhe ta nënshtonin krejtësisht nën urdhërat e grupit trockist Tito. Grushti i rëndë, i dëshiruar dhe i përgatitur nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe trockistët jugosllavë, erdhi me akuzën e dytë që u bë në nëntor të vitit 1947. Kjo akuzë kundër Komitetit tonë Qendror ishte në platformë të gjerë. Kjo godiste njëkohësisht Komitetin tonë Qendror dhe Partinë tonë, popullin shqiptar, indipendencën dhe sovranitetin e tij, po ashtu godiste edhe Bashkimin Sovjetik, prestigjin e tij të madh në vendin tonë, godiste kampin demokratik dhe antiimperialist në sektorin e Shqipërisë. Kuptohet vetëvetiu se Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u bënë mbrojtësit e zjarrtë të akuzës së poshtër trockiste antishqiptare, antimarksiste, antisovjetike. Gjatë tre vjetëve Koçi Xoxe i kishte perfeksionuar dhe mësuar mirë metodat trockiste të udhëheqjes jugosllave dhe i vuri në zbatim menjëherë pas ardhjes së akuzës jugosllave. Gjoja duke u mbështetur në rregullat organizative ai bëri që akuzat jugosllave të shtroheshin në Byro duke eliminuar nga pjesëmarrja në diskutim shokë anëtarë dhe kandidatë të Byrosë Politike si Mehmet Shehu, etj. dhe këtë e bëri nga frika se mos gjithë kjo punë armiqësore, e kurdisur prej jugosllavëve dhe prej

tij, i pëlciste në duar. Kjo ishte përgatitja e parë për të izoluar nga një mbështetje e sigurtë shokët Enver Hoxha, Nako Spiru, etj. E dyta, Koçi Xoxe, para analizës, në mënyrë të shndershme e antikomuniste, në atë situatë aq të rëndë, për të forcuar tezën jugosllave dhe për të likuiduar besimin e Sekretarit të Përgjithshëm ndaj Nako Spirit, solli një sërë «faktesh» që gjoja Nako Spiru kishte mbledhur kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Të gjitha këto kanë qenë shpifje të kurdisura prej trockistëve jugosllavë, prej Koçi Xoxes e Pandi Kristos. E treta, Koçi Xoxe, para se të shtrohej në Byro akuza jugosllave, këtë problem kaq të madh, ku viheshin në kundërshtim pikëpamjet e trockistëve jugosllavë me pikëpamjet e drejta të Komitetit tonë Qendror e spostoi, duke i vënë rëndësi më të madhe problemit të Nako Spirit. Ky problem, ku grupi trockist Tito, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo kërkonin t'i drejtonin debatet në Komitetin Qendror, nuk ishte aq i thjeshtë dhe në planin personal, po ishte një taktikë që, gjoja për të shikuar problemin e Nako Spirit, të fshihnin qëllimin kryesor, grushtin e rëndë që i bëhej Partisë sonë. E katërta, të gjitha këto shkaktuan vetëvrasjen e Nako Spirit dhe me këtë vetëvrasje u eliminua një nga luftëtarët e vendosur të vijës së drejtë të Partisë. Fill pas vetëvrasjes së Nako Spirit, trockistët jugosllavë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo mbollën dyshimin në anëtarët e tjerë të Byrosë dhe të Komitetit Qendror për të krijuar mosbesim ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë.

Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe prapa tyre, delegati trockist i grupit Tito, me flamurin e shpëtimtarëve të

Partisë, pregatitën Plenumin VIII, që është pika më e zezë në historinë e Partisë sonë. Koçi Xoxe e Pandi Kristo dhe delegati trockist i Komitetit Qendror të PK Jugosllave i muarën të gjitha masat. Kur në Byronë Politike Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Kristo Themelko mbronin me zjarr pikëpamjet trockiste të jugosllavëve, vijën antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike, kur godisnin egërsisht dhe e akuzonin Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë që gjoja kishte shtrembëruar vijën, kishte lejuar gjoja të shkatërrohej Partia, që kishte lejuar organizimin e fraksionit në kokën e Partisë, që kishte sjellë në krye të Shtatmadhorisë dhe në Byro njerëz gjoja antikomunistë si shokun Mehmet Shehu e të tjerë, kundër të cilëve u shpif në mënyrë të poshtër, Koçi Xoxe, i pregatitur nga trockistët jugosllavë, me fjalimin e tij përpara Shkollës së Partisë, pregatiste me frymëzime antiparti, trockiste dhe antisovjetike opinionin e Partisë. Nga ana tjetër Koçi Xoxe pregatiti dhe propozoi listat për kooptimet e reja në Komitetin Qendror duke zgjedhur njerëz, që kujtonin se këta do të mbronin vijën trockiste jugosllave, të Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos. Në këto rrethana u mblodh Plenumi VIII, ku mbretëroi intriga, gënjeshtria, megalomania, fryma otomane e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos. Në këtë plenum u mposht Komiteti Qendror dhe Sekretari i Përgjithshëm, u shkel vija e drejtë e Partisë dhe u ngjall fryma antisovjetike. Plenumi VIII ishte triumfi i grupit trockist Tito dhe i bashkëpunëtorëve të tij. Plenumi VIII hodhi bazat e nënshtrimit të Partisë sonë nën grupin trockist Tito. Vetëm një gjë shpëtoi nga këto dallgë të tërbuara: orientimi i Partisë sonë drejt Bash-

kimit Sovjetik dhe besimi e dashuria e madhe e Partisë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin. Trockistët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, e kuptonin se kjo çështje ishte shumë e rrezikshme, po të flitej haptas në ato momente. Duke bërë gjithë këtë punë antishqiptare, antimarksiste dhe njëkohësisht antisovjetike, duke goditur drejtpërdrejt eksperiencën sovjetike, duke e rrëzuar atë përpara kuadrove tanë, duke përdorur demagogji e fraza hipokrite në drejtim të Bashkimit Sovjetik, duke ngritur në qiell rolin e madh të Jugosllavisë në Ballkan dhe në Evropën Qendrore, ata përgatitnin goditjen e orientimit të drejtë të Partisë sonë drejt Bashkimit Sovjetik, që ishte në bazën e gjithë politikës së Partisë dhe të popullit tonë. Trockistët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë, këtu nuk patën asnjë sukses. Dashuria dhe besnikëria ndaj Partisë Bolshevike, që ushqente Partia jonë dhe populli ynë e ndihmoi të shpëtojë Partinë tonë dhe demaskoi planet e trockistëve jugosllavë dhe të Koçi Xoxes. Pas mbarimit të Plenumit VIII doli rezolucioni i tij, i cili është dokumenti më i hidhur i historisë së Partisë sonë. Në të pasqyrohet gjithë veprimtaria armiqësore e grupit trockist Tito dhe e bashkëpunëtorëve të tyre Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo; aty pasqyrohet qartë se si u godit dhe u shtrembërua vija e drejtë e Partisë, udhëheqja e shëndoshë e saj, nënshtrimi i Partisë dhe i vendit ndaj Komitetit Qendror të PK Jugosllave, goditja e independencës dhe e sovranitetit të vendit tonë, shqelmosja e centralizmit demokratik, e kritikës dhe e autokritikës; aty pasqyrohen metodat puçiste terroriste, metodat ush-

tarake dhe otomane; aty pasqyrohet triumfi i megalomanisë dhe i ambicies, triumfi i padrejtësisë dhe i arbitrarismit, i frymës armiqësore, trockiste, etj.

Pas Plenumit VIII, Koçi Xoxe e Pandi Kristo për të forcuar këto pozita, filluan pastrimin dhe goditjen e kuadrove dhe sjelljen në vendet e tyre të njerëzve që ata mendonin se do ta kryenin me ndërgegje të plotë vepërën e këtyre të dyve dhe të grupit trockist Tito, për të mposhtur përfundimisht Partinë dhe popullin.

Më lart, kur fola për marrëdhënjet me Jugosllavinë, thashë se ku donte të arrinte grupi trockist Tito, pas Plenumit VIII të Komitetit tonë Qendror dhe si letrat e Partisë Bolshevike e ndihmuan Partinë tonë dhe popullin tonë të shpëtonte nga një katastrofë e madhe. Po pas ardhjes së letrave të Partisë Bolshevike, cili ishte qëndrimi i Koçi Xoxes, i Pandi Kristos dhe i Kristo Themelkos?

Kristo Themelko realizoi gabimet e tija, i njohu këto dhe bëri autokritikën, kurse Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo pranuan në dukje dhe në parim pikëpamjet e drejta bolshevike të letrave të KQ të PK(b) të BS po kjo ishte një gjë formale, sepse Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, për një kohë shumë të gjatë, luftuan për të fshehur gabimet e tyre të rënda, për të mos i njohur këto gabime dhe, për të shpëtuar çka mund të shpëtonin, ata përdorën metodat e tyre të zakonshme trockiste. Ju desh Byrosë Politike një kohë shumë e gjatë, prej muajsh të tërë dhe një luftë e përditshme për të zbuluar gabimet e Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos, të cilët mbroheshin me kujdesin më të madh dhe përpiqeshin të fshihnin shumë gjëra.

Plenumi XI i Komitetit Qendror i dha fund një situatë kaq të rëndë dhe të vështirë për Partinë. Plenumi XI u bë në bazë të një analize marksiste-leniniste të shëndoshë dhe në dritën shpëtimtare të letrave të Partisë Bolshevike, drejtuar KQ të PKJ si dhe në dritën e Rezolutës së Informbyrosë «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave». Plenumi XI zbuloi gjithë gabimet e rënda, që ishin vërtetuar në Partinë tonë dhe që e kanë burimin kryesor nga influenca direkte e grupit trockist Tito dhe nga fajet e rënda e puna me frymë trockiste e Koçi Xoxes dhe e Pandi Kristos. Plenumi XI rindërtoi vijën e drejtë të Partisë, zbuloi qëllimet e trockistëve ndaj vendit tonë, ndaj Bashkimit Sovjetik dhe ndaj kampit demokratik e antiimperialist në sektorin e Shqipërisë. Ky plenum zbuloi gabimet e mëdha organizative, gabimet e mëdha në politikën e kuadrove, rивendosi si duhet centralizmin demokratik në Parti, disiplinën e hekurt dhe të ndërgjegjshme, vuri në rendin e ditës kritikën dhe autokritikën bolshevike, forcoi unitetin në udhëheqjen dhe siguroi për Partinë baza të shëndosha marksiste-leniniste që do ta bëjnë këtë të ecë përpara.

Më parë se të përmbledh shkurtimisht edhe disa gabime të tjera të rënda, që ishin vërtetuar në Partinë tonë dhe që letrat shpëtimtare të Partisë Bolshevike na dhanë dritë t'i njohim dhe t'i korrigjojmë, do të bëj një përmbledhje për vendimet e marrura nga Komiteti Qendror në Plenumin XI në lidhje me masat ndaj Koçi Xoxes, Pandi Kristos, etj., si edhe mbi qëndrimin e këtyre në Plenumin XI dhe pas Plenumit XI përpara aktiveve të Partisë, ku punohej Rezolucioni i Plenumit XI të Komitetit Qendror.

Mendimi i Komitetit Qendror është se, pas Plenumit XI, përveç dëmit që i kanë bërë Partisë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo i fshehën të vërtetën Partisë. Kjo është një gjë shumë e rëndë dhe e dënueshme. Një qëndrim i tillë ndaj Partisë së tyre, nuk është i denjë për komunistët dhe për punëtorët, po Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk mund të përfaqësojnë klasën punëtore, se një qëndrim i tillë i ndan përgjithmonë nga klasa deri në fund revolucionare, që është themelia e shëndoshë e Partisë sonë. Qëndrime dhe veprime si këto të Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos, nuk mund të jenë qëndrime të njerëzve të klasës, po të njerëzve të huaj të klasës punëtore. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo kanë hyrë në rrugën e largimit nga ideologjia e klasës dhe për ta është momenti më tepër se kurrë t'i thonë vetes ndal dhe të bëjnë kthesën e menjëhershme për të mos dalë përgjithmonë nga binarët e marksizëm-leninizmit.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo kanë qenë solidarë me trockistët jugosllavë në gjithë punën e tyre armiqësore ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Trockistët kanë për qëllim të goditin udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe të gjithë ata shokë që luftojnë në këtë udhëheqje, që luftojnë për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë.

Shoku Stalin në fjalën e tij më 19 nëntor 1924 jep këtë definicion mbi trockizmin:

«Trockizmi përmban tri veçori, që e vënë atë në kundërshtim të papajtueshëm me leninizmin...

E para. Trockizmi është teoria e revolucio-

nit «permanent» (të pandërprerë). Po ç'është revolucioni permanent në kuptimin e tij trockist? Ky është një revolucion që nuk e llogarit fshatarësinë e varfër si një forcë revolucionare. Revolucioni «permanent» i Trockit, është siç thotë Lenini një «kapërcim» përmbi lëvizjen fshatare, një «lodër me marrjen e pushtetit»...

E dyta. Trockizmi është mosbesimi në parimet e Partisë Bolshevike, në unitetin e saj monolit, në qëndrimin e saj armiqësor kundrejt elementëve oportunistë. Trockizmi në fushën organizative është teoria e bashkëjetesës së revolucionarëve dhe të oportunistëve, të grupeve të tyre të mëdha dhe të vogla në gjirin e një partie të vetme...

E treta. Trockizmi është mosbesimi kundrejt krerëve të bolshevizmit, orvatja për diskreditimin e tyre, për uljen e meritave të tyre. Unë nuk di asnjë rrymë në parti, e cila të mund të krahasohet me trockizmin në çështjen e diskreditimit të krerëve të leninizmit»¹.

Stalini vazhdon:

«Trockizmi i ri nuk merr guximin të dalë kundër leninizmit si një forcë luftarake, ai preferon të manevrojë nën flamurin e përbashkët të leninizmit, duke u paraqitur nën parullën e interpretimit, e përmirësimit të leninizmit. Kjo ngjan sepse ai është i dobët. Nuk duhet konsi-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 361-363.

deruar si një gjë e rastit fakti që dalja në skenë e trockizmit të ri, koincidoi me çastin e vdekjes së Leninit. Po të ishte gjallë Lenini ai nuk do të guxonte të bënte një hap kaq të rrezikshëm»¹.

«Ku qëndron rreziku i trockizmit të ri? Në faktin që trockizmi nga e gjithë brendia e tij i ka të gjitha shanset për t'u bërë qendra e grumbullimit të elementëve joproletarë, që përpiqen të dobësojnë dhe të shkatërrojnë diktaturën e proletariatit»².

Trockistët luftojnë për likuidimin e partisë leniniste-staliniane, për shndërrimin e saj në një organ policor, që t'i shërbejë aparatit të sigurimit të shtetit, i cili merr formën kryesore drejtuese dhe sunduese për vendin. Pra për trockistët, sigurimi i shtetit luan rolin e «pararojës», sikundër e ka cilësuar Koçi Xoxe, dhe ka në program shndërrimin e një shteti demokratik popullor, në një shtet policor dhe antidemokratik, ku ligji zëvendësohet me provokacionin, terrorin, kërbagjin dhe plumbin.

Për t'ja arritur këtij qëllimi trockistët në të njëjtën kohë fillojnë sabotazhe në shtet me gjithfarë mënyrash: sabotazhe direkte në punime, konfuzion dhe anarki në organizimin e aparateve të shtetit, mbjellje e disfatizmit në kuadrot, demoralizim dhe goditje kuadrosh, krijimi i një psikoze lufte, pasigurie, represalje. Njëkohësisht trockistët godasin vijën e partisë në gjithë drejti-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 365.

² Po aty, f. 369.

met dhe në radhë të parë, bazën e kësaj vije, marksizëm-leninizmin. Në bazë të punës së tyre trockistët kanë edhe antisovjetizmin e tërbuar. Të godasësh Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin, është gjithshka për trockistët, sepse Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevike dhe shoku Stalin, janë shembull dhe mbështetje për të gjitha partitë komuniste në botë, për kampin e socializmit dhe për gjithë popujt përparimtarë të botës. Pra, gjithë puna e trockistëve synon në këtë pikë kundër Bashkimit Sovjetik. Këtë punë trockistët e kryejnë duke përdorur taktika të ndryshme, nën parullat e përgjithshme të marksizëm-leninizmit dhe pasi përgatitin terrenin ata dalin me parulla të hapëta antisovjetike, ashtu si treguam më lart. Parullat antisovjetike fillojnë t'i përdorin në ato momente, që ata i gjejnë të volitshme dhe të çastit. Ashpërsimi i luftës së partisë komuniste i bën trockistët të ashpërsojnë edhe ata luftën e tyre dhe të dalin me fytyrën e vërtetë të armikut. Për trockistët tri kala janë të rëndësishme, që ata përpiqen t'i thyejnë dhe t'i marrin: partinë, sigurimin dhe ushtrinë. Në të gjithë sektorët e tjerë ata sabotojnë, demoralizojnë, shtrëmbërojnë, përgatitin fushën për degjenerimin e Republikës Popullore.

Kalaja e parë dhe më e rëndësishme është partia. Po të kenë mposhtur partinë, çdo gjë mbaroi, sukcesi i tyre është i plotë, regjimi policor, regjimi i kapitalit u vendos.

Puna personale është karakteristikë e trockistëve. Të jesh një udhëheqës nga më kryesorët dhe të bësh, të organizosh dhe të kesh në gjak punën personale, kjo do të thotë t'i hipësh partisë në kurriz dhe të shndërro-

hesh në një diktator të urryer. Të bësh një punë personale ka një qëllim të keq, qoftë edhe prej një njeriu të thjeshtë; të bësh një punë personale do të thotë të vësh veten tënde në qendër dhe të tjerët të punojnë dhe të të binden, të tjerët të përmbushin nevojat e tua, të përkëdhelin ambicien tënde, të të fryjnë megalomaninë dhe të presin në kurriz kërbacën tënd.

Një punë e tillë personale e transportuar në planin e një udhëheqësi nga më kryesorët të partisë, do të thotë ta nënshtrosh partinë komuniste nën vullnetin e një njeriu, t'i mohosh rolin avangardë të partisë, rolin drejtues të saj, të shkelësh parimet e partisë, të shkelësh marksizëm-leninizmin.

Ai që ka në gjak punën personale, ai është njëkohësisht dhe ambicioz i madh dhe një megaloman. Thjeshtësia qëndron shumë larg nga ky njeri.

Si vepruan në Shqipëri dhe në Partinë tonë trockistët jugosllavë? Ata vepruan si thashë më lart dhe Koçi Xoxe e ndihmësi i tij Pandi Kristo ishin solidarë me ta dhe punuan në këtë rrugë.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, dy herë rresht goditën vijën e drejtë të Partisë, goditën udhëheqjen dhe unitetin e Komitetit Qendror, goditën Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, goditën gjithë shokët e tjerë të Byrosë Politike që mbronin vijën e drejtë të Partisë. Një punë e tillë vazhdoi për katër vjet rresht.

Në Kongresin XVIII të Partisë Bolshevike shoku Zhdanov ka thënë:

«Elementët armiq e kanë praktikuar shumë vënjen e disiplinës zyrtare përmbi disiplinën e Partisë, duke de-

moralizuar kështu punëtorët e ndershëm... Në Plenumin e Komitetit Qendror në shkurt-mars 1937 dhe në Plenumin e janarit 1938, Partia dënoi qëndrimin formal dhe burokratik të pashpirt kundrejt fatit të anëtarëve të Partisë në çështjen e përjashtimit nga Partia dhe të rehabilitimit në Parti. Sikundërqë e dimë, kjo është një taktikë pune që u përdor gjerësisht prej elementëve karrieristë, të cilët çanë rrugën e tyre në Parti dhe u përpoqën të dallohen dhe të avancojnë, duke përjashtuar njerëzit nga radhët e Partisë, sikundërqë u përdor gjerësisht dhe nga armiqtë e maskuar në Parti, të cilët u përpoqën me anën e dënimeve të shumta të shkatërrojnë anëtarët e ndershëm të Partisë dhe të mbjellin dyshimin e panevojshëm në radhët e Partisë. Duke ndryshuar taktikën e tij, armiku u kap pas vigjilencës dhe e përdori me mjeshtëri, duke vepruar nën maskën e shprehjeve hipokrite mbi vigjilencën për të shkatërruar sa më shumë komunistë të ndershëm që të ishte e mundur me qëllim që të futej dyshimi reciprok dhe dizorganizimi në radhët tona.

Të shpifurit kundër elementëve të ndershëm, nën flamurin e «vigjilencës» është në kohën e tashme metoda më e praktikuar për të maskuar dhe mbuluar veprimtarinë armike. Në qoftë se dëshiron të zbulosh çerdhet e fshehta të armikut, shiko se do t'i gjesh pranë shpifjeve».

Të tilla shpifje dhe akuza u bënë në Berat dhe në Plenumin VIII prej trockistëve jugosllavë dhe Koçi Xoxës e Pandi Kristos.

Byroja Politike e KQ të Partisë sonë ka humbur

një kohë të paçmueshme prej 5 muajsh për të bërë analizën, derisa arriti në Plenumin XI dhe kjo humbje e madhe kohe për Partinë i detyrohet Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos. Në Plenumin XI, Komiteti Qendror caktoi masat që duheshin marrë ndaj këtyre shokëve dhe këto masa kishin një karakter edukativ. Gjëja e parë ishte që këta të dy të njihnin ndershmërisht gabimet dhe fajet e tyre të rënda dhe të bënin autokritikë bolshevike dhe e dyta, të hiqeshin nga ato funksione, ku kishin gabuar. Komiteti Qendror e kishte për detyrë të mos i flakte këta njerëz në rrugë, në rast se i njihnin ndershmërisht gabimet dhe fajet e rënda të tyre, por t'i ndihmonte, t'u jepte dorën dhe t'i tërhiqte nga buza e honit. Qëllimi ishte të ndihmohej Partia duke u zbuluar gabimet dhe njëkohësisht të shpëtoheshin këta për Partinë. Komiteti Qendror peshoi gabimet dhe fajet e tyre të rënda, po edhe armiqtësinë e madhe të trockistëve jugosllavë. Duhet t'i shpëtojmë njerëzit, t'i ndihmojmë kuadrot, po kjo ndihmë ka një kufi — na mëson shoku Stalin. Po fakti është se në të gjitha konferencat e Partisë, ku është punuar Rezolucioni i Plenumit XI, dualën shumë gjëra të tjera që Koçi Xoxe ja kishte fshehur Partisë. Masat e Partisë i gjykuan punët me objektivitet të madh dhe këto gjëra të reja ju shtuan analizës dhe Rezolucionit të Plenumit XI. Ndërkaq Partia nuk i gjeti aq të rënda masat e Komitetit Qendror dhe ajo kishte të drejtë.

Si u muarën masat e Plenumit XI.

Pas analizës së gjerë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk bënë një autokritikë në lartësinë e një udhëheqësi, megjithatë ata u shfaqën «pa rezerva solidarë» në puni-

met dhe vendimet e Plenumit XI. Pas këtyre deklaratave Komiteti Qendror rifilloi përsëri kritikën ndaj tyre, kundër autokritikës së tyre. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo i dhanë të drejtë Komitetit Qendror, pranuan disa gjëra dhe i premtuan Komitetit Qendror se i realizojnë gjithë fajet e tyre dhe, përpara Partisë, përpara masave të gjera të Partisë, ata do të delnin me një autokritikë të hapët, krejt të hapët. Po këto deklarata përpara Plenumit XI nga ana e këtyre të dyve nuk ishin të shëndosha, se autokritika e tyre përpara Partisë ka qenë dredharake dhe ka shkuar duke u zbrapsur dhe dobësuar. Pas aktivitetit të parë në Tiranë, ku hapët i është bërë përsëri kritikë Koçi Xoxes nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe është këshilluar përsëri që të thellohet në fajet e tija, Koçi Xoxe pranoi dhe premtoi se do të thellohej. Në aktivitetin e Korçës, aktiv shumë i shëndoshë dhe që u tregua në lartësinë e duhur, përpara kësaj çështjeje të madhe, para objektivitetit dhe mprehtësisë komuniste të organizatës së Partisë të Korçës, Koçi Xoxe u rezervua edhe ca më tepër në autokritikën e tij. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk e dëgjuan zërin e fuqishëm dhe të drejtë të Partisë dhe, në vend që të ecnin përpara, ata shkuan në rrugën e kundërt. Natyrisht këtu u krijuan situata të reja, të ndryshme nga ato, ku Komiteti Qendror mori vendime për ato masa, ndër ato rrethana, përpara atyre fakteve dhe me ato qëllime që tregova më lart. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo qëllimet e larta edukative të Komitetit Qendror i muarën si një dobësi nga ana e Komitetit Qendror dhe jo si një ndihmë e vërtetë që u jepej atyre. Me këto pikëpamje ata kujtuan se kjo çështje kaq e madhe do të kalonte lehtë

në Parti. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo qëndronin kurdoherë në pikëpamjet e gabuara të vjetra se gjoja Partia nuk do të zbulonte gjërat e tjera dhe do t'i pranonte pa diskutim vendimet në lidhje me masat që kishte marrë Komiteti Qendror ndaj tyre. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo qëndronin në pozitë të vjetra të konsiderimit të Partisë jo si një organizatë vetëvepruese, po si një detashment partizan. Këta të dy janë larg nga të kuptuarit si duhet të letrave historike të Partisë Bolshevike. Kështu që duke pasur këto pikëpamje kundrejt Partisë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo në vend që të bënin përparime në autokritikën e tyre, ata bënë shumë hapa prapa. Pas zhvillimit të aktiveve të Partisë, pas gjërave të tjera që ju shtuan fajëve të këtyre të dyve dhe pas qëndrimit të tyre shumë negativ, Komiteti Qendror nuk mund të qëndrojë më në pozitë të Plenumit XI, në lidhje me masat e marrura ndaj këtyre të dyve. Kjo situatë e krijuar lyp masa të tjera më të rënda, sepse më të rënda po bëhen fajet e tyre. Mendimi i udhëheqjes është që këta të dy duhet të përjashtohen nga Komiteti Qendror dhe Komiteti Qendror ja le të drejtën organit më të lartë të Partisë, Kongresit I të saj, të marrë të gjitha masat ndaj këtyre të dyve dhe shokëve të tjerë që e gjen të arësyeshme, në lidhje me fajet e rënda që janë vërtetuar.

Megjithatë, Komiteti Qendror u kujton Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, etj., të dëgjojnë zërin e fuqishëm dhe të drejtë të Partisë që do të dalë nga ky kongres dhe të kthehen me urgjencë në rrugën e drejtë të Partisë, sepse për ata njerëz që kthehen në rrugën e shëndoshë të Partisë, Partia i merr nga krahu dhe i ndihmon me të gj-

tha forcat që të shërohen, që të ngjallen dhe të hyjnë përsëri si njerëz të rinj në gjirin e fuqishëm të Partisë dhe të bëhen luftëtarë të mirë për qëllimet e larta të saj. E tillë është Partia jonë Komuniste.

PARTIA DHE ORGANIZATAT E GJERA TË MASAVE

A. Mobilizimi i masave dhe Fronti Demokratik. — Pas çlirimit Partia jonë konkretizoi problemet e mëdha të rindërtimit që i delnin përpara vendit tonë, konkretizoi detyrat sociale dhe kulturele. Për zbatimin e kësaj vije Partia, si kurdoherë, u bëri thirrje masave të popullit, punëtorëve, fshatarëve, rinisë sonë heroike dhe grave të Shqipërisë që të vënë të gjitha forcat e tyre për ngritjen e Shqipërisë së re. Partia i foli popullit ashtu si ishte e vërteta, i tha se vështirësitë ishin të mëdha, i tha se kërkohej punë, vullnet dhe sakrifica, ashtu si gjatë luftës, i tha se kjo është një rrugë e gjatë dhe e vështirë dhe se gjatë rrugës do të ndeshemi me armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, që do të mundohen të na pengojnë në punën tonë. Partia jonë i bëri thirrje popullit që në punën për rindërtimin e Shqipërisë së re duhej të ishin të organizuar, ashtu si ishin të organizuar përballë armikut në Frontin Demokratik. Ashtu sikundër populli u grumbullua pas thirrjes së Partisë në Frontin Nacional-Çlirimtar, të udhëhequr nga Partia jonë, për të çliruar atdheun, ashtu edhe për rindërtimin e Shqipërisë shtresat e gjera të popullit punonjës duhej të grumbulloheshin dhe të organizoheshin në Front, me në krye klasën punëtoare dhe nën udhëheqjen e Partisë

Komuniste. Si dje në luftë edhe sot në paqe, ekzistenca e Frontit Demokratik që grumbullon punëtorinë dhe shtresat e gjera të fshatarësisë së varfër dhe të mesme, shtresat gjysmëproletare dhe borgjezinë e vogël, e ndihmon klasën punëtore dhe avangardën e saj, të përmbushë rolin drejtues, të zgjerojë influencën e vet në masat e gjera të popullit dhe t'i tërheqë në rrugën e saj. «Nga ana tjetër kjo bën të nevojshme një luftë të vazhdueshme kundër hezitimeve borgjeze të vogla dhe kundër qëllimeve të reaksionit. Vënja në zbatim e vendimeve të Frontit Demokratik kërkon ndjekjen me këmbëngulje të një lufte të re, të cilën të gjithë anëtarët e Frontit nuk janë në gjendje ta bëjnë njësoj». Në këtë drejtim Partia jonë Komuniste nuk harron se mbështetje kryesore e saj janë organizata e Frontit Demokratik dhe sindikatat, të cilat janë të zonjat ta mbrojnë politikën e saj më me konsekuencë dhe ta realizojnë më plotësisht e drejtëpërdrejtë në lidhje me klasën punëtore dhe me ndërmjetësinë e kësaj, në pjesën tjetër të masave punonjëse. Kësaj thirrjeje të Partisë i janë përgjegjur njëzëri të gjitha masat punonjëse të vendit tonë me në krye klasën punëtore.

B. Klasa punëtore dhe sindikatat në vendin tonë. — Partia jonë që në ditën e themelimit të saj, i kushtoi një kujdes të veçantë klasës punëtore, sepse ajo është klasa më revolucionare dhe te ajo do të jetë mbështetja kryesore e Partisë. Nën regjimin feudal të Zogut, ku mbretëronin format e feudalizmit dhe mungonte gati krejt industria e lehtë, klasa punëtore e vendit tonë ishte shumë e vogël dhe heterogjene. Me koncesionet që Zogu i dha Italisë dhe me shfrytëzimin e naftës, të

bakrit e të kromit, filluan të hidhen bazat e një proletariati shumë të kufizuar. Ky përbëhej nga fshatarë të varfër që, duke vdekur nga uria në fshat, vinin e punonin në kantiere e në rrugë, në kondita të mjerueshme e shfrytëzimi deri në palcë nga ana e okupatorit dhe e sipërmarrësve gjakpirës. Klasa punëtore e vogël, me të gjitha karakteristikat e fshatarit të varfër, me thirrjen e Partisë u çua më këmbë, u grumbullua rreth Partisë së saj dhe u hodh pa rezerva në luftë për të fituar lirinë dhe të drejtat e saja. Klasa jonë punëtore e shtypur dhe e shfrytëzuar nga regjimi i Zogut, përveç mjerimit të madh, në të cilin ajo jetonte, nuk mundi të krijonte një organizim të shëndoshë dhe një koordinim luftime kundër klasës shfrytëzuese të borgjezisë. Sikundërqë i pamë më lart, organizimet e para u dukën në Korçë, me shoqërinë «Puna»; disa tentativa të tjera të vogla organizimi u dukën në Tiranë si dhe greva në Kuçovë. Përpyekjet e grupeve komuniste ishin larg një organizimi të punëtorisë sonë dhe vetëm Partia jonë, nëpërmjet luftërash të përgjakshme, do të grumbullonte punëtorinë shqiptare në gjirin e saj dhe do ta edukonte e çelnikoste në luftë. Partia jonë do t'ja bënte të qartë rolin revolucionar të saj dhe rolin e pararojës nën drejtimin e së cilës do të mobilizoheshin të gjitha masat e popullit tonë për Luftën nacional-çlirimtare. Pas çlirimit të Shqipërisë dhe fitores së plotë të pushtetit tonë popullor u hodhën bazat e organizimit të klasës punëtore në sindikata, të cilat u bënë organizata masash të punëtorëve, që do të luanin një rol të madh drejtues në shtetin tonë të ri. Partia, duke çmuar si duhet rolin e sindikatave, organizata të klasës punëtore, organizoi më 28 te-

tor 1945 Kongresin I të sindikatave. Ky kongres që në atë kohë përfaqësonte 25 000 punëtorë dhe nëpunës, caktoi detyrat e organizatave sindikale, vijën politike dhe organizative, që ato duhej të ndiqnin në punën e tyre të rëndësishme. Për herë të parë në vendin tonë u krijuan organizatat sindikale dhe u ngritën mbi parime të prodhimit dhe të territorit. Politika ekonomike e drejtë dhe vendimtare e Partisë sonë, që bëri menjëherë shtetëzimin dhe nacionalizimin e minierave dhe më vonë të të gjithë industrisë së lehtë që ekzistonte në vendin tonë, krijoi konditat për rritjen e klasës punëtore, e cila mori drejtimin e ekonomisë së vendit tonë. Kjo bëri gjithashtu të mundur shtrirjen dhe zgjerimin e organizatave sindikale. Sot në organizatat sindikale të vendit tonë janë grumbulluar gati 57 500 punëtorë dhe nëpunës të organizuar në 601 degë sindikale, 64 sindikata lokale dhe 26 sindikata rrethesh. Klasa jonë punëtore, sado që është akoma në numër të vogël, po me një bërthamë shumë të shëndoshë dhe me perspektiva, siç janë punëtorët e Kuçovës, të Minierës së Rubikut, të minierës së serës, të naftës së Patosit dhe të qymyrit, është e ndërgjegjshme për rolin e saj historik. E grumbulluar në sindikata ajo përbën forcën e madhe të avangardës së saj, Partisë Komuniste të Shqipërisë, së cilës i bie roli historik të ndërtojë socializmin në vendin tonë. Organizatat sindikale në vendin tonë, që në ditët e para të organizimit të tyre, i vunë vetes për detyrë kryesore edukimin dhe mobilizimin e punëtorëve dhe të gjitha masave punonjëse të popullit në vijën e Partisë. Sindikatat, duke qëndruar kurdoherë në organizata që mbrojnë interesat materiale dhe kulturele të punëtorëve, kuptuan

më së miri rolin e tyre në jetën shoqërore dhe shtetërore të Republikës sonë Popullore, d.m.th. edukimin e masave të popullit punonjës për të qenë besnike deri në fund të regjimit popullor dhe të socializmit. Lenini ka thënë se sindikatat sovjetike

«...janë shkollë, shkollë drejtimi, shkollë administrimi, shkollë e komunizmit»¹.

Puna heroike dhe plot vetëmohim e punëtorëve tanë, për të ndërtuar ato që na shkatërruan okupatorët dhe tradhëtarët dhe për të zbatuar me përpikmëri direktivat e Partisë, është dëshmia më e mirë e rolit të klasës punëtoare, të sindikatave. Ne të gjithë e dimë sa i varfër ishte vendi ynë në teknikë dhe specialistë dhe si u gjendëm ne pas çlirimit me industrinë dhe minierat tona. Po ne dimë gjithashtu se sa të mëdha ishin përpjekjet e klasës sonë punëtoare për t'i ndërtuar këto dhe për të marrë vetë drejtimin në duart e tyre. Sa e ashpër ishte lufta e punëtorëve tanë kundër sabotatorëve armiq dhe veglave të të huajve, që përpiqeshin të shkatërronin për së dyti ato që i rindërtuam me kaq mundime. Punëtorët tanë, kudo që ishin, me vigjilencën më të madhe, i mbrojtën maqinat e tyre, rafineritë e tyre dhe sot ne kemi një numër të madh specialistësh që më parë ishin punëtorë të thjeshtë. Punëtorët e vendit tonë mësuan nga Partia ta konsolidojnë industrinë nacionale, ta shtojnë dhe ta përmirësojnë prodhimin dita-ditës, se vetëm kështu ndërtohet socializmi në vendin tonë dhe

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 2.

janë organizuar klube dhe rrethe artistike, ku aktivizohen 4 415 anëtarë dhe rreth 100 kënde të kuq, ku ushtrohet aktivitet kultural e artistik. Ekzistojnë 176 grupe artistike që kanë dhënë brenda vitit rreth 400 shfaqje, 746 grupe leximi, etj. Shtypi është zhvilluar, kinemaja gjithashtu. Janë hapur kurse qendrore për kuadro sindikale, etj.

Partia jonë, që udhëheq Frontin Demokratik, mbështetjen kryesore e ka në këtë organizatë të masave të gjera të popullit dhe në organizatën e sindikatave. Prandaj detyra e Partisë në punën me sindikatat është shumë e madhe. Partia duhet të zhvillojë në gjirin e sindikatave përpjekje të mëdha për demokratizimin e tyre, ku të zhvillohet kritika dhe autokritika në baza të shëndosha marksiste-leniniste. Klasa punëtore dhe masat punonjëse të vendit tonë të edukohen në shembullin dhe në frymën e avangardës së tyre. Një zhvillim i tillë i kritikës së hapët dhe të drejtë nga ana e klasës punëtore do të zbulojë çdo të metë, do të zbulojë armikun, që mund të jetë i infiltruar për të dëmtuar ndërtimin e socializmit. Partia në sindikata, me anë të anëtarëve të saj, duhet të farkëtojë njerëzit me një vullnet të hekurt në punë dhe me një vigjilencë revolucionare për ruajtjen e punës dhe të djersës së popullit, t'i edukojë masat e sindikuara, t'i zbulojë sabotatorët, armiqtë, spiunët dhe t'i luftojë pa mëshirë. Anëtarët e Partisë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të ngritur ideologjikisht dhe politikisht masat e gjera të sindikuara, të shtojnë emulacionin e tyre në punë, disiplinën, produktivitetin, të edukojnë klasën punëtore të forcojë aleancën me fshatarësinë e varfër dhe të mesme dhe me pu-

nën e tyre, me shtimin e prodhimit industrial t'i vijë në ndihmë fshatit për të modernizuar bujqësinë tonë dhe për ta çuar në rrugën e socializmit. I tillë duhet të jetë kujdesi i Partisë sonë për klasën punëtore dhe për sindikatat në perspektivën e zhvillimit të industrisë në vendin tonë. Partia, në radhë të parë, duhet t'i kushtojë kujdes zgjerimit dhe forcimit të klasës punëtore, ngritjes së saj ideologjike, politike dhe kulturele, pajisjes së saj me një kulturë të shëndoshë marksiste-leniniste dhe të përgjithshme, ta edukojë atë me teknikën moderne, ose vetëm në këtë mënyrë, duke pasur bazën kryesore të saj të fortë, Partia jonë do të forcohet.

C. Roli i Rinisë Popullore dhe organizata e saj. — Në lëvizjen e gjerë të masave roli i rinisë sonë heroike është i madh dhe i rëndësishëm. Në kohën e luftës rinia ju përgjegj thirrjes së Partisë dhe ishte në radhët e para të luftës duke i dhënë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe popullit me mijëra e me mijëra partizanë e dëshmorë nga më heroikët. Kontributi i rinisë gjatë luftës ka qenë nga të dorës së parë dhe vendimtar për sukseset tona në punën politike me masat, për zgjerimin e luftës së armatosur. Ajo, e organizuar në Rininë Komuniste dhe në Rininë Antifashiste, ka qenë rezerva dhe ndihmësja më e madhe e Partisë për luftën dhe për edukimin e masave të rinisë dhe të popullit në rrugën e Partisë. Rinia jonë mundi ta luajë këtë rol të rëndësishëm gjatë luftës, pse Partia që në fillim i kushtoi një kujdes të veçantë dhe zbuloi te kjo forca të mëdha revolucionare, të cilat nën drejtimin e Partisë do të jepnin kaq rezultate të mëdha, që i dinë të gjithë. Pra është kujdesi dhe drejtimi i Partisë që i organizoi forcat e rinisë dhe

u hapi rrugën këtyre për vepra të mëdha, si ato të luftës dhe të pasluftës. Dhe gjithnjë nën drejtimin e Partisë, organizata e Rinisë Popullore do të kryejë me nder detyrat e saja për edukimin e brezit të ri në frymën e socializmit, duke e furnizuar Partinë dhe shtetin me rezerva të reja, të përgatitura dhe besnike të popullit. Pas çlirimit roli i rinisë vazhdon të jetë kurdoherë i madh. Tani rininë heroike e shikojmë në ballë të punës për rindërtimin e vendit. Për të kryer punimet që ishin vënë në plan për vitin 1946, për të zbatuar drejt parullën e hedhur nga Partia se «Shqipëria e Veriut nuk do të ishte më e jezuitëve dhe e bajraktarëve, që kishin shfrytëzuar popullin e këtyre vendeve, po atje pushteti ynë popullor do të çonte dritën e përparimit», në qershor të atij viti, filluan punimet për ndërtimin e rrugës Peshkopi-Bicaj. Rinia jonë ju përgjegj thirrjes së Partisë dhe më tepër se 4 000 të rinj e mbaruan me sukses detyrën e tyre. Ky aksion i madh dhe punime të tjera të kryera nga rinia gjatë vitit 1946, e bënë rininë tonë shembull vetëmohimi dhe heroizmi si në kohën e luftës. Rinia kuptoi drejt se me këto aksione dhe me këto punime lidhej dhe edukimi i saj, prandaj ajo u dha këtyre një rëndësi të madhe dhe tregoi kujdes të veçantë për edukimin dhe ngritjen e nivelit kultural dhe teknik të masave të rinisë. Rinia me një punë të gjerë dhe të drejtë e ndihmon pushtetin si në shkollë, në ara dhe në fabrika. Ajo di ta lidhë mirë punën e saj me problemet e shtetit. Partia dhe shteti me besim të madh të rinia i ngarkoi kësaj përsëri ndërtimin e hekurudhës Durrës-Peqin dhe për 8 muaj rresht 30 230 të rinj punuan me heroizëm të papërshkruar për ndërtimin e

Shqipërisë së re, për jetën e tyre të lumtur. Po kështu edhe sivjet 24 000 të rinj dhe të reja kanë punuar deri tani për ndërtimin e hekurudhës tjetër Durrës-Tiranë. Të gjitha këto tregojnë forcën e madhe të rinisë sonë, vullnetin e çelniktë të saj dhe zotësinë e saj në organizimin e punës nën drejtimin e Partisë. Partia dhe shteti duhet t'i kushtojnë kujdesin më të madh rritjes së brezit të ri të vendit tonë, ta pajisin atë me kulturën marksiste-leniniste. Për këtë gjë t'u vihet kujdes i veçantë shkollave profesionale në radhë të parë si dhe të tjerave dhe të dërgojnë në to djemtë e vajzat e punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër e të mesëm, për t'i edukuar me teknikën moderne dhe të krijohet kështu inteligjencia e klasës. Të kujdesen gjithashtu për shëndetin e rinisë sonë, për nevojat e saja, për dëfrimin e saj. Asgjë të mos kursehet për edukimin e gjithanshëm të brezit tonë të ri dhe ta bëjmë atë mbrojtësen e çelniktë të atdheut, ta bëjmë atë ta dojë popullin dhe atdheun, ta dojë Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin me të gjitha forcat e saja.

Partia, sikundërqë shprehet dhe në statutin e saj, duhet të ketë nën drejtimin dhe kujdesin e vet organizatën e Rinisë Popullore. Në situatat e sotme lypset që asnjë formë organizative të mos e pengojë mobilizimin e masave të gjera të rinisë në gjirin e organizatës së Rinisë Popullore dhe të mos ekzistojë ndërmjetës në mes të Partisë dhe organizatës së Rinisë Popullore. Dhe që puna të shkojë mbarë në këtë drejtim, që organizata e Rinisë Popullore të zgjerohet dhe të forcohet njëkohësisht, është e domosdoshme shkrirja e Rinisë Komuniste dhe e Rinisë Popullore në një organizatë të

vetme, në organizatën e Rinisë Popullore. Kjo shkrirje do ta forcojë dhe do ta zgjerojë organizatën e Rinisë sonë Popullore.

Ç. Lëvizja e gruas dhe organizata e saj. — Një vend me rëndësi zë gruaja dhe një rol të madh luan ajo në vendin tonë. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe pas çlirimit në jetën politike, ekonomike e shoqërore të vendit tonë kemi parë të rritet roli i grave shqiptare, të cilat, deri atëhere të shtypura, u thirrën dhe u udhëhoqën nga Partia jonë, duke zënë vendin që meritonin në Shqipërinë tonë të përparuar. Partia jonë, e udhëhequr nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, e çmoi si duhet forcën e gruas, e ndihmoi gruan të kapërcente gjithë pengesat në rrugën e saj. Gruaja doli nga gjendja e saj e mjeruar dhe e përçmuar dhe zuri vendin e merituar në Shqipërinë e re, nëpërmjet rrugës së luftës për çlirimin e atdheut e të popullit si dhe për çlirimin e saj. Me një vendosmëri të pashembullt gruaja shqiptare ka ecur në rrugën e Partisë dhe ka arritur rezultate të mëdha. Ajo mori pjesë gjallërisht me armë në dorë në revolucionin popullor. Gratë forcuan radhët e ushtrisë, ato u bënë shoqe lufte të burrave, të vëllezërve dhe të bijve të tyre. Afro 6 000 partizane luftuan nëpër male. Shumë gra ranë në fushën e nderit. Me qindra e mijëra gra luftuan në prapavija të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për forcimin e bashkimit në luftë, për të ndihmuar ushtrinë popullore, për të ndihmuar luftën e guerrileve dhe të ilegalëve në qytete.

Me një dashuri të thellë u lidh gruaja me Partinë në ditët më të vështira të luftës dhe sot gratë e Shqipërisë po e rrisin dhe po e forcojnë gjithnjë e më tepër

këtë dashuri dhe lidhje me Partinë, që i çliroi dhe i udhëheq drejt një jete të re.

Nën udhëheqjen e Partisë roli i grave të vendit tonë pas çlirimit po ngrihet gjithmonë më tepër dhe në të gjitha drejtimet. Ato ruajnë me vigjilencën më të madhe, me atë vigjilencë të shquar të nënës, fitoret e pushtetit popullor. Mbi 1100 gra janë zgjedhur në këshillat popullore të lokaliteteve dhe të rretheve. Ndërsa më parë gratë në industri nuk përfaqësonin as disa dhjetëra, sot ka mbi 600 punëtore. Para çlirimit kishte vetëm 668 gra në marrëdhënje pune, kurse sot në aparatit shtetëror e kooperativist ka 7 570; në kooperativat bujqësore ka 990 gra anëtare dhe në ato të artizanatit 709 gra. Gratë fshatare, që marrin pjesë gjerësisht në punët bujqësore, përbëjnë një forcë të madhe dhe të gjallë për ndërtimin e Shqipërisë së re. Fakti që gjatë vitit 1947 — 1948, 113 708 gra kanë punuar kolektivisht, shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin e ndërgjegjes së kolektivizimit. Gratë, të mobilizuara nga organizata e tyre (Bashkimi i Grave të Shqipërisë), janë anëtare aktive në aksionet e punës vullnetare të Frontit. Që pas çlirimit e deri më sot më shumë se gjysmë milioni gra kanë bërë mbi 6 000 000 orë punë vullnetare.

Bashkimi i grave të Shqipërisë, që grumbullon rreth 246 000 gra, luan një rol të rëndësishëm të aktivizimit të grave dhe në ngritjen e tyre politike e kulturele. Gruaja shqiptare dhe organizata e saj, nën udhëheqjen e Partisë bëjnë një luftë të vazhdueshme për zhdukjen e plagëve shoqërore në vendin tonë, që kanë mbetur si trashëgim i sundimit feudal dhe i regjimeve anti-popullore.

Pas çlirimit mbi 51 000 gra kanë mësuar të shkruajnë dhe të këndojnë. Në tre vjetët e fundit janë organizuar mbi 7 400 konferenca kulturele që janë dëgjuar nga 159 000 gra; janë organizuar 14 564 konferenca mbi higjienën, nënën e fëmijën që janë dëgjuar nga 317 335 gra. Konferenca të tjera, kurse, grupe leximi, etj., organizohen nga Bashkimi i Grave të Shqipërisë, që ndihmojnë shumë në shkëputjen e gruas nga e kaluara.

Po Partia duhet të ketë parasysh se, që të bëhet gruaja një rezervë e fuqishme për ndërtimin e socializmit, duhet të bëhet një punë e gjerë dhe e vazhdueshme për shkëputjen e gruas sa më parë nga prapambetja; për këtë gjë të luftohet në radhë të parë analfabetizmi dhe shfaqjet e ndryshme të fanatizmit. Kujdesi i madh për fëmijët, që është një nga problemet më të rëndësishme të vendit, organizata e gruas e ka një nga detyrat më kryesore në programin e vet. Partia dhe shteti duhet të japin gjithë ndihmën në këtë drejtim, sepse ky është një problem jetik për vendin tonë. Të shpëtohen me çdo kusht kalamanët e vendit tonë nga sëmundjet, të forcohet shëndeti i tyre, të edukohen mëmat në këtë drejtim.

Por që të shtohet fuqia e Republikës sonë Popullore dhe të shpejtohet ndërtimi i socializmit në vendin tonë, është e domosdoshme pjesëmarrja sa më e gjerë e grave në jetën politike, në lëmin e ndërtimit, të prodhimit dhe të kulturës. Partia duhet të bëjë përpjekje të mëdha në këtë drejtim; të ngrihet gruaja shqiptare dhe të ecë përpara, pse kështu do të ecë përpara vendi ynë. Partia dhe shteti t'i thyejnë gjithë pengesat që pengojnë përparimin e gruas shqiptare.

NE LIDHJE ME FRONTIN

Një nga çështjet me shumë rëndësi, që ngre Partia Bolshevike në letrat historike të saja, drejtuar KQ të PKJ, është çështja e Frontit dhe, në lidhje me të, çështja e Partisë, ku grupi trockist Tito ka dalë jashtë nga binarët e marksizmit. Në këtë çështje parimore me kaq rëndësi, Partia jonë nuk mund të thotë se nuk i ka shpëtuar influencës së Partisë Komuniste Jugosllave. Partia jonë ka marrë mjaft gjëra nga organizimi i frontit në Jugosllavi si edhe mjaft formulime të gabuara të jugosllavëve, të cilat i ka adoptuar. Kjo është e vërtetë. Këto gabime i njohu Partia jonë dhe i ndreqi dhe këtë ja detyron Partisë Bolshevike dhe Informbyrosë, që është eksperiencia e 8 partive komuniste e punëtore motra dhe që është një mbështetje e madhe për punën e Partisë sonë. Fronti në vendin tonë, i krijuar në rrethanat që shpjeguem më lart, ka qenë dhe është organizata e gjerë e masave tona, që e drejton Partia. Kaq është e vërtetë sa reaksioni ballist, «Legaliteti» dhe kuislingët, këtu i drejtonin goditjet e tyre, pse këtu, te një organizatë e tillë e masave, e drejtuar nga Partia dhe me një platformë unike lufte, ata e shihnin rrezikun e heqjes nga duart e reaksionit, fshatarësinë, pjesën më të madhe të borgjezisë së vogël të lëkundshme që mobilizohej në Front; Fronti i hiqte gjithashtu mundësinë reaksionit që t'i dezorientonte këto masa ose t'i neutralizonte. Krijimi i organizatës së «Ballit Kombëtar» kishte po këtë qëllim: të izolonte Partinë tonë Komuniste dhe të shuante rolin drejtues të saj në masat e

gjera të popullit. Në Partinë tonë, gjatë kohës së luftës, sido që rreziku ishte më i madh në atë kohë, mund të bëheshin gabime, pse masat e gjera të popullit ishin shumë të ulëta ideologjikisht e politikisht dhe, për t'i grumbulluar këto, mund të bëheshin lëshime drejt oportunitizmit duke e fshehur flamurin e Partisë në Front, por ky gabim nuk u bë. Masat e gjera të popullit tonë, shumë herë nuk e përmendnin fare emrin e Frontit, po luftonin me emrin e Partisë në gojë duke thënë shpesh: «Këtë e urdhëroi Partia», «Në kohën kur erdhi Partia në fuqi», etj. shprehje të tilla. Në këtë drejtim ne mund të themi se deri diku roli dhe organizimi i shëndoshë i Frontit ishte neglizhuar dhe kishte mbetur si organizatë mjaft e çlirët. Ndryshimi i Frontit tonë nga frontet e tjera në demokracitë popullore ishte se në Frontin tonë s'kishte parti të tjera, përveç Partisë sonë. Në Shqipëri nuk kanë ekzistuar parti të organizuara. Edhe ato parti, që kishin ekzistuar në regjimin e shkurtër të Fan Nolit, u shpartalluan nga regjimi i Zogut, i cili shtypi çdo tentativë për formimin e ndonjë partie pak a shumë demokratike. Kështu që borgjezia nuk i kishte konsoliduar pozitat e saja dhe s'kishte mundur të formonte një parti të sajën politike. Në luftë me okupatorin u formua Partia jonë dhe kjo udhëhoqi masat e popullit.

Pra, në Frontin tonë kishte elementë të ndryshëm, por si individë, që mund të themi se nuk kanë qenë dhe aq të pakontrolluar, bile në këtë drejtim mund të themi se kemi qenë edhe ca sektarë. Në Frontin tonë është bërë kurdoherë diferencimi i elementëve të dobët dhe ky, me anë të luftës, e cila ka demaskuar në çdo etapë

elementin e reaksionit. Kjo për kohën e luftës. Por, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, të influencuar nga delegati i Komitetit Qendror të PK Jugosllave në Berat, Fronti ynë i hapi dyert dhe në të hynë edhe armiq, të cilët meritonin litarin në grykë, po s'ishte vetëm kjo. Pikëpamjet oportuniste të Komitetit Qendror të PK Jugosllave, në lidhje me zgjerimin e Frontit dhe ato të Sejfulla Malëshovës, për t'i lëshuar brezin reaksionit dhe borgjezisë, u bënë shkas për lëshime nga ana e Komitetit tonë Qendror, aq sa elementë të kamufluar në Front, erdhën deri në Kuvendin Popullor. Në këto momente në Front ka qenë rreziku i krijimit të partive të tjera të borgjezisë për të rrëzuar pushtetin popullor ose për të ndarë pushtetin me Partinë tonë Komuniste. Komiteti ynë Qendror i kishte lëshuar direktivë të qartë Partisë, që Partia jonë nuk do të toleronte krijimin e partive të tjera borgjeze në Front, sepse ato nuk do të ishin veçse fole, ku do të grumbullohej reaksioni me maskë dhe pa maskë për të goditur Partinë tonë, Frontin Nac.-Çl. dhe nën parulla pseudodemokrate këto parti do të lidheshin ngushtë me imperializmin anglo-amerikan, për t'i rrëmbyer Partisë sonë pushtetin nga duart. Përpjekje të tilla të elementit reaksionar të kamufluar do të bëheshin në Front. Këta elementë reaksionarë të kamufluar, ishin rezervat e reaksionit dhe një nga kartat e tija të fundit; këta kishin mundur t'i rezistonin presionit të luftës dhe pas çlirimit ata hynë në aksion. Dhe pikërisht që prej çlirimit të Shqipërisë, nën influencën e Komitetit Qendror të PKJ, Partia jonë ka gabuar duke mbajtur veten e saj në gjysmlegalitet. Letrat e Partisë Bolshevike na e ndriçuan këtë gabim të madh.

«Shokët Tito dhe Kardel mendojnë, si duket, se me këtë dredhi të vogël, ata mund të ndryshojnë ligjet e zhvillimit historik, të mashtrojnë klasat, të mashtrojnë historinë. Po kjo do të thotë të rrosh me ëndrra dhe të gënjesh vetëveten. Derisa ekzistojnë klasa antagonistë, do të ekzistojë dhe lufta midis tyre dhe, derisa ka luftë, do të ketë dhe pasqyrim të kësaj lufte në veprimtarinë e grupeve dhe partive të ndryshme, legalisht ose ilegalisht. Lenini ka thënë se Partia është arma më e rëndësishme në duart e klasës punëtore. Detyra e udhëheqësve është ta mbajnë këtë armë në gatishmëri luftarake. Por derisa shokët jugosllavë fshehin flamurin e partisë dhe refuzojnë të vënë në dukje para popullit rolin udhëheqës të partisë, ata e dobësojnë këtë armë të klasës punëtore, ulin rolin e partisë, çarmatosin klasën punëtore. Është qesharake të mendosh që për shkak të një dredhie të vogël të shokëve jugosllavë, armiku do të heqë dorë nga lufta. Pikërisht për këtë gjë partia duhet mbajtur në gatishmëri luftarake, për luftë kundër armiqve dhe jo të vihet në gjumë, jo të fshihet flamuri i saj, jo të nanuriset ajo me mendimin që në qoftë se nuk do t'i jepet shkak, armiku do ta pushojë luftën, do të ndalojë organizimin e forcave të veta në formë legale ose ilegale»¹.

Vërtetësinë e madhe të thënjeve të Partisë Bolshevike ne mund ta ilustrojmë me shumë veprime tona në jetën e Partisë e të Frontit dhe si i kuptonim ne marrëdhënjet reciproke në mes të tyre, pas çlirimit. Ne

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

kemi pasur frikë të vinim hapët rolin e Partisë në Front, se mos frikësonim elementët reaksionarë dhe të lëkundshëm të kamufluar. Jo vetëm që fshihnim nderin e madh tonin të qenjes anëtarë të Partisë, por e gjenim oportune dhe të drejtë që disa ministra, anëtarë partie, të panjohur nga masat e gjera të Frontit si të tillë, të vazhdonin të ruanin fshehtësinë e qenjes'së tyre si anëtarë partie. Kjo bëhej që të mos i jepej qeverisë sonë ose Kuvendit Popullor fytyra e vërtetë e një qeverie komuniste ose e një Kuvendi Popullor, ku të predominonin komunistët dhe kjo bëhej për t'u dhënë gjoja të kuptonin elementëve armiq të kamufluar në Front që s'ishte nevoja të organizoheshin, qoftë legalisht, qoftë ilegalisht, sepse njerëz që s'ishin komunistë merrnin pjesë në qeveri dhe gjatë. Por, siç thotë drejt letra e Partisë Bolshevike, kjo ishte një «dredhi e vogël». Ne s'e gënjem dot elementin reaksionar brenda dhe jashtë Frontit. Këtë e tregoi puna armiqësore e disa deputetëve dhe e armiqve të tjerë të kamufluar në Front. Te ne fshiheshin zyrat e Partisë prapa zyrave të Frontit, Partia nuk i publikonte vendimet e saja, po këto i jepte nëpërmjet Frontit. Masat e gjera të popullit punonjës nuk e shihnin fytyrën e Partisë, atë fytyrë që e donin dhe që kishin luftuar me heroizëm për të. Ky ishte një gabim i rëndë dhe ne e korrigjuam.

Gabime të tjera ka bërë Partia jonë duke qëndruar në gjysmilegealitë. Mungesa e demokracisë së brendshme, mungesa e zgjedhjeve, mungesa e centralizmit demokratik, mungesa e kritikës dhe e autokritikës dhe kooptimet e shumta në Komitetin Qendror janë vërtetuar në Partinë tonë dhe këtu ka influencuar jashtëza-

konisht Partia Komuniste Jugosllave. Të gjitha këto gabime si dhe gabimi i madh organizativ antimarksist-leninist i qenjes së sekretarit të Partisë për kuadro, njëkohësisht dhe ministër i brendshëm, kanë shkaktuar vënjen e Partisë nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit. Në Partinë tonë janë vërtetuar edhe gabime të tjera organizative në politikën e kuadrove, etj., që e kanë dëmtuar rëndë Partinë tonë dhe e kanë penguar të ecë përpara. Partia jonë i pa këto gabime, i njohu ndershmërisht dhe i korrigjoi.

ÇËSHTJA E LUFTES SË KLASAVE

Partia jonë nuk është influencuar nga deviacioni i madh i Partisë Komuniste Jugosllave në çështjen e luftës së klasave. Vija e drejtë e Partisë sonë nuk është prekur dhe mësimet e Partisë së lavdishme Bolshevike janë një armë dhe një mësim i madh për Partinë tonë që të ruhet nga këto rreziqe. Në letrat e Partisë Bolshevike, drejtuar Titos me shokë, thuhet:

«Në Partinë Komuniste Jugosllave nuk ndjehet fryma e politikës së luftës së klasave. Rritja e elementëve kapitalistë në fshat, gjithashtu edhe në qytet, kryhet me hapa të mëdhenj, kurse udhëheqja e Partisë nuk merr masa që të kufizohen elementët kapitalistë. Partinë Komuniste Jugosllave e 'nanurisin me teorinë oportuniste të kalbur të integritit paqësor të elementëve kapitalistë në socializëm. të huajtur nga Bernshtajni, Folmari, Buharini».¹

¹ Letër e KQ të PK (b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 27 mars 1948. AQP.

Partia jonë s'ka bërë lëshime në këtë drejtim, përkundrazi dita-ditës ajo e ka ashpërsuar luftën e klasave si në fshat dhe në qytet, i ka goditur pa mëshirë kulakët, bejlerët, latifondistët, tregëtarët e mëdhenj, spekulatorët, fajdexhinjtë, etj. dhe nuk ka lënë, as në fshat, as në qytet që këta të ngrenë krye. Këta i kemi çarmatosur, por, në rast se Partia e dobëson këtë luftë klasash, rreziku i ringjalljes së tyre ekziston kurdoherë. Letrat e Partisë Bolshevike, na mësojnë se nuk duhet të nxjerrim një deduksion që nuk ekziston rreziku i forcimit të elementëve kapitalistë. Lenini më 1920 ka thënë:

«Derisa ne rrojmë në një vend me ekonomi të vogla fshatare, për kapitalizmin në Rusi ka një bazë ekonomike më të shëndoshë, se sa për komunizmin»¹.

«Sepse... prodhimi i vogël lind kapitalizmin dhe borgjezinë vazhdimisht, çdo ditë, çdo orë, në mënyrë spontane dhe në shkallë të gjerë»².

Partia jonë nuk duhet në asnjë moment të dehet nga sukseset e arritura, nga reformat e thella shoqërore dhe nga sukseset që ka arritur në këtë drejtim. Ajo nuk duhet ta neglizhojë luftën e klasave dhe as ta dobësojë atë. Partia jonë duhet të ketë kurdoherë përpara syve çka na mëson letra e Partisë Bolshevike që thotë:

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 595.

2 Po aty, f. 8.

«Askush nuk e mohon thellësinë dhe karakterin rrënjësor të transformimeve shoqërore që u kryen në BRSS si rezultat i Revolucionit socialist të Tetorit. Por nga ky fakt PK(b) e BS asnjëherë nuk ka nxjerrë konkluzionin mbi dobësimin e luftës së klasave në vendin tonë ose që nuk ekziston rreziku i forcimit të elementëve kapitalistë... Dihet se gjatë një kohe prej 15 vjetësh, pas Revolucionit të Tetorit nga rendi i ditës i Partisë sonë nuk u hoq çështja, në fillim, mbi masat për kufizimin e elementëve kapitalistë në fshat dhe, më pas, mbi likuidimin e kulakëve si klasa e fundit kapitaliste. Nënveftësimi i kësaj eksperience të PK(b) të BS në çështjen e sigurimit të kushteve themelore për ndërtimin e socializmit në Jugosllavi, është i mbarsur me rreziqe të mëdha politike dhe është i palejueshëm për marksistët, sepse nuk mund të ndërtohet socializmi vetëm në qytet, vetëm në industri, ai duhet ndërtuar gjithashtu në fshat, në bujqësi»¹.

Nga sa rreziqe të mëdha mund të kërcënohemi ne, komunistët shqiptarë, në rast se nuk i kemi kurdoherë parasysh këto parime të mëdha të leninizmit, pse vendi ynë është një vend bujqësor, ku mbretëron prona private e fshatit në një shkallë shumë të prapambetur dhe ku ekzistojnë në fshat mentaliteti i vjetër, injoranca, fanatizmi, etj. Ne duhet të ruhem nga rreziku që mund të gabojmë nga çështja se duke menduar se i kemi reduktuar kulakët tanë në fshat në një shkallë

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

me fshatarësinë e varfër ose të mesme, në lidhje me tokën dhe me gjendjen ekonomike të tyre, ne kemi zhdukur kulakun si kulak, si klasë e fundit kapitaliste. Duke u nisur që këtej ne mund të harrojmë të bëjmë diferencimin e klasave në fshat dhe «... fshatarësia shikohet si një e tërë e vetme dhe Partia nuk mobilizohet për kapërcimin e vështirësive që rrjedhin nga rritja e elementëve shfrytëzues në fshat»¹. Ne kulakun në fshatin tonë e gjejmë në aktivitet të madh, duke na sabotuar në të gjitha problemet e ekonomisë bujqësore si dhe në çështjet politike në fshat. Kulaku përpiqet të mbjellë moskënaqësira në fshat, të futet në pushtet nga ku mund të sundojë dhe të sabotojë, të futet në grumbullimet e fshatarëve dhe deri në kooperativat e punës, në të cilat ne duhet të bëjmë një rishikim të shumanshëm, sepse në kooperativat e punës janë vërtetuar gabime parimore e organizimi, që shtrembërojnë kuptimin e vërtetë dhe qëllimin e kooperativave në përgjithësi dhe të kooperativave të punës në veçanti. Jugosllavët, me ligjet dhe rregulloret e ndryshme që na kanë huajtur, kanë arritur të na çorientojnë në çështjet e fshatit. S'ka asnjë dyshim që gjendja ekonomike e fshatit tonë është shumë e përmirësuar, po ndërsa ne nga një anë bëjmë reformën agrare, që ishte një vepër e pavdekshme e Partisë sonë dhe kulakët i shpronësuam nga parcelat e mëdha të tokës, në anën tjetër, me ligjet e taksave, ne u lamë mundësinë kulakëve dhe një pjese të fshatarësisë së mesme, me mentalitetin kapitalist të

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

vogël, të pasurohen duke mos i detyruar asgjë shtetit. Në ligjin tonë mbi tatimin e ekonomisë bujqësore, vetëm tarifa, megjithëse e bazuar në bazë progresive, d.m.th. tatimi sipas të ardhurave, favorizonte fshatarin e pasur dhe godiste shtresat e varfëra fshatare. Me fjalë të tjera një ekonomi fshatare që do të kishte 90 000-100 000 lekë të ardhura, do të tatohej me 15 000 lekë plus 43%, kurse një ekonomi tjetër fshatare që do të kishte më tepër se 100 000 lekë të ardhura do të tatohej me 20%. Dhe çka është karakteristike e pikëpamjeve antimarksiste të udhëheqjes jugosllave, është se në ligjin e lartpërmendur, që është një ligj nga çdo pikëpamje në vijën e drejtë, ata na kanë huajtur dhe kanë bërë të depërtojë vetëm në tarifën një gabim i tillë antimarksist, që lejon pasurimin e kulakëve. Këtu dhe në format e tjera të gabuara, që përmendëm më lart, e kanë burimin vështirësitë tona ekonomike dhe çka është më e rrezikshme, mungesa e luftës së klasave në fshat gjë që do të na dëmtonte pa masë. Për të luftuar në këtë drejtim duhet të mos lëkundemi, të vëmë në baza të drejta kooperativat, të krijojmë sa më shumë nga ato të shitblerjes, të mësojmë fshatarin të çojë prodhimin në ato dhe ta largojmë nga spekulimi e tregu i zi, të godasim spekulatorët në fshat; kooperativat e punës t'i vëmë në baza të drejta dhe t'i ndihmojmë shumë, që këto të bëhen model për fshatrat rreth e rrotull. Në lidhje me çështjen e fshatarësisë, ne duhet të zbatojmë përpikërisht këshillat e paçmueshme të shokut Stalin, i cili na mëson të ecim me hapa të sigurtë e të matur, të njohim mirë konditat e fshatarit tonë e mentalitetin e tij dhe në këtë drejtim vija e Partisë sonë të mos lëkundet për

asnjë grimë nga parimet e marksizëm-leninizmit. Është një punë shumë e vështirë për Partinë tonë puna në fshat dhe kjo duhet të na bëjë më të fortë për të kapërcyer vështirësitë. Letrat e Partisë Bolshevike na mësojnë:

«Në kushtet kur në Jugosllavi nuk është bërë nacionalizimi i tokës, kur ekziston pronësia private mbi tokën dhe shitblerja e saj, kur në duart e kulakëve janë grumbulluar parcela të konsiderueshme tokash, kur përdoret puna me mëditje etj., nuk mund të edukohet Partia në frymën e shuarjes së luftës së klasave dhe të pajtimit të kontradiktave klasore, pa e çarmatosur kështu Partinë përballë vështirësive kryesore të ndërtimit të socializmit»¹.

Nga këto letra të Partisë Bolshevike ne duhet të nxjerrim mësimë për të luftuar me ashpërsinë më të madhe lëshimet ose gabimet, që mund të shfaqen. Vendi ynë është një vend bujqësor dhe fshatarësia përbën pjesën më të madhe të popullit tonë, prandaj këtu duhet të vëmë kujdesin më të madh për të ruajtur qartësinë për çështjen e rolit udhëheqës të klasës punëtore. Letrat e Partisë Bolshevike na mësojnë:

«Marksizëm-leninizmi konsideron në Evropë, duke përfshirë edhe vendet e demokracisë popullore, klasën punëtore dhe jo fshatarësinë si klasën pararojë e deri në fund revolucionare. Përsa i përket fshatarësisë, shumica

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

e saj, d.m.th. të varfërit dhe të mesmit, mund të jenë ose janë tanimë në aleancë me klasën punëtore, ndërsa roli udhëheqës në këtë aleancë i takon klasës punëtore»¹.

Këtu kanë devijuar udhëheqësit jugosllavë. Fshatarët e varfër dhe të mesëm në vendin tonë kanë besimin më të madh te Partia jonë, pse ajo u dha tokën dhe, me udhëheqjen e saj të drejtë, ua përmirësoi jash-tëzakonisht konditat e tyre ekonomike. Fshatarësia jonë e njeh rolin drejtues të Partisë dhe e do Partinë tonë. Kjo do të thotë se fshatarësia e varfër dhe e mesme e ka përqaftuar aleancën me klasën punëtore dhe e njeh rolin drejtues të kësaj të fundit. Por Partisë sonë i bie një detyrë e madhe përpara që ta forcojë dita-ditës këtë aleancë dhe kjo do të arrihet duke zbatuar me vendosmëri dhe me urtësi parimet e mëdha të marksizëm-leninizmit, duke luftuar me urtësi kundër teorive të kalbura oportuniste të integritit paqësor të elementëve kapitalistë në socializëm dhe duke mos e shikuar ndërtimin e socializmit në qytet, të shkëputur nga ndërtimi i socializmit në fshat. Për këtë gjë ajo të zhvillojë ndërgjegjen politike të masave të gjera fshatare dhe t'i aktivizojë ato për të forcuar influencën e saj në këto masa dhe të zgjerojë organizatat bazë të saj në fshat. Gjithashtu Partia jonë, me politikën e saj agrare, t'i japë një hov më të madh zhvillimit dhe shumëzimit të prodhimit në fshat, që t'i përgjigjet kështu nevojave të mbarë popullit dhe nevojave të industrisë, që është në zhvillim e sipër.

¹ Letër e KQ të PK(b) të BS, drejtuar KQ të PKJ, 4 maj 1948. AQP.

Partia duhet të mobilizohet për luftën e ashpër kundër kulakëve në fshat dhe spekulatorëve. Për këtë gjë ajo duhet të bëjë një punë të gjatë përgatitore për t'i penguar këta që të ngrenë krye. Kjo duhet të bëhet duke forcuar aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë dhe duke zhvilluar drejt kooperativat e ndryshme.

MBI NGRITJEN IDEOLOGJIKE TË PARTISË

Gjatë gjithë periudhës së luftës konditat kanë qenë të vështira dhe preokupacioni për ngritjen ideologjike të anëtarëve të Partisë ka qenë shumë i kufizuar. Vetëm në marsin e 1944-s u çel pranë Komitetit Qendror, në mal, një kurs njëmuor me 30-40 kuadro të komiteteve qarkore dhe të seksioneve politike të brigadave, me lëndë shumë të kufizuara. Pas çlirimit të Shqipërisë janë organizuar 6 kurse pranë Komitetit Qendror me një pjesëmarrje komplekse prej 741 kuadros të komiteteve qarkore, të komiteteve të rretheve, të seksioneve politike të divizioneve dhe të regjimenteve. Më vonë në vitin 1947 u krijuan 3 kurse të tjera. Kurset e vitit 1947—1948 kanë shkuar duke u organizuar më mirë, me lëndë teorike marksiste-leniniste më të zgjedhur, por megjithatë ato janë akoma në nivel të ulët. Në kurset e qarqeve dhe të rretheve kanë kaluar gjithsej 1 831 shokë, por edhe këtu organizimi i këtyre kurseve, metoda burokratike e dhënjes së mësimit dhe programet nuk kanë qenë të studjuara mirë; ato nuk kanë qenë në lartësinë e duhur dhe në to është përdorur edhe material jugosllav. Është për të vënë në dukje se Komiteti

Qendror i Partisë sonë nuk e ka marrë çështjen e edukimit marksist-leninist të kuadrove të Partisë në një studim serioz dhe të thellë dhe nuk ka dalë me vendime që ta vinin në baza më të shëndosha këtë problem kaq të rëndësishëm. Është folur vazhdimisht për nevojën e studimit, për ngritjen ideologjike të Partisë, po e vërteta është se kjo çështje kaq e rëndësishme është thelluar pak nga Komiteti Qendror. Duhet t'i jepet fund një praktike të tillë. Kuadrot e Partisë duhet të armatosen me teorinë marksiste-leniniste, të ndihmohen sa më shumë dhe, që të mund të orientohen drejt në çdo situatë dhe t'i zgjidhin më me shumë lehtësi problemet e rënda që kërkojnë zgjidhje, ato duhet ta përvetësojnë më shpejt këtë. Stalini na mëson se

«Forca e teorisë marksiste-leniniste qëndron në faktin se ajo i jep Partisë mundësi të orientohet në çfarëdo situatë, të kuptojë lidhjen e brendshme të ngjarjeve që zhvillohen rreth saj, të parashikojë rrjedhjen e ngjarjeve dhe të dallojë jo vetëm si dhe në çfarë drejtimi zhvillohen ngjarjet sot, po edhe si dhe në çfarë drejtimi duhet të zhvillohen ato në të ardhmen»¹.

Anëtarët e Partisë sonë, duke mos i vënë aq sa duhet rëndësi ngritjes kulturele të tyre në përgjithësi dhe veçanërisht, duke mos ju vënë sa duhet studimit për ngritjen ideologjike të tyre, pse punëra të mëdha u janë ngarkuar, janë bërë prakticienë. Mungesa e

¹ Historia e PK(b) të BS. Tiranë, 1953, f. 367.

teorisë ka shkaktuar që problemet mos t'i zgjidhim dot si duhet dhe disa herë të gabojmë. Stalini thotë:

«Teoria është eksperiencia e lëvizjes punëtore të të gjitha vendeve, e marrë në formën e saj të përgjithshme. Natyrisht teoria bëhet një gjë pa objekt, po qe se ajo nuk lidhet me praktikën revolucionare, po ashtu sikurse edhe praktika bëhet e verbër, po qe se nuk e ndriçon rrugën e saj me teorinë revolucionare. Por teoria mund të bëhet një forcë e madhe e lëvizjes punëtore, po qe se ajo formohet në lidhje të pandarë me praktikën revolucionare, pse ajo dhe vetëm ajo mund t'i japë lëvizjes sigurinë, forcën e orientimit dhe kuptimin e lëvizjes së brendshme të ngjarjeve, pse ajo dhe vetëm ajo mund ta ndihmojë praktikën të kuptojë jo vetëm se si dhe në ç'drejtim lëvizin klasat në kohën e sotme, por edhe si dhe në ç'drejtim ato duhet të ecin në të ardhmen e afërt»¹.

Në tekstin e kursit të shkurtër të «Historisë së Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik», thuhet:

«Partia Bolshevike nuk do të kishte mundur të fitonte në Tetor të 1917-s, sikur kuadrot pararojë të saj të mos e kishin zotëruar teorinë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 92.

e marksizmit, sikur ata të mos kishin mësuar ta shikonin këtë teori si një udhëheqje për veprim...¹.

Duke marrë parasysh, pra, nivelin e ulët ideologjik të Partisë sonë, duhet të marrim menjëherë masat e duhura për një punë të organizuar dhe sistematike, për të ngritur nivelin ideologjik të kuadrove të Partisë dhe ta zgjidhim këtë mungesë të madhe. Detyra kryesore e Partisë sonë është t'i përvetësojmë bazat e teorisë marksiste-leniniste, sepse, pa një përgatitje të tillë, aktiviteti i Partisë ndërpritet, rruga e Partisë errësohet dhe bëhen gabime të rënda, që i kushtojnë shumë shtrenjtë Partisë dhe popullit, prandaj jo vetëm duhet të studjojmë teorinë marksiste-leniniste, po ta përhapim këtë sa më shumë dhe në të gjitha format e mundura, në të gjitha masat e Partisë.

Duhet të merren masa të ngutshme për të forcuar Shkollën e Partisë dhe të perfeksionohen kurset e tjera në qendra; nga ana tjetër, anëtarët e Partisë e kanë për detyrë të ndihmohen dhe të inkurajohen në këtë drejtim, të mësojnë në mënyrë individuale shkencën marksiste-leniniste, të studjojnë në radhë të parë historinë e Partisë Komuniste Bolshevike. Në një vendim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik më 14 nëntor 1938 thuhet: «Metoda kryesore ku të mësojnë kuadrot marksizëm-leninizmin duhet të jetë metoda e studimit individual të historisë dhe të

¹ Historia e PK(b) të BS. Tiranë, 1953, f. 370.

teorisë së Partisë Bolshevike, që është vërtetuar në eksperiencën e brezave më të vjetër të bolshevikëve».

Anëtarët e Partisë të mësojnë bazat e marksizëm-leninizmit dhe çështjet e leninizmit, etj. Anëtarët e Partisë, kështu, të armatosur me teorinë marksiste-leniniste e luftojnë më mirë ideologjinë borgjeze. Lenini na mëson se

«çdo zvogëlim i ideologjisë socialiste, çdo largim prej saj, do të thotë njëkohësisht forcim i ideologjisë borgjeze»¹.

«Çështja shtrohet vetëm kështu: ose ideologji borgjeze ose ideologji socialiste. Rrugë të mesme këtu nuk ka»² — thotë Lenini.

Prandaj, avangarda e klasës punëtore, Partia Komuniste duhet të luftojë pa ndërprerje ideologjinë borgjeze dhe mbeturinat që ekzistojnë në vendin tonë të importuara nga Perëndimi, nga njerëzit që kanë mësuar atje. Ideologjinë borgjeze do ta gjejmë sidomos nëpër shkollat tona dhe prandaj, Partia duhet të vërë kujdesin më të madh në këtë drejtim, jo vetëm duke vënë tekste në duar të nxënësve, të bazuara në teorinë marksiste-leniniste dhe në eksperiencën e madhe të shkollës sovjetike, po duhet të edukojë dhe të orientojë trupin arësivor në rrugën e ideologjisë marksiste-leniniste. Këtë pengesë Partia jonë duhet ta kapërcejë patjetër, sepse me të është e lidhur çështja e edukimit të brezave të ardhshëm të Shqipërisë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 453.

² Po aty, f. 452-453.

Është detyrë e gjithë anëtarëve të Partisë që të studjojnë për të zgjeruar sa më shumë njohuritë e përgjithshme të tyre, të zhvillojnë intelektin e tyre dhe, në punë ku janë, të ndjekin dhe të mbarojnë shkollat. Partia gjithashtu duhet të marrë masat për të vënë në duart e anëtarëve të Partisë sa më shumë libra teorike të marksizëm-leninizmit dhe të literaturës sovjetike. Një rëndësi të madhe Partia duhet t'i vërë çështjes së botimit dhe të shtypit të Partisë, i cili duhet të luajë një rol të dorës së parë për të ushqyer masat e Partisë me lëndë të nevojshme teorike dhe për të përhapur propagandën në masat e Partisë në një shkallë më të gjerë.

E vërteta është se detyrat konkrete në këto vjetët e çlirimit dhe punët e mëdha praktike kanë bërë që të dëmtohet puna e sistemuar dhe e vazhdueshme për ngritjen ideologjike të kuadrove. Mungesa e një pune të tillë ka reperkusione të rënda në Partinë tonë. Shoku Stalin, duke theksuar rrezikun e një pune të tillë, ka thënë:

«Në qoftë se megjithkëtë fillon të çalojë për një arësye ose për një tjetër propaganda jonë e partisë, në qoftë se fillon të dobësohet edukimi marksist-leninist i kuadrove tanë, të dobësohet puna jonë për ngritjen e nivelit politik dhe teorik të këtyre kuadrove dhe vetë këta kuadro, si pasojë, nuk interesohen më për perspektivën e lëvizjes sonë, nuk kuptojnë më drejtësinë e kauzës sonë dhe bëhen njerëz vulgarë të praktikës, njerëz pa perspektiva, që i zbatojnë verbërisht dhe në mënyrë mekanike direktivat, —

atëhere duhet patjetër të dobësohet gjithë puna jonë e shtetit dhe e partisë. Duhet të pranojmë si një aksiomë se sa më i lartë është niveli politik dhe ndërgjegjja marksiste-leniniste e funksionarëve në çdo degë të punës së shtetit dhe të partisë, aq më e mirë dhe më e frytshme është vetë puna, aq më të mira janë rezultatet e punës, dhe përkundrazi, sa më i ulët është niveli politik dhe ndërgjegjja marksiste-leniniste e funksionarëve, aq më tepër shtohet probabiliteti për të meta dhe mossuksese në punë...»¹.

Partia jonë e ndjen thellë këtë mungesë dhe ka nevojë të madhe dhe urgjente që ta përmirësojë dhe ta ngrejë në një nivel më të lartë punën për ngritjen ideologjike të kuadrove.

Partia jonë dhe Komiteti Qendror i ri do të vënë të gjitha forcat për ta përmbushur këtë detyrë të madhe. Duhet të kemi kurdoherë parasysh se një parti komuniste e armatosur me ideologjinë e saj marksiste-leniniste, që do të thotë që kuadrot e saj të bëjnë përpjekje më të mëdha për t'u lartësuar dhe për të përvehtësuar marksizëm-leninizmin, kjo parti dhe kuadrot e saj nuk mund të kapen në befasi nga ngjarjet, qofshin këto të papritura, po do të dinë t'i kuptojnë këto dhe të orientohen drejt. Ngjarjet nuk duhet të tërheqin zvarrë Partinë dhe anëtarët e saj, por ata duhet të jenë kurdoherë zot të situatës dhe të veprojnë drejt në çdo situatë, se teoria është udhëheqëse për aksion dhe ajo është

¹ J. V. Stalin. Çështje të leninizmit, f. 625-626, Tiranë 1949.

forca kryesore e masave. Partia jonë, pra, që është në krye të masave punonjëse, duhet t'i edukojë dhe t'i drejtojë këto masa.

Duke pasur parasysh se Partia i mëson masat, nuk duhet të harrojmë që Partia mëson nga masat, përfiton nga eksperiencia e gjerë e tyre dhe këtej del nevoja urgjente që me anën e agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, t'i ushqejmë vazhdimisht masat e gjera të popullit tonë me frymën e ideologjisë sonë; nga kjo rrjedh gjithashtu kontakti i ngushtë dhe i vazhdueshëm i Partisë me popullin. Të gjitha tendencat antiparti, që synojnë t'i bëjnë udhëheqësit e Partisë burokratë dhe të mbyllur në vetëvete dhe me një punë të ngushtë e sektare, të çojnë në rrugën e shkëputjes së Partisë nga populli. Këta elementë me tendencë të tilla duhet të luftohen pa mëshirë, pse në qoftë se ne lejojmë që frika e tyre ndaj masave të Partisë dhe të popullit të bëhet metodë, kjo rrugë nuk të çon përveçse në tradhëti. Duhet, pra, të jemi shumë vigjilentë nga të tilla influenca, të cilat e kanë burimin në ideologjinë borgjeze. Influencat e kundërta të borgjezisë bëjnë kurdoherë presion dhe sulmojnë ideologjinë marksiste-leniniste, që është baza e Partisë sonë dhe këto bëhen me qëllim që ta shndërrojnë Partinë tonë revolucionare në një parti të tipit të Internacionales II. Të tilla mund të jenë dhe shfaqjet e dëmshme dhe të palejueshme të interpretimeve të lirisë së fjalës në parti me ngjyra dhe me forma gjoja ekstremiste. Në Partinë tonë ekziston e plotë liria e fjalës dhe e shfaqjes hapët të mendimeve, por kjo s'do të thotë aspak të sjellësh opinione të huaja brenda në parti. Të tilla mund të jenë pikëpamjet e gabuara, që synojnë të

shkatërrojnë format e stabilizuara të punës në organizatat bazë të Partisë dhe të thyerjes së disiplinës, siç janë shfaqur disa tendenca kohët e fundit, që problemet e një organizate bazë, të bëhen objekte diskutimesh për organizata të tjera bazë të Partisë. Një veprim i tillë është i dëmshëm dhe duhet të ecet drejt në rrugën që na cakton Statuti i Partisë dhe rregullat e vendosura në bazë të Statutit të Partisë.

Agjitacioni dhe propaganda e Partisë sonë nuk kanë qenë në lartësinë e duhur, përkundrazi, në to janë vërtetuar gabime, mungesa dhe lëshime. Komiteti ynë Qendror, është e vërtetë të thuhet se nuk i ka vënë rëndësinë e duhur këtij sektori, po puna këtu ka shkuar nëpër dallgë dhe është lënë në fatin e pikëpamjeve të gabuara që janë vërtetuar në Partinë tonë. Kjo gjë ka shkakuar që, si organizimi në atë sektor, si programi, kanë çaluar kurdoherë dhe ka pasur dezorientime të vazhdueshme në kuadrot që punonin në atë sektor të rëndësishëm dhe pra, dezorientim të të gjitha çështjeve të propagandës e të agjitacionit. Influenca e trockistëve jugosllavë ka depërtuar edhe këtu. Në literaturën tonë ka boll gjëra të huajtura nga jugosllavët dhe i bie barra Partisë dhe Komitetit Qendror të rishikojë të gjithë shtypin tonë dhe të pastrojë çdo gjë nga gjërat e huaja për ideologjinë marksiste-leniniste. Kjo duhet të merret me seriozitetin më të madh dhe kjo çështje s'është vetëm çështje e një komisioni, po është çështje e çdo anëtarit të Partisë, që, sipas udhëzimeve të Drejtorisë së agjitacionit dhe të propagandës, të punojë fuqimisht për spastrimin e krejt teksteve, broshurave, librave antimarksiste dhe trockiste, që na janë futur nga troc-

kistët jugosllavë. Përpara Partisë dhe Komitetit Qendror vihet detyra e rëndësishme të rishtypë dhe të shtypë libra të reja marksiste-leniniste, të kontrolluara dhe të shkruara në gjuhën e thjeshtë popullore dhe t'i vënë këto në dorën e anëtarëve të Partisë. Të përkthehen sa më shumë vepra të Leninit dhe të Stalinit, të përkthehet gjerësisht literatura sovjetike dhe në radhë të parë u vihet si detyrë anëtarëve të Partisë, mësuesve dhe gjithë nxënësve të shkollave të Shqipërisë, të mësojnë sa më shpejt dhe sa më mirë gjuhën ruse, që njerëzit tanë të marrin drejtpërdrejt kontakt me veprat teorike, me literaturën sovjetike dhe me eksperiencën e madhe të bolshevikëve.

Është e vërtetë se studimi individual, sikundërqë thamë më lart, është një mjet që kuadrot tanë duhet ta përdorin për të përvetësuar ideologjinë marksiste-leniniste. Por këtë mjet, ne dimë nga eksperiencia e madhe e Partisë Bolshevike, do ta përdorin me zor dhe jo me një rendiment aq sa dëshirojnë kuadrot e Partisë sonë, po që se janë në një nivel ideologjik dhe kultural të ulët. Një metodë e tillë, shumë e drejtë, duhet t'u shërbejë në këto momente më shumë njerëzve të Partisë që kanë një përgatitje të mirë në këtë drejtim, por për ta zhdukur këtë të metë, Partia duhet të organizojë më mirë rrethet e studimit, ku anëtarët e Partisë të studjojnë në grupe. Një gjë e tillë nuk duhet të mbetet vetëm një dëshirë, po duhet të organizohet fort dhe mirë nga ana e Partisë, me anën e Shkollës së Partisë dhe të kurseve të ndryshme, të përgatiten kuadro speciale për drejtimin e këtyre rretheve.

Komiteti Qendror duhet të përmirësojë dhe të shtojë

shtypin e Partisë. Në radhë të parë «Zëri i Popullit» duhet të bëhet një armë e fuqishme, ku të rrihen probleme të rëndësishme të vendit tonë që t'u shërbejnë Partisë dhe popullit si material i vlefshëm për edukimin e tyre dhe jo të ketë vetëm karakterin informativ. Që të mundet «Zëri i Popullit» të kryejë këtë detyrë, duhet të kontribuojnë fuqimisht anëtarët e Komitetit Qendror në radhë të parë dhe e gjithë Partia. Komiteti Qendror duhet që revistën «Agjitorin» ta bëjë një revistë, ku të rrihen probleme nga ana teorike dhe që t'u shërbejë anëtarëve të Partisë si orientim i shëndoshë, për të zgjidhur drejt çështjet dhe për t'i bërë ata të aftë, për të zgjidhur problemet e rëndësishme që u ngarkohen. Një detyrë tjetër me shumë rëndësi i vihet përpara Komitetit Qendror dhe kjo është zgjidhja e çështjes së mësimin të historisë së Partisë sonë. Deri tani kjo çështje nuk është zgjidhur dhe më të shumtën e rasteve anëtarët e Partisë jo vetëm që nuk dinë historinë e Partisë sonë, po ka pasur çorientime në këtë drejtim, ka pasur shtrembërime. Një gjë e tillë duhet të marrë fund. Gjithë mundësitë janë për shkruarjen e historisë së Partisë sonë dhe këtë nevojë të madhe duhet patjetër ta kryejë Komiteti Qendror.

FORCIMI I MËTEJSHËM I PARTISË

Sikundër e dimë, Partia, avangarda e klasës punëtore dhe e masave punonjëse të vendit tonë, udhëhoqi me sukses luftën e madhe çlirimtare të popullit tonë. Populli ynë nuk mund të luftonte dhe të korrite këto

suksese që korri, pa ekzistencën e Partisë sonë, të fortë, të disiplinuar dhe besnike deri në fund për kauzën e popullit dhe të socializmit. Partia jonë ka luftuar dhe do të luftojë nën flamurin e marksizëm-leninizmit dhe është Partia, që kondicionon sukseset e politikës sonë të drejtë të përgjithshme.

Në Kongresin XVII të Partisë Bolshevike Stalini ka thënë:

«Fitorja nuk vjen kurrë vetë, — ajo zakonisht merret me luftë»¹.

Historia e popullit tonë e vërteton edhe një herë mendimin gjenial të shokut Stalin. Populli ynë ka luftuar tërë jetën e tij për të fituar lirinë dhe të drejtat e tija. Po ai ka qenë i mashtruar, sepse nuk ka ekzistuar një parti revolucionare e dalë nga gjiri i tij i vuajtur dhe që ta drejtonte këtë me besnikëri në rrugën e revolucionit popullor. Feudalët, pelivanët politikanë në shërbim të imperializmit të huaj, elementët e borgjezisë dhe intelektualët antipopullorë kanë përfituar në çdo situatë të historisë së kaluar të vendit tonë, të dalin në krye të lëvizjeve dhe të përpjekjeve popullore dhe t'ja rrëmbejnë kurdoherë fitoren nga duart popullit, që derdhte gjak dhe këtë fitore, ta përdornin për interesat e klasave të privilegjuara në dëm të masave punonjëse.

E kundërta e kësaj ngjau pas okupacionit të 7 prillit 1939. Partia jonë Komuniste e lindur në luftë dhe e dalë nga gjiri i popullit punonjës dhe luftëtar, luftoi

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 352.

dhe fitoi, se ajo ishte avangarda e këtyre klasave, që kishte për qëllim realizimin e plotë të aspiratave të masave të popullit tonë. Që të arrihej fitorja duhej që Partia jonë të ishte një Parti e fortë. Dhe kjo u bë Parti e tillë jo me dekrete, po me heroizëm të shquar, me sakrificë të panumërta, me një devocion të papërshekrueshëm dhe me një disiplinë të çelniktë.

Pra, barra dhe detyrat e Partisë, që i vihen përpara në të ardhshmen, nuk janë aspak më të vogla nga ato, që i viheshin në kohën e luftës. Këto detyra historike Partia jonë duhet t'i kryejë dhe do t'i kryejë, kur ajo të forcohet dita-ditës më shumë.

Si detyrë kryesore na vihet përpara, pra, forcimi i Partisë sonë. Puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e bashkëpunëtorëve të tyre, me Koçi Xoxen në krye, synonin shkatërrimin dhe dobësimin e Partisë sonë, po shërimi dhe spastrimi i kësaj sëmundjeje të rëndë në Partinë tonë, zbulimi dhe luftimi i pikëpamjeve trockiste antimarksiste, antishqiptare dhe antisovjetike në gjirin e Partisë sonë, bënë që Partia jonë të forcohet edhe ca më shumë. Partia jonë doli në dritë dhe e çau rrethimin, ku fermentoheshin sëmundje të rrezikshme dhe të huaja për të. Fryma e pastër fryn tani në Partinë tonë, forca të reja dhe të mëdha janë ngritur në Partinë tonë dhe janë shtuar për t'i shërbyer Partisë më mirë në rrugën e marksizëm-leninizmit. Diskusionet në aktivet e ndryshme të Partisë, ku u punua Rezolucioni i Plenumit XI të Komitetit Qendror të Partisë, treguan forcën e madhe të Partisë sonë heroike që të ngrihet e pamëshirshme dhe të godasë trockistët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre, që kërkonin t'i bënin varrin

Partisë dhe popullit tonë. Aktivitetet e Partisë fuqimisht dhe në mënyrë revolucionare manifestuan besimin e plotë të Partia dhe Komiteti Qendror. Në këto momente të rënda, nga ku kalonte Partia, duhej luftë e ashpër dhe Partia luftoi dhe fitoi. Kjo tregon se Partia jonë është një Parti revolucionare dhe që ka në gjirin e saj me mijëra e me mijëra anëtarë që, të frymëzuar nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, mbrojnë me heroizëm Partinë dhe vijën e saj të drejtë. Partia nuk lejoi kurrë që të luhej me interesat e shenjta të saj dhe të popullit dhe Partia nuk do të lejojë kurrë që këto interesa të dëmtohen; ajo do të jetë e pamëshirshme kundër gjithë atyre që nuk do të zbatojnë ose do të shtrembërojnë vijën e saj, ligjet dhe rregullat e saja. Partia jonë, e gjallë dhe luftëtare, u çua e tëra në këmbë për të rivendosur si duhet gjithë parimet dhe rregullat e Partisë, që ishin shkelur dhe marrë nëpër këmbë. Të gjitha këto i rifitoi Partia jonë dhe s'do të ketë zot që t'ja rrëmbejë, t'ja shkelë ose t'ja shtrembërojë. Në këto do t'i mbrojmë deri në fund dhe do të triumfojmë mbi këdo që do të guxojë edhe një herë të godasë Partinë tonë, unitetin, vijën e drejtë të saj...

Prandaj, Partia jonë të shtojë dhe të forcojë vigjilencën revolucionare, të shtërngojë fort dhe të spastrojë radhët e saja e të jetë e pamëshirshme kundër deviatorëve të marksizëm-leninizmit, kundër puçistëve, kundër trockizmit dhe anarkizmit. Partia të ruajë kompaktësinë e saj dhe të luftojë me të gjitha forcat për çelnikosjen e unitetit, kundër të cilit kanë goditur dhe do të përpiqen të godasin armiqtë e Partisë sonë. Partia jonë ka korrur suksese dhe ka bërë mjaft përparime, po

kjo nuk përjashton gabimet tona dhe duhet të mos harrojmë se armiqtë tanë, imperializmi dhe fashizmi, s'i kanë hedhur armët.

Mos të harrojmë që duhet të ndërtojmë, të ruajmë dhe të luftojmë për pastërtinë e vijës së Partisë dhe për zbatimin e saj në jetë. Duhet të mos ndahemi asnjë moment nga këshillimet e shokut Stalin i cili thotë:

«Disa mendojnë se mjafton të përpunosh vijën e drejtë të Partisë, ta shpallësh atë botërisht, ta paraqesësh në formë tezash të përgjithshme dhe rezolucionesh dhe ta votosh atë njëzëri, që fitorja të vijë vetë, si të thuash, vetëvetiu. Kjo, sigurisht, nuk është e vërtetë. Ky është një gabim i madh. Kështu mund të mendojnë vetëm burokratët dhe formalistët e pandreqshëm. Në të vërtetë këto suksese dhe fitore nuk kanë ardhur vetëvetiu, por nëpërmjet një lufte të ashpër për zbatimin e vijës së Partisë. Fitorja nuk vjen kurrë vetë, — ajo zakonisht merret me luftë. Rezolucionet dhe deklaratat e mira në favor të vijës së përgjithshme të Partisë s'janë veçse fillimi i punës, sepse ato s'tregojnë gjë tjetër veçse dëshirën për të fituar, por jo vetë fitoren. Pasi të jetë dhënë një vijë e drejtë, pasi të jetë dhënë zgjidhja e drejtë e çështjes, sukse si varet nga puna organizative, nga organizimi i luftës për zbatimin e vijës së Partisë, nga zgjedhja e mirë e njerëzve, nga kontrolli i zbatimit të vendimeve të organeve udhëheqëse. Pa këtë, vija e drejtë e Partisë dhe vendimet e drejta,

ka rrezik të dëmtohen seriozisht. Për më tepër: pasi të jetë dhënë vija e drejtë politike, puna organizative vendos gjithshka, edhe fatin e vetë vijës politike, — realizimin apo dështimin e saj»¹.

Duke u bazuar fuqimisht në mësimet e shokut Stalin, Partia jonë duhet të kuptojë mirë se çështja e kuadrove është çështje decizive. Me kuadrot do të zgjidhim çdo gjë dhe pikërisht në këtë çështje me rëndësi janë vërtetuar gabime të rënda, që do të vihen në dukje në raportin tjetër. Unë do të mjaftohem vetëm t'u përmend shokëve të kongresit dhe gjithë shokëve të Partisë se çështja e kuadrit s'është vetëm një çështje e Komitetit Qendror, po e gjithë komiteteve të qarqeve e të rretheve, është një çështje e gjithë Partisë. Në radhë të parë kuadrot e Partisë, që janë kuadro udhëheqës, në qoftë se neglizhohen lidhjet me masat, ata e kanë humbur aftësinë e drejtuesit, ata nuk mund të jenë udhëheqës bolshevikë. Udhëheqësit e Partisë, që nga më i larti deri te më i ulëti, duhet t'i njohin mirë kuadrot në luftë dhe në jetë për zbatimin e vijës së Partisë. Po kjo nuk mjafton. Ata duhet ta ndihmojnë kuadrin, ta mësojnë kuadrin, të mësojnë njëkohësisht edhe nga ai; kjo do të thotë të mësojmë nga eksperienca e Partisë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të lihet kuadri në fatin e tij, i vetmuar në luftë me vështirësitë e mëdha, po duhet t'i vihet në ndihmë; kjo është barra e një udhëheqësi. Kjo gjë nuk është shikuar dhe nuk është praktikuar drejt në Partinë tonë.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 351-352.

Partia duhet të ketë kujdes nga elementët karrieristë dhe llafazanë, që depërtojnë në Parti dhe çajnë rrugën me supe dhe me fjalë dhe s'mungojnë të dëmtojnë Partinë dhe kuadrot e shëndoshë të Partisë. Partia duhet të ketë kujdes më të madh për të mos humbur mprehtësinë dhe vigjilencën ndaj këtyre njerëzve dhe të mos u besojë vende udhëheqëse nga ku ata synojnë ta dëmtojnë më mirë Partinë.

Duhet që njerëzit të ndahen dhe të ngrihen sipas zotësisë së tyre. Kjo gjë të bëhet duke marrë kurdoherë parasysh vendosmërinë e tyre për Partinë, besnikërinë ndaj marksizëm-leninizmit dhe ndaj Partisë, besnikërinë e tyre ndaj popullit tonë dhe Bashkimit Sovjetik dhe këtë ta kenë treguar me luftë dhe me vepra. Për vendosjen e kuadrit, për ngritjen dhe për ndarjen e tyre në vende të ndryshme, nuk duhet të shikohet vetëm gjendja e tyre e brendshme e Partisë, po njëkohësisht dhe lidhjet që kanë me masat këta kuadro. Kjo ka një rëndësi të madhe, sepse në Partinë tonë është nënvleftësuar kjo gjë dhe masovikë të zot janë hequr nga vende, ku populli kishte një besim të madh dhe janë çuar e mbyllur nëpër zyra teknike. Kështu humbasin për Partinë vlera të mëdha.

Nuk duhet t'i gjykojmë kuadrot vetëm sipas meritave të së kaluarës, po duhet të vlerësojmë njëkohësisht dhe meritat e reja të tyre. Për Partinë tonë kuadrot e vjetër të luftës janë koska e Partisë sonë, janë të dashur dhe të vlefshëm për Partinë tonë, sepse ata janë garancia më e madhe e Partisë sonë. Po Partia jonë e re ecën kurdoherë përpara dhe militantët duhet të ecin përpara, se atëhere është rrezik të kapërcehen. S'duhet të kemi

kurrë frikë për të shtyrë përpara kuadrot e shëndoshë të rinj, se ndryshe Partia jonë rrezikohet të vdesë.

Në Partinë tonë duhet të shtohet shpirti i iniciativës. Në asnjë mënyrë të mos pritet iniciativa e shëndoshë dhe çdo shok partie, në kuptim të mirë të vijës së drejtë të Partisë, të marrë me guxim vendime dhe ta ndjejë përgjegjësinë e plotë për detyrën dhe vendin që i ka caktuar Partia.

Në Partinë tonë duhet të çelënikoset disiplina e vetëdijshme që e ka burimin e vet në centralizmin demokratik, në demokracinë e brendshme të Partisë, në kritikën dhe autokritikën bolshevike; në Partinë tonë duhet të ekzistojë vendosmëria bolshevike dhe zbatimi i përpiktë i vendimeve të dhëna nga organet më të larta.

Përqindja e grave në Partinë tonë është shumë e paktë dhe një situatë e tillë duhet ta preokupojë Partinë, sepse gruaja është një forcë revolucionare dhe duhet të bëhet një burim i shëndoshë për kuadro Partie. Duhet zhdukur sektarizmi i dëmshëm i disa shokëve në pranimin e grave në Parti, të cilët jo vetëm që nuk i vënë kujdes kësaj çështjeje të rëndësishme, po edhe e pengojnë. Orientimi i Partisë sonë nuk mund të jetë i drejtë, kur nisemi nga parimi se nuk duhen futur në Parti gratë e shokëve, se rrezikohet që çështjet e Partisë të bëhen çështje të familjes. Partia duhet të vërë forcat për të afruar në Parti sa më shumë gra të punëtorëve, të komunistëve dhe gra të vendosura dhe revolucionare të popullit tonë. Nuk lejohet që gruas t'i mbyllet dera e Partisë, pse ajo është e martuar me një shok, pse ajo është nënë me fëmijë, etj.

Përsa u përket pranimeve, në përgjithësi, gjendja

e sotme në Parti paraqet një situatë anormale dhe të parregullt në lidhje me kandidatët për anëtarë partie. Ky anormalitet qëndron në proporcionin jo të drejtë ndërmjet numrit të anëtarëve të Partisë dhe numrit të kandidatëve. Në Partinë tonë ka 29 137 anëtarë dhe 16 245 kandidatë. Siç e shohim, numri i kandidatëve është shumë i madh. Një proporcion i tillë nuk lejohet në asnjë mënyrë të mbahet. Kjo tregon sektarizmin, tregon se po mbahen e po grumbullohen në stazhe për kandidatë, shokë që, sigurisht, kanë kondita të hyjnë në Parti. Duhet, pra, që Partia ta marrë në studim këtë çështje e ta likujdojë sa më parë këtë situatë anormale.

Pas një studimi të hollësishëm marksist-leninist, Komiteti Qendror i Partisë e gjeti të nevojshme dhe të domosdoshme t'i propozojë Kongresit I të Partisë ndryshimin e emrit të Partisë sonë Komuniste në «Partia e Punës». Ndryshimi i emrit të Partisë sonë është i drejtë dhe kjo për arsye të kompozicionit shoqëror të vendit tonë dhe të Partisë sonë, që e përfaqëson besnikërisht këtë kompozicion shoqëror të popullit. Nga analiza e punës dhe e veprës së Partisë, që bëme më lart, duket qartë se konditat e vendit tonë na imponojnë me të drejtë këtë ndryshim të emrit të Partisë. Ne dimë se në vendin tonë nuk ekziston një klasë punëtore e gjerë, sikundër që ekziston në vendet të tjera të përparuara. Klasa jonë punëtore është ende e vogël dhe sigurisht ajo do të zmadhohet dhe do të forcohet me zhvillimin e industrisë së rëndë dhe të lehtë në vendin tonë. Ne e dimë se në vendin tonë shumica e popullsisë përbëhet prej fshatarësisë, që arrin gati në 90%. Po t'i hedhim një sy gjendjes që na paraqitet dhe përbërjes së Partisë

sonë gjatë këtyre vjetëve, do të shohim se në vitin 1948 përqindja e punëtorëve në Parti nuk arrin përveçse 22,6% dhe kjo, natyrisht, është ngritur 10% më tepër nga ajo e vitit 1946. Kurse përqindja e fshatarësisë së varfër më 1948 është 54,3% dhe e asaj së mesmes 13%, kurse 10% të tjera janë intelektualë, zanatçinj, etj. Nuk mundemi t'i shmangemi këtij realiteti dhe këtij ndryshimi të emrit, që bazohet në kompozicionin social të vendit tonë dhe në shkencën marksiste-leniniste. Konsideracionet sentimentale nuk mund të qëndrojnë më këmbë përpara realitetit dhe shkencës marksiste-leniniste. Partia jonë e Punës do të jetë vazhdimi i Partisë sonë heroike Komuniste, e frymëzuar dhe e mbështetur fuqimisht në marksizëm-leninizmin; ajo do të ketë programin e saj të përcaktuar nga konditat shoqërore të vendit tonë, të udhëhequr nga marksizëm-leninizmi për triumfin e socializmit në vendin tonë. Partia jonë e Punës do të ketë ndërtimin marksist-leninist të partive të tipit të ri dhe ajo do ta udhëheqë me besnikëri klasën tonë punëtore, fshatarësinë dhe gjithë masat punonjëse të vendit tonë në ndërtimin e jetës më të mirë, në triumfin e socializmit.

Shokë, po e mbaroj raportin.

Në vija të përgjithshme u përpoqa të tregoj aktivitetin e Partisë sonë dhe të Komitetit Qendror të saj, që prej formimit të Partisë dhe deri më sot. Gjatë kësaj periudhe të gjatë në punën tonë janë vërtetuar lëshime dhe gabime. Këto Partia jonë dhe Komiteti Qendror nuk i fshehin. Partia dhe Komiteti Qendror i kanë korrigjuar dhe do t'i korrigjojnë dhe këto do të shërbejnë si mësim për të mos u përsëritur më.

Partia jonë e udhëhoqi me sukses popullin tonë në momentet më të rënda dhe të koklavitura të historisë së tij, nëpërmjet betejash të përgjakshme. Ajo në krye të popullit shqiptar mundi okupatorët, kuislingët dhe tradhëtarët dhe i siguroi atdheut dhe popullit lirinë, independencën dhe sovranitetin, vendosi në vendin tonë Republikën dhe demokracinë popullore. Nën udhëheqjen e Partisë u vendosën ligjet e popullit, u vendos push-teti i ri popullor, u rindërtua atdheu i shkatërruar nga lufta dhe nën udhëheqjen e Partisë po ndërtohet socializmi në vendin tonë. Partia jonë Komuniste, e ndër-gjegjshme për rolin e saj si udhëheqëse dhe avangardë, do të vazhdojë të luajë me forca të shumëfishuara rolin e saj historik për ta çuar popullin tonë në fitore të reja. Partia jonë Komuniste, pjella e denjë e popullit tonë punonjës, e lindur dhe e farkëtuar në luftë dhe në përpjekje, do t'i përmbushë me urtësinë më të madhe dhe me heroizëm detyrat e mëdha që i ngarkon populli dhe historia. Partia jonë, e udhëhequr nga mësimet e më-suesve të mëdhenj të proletariatit botëror, Marks-Engels-Lenin-Stalin, do ta mbrojë dhe do të luftojë për triumfin e marksizëm-leninizmit, do të ndjekë me besnikëri rrugën marksiste-leniniste, rrugën e lavdish-me të Partisë Bolshevike dhe të shokut tonë të madh Stalin. Partia jonë dhe populli ynë do të ndjekin me besnikëri rrugën e paqes dhe të sigurimit në botë, do të luftojnë me të gjitha forcat e tyre në aleancë e vëlla-zërim të pathyeshëm me të gjithë popujt dhe shtetet vëllezër e aleatë të demokracive popullore dhe me po-pujt e tjerë përparimtarë, që janë rreshtuar në kampin demokratik antiimperialist, në krye të të cilit qëndron

i pathyeshëm Bashkimi Sovjetik, përballë kampit imperialist luftëdashës dhe agresor, armik i paqes dhe i njerëzimit, pasues besnik i veprës gjakatare të fashizmit gjerman, në krye të të cilit qëndron imperializmi amerikan.

Sot Kongresi historik i Partisë sonë do të përcaktojë vijën që duhet të ndjekë Partia jonë dhe Komiteti Qendror i ri i saj në të ardhshmen. Vijën që do të caktojë Kongresi i Partisë, Partia do ta bëjë jetë dhe do ta zbatojë me përpikmërinë dhe me vendosmërinë më të madhe, sepse nga zbatimi rigoroz i kësaj vije, varet lumturia e popullit tonë, varet ndërtimi i socializmit në Shqipëri, varet sigurimi i jetës më të lumtur të brezave të ardhshëm të vendit tonë. Për këtë detyrë të rëndë dhe të shenjtë Partia jonë është e ndërgjegjshme dhe do ta kryejë me nder.

Kongresi I historik i Partisë sonë do t'i japë Partisë, Komitetin Qendror të ri dhe delegatët e Partisë sonë heroike dhe revolucionare do të zgjedhin në Komitetin Qendror të ri elementët më revolucionarë dhe besnikë të Partisë. Në Komitetin Qendror të ri duhet të vijnë njerëzit e provuar në luftë dhe në punë për besnikërinë e tyre të pafund ndaj Partisë dhe popullit, ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, ndaj kampit të socializmit në botë. Në Komitetin Qendror të ri të vijnë shokët më të vendosur, më të dashur dhe internacionalistë, të vijnë luftëtarë të paepur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit kundër trockizmit, kundër grupit trockist Tito dhe të gjithë armiqtë të brendshëm të Partisë dhe të popullit nën çdo maskë që ata mund të fshihen, të vijnë shokë luftëtarë të çështjes

së Lenin-Stalinit, që është çështja e Partisë sonë dhe e popullit tonë, të vijnë shokë që të jenë armiq të përkulur kundër imperializmit amerikan dhe anglez dhe satelitëve të tyre, të cilët përpigën t'i bëjnë varrin popullit dhe atdheut tonë. Në Komitetin Qendror të ri të vijnë shokë të zot dhe me perspektiva të gjera që të marrin në duart e tyre të çelnikta drejtimin e Partisë dhe të popullit tonë, të vijnë shokë të sprovuar dhe në radhë të parë shokë të dalë nga gjiri i klasës punëtore, shtylla e fortë e Partisë sonë, të dalë nga gjiri i fshatarësisë së varfër dhe të mesme dhe nga ata intelektualë komunistë të sprovuar në luftë dhe në punë, besnikë të Partisë dhe besnikë të klasës punëtore. Këto detyra na ka ngarkuar Partia, kur na ka dhënë mandatin për ta përfaqësuar në kongres dhe këto detyra historike ne duhet t'i përmbushim me nder, pse kemi përgjegjësi të madhe ndaj Partisë sonë dhe popullit tonë. Anëtarët e Partisë sonë heroike në asnjë moment nuk u janë shmangur përgjegjësive shumë të rënda dhe asnjëherë nuk do t'u shmangen; ata do t'i marrin këto përgjegjësi dhe do të dalin fitues për kauzën e madhe të Partisë dhe të popullit, për kauzën e socializmit.

Kongresi ynë, shokë, koïncidon me dy data historike, me datën e Revolucionit të madh të Tetorit dhe me datën e themelimit të Partisë sonë. Këto tri ngjarje historike përfaqësojnë Shqipërinë e re, përfaqësojnë lindjen e saj dhe ecjen e saj në rrugën e socializmit. . .

Rroftë populli ynë heroik!

Lavdi e përjetshme bijve dhe bijave heroike të

Shqipërisë, që derdhën gjakun e tyre pa kursyer dhe ranë në fushën e nderit për kauzën e madhe të popullit tonë dhe të Partisë sonë!

Rroftë Partia jonë heroike ngadhnjimtare, udhëheqësja besnike dhe e çelniktë e popullit tonë, që me zgjuarësi dhe heroizëm e shpuri popullin tonë në fitoren më të madhe të historisë së tij, që e shpic me urtësi dhe me vendosmëri në fitore të reja, në fitoren e ndërimit të socializmit!

Lavdi popujve të Bashkimit Sovjetik dhe atdheut të madh të socializmit, mbrojtës i pathyer i paqes dhe i sigurimit në botë, mbrojtës i lirisë dhe demokracisë së vërtetë, mbrojtës besnik i popujve të mëdhenj dhe të vegjël përparimtarë dhe luftëtar ngadhnjimtar kundër fashizmit, kundër imperializmit amerikan dhe anglez!

Lavdi Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, që ndërtoi atdheun e lavdishëm të socializmit, që ngriti dhe edukoi Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, që në saje të udhëheqjes së saj të ndritur u fitua lufta më e madhe dhe më e egër që ka parë njerëzimi deri më sot dhe që përfundoi me fitoren e plotë të Bashkimit Sovjetik mbi fashizmin gjerman dhe satelitët e tij, që u ka dhënë dhe u jep dritë gjithë partive komuniste në botë dhe gjithë popujve përparimtarë të ndërtojnë socializmin në vendet e tyre dhe të organizojnë luftën e pamëshirshme kundër armikut të tyre më të madh, imperializmit amerikano-anglez dhe satelitëve të tyre!

Jetë të gjatë dhe lavdi shokut tonë, Stalinit të madh,
mësuesit të lavdishëm të Partisë sonë dhe të gjithë pro-
letariatit ndërkombëtar!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 5(26), 6(27), 7(28), datë
9, 10, 11 nëntor 1948*

*Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë.*

FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES SË KONGRESIT I TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

22 nëntor 1948

Shokë e shoqe kongresiste,

Në emër të Komitetit Qendror të ri përshëndes kongresin dhe nëpërmjet tij gjithë Partinë tonë dhe ju sigurojmë se ne, që na besuat këtë detyrë kaq të rëndë, do ta kryejmë me besnikërinë më të madhe dhe do të jemi kurdoherë në radhën e parë për të luftuar për interesat e popullit dhe të Partisë sonë, do të luftojmë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit me vendosmërinë më të madhe, do ta duam, ashtu si na mëson Partia jonë dhe populli ynë, Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun tonë të madh Stalin. Partia jonë dhe udhëheqja e saj do të jenë në radhë të parë për të luftuar dhe për të forcuar kampin e socializmit në botë, në krye të të cilit qëndron i pamposhtur Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, Partia jonë e Punës dhe udhëheqja e saj, do të luftojnë pa u mposhtur për kauzën e paqes së njerëzimit dhe për zhvillimin e mëtejshëm e për forcimin sa më të madh të marrëdhënjeve

tona miqësore me demokracitë e reja popullore. Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj me ashpërsinë më të madhe do të luftojë, duke mobilizuar popullin, në vijën e saj të drejtë kundër imperializmit amerikano-anglez si dhe kundër të gjithë shërbëtorëve të tyre, që kërkojnë të dëmtojnë paqen, që kërkojnë të dëmtojnë kampin e socializmit, që kërkojnë të çenojnë qoftë edhe për një grimë kampin e pathyeshëm demokratik, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, që kërkojnë të dëmtojnë popullin tonë dhe Republikën tonë Popullore.

Partia jonë dhe i gjithë populli ynë do të luftojnë pa mëshirë kundër grupit nacionalist trockist Tito, që i ka sjellë Partisë sonë dhe popullit tonë dëme shumë të mëdha, do të luftojnë gjithashtu agjentët e tyre brenda në Shqipëri, do të jenë të pamëshirshëm kundër atyre dhe do t'i asgjësojnë ata, për të mirën e Partisë sonë, të popullit tonë e të socializmit.

Shokë, Kongresi I i Partisë sonë ka qenë pasqyra më e qartë e vendosmërisë, e unitetit të çelniktë dhe e pjekurisë politike të Partisë sonë që ndërmori një rrugë kaq heroike e që kishte mbi supet e veta barrën e rëndë të rindërtimit të vendit tonë të shkatërruar dhe që ka mbi supet ndërtimin e socializmit. Në këtë kongres të një rëndësie të madhe historike për popullin tonë u shfaq me të gjithë madhështinë e vet dashuria e komunistëve shqiptarë për atdheun e popullin, të cilët nuk kanë kursyer gjakun, që kanë qenë në ballë të luftës për lirinë e pavarësinë, për të siguruar mirëqenjen dhe që janë gati dhe luftojnë për ta çuar popullin tonë drejt një jete më të lumtur, në rrugën e socializmit.

Populli ynë sikurdoherë edhe në momentet më të

rënda, i ka shtërnguar radhët rreth Partisë së tij dhe ka treguar se sa besim të pakufishëm ka ai te Partia jonë.

Kongresi ynë jo vetëm që ka mobilizuar Partinë, ka çelnikosur zemrat e komunistëve, por ka mobilizuar dhe gjithë popullin tonë, i cili është në këmbë, ndoqi të gjitha punimet kaq të rëndësishme të Kongresit dhe shprehu dashurinë e madhe për Partinë tonë të Punës.

Partia jonë ndjek me besnikëri politikën e drejtë marksiste-leniniste dhe në punimet e rëndësishme të këtij Kongresi ne jemi udhëhequr nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe nga mësimet e lavdishme të Partisë Bolshevike dhe të shokut Stalin. Këta na ndritën rrugën tonë gjatë luftës, rrugën tonë për ndërtimin e një jete më të mirë për popullin tonë. Këta na ndritën rrugën e Partisë sonë dhe të Komitetit Qendror, për të shëruar plagën e madhe, sëmundjen që ekzistonte në Partinë tonë, sëmundjen e rrezikshme që na e kishin sjellë trockistët jugosllavë dhe që e kishin mbështetur me të gjitha forcat e tyre Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo.

Në dritën e mësimëve të Partisë Bolshevike, Partia jonë, e armatosur siç duhet, i goditi rëndë në kokë edhe trockistët jugosllavë edhe trockistët e brendshëm. Partia jonë e kuptoi si duhet këtë rrezik kaq të madh dhe u mobilizua e tëra për luftë, për të qëruar këto ferra dhe për të studjuar problemet e mëdha që i dalin përpara, për të përcaktuar vijën e drejtë, për të përcaktuar detyrat që ka përpara. Dhe ne mendojmë se ky kongres i shtroi të gjitha çështjet drejt.

Pikësëpari kongresi i përcaktoi Partisë sonë vijën politike, vijën organizative, vijën ekonomike, por këtë

herë një vijë të drejtë, të spastruar nga deviacionet dhe shtrembërimet, të spastruar nga tendencat trockiste që kishin hyrë në Partinë tonë. Partia jonë nga punimet e këtij kongresi mësoi dhe do të mësojë edhe më mirë se si duhet të jemi të pamëshirshëm kundër imperializmit, armikut më të madh dhe kryesor të vendit tonë, të Bashkimit Sovjetik, të kampit të socializmit. Të jemi të pamëshirshëm kundër imperializmit, i cili me çdo mjet kërkon të shtypë popullin tonë dhe të shtrojë nën veglat e tij, në robërinë më të rëndë Republikën tonë Popullore, të ndërtuar me kaq gjak, një vend ku janë zhvilluar kaq luftëra për liri, pavarësi e demokraci të vërtetë. Prandaj, Partia jonë duhet të jetë e armatosur e t'i mbajë këto armë të mprehta dhe të godasë çdo tentativë, qoftë nga jashtë ose nga brenda, të kurdisur nga imperializmi i poshtër, me në krye imperializmin amerikan. Në të njëjtën rrugë me imperialistët hyjnë të gjithë ata që janë kundër Partisë sonë dhe popullit tonë, të gjithë ata që luftojnë Partinë tonë, që luftojnë popullin tonë si dhe ata që janë të lidhur drejtpërdrejt me armiqtë e jashtëm, me imperializmin. Çdo tradhëti qoftë, atje të çon, çdo deviacion, çdo fraksion kundër Partisë sonë, është kundër popullit tonë dhe të çon në rrugën e armikut. Prandaj, Partia jonë duhet të jetë vigjilente dhe e papërkulshme, e gatshme kurdoherë të mobilizojë popullin si duhet për t'u mbrojtur nga imperializmi i huaj e agjentët e tij të brendshëm. Dhe këtë kongresi ynë e ka pasë të qartë dhe tani e ka më të qartë e do të luftojë për këtë vijë, që përfaqëson mbrojtjen e interesave të popullit tonë.

Çështjet ekonomike janë për Partinë tonë probleme

të dorës së parë, për të cilat Partia jonë duhet të vërë kujdesin më të madh. Kemi pasur shumë vështirësi në çështjet ekonomike. Kongresi ynë i vuri fare mirë në dukje. Vuri në dukje gjithashtu arësyet e shkaqet e këtyre pengesave e vështirësive ekonomike, të shkaktuara nga politika armiqësore e grupit nacionalist Tito, i cili synonte, me presione ekonomike, të zhdukte pavarësinë e popullit tonë dhe të Republikës sonë Popullore. Por njëkohësisht vështirësitë, që janë shkaktuar nga mungesat e një organizimi të shëndoshë nga ana jonë, duhet të zhduken. Prandaj, Partia jonë në çështjen e organizimit qoftë të Partisë, në radhë të parë si dhe të gjithë aparateve të shtetit, të pushtetit tonë popullor, të organizatave të ndryshme politike dhe ekonomike, duhet të orientohet në vijën e drejtë që caktoi ky kongres, ta vërë në zbatim, të luftojë për zbatimin e drejtë të kësaj vije, d.m.th. për forcimin dhe modernizimin e të gjitha aparateve të shtetit tonë dhe të organizatave të tjera të masave. Derisa organizimi ynë të jetë i shëndoshë, ne do të kemi rezultate të dukshme e të mira dhe ekonomia jonë do të përparojë si duhet, sepse ne kemi ndihmën e madhe e të sigurtë të Bashkimit Sovjetik, i cili nuk ka kursyer dhe nuk kursen asgjë që ta ndihmojë popullin tonë në ngritjen e ekonomisë së tij socialiste. Varet nga ne, nga mobilizimi i Partisë sonë dhe i popullit tonë, që ky organizim të bëhet sa më i shëndoshë dhe që ndihma e paçmueshme e Bashkimit Sovjetik që na jepet, të përdoret si duhet, që të japë rendimentin më të madh.

Që të mund të ngrejme ekonominë tonë duhet që anëtarët e Partisë të jenë në ballë të punës, të jenë

organizatorët më të mirë, të jenë njerëzit më të dashur të masave, të jenë mbrojtësit e drejtë e të pamposhtur të ligjeve të pushtetit, që përfaqësojnë drejtësinë më të madhe. Puna armiqësore e Koçi Xoxes, Pandi Kristos dhe e trockistëve jugosllavë ka lënë në vendin tonë dhe në Partinë tonë disa gjurma, të cilat nuk duhet t'i neglizhojmë aspak, por duhet t'i spastrojmë sa më parë, t'i korrigjojmë e t'i godasim ashpër.

Ne mendojmë se shokët komunistë që kanë bërë më shumë gabime në këtë drejtim, duhet përnjëherësh të shkunden nga këto gabime, jo me fjalë, por me punë, t'i japin prova Partisë se gabimet që kanë bërë po i lajnë. Dhe Partia të ketë sytë hapët, t'i ndihmojë këta njerëz të shërohen, të mos u futë shqelmin, shqelmin t'ua fusë dhe bile pa mëshirë, kur këta nuk ndërrojnë rrugë.

Partia është e armatosur dhe dita-ditës do të armatoset dhe më tepër. Kongresi ka qenë një eksperiencë e madhe. Ka pasë gabime të rënda në Parti, që na janë bërë mësim dhe Partia do të jetë e zonja të shohë çdo shfaqje dhe tendencë trockiste, do të kuptojë më mirë metodat dhe dredhitë me anën e të cilave armiqtë e brendshëm të Partisë do të përpiqen të godasin Partinë. Partia jonë është e armatosur dhe, në luftë kundër këtyre tendencave trockiste, ajo do të armatoset dhe më tepër. Partia jonë do të dijë të jetë e ndërgjegjshme, të jetë një ndihmëse e vërtetë për ata njerëz të molepsur, të sëmurë dhe do t'i ndihmojë ata. Partia jonë do të jetë njëkohësisht vigjilente, e ashpër dhe e mprehtë kundër të gjithë atyre që vazhdojnë në rrugën e gabuar

dhe që do të orvaten të dëmtojnë interesat e Partisë dhe të popullit.

Ju e dini fare mirë, nga zhvillimi i aktiveve të Partisë dhe i këtij kongresi kaq të madh të Partisë sonë, se sa në mënyrë të poshtër kanë vepruar trockistët jugosllavë në Shqipëri dhe bashkëpunëtorët e tyre të brendshëm në Partinë tonë me Koçi Xoxen në krye, të cilët janë përpjekur të armiqësojnë popullin tonë me Partinë tonë. Këta s'mundën t'ja arrinin qëllimit, se populli ynë e do dhe e ruan Partinë si sytë e ballit, se në saje të udhëheqjes së saj ai fitoi të gjitha këto dhe ai do të fitojë edhe jetën më të lumtur. Po këta armiq kanë vepruar në mënyrë konshiente, kanë dashur të armiqësojnë popullin e Veriut me Partinë tonë, me krime të poshtra, të pregatisin terrenin për planet e grupit Tito, kanë pregatitur arratisjen e disa familjeve nga malësitë për t'u grumbulluar në Jugosllavi dhe për t'i pasur ata si një armë kundër nesh, etj. Të gjitha këto janë rezultate të punës armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre në Shqipëri. Gjëra të tilla nuk i lejon Partia. Këto janë bërë pa dijeninë e Partisë, por me dijeni të plotë të trockistëve jugosllavë. Këto gabime ne duhet t'i ndreqim sa më parë dhe do t'i ndreqim. Drejtësia e vërtetë do të vendoset dhe anëtarët e Partisë duhet të jenë ata që të luftojnë me të gjitha forcat për mbrojtjen e ligjeve të Republikës sonë Popullore.

Shokë, Partia jonë është parti e klasës punëtore që udhëheq gjithë masat punonjëse. Prandaj, të mos harrojmë asnjë moment që po u shkëputëm nga këto masa, po u suallëm ashpër me popullin, po nuk i shërbyem

popullit, Partia jonë do të mbetet e izoluar, Partia jonë do të dobësohet dhe armiku do të ketë fushë për të goditur Partinë tonë dhe popullin tonë punonjës. Të luftohen të gjitha shfaqjet e arbitrarizmit, të brutalitetit që shfaqen aty-këtu, se këto nuk i lejon Partia. Kush ndahet nga populli, ai shkon në tradhëti. S'ka rrugë tjetër. Kush ka frikë nga populli, shkon përsëri në tradhëti. Dhe trockistët jugosllavë këtë vijë kishin ndjekur dhe këtë rrugë morën, bashkë me bashkëpunëtorët e tyre në vendin tonë.

Prandaj, të gjitha tendencat e gabuara dhe të sëmura, që një punë e tillë ka lënë në radhët tona, duhet me forcë të spastrohen sa më parë.

Një gjë tjetër. Duhet që shokët e Partisë sonë të bëjnë të gjitha përpjekjet për ngritjen e tyre ideologjike. Të mësojnë, të armatosen me ideologjinë marksiste-leniniste, se ndryshe nuk ecet përpara. Nuk mjafton vetëm vullnet, kurajë dhe entuziazëm, por duhet edhe dituri dhe këtë dituri të mos e presim të na bjerë nga qielli, por duhet të vëmë të gjitha forcat tona e ta përvetësojmë, ta zgjerojmë sa më parë. Partia jonë, një Parti e re, një Parti dinamike, i ka të gjitha mundësitë që ta përvetësojë, prandaj, Partia jonë duhet të ketë kujdesin më të madh që këtë problem ta zgjidhë sa më parë dhe të duket përparimi, pse kështu ne do të zgjidhim problemet më mirë dhe më drejt në interesin e popullit tonë. Dhe mbi të gjitha, shokë e shoqe kongresiste, duhet që Partia jonë të forcojë dhe të çelënikosë në zemrat e të gjithë anëtarëve të Partisë sonë dhe të popullit, dashurinë dhe besnikërinë për Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin.

T'i godasim pa mëshirë, të jemi kurdoherë të gatshëm për luftën e pamëshirshme kundër mbeturinave të fashizmit dhe të kapitalizmit këtu në vendin tonë. Për asnjë moment të mos zbutemi ndaj tyre, s'ka mëshirë për ta.

Të armatosur me këtë eksperiencë të madhe të Kongresit I të Partisë, duhet të shkojmë në organizatat e Partisë, të çojmë vijën e Partisë, të punojmë vijën e Partisë në këtë mënyrë si u punua këtu, me këtë zjarr dhe entuziazëm, me besim dhe me pjekuri, sikundër u bë këtu. Të ruhet kjo forcë e madhe që u shfaq këtu nga Partia me guxim si dhe kritika e drejtë për mbrojtjen e interesave të Partisë. Në këtë mënyrë të zhvillohet në Parti kritika dhe autokritika, ashtu si bëtë ju këtu, kur vinit në tribunë dhe mbronit Partinë, kur kërkonit të sillnit në udhëheqje të Partisë njerëzit më të mirë, më besnikë dhe më të vendosur. Këhtu do të mobilizohet Partia jonë dhe kështu do të forcohet, se të tillë njerëz ka Partia jonë.

Rroftë Partia jonë e Punës!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, Partia Bolshevike dhe shoku Stalin!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 18, (39), datë 23 nëntor 1948

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 18, (39), datë 23 nëntor 1948 .

LËNDA

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 5	V—IX
---------------------------------	------

1948

REFERAT NË AKTIVIN E PARTISË NË TIRANË MBI ANALIZËN DHE KONKLuzionET E PLENUMIT XI TË KQ TË PKSH (4 tetor 1948)	1—160
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------

- Rëndësia e letrave të Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe e Rezolucionit të Byrosë Informativë 1
- Plenumi i Beratit dhe rezultatet e tij 8
- Situata pas Plenumit të Beratit dhe tezat e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë për revizionimin e këtij 37
- Marrëdhënjet ekonomike dhe zhvillimi i tyre ndërmjet Jugosllavisë dhe vendit tonë 48
- Marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovjetik dhe qëndrimi i udhëheqjes jugosllave ndaj këtyre 78
- Analiza e Plenumit VIII të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe gabimet tona të mëdha 85
- Çështja e «fraksionit në kokë të Partisë». .. 114

FJALA E MBYLLJES MBAJTUR NË AKTIVIN E PARTISË NË KORÇË (11 tetor 1948).	161—182
----------------------------------------------------------------------------------	---------

- Disa fjalë për Koçi Xoxen, Pandi Kriston e të tjerë. 176

RAPORT NË KONGRESIN I TË PKSH «MBI PUNËN E KOMITETIT QENDROR DHE DETYRAT E REJA TË PARTISË» (8 Nëntor 1948) 183—606

I

LUFTA E POPULLIT DHE E PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR ÇLIRIM 183—325

- Gjendja e mjerueshme e popullit gjatë regjimit të Zogut 186
- Okupacioni fashist italian i vendit tonë 218
- Grupet e para komuniste në Shqipëri para formimit të Partisë 226
- Formimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe organizimi i Luftës nacional-çlirimtare. . 247
- Konferenca e Pezës dhe zgjerimi i Luftës nacional-çlirimtare 270
- Konferenca e parë e Vendit e PKSH dhe formimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare 290
- Lufta me okupatorin gjerman 297
- Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit. Ndërtimi i shtetit të ri të demokracisë popullore dhe lufta për çlirimin e plotë të Shqipërisë 312

II

NDËRTIMI I SHQIPËRISË SË RE 326—527

— Industria dhe minierat 332

— Bujqësia 337

— Blegtoria	371
— Pyjet	384
— Detyrat tona në fushën e bujqësisë	398
— Tregëtia	411
— Arësimi popullor dhe kultura	417
— Shëndetësia	438
— Forcimi i Pushtetit popullor të këshillave ..	441
— Legjislacioni dhe drejtësia	449
— Ushtria Kombëtare	453
— Arma e Sigurimit të Shtetit	457
— Politika e jashtme e Partisë sonë	462
— Lufta kundër reaksionit të brendshëm pas çlirimit.	504
— Marrëdhënjet tona me popujt e Jugosllavisë dhe lufta kundër ndërhyrjes së grupit nacio- nalist të Titos	508

III

PARTIA 528—606

— Shkatërrimi i punës armiqësore në gjirin e Partisë sonë.	528
— Partia dhe organizatat e gjera të masave ..	555
— Në lidhje me Frontin	569
— Çështja e luftës së klasave	574
— Mbl ngritjen ideologjike të Partisë	581
— Forcimi i mëtejshëm i Partisë	591

FJALA E MBAJTUR NË SEANCËN E MBYLLJES TË KONGRESIT I TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQI- PËRISË	606
-------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----